

ENVER HOXHA

VEPRA

12

PROLETARE TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

ENVER HOXHA

VEPRA

**BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE
SHQIPERISE**



ENVER HOXHA

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE - LENINISTE
PRANË KQ TË.PPSH

ENVER HOXHA

VËLLIMI

12

SHTATOR 1954 – QERSHOR 1955

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»
TIRANË, 1972

PARATHËNJE PËR VËLLIMIN 12

Vëllimi i 12-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përfshin shkrime të periudhës shtator 1954 — qershor 1955.

Në këtë vëllim hyjnë: Fjala me rastin e 10-vjetorit të çlirimit të atdheut (nëntor 1954), fjala në Kongresin e katërt të Bashkimeve Profesionale (shkurt 1955), fjala e mbylljes në Plenumin XIII të KQ të PPSH (prill 1955), raporti dhe fjala e mbylljes në Plenumin XIV të KQ të PPSH (qershor 1955), raporti në Kongresin e tretë të Frontit Demokratik (qershor 1955), diskutime në mbledhje të Byrosë Politike e të Sekretariatit të KQ të PPSH, artikuj të botuar në shtypin komunist të huaj, biseda, letra e telegrame përshëndetjeje etj. Shumica e shkrimeve të këtij vëllimi botohen për herë të parë.

Veprat e këtij vëllimi japin një pasqyrë të qartë të një vargu suksesesh që u arritën në lëmin politik dhe ekonomik në vitet 1954-1955 si pasojë e masave të rëndësishme që mori Partia në vitet e mëparshme dhe e punës vetëmohuese të masave punonjëse.

Përfundimet e arritura në plotësimin dhe tejkalimin e planeve të prodhimit industrial më 1954 dhe 1955 vendosën zbatimin me sukses të planit të parë pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik të RPSH. Në bujqësi u bënë hapa

të mëdhenj në nxjerrjen e saj nga prapambetja, në shtimin e sipërfaqeve të mbjella dhe në rritjen e prodhimit të drithërave. Rënja e blegtorisë u ndalua dhe filloi një shtim i dukshëm i numrit të bagëtisë. Punonjësve ju ndanë sipërfaqe banimi në një përqindje shumë më të lartë se vitet e tjera, u rrit në të njëjtën kohë qarkullimi i mallrave dhe u zgjeruan shkëmbimet midis qytetit e fshatit.

Të gjitha këto sollën forcimin e aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse, bashkimin e popullit rreth Partisë në Frontin Demokratik.

Vitet 1954-1955 qenë gjithashtu vite fitoresh në forcimin e pushtetit popullor, të Ushtrisë Popullore, të reparteve të Mbrojtjes së kufirit dhe të organeve të Sigurimit të Shtetit; qenë vite fitoresh në shkatërrimin e planeve dhe të veprimtarisë armiqësore të imperialistëve e të revizionistëve jugosllavë kundrejt Republikës Popullore të Shqipërisë; qenë edhe vite suksesesh të rëndësishme në fushën e arësimit, të artit e të kulturës në përgjithësi.

Një fitore tjetër e madhe e këtyre viteve është shkatërrimi i orvatjeve për revizionimin e vijës marksiste-leniniste të Partisë që bënë armiqtë brenda radhëve të saja, si Tuk Jakova e Bedri Spahiu, të inkurajuar nga përgatitjet e revizionizmit ndërkombëtar për sulmin e përgjithshëm kundër marksizëm-leninizmit.

Luftën për shkatërrimin e këtyre orvatjeve dhe për zbatimin e detyrave politike dhe ekonomike brenda vendit, PPSH e lidhi ngushtë me luftën për të ruajtur e forcuar kampin socialist dhe lëvizjen komuniste ndërkombëtare përballë planeve dhe veprimtarisë shkatë-

rrimtare e diversioniste të imperializmit, të revizionizmit jugosllav e të reaksionit botëror në përgjithësi.

Duke paraqitur dhe duke analizuar sukseset e arritura, punën e madhe të Partisë e të punonjësve për sigurimin e këtyre sukseseve, shoku Enver Hoxha në veprat e atyre viteve bën përgjithësime teorike e praktike me një përmbajtje të thellë revolucionare në drejtim të kapërcimit të vështirësive e pengesave; të vigjilencës së vazhdueshme kundrejt armiqve të brendshëm e të jashtëm të klasës, të luftës së pandërprerë kundër këtyre armiqve; të forcimit e të përsosjes të të gjithë sistemit të diktaturës së proletariatit, të çelnikosjes gjithnjë e më të madhe të bashkimit të punonjësve rreth Partisë, të luftës kundër burokratizmit; të drejtimit shkencor të ekonomisë e të shoqërisë socialiste në përgjithësi; të zgjerimit e të thellimit të arësimit e të kulturës ndër masat e gjera popullore; të rritjes së mirëqenjes së punonjësve; të forcimit të Partisë e të organizatave të masave; të zbatimit me vendosmëri të parimit të internacionalizmit proletar në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare, të solidaritetit me të gjitha forcat revolucionare dhe antiimperialiste botërore.

Këto përgjithësime dhe mësimet kanë rëndësi aktuale për punën e Partisë, të kuadrove dhe të të gjithë punonjësve në ditët e sotme.

TË RRITET MË SHUMË KUJDESI PËR KULTURËN E PAMBUKUT

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ TË PPSH¹*

7 shtator 1954

Nga diskutimet e shokëve të Sekretariatit të KQ të PPSH konstatohet se në rrethet ku kultivohet pambuku zhvillohen mbledhje të shumta e njëra pas tjetrës për çështjen e kësaj kulture. Në këtë mënyrë, kuadrove më të mirë të Partisë, të rinisë, të bujqësisë etj., u shkon koha nëpër mbledhje ku flitet e stërflitet për këtë kulturë, po megjithatë rezultatet nuk janë ato që priten. Mendoj se edhe këto mbledhje mbi zhvillimin e pambukut nuk përgatiten dhe nuk organizohen si duhet. Prandaj komitetet e Partisë në qarqe e rrethe, përpara se të bëjnë një mbledhje, të përgatitin mirë planin e punës,

¹ Në këtë mbledhje, ku merrnin pjesë edhe shokë nga baza, u analizua puna e Partisë në zonat ku mbillet pambuku në lidhje me shërbimet, vjeljen, grumbullimin dhe depozitimin e tij.

qëllimet që duhen arritur, masat politike dhe organizative, të kenë parasysh sa të jetë e mundur më pak mbledhje e më shumë rezultate, bile edhe mbledhjet të zhvillohen më tepër në fushë, në praktikë dhe shumë pak, vetëm ato që janë të domosdoshme, të bëhen nëpër zyrat e qytetit e të fshatit.

Partia, sidomos në rrethet ku mbillet e rritet pambuku, duhet të kuptojë mirë se kjo është nga bimët më të rëndësishme për popullin tonë, është lënda e parë për Kombinatin e tekstileve «Stalin» dhe lidhet me eksportet tona. Gjithashtu, duhet kuptuar mirë edhe fakti që pambuku është një kulturë delikate dhe kultivimi i tij është i panjohur për fshatarët tanë. Këto janë vështirësi që ne duhet t'i njohim e t'i përballojmë dhe jo të justifikohemi duke thënë: «neglizhojnë fshatarët». Fshatari reziston ta mbjellë ose ta kultivojë si duhet pambukun, pse nuk e njeh, nuk ka eksperiencë, prandaj dhe nuk e zbaton si duhet agrorregulloren. Por, po ta mësojmë atë si ta mbjellë këtë kulturë dhe si t'ja bëjë shërbimet deri në grumbullim, atëhere ai do të shohë leverdinë dhe me siguri do të bindet. Po u arrit kjo, fshatari nuk do ta ujitë misrin me ujët e pambukut, nuk do të mbjellë misër atje ku zhvillohet pambuk etj. Të gjithë ne po e shohim me sytë tanë se si masat gjysmake japin prodhime gjysmake, prandaj edhe kultura e pambukut në vendin tonë zhvillohet ngadalë.

Nga eksperiencia sovjetike mësojmë se zhvillimi i kulturës së pambukut kërkon kuadrin agronom të nevojshëm. Në lidhje me këtë, Ministria e Bujqësisë, komitetet e Partisë dhe Drejtoria e bujqësisë pranë Komitetit Qendror duhet të kenë një plan perspektiv për

pregatitjen e kuadrove të ulët dhe të mesëm dhe brenda një ose dy viteve të dimë sa specialistë do të kemi për një sasi të caktuar hektarësh dhe të luftohet që këta specialistë t'i sigurojmë medoemos. Mundësitë janë, njerëzit i kemi: komunistë, të rinj dhe bujq përparimtarë, njerëz patriotë që mund të mësojnë ta kultivojnë pambukun me kurajë duke luftuar edhe kundër pikëpamjeve mikroborgjeze të vënjes së interesit personal mbi interesin e përgjithshëm. Këta do të jenë specialistë, por edhe aktivistë shoqërorë, që, kur të shkojnë në aktivitet e fshatarëve, të japin jo vetëm udhëzime teknike për kultivimin e pambukut, por të jenë edhe njerëz politikë. Pra, puna nuk mund të kryhet, plani i pambukut nuk mund të realizohet, në rast se ne nuk marrim masa e të përgatitim kuadro të ulët e të mesëm bujqësorë, ose po të qëndrojmë duke pritur agronomë të lartë. Për këtë qëllim është hapur Teknikumi bujqësor në Korçë, por në vend të 50 nxënësve kanë vajtur për të mësuar vetëm 40. Kjo nuk duhet lejuar, shokë.

Këto gjëra duhen parë me seriozitetin më të madh. Krahas përgatitjes së kuadrit në shkollë, Ministria e Bujqësisë dhe komitetet e Partisë duhet të marrin masa të menjëhershme edhe për të çelur kurse agroteknike veçanërisht për pambukun. Komitetet e Partisë dhe sekretarët e organizatave bazë të caktojnë njerëzit për çdo kurs, ku të zhvillohen tema nga më të ndryshmet si për ujitje, për prashitje, për mbjelljet në vija të drejta e deri te vjelja e pambukut me dy duar. Leksionet që do të zhvillohen në këto kurse të përgatitjes me aq seriozitet sa përgatitjen edhe ato të kurseve dy dhe pesë mujore të Partisë, pse mbarëvajtja dhe realizimi i

planit të pambukut është konkretizimi në praktikë i vijës së Partisë. Në këto kurse të mos dërgohen vetëm komunistë, po edhe të rinj, patriotë, të cilëve t'u tregohet rëndësia e madhe që ka pambuku për interesin e tyre, të rrethit dhe të gjithë Republikës. Kështu me një punë të tillë do të përgatitim me qindra kuadro dhe, kur të zhvillohen konsulta e konferenca, Partia do të dijë ku të mbështetet, sepse do të ketë, përveç këtyre, edhe shumë njerëz të tjerë të përgatitur jo vetëm nga ana teorike por edhe nga ana praktike. Nën udhëheqjen e Partisë, ata përbëjnë grupe aktive dhe ndihmojnë në mbarëvajtjen e zhvillimit të pambukut.

Organizimi i mirë i punës nga ana e Partisë dhe shembulli i lartë i komunistëve, si kudo edhe në luftën për zhvillimin e pambukut, luajnë një rol të madh. Askush nuk mund të thotë se ju, shokë të rretheve e të bazës, nuk keni punuar. Fakti është se ju jeni përpjekur shumë, por rezultatet nuk janë të mira. Arësyeja kryesore që ndodh kjo është se puna e Partisë nuk organizohet si duhet dhe shembulli personal i komunistëve nuk është gjithmonë dhe nga të gjithë në lartësinë e duhur. Çdo komunist duhet ta ketë për nder që Partia atë e ka mësuar në një kurs, organizata bazë i ka caktuar një detyrë, të cilën duhet ta kryejë plotësisht dhe me shembullin e tij të mirë, t'i bëjë shembull edhe gjithë të tjerët në fshat. Në këtë mënyrë, organizata bazë do të bëhet luftarake, dhe shokët e Partisë do të zbatojnë në jetë direktivat e Komitetit Qendror. Nderin e madh që ka ai, i cili mban titullin e lartë të anëtarit të Partisë, duhet ta meritojë plotësisht me punë të palodhur atje, në fushë, në këtë front të vështirë por të lavdishëm

ku toka prodhon, gjelbëron, ku pambuku lëshon gonxhe dhe zbardhon.

Vjet, detyra që caktoi Partia ishte që ekonomitë fshatare pa krahë dhe pa kafshë pune të mos ngarkohen me shumë pambuk. Megjithatë janë vërtetuar përsëri gabime. Duket që edhe evidencat e statistikave nuk mbahen mirë, në organizatat bazë të Partisë në fshat nuk shpërndahen si duhet punët, nuk vihen në lëvizje të gjithë komunistët dhe aktivistët, për shpeshherë ato mbeten monopol i disave. Duke u nisur nga këto të meta, të marrim masa për ta organizuar më mirë punën këtë vit. Në radhë të parë Partia të tregojë kujdesin më të madh që, me rastin e mbjelljeve të vjeshtës, tokat e caktuara për pambuk të mos zihen me kultura të tjera. Ka dhe probleme të tjera që Partia duhet t'i mbajë parasysh për çdo etapë, të kërkohet llogari, por të jepet edhe ndihmë me qëllim që detyrat e caktuara për bujqësinë të zbatohen me suksesin më të madh.

E shoh të nevojshme të ngre tani një çështje shumë të rëndësishme për bujqësinë tonë, atë të ujitjes. Unë kam qenë dhe jam i mendimit se rendimentet e planifikuara në tokat me ujë kanë qenë të pakta. Kur ne kemi arritur të marrim 22 kv. misër për ha. në toka mbi ujë, është skandaloze që nga tokat nën ujë të merren 6-7 kv. për ha. Duke e parë çështjen kështu, duhet ta konsiderojmë se nuk e kemi kryer si duhet detyrën. Kooperativa bujqësore e Maminasit është e re, njerëzit atje nuk kanë eksperiencë e megjithatë marrin 22 kv. misër për ha., kurse në toka shumë të mira e të ujitshme, si është e mundur që Partia të mos e organizojë si duhet punën, që ajo ta bindë fshatarin për të bërë

vijat e ujitjes dhe bima të mos mbytet? Kjo është një dobësi e madhe për drejtuesit e Partisë. Të gjithë shokët e dinë mirë se më përpara në malësitë e vendit tonë, e vlerësonin kaq shumë ujët sa që kanë ndodhur edhe vrasje, kurse sot që shteti hapi kanale dhe çoi ujë edhe në toka ku s'kishte, duke harxhuar shuma kolosale të hollash, shpeshherë ka një indiferentizëm të madh për ujitjen. Partia i ka luftuar ato zakone barbare, por ajo duhet t'i ngrejë fshatarët në këmbë për të mbrojtur interesat e veta, ujin e vet, të cilin ta përdorin për ujitje në kohë dhe të arrijnë kështu të marrin rendimente të larta. Po që të realizohet kjo, në radhë të parë duhet të mobilizohet rinia, e cila është e gatshme të hidhet në çdo aksion ku e thërret Partia. Prandaj, të insistojmë vazhdimisht që organizatat bazë të Partisë ta ndjejnë thellë edhe përgjegjësinë që kanë për edukimin dhe mobilizimin e rinisë, pa të cilën nuk mund të ecin si duhet përpara problemet e bujqësisë, pse ato kërkojnë metoda të reja që rinia i përqafton më shpejt dhe bëhet zbatuese dhe përhapëse e tyre në masat e gjera të fshatarësisë. Ç'prisni ju, shokë të rretheve, mos vallë prisni që Ministria e Bujqësisë t'ju sigurojë njerëz të mësuar për ujitje me brazda? Jo, këto duhet t'i siguronin vetë në fshat. Tre vetë në fshat mund të gjenden dhe të interesohen që ujët t'i shkojnë tokës në kohë. Shumë njerëz nga fshatrat e Lushnjës ditën e pazarit venë në qytet, duke mbajtur në duar ndonjë gjel ose 5 kokrra vezë dhe humbasin gjithë atë kohë pune. Atëhere, si nuk paska mundësi të gjenden njerëz e të mësohen për të ujitur? Kjo duket si një punë e vogël, por është me

rëndësi të madhe, pse disa herë sipërfaqe të tëra digjen për një pikë ujë, ose ujiten me përmbytje.

Këto mësimë që nxjerrim të na shërbejnë për vitin e ardhshëm, e ashtu si këto, edhe çështje të tjera të mos i lini në harresë, shokë. Mos lejoni t'ju marrë zvarrë rutina. Punoni duke u thelluar në detyrat që u ngarkohen, i zbërtheni direktivat e KQ të Partisë, lidhini ato konkretisht me terrenin tuaj, me format organizative që ju ka mësuar Partia dhe, në rast se ka forma që nuk janë të mira ose janë statike, i zëvendësoni ato me të tjera, i ndryshoni dhe i zhvilloni në përshtatje me situatën, vendin dhe forcat e Partisë aty.

Unë jam dakord që të konsultoheni me agronomët edhe për ujitjen e pambukut. Partia duhet të kontrollojë që kjo ujitje të bëhet atje ku duhet. Masa serioze organizative mendoj të merren edhe për grumbullimin e pambukut në bazë të një grafiku të caktuar. Është urgjente të dihet se kur do të fillohet nga puna e kur do të mbarohet. Gjatë kësaj periudhe, me një organizim të mirë të hidhemi në sulm për vjeljen e pambukut. Të mos mbetet fije pambuku pa u mbledhur. Edhe ne nga lart do t'ju ndihmojmë, po puna varet më shumë nga ju shokët e rretheve. Do të venë në fshat për të ndihmuar në grumbullimin e pambukut edhe ushtarë, nxënëses shkolle, të rinj e gra nga qyteti, po kjo është gjithnjë ndihmë, kryesorja është puna e vetë fshatarëve. Kjo të sqarohet mirë dhe ndihma të koordinohet si duhet me qëllim që forcat të shfrytëzohen plotësisht. Duhet ditur se njerëzit që i venë fshatit në ndihmë, nuk e dinë se cili pambuk është i kualitetit të parë dhe cili i kualitetit të dytë. Prandaj këto duhet t'ua mësojmë dhe

grumbullimi i pambukut të bëhet sipas klasifikimit. Për këto punë të caktohen përgjegjësit, të aktivizohen përveç komunistëve edhe njerëz pa parti, të cilët të kontrollohen e të ndihmohen për të kryer si duhet detyrat. Të mos harrohen edhe çështje të tilla siç janë sigurimi i depove në kohën e duhur, kuadri që do të punojë në këto depo, instruktazhi i tij etj.

Të gjitha problemet që rrahëm në këtë mbledhje jua rekomandojmë t'i studjoni dhe t'i zbërtheni para së gjithash nga pikëpamja politike, ekonomike dhe organizative. Bëni një plan pune dhe filloni nga puna. Pas kësaj organizoni kontrollin me anë të instruktorëve, të shokëve të byrosë dhe të komitetit të Partisë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

**NGA FJALA NË PRITJEN E DHËNË NGA
AMBASADA BULLGARE ME RASTIN E FESTËS
KOMBËTARE TË RP TË BULLGARISË**

9 shtator 1954

Të dashur shokë dhe miq,

Jemi mbledhur sot këtu të gëzojmë së bashku festën e madhe të popullit bullgar, 10-vjetorin e çlirimit të Bullgarisë nga Ushtria e lavdishme Sovjetike, 10-vjetorin e kryengritjes së armatosur të 9 shtatorit 1944, kryengritje e frymëzuar, e organizuar dhe e drejtuar nga Partia Komuniste e Bullgarisë dhe Komiteti Qendror i saj, i kryesuar nga i madhi Gjergj Dimitrov.

Më lejoni që në emër të popullit shqiptar dhe të Partisë së Punës të Shqipërisë t'ju përshëndes nxehtësisht, shoku ambasador i popullit vëlla bullgar, dhe nëpërmjet jush të gjithë popullin bullgar dhe Partinë Komuniste të Bullgarisë me rastin e kësaj feste të madhe të Republikës Popullore të Bullgarisë.

Populli vëlla bullgar shkëputi përgjithmonë prangat e robërisë shekullore, ai u shkëput përgjithmonë nga bota kapitaliste dhe në Bullgari u vendos pushteti i popullit, regjimi i demokracisë popullore, u shemb për-

gjithmonë fashizmi dhe regjimi i feudoborgjezisë bullgare.

Populli ynë dhe gjithë popujt e tjerë përparimtarë ndjekin me admirim dhe gëzohen pa masë për përparimet e mëdha që ka bërë Bullgaria nën regjimin popullor dhe nën udhëheqjen e urtë e të lavdishme të Partisë Komuniste Bullgare. Faqja e Bullgarisë ka ndryshuar rrënjësisht: industria e prapambetur bullgare sot është bërë një industri e fuqishme, bujqësia lulëzon e po kthehet me sukses dhe me hapa të shpejtë në një bujqësi të përparuar socialiste. Tash më se gjysma e ekonomive fshatare në Bullgari, janë bashkuar në kooperativa dhe kjo ka bërë që prodhimet bujqësore çdo vit të shtohen me bollëk, si rrjedhim të shtohet mirëqenja e popullit bullgar. Kjo ka lejuar që qeveria bullgare të ketë hequr të gjitha triskat, të ketë ulur për shumë herë me radhë çmimet e sendeve të konsumit të gjerë, të ketë ulur taksat etj.

Populli vëlla bullgar nën udhëheqjen e partisë dhe të qeverisë së tij ka bërë një revolucion të madh kulturor dhe shoqëror dhe klasa punëtore revolucionare bullgare, në aleancë të ngushtë me fshatarësinë punonjëse, është bërë forca kryesore udhëheqëse e ndërtimit të socializmit në Bullgari.

Populli shqiptar mburret me përparimet e mëdha që ka bërë populli bullgar. Ne, shqiptarët, sot jemi aq të gëzuar sa do të jemi të gëzuar edhe në festën e 29 Nëntorit, data e 10-vjetorit të çlirimit të atdheut tonë. Të dy popujt tanë, shqiptarë dhe bullgarë, janë dashur shumë gjatë shekujve, kanë qenë të lidhur ngushtë, kanë luftuar kurdoherë për liri dhe pavarësi

dhe në ditë të këqia dhe të lumtura ata kanë qenë kurdoherë së bashku. Na kanë lidhur qëllimet dhe aspiratat e përbashkëta të lirisë, së bashku kemi luftuar dhe kemi derdhur gjak kundër të njëjtëve okupatorë armiq, otomanë e të tjerë që na kishin robëruar, që na vrisnin dhe na digjnin. Na ka lidhur karakteri, pse të dy popujt tanë kanë qenë të varfër, por liridashës, të ndershëm, të thjeshtë dhe trima. Këto lidhje kaq të ngushta dhe të sinqerta, këto lidhje idealesh, gjaku dhe karakteri, i zbukuroi, i çimentoï, i bëri të pazgjydhshme në shekuj leninizmi.

Partia juaj Komuniste dhe Partia jonë e Punës që udhëheqin fatet e të dy popujve tanë, janë dy parti motra, siç janë vëllezër të dy popujt tanë. Kam pasur mjaft herë fatin e mirë të vizitoj Bullgarinë, të takohem me shokët bullgarë, një punëtorë dhe me fshatarë, të cilët e duan pa kufi popullin tonë. E thellë ka qenë përshtypja ime përpara shfaqjes së dashurisë së madhe dhe të mirënjohjes së pafund për Bashkimin Sovjetik në çdo punonjë të Bullgarisë.

Ashtu si populli bullgar dhe populli shqiptar rilindi dhe ecën përpara, i sigurtë në të ardhshmen, duke pasur dhe përkrahjen e Bashkimit Sovjetik, të Partisë Komuniste dhe të qeverisë sovjetike.

Populli shqiptar dhe populli bullgar do ta çelniksin çdo ditë dhe më shumë miqësinë e madhe me Bashkimin Sovjetik. Populli shqiptar do të farkëtojë lidhje akoma më të ngushta me popullin vëlla bullgar, çdo ditë do ta forcojë dashurinë dhe aleancën që lidh të dy popujt tanë, aleancë që është një faktor i vërtetë paqeje në Ballkan dhe të dy krah për krah e të pandarë do të

ecim drejt fitoreve të reja. Ne i urojmë popullit vëlla bullgar suksese akoma më të mëdha në ndërtimin e socializmit!

Të rrojë miqësia e pathyeshme në mes të popullit shqiptar dhe popullit bullgar!

Të forcohet dhe të rrojë në shekuj dashuria e madhe dhe miqësia e shtrenjtë në mes të dy popujve tanë dhe të popujve të tjerë vëllezër të Bashkimit Sovjetik dhe të demokracive popullore!

Të pimë për shëndetin e popullit vëlla bullgar, për Partinë Komuniste të Bullgarisë dhe Komitetin e saj Qendror!

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TELEGRAM PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR KONGRESIT IV TË PK TË BRAZILIT

20 shtator 1954

KONGRESIT IV TË PARTISË KOMÛNISTE TË BRAZILIT

Rio de Zhaneiro

Të dashur shokë,

Komiteti Qendror i Partisë, së Punës të Shqipërisë i dërgon Kongresit IV të Partisë Komuniste të Brazilit përshëndetjet e tija të përzemërta komuniste dhe i uron suksese në zhvillimin e punimeve të tij.

Kongresi IV i Partisë Komuniste të Brazilit, që mbledhet në rrethana historike të rëndësishme, do të luajë një rol të madh në bashkimin e forcave demokratike dhe patriotike të popullit brazilian, i cili lufton për çlirimin e tij nga zgjedha e imperialistëve amerikanë.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli shqiptar e ndjekin me simpati të madhe luftën heroike të popullit brazilian për paqen, lirinë e demokracinë. Ata kanë besim se kjo luftë e udhëhequr nga Partia Komuniste e

Brazilit do të triumfojë sepse është e drejtë dhe e pandarë nga lufta që bën gjithë kampi i paqes dhe i socializmit që udhëhiqet nga Bashkimi i madh Sovjetik.

Rroftë Kongresi IV i Partisë Komuniste të Brazilit!

Për Komitetin Qendror të PPSH

Sekretari i Parë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

DISA VËREJTJE MBI ÇMIMET DHE STIMULACIONET E PRODHIMEVE BUJQËSORE E BLEGTORALE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH*

21 shtator 1954

Kam edhe unë diša vërejtje lidhur me këtë studim¹. Faktet tregojnë se problemet ekonomike janë shumë të mëdha dhe ne si udhëheqje duhet t'i studjojmë ato më thellë duke u bazuar në forcat dhe mundësitë tona.

Në fillim do të them pak fjalë për metodën e punës gjatë studimeve tona. Komisionet që po aktivizojmë për këto studime nuk po ndihmohen si duhet. Është e domosdoshme që ato të orientohen dhe të kontrollohen vazhdimisht në punën e tyre studimore. Përveç kësaj, të tregojmë një kujdes më të madh që në këto komisione të aktivizohen specialistët më të mirë për çështjet

¹ Është fjala për studimin e paraqitur nga Ministria e Tregëtisë «Mbi harmonizimin e çmimeve dhe stimulacioneve të bimëve industriale e të prodhimeve bujqësore-blegtorale», që u shqyrtua në këtë mbledhje.

që studjohen. Ne kemi njerëz që i njohin çmimet si nga ana teorike ashtu edhe nga ana praktike. Por në këtë drejtim ne nuk punojmë si duhet. Pse e them këtë? E them se ne kemi 10 vjet që jemi çliruar dhe akoma nuk kemi qenë në gjendje të caktojmë me saktësi as çmimet e naftës, gjë që nuk është aq vështirë të bëhet, pse nafta është sektor socialist dhe të gjitha proceset e punës ja njohim mirë.

Çështja e caktimit të çmimeve është me të vërtetë një labirinth i tërë, por jo e pamundur që të zgjidhet. Fakti që në mbledhjen e Byrosë Politike u ngritën shumë gjëra, që nga tregu reciprok e deri te tregu i lirë, është një gjë e mirë, por pse nuk ja kemi sinjalizuar me kohë komisionit të ngritur për studim që ai t'i kishte parasysh këto gjëra gjatë studimit të tij, pse t'i linim për t'i ngritur këtu në këtë mbledhje? Kështu nuk mund të zgjidhen të gjitha çështjet. Do të ishte më mirë që ne, pasi studjuam materialin, vërejtjet tona t'ja kishim dhënë komisionit, të cilit do t'i shërbenin për studimin e problemit. Në këtë mënyrë studimi do të ishte më i plotë.

Kisha edhe disa vërejtje të përgjithshme që mund të kihen parasysh. Pikësëpari, problemi i çmimeve është i rëndësishëm dhe nuk mund të zgjidhet menjëherë, por edhe sikur ta lëmë kështu siç është sot, do të bënim gabim. Ne e kemi organizuar punën për caktimin e çmimeve në vitin 1949, por qysh atëhere e deri tani janë vërtetuar gabime në zbatimin e parimit për ndërtimin e çmimeve. Në këtë çështje ne kemi vepruar duke parë vetëm realizimin e planeve tona të çdo viti dhe nuk kemi marrë si duhet për bazë gjendjen reale të ekono-

misë sonë. Ka pasur raste që çmimet janë caktuar pa parë mirë leverdinë ekonomike dhe, si rrjedhim, jemi dëmtuar ekonomikisht.

Që të mund të kemi një konjunkturë të drejtë çmimesh dhe ta ndjekim atë vazhdimisht, duhej të caktonim çmimet e disa prodhimeve kryesore bazë në mënyrë pak a shumë të përafërt. Këtë gjë nuk e kemi bërë si duhet, duke parë më thellë si anën politike, ashtu dhe anën ekonomike të artikujve. Të marrim për shembull çmimin e bukës. Bukës ne i kemi caktuar një çmim shumë të ulët, në një kohë kur kishim mungesa të mëdha bereqeti në treg dhe sillnim sasi të konsiderueshme nga jashtë. Ka edhe shumë çmime të tjera që nuk janë caktuar me kalem në dorë. Po kështu gjatë kësaj kohe janë shitur mallra të importuara me çmime jashtëzakonisht të ulëta, në një kohë kur industria jonë të tilla mallra i prodhon me kosto të lartë. Gjatë gjithë këtyre viteve ne nuk kemi bërë një rishikim të çmimeve që të mund t'i caktonim sa më drejt, sidomos për mallrat që importojmë, që t'u vinim çmime më të arësyeshme. Ne kemi thënë shumë herë se duhet të bëjmë sakrificë dhe në fakt kështu kemi bërë e po bëjmë, megjithkëtë për mallrat që importojmë mund të kishim vënë çmime më të larta dhe kjo të dihej, ndërsa vitin pasardhës t'i ulnim ato e mallrat të ishin më të lira.

Aktualisht ne gjendemi në një situatë të vështirë për shkak të mosrealizimit të planit dhe të detyrave për uljen e kostos. Këtu hyn edhe çështja e harmonizimit të çmimëve, të cilën ne nuk e kemi parë si duhet. Prandaj, ta shikojmë me kujdes dhe të ruhem nga shablonizmi. Komiteti i Grumbullimeve, për shembull, nuk

bën kontroll si duhet mbi çmimet. Po kështu edhe Ministria e Bujqësisë dhe ajo e Financave. Te ne nuk ka një organ qendror që të kujdeset për këtë problem kaq të rëndësishëm. Pa një gjë të tillë nuk mund të zgjidhen çështjet.

Nuk është e drejtë që ne kemi vendosur të ulim çmimin e sheqerit në një kohë kur importojmë sheqer. Kështu do të detyrohem të mos nxjerrim sheqer në tregun e lirë, gjë që do t'i nxitë fshatarët që kanë sheqer nga tregu reciprok, të ngrenë çmimet e tij. Prandaj çështjen e çmimeve duhet ta rishikojmë se si ka shkuar gjatë këtyre viteve, të zbulojmë në mirë faktorët që përcaktojnë nivelin e tyre dhe të bëjmë harmonizimin e nevojshëm në këtë fushë.

Edhe çështja e stimulacioneve është e lidhur me atë të çmimeve. Po të vendosen çmime të studjuara e të drejta edhe stimulacionet do të vendosen në baza të shëndosha. Në themi të krijohet leverdisshmëria për stimulacionet po kjo çështje duhet të shihet në kompleks. Të marrim për shembull stimulacionin e orizit, i cili në të vërtetë është i lartë. Po si e kemi marrë atëhere një vendim të tillë? Ne mund të na interesojë që edhe të importojmë oriz dhe stimulacionin e tij t'ja kalojmë gjalpfit, vajit etj. Domethënë këto stimulacione të jenë të studjuara në të tërë kompleksin e tyre.

Përsa i përket vlerës së ditës së punës, në parim kjo është një çështje e drejtë, pse që të mund t'i vëmë çmimin një prodhimi bujqësor ose blegtoral, duhet të llogaritim mirë djersën që ka derdhur fshatari për një prodhim të caktuar. Edhe tatimet, po të na venë mirë punët, ne do t'ua ulim akoma fshatarëve. Por puna është

sa ja stimulojmë dhe sa ja paguajmë fshatarit prodhimet bujqësore. Në rast se ne ja çmojmë pak, ai e paguan shtrenjtë ndërtimin e socializmit. Por edhe në ato shifra që cakton Ministria e Bujqësisë ne nuk mund të bazohemi. Kjo çështje nuk ngrihet sot për herë të parë, por ka kohë. Mirëpo, a ka marrë vallë ndonjëherë mundimin Ministria e Bujqësisë që këto gjëra t'i vërtetojë në jetë? Ne kemi me mijëra e mijëra ekonomi që janë të predispozuara për t'i verifikuar në jetë këto parime. Kështu ne do të kemi disa baza për një caktim të drejtë çmimesh, prandaj këto të dhëna janë shumë të vlefshme për Komitetin Qendror.

U ngrit këtu edhe çështja e duhanit. Unë dua të them se nga kjo kulturë ne kemi dhe duhet të kemi fitime të konsiderueshme, bile akoma më shumë se deri tani. Por ne nuk duhet të jemi dorëlëshuar dhe t'ja blejmë duhanin fshatarit sa të dojë ai. Një veprim i tillë nuk do të ishte i drejtë. Konstatohet se fshatari, për çdo hektar tokë të mbjellë me duhan, merr 107 000 lekë të ardhura, kurse nga kulturat e tjera merr më pak. Por këtu rëndojnë mjaft ditët e punës. Që duhet t'i vihet kujdes duhanit, se është një artikull shumë i rëndësishëm për eksportin tonë e na sjell të ardhura të mëdha, kjo është e drejtë. Prandaj duhet të marrim masa për të mbjellë më shumë duhan. Për këtë qëllim është e nevojshme që fshatarin ta ndihmojmë me kredi, vegla bujqësore, me kanale ujitëse, të përgatitim kuadro specialistësh për ta klasifikuar mirë duhanin, i cili, duke u eksportuar, do të na sigurojë të ardhura më të mëdha. Kjo çështje është ngritur me të drejtë shumë herë, pse duhani bashkë me kromin janë dy artikuj kryesorë të

eksportit tonë. Megjithkëtë, ne nuk duhet të harrojmë artikujt e tjerë, që nga ullinjtë e deri te portokallet. Këta artikuj ne i kemi stimuluar mirë, po për eksportimin e tyre ka rëndësi organizimi i mirë i punës dhe ambalazhimi. Të gjitha këto ne duhet t'i stimulojmë se kanë vlerë të madhe dhe të luftojmë shumë për të shtuar eksportimet tona.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

**LETËR DREJTUAR KQ TË PK TË KINËS ME ANËN
E SË CILËS I SHIPREH ATIJ KËNAQËSINË PËR
DËRGIMIN E AMBASADORIT TË PARË KINEZ
NË VENDIN TONË**

21 shtator 1954

Ardhja e ambasadorit të parë të Republikës Popullore të Kinës në vendin tonë është pritur me një gëzim të madh nga i gjithë populli dhe Partia jonë. Kjo është një ngjarje me rëndësi të madhe në historinë e popullit shqiptar dhe do të ndihmojë pa masë në përforcimin e mëtejshëm të marrëdhënjeve vëllazërore dhe të miqësisë së sinqertë që lidh të dy popujt tanë vëllezër.

Populli shqiptar e ka ndjekur me interesim luftën heroike të popullit të madh kinez për çlirimin e tij nga zgjedha e imperialistëve dhe e feudoborgjezisë së vendit, me simpati të madhe ndjek përpjekjet që po bën populli vëlla kinez për ndërtimin e jetës së tij të re, i udhëhequr nga Partia e tij e lavdishme Komuniste, me shokun Mao Ce Dun në krye.

Populli shqiptar dhe Partia e Punës e Shqipërisë i urojnë nga zemra popullit të madh kinez suksese akoma më të shkëlqyera në ndërtimin e socializmit.

Partia jonë e Punës e edukuar me idetë e internacio-

nalizmit proletar, do ta mësojë vazhdimisht popullin tonë ta shtojë dashurinë dhe miqësinë për popullin vëlla të Kinës së madhe.

Ardhja e ambasadorit kinez në atdheun tonë e ka forcuar akoma më shumë situatën politike ndërkombëtare të vendit tonë, ja ka shtuar akoma më shumë besimin dhe kurajën në punën e tij ndërtimtare. Populli shqiptar i vogël dhe i shumëvujtur shikon sa forcë të madhe i jep leninizmi, sa miq të fortë dhe të sinqertë ka. Ai është i sigurtë në jetën e tij dhe në të ardhshmen, pse ka miq besnikë Bashkimin e lavdishëm Sovjetik, Kinën e madhe të Mao Ce Dunit dhe popujt e vendeve të tjera të demokracive popullore.

Gëzimi i shokëve të Komitetit tonë Qendror, të qeverisë dhe i imi ka qenë shumë i madh, kur u takuam me ambasadorin kinez. Ne u takuam për herë të parë me të, por ishte njëlloj sikur të ishim njohur tërë jetën, pse dashuria dhe lidhjet tona janë lidhjet e thella të popujve tanë, të partive tona, lidhje që populli ynë i karakterizon duke thënë «si mishi me thoin».

Ambasadori i jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë i Republikës Popullore të Kinës nuk konsiderohet nga ne vetëm si përfaqësues zyrtar i një shteti mik, por sidomos si një shok komunist, si një anëtar i Partisë Komuniste të Kinës në vendin tonë. Prandaj nga ana jonë atij do t'i jepet çdo ndihmë e nevojshme për ta kryer më së miri misionin e rëndësishëm për të cilin është ngarkuar nga ana e partisë dhe e qeverisë së tij. Të jeni të sigurtë se përfaqësuesi i Kinës së madhe motër do ta ndjejë veten si në vendin e tij. Ne do ta njohim atë me çdo gjë në vendin tonë, do ta njohim me popullin

tonë, me luftën dhe me përpjekjet e tija dhe jemi të sigurtë se shoku ambasador dhe shokët e tjerë kinezë në vendin tonë do të na ndihmojnë pa u kursyer me eksperiencën e madhe të Partisë së lavdishme Komuniste të Kinës dhe të popullit të mrekullueshëm kinez.

Ne përfitojmë nga ky rast t'u transmetojmë të gjithë shokëve të Komitetit Qendror dhe veçanërisht shokut tonë të dashur Mao Ce Dun ndjenjat e dashurisë dhe të respektit të madh që ushqejnë populli ynë, komunistët shqiptarë dhe Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë për Partinë motër Komuniste të Kinës dhe për popullin vëlla kinez.

Me përshëndetje të përzemërta.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**PËRSHËNDETJE DËRGUAR SHOKUT
MARSEL KASHEN¹ ME RASTIN E 85-VJETORIT
TË DITËLINDJES SË TIJ**

21 shtator 1954

SHOKUT MARSEL KASHEN

Paris

Në përvjetorin e 85-të të ditëlindjes Suaj, në emër të Komitetit Qendror, Ju dërgojmë përshëndetjet më të nxehta e vëllazërore dhe Ju urojmë jetë të gjatë e shëndet për të mirën e Partisë Komuniste Franceze dhe të popullit heroik të Francës.

Partia jonë e Punës dhe populli shqiptar, që ju patën midis tyre katër vjet më parë, ushqejnë një dashuri të madhe për Ju, miku ynë i shtrenjtë, bir i shquar i Partisë Komuniste të Francës, një nga themeluesit

¹ Marsel Kashen (1869-1959), militant i shquar i lëvizjes punëtore franceze dhe ndërkombëtare, një nga themeluesit dhe adhëheqësit e PK të Francës, mik i ngushtë i Partisë dhe i popullit tonë.

e vjetër të saj, një nga militantët e shquar të lëvizjes punëtore ndërkombëtare dhe të paqes.

Partia jonë e Punës dhe populli ynë ndjekin me admirim luftën heroike që po bën populli francez e Partia juaj Komuniste për të ruajtur pavarësinë dhe sovranitetin e Francës, nderin dhe ndërgjegjen e kombit francez, që imperialistët amerikanë kërkojnë t'ja marrin nëpër këmbë, për të realizuar planet e tyre të çmendura për përgatitjen dhe shpërthimin e një lufte të re. Ne kemi besim se populli heroik i Francës, nga gjiri i të cilit kanë dalë bij të shquar si Ju, shoku Kashen, do të luftojë si kurdoherë pa u tundur për të bërë që të dështojnë planet e armiqve të popullit francez dhe të paqes në botë, e cila do të triumfojë me siguri pë për atë punon dhe lufton i gjithë kampi i paqes dhe i socializmit, me në krye Bashkimin e madh Sovjetik.

Edhe një herë, shoku Kashen, Ju urojmë jetë të gjatë, lumturi dhe plot shëndet për t'i shërbyer akoma popullit dhe atdheut tuaj!

Në emër të Komitetit Qendror të PPSH

Sekretari i Parë

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 225 (1865), 21 shtator 1954

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

MBI PËRSOSJEN E MËTEJSHME TË METODËS SË PUNËS SË PARTISË NË FSHAT

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

22 shtator 1954

Çështjet që u thanë nga shokët e tjerë sekretarë duhet të kihen parasysh, megjithkëtë, unë dëshiroj të theksoj disa gjëra që kanë të bëjnë sidomos me metodën e punës së Partisë në fshat.

Një problem me rëndësi për ne është se si procedon Partia në lidhje me kuadrot e saj dhe si përpiqen ata që të përvetësojnë e të zbatojnë sa më mirë në praktikë vijën e Partisë. Partia procedon duke e njohur mirë kuadrin, anën politike të tij, origjinën, ngritjen politiko-kulturale dhe zotësinë, e zgjedh kurdoherë njeriun me perspektivë, që ai, i ndihmuar nga Partia, me luftën e tij revolucionare, të ecë përpara dhe të kryejë detyrën. Le të marrim si shembull bujkun. Si procedon për ta

¹ Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti i Komitetit të Partisë për qarkun e Tiranës «Mbi punën e Partisë në fshat».

shfrytëzuar sa më mirë tokën? Ai, me eksperiencën e tij shekullorë, studjon ç'mund të mbillet në tokën e tij, si mund të punohet ajo, sheh forcën e kafshëve të tija, përpiqet të gjejë parmendën më të mirë, farën, e pasttron atë dhe zbaton një sërë rregullash agroteknike. Pra dhe bujku nuk ecën qorrazi. Aq më tepër Partia, puna e së cilës në fshat është shumë delikate dhe e vështirë. Në rast se Partia nuk procedon me kujdes dhe ta njohë mirë situatën e fshatit, në rast se parullat dhe direktivat lëshohen prej saj në një terren të panjohur, atëhere punët do të ecin shumë ngadalë, rezultatet tona do të jenë të vogla. Mendoj se udhëheqja e Partisë, në përgjithësi, si në Tiranë ashtu edhe në rrethet tjera, i jep rëndësi dërgimit të njerëzve në fshat, por nuk shikon si duhet cilësitë e tyre, a janë të përshtatshëm për këtë ose atë fshat dhe, në të njëjtën kohë, pak preokupacion ka nga ana e drejtuesve për t'i ndihmuar ata. Mirëpo kjo ka të bëjë me fatin e zbatimit të direktivave të Partisë, pse janë kuadrot ata që do t'i shpien direktivat në mënyrë të organizuar, do t'i zbërthejnë e do t'i zbatojnë ato duke u mbështetur, natyrisht në masat. Prandaj puna e Partisë me kuadrin në fshat është e një rëndësie të veçantë.

Në raportin që na është paraqitur flitet për fshatin e Tiranës, por duhej të na thuhej më mirë situata konkrete, përbërja e fshatarësisë, pikat e dobëta të punës së Partisë në fshat etj. Këtu flitet në përgjithësi mbi prapambetjen, injorancën, fanatizmin etj., por shtresat e popullsisë në fshat nuk analizohen. Për këtë shkak, udhëheqja e Partisë nuk është si duhet në dijeni të gjendjes në fshat, nuk di për shembull sa fshatarë të

varfër u bënë të mesëm, nëse shtohet apo pakësohet numri i fshatarëve të mesëm, cilat janë pengesat që puna politike ecën ngadalë etj. Ne i kemi të gjitha mundësitë ta njohim gjendjen në fshat, pse atje kemi organizatat bazë të Partisë dhe të rinisë, por e keqja, më duket mua, është te metoda e punës. Kur një drejtues merr kontakt me shokët e Partisë në fshat, në mos gabo hem, pak interesohet të shtrohet e të bisedojë konkretisht me sekretarin e organizatës për situatën politike e morale të fshatit, për tendencat që shfaqen, ose të marrë mendimin e sekretarit si mund të punohet në këtë drejtim etj. Për tatimet e grumbullimet shokët nuk harrojnë të flasin, ndërsa për punën e agjitacionit e të propagandës, për veprimtarinë e kulakëve, s'thellohen sa duhet.

Nuk mjafton vetëm me përshtypjet e jashtme mbi çështjet që bisedohet, duhet të depërtohet thellë në thelbin e tyre. Kështu do të gjenden në punë e sipër edhe forma e metoda më efikase të punës dhe do të përcaktohen edhe masa të drejta që duhen marrë nga Partia. Kjo ka një rëndësi të jashtzakonshme dhe duhet praktikuar që në bazë. Komunisti nuk duhet të kënaqet vetëm me konstatime, ai duhet të mendojë dhe të veprojë si udhëheqës, pse çdo komunist është një udhëheqës. Në qoftë se ndodh diçka në një familje, komunisti duhet të shohë pse ndodh, cilat janë shkaqet. Në rast se kjo ndodh dhe në disa familje të tjera të fshatit, atëhere ai duhet të mendojë mbi masat që duhen marrë në rrugë partie.

Ose le të marrim rastin kur duam të bëjmë një politikë të drejtë mbi luftën e klasës. Organizata bazë e Partisë duhet të dijë sa është forca e fshatarëve të varfër, sa është niveli i tyre politik e ideologjik, të dijë

konceptet mikroborgjeze dhe pengesat që do të hasen në zhvillimin e luftës së klasave. Po kështu, organizata bazë në fshat të dijë mirë cilët janë fshatarët e mesëm, cilët prej tyre janë më të sigurtë për t'i tërhequr në rrugën e Partisë, cilët janë fshatarët e pasur, qëndrimi i tyre politik, lidhjet, tendencat e pikëpamjet e tyre etj. Të shihet se ku qëndron fanatizmi në gratë, burrat, të rinjtë, pleqtë. ku duhet të mbështetet Partia dhe ç'forma duhet të përdoret për të luftuar kundër këtyre shfaqjeve. Të shihet çështja e pastërtisë dhe e higjienës në fshat etj.

E tërë politika e Partisë duhet të kuptohet mirë nga komunistët e fshatit, në mënyrë që ata t'i adaptojnë si duhet format e punës së Partisë. Edhe unë, si tërë shokët, jam kundër formave burokratike dhe dogmatike. Jam dakord me atë që u tha këtu se shumë forma nuk janë të përshtatshme për kushtet e sotme dhe duhen rishikuar. Po që të bëhet kjo, puna nuk varet vetëm nga lart, nga Komiteti Qendror dhe aparati i tij. Duhen përpjekje edhe nga komitetet e Partisë dhe organizatat bazë. Kjo gjë duhet kuptuar mirë. Prandaj, eksperiencia e përditshme e Partisë të na bëjë që t'i marrim këto vërejtje, t'i shohim dhe të përdorim forma e metoda të përshtatshme të punës në të gjitha drejtimet. Ndryshe, format e papërshtatshme mund të na pengojnë në ecjen tonë përpara.

Komitetet e Partisë të qarqeve e të rretheve, personalisht sekretarët, duhet t'i njohin mirë të gjithë sekretarët e organizatave bazë. Të mbahen kontakte të ngushta me ta, të bisedohet jo në formë zyrtare, por lirisht ashtu si mund të bisedojnë komunistët midis tyre për çdo gjë dhe për çdo hall të fshatit. T'u krijohet sekreta-

rëve të organizatave bazë një ambient i tillë që të mos kenë frikë t'i shtrojnë çështjet realisht. Të gjitha këto ndihmojnë për të njohur mirë situatën, me qëllim që të merren masa konkrete për ta përmirësuar atë. Kontaktet e ngushta me bazën nga ana e udhëheqësve të Partisë, bëjnë të mundur që fenomenet e ndryshme të mos gjykohen nga shfaqjet e jashtme, por mbi bazën e shkaqeve të brendshme të tyre dhe të dilet me konkluzione të drejta. Duke vepruar kështu do të ketë efekt puna e Partisë, do të zgjidhen më drejt dhe më mirë problemet. Prandaj ka rëndësi të madhe që puna politike e komiteteve të Partisë me masat, duhet të jetë më e dendur, më e studjuar dhe më e bazuar. Po, kur flasim për punë politike, të mos kuptojmë vetëm luftën në Kore ose Konferencën e Gjenevës, por të kemi një koncept më të gjerë. Me punë politike duhet kuptuar ajo punë konkrete e koordinuar për të gjithë situatën politike, të brendshme dhe të jashtme që zhvillohet nga ana e Partisë dhe e rinisë e lidhur kjo me detyrat që shtrohen dhe format më adapte që duhen përdorur në terrenin ku do të zbatohen këto detyra.

Një çështje tjetër është edhe ajo e organizimit të punës për zbatimin e detyrave. Të mos kënaqemi vetëm me përqindjet që na jepen. Direktivat, leksionet dhe informacionet politike nuk duhen lënë në fatin e vet. Komunistët që i zbatojnë këto të mos presin që format organizative t'u caktohen nga lart, po secili të mendojë me kokën e vet. Mundet që ne të japim më pak direktiva dhe detyra, po ato t'i ndjekim më mirë dhe të arrijmë që shokët e bazës të mendojnë vetë, të kenë inisiativë për organizimin e punës dhe zbatimin e detyrave.

Edhe në rrethin e Tiranës punohet, bëhen përpjekje, ka rezultate, por këto rezultate nuk duhet të dëhin njeri, pse ka mundësi të mëdha për më shumë suksese. Është e vërtetë se influenca e kryeqytetit në fshatrat e Tiranës do të ndihmonte shumë në lidhje me ngritjen politike dhe ideologjike të tyre. Komiteti i Partisë i qarkut të Tiranës, të përpiqet për të shpënë në fshat frymën revolucionare të klasës punëtore, sepse në mjaft fshatarë të Tiranës vihet re një shpirt prej tregëtari. Ne duhet ta analizojmë këtë dhe të arrijmë, për shembull, në konkluzionin se për të luftuar këtë tendencë duhet të punojmë për forcimin e kooperativave të shitblerjes etj. Përveç kësaj, komiteti i Partisë duhet të marrë masa për të zhdukur këtë plagë që mban gjallë shpirtin mikroborgjez në fshatarin e Tiranës dhe është njëkohësisht një pengesë për zbatimin praktik të vijës së Partisë në bujqësi. Të bëhet që fshatari të prodhojë sa më shumë, të fitojë dhe të lidhet sa më tepër me punën. Por nuk është e mundur të arrihen këto pa gjetur edhe kuadro të zot nga ana tregëtare dhe politike, që të mundin të zhvillojnë një punë të kulturuar në tregëtinë socialiste e njëkohësisht një punë politike me fshatarët e Tiranës. Kështu edhe për luftën kundër analfabetizmit etj. Në këtë mënyrë do të kemi më shumë suksese në fshat. Fshatarët e Tiranës kanë ndryshuar, por kjo s'mjafton. Po të punojë më mirë Partia, ata do të ndryshojnë akoma më shumë. Kjo do të arrihet me një punë edukative intensive.

U ngrit këtu çështja e gazetës, të cilën duhet ta kemi kujdes. Duke marrë parasysh se në qarkun e Tiranës ka shumë fanatizëm dhe prapambetje, roli i gazetës

bëhet edhe më i madh. Prandaj duhen marrë masa në rrugë partie dhe në rrugë shtetërore që të zgjidhet drejt përhapja, shpërndarja dhe shfrytëzimi i shtypit në fshatrat e Tiranës. Komiteti i Partisë për qarkun duhet të ketë vëmendjen më të madhe për punën politike që bëjnë në përgjithësi komitetet e Partisë të rretheve. Format e edukimit të Partisë, diskutimi i problemeve të Partisë, të jenë në lartësinë e duhur. Mbledhjet e sekretarëve të organizatave bazë të zhvillohen më serioze, më të përgatitura. Të kemi parasysh se njerëzit janë akoma me një nivel të ulët dhe kanë nevojë të ndihmohen sa më mirë. Prandaj këtyre çështjeve duhet t'u jepen rëndësi e madhe.

Një levë e fuqishme për edukimin dhe mobilizimin e masave edhe në Tiranë është organizata e Frontit. Nëpërmjet kësaj organizate të gjerë çohet vija e Partisë në masat punonjëse, të cilat bashkohen, organizohen dhe luftojnë për ta vënë në jetë këtë vijë. Kjo bëhet me anë të punës edukative dhe jo me dekrete e me urdhëra. Partia i shpjegon popullit me durim vijën e saj, i sqaron direktivat e saja, që masat t'i përqafojnë e t'i zbatojnë ato vullnetarisht dhe me gjithë zemër. Fronti nuk duhet aktivizuar vetëm me raste fushatash, por vazhdimisht në problemet që i dalin Partisë, duke i caktuar detyra në luftë kundër analfabetizmit, fanatizmit, për pastrimin e kullotave etj. etj.

Në lidhje me pranimet në Parti në raport bëhet edhe autokritikë, pse ky problem nuk është parë si duhet. Kësaj çështjeje në fshatin e Tiranës duhet t'i vëmë një rëndësi të veçantë. Është e domosdoshme, sidomos në ato fshatra ku ka shumë vështirësi, të kemi organizatë

partie ose disa komunistë. Ata mund të mos jenë dhe aq të ngritur nga ana ideo-politike, po të jenë njerëz me perspektivë, natyrisht të kenë edhe garancitë e nevojshme. Prandaj detyra jonë është t'i edukojmë të ecin përpara, po jo të mos bëjmë pranime me pretëkstin se «nuk ka njerëz». Njerëz ka dhe bile të mirë. Në një aktiv të Tiranës që shkova kohët e fundit vura re se ka sekretarë organizatash që janë njerëz të zot, dinamikë e me perspektivë dhe si ata duhet të ketë shumë në Tiranë. Të mbahen afër këta, me ta të bisedohet gjatë e gjerë për problemet e Partisë dhe t'u hapen perspektiva në punë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH.
që gjendet në AQP*

TE ZHIVILLOJME TE GJITHA LLOJET E SPORTIT DHE JO VETEM FUTBOLLIN

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

22 shtator 1954

Duke u bazuar në vendimet që kemi marrë gjatë vitit 1949 dhe në propozimet që bëhen në këtë mbledhje, unë mendoj që të hartohet një protokoll i Sekretariatit të Komitetit Qendror, ku të rikujtohen të gjitha detyrat e mëparshme, dobësitë dhe të metat që ekzistojnë në këtë sektor dhe të theksohet mirë para Partisë edhe një herë rëndësia e madhe që ka sporti e fiskultura për masat punonjëse, për kalitjen dhe shëndetin e tyre. Në këtë protokoll të vihet në dukje se sporti e fiskultura nuk vlerësohen si duhet nga vetë Partia, duke filluar që nga Komiteti Qendror e deri në bazë dhe të tërhiqet vëmendia se kështu nuk mund të ecet.

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi zhvillimin e fiskulturës në vendin tonë», paraqitur nga Ministria e Shëndetësisë.

Lidhur me zhvillimin e sportit e të fiskulturës në shkolla duhet t'i përcaktojmë detyra kategorike Ministrisë së Arësimit e të Kulturës, të cilën ta porositim që vendimet e marrura për këtë problem të zbatohen me rigorozitet. Zakonisht në shkolla organizohen aktivitete fiskulturale, por këto janë të pamjaftueshme si nga pikëpamja e masivitetit, ashtu dhe e cilësisë sportive. Rëndësi ka që të shikohet nga ana e Ministrisë së Arësimit e të Kulturës edhe baza materiale për këtë qëllim. Përveç fondeve që mund të përdoren nga shteti, duhet nxitur edhe inisiativa e vetë nxënësve, pse shumë gjëra mund të bëhen me forcat e tyre, nëpërmjet aksioneve, siç janë terrenet sportive për të zhvilluar disa lloje sportesh.

Shoqëritë sportive që janë ngritur duhet të zhvillojnë të gjitha llojet e sportit dhe jo vetëm futbollin. Për shembull, në qendrat e prodhimit të zhvillohen ato lloj sportesh që i përgjigjen më mirë karakterit të punës. Në një ndërmarrje, ku punëtorët punojnë tërë ditën në këmbë, duhet të organizohen ushtrime të tilla sportive që zhvillojnë gjoksën dhe duart. Ose, me artizanët që punojnë tërë ditën ulur, është e nevojshme të zhvillohen të tjera lloj aktiviteteve sportive e fiskulturale etj. Kështu duhet parë, mendoj unë, zhvillimi i sportit në qendrat e punës, në fshat, në shkolla e kudo. Në planin e tyre shoqëritë duhet të caktojnë konkretisht llojet e sportit dhe në përputhje me këtë të harxhojnë edhe fondet e caktuara. Kjo është e domosdoshme, pse ndryshe mendohet e shpenzohet vetëm për futboll. Pra, buxheti që do t'i caktohet një shoqërie duhet të destinohet për zhvillimin e të gjitha llojeve të sportit dhe, mbi

këtë çështje, të ushtrohet kontroll. Ndryshe do të bëhet ashtu si duan tifozat e një lloj sporti dhe, kërraba do të tërheqë nga futboll, duke mbetur pa u zhvilluar si duhet sportet e tjera, që nga atletika e deri te lodrat popullore, që nga noti e deri te skitë etj.

Mjetet sportive, të cilat nuk i kemi me shumicë, ka mundësi të përdoren racionalisht nga të gjithë. Kështu, mjetet që ka SHNUM¹ t'i përdorë edhe shoqëria «Dinamo» dhe anasjelltas. Mendoj t'i propozojmë qeverisë që të rishikojë mundësinë e shtimit të fondeve në buxhetin e fiskulturës. Edhe çmimet e biletave të aktiviteteve sportive të ulen dhe këto të ardhura të përdoren për investimet e nevojshme për bazën materiale sportive. Përveç kësaj t'i rekomandojmë qeverisë që palestra e Shkodrës të ndërtohet, por të kihet parasysh që të mos lakmohet për gjëra të mëdha, përkundrazi, në kërkesa të jemi të thjeshtë. Edhe stadiumi i Korçës duhet të mbarojë. Në Tiranë mendoj se duhet të kemi jo vetëm qendër sportive, por të krijohen edhe disa fusha të vogla të pajisura me materialet e nevojshme. Të merren masa për administrimin e mirë të fushave sportive nga vetë shoqëritë, por të organizohet edhe kontrolli nga ana shtetërore. Të ndiqet zbatimi i vendimit për rrethimin e fushave kryesore, për kanalizimet e tyre etj.

Në të gjitha këto drejtime, si për ruajtjen e bazës materiale ashtu dhe për zhvillimin e fiskulturës, duhet të interesohet veçanërisht organizata e rinisë, pa pjesë-

¹ Shoqëria në ndihmë të ushtrisë dhe të mbrojtjes u krijua më 1949, e cila, nga kalimi në formë të tjera organizimi për mbrojtje, u shpërnda më 1965.

marrjen e së cilës s'ka sport e fiskulturë. Sidomos në fshat, organizata e rinisë duhet të ketë më tepër kujdes. Të luftohet kundër tendencave e koncepteve që pa fonde s'ka fiskulturë. Edhe fonde do të përdorim, por ne duhet t'i shtrijmë këmbët sa kemi jorganin, të punojmë sipas konditave tona.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TË PËRMIRËSOJME MË TEJ PUNËN E ORGANEVE TË DREJTËSISË

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

28 shtator 1954

Ju, tre titullarët e organeve të drejtësisë², duhet të forconi lidhjet me aparatin e Komitetit Qendror dhe me sekretarin që drejton këtë sektor. Po kjo nuk do të thotë që të mos keni kontakt edhe me mua. Unë do të jem shumë i kënaqur të vini e të bisedojmë probleme mbi zbatimin e politikës së përgjithshme në organet e drejtësisë, të diskutojmë së bashku, unë të mësoj nga ju dhe, në të njëjtën kohë, të përpiqem të jap edhe ndihmën time. Gjithashtu edhe nga ana jonë ju mundet dhe duhet të thërriteni për probleme të ndryshme të politi-

¹ Në këtë mbledhje u analizua relacioni «Mbi zbatimin e vendimit të Byrosë Politike mbi të metat në punën e organeve të drejtësisë dhe masat që duhen marrë për likuidimin e tyre».

² Ministri i drejtësisë, prokurori i përgjithshëm dhe kryetari i Gjykatës së Lartë.

kës penale. Për vërejtjet që mund të kenë Byroja Politike ose Sekretariati mund të thërritet ministri i drejtësisë, kryetari i Gjykatës së Lartë ose prokurori i përgjithshëm dhe t'u vihen në dukje ato.

Përveç marrëdhënjeve në rrugë partie, rëndësi të madhe kanë edhe lidhjet tuaja shtetërore me Presidiumin e Kuvendit Popullor, përpara të cilit ju jeni direkt përgjegjës. Prandaj Presidiumi herë pas here t'ju thërrasë dhe ju t'i raportoni për çështje të caktuara, nga të cilat të nxjerrë konkluzione. Përgjithësimet në organet e drejtësisë kanë një rëndësi të madhe. Po të arrini ju që nga e gjithë puna që zhvillon në gjykimin e çështjeve, të nxirrni konkluzionet përkatëse dhe t'ja referoni këto Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe Komitetit Qendror të Partisë, do të bëni një punë shumë të mirë. Kjo ka rëndësi shumë të madhe. Çështja e nxjerrjes së konkluzioneve, sidomos nga Gjykata e Lartë, shërben së tepërmi për edukimin e të gjithë kuadrit të gjykatave në lidhje me zbatimin praktik të ligjeve të shtetit dhe të kulturës gjyqësore. E gjithë eksperiencia praktike grumbullohet në Gjykatën e Lartë. Këtej duhen nxjerrë konkluzione për t'ua shtruar gjyqtarëve në bazë të një plani. Pastaj ju, shokë të drejtësisë, duhet të shfaqni edhe mendimet tuaja në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë e t'i thoni Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe Komitetit Qendror që të marrin masa për rishqyrtimin e këtyre ose atyre çështjeve. Në këtë mënyrë do të mund ta ruajmë të pastër vijën dhe njëkohësisht do të bëjmë më mirë edhe punën për edukimin e kuadrit.

Në gjykimin e çështjeve, Partia, të gjithë ne, sekretarët e anëtarët e Komitetit Qendror, duhet të kemi

parasysh se ligjet tona pasqyrojnë vijën e Partisë, prandaj zbatimi i tyre do të thotë zbatimi i vijës së Partisë. Por kjo kërkon të forcojmë, përveç të tjerave edhe punën kolegjiale. Konsultimet me Partinë janë të nevojshme, por si gjyqtarët, ashtu dhe drejtuesit e Partisë duhet të kuptojnë mirë se deri ku e kanë kufirin e punës së tyre, deri ku mund të veprojnë gjyqtari pa u këshilluar me Partinë, dhe deri ku ai nuk mund të veprojë pa qenë nevoja të marrë mendimin e Partisë.

Të marrim një shembull. Implikohet në një çështje një komunist. Sigurisht, çështja e tij nuk duhet mbyllur, pse përpara ligjeve të gjithë njerëzit janë njësoj. Por meqë kemi të bëjmë me një komunist, a nuk duhet vënë në dijeni Partia, e cila ndofta mund ta shqyrtojë më parë këtë çështje në organizatën bazë? Pastaj, ky njeri të hidhet në gjyq. Mund të ndodhë që dikush të bëjë përpjekje për t'i mbuluar fajin ndonjë personi, por kur gjyqtari është i bindur, pse ka argumenta që vërtetojnë akuzën, atëhere le të bëjë punën e vet, në pavarësi të plotë, pa ndërhyrjen e asnjërit, pa u influencuar nga asnjë shok qoftë edhe më me përgjegjësi. Por duhet ditur edhe ana tjetër që në rast se ndonjë gjyqtar ose prokuror nuk ka faktet e duhura ose i fryn ato që ka dhe jep dënime të pagjykuara mirë, atëhere Partia kundër tij merr masa. Kështu veprohet edhe kur jemi përpara ndonjë dëshmie të rreme, që i pandehuri mbrohet ose kundër tij shpifet pa baza. Pra, siç shihet, këto çështje janë me përgjegjësi të madhe. Kryesorja është që si Partia, ashtu edhe gjyqtarët të kuptojnë mirë se nuk mund dhe nuk duhet të pengohet zhvillimi i gjyqeve dhe zbatimi i ligjeve. Për cilindo që bën gabim në këtë

drejtim të merret masë, lëshime nuk mund të bëhen për asnjë njeri.

Edhe për vjedhjet kërkohen përcaktime më të drejta. Mendoj se nuk duhet futur në kategorinë e hajdutëve e të dënohet si i tillë edhe një person që vjen e thotë vetë se ka bërë faj duke dëmtuar pasurinë socialiste nga pakujdesia e tij. Ndaj një njeriu të tillë, të singertë e thellësisht të penduar, të merren masa administrative dhe jo penale. Edhe kur në veprën e njerëzve të penduar ka elementë krimi, po të gjykohet se shkalla e rrezikshmërisë së tyre dhe e veprës nuk është e atillë sa të paraqesë nevojën e izolimit nga shoqëria, mund të dënohet me kusht.

Përsa i përket çështjes së shitjes së mallrave me çmime më të larta nga matrapazët, që ngriti këtu kryetari i Gjykatës së Lartë, në fakt kjo është spekulim, por në trajtimin e këtij problemi duhen marrë parasysh veçoritë tona, se ne akoma nuk kemi një industri të tillë që të plotësojë kërkesat dhe të mos jetë nevoja e tregut të vogël privat. Tregëtinë e vogël private ne e kemi lejuar me ligj. Në rast se spekulimi, për të cilin po flasim, përbën një problem me rëndësi, ligjet i kemi dhe të merren masat. Ndonjëherë spekulatorët edhe mund t'i godasim, po shitësin e vogël privat që ka në tezgën e tij një ombrellë dhe e shet me çmim të lartë mendoj se në rrethanat e tanishme nuk duhet ta dënojmë. Shitësi privat nuk të nxjerr shumë mallra në dyqan, prandaj shet vetëm një dhe po e zure do ta dënosh vetëm për atë, por për një send me vlerë të vogël, me 3 vjet burg nuk e dënon dot. Është tjetër punë kur kapet një matrapaz që bën shumë spekulime të tilla, dhe me anë të

goditjes së tij do të japësh shembull edhe në tregëtarët e tjerë, në këtë rast duhet vepruar, por pa e përgjithësuar goditjen se ndryshe do të bësh dëm, në vend që të bësh mirë. Thuhet se privatët marrin shisheet e flitit për t'i shitur, po nga ato ka marrë edhe populli sa të duash. Po sa shisheet fliti ka marrë matrapazi nuk e përcakton dot saktë që të mund të bëhet goditja e drejtë kundër tij. Po ta shohësh si shtet këtë blerje matrapazësh, mua më duket se ata kanë marrë pak. Atëherë çfarë politike penale mund të bëjmë kundër këtyre njerëzve? Ka sigurisht njerëz të tillë që janë më të liq se të tjerët dhe prokuroritë duhet t'i gjurmojnë, këta janë matrapazët e regjur që nuk kanë në kurrizin e tyre vetëm ombrellat po edhe faje të tjera të rënda. Ndonjë njeri i tillë t'i jepet gjyqit dhe për dënimin e tij të shkruajë edhe shtypi.

Përsa i përket zbatimit të vendimeve të gjyqeve duhet t'u thuhet shokëve të sektorit të policisë të Ministrisë së Punëve të Brendshme t'i zbatojnë menjëherë.

Edhe unë jam i një mendimi me shokët e tjerë që si në gjykatat ashtu edhe në prokuroritë ka përparime dhe bashkëpunimi midis tyre po forcohet. Puna kolegjiale e gjykatave dhe edukimi i gjyqtarëve e i prokurorëve me të gjitha format që kemi vendosur ka bërë përparime. Ju duhet të përpiqeni që çdo gjykim të shërbejë për edukimin e kuadrove dhe të masave. Me gjithë pengesat, vështirësitë dhe javashllëkun në gjykim që akoma vihen re në organet e drejtësisë, prapë janë arritur suksese dhe ne konstatojmë me kënaqësi se njerëzit, punonjësit e këtyre organeve, po mësojnë. Shumë gjyqtarë në gjykatat e qarqeve i kemi njerëz me

shkollë dhe një pjesë nga të vjetrit, që nuk po ecin dot përpara, gradualisht, do t'i zëvendësojmë. Shokët që përgatiten në kursin dyvjeçar të drejtësisë, kur të mbarojnë, duhet t'i shpërndajmë mirë nëpër gjykatat e të gjitha shkallëve, në prokurori dhe në Ministrinë e Drejtësisë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

ZBATIMI I VENDIMIT KËRKON EDHE INISIATIVË E VETËVEPRIM

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

28 shtator 1954

Çështjet që diskutuam në këtë mbledhje kanë shumë rëndësi, prandaj organizata e Partisë dhe drejtoria e Kombinatit të tekstileve «Stalin» duhet të interesohen më tepër për to.

Ne, si Sekretariat, nuk mund të dalim mbi Byronë Politike dhe mbi qeverinë dhe të marrim vendim, por duhet të kontrollojmë se si janë zbatuar vendimet nga ata që janë ngarkuar. Duke e bërë këtë edhe për vendimin që u muar nga Byroja Politike lidhur me forcimin e mëtejshëm të punës në Kombinatin e tekstileve

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth relacionit të paraqitur nga Drejtoria e industri-ndërtimit pranë aparatit të KQ mbi zbatimin e vendimit të Byrosë Politike të KQ të PPSH të 3 majit 1954 «Për forcimin e mëtejshëm të punës në Kombinatin e tekstileve «Stalin».

«Stalin», mund të arrijmë në konkluzion se ky vendim nuk është zbatuar si duhet dhe kjo duhet t'ju preokupojë ju, shokë të kombinatit, pse keni përgjegjësi të madhe, ashtu siç ka edhe vetë Ministria e Industrisë. Të marrim për shembull çështjen e sovajkave, prodhimi i të cilave ka 6 muaj që po sorollatet. Mua më duket se për këtë problem akoma nuk po punohet me llogari dhe përgjegjësi. Druri i shkozës ekziston dhe kjo çështje mund të zgjidhet brenda një kohe të shkurtër, por vazhdon të neglizhohet. Prandaj duhet më tepër inisiativë dhe një kujdes më i madh, e jo të qahemi kaq shumë për vegla këmbimi, në një kohë që shumë prej tyre mund t'i prodhojmë në vend. Ne konstatojmë me kënaqësi se punëtorët tanë, megjithëse akoma nuk janë dhe aq të kualifikuar, na bëjnë shumë propozime në këtë drejtim. Po prodhimi i sovajkave, a nuk mund të bëhej në vend një vit më parë?

Detyrat që përcaktohen në një protokoll të Byrosë Politike duhet të kontrollohen më mirë e të zbatohen deri në fund nga aparatet e Komitetit Qendror. Kur këto aparate konstatojnë se një vendim nuk po zbatohet, duhet të nxjerrin edhe detyra, pavarësisht se janë caktuar detyra edhe më parë. Gjatë zbatimit të një vendimi mund të bëhen vërejtje, propozime etj., të cilat Byroja Politike i shikon dhe del me konkluzione. Por vendimi duhet të zbatohet. Me ç'të drejtë Komisioni i Planit, Ministria e Industrisë dhe ajo e Arësimit anulojnë një masë me rëndësi që merr Byroja Politike për hapjen e teknikumit të mbrëmjes dhe ne s'na jepet asnjë sinjalizim? Nuk mund të lejohet cilido që të shkelë një vendim të Byrosë Politike, gjë që mund ta bëjë vetëm

Komiteti Qendror. Të gjithë të tjerët, kushdo qoftë, duhet ta zbatojnë.

Përsa u përket veglave të këmbimit, shpejtësia e sigurimit të tyre varet në radhë të parë nga ju, shokë të kombinatit, dhe nga Ministria e Industrisë. Lufta për sigurimin e tyre në vend, me forcat tona nuk përjashton interesimin nga ana e Ministrisë së Tregëtisë së Jashtme. Por ne nuk duhet t'i varim të tëra shpresat në import. Byroja Politike e studjoi këtë çështje dhe bashkë me qeverinë do të marrin masat për t'i siguruar kombinatit një rezervë të vogël gjashtëmujore që të mos ndërpritet prodhimi. Por e theksoj dhe një herë se ekzistojnë shumë mundësi që teknikët tanë, në bashkëpunim të ngushtë me punëtorët, të mendojnë, të propozojnë dhe të marrin inisiativa për të prodhuar vetë vegla këmbimi. Partia në kombinat të tregojë një kujdes të veçantë që ato vegla, të cilat mund të prodhohen këtu, të bëhen sivjet dhe jo pas një viti. Ministrisë së Industrisë nuk i lejohet të neglizhojë për nevojat që ka kombinati lidhur me sigurimin e veglave të këmbimit.

Puna në kombinat nuk është aq e thjeshtë. Nuk është vetëm çështja e veglave të këmbimit që na ngrihet orë e çast nga shoqja Eleni¹, po ka edhe gjëra të tjera. Sigurisht veglat e këmbimit lozin një rol shumë të rëndësishëm në ecjen përpara të punës, sepse bezja do të bëhet me maqina, por nuk duhen lënë pasdore edhe çështjet e tjera. Dobësitë nuk duhet të mbulohen. Edhe nga ato pjesë këmbimi që kanë ardhur, shumë janë

¹ Eleni Terezi (Pashko), atëhere drejtore e Kombinatis të tekstileve «Stalin».

prishur nga pakujdesia, pse hidhen andej-këtej, nuk përdoren mirë. Ne nuk kemi pretendime se punëtorët e kombinatit me 2-3 vjet janë bërë të kualifikuar, por duam të themi se detyrat që ka vendosur Byroja Politike në këtë fushë nuk po zbatohen si duhet. Kështu ka edhe çështje të tjera. Pra nuk janë vetëm pjesët e këmbimit që mungojnë në kombinat por ka edhe mungesa organizimi e kontrolli në punë nga ana e komitetit të Partisë dhe drejtorisë së kombinatit për të ruajtur si duhet veglat e këmbimit dhe maqinerinë që kemi.

Ju e dini mirë se, kur thuhet të ruhet dhe të shfrytëzohet në maksimum maqinaria, duhet të merren të gjitha masat organizative për këtë qëllim. Veç kësaj, duhet të punojnë mirë shkollat, kurset, të forcohet disiplina në punë, disiplina teknike etj. dhe të gjitha këto janë në dorën tonë, varen nga ne. Unë nuk them se në kombinat s'ka përmirësime, po më duket se ka mundësi të bëhet më shumë. Prandaj vërejtjet e shokëve në këto drejtime si dhe mendimet e shfaqura në relacionin e aparateve të Komitetit Qendror, janë interesante dhe të drejta dhe duhen zbatuar si nga ana e drejtorisë, ashtu edhe nga komiteti i Partisë i kombinatit. Nga konstatimet e përditshme në punë, duhet që komiteti i Partisë, që është udhëheqja e kombinatit, të nxjerrë konkluzione dhe të marrë masat përkatëse, duke mobilizuar organizatat bazë të Partisë, bashkimet profesionale, rininë etj. Po të veprohet kështu, detyrat do të zbatohen më mirë, pse për ato do të vihet në lëvizje forca e madhe e klasës punëtore. Punëtorët kanë nevojë për sqarim dhe për ndihmë dhe po u bë kjo, nuk ka detyrë që të mos kryhet. Duhet të merret eksperiencia

praktike në radhë të parë nga punëtorët pastaj nga punonjësit e tjerë, nga specialistët e teknikët dhe e gjithë kjo eksperiencë e pasur të studjohet nga komiteti i Partisë, i cili ka një rol të madh në këtë drejtim. Ai duhet të nxjerrë e të përgjithësojë eksperiencën e mirë, të analizojë dobësitë, të theksojë shkaqet e dobësive dhe të marrë masa. Në këtë kompleks çështjesh, kanë rëndësinë e tyre edhe «gjërat e vogla» si ushqimi për punëtorët etj. Këto nuk duhet të neglizhohen, pse influencojnë në disiplinën, në rregullin, në realizimin e planit etj. Po të shihen kështu të gjitha çështjet, punët do të venë më mirë.

Një detyrë tjetër e rëndësishme që shënohej në protokollin e Byrosë Politike është që të realizohej plani i banesave. Në përcaktimin e kësaj detyre ne u nisëm nga fakti se materialin e ndërtimit dhe lëndën e drurit i kemi në vend, prandaj duhet të ndërtojmë shtëpi për kombinatin. Por edhe kjo detyrë nuk po zbatohet si duhet. Ka më se 8 muaj që një grup shtëpish në kombinat vazhdojnë të jenë në të njëjtin nivel ndërtimi, pra këto ndërtime ecin me hapin e breshkës. Ky është një paralajmërim që u bëhet organeve të ndërtimit, të cilat nuk duhet t'i lejojnë vetes dobësi të tilla. Ndërtimet te ne duhet të ecin me një temp të shpejtë.

Çështjet që u ngritën në këtë mbledhje duhet të shtrohen edhe një herë në kombinat dhe të vihen në rrugën e zgjidhjes. Edhe Ministria e Industrisë duhet ta ndihmojë më shumë kombinatin. Fabrika e leshit deri në fund të vitit duhet ta realizojë planin. Veglat e këmbimit që do të vijnë për kombinatin duhet të vihen sa më shpejt në shfrytëzim dhe të ulen kështu deficitet e

krijuara. Mos harroni, shokë, se çështja e disiplinës teknike dhe e disiplinës në punë nuk mund të arrihen aq lehtë. Partia duhet të mendojë se ata që punojnë në kombinat janë fshatarë dhe nuk janë akoma punëtorë me një disiplinë të shëndoshë proletare, ata janë mësuar të shkojnë në punë me orar e pa orar, kurse në ndërmarrje duhet t'i nënshtrohen një pune shumë të organizuar. Prandaj që të mund t'i futet në shpirt puna me norma, që punëtori ta kuptojë disiplinën etj., duhen bërë përpjekje të jashtzakonshme nga ana e Partisë për të thyer mentalitetin prej fshatari të punëtorëve të rinj. Çështjet që fabrika është e jona pushteti është i yni, Partia duhet t'ua shpjegojë mirë, të kuptojë me të vërtetë punëtori që fabrika është e tij deri te gjilpëra dhe vegla e vogël e këmbimit që ai e hedh poshtë, te xhami që e thyen nga pakujdesia etj., dhe të mos konsiderohen këto si «mall shteti» që nuk mbarohen.

Komiteti dhe organizatat bazë të Partisë duhet të bëjnë një punë të thellë edukative e të gjithanshme me gjithë punëtorët dhe në këtë drejtim të aktivizohen më tepër të gjithë komunistët, organizata profesionale dhe rinia. Punëtorët e kombinatit janë njerëz të afërtë të Partisë, por duhet që shembulli i komunistëve të jetë në lartësinë e duhur, të gjithë komunistët duhet të bëhen punëtorë të përparuar. Në ta dhe në të gjithë punëtorët të ngrihet entuziazmi revolucionar në punë.

Mua më duket se mjaft forma edukative me punëtorët janë burokratike. Ato nuk duhet të mbeten forma për forma, po të gjallërohen dhe t'i përshtaten realitetit tonë. Në rast se ndonjë nga këto forma nuk bën, atëhere të zëvendësohet me një formë tjetër më të mirë. Po

gjerë mishin me peshk. Ose në këtë kohë ne kemi edhe ullirin. Atëhere një pjesë të mishit mund ta zëvendësojmë me ullinj, me vaj, pse në këtë kohë fillojnë e dalin edhe zarzavate. Pra kur vaji është i paktë, të kemi më shumë mish dhe kur mishi është i paktë, të kemi më shumë vaj. Po t'i vëmë forca edhe peshkut, mund të krijojmë edhe disa rezerva mishi. Po si mund t'i krijojmë këto rezerva? Ne mund t'i krijojmë duke marrë masa serioze për sigurimin e frigoriferëve, ku mund të mbahen bagëti të therura. Po për frigoriferët ne mendojmë vetëm në letër, lexojmë literaturë, shfaqim dhe dëshirën e kënaqemi se pas dy vjetësh sigurohet një frigorifer, kurse në të vërtetë, nga zgjerimi dhe shtimi i numrit të tyre, varet ushqimi i popullit, prandaj ta marrim me seriozitetin më të madh sigurimin e frigoriferëve.

Situata te ne është e qartë; mundësitë tona për t'i zgjidhur të gjitha çështjet menjëherë janë të vogla, prandaj ne duhet të kapim problemet kyç: bukën dhe mishin. Këto duhet t'i studjojmë më seriozisht. Po të kemi frigoriferë, nuk do t'i lëmë bagëtitë të dobësohen për mungesë ushqimi ose kullote, por do t'i them kur ato janë të majme për t'i dhënë mish popullit. Mirëpo çështjet këtu në Byro na paraqiten në mënyrë të shkëputur. Shumë probleme ne duhej të na shtroheshin më drejt dhe më konkretisht. Edhe shifra mund të na thuheshin në qoftë se komisioni do të kishte bërë një punë përgatitore më të mirë, të ishte ngulur më tepër dhe t'i paraqiste problemet më të plota.

Në lidhje me prodhimet bujqësore e blegtorale konstatohet se ato nuk grumbullohen plotësisht. Të marrim parasysh se kullotat te ne janë të varfëra, pakuj-

desitë e njerëzve për blegtorinë janë të mëdha, dimri na ka dëmtuar dhe fshatarët konsumojnë më shumë prodhime blegtorale, sidomos qumësht etj. Megjithatë ka akoma shumë prodhime blegtorale që ne mund dhe duhet t'i grumbullojmë. Unë mendoj se çështja e ambalazhimit dhe e transportimit në thellësi luan një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm, pa nënvleftësuar këtu çështjen e transportit automobilistik. Një fshatari që ka disa dele duhet t'i krijojë konditat që qumështin e prodhuar prej tyre t'ja shesë shtetit. Si mund ta sjellë qumështin ai në baxho kur ajo është shumë larg, ose kur në treg nuk ka matara¹? Edhe baxhot nuk duhet të presin që fshatari t'ua çojë qumështin kur janë këto mungesa, të cilat duken si të vogla.

Ose për frutat dhe zarzavatet që i lëmë derisa prishen për shkak se nuk ka ambalazhe e transport. Po të ketë ambalazh, fshatari nuk e lë rrushin ose fikun t'i kalbet, pse kjo nuk është në interesin e tij, po puna është që ai nuk ka ose ka fare pak shporta, kanistra, kosha e kazana. A janë këto mjete të nevojshme për të tërhequr mallrat nga fshati? Mua më duket se po. Megjithkëtë, nuk merren seriozisht dhe nuk ka inisiativë as nga Partia, as nga kooperativat e shitblerjes, por pritet derisa dërrasat të vijnë nga sharrat. Rrush ka në Skrapar, ai mund të vijë edhe në Durrës e në Tiranë po si e me se të vijë? Fjala e parë është sigurimi i ambalazhit. Që të vijë rrushi nga fshatrat e Skraparit deri në Çorovodë duhen kosha me shumicë, të cilët mungojnë, kur e tërë krahina e Beratit është plot me shelgje për të

¹ Enë prej tenqeje që përdoret për transportimin e qumështit.

bërë kosha. Atëhere, përse të mos krijohen punishte, ku të pregatiten shporta e kosha nga të cilat t'i dërgohen edhe Skraparit për të vendosur e transportuar rrushin? Mundësi për të bërë nga këto gjëra ne kemi, por, po të hedhësh një parullë të tillë, disa thonë: «Të tëra këto kostojnë shtrenjtë»! Unë them se kështu mund të ndodhë në rast se nuk mendohet e organizohet mirë puna.

Mendoj se për të tërhequr nga fshatari mallrat që i teprojnë dhe i prishen, atij duhet t'i krijohen mundësitë që t'i sjellë ato në qytet. Lidhur me këtë, përveç ambalazhit, shumë serioze paraqitet çështja e transportimit të këtyre mallrave me automobila nga qendrat krahinore në ato të konsumit. Nga ana e qeverisë kjo çështje duhet të ristudjohet dhe ta zgjidhim më mirë se deri tani. Transportimi i prodhimeve nga zonat e thella për në qendra, me automobil ose pa automobil, mund të bëhet me një organizim më të mirë të punës, gjë që do të na lehtësonte mjaft në këtë drejtim. Transportimi i prodhimeve nga fshati në qytete, në vendin tonë, nuk mund të bëhet vetëm me automobila, pse vendi ynë është malor dhe në rast se nuk i vëmë rëndësi rritjes së kafshëve bartëse, të cilat fshatari në pjesën më të madhe nuk i shfrytëzon si duhet, nuk zgjidhet ky problem. Prandaj të nxiten fshatarët që t'i shfrytëzojnë kafshët në interes të tyre dhe të kooperativave të shitblerjes. Ky problem të shihet më gjerë nga Partia.

Jam dakord me shumë probleme që shtruan këtu shokët në lidhje me çrregullimet që ekzistojnë në treg për çmimet. Në rast se kjo çështje në komitetet ekzekutive të qarqeve ose të rretheve varet nga një njeri, siç u tha këtu, është shumë gabim. Nuk duhet lejuar që

politika e çmimeve të tregut t'i lihet vetëm një njeriu, por të krijohet një komision për këtë qëllim. Kjo çështje duhet studjuar e duhet zgjidhur medoemos, pse ka vështirësi të mëdha në caktimin e çmimeve të prodhimeve bujqësore e blegtorale që varen edhe nga sezoni sepse këto prodhime një herë dalin e herën tjetër s'dalin, prandaj çështja e çmimeve është shumë serioze. Ne kemi vendosur për një përqëndrim të kësaj çështjeje duke ngritur një komision pranë qeverisë, i cili të studiojë çmimet në të gjithë Republikën, prandaj kjo çështje të studjohet e të organizohet mirë nga qeveria.

Komiteti Qendror ka vendosur të inkurajohet sektori i tregëtisë së vogël private, po në këtë sektor të mos harrojmë të kërkojmë rregullat higjienike, ato si kudo edhe këtu duhet të zbatohen patjetër. Që të furnizohen njerëzit duhet rregulluar orari i hapjes së dyqaneve të privatëve. Mund ta detyrosh privatin t'i vërë mallit etiketat e çmimeve, por jo ta detyrosh atë që ta mbyllë dyqanin në orën kur punëtorët dalin nga puna dhe kur venë në pazar për të blerë. Prandaj kjo duhet menduar mirë. Privatët le ta mbajnë hapur sa të duan dyqanin e tyre. Shokët e Ministrisë së Tregëtisë mendojnë se nuk duhet të influencohen nga disa njerëz që bëjnë presion në këtë drejtim. Kur është fjala për spekulime, këto duhet të luftohen. Goditjet të bëhen, por me kujdes, me diferencim. Ndryshe duhet parë një spekulant që është me damkë. ndryshe një tjetër që s'është i tillë. Goditje nuk duhet të bëjmë kundër çdo tregëtar. Ligji të zbatohet ndaj një spekulanti të vërtetë dhe jo kundër atij që shet disa brisqe për t'u rruar.

Çështja e kuadrit në sektorin e tregëtisë ka një

rëndësi të madhe. Ne e shohim sa vjedhje kryhen në këtë sektor. Këto vjedhje janë një plagë e madhe në tregëti, për shkak të përbërjes jo të mirë të kuadrit, sidomos të kuadrit kontabël. Kësaj çështjeje as organet tregëtare, as Partia në bazë e as aparati i Komitetit Qendror nuk i kanë kushtuar kujdesin e merituar. Vigjilenca e Partisë në sektorin e tregëtisë është për tokë. Ne do ta shtrojmë me forcë të madhe problemin e kuadrit, të vjedhjeve dhe të vigjilencës, si në sektorin e tregëtisë shtetërore, ashtu dhe në atë të kooperativave të shitblerjes. Te ne ka komunistë që po t'u thuash «mëso të bëhesh tregëtar» u duket vetja sikur bëhen borgjezë! Ky është koncept i gabuar. Në tregëti zbatohet politika e Partisë në lidhje me shpërndarjen e mallrave dhe furnizimin e popullit me to. Po këta njerëz nuk e kuptojnë kështu këtë çështje. Për edukimin e punonjësve të tregëtisë, roli i komunistëve duhet të jetë i madh që ata vetë t'i shërbejnë sa më mirë popullit. Në drejtim të edukimit si nga ana e Ministrisë së Tregëtisë ashtu edhe nga Bashkimi Qendror i Kooperativave, ka mjaft mungesa të cilat do të zhduken po të interesohet më tepër edhe Partia, anëtarët e së cilës, sipas mendimit tim, duhet të kujdesen edhe për defteret që mbahen në tregëti. Cilët janë ata komunistë që e kanë ngritur zërin dhe kanë kërkuar ç'u bënë defterët e llogarisë, ku janë, pse nuk mbahen në rregull etj.? Po të mos e bëjë një kontroll të tillë Partia, defterët do të zhduken. Prandaj kërkohet edhe dora e Partisë në vendimet që merr shteti për tregëtinë, ndryshe ato nuk do të gjejnë zgjidhjen e duhur.

Kundër vjedhjeve Partia duhet të veprojë më me zgjuarësi dhe energji. Vigjilentë duhet të jenë të gjithë,

jo vetëm komunistët, por edhe patriotët. Faktet tregojnë se organizatat bazë dhe komitetet e Partisë nuk bëjnë sa duhet kujdes ndaj vjedhjeve. Zhvillohen plenumë dhe aktive të Partisë po flitet pak e, ndonjëherë, aspak për vjedhjet; kjo është e palejueshme. Atëhere si mund të zbatohen rregullat shtetërore që vihen në tregëti pa e kuptuar mirë vetë Partia rëndësinë e tyre? Këtë gjë ne duhet ta theksojmë shumë. Po edhe Ministria e Tregëtisë duhet të marrë masa që vendimet të zbatohen me rigorozitetin më të madh. Detyrat që caktohen për shpërndarjen dhe ruajtjen e mallrave duhet të kontrollohen, të ketë gjithashtu kontroll për çmimet dhe peshat dhe të gjitha këto të merren me seriozitetin më të madh. E vërteta është se në tregëtinë socialiste ka përparime, por nuk mund të mohojmë faktin se ekzistojnë edhe mjaft të meta, të cilat në kooperativat e shitblerjes janë edhe më të theksuara, pse ato janë më pak të kontrollueshme; në peshoret e tyre nuk ka sa duhet kontroll gjë që i lë shteg vjedhjeve.

Me të gjitha vërejtjet që u bënë dhe detyrat që u shtruan këtu nga shokët e Byrosë Politike jam dakord që të hartohet një vendim i qartë dhe i shkurtër, ku gjërat e përgjithshme të shënohen bashkërisht, ndërsa detyrat të vihen veç për kooperativat e shitblerjes dhe veç për tregëtinë shtetërore.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

NGA FJALA E MBAJTUR NË PRITJEN E DHËNË NGA AMBASADA KINEZE NË TIRANË ME RASTIN E 5-VJETORIT TË THEMELIMIT TË RP TË KINËS

1 tetor 1954

Shoku ambasador i Republikës Popullore të Kinës,
Shokë dhe zotërij,

Më lejoni, shoku ambasador, t'Ju përshëndes Ju dhe nëpërmjet Jush gjithë popullin heroik vëlla kinez për festën e madhe të 5-vjetorit të themelimit të Republikës Popullore të Kinës. Ju lutem gjithashtu, me këtë rast solemn, t'i transmetoni Partisë së lavdishme Komuniste të Kinës, Komitetit të saj Qendror, qeverisë dhe popullit kinez, urimet më të nxeha revolucionare dhe vëllazërore të popullit shqiptar, të Partisë së Punës dhe të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë.

Pesë vjet me radhë, populli shqiptar e ka festuar me gëzim këtë ditë të shënuar të popullit vëlla kinez, për arësye se fitorja juaj e madhe, që ishte rezultat logjik i revolucionit popullor triumfues të Kinës, i udhëhequr nga Partia heroike Komuniste Kineze me në krye shokun Mao Ce Dun, është njëkohësisht një fitore e madhe e jona, e popullit tonë, e popujve të kampit të socializmit dhe të paqes, e të gjithë popujve të botës.

Vendosja e pushtetit popullor në Kinë, themelimi i Republikës Popullore të Kinës, u arritën pas kaq luftërash të përgjakshme, pas kaq heroizmash të papërshkruara të komunistëve dhe të patriotëve kinezë, të ushtrisë së madhe ngadhënjimtare të popullit kinez kundër imperialistëve amerikanë, anglezë, japonezë, kundër latifondistëve, feudalëve, borgjezisë reaksionare dhe përfaqësuesit të tyre kriminel, bandit e të shitur, Çan Kai Shi-së dhe bandës së tij të Gomindanit.

Shpallja e republikës suaj popullore, shoku ambasador, është paguar shtrenjtë me gjakun e bijve më të mirë të popullit kinez dhe Republika Popullore e Kinës është vepra e lavdishme e politikës marksiste-leniniste të Partisë suaj Komuniste, ashtu sikundër Republika Popullore e Shqipërisë është paguar shtrenjtë me gjakun e mijëra heronjve të popullit tonë dhe është vepra e pavdekshme e vijës politike marksiste-leniniste të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Fitoret e mëdha të revolucioneve tona popullore, janë fitore të përbashkëta, pse popujt tanë të vëllazëruar, të frymëzuar dhe të edukuar nga idetë gjeniale të Marksit, Engelsit, Leninit dhe të Stalinit, u çuan me armë në dorë kundër të njëjtëve armiq imperialistë shtypës, që na kishin shkelur vatrat tona, që na digjnin e na vrisnin. Ne u hodhëm në luftën e madhe çlirimtare, pse luhej fati i popullit dhe i atdheut tonë. Të huajt dhe shërbëtorët e tyre vendës ne na kishin grabitur lirinë dhe pavarësinë. Ne i dhamë fund përgjithmonë kësaj gjendjeje. Populli i mundi armiqtë e tij si në Kinë dhe në Shqipëri. Populli vendosi pushtetin e tij si në Kinë dhe në Shqipëri. Populli ndërton socializ-

min si në Kinë dhe në Shqipëri. Asgjë s'i ndan më popujt tanë, këta çdo gjë i bashkon, prandaj të bashkuar dhe të vëllazëruar ne ecim përpara. S'ka forcë në botë që të pengojë hovin tonë ndërtimtar, pse forca jonë është e madhe, pse forca e popullit është e pathyeshme, pse çështja për të cilën ne luftojmë dhe e mbrojmë është e drejtë.

Të dy popujt tanë fituan mbi armiqtë, vendosën pushtetin e demokracisë popullore dhe po ecin me sukses përpara në rrugën e ndritur të socializmit.

Eksperienca e madhe dhe e pasur e Bashkimit Sovjetik u jep mundësinë popujve tanë të ngrenë ekonominë e tyre të re brenda afateve sa më të shkurtëra. Një hov dhe entuziazëm i madh për punë ka shpërthyer në popujt tanë. Energjitë revolucionare të grumbulluara në shekuj nga populli juaj i kanë dhënë mundësinë Republikës Popullore të Kinës të bëjë përparime të mëdha të papara në historinë mijëvjeçare të popullit tuaj brenda këtyre pesë viteve. Revolucionari agrar në Kinë u krye me sukses dhe sot fshatari kinez, që deri dje ishte pa tokë dhe shfrytëzohej egërsisht nga imperialistët e huaj dhe feudoborgjezia e vendit, është bërë zot në tokën e tij dhe tani prodhon për familjen dhe për popullin e tij. Pas çlirimit, vetëm brenda tre viteve populli heroik revolucionar kinez shëroi me sukses plagët e luftës dhe krijoi kështu konditat për të kaluar në ndërtimin e një ekonomie moderne të planifikuar. Të shkëlqyera kanë qenë rezultatet e Republikës Popullore të Kinës në lëmin e ekonomisë në mbarim të vitit të parë të planit pesëvjeçar dhe me sukses po realizohet dhe plani i këtij viti.

E udhëhequr nga parimet e pavdekshme marksiste-leniniste, Republika Popullore e Kinës luan sot një rol të rëndësishëm për mbrojtjen e paqes në botë. Populli i madh heroik i Kinës ka dhënë një ndihmë të paçmuar në shuarjen e dy vatrave të luftës të ndezura nga imperialistët botërorë në Kore dhe në Vietnam. Sot është absurde dhe kriminale të mohosh rolin e Republikës Popullore të Kinës si një faktor i rëndësishëm i dorës së parë për zgjidhjen e problemeve ndërkombëtare. Por të drejtat e Republikës Popullore të Kinës në lëmin ndërkombëtar kërkojnë t'ja mohojnë imperialistët amerikanë, të cilët shohin te populli i madh kinez një pengesë serioze për realizimin e planeve të tyre të luftës dhe të skllavërimit të popujve. Një rrugë të tillë kanë ndjekur dhe vazhdojnë të ndjekin imperialistët edhe me popullin tonë në lëmin ndërkombëtar që prej dhjetë vjetësh. Por një rrugë e tillë është pa krye dhe e destinuar të dështojë. Republika Popullore e Kinës është bërë sot një fuqi e dorës së parë në arenën botërore pa pjesëmarrjen e së cilës asnjë çështje nuk mund të zgjidhet seriozisht, prandaj ajo medoemos dhe sa më parë ka për të zënë me siguri vendin që meriton midis fuqive të mëdha.

Populli heroik i Kinës është një popull paqësor. Ai po punon i qetë për ndërtimin dhe lulëzimin e atdheut të tij të madh, por njëkohësisht ruan me vigjilencë fitoret e tija të mëdha nga kërcënimet e imperialistëve. Disa dhjetëra kilometra larg bregdetit lindor të Kinës ka akoma tokë kineze të paçliruar që sundohet mizorisht nga klika e Çan Kai Shi-së, e ndihmuar me të gjitha mjetet nga imperialistët amerikanë. Kjo bandë gangste-

rësh dhe vrasësish të popullit kinez po bën provokime të vazhdueshme në territorin mëmë të Republikës Popullore të Kinës. Me armët e imperialistëve amerikanë Ishulli i Taivanit mbahet i shkëputur nga trupi i Kinës së pafund. Prandaj është plotësisht e drejtë dhe legjitime dëshira e madhe e popullit kinez për çlirimin e plotë të atdheut të tij të madh, për çlirimin e Taivanit dhe të ishujve të tjerë afër tij. Një fat të tillë pati dikur edhe ishulli ynë i vogël i Sazanit që u mbajt për një kohë të gjatë nga imperialistët italianë me qëllim që ta përdornin si kobure drejt zemrës së atdheut tonë. Por populli ynë, me luftën e tij çlirimtare, ashtu sikurse çliroi nga thonjtë e okupatorëve gjithë Shqipërinë, çliroi e bashkoi Sazanin tonë me mëmëdheunë. Populli ynë e çmon shumë dëshirën e zjarrtë dhe të drejtë të popullit vëlla të Kinës për çlirimin e plotë të gjithë atdheut të tij, prandaj ai është solidar dhe i uron popullit kinez ta realizojë me sukses çlirimin e Taivanit!

Shoku ambasador!

Në këtë ditë të madhe gëzimi për popullin kinez, populli shqiptar, sikurse të gjithë popujt përparimtarë të botës, i uron atij suksese të mëtejshme në ndërtimin e jetës së tij të re. Populli shqiptar feston sot dhe gëzon së bashku me popullin vëlla të Kinës së madhe festën e 5-vjetorit të çlirimit si dhe datën e madhe historike të proklamimit të Kushtetutës së Republikës Popullore të Kinës dhe e ndjen veten e tij të lidhur akoma më ngushtë me të. Marrëdhënjet diplomatike që u vendosën

në mes të dy vendeve tona, përbëjnë për popullin shqiptar një fitore të madhe dhe një nga datat e shënuara në historinë e vendit tonë. Ardhja juaj, shoku ambasador, në gjirin e popullit tonë, u prit me gëzim të përpshkruar nga populli ynë. Kjo është shprehje e dashurisë që populli ynë ka për popullin e madh kinez. Partia jonë e Punës dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë Ju sigurojnë se do të punojnë pa u lodhur që edhe në të ardhshmen të forcohen gjithnjë e më ngushtë miqësia dhe lidhjet midis të dy popujve tanë vëllezër.

Rroftë dhe u forcoftë çdo ditë e më shumë RP e Kinës!

Rroftë Partia e lavdishme heroike e Kinës!

Rroftë Presidenti i Republikës Popullore të Kinës, miku i shtrenjtë i popullit shqiptar, shoku Mao Ce Dun!

Rroftë dhe u forcoftë kurdoherë më shumë miqësia e pathyeshme e popujve tanë, kinez dhe shqiptar!

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**LETËR DËRGUAR KQ TË PPB TË POLONISË ME
ANË TË SE CILËS KËRKON QE MARRËDHËNJET
TREGËTARE MIDIS DY VENDEVE TË VIHEN
MBI BAZA MË PARIMORE SI DHE AKORDIMIN
E NJË KREDIE¹**

6 tetor 1954

**KOMITETIT QENDROR TË PARTISË PUNËTORE
TË BASHKUAR TË POLONISË
SHOKUT BOLESLAV BJERUT**

V a r s h a v ë

Të dashur shokë,

Në saje të punës vetëmohuese të masave punonjëse të vendit tonë të drejtuara nga Partia e Punës, dhe në saje të ndihmës bujare të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore, vendi ynë po ecën me hov përpara dhe ka arritur suksese të rëndësishme në rrugën e ndërtimit të socializmit, gjatë dhjetë viteve të ekzistencës së pushtetit popullor në Shqipëri. Ndihma

¹ Letra, për afërsisht, të tilla u janë dërguar të gjitha partive të ish-vendeve socialiste të Evropës.

vëllazërore që na ka dhënë Republika Popullore e Polonisë ka qenë një faktor i rëndësishëm në arritjen e këtyre sukseseve nga populli ynë.

Gjatë dhjetë viteve të ekzistencës së pushtetit popullor, ne kemi ngritur një industri të lehtë moderne, e cila në vitin 1953 prodhoi gati dhjetë herë më shumë në krahasim me vitin 1938. Në vitin 1953, në krahasim me vitin 1938, sipërfaqja e mbjellë arriti në 164 për qind dhe prodhimi i dridhërave të bukës 158 për qind. Blegtorija ka filluar të shtohet në numër. Kemi hedhur hapat e parë të kolektivizimit të bujqësisë dhe po bëjmë përpjekje për ta nxjerrë bujqësinë nga prapambetja e madhe. Arësimi dhe kultura po zhvillohen me hov të madh. Niveli i jetesës së masave punonjëse po ngrihet vazhdimisht. Në vitin 1953, në krahasim me vitin 1950, të ardhurat e popullsisë u rritën në 156 për qind dhe xhirua e mallrave të tregëtisë socialiste në 165 për qind¹.

Me gjithë suksset e mëdha që ne kemi arritur, gjendja ekonomike e vendit tonë nuk është e kënaqshme. Ne kemi të meta në metodën e drejtimit të ekonomisë popullore dhe në realizimin e planit të shtetit. Ne akoma edhe sot, dhjetë vjet mbas çlirimit të vendit dhe vendosjes së pushtetit popullor, nuk kemi mundur të heqim sistemin e triskëtimit. Niveli i jetesës së masave tona punonjëse është relativisht i ulët. Mjafton të përmendim faktin se gjatë vitit 1953, ne nuk kemi mundur që t'i japim fshatarësisë, mesatarisht për çdo frymë, veçse: 4,5 metra linear tekstile të pambukta,

¹ Në shifrat e kësaj letre ka nga ato që janë parashikime të pritshme.

2,5 kg. sheqer, 0,6 kg. sapun, 1,4 litra vajguri, pa bërë fjalë për sendet e tjera që ka nevojë fshatari, si gozhdë, litar, vegla pune etj., që kanë qenë krejt të pamjaftueshme.

Në zhvillimin e ekonomisë sonë popullore ekziston një disproporcion i madh midis zhvillimit të industrisë dhe zhvillimit të bujqësisë. Bujqësia ka mbetur shumë prapa. Metoda e punimit të tokës është akoma e prapambetur dhe ekonomia fshatare tepër e coptuar. Nga 165 000 ekonomi fshatare individuale, rreth 60 000 prej tyre nuk kanë asnjë kafshë pune. Ne nuk kemi mundur, deri sot, të prodhojmë bukën në vend. Importi i drithërave të bukës përbën mesatarisht çdo vit rreth 20 për qind të të gjithë importit tonë. Konsekuencat e prapambetjes së bujqësisë janë mjaft të rënda si për furnizimin e popullsisë, ashtu edhe për furnizimin e industrisë me lëndë të para. Thatësira e këtij viti dhe ajo e viteve të kaluara na ka dëmtuar mjaft. Prapambetja e bujqësisë është bërë pengesë serioze edhe për realizimin e planit të eksportit, meqenëse rreth 65 për qind e vëllimit të eksportit tonë vjen nga prodhimet bujqësore.

Disproporcioni që ekziston midis nivelit të ulët dhe numrit relativisht të vogël të kuadrove tanë teknike dhe nevojave gjithnjë më të mëdha që lindin nga zhvillimi i hovshëm i ekonomisë popullore, ka bërë që shfrytëzimi i kapacitetit të maqinerisë sonë të mos jetë i plotë dhe rendimenti i punës të mos jetë në lartësinë e duhur.

Duke mos siguruar me kohë dhe në sasinë e nevojshme mallrat nga importi, shumë ndërmarrje ekonomike shtetërore të vendit tonë vihen në pozita të vështira për realizimin ritmik të planit shtetëror. Vështirësi për të

siguruar, me kohë dhe në sasinë e nevojshme, mallra të importit, ne kemi me të gjitha vendet e demokracisë popullore, ndër të cilat edhe me Poloninë. Ndodh shumë herë, p.sh., që shumë nga kërkesat tona tepër të rëndësishme për ekonominë tonë popullore, të mos sigurohen. Ndodh gjithashtu, shumë herë, që kur pranohet sigurimi i kërkesave tona, nuk pranohen afatet e dorëzimit të materialeve të importit, ose nuk respektohen afatet e livrimit të mallrave në bazë të kontratave. Një gjendje e këtillë e vështirëson mjaft punën e ndërmarrjeve tona ekonomike shtetërore.

Ne kemi një disproporcion të madh midis kapacitetit të transportit dhe nevojave për transport; lloji kryesor i transportit tonë është transporti automobilistik, i cili kryen rreth 85 për qind të vëllimit të transportit. Rrugët tona janë në gjendje të keqe. Sot rreth 30 për qind e mallrave që duhet të transportohen mbeten pa u siguruar me transport. Kjo gjendje influencon direkt negativisht në realizimin e planit.

Ne nuk kemi mundur akoma deri sot që të sigurojmë rezervën e duhur shtetërore, si për bukën, për materialet e lëndët e para që nevojiten për ndërmarrjet ekonomike, për veglat e këmbimit ose mallrat e konsumit të gjerë. Zakonisht, atë që e prodhojmë ose e importojmë sot, ne e harxhojmë menjëherë nesër. Kjo gjendje pengon seriozisht ekonominë tonë, sidomos në rrethanat gjeografike dhe ekonomike në të cilat ndodhet vendi ynë.

Komiteti Qendror i Partisë sonë ka analizuar thellë të metat në drejtimin e çështjeve shtetërore dhe ekonomike. E gjithë Partia dhe të gjitha organet shtetërore dhe ekonomike po luftojnë për zhdukjen e të metave su-

bjektive, sidomos për të zhdukur spontaneitetin në drejtimin e çështjeve ekonomike dhe shtetërore, për të luftuar burokratizmin e për të forcuar kontrollin e zbatimit të vendimeve, për të mobilizuar të gjitha rezervat e brendshme e për të forcuar regjimin e kursimit, për të ngritur nivelin tekniko-profesional të kuadrove, për të siguruar konkretisht rolin drejtues e kontrollues të Partisë mbi të gjitha organet ekonomike dhe shtetërore. Ne ndreqëm gabimet që kishim bërë në planifikim, duke u përqëndruar veçanërisht në drejtim të zhvillimit të bujqësisë, në drejtim të rritjes së prodhimit të mallrave të konsumit të gjerë për të siguruar rritjen e vazhdueshme të nivelit të jetesës së masave punonjëse. Duke marrë parasysh vështirësitë ekonomike të vendit tonë dhe gjendjen specifike të Republikës sonë Popullore, qeveria sovjetike e shtyu afatin e shlyerjes së detyrimeve që lindin nga kreditë që kemi marrë nga Bashkimi Sovjetik. Duhet pasur parasysh se kredia që na është dhënë nga Bashkimi Sovjetik përbën pjesën më të madhe të vëllimit të kredive që ne marrim nga vendet miq.

Me qëllim që ne të mundemi të zhvillojmë edhe më tej ekonominë tonë popullore, të zhdukim pengesat objektive për realizimin e planit të shtetit, me qëllim që të sigurojmë ngritjen e vazhdueshme të nivelit të jetesës së masave punonjëse, që është qëllimi kryesor i Partisë sonë, Komiteti Qendror i Partisë sonë i drejtohet Komitetit Qendror të Partisë Punëtore të Bashkuar të Polonisë që të na ndihmojë, brenda mundësive. Për këtë, Komiteti Qendror i Partisë sonë ju lutet që të pranoni të dërgojë në Varshavë një delegacion nga ana jonë, i cili të kryesohet nga shoku Mehmet Shehu, Kryetar i

Këshillit të Ministrave dhe anëtar i Byrosë Politike të Partisë sonë.

Ne propozojmë që delegacioni ynë të shtrojë para Qeverisë së Republikës Popullore të Polonisë dhe para jush çështjet e mëposhtme:

1. — *Çështja e shtytjes së afatit të shlyerjes së ratave dhe interesave që rrjedhin nga kredia e akorduar.* Dihet se, në bazë të marrëveshjes së datës 25 janar 1951, Qeveria e Republikës Popullore të Polonisë i ka akorduar Qeverisë së Republikës sonë Popullore një kredi prej 60 milion rublash¹ për vitet 1951-1955. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, shlyerja e ratave dhe interesave nga ana e jonë duhet të bëhet gjatë periudhës 1958-1967.

Duke marrë parasysh vështirësitë e mëdha ekonomike të vendit tonë dhe nevojën për të krijuar mundësi më të mëdha se sa deri sot për sigurimin e rritjes së nivelit të jetesës së masave punonjëse të vendit tonë, i lutemi Komitetit Qendror të Partisë Punëtore të Bashkuar të Polonisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Polonisë që afati i shlyerjes së ratave dhe interesave që lindin nga kredia që na është akorduar në bazë të marrëveshjes së datës 25 janar 1951, të shtyhet për t'u shlyer në masën 30 për qind gjatë periudhës 1961-1964 dhe në masën 70 për qind gjatë periudhës 1965-1972.

2. — *Mbi ndërrimin e destinacionit të një pjese të kredisë.* Në bazë të marrëveshjes së datës 25 janar 1951, Qeveria e Republikës Popullore të Polonisë na ka akor-

¹ Sipas kursit të ri të rublës kjo sasi është përafërsisht e barabartë me 13,5 milion rubla.

duar, midis të tjerave, edhe një kredi prej 21,5 milion rublash me qëllim që të blenim pajisje për hekurudhat tona. Kjo shumë është caktuar në një kohë kur ne kishim në plan të ndërtonim një hekurudhë për të lidhur Minierën e qymyr gurit të Memaliajt me portin e Vlorës. Më vonë, ne e kemi hequr nga plani ndërtimin e kësaj hekurudhe, për arsye se rezervat e qymyr gurit të kësaj miniere nuk ka qenë e mundur që të përcaktohen as sot e kësaj dite. Kështu që kjo hekurudhë, pa u përcaktuar rezervat gjeologjike të qymyr gurit të Minierës së Memaliajt, nuk mund të ndërtohet. Nga kredia e caktuar për hekurudhat tona ne kemi përdorur, deri sot, 9 milion rubla. Mbetja prej 12,5 milion rublash nuk mund të përdoret prej nesh për hekurudhat. Ne ju lutemi shumë që pjesa e kredisë prej 12,5 milion rublash e destinuar për hekurudhat tona, por që nuk ka mundësi të përdoret prej nesh tani për tani për këtë qëllim, të na lejohet ta përdorim për të blerë gjatë vitit 1955 në Poloni mallra të ndryshme për të cilat ka nevojë vendi ynë, si metale, drithëra buke, automjete, mallra të konsumit të gjerë etj. Një lehtësi të këtillë ne na e kanë bërë edhe vende të tjera të kampit tonë.

3. — *Mbi rishikimin e çmimeve të mallrave të importit dhe të eksportit.* Nga të dhënat që ne disponojmë nga organet tona të tregëtisë së jashtme rezulton se çmimet e shumë mallrave që ne importojmë nga Republika Popullore e Polonisë të jenë më të larta se çmimet e tregut ndërkombëtar të kampit socialist ose se çmimet e tregut ndërkombëtar në përgjithësi. Kjo çështje është shtruar disa herë nga organet tona të tregëtisë së jasht-

me para organeve tuaja të tregëtisë së jashtme, por nuk ka gjetur akoma zgjidhje. Ne ju lutemi që ta rishikojmë së bashku çështjen e çmimeve të mallrave të importit dhe të eksportit, për të dy vendet, për periudhën 1951-1954, me qëllim që të zgjidhet kjo çështje në mënyrë parimore, duke marrë për bazë çmimet e caktuara nga të dy palët në vitin 1950 ose çmimet e tregut të kampit socialist.

4. — *Mbi çështjen e transportit të mallrave me mjete detare poloneze për në vendin tonë.* Sipas të dhënave që ne disponojmë, tarifa që zbaton pala poloneze për transportimin e mallrave me anën e mjeteve detare për llogari të Republikës sonë Popullore është mjaft e lartë, pothuajse qind për qind më e lartë se tarifa ndërkombëtare e transportit detar. Ne ju lutemi që të rishikohet kjo çështje dhe propozojmë që për të transportuar mallra me mjete detare poloneze për në portet tona të përdoret tarifa ndërkombëtare e transportit detar. Njëkohësisht do të dëshëronim që, brenda mundësive, të merren masa në mënyrë që të shpejtohet transportimi i mallrave me mjete detare poloneze për në portet tona, sidomos transportimi i mallrave që vijnë nga Republika Demokratike Gjermane tranzit nëpër portet e Polonisë.

5. — *Mbi nevojat tona për kredi për pesëvjeçarin e dytë 1956-1960.* Dihet se për pesëvjeçarin e parë 1951-1955, Republika Popullore e Polonisë na ka dhënë një kredi prej 60 milion rublash. Ne nuk jemi në gjendje akoma që të përcaktojmë qysh tani se sa kredi do të na nevojitet të kërkojmë nga Republika Popullore e Polonisë për pesëvjeçarin e dytë. Nga një studim paraprak

që i kemi bërë zhvillimit perspektiv të ekonomisë sonë popullore, del se ne do të jemi në gjendje për të shlyer detyrimet që do të rrjedhin nga kreditë e reja që do të mund të marrim nga vendet miq për pesëvjeçarin tonë të dytë, vetëm në periudhën pas vitit 1972. Prandaj, ju lutemi që ta kini parasysh këtë gjë.

Ne i lutemi Komitetit Qendror të Partisë Punëtore të Bashkuar të Polonisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Polonisë që ta na akordojë një kredi prej 6 milion rublash për vitin 1956, viti i parë i pesëvjeçarit të dytë. Kjo shifër, natyrisht, nuk mund të konsiderohet veçse si orientative dhe definitivisht do të mund të përcaktohet gjatë vitit 1955, kur ne të kemi bërë projektin e planit të dytë pesëvjeçar. Gjatë vitit 1955 ne do të mund të japim gjithashtu shifra orientative për kredinë që do të kërkojmë për vitet 1957, 1958, 1959 dhe 1960 dhe këto shifra do të mund t'i përcaktojmë definitivisht në gjashtëmuorin e parë të vitit 1956, kur të jetë aprovuar plani ynë i dytë pesëvjeçar.

Kredinë që do të mund të na akordojë Qeveria e Republikës Popullore të Polonisë për pesëvjeçarin tonë të dytë, ne do të kemi nevojë ta përdorim kryesisht për të blerë në Poloni mekanizma për qymyret, prokate, tuba të ndryshme, lëndë eksplozive, vegla bujqësore, mallra të konsumit të gjerë etj.

Duke shfrytëzuar ardhjen në Varshavë, delegacioni ynë mund të paraqesë edhe listën e mallrave kryesore që ne do të dëshironim të importonim nga Polonia gjatë vitit 1955.

Partia dhe populli ynë janë tepër mirënjohës ndaj Partisë Punëtore të Bashkuar të Polonisë dhe popullit

vëlla polonez për ndihmën bujare që na kanë dhënë për ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë. Partia dhe qeveria jonë do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të plotësuar detyrimet që ne kemi kundrejt Republikës Popullore të Polonisë.

Zgjidhja e favorshme e çështjeve që ne shtrojmë në këtë letër do të jetë një ndihmë e madhe për forcimin e ekonomisë sonë popullore, për ngritjen e mëtejshme të nivelit të jetesës së masave tona punonjëse, për ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë.

Komiteti Qendror i Partisë sonë dhe Qeveria e Republikës sonë Popullore kanë bindje të plotë se Komiteti Qendror i Partisë Punëtore të Bashkuar të Polonisë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Polonisë, si kurdoherë, do të na ndihmojnë efektivisht për të zgjidhur këtë problem të rëndësishëm për vendin tonë.

Mbetemi në pritje të përgjigjes suaj për dërgimin e delegacionit tonë në Varshavë, duke Ju falënderuar përzemërsisht.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

*Botohet për herë të parë, me
disa shkurtime, sipas origjinalit
që gjendet në AQP*

TË REVOLUCIONARIZOJMË MË TEJ PUNËN E FORUMEVE TË BASHKIMEVE PROFESIONALE

Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH¹

13 tetor 1954

Kam përshtypjen se forumet e bashkimeve profesionale nganjëherë nuk mobilizohen si duhet për të kryer detyrat që u ngarkohen nga Partia. Klasa jonë punëtore, megjithëse e re, është mjaft e guximshme dhe revolucionare, kurse disa nga drejtuesit e saj në bashkimet profesionale janë zyrtarë e burokratë. E them këtë duke u bazuar në kontaktet që kam pasur me punëtorët, ku ka dalë se jo gjithnjë forumet e bashkimeve profesionale e kanë kuptuar rëndësinë e punës me masat dhe parimet marksiste-leniniste që duhet të zbatojë në jetë kjo organizatë, të cilat ka që i dinë, por nuk i vënë si duhet në praktikë. Si shembull mund të sjell kontaktin që mora kohët

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi punën e bashkimeve profesionale, për zbatimin e vendimeve të Plenumit të dhjetorit dhe të prillit të KQ të PPSH», paraqitur nga Këshilli Qendror i BPSH.

e fundit me punëtorët e Fabrikës së çimentos në Vlorë, të cilët thanë shumë gjëra. I pyeta nëse i ngrenë këto çështje në organizatën profesionale dhe m'u përgjegjën se nuk i dëgjon njeri. Atëhere u thashë nëse kishin shkuar ose jo te ndonjë sekretar i Komitetit të Partisë në Vlorë, të cilit t'i thoshin që drejtori dhe organizata bazë e Partisë nuk na e dëgjojnë zërin. Por është e qartë se drejtuesit e bashkimeve profesionale janë burokratizuar më shumë se disa punëtorë të aparateve të Partisë dhe nëpunës të zyrave. Na thuhet gjithnjë se «ky ose ai nuk është i zoti». Kur një njeri nuk punon si duhet, ka shokë të bashkimeve profesionale që janë gati ta pushojnë nga puna, kurse vetë, ndonjërit prej tyre, nuk i vjen mirë ta pushojnë kur s'është në rregull me punën.

Organizata e bashkimeve profesionale është një armë e fortë e Partisë në luftë për të ndërtuar socializmin. Klasa punëtore është në udhëheqje dhe ka për detyrë që të luftojë kundër burokratizmit në aparatet shtetërore bile edhe në Parti. Atëhere si mund të lejojë klasa punëtore që të ketë burokratizëm në punën e bashkimeve profesionale? Është tjetër çështje kur mungon materiali në një ndërmarrje dhe ka vështirësi të mëdha, po ka probleme të tjera, zgjidhja e të cilave varet nga ne, nga mundësitë tona. Forumet e organizatave profesionale nuk janë bërë sa duhet revolucionare dhe të thonë fjalën e tyre për të vajtur çdo gjë në vend.

Të jetë e qartë se kur një organizatë profesionale ose forum i saj nuk e dëgjon zërin e punëtorëve, atëhere të shkohet në organizatën bazë të Partisë, në komitetin e Partisë të rrethit dhe po nuk u zgjidh problemi, çështja të vijë deri këtu në Komitetin Qendror. Më-

rëpo nuk luftohet kështu. Unë u thashë punëtorëve të Fabrikës së çimentos në Vlorë se ato që ngrinin ata ishin të drejta. Fjala është që në vendin e punës nuk ka pastërti. Po nuk arritën bashkimet profesionale që t'i hedhin punëtorët në aksion për higjienën e pastërtinë, atëhere si do t'i kryejnë detyrat e tjera më të vështira?

Organizatave profesionale nuk e luajnë gjithnjë si duhet rolin e tyre të madh, megjithëse në gjirin e vet ato kanë elementë shumë të zot e revolucionarë. Përveç atyre që kanë punë zyre, siç janë nëpunësit e financës e të sigurimeve shoqërore, të tjerët, në radhë të parë kryetarët e komiteteve profesionale, duhet të jenë masovikë, të shkojnë atje ku punojnë, jetojnë dhe mësojnë punëtorët. Natyrisht në këto çështje ka një përgjegjësi të madhe edhe Partia, e cila duhet t'i udhëheqë më mirë bashkimet profesionale, të ngrrejë autoritetin e tyre, të ndihmojë shokët që punojnë me to, mbasi një punë kolosale Partia e bën nëpërmjet organizatave të masave, në radhë të parë me anë të bashkimeve profesionale. Prandaj, është e domosdoshme që drejtuesit e bashkimeve profesionale të shkunden nga plogështia dhe burokratizmi në punë. Unë mund të them se burokratizëm ka edhe në aparatet e shtetit e të Partisë, gjë që reflektohet edhe në organizatat profesionale.

Në kushtet e sotme, s'ka shumë rëndësi që udhëheqësit e bashkimeve profesionale nuk kanë dhe aq njohuri teknike, mjafton të kenë shpirtin luftarak, pse organizata ka me qindra anëtarë që janë teknikë të zot, të cilët duhet t'i aktivizojë. Një teknik do ta ketë për nder po të ngarkohet me një detyrë shoqërore. Kur të shohë se organizata profesionale lufton si duhet, ai nuk do të

kursehet të bëjë një konferencë të karakterit teknik ose të kryejë ndonjë detyrë tjetër. Unë nuk mund ta kuptoj se si mund të refuzojë ndonjë inxhinier apo teknik t'i flasë klasës punëtore po të ngarkohet nga organizata profesionale. Të gjitha mundësitë që kemi duhet t'i shfrytëzojmë. Çështja e aktivitetit të organizatës profesionale ka shumë rëndësi. Ka shumë prej tyre që kanë qenë në luftë, po më duket se nuk kanë ndihmë e kontroll sa duhet dhe ata kujtojnë se puna e tyre është vetëm të venë e të shohin disa forma edukimi, kurse në të vërtetë ata duhet të kuptojnë mirë se puna e tyre nuk kufizohet me kaq. Po të ngrihet klasa punëtore dhe t'i tregojë vendin atij që neglizhon ose që nuk zbaton ligjet e shtetit, s'ka gjë që nuk bëhet. Po ndërtohet gjithë ajo fabrikë e çimentos në Vlorë dhe nuk po bëhet asgjë për t'u siguruar punëtorëve ujë të pishëm, për shkak se drejtori nuk siguron 10 m. tuba! Si mund ta lejojnë bashkimet profesionale një gjë të tillë? Ju, shokë, që jeni ngarkuar nga Partia të drejtoni këtë organizatë, duhet t'i merrni më seriozisht probleme të tilla. Edhe për çështjet e kulturës e të tjera mendoj se keni shumë mundësi, në rast se ekziston inisiativa revolucionare. Unë mendoj që edhe qeveria ta rishikojë problemin e fondeve që nuk shpenzohen, po më duket se nuk është çështja këtu, më shumë puna është te mungesa e inisiativës.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TE FORCOJME MË SHUMË PUNËN E PARTISË NË KOOPERATIVAT BUJQËSORE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

13 tetor 1954

Edhe unë jam dakord me raportin që na është paraqitur, i cili nuk është përgatitur keq, ndërsa projektvendimi mendoj se duhet të ripunohet më mirë për të pasqyruar si duhet raportin dhe detyrat që dalin nga kjo mbledhje e Byrosë Politike. Në këtë mënyrë Partisë do t'i jepet në dorë një dokument më i plotë në luftën e saj për forcimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të kooperativave bujqësore. Me vërejtjet e shokëve, në përgjithësi, jam dakord me disa përfundime.

Të gjithë ne duhet të kuptojmë thellë dhe të zbatojmë mirë direktivat e Partisë në lidhje me kooperativat

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi gjendjen e kooperativave bujqësore ekzistuese dhe propagandën për kolektivizimin», paraqitur nga Drejtoria e bujqësisë pranë aparatit të KQ të PPSH.

bujqësore. Çdo vit shtohen mundësitë tona për të ecur përpara në kolektivizimin e bujqësisë, në radhë të parë për arësye politike, sepse fshatarësia vazhdimisht po ngrihet politikisht dhe e kupton më mirë rrugën që i cakton Partia. E gjithë puna politike ka bërë që fshatarësia të shohë interesimin e përhershëm të Partisë për zhvillimin e bujqësisë. Ndihma e shtetit për bujqësinë me kredi, me traktorë etj. vjen duke u shtuar gjithnjë e më shumë, por duke pasur kurdoherë parasysh direktivat e Komitetit Qendror, ne nuk duhet as të ecim me të katra, as të qëndrojmë në vend.

Vija e Partisë për kolektivizimin e bujqësisë te ne ka në themelin e vet mësimet e marksizëm-leninizmit, të përpunuara në bazë të kushteve konkrete objektive të vendit tonë. Në rezultatet e arritura për zbatimin e kësaj vije, rol vendimtar luan edhe faktori subjektiv. Atje ku puna e Partisë ka qenë më e mirë dhe fshati më i përparuar, edhe transformimi socialist i bujqësisë ka ecur më përpara. Të marrim për shembull Korçën. Në këtë rreth, jo vetëm që fshatarët janë më të përparuar, por edhe puna e organizatës së Partisë është më e organizuar. Unë kam shkuar në disa kooperativa bujqësore të Vlorës, Korçës, Tiranës dhe të Durrësit, po fakti është se në Korçë duket një ngritje më e madhe, pavarësisht nga të metat që kanë edhe atje komunistët. Është fakt se në Korçë interesimi i komitetit të Partisë dhe i komitetit ekzekutiv ka qenë shumë më i madh për problemin e kolektivizimit nga ai i qarqeve të tjera, gjë që ka influencuar në një zhvillim më të madh të kolektivizimit. Ndryshe qëndron puna në rrethe të tjera. Në Shqipërinë e Mesme, ku organizatat bazë të Partisë janë

mjaft të dobëta dhe prapambetja është më e madhe, kolektivizimi ecën më ngadalë. Në Shkodër, në disa kooperativa ekzistuese, ka kohë që zhvillohet një punë armiqësore. Në Lushnjë dhe në Vlorë situata paraqitet e mirë, me gjithë të metat dhe vështirësitë që ka, sepse edhe atje organizata e Partisë bën një punë më të shëndoshë. Prandaj mëndoj të theksohet në vendim që Partia të luftojë në mënyrë sistematike, të shikojë në cilin fshat janë pjekur kushtet dhe të veprojë e matur për të ngritur kooperativën bujqësore. E theksoj këtë pse ka edhe raste që për krijimin e kooperativave nuk veprohet drejt, propaganda e kolektivizimit nuk është në lartësinë e duhur dhe, si rrjedhim, kemi kooperativa të çala e me pjesëmarrje të vogël.

Tani janë të gjitha mundësitë që ne të ngremë më shumë kooperativa bujqësore. Unë jam dakord me propozimet që bëhen për të ngritur edhe nëntë kooperativa të reja në rrethin e Korçës. Në Sovjan, për shembull, edhe pse disa komunistë nuk japin shembullin e mirë, kooperativa mund të formohet. Propozimet që kanë qarqet e tjera, t'i shohim në Sekretariat. Kur te ne ka një hov kaq të madh të fshatarëve, për disa komunistë nuk është e lejueshme që të mos qëndrojnë në pararojë. Ose, po ta ngremë kooperativën bujqësore në Bozhigrad, gjendja nuk është dhe aq e lehtë, pse kanë shfaqur vullnetin vetëm 25 familje nga të 200 që ka gjithsejt fshati dhe mund të na pengojnë elementët kulakë, por, duke marrë parasysh se rreth e qark ka kooperativa si dhe ndihmën që do t'u jepet nga shteti e kujdesi që do të tregojë Partia, me siguri kjo kooperativë do të ngrihet, numri i anëtarëve të saj do të rritet dhe nuk do të jetë

e largët dita që ajo do të forcohet. Po të ishte ky rast në Shkodër e jo në Korçë, atëhere, natyrisht, duhej mbajtur një qëndrim tjetër. Në këtë situatë konkrete, ne duhet t'i vëmë rëndësi edhe shtimit të numrit të kooperativave sidomos në Korçë, Berat, Vlorë, pse atje ka edhe mundësi më të mëdha nga ana ekonomike. Kjo nuk do të thotë aspak që në Elbasan, Tiranë, Durrës dhe Shkodër të mos ngremë kooperativa të reja, po në radhë të parë atje duhet të forcojmë më tepër punën e Partisë në fshat, të përmirësojmë e dëndësojmë propagandën e kolektivizimit. Hapa përpara janë bërë edhe në këto qarqe po duhet të punojmë akoma më shumë.

Kur foli këtu një shok i ftuar tha se masat favorizuese që ka vendosur qeveria ndihmojnë në lindjen e kulakëve të rinj. Unë, ashtu si dhe shokët, nuk jam dakord me këtë konkluzion, i cili është shumë i shpejtuar dhe i rrezikshëm. Masat favorizuese ne i kemi marrë, pse fshatari ynë ka qenë nevojtar dhe detyrimet i kish mjaft të rënda. Për lindjen e kulakëve të rinj ne duhet të jemi vigjilentë, po unë nuk mendoj se po na mbulojnë kulakët e rinj. Çështja kryesore është që Partia të punojë më mirë në fshat, veçanërisht për kolektivizimin e bujqësisë.

Një gjë tjetër që dëshiroj të theksoj është se, në ato fshatra ku organizata e Partisë nuk është e fortë, ndonjëherë arrihet në konkluzionin se kolektivizimi pengohet për shkak të disa elementëve, të cilët nuk e kuptojnë vijën e Partisë. Mendoj se ky përfundim nuk është i drejtë. Po të punojë mirë organizata e Partisë, po të japin shembullin e lartë të pararojës komunistët, vija

e Partisë kuptohet, bindja te njerëzit krijohet. Prandaj kryesorja është forcimi i punës së Partisë.

Është e vërtetë se forcimi i kooperativave kërkon kuadro të aftë për të drejtuar. Po kush e ka fajin për këtë? Mua më duket se fajin e kanë komitetet e Partisë dhe organizatat bazë të Partisë të kooperativave bujqësore, të cilat, sikur nga një njeri të dërgonin në shkollën e kuadrove të kooperativave bujqësore, do të kishin mundur të siguronin minimumin e kuadrit të nevojshëm. Prandaj, t'u vëmë detyrë komiteteve të Partisë dhe organizatave bazë që këtë numër ta plotësojnë. Kur më është dhënë rasti që të bisedoj për këtë çështje nëpër rrethe, të tërë kanë qenë të gatshëm për të dërguar njerëz në shkolla dhe kurse, por për mungesë organizimi kjo nuk është bërë. Ja se si, për çdo problem që kërkon zgjidhje, na del përpara nevoja për të forcuar organizatat bazë të Partisë në kooperativat bujqësore. Po të mos vejë puna mirë në kooperativat bujqësore, fajin e ka Partia në bazë, në rreth e në qark, pse po t'i kuptojë ajo mirë problemet e të luftojë si duhet, do të vërë përpara përgjegjësisë edhe komitetin ekzekutiv, edhe Ministrinë e Bujqësisë, të cilët, brenda mundësive, do të marrin masa për të ndrequr situatën. Pra, lufta e Partisë do të bëjë që edhe Ministria e Bujqësisë të mos neglizhojë, përkundrazi, ajo do të shtyhet për të marrë masa deri te caktimi nën patronazh i kooperativave nga njerëz kompetentë.

Kolektivat bujqësore, statutet e të cilave na paraqiten për shqyrtim, mendoj se përbëjnë një nga format përgatitore për të kaluar në kooperativën bujqësore. Ashtu si dhe shokët e tjerë unë them se me krijimin

e këtyre kolektivave, po të punojë mirë Partia, mund të arrihet që brenda 2-3 vjetësh ato do të kthehen në kooperativa bujqësore. Jam gjithashtu dakord që të shikohet edhe shpërblimi i kryetarit të kooperativës¹ si dhe çështja e shpërndarjes së traktorëve në qarqe, e cila nuk duhet lënë vetëm në dorën e Ministrisë së Bujqësisë, por të shqyrtohet më me kujdes edhe nga qeveria ose të paktën nga kryesia e saj.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Burosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

¹ Në atë kohë shpërblimi i kryetarëve ishte shumë i lartë në krahasim me të ardhurat për ditë-pune që merrnin anëtarët e kooperativës.

TELEGRAM PËRSHËNDETJEJE DREJTUAR KQ TË PK TË SPANJËS

18 tetor 1954

KOMITETIT QENDROR TË PARTISË KOMUNISTE
TË SPANJËS

Të dashur shokë,

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë ju njofton me keqardhje se mori me shumë vonesë letrën tuaj mbi mbledhjen e Kongresit V të Partisë Komuniste të Spanjës dhe nuk mundi të dërgojë, në kohën e duhur, delegacion ose përshëndetje për kongresin tuaj. Megjithkëtë, Komiteti Qendror përfiton nga rasti dhe ju dërgon përshëndetjet e tija më të përzemërta juve dhe nëpërmjet jush gjithë Partisë Komuniste heroike të Spanjës.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe gjithë populli shqiptar ushqejnë për Partinë Komuniste të Spanjës dhe për popullin spanjoll një simpati dhe admirim të thellë. Komunistët shqiptarë dhe masat punonjëse të vendit tonë kanë qenë përkrah Partisë Komuniste dhe popullit spanjoll në ditët e vështira të luftës kundër fashizmit. Gjaku i komunistëve dhe i patriotëve revo-

lucionarë shqiptarë është derdhur së bashku me gjakun e bijve më të mirë të popullit spanjoll. Gjaku dhe sakrificat e përbashkëta për një kauzë të përbashkët, kanë çimentuar një miqësi të pathyeshme e të përjetshme midis popullit shqiptar dhe popullit heroik të Spanjës. Sot që Spanja vuan nën thundrën e xhelatit Franko dhe të padronëve të tij imperialistë, Partia dhe populli ynë janë me gjithë shpirt përkrah luftës çlirimtare të popullit spanjoll të udhëhequr nga Partia Komuniste e Spanjës. Partia dhe populli ynë kanë besim të patundur se do të vijë dita kur populli vëlla spanjoll do të fitojë mbi armiqtë e tij dhe do të ndërtojë një Spanjë të lirë, të pavarur dhe popullore.

Ju urojmë, të dashur shokë, suksese të mhtëjshme në luftën tuaj kundër regjimit fashist të Frankos dhe kundër planeve luftënxitëse të imperialistëve amerikanë. Lufta e drejtë e popullit spanjoll për liri e pavarësi kombëtare është një kontribut i rëndësishëm në luftën e gjithë forcave paqedashëse e përparimtare të botës, të kryesuara nga Bashkimi i lavdishëm Sovjetik, për triumfin e kauzës së paqes, demokracisë dhe socializmit.

Rroftë Partia Komuniste heroike e Spanjës!

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TE MBROJME PRONEN SOCIALISTE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

21 tetor 1954

Unë jam dakord me vërejtjet e shokëve dhe nuk kam se çfarë të shtoj. Kisha vetëm vërejtjen që raporti nuk është i plotë dhe projektvendimi duhet ripunuar në bazë të mendimeve e propozimeve që bënë shokët e Byrosë Politike, të cilat më duken të rëndësishme, parimore dhe shumë serioze.

Kisha edhe një vërejtje tjetër: në projektvendimet që na paraqiten nuk propozohet asnjë masë ndëshkimore. Komiteti Qendror dhe Byroja Politike kanë orientuar e kanë porositur që të mbrohet prona socialiste. Por, në fakt, ndodhin vjedhje, për të cilat duhet të dalë mirë përgjegjësia. Unë jam dakord që edhe drejtuesit e Ministrisë së Tregëtisë dhe të Bashkimit Qendror të

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi punën e Partisë në rrethin e Fierit për ruajtjen e pronës socialiste», paraqitur nga Drejtoria e tregëtisë pranë aparatit të KQ të PPSH.

Kooperativave të Shitblerjes nuk mund t'i shpëtojnë përgjegjësisë së madhe që kanë për kontrollin e dobët që ushtrojnë në sektorët e tyre.

Në praktikë duhet që Partia të luftojë më tepër dhe të jetë me të vërtetë luftarake, pse armiku i klasës mundohet të na dëmtojë, sidomos në sektorët ekonomikë e veçanërisht në industri e tregëti. Lufta kundër kulakëve në fshat po zhvillohet, ndërsa kundër vjedhjeve në këta sektorë ajo është shumë e dobët. Të mbajmë parasysh edhe faktin që në sektorët ekonomikë janë grumbulluar e punojnë edhe armiq.

Partia duhet të jetë e ndërgjegjshme për dëmin e madh që ka pësuar në Fier¹, pse nuk humbi vetëm material por edhe njerëz, të cilët hynë në burg, por veç këtyre ka dhe shumë të tjerë që janë implikuar me ta. Një gjë e tillë krijon një atmosferë të rëndë.

Shokët që drejtojnë tregëtinë nuk dërgojnë njerëz në kurse dhe shkolla që të nxjerrin kuadro më të pregatitur për të bërë jo vetëm tregëtinë më të kulturuar, por për të qenë më në gjendje që të zhvillojnë edhe luftën e klasës. Prandaj kur hapen kurse nga Ministria e Tregëtisë ose e Financave, Partia të marrë të gjitha masat politike dhe organizative për të dërguar atje sa më parë njerëz. Nuk janë të rralla rastet që na thuhet: «Punëtorë në qendrat e punës nuk na vijnë, të rinj e të reja në kurse nuk na vijnë» etj. Po pse ndodh kështu? Shkaku është se nuk bëhet si duhet puna politike

¹ Është fjala për vjedhjet që ishin kryer në NTLAP, në kooperativën e konsumit dhe në ndërmarrjen e grumbullimit të këtij rrethi.

e Partisë me njerëzit. Për shembull një magazinier merr një rrogë të vogël dhe nuk kënaqet. Në këtë rast Partia duhet të punojë me të e t'i thotë: «Në nivelin që je ti nuk mund të paguhesh më shumë, po perspektivën e ke të hapët, mëso në kurs, në shkollë dhe, kur të bëhesh më i zoti, mund të punosh në një detyrë tjetër e të marrësh më shumë». S'ka gjë se e fillon nga puna e vogël, me përpjekjet e tija njeriu e gjen vetë vendin. Po të mos punosh, si mund të jesh-tosh? Ndryshe do të arrish të bëhesh matrapaz ose vjedhës.

Me vërejtjet që u bënë nga shokët, projektvendimet të bëhen më të forta e më konkrete dhe jo me fraza të përgjithshme. Në vendim të shënohen detyrat për Komitetin e Partisë të rrethit të Fierit, për organet e tregëtisë, të vihen detyra kontrolli e ndihme për Drejtorinë e tregëtisë pranë Komitetit Qendror të Partisë, për Ministrinë e Financave si dhe për atë të Kontrollit.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TË PLANIFIKOHET DREJT MARRJA DHE SHFRYTËZIMI I KREDIVE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

21 tetor 1954

Do të flas edhe unë mbi disa çështje që u ngritën këtu, për të cilat nuk jam plotësisht dakord. Mendoj se kredi për pesëvjeçarin e dytë duhet të kërkojmë patjetër, pse nuk ja dalim dot të përballojmë nevojat e mëdha që kemi. Por ka rëndësi të përcaktojmë drejt se përse do ta kërkojmë dhe përdorim kredinë.

Në radhë të parë ne duhet të bëjmë kërkesë për bujqësinë. Unë nuk them t'i caktojmë objektet që tani, po këtu duhet të kemi një parashikim. Sasia e kredisë për bujqësinë të jetë e tillë që gjatë pesëvjeçarit të dytë të kemi bërë një ndryshim jashtëzakonisht të madh në bujqësi. Deri tani bujqësia te ne nuk ka ecur

¹ Ky diskutim u zhvillua në Byronë Politike rreth skicë-idesë të paraqitur nga Komisioni i Planit të Shtetit në lidhje me kreditë që do të kërkohej për pesëvjeçarin e dytë.

me ritmin e duhur përpara dhe këtu përgjegjësi kemi të tërë. Por investimet që kemi bërë deri tani në bujqësi do të na ndihmojnë të kemi rezultate më të mira në të ardhshmen. Të jemi të ndërgjegjshëm shokë, se kemi shumë për të bërë në bujqësi. Ne kemi shpenzuar miliona lekë për të ndërtuar kanale të reja, po ç'po na japin ato? Kemi sjellë shumë traktorë për nevojat e bujqësisë dhe akoma më shumë do të sjellim për ta ndryshuar situatën. Do të ecim përpara në rrugën e kolektivizimit të bujqësisë, do të forcojmë organizimin socialist dhe në këtë mënyrë, do të kemi më shumë grurë, panxhar, pemë, nga të cilat do të sigurojmë të ardhura kolosale. Megjithëse po mbillen me dhjetëra mijëra rrënjë fiq, mollë, dardhë, ullinj duhet pranuar se në këtë drejtim në kushtet e vendit tonë, të përshtatshme për zhvillimin e frutave, nuk po bëhet sa duhet. Prandaj, duke marrë kredi për bujqësinë dhe duke punuar më mirë për zhvillimin e frutikulturës, do të na jepet mundësia për të rritur edhe eksportimet tona.

Unë mendoj që deri nga fundi i pesëvjeçarit të dytë të zhvillojmë edhe pambukun e të arrijmë rendimente të larta. Derisa tokën dhe klimën i kemi të mira dhe mjetet po na vijnë, atëhere pse të mos zhvillojmë mirë duhanin, panxharin dhe pambukun? Prandaj, si për shtimin e eksportit, ashtu edhe për plotësimin e nevojave të popullit ne duhet të marrim masa serioze, t'i zgjidhim këto me ndihmën e re që do të na jepet. Në pesëvjeçarin e dytë, jo vetëm duhet t'i realizojmë parashikimet, por të krijojmë edhe rezerva që të mund të shlyejmë borxhet në afatet që janë caktuar.

Për fabrikat që do të ndërtojmë në pesëvjeçarin e

dytë, ne vetë të mendojmë të sjellim disa prej tyre, me të cilat të plotësojmë deri diku nevojat e popullit tonë. Të mos i vardisemi kaq shumë birrës, të mos shohim vetëm çështjen e akumulacionit, të shkurtojmë një sërë materialesh nga importi; çështjen e letrës, për shembull, ta shohim më me kujdes. Gjatë pesëvjeçarit të parë ne nuk kemi sjellë asnjë maqineri për tulla, prandaj unë them se pa të nuk bëjmë dot në gjendjen që jemi. Duhet parë edhe nëse mund të pjekim tulla në punishte siç bën artizanati.

Çështja e transportit është shumë e rëndësishme, unë jam dakord që edhe për këtë sektor të kërkojmë kredi, vetëm se ne duhet të bëjmë përpjekje t'i shfrytëzojmë mirë mjetet e transportit që disponojmë. Sa për mallra të konsumit të gjerë nuk duhet të kërkojmë më kredi, po t'i blejmë vetë me klering¹. Edhe veglat e këmbimit t'i përballojmë me eksportet tona. Në shikim të këtyre çështjeve ne mund të caktojmë edhe shifrat e kredisë. Kështu e mendoj unë kredinë dhe jo të përfshijmë në të edhe bukën, mallrat e konsumit të gjerë, llamarinën etj., të cilat duhet t'i realizojmë me mundësitë tona, me mjetet që kemi.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

¹ Klering (angl.) — sistem tregëtar ku likuidimi për mallrat që importohen ose eksportohen midis dy vendeve nuk bëhet me para në dorë, por nëpërmjet vleftës së mallrave që shkëmbehen.

PËR DEMOKRATIZIMIN E MËTEJSHËM TË KESHILLAVE POPULLORE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

28 tetor 1954

Unë do të them disa fjalë si për shokët e Partisë që drejtojnë në rrethin e Peqinit, ashtu edhe për shokët e tjerë. Megjithëse kujdesi i Partisë për pushtetin ka ardhur gjithmonë duke u shtuar, unë mendoj se akoma më tepër dhe më mirë duhet të interesohen si aparati i Komitetit Qendror, ashtu edhe komitetet e Partisë në rrethe e organizatat bazë. Të marrim një çështje, atë të funksionimit të organeve të pushtetit, të cilën Drejtoria e organizimit pranë Komitetit Qendror e shikon vetëm nga ana formale, pa hyrë në atë që është kryesorja: në demokratizimin e pushtetit popullor. Kam

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi punën e pushtetit në rrethin e Peqinit», paraqitur nga Drejtoria e organeve të Partisë, rinisë e bashkimeve profesionale pranë aparatit të KQ të PPSH.

përshtypjen se në këtë mënyrë e shohin këtë çështje edhe seksionet e organizimit pranë komiteteve të Partisë në rreth.

Të gjitha ligjet, të gjitha direktivat që nxjerr Partia, Komiteti Qendror, zbatohen nëpërmjet pushtetit. Partia duhet të ndihmojë që këto të kuptohen dhe të zbatohen drejt, por pa spostuar rolin e pushtetit. Këtë e kemi shtruar dhe do ta shtrojmë vazhdimisht. Por që kjo të kuptohet drejt duhet, në radhë të parë, që të gjithë komunistët dhe njerëzit pa parti, që punojnë në pushtet, të njohin mirë kompetencat e tyre, zbatimimi i të cilave e shpie punën përpara.

Partia duhet ta kuptojë më mirë rolin e madh të këshillave popullore. Kjo do të arrihet jo vetëm me punë propagandistike, por edhe përmes aksioneve konkrete. Le të organizojmë, për shembull, luftën për të zhdukur analfabetizmin në radhët e anëtarëve të këshillave popullore. Kjo është e domosdoshme, ndryshe si mund të punojnë organet e pushtetit duke pasur në gjirin e tyre njerëz analfabetë? Këta kanë funksione me rëndësi që ua ka besuar populli: duhet të studiojnë ligjet, të kontrollojnë zbatimin e tyre etj. Mirëpo një çështje të tillë të rëndësishme Partia nuk e ka marrë si duhet në dorë, nuk është kuptuar thellë se këshilltarët, si përfaqësues të popullit, duhet të kërkojnë llogari nga ata që kanë zgjedhur në udhëheqjen e përditshme, siç është komiteti ekzekutiv. Po si është e mundur që një këshilltar të kontrollojë të tjerët kur ai është analfabet? Jo vetëm kaq, por njerëzit e zgjedhur në pushtet duhet të aktivizohen, të dëgjojnë zërin e popullit dhe të veprojnë për të zgjidhur kërkesat dhe ankesat e

tija. Pra, të, zgjedhurit në pushtet kanë detyra të rëndësishme për të zgjidhur, detyra të cilat nuk mund të plotësohen pa ditur shkrim dhe lexim. Prandaj, Partia të marrë përsipër luftën kundër analfabetizmit në radhët e këshilltarëve, gjë që ka të bëjë me ngritjen e rolit të tyre, me forcimin e mëtejshëm të pushtetit popullor.

Në teori, Partia ka thënë gjithnjë «të demokratizojmë pushtetin popullor», por në praktikë nuk luftohet si duhet. Të marrim një çështje tjetër, atë të aktivizimit të këshilltarëve nëpërmjet komisioneve të ndryshme pranë këshillit popullor. Ne themi që këshilltari duhet të kërkojë llogari, por si do të kërkojë llogari, kur ai nuk ka një përgjegjësi të caktuar, kur nuk punon në një komision? Ndryshe është kur i mbledh shokët e këshillave popullore dhe i ngarkon me detyra në komisione, atëhere ata do të aktivizohen më shumë. Një gjë e tillë nuk bëhet mirë, sepse Partia nuk e ka kuptuar si duhet këtë çështje. Në bazë të kompetencave të përcaktuara me ligj, kryetari i komisionit ka të drejtë të thërrasë, për shembull, drejtorin e degës së bankës dhe t'i kërkojë llogari. Ose, kur ta thërrasë komisioni përgjegjës në seksionit të tregëtisë, ky duhet ta ndjejë forcën, kontrollin dhe autoritetin e pushtetit si në qytet ashtu dhe në fshat. Po kush i ka pyetur këta shokë, funksionet e të cilëve janë caktuar me ligj? Mund të themi asnjëri, prandaj Partia duhet t'i nxitë dhe t'i mësojë të gjithë këshilltarët që të aktivizohen.

Lidhur me këto çështje, dëshiroj të theksoj edhe faktin se disa sektorë shpeshherë neglizhohen nga komitetet ekzekutive dhe komitetet e Partisë, të cilat, ndërsa preokupohen jashtëzakonisht për çështjen e buj-

qësisë e të industrisë, dhe, kjo është e drejtë, pse ekonomia është baza, lënë pasdore sektorë të tjerë siç janë arësimi, kultura, shëndetësia etj. Të marrim Elbasanin, ky është një qytet ku vihet re papastërti, në Peqin po ashtu. Por në qoftë se ne duam të çojmë kulturën e pastërtinë në fshatrat e Peqinit; këtë do ta bëjmë, përveç të tjerave, me anë të shembullit që duhet të japë qyteti i Peqinit. Unë nuk them që të ngrihen pallate, pse të gjithë e kuptojmë që kemi shumë vështirësi për krahun e punës dhe për lëndën e ndërtimit, por që të lihen plehrat rrugës, kjo nuk u lejohet komiteteve ekzekutive të këshillave popullore. Te ne ka ligje, ka rregulla, në bazë të të cilave komiteti ekzekutiv duhet të marrë masa kundër atyre që nuk mbajnë pastërti. Këto ligje e rregulla mund të mos i dijë të gjitha kryetari, ai duhet t'i njohë ato në përgjithësi, por përgjegjësit përkatës i dinë ato në detaje. Janë të gjitha mundësitë që këto gjëra të kryhen, por duhet të interesohet Partia, pse s'ka gjë që ta thotë Partia e të mos bëhet, veçse kjo duhet shoqëruar me një punë të gjerë politike dhe organizative. Në këtë mënyrë duhet të veprohet edhe për pastrimin e qyteteve jo me të holla, por duke mobilizuar masat, popullin, siç bëhet në Korçë. Ne duhet të arrijmë që qytetet të marrin një pamje tjetër dhe parqet të lulëzojnë. Mendoni pak sa do të kënaqej në një ambient të bukur, të qetë e të pastër ai që është i lodhur nga puna.

Me gjithë të metat që ka në Peqin, shokët atje punojnë, janë punëtorë të mirë. Por duhet t'i kërkojmë më tepër vetes, shokë. Prandaj, organizoni më mirë punën. Edhe Komiteti ekzekutiv i qarkut të Elbasanit

duhet t'ju ndihmojë më tepër. Organet e pushtetit në rrethe kanë vartësi edhe nga Presidiumi i Kuvendit Popullor, jo vetëm nga Kryeministria. Prandaj ndihma duhet të jepet më mirë edhe këtej nga lart. Kjo do të shpjerë në një forcim e demokratizim të mëtejshëm të pushtetit tonë popullor në të gjithë hierarkinë e tij.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TE FORCOJME ME SHUME DREJTIMIN NE CESHTJET E BUJQESISE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

29 tetor 1954

Jam dakord me vërejtjet që bënë shokët. Kritikkat janë të hidhura, por na bëjnë mirë, prej tyre nxjerrim mësim. Të jemi të ndërgjegjshëm për dëmin që i shkaktojmë popullit dhe ekonomisë së tij. Dobësitë që ekzistojnë në bujqësi e kanë burimin në mungesat tona, duke përjashtuar ndonjë arsye objektive. Të gjithë kemi përgjegjësi për këtë gjendje, por në mënyrë të veçantë kanë përgjegjësi disa shokë të Ministrisë së Bujqësisë, të cilët pandehin se bujqësinë e kanë në duar, se janë bërë kompetentë. Një pikëpamje e tillë më duket se është e gabuar dhe patjetër ajo shpie në gabime. Duke marrë parasysh se bujqësia në vendin tonë

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi realizimin e planit të prodhimit të drithërave e bimëve industriale dhe mbi grumbullimin e drithërave të bukës», paraqitur nga Drejtoria e bujqësisë pranë aparatit të KQ të PPSH.

është shumë e prapambetur, me mungesa të mëdha mjetesh, me fshatarësi të një niveli të ulët kultural dhe të shpërndarë, të arrish në konkluzionin se «unë i di të gjitha dhe me një urdhër ose direktivë i zgjidh çështjet», është gabim i madh. Në rast se një njeri di, është shumë mirë për Partinë, po eksperiencia dhe vërejtjet e saja dhe të popullit janë shumë më të mira dhe kush i harron ato gabon rëndë. Prandaj drejtuesit e bujqësisë duhet të jenë më modestë në këtë drejtim, ashtu sikurse duhet të jenë edhe shokët e tjerë të Partisë kudo që punojnë, si në qendër dhe në bazë.

Është e domosdoshme që të gjithë ne të bëjmë kujdes të madh për problemet e bujqësisë, ashtu siç na porosit Komiteti Qendror, prandaj na bie detyra të mësojmë. Përgjegjësitë tona janë të mëdha dhe ato nuk mund të kryhen pa rritur aftësitë drejtuese, pa mësuar nga agroteknika dhe eksperiencia e pasur e fshatarëve, e cila është interesante. Ne nuk mund të pajtohemi me Maqon [Como] që thotë të mbjellim grurë atje ku fshatari mendon se nuk mbin. Eksperiencia na tregon se atje nuk duhet mbjellë grurë. Me një fjalë duhet t'i vëmë kujdes bujqësisë.

Po të shohim realizimin e planit në bujqësi, do të konstatojmë se atë na e rrëzon shumë sektori shtetëror, ndërsa sektori kooperativist, bile edhe ai privat qëndrojnë më lart. Në këtë shembull të keq të sektorit shtetëror ka influencuar sidomos ferma e Sukthit dhe e Maliqit në të cilat është punuar dobët. Në mënyrë të veçantë shokët drejtues të fermës së Sukthit duhen konsideruar shumë fajtorë, por për këtë ka përgjegjësi të rëndë edhe vetë Ministria e Bujqësisë, sidomos sho-

ku Maço që merret me sektorin shtetëror dhe që mendon se «i di të gjitha»; pastaj ka përgjegjësi edhe drejtori i fermës së Sukthit, i cili është një shok i mirë, i vendosur dhe me eksperiencë në sektorin e bujqësisë, po më duket se duhet të mbështetet më shumë te organizata e Partisë, që kjo ta udhëheqë si duhet tërë punën e fermës. Sukthi në radhë të parë dhe Maliqi në radhë të dytë kanë pasur mekanikë të mirë, prandaj nuk duhej të kishin dalë sivjet me rezultate kaq të dobëta, duke marrë parasysh edhe eksperiencën, vjetërsinë e kuadrove, mjetet që kanë etj. Çështja tani është që nga këto dobësi të nxjerrim mësim, të cilat të na shërbejnë për vitin tjetër dhe të mos vijmë më me këto rezultate. Për këtë qëllim qysh tani ne duhet t'u vëmë rëndësi mbjelljeve, të organizojmë mirë punën dhe të dalim me suksese.

Byroja Politike nuk mund të pranojë justifikimet e Ministrisë së Bujqësisë për feramat. Më duket se drejtuesit e saj duhet të jenë më operativë dhe më me inisiativë. Komiteti Qendror nuk do ta dënonte për shembull ministrin, i cili, për të shpëtuar grurin e fermave të kish marrë inisiativën duke dhënë edhe një pjesë të plehut kimik. Është e vërtetë se orientimi i Partisë është që plehu të shfrytëzohet për bimët industriale, po për të shpëtuar një situatë kritike mund të veprohet edhe kështu. Në këto raste, ndonjë shok kryesor që drejton një sektor të caktuar duhet të marrë edhe inisiativa, prandaj të mos merren strikt disa çështje. Kur bëjmë gabime të na dënojë Komiteti Qendror, po ai nuk do të na dënonte po të bindej se këtë ose atë masë ne e morëm me ndërgjegje, me qëllim që të shpëtojmë prodhimin.

Edhe unë mendoj si shokët që diskutuan se në Ministrinë e Bujqësisë dhe në aparatën e Komitetit Qendror ka burokratizëm të theksuar. U bë mirë që u ngrit çështja e studimit të problemeve, pse në përgjithësi edhe në thelb kjo është një detyrë që nuk kryhet si duhet; por unë them se studime duhen bërë si nga Ministria e Bujqësisë, ashtu edhe nga Drejtoria e bujqësisë pranë Komitetit Qendror, sepse është e domosdoshme që udhëheqja të informohet drejt se cilat janë problemet kryesore për të cilat kërkon të sqarohet Partia, ç'masa duhen marrë për forcimin e punës. Edhe ato studime që janë caktuar, megjithëqë kanë afate të gjata, nuk po kryhen si duhet. Kështu janë për shembull studimi i tokës, i gjedheve, i duhanit, i agrumeve ose disa studime të bëra nga Instituti i shkencave për farërat etj. Ka dy vjet që unë kam lexuar një libër të botuar nga Instituti i kërkimeve bujqësore, po si bëhet që baza nuk i ka këto studime, po mbeten në sirtaret e njërit apo të tjetrit? Kjo është e palejueshme. Është më mirë që këto studime të jenë në bazë, se sa të flenë këtu lart.

Studimet kanë rëndësi të madhe për bujqësinë tonë dhe po të mos i bëjmë ato, do të çalojmë. Mua më duket se edhe afatin e caktuar për studime mund ta shkurtojmë. Kur statistikat dhe vërejtjet i kemi, atëherë përse disa materiale duhet të qëndrojnë muaj të tërë nëpër duar? Komiteti Qendror ka Drejtorinë e bujqësisë me disa seksione, punonjësit e të cilave shkojnë në bazë, kontrollojnë e ndihmojnë dhe më në fund vijjnë këtu me vërejtjet dhe mendimet e tyre. Edhe Ministria e Bujqësisë ka një varg të tërë njerëzish. Prandaj ka mundësi

që kur kërkohet nga Byroja Politike të studjohet një çështje, më duket se konkluzionet nga ana e aparateve duhen hartuar dhe paraqitur shpejt. Po një punë e tillë nuk bëhet si duhet, pse njerëzit venë poshtë dhe s'tregojnë kujdesin e duhur të mbajnë dhe shënime. Kjo bën që kur kemi për t'i paraqitur ndonjë material Byrosë Politike ose qeverisë, atëhere punohet dy muaj me radhë. Kjo nuk është metodë e mirë pune. Prandaj njerëzit që venë poshtë duhet të mbajnë shënime dhe në çdo kohë të nxjerrin konkluzione prej tyre. Të angazhosh për hartimin e një raporti me dhjetëra njerëz, kjo nuk është e drejtë. Por edhe pa materiale të tilla nuk mund të bëjmë dot. Prandaj Ministria e Bujqësisë të luftojë për zhdukjen e burokratizmit, të jetë më operative për çështjet e bujqësisë, në radhë të parë për sektorin socialist, pa harruar sektorin privat, që është vendimtar pse sot përfaqëson shumicën e prodhimeve bujqësore.

Rol vendimtar duhet të luajnë edhe organizatat bazë të Partisë pa ndihmën e të cilave bujqësia nuk mund të ecë përpara dhe të zhvillohet me ritmet e duhura. Organizata bazë të jetë ajo që të luftojë për zhdukjen e burokratizmit. Ajo duhet të organizojë një cikël leksionesh me agronomët, teknikët, inxhinierët, të shohë si mbillet konkretisht në arë etj. Po të mos veprojmë si duhet organizata bazë e Partisë, Ministria e Bujqësisë vështirë se mund të përballojë këtë sektor kaq të madh e të rëndësishëm. Ç'të bëjë Ministria e Bujqësisë që këtej nga Tirana për plehun organik po të mos e marrë në dorë Partia në bazë këtë problem? Partia duhet ta shfrytëzojë kapacitetin e të gjithë nje-

rëzve të bujqësisë, duke zbatuar kështu direktivat e Komitetit Qendror. Këtu kemi përgjegjësi ne lart, po kanë përgjegjësi edhe organizatat e Partisë në bazë. Këtë situatë ne duhet ta ndryshojmë. Nuk mund të them se Partia s'është interesuar për problemet e bujqësisë, sepse ajo është kujdesur aq shumë, sa që ndonjëherë ka lënë pasdore sektorët e tjerë, gjë që s'është aspak e drejtë. Por unë mendoj se udhëheqja e Partisë ka mundësi ta organizojë më mirë zbatimin e detyrave në sektorin e bujqësisë dhe shfrytëzimin e eksperiencës që ka populli në këtë fushë. Kështu do të arrijmë rezultate më të mëdha.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verkali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TË KUJDESEMI MË SHUMË PËR PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË PUNËS DHE TË JETËS SË PUNËTORËVE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

29 tetor 1954

Është e tepërt të flasim për të kaluarën e minierave, pse me porositë që ka dhënë herë pas here Byroja Politike për problemin e qymyr gurit dhe urdhërat e dhëna nga qeveria, janë marrë masa më të forta dhe tani puna shkon më mirë sidomos për realizimin e planit të vitit 1954. Megjithatë, unë kam përshtypjen se prapa planit fshihen disa dobësi të enteve të ndryshme, sidomos nga ana e Ministrisë së Industrisë, që nuk e ka në kujdes të plotë problemin e qymyr gurit. Komiteti Qendror ka theksuar shumë herë se qymyr guri është

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi gjendjen e industrisë së qymyr gurit, perspektivat gjeologjike dhe masat që duhen marrë», paraqitur nga Ministria e Industrisë dhe e Minierave.

buka e industrisë sonë, nxjerrja e tij është vërtet e zorshme, por edhe interesimi e kujdesi nga ana e ministrisë për këto miniera veçanërisht për atë të Kërrabës e të Memaliajt nuk është në lartësinë e duhur ashtu si ka rekomanduar Komiteti Qendror. Ne jemi komunistë dhe si të tillë e ndjejmë përgjegjësinë që kemi para Partisë dhe popullit. Shokët që drejtojnë Ministrinë e Industrisë dhe të Minierave duhet të luftojnë më shumë e më mirë që të përmirësohet gjendja.

Në minierat e qymyr gurit duhet të ketë njerëz të fortë, njerëz partie në radhë të parë. Përgjegjësia përpara Partisë është shumë më e madhe se sa përgjegjësia penale. Komunisti, në rast se nuk e kupton kështu përgjegjësinë, nuk është komunist i fortë. Asnjë njeri nuk mund t'i shpëtojë përgjegjësisë penale kur ka bërë një krim karshi Partisë dhe popullit, por të përjashtohet nga Partia një komunist është njësoj sikur ai të pushkatohet. Në këtë drejtim, e sidomos kur kemi të bëjmë me një zanaq kaq të rëndë dhe me një klasë punëtore që po e rritim, duhet që çështjet të shihen në frymën e Partisë dhe Partia të punojë në bazë të ligjeve të veta. Edhe anëtari i Partisë punon në bazë të ligjeve të shtetit, paguhet edhe ai si të gjithë punonjësit, në kohë të vështirë anëtari i Partisë bën edhe sakrificat të mëdha, bile edhe vritet, po kjo nuk do të thotë që ai të punojë pa pagesë, megjithkëtë atje ku punon anëtari i Partisë duhet të shohë më parë interesin e Partisë dhe të popullit pastaj interesin e tij. Kjo ka rëndësi të madhe. Interesi i Partisë e do që një komunist të rrijë në minierë, mbasi ajo ka rëndësi të madhe për ekonominë e popullit dhe kur një komunist që e dërgon Partia thotë se do të vdes në

minierë, kjo tregon se ai e ka të qartë kuptimin e lartë të titullit «anëtar partie».

Organizata bazë e Partisë në minierë është ajo që ndihmon e kontrollon edhe drejtorin, i cili është njeri i Partisë, forcën dhe autoritetin atij ja ka dhënë Partia. Këtu u tha për punën e mirë që bëri rinia e minierës së Kërrabës kur asaj ju bë thirrje për zbritjen e qymyrgurit. Këtë ajo e bëri pse pa te drejtori, që i bëri thirrje, njeriun e Partisë. Partia atje ka punuar për rritjen e autoritetit të drejtorit, fjala e të cilit e mobilizoi rininë. Të neglizhuarit e forcës së rinisë në minierë është gabim, Partia duhet të interesohet për këtë forcë të madhe, e cila të punojë nën kujdesin dhe udhëheqjen e saj. Në qoftë se një drejtor ndër marrjeje s'interesohet për rininë, atëhere i thuhet sekretarit të organizatës së Partisë, i cili duhet ta shohë këtë çështje, të bisedojë me drejtorin dhe, po qe nevoja, ta shtrojë në mbledhje të byrosë së organizatës bazë, ku të kritikohet drejtori sipas rregullave të Partisë. Ju, shokë të Partisë, mos harroni të mbështeteni fuqimisht te Partia, të ngrini plotësisht lart rolin e saj, sidomos në minierë ku ka një terren shumë të përshtatshëm. Këtë e them që të mos nënvleftësohet roli i organizatës së Partisë, ose Partinë ta shohim te sekretari, pse sekretari është i zgjedhur nga organizata bazë. Partia te ju ka besim të plotë, pse aty është edhe elementi më i mirë i saj, prandaj për punët e Partisë në minierë, ju nuk duhet t'ju zërë as gjumi, t'i edukoni komunistët dhe punëtorët që të jenë luftëtarë të vendosur për të zbatuar direktivat e Partisë. Organizata e Partisë të ketë mirë nën drejtimin e saj rininë dhe bashkimet profesionale, të cilat të jenë mbështetje në çdo rast për

të forcuar punën në minierë. Të luftohet burokratizmi kudo që shfaqet në ndërmarrje, të vihet drejtori përpara përgjegjësisë dhe, në rast se detyrat nuk zbatohen, të vini deri në Komitetin Qendror, në qeveri, te kryeministri, kudo portat janë të hapura. Merrni në telefon menjëherë kur shihni se nuk zbatohen vendimet e qeverisë, pse ka dhe autoritete më të larta që ndërhyjnë për t'i zgjidhur problemet.

Përsa i përket çështjes së banesave, të përmirësimit të kushteve të jetesës për punonjësit dhe forcimit të punës në transport, nuk është vepruar me seriozitetin e duhur, siç doli edhe nga diskutimet e shokëve të Byrosë Politike. Komiteti i Partisë për Tiranën ka disa vërejtje në lidhje me ndërtesat e banimit, vërejtje të tilla mund të ketë edhe nga qarqet e tjera. Prandaj këto duhet t'i dimë, me qëllim që në hartimin e planit të shohim ku do të përqëndrohemi dhe, po qe nevoja, kuotat, brenda mundësive, t'i lëvizim. Shokët t'i vëmë përpara përgjegjësisë që të arrijmë jo vetëm realizimin e planit të qymyr gurit, por edhe ndërtimin e banesave. Gjirokastra për këtë çështje ka marrë edhe vendim, i cili duhet të kontrollohet e të zbatohet.

Disa kërkesa që bënë këtu shokët e minierave më duket se nuk janë të cekzagjeruara. Unë mendoj që për këto çështje Byroja Politike të kërkojë nga qeveria që të japë urdhërat përkatëse për plotësimin e tyre sa më parë duke marrë parasysh vështirësitë aktuale që kanë minierat p.sh. në Mborje bie 1,5 m. dëborë, prandaj për punëtorët jo vetëm duhet të jepen batanie, por ato të jenë edhe nga më të mirat. Të interesohemi konkretisht për minatorët ashtu si nëna për fëmijën e vet. Më duket

se as Byroja Politike as qeveria s'kanë përse t'i dënojnë ata shokë që marrin masa të drejta për të përmirësuar kushtet e punës dhe të jetës së minatorëve. Prandaj të bëhen përpjekje të tilla dhe të mos jemi shumë të ngurtë në këto gjëra, ndërsa jemi mjaft dorëlëshuar në mungesën e kontrollit, në burokraci, në vjedhjet etj. Nevojat e minatorëve duhet të plotësohen. Ka mundësi që edhe mjeku të vejë në Memaliaj dhe kjo të bëhet patjetër. Ç'na kushton ne që një autobus të shkëputet të shtunën në orën 6 mbas dite, të shkojë të marrë ata punëtorë të Kërrabës që duan të vijnë në Tiranë dhe t'i kthejë përsëri në minierë po atë natë, qoftë edhe vonë? Kjo do të ishte një kënaqësi e madhe për punëtorët. Edhe shkolla atje të fillojë të bëhet. Gjithashtu të merren masa serioze për spitalin dhe ambulancën, pse as në Petrelë nuk ka mjek dhe të caktohet organika e personeli tjetër. Për këtë qëllim në Kërrabë mjafton të bëhet dhe një barrakë prej dërrase. Çështjen e çizmeve për punëtorët e qymyr gurit qeveria mund ta shikojë veçanërisht dhe të marrë një vendim për t'i pakësuar ato si numër, por të bëhen më të forta. Edhe kinematë duhet të shfrytëzohen më mirë dhe aparatet të mos qëndrojnë 4 muaj kot siç ndodh në Voskopojë, ku punëtorët mbeten pa parë film. Komiteti i Partisë i Tiranës duhet të ndërhyjë pranë kinostudios për të dërguar në Kërrabë më shumë filma. Të gjitha këto të pasqyrohen në vendimin që do të marrim dhe të veprohet me seriozitetin më të madh dhe me zemër për t'ua plotësuar nevojat minierave. Të merren edhe inisiativa të tjera dhe të bëhen gjëra edhe jashtë atyre që janë parashikuar. Punëtorët i duan shumë përgjegjësit e tyre kur ata interesohen për gjithshka dhe,

duke qenë të rrethuar me kujdesin e Partisë e të pushtetit, ata hidhen në sulm për të realizuar planin.

Çështja e përmirësimit të kushteve të punës e të jetës ka rëndësi të madhe edhe për punëtorët e ndërtimit, pse edhe atje ka vështirësi. Ka raste që atyre u jepet vetëm bukë me ca kokrra ullinj. Kjo është e palejueshme. Në këto kondita s'kanë si qëndrojnë në punë punëtorët e ndërtimit. Vajta një ditë në Fabrikën e çimentos të Vlorës dhe vura re se për punëtorët e ndërtimit nuk mendohej si duhet se si punojnë e jetojnë. Prandaj edhe për ata duhet të merren masa. Çështja e furnizimit të punëtorëve në përgjithësi lihet në dorë të fundit. Kjo nuk është e drejtë, prandaj të marrim masa, të forcojmë iniciativën dhe të sigurojmë kushte më të mira edhe në sektorin e ndërtimit. Në këtë sektor me rëndësi ne nuk jemi pa specialistë, mbasi këtu ka njerëz të zot, që kanë dalë nga puna e madhe që është bërë gjatë dhjetë viteve në ndërtime. Njerëz të tillë sot mund të ngarkohen edhe me punë të mëdha organizative në ndërtim. Një specialist në ndërtim me eksperiencë kaq të madhe, bashkë me një shok të aftë si drejtues, mund të bëjë shumë që punët të ecin përpara. Pra, edhe në ndërtim, kryesorja është çështja e trajtimit të mirë të punëtorëve dhe e organizimit të punës.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

KUNDËR FRAZEOLOGJISË NË FAQET E SHTYPIT TONË

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

5 nëntor 1954

Edhe në shtypin tonë, sikurse në çdo sektor tjetër, kemi suksese. Gazeta «Bashkimi» po gjallërohet dhe kjo tregon se orientimi i Komitetit Qendror është i drejtë. Gazeta «Rinia» kërkohet e lexohet me interes. «Puna», sikurse u tha këtu, vete mirë, vetëm me këtë nuk duhet të kënaqemi, por duhet që atë ta bëjmë sa më popullore dhe konkrete. Por, me gjithë përparimet, ekzistojnë edhe disa të meta.

Kur flasim për lidhjen e shtypit me masat duhet kuptuar në radhë të parë se sa popullaritet ka gazeta, sa e gjallë është ajo dhe si pasqyrohen problemet e ndryshme në faqet e saja. Këto kanë rëndësi të madhe dhe këtej vijnë edhe çështjet e tjera.

Një nga vërejtjet që kam unë është se në organet

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth relacionit «Mbi punën e organeve të shtypit për forcimin e lidhjeve me masat», paraqitur nga Drejtorja e agjitacionit dhe e propagandës pranë aparatit të KQ të PPSH.

kryesore të shtypit tonë, shpeshherë, ka shumë formalizëm dhe shumë frazeologji, kundër të cilave ne duhet të luftojmë që t'i zhdukim dhe të bëjmë kthesë. Edhe vetë ne, udhëheqësit e Partisë si dhe drejtuesit e shtypit, kur shohim frazeologji në gazetë themi «ç'na grin edhe ky». Mua më duket se uji që vihet re në faqet e shtypit tonë e ka burimin në faktin se punonjësit e gazetave kryesore nuk mbahen në korrent si duhet për problemet e Partisë e të shtetit. Është e vërtetë se këtu në qendër bëhen mbledhje me gazetarë e shkëmbehet eksperiencë, por në praktikë s'po hiqet dorë nga frazeologjia boshe, redaktorët e gazetave vijnë rrotull frazave pa ide. Kjo situatë duhet të ndryshojë patjetër. Mendoj që, për vendimet që merren nga Partia dhe qeveria, të thirren nga drejtoritë e aparatit të Komitetit Qendror dhe nga dikasteret, kryeredaktorët e gazetave, të cilëve t'u shpjegohen shkaqet se çfarë e shtyn Komitetin Qendror ose qeverinë që morën këtë ose atë vendim. Për redaktorët e gazetave këto vendime nuk duhet të jenë të fshehta, me ndonjë përjashtim. Redaksitë e gazetave duhet të dinë se ç'probleme ka Partia dhe qeveria, pse ka plot vendime që dërgohen në bazë, të cilat nuk botohen. Kështu do t'u hapen horizontet shokëve që punojnë në gazetë dhe do të mund të shkruajnë më konkretisht.

Një rëndësi të madhe ka detyra e korrespondentëve. Nga njëra anë duhet thënë se ai që shkruan vetëm një herë në vit nuk mund t'i thotë vetes korrespondent. Nga ana tjetër, edhe mjaft shkrime të korrespondentëve janë të cekta. Prandaj, unë mendoj që të tregohet më tepër kujdes në zgjedhjen e korrespondentëve. Jo vetëm kjo që duhet bërë më mirë se deri tani, por i duhet kushtuar

rëndësi më e madhe edukimit ideo-profesional të korrespondentëve, mbajtjes së tyre në korrent të vazhdueshëm me problemet e Partisë, pse si korrespondentët profesionistë, ashtu dhe ata vullnetarë nuk duhet të jenë të shkëputur nga jeta, nga problemet, nga Partia. Si ju, shokë të redaksisë në qendër, që duhet të mbani lidhje me aparatën e Komitetit Qendror dhe Kryeministrinë, ashtu edhe korrespondentët në rrethe e në bazë, duhet të mba-hen afër dhe të ndihmohen në detyrën e tyre të rëndësishme.

Dëshiroj të them pak fjalë edhe për çështjen e letrave. Mua më duket se po të vijnë 50-60 letra në ditë është vështirë t'u jepet përgjegje një nga një. Rruga e zgjidhjes nuk është të shtojmë numrin e njerëzve që merren me sektorin e letrave në gazetë, por mendoj që çështjet e ngritura në letra mund të trajtohen në një artikull, në përmbajtjen e të cilit, njeriu që ka bërë letrën, të gjejë edhe përgjegjen. Mund të ndodhë që ndonjëri që dërgon një letër në redaksi, ta shikojë çështjen vetëm nga ana profesionale, kurse ne, duke ditur situatën, të japim përgjegje me anë të artikujve konstruktivë. Mund të ketë edhe raste që t'u përgjigjemi direkt autorëve të letrave, por ajo që ka rëndësi është që shtypi ynë duhet të nxjerrë konkluzione përgjithëse. Shumë kujdes duhet pasur për letrat anonime nga të cilat ka që s'janë të vërteta, por ka edhe që ngrenë probleme dhe duhen verifikuar.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

MBI DISA MASA PËR REALIZIMIN E PLANIT DHE PËR FURNIZIMIN E POPULLIT NË STINËN E DIMRIT

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

18 nëntor 1954

Këtë mbledhje po e zhvillojmë në lidhje me realizimin e planit. Stina e dimrit ka vështirësitë e saja, tani në malësi ka rënë dëborë deri në 1 m., natyrisht edhe shira do të bien. Realizimet e planeve tona janë 10-20 për qind më të ulëta në krahasim me ato të vitit të kaluar. Kjo ndodh edhe në sektorin e industrisë e të minierave, por veçanërisht në transport.

Përpara këtyre situatave ne duhet të marrim masa serioze, pse ndryshe do të gjendemi në vështirësi të jashtzakonshme. Prandaj që nesër të fillojmë nga një punë më e organizuar për realizimin e planit dhe të mos

¹ Në këtë mbledhje u diskutua «Mbi disa masa për sigurimin e realizimit të planeve ekonomike dhe për furnizimin e popullit gjatë stinës së dimrit...»

na spostojnë vëmendjen festat e 28 e 29 Nëntorit. Me këtë dua të them që të mos mobilizohemi vetëm për të propaganduar fitoret e arritura gjatë këtyre dhjetë viteve të pushtetit popullor, por paralelisht me këtë, të mobilizohemi edhe për të arritur rezultate të reja në punë, në radhë të parë duke plotësuar detyrat e planit. Partia dhe klasa punëtore kudo janë mobilizuar, por këtë çështje ne duhet ta marrim në dorë akoma më mirë.

Puna kryesore që duhet të kryejmë ne është, pikë-sëpari, të futim brenda prodhimet bujqësore, si misrin, pambukun dhe duhanin. Misri, sidomos, në shumë krahina është akoma në fushë. Veç kësaj, të organizojmë më mirë punën për grumbullimin e misrit, të fasuleve dhe të orizit. Me mish dhe lesh jemi mirë, 93 për qind dhe 94 për qind, kurse me oriz, vezë, misër dhe fasule jemi akoma prapa, prandaj duhet të aktivizohemi e të mobilizohemi më shumë për t'i grumbulluar ato.

Një tjetër problem i rëndësishëm është ai i transportimit të mallrave të ndryshme në destinacionin e caktuar, pa çrregullime siç ndodh disa herë. Nga mbledhja e Sekretariatit doli se drejtuesit e sektorit të komunikacionit duhet ta organizojnë më mirë punën, jo të zgjidhin për shembull problemin e lëndës për kombinatin e drurit në kurriz të sektorëve të tjerë, por me këto mundësi që kemi, të sigurojmë transportin në mënyrë të tillë që plani të realizohet kudo. Të transportojmë në radhë të parë qymyr gurin, kromin, bitumin, panxharin ta afrojmë në fabrikë, pambukun e duhanin t'i shpiem në depot e shtetit. Po kështu është edhe problemi i transportimit të të gjitha mallrave ushqimore, të caktuara në plan, për në destinacionet e parashikuara, në radhë të parë për në

vendet që në dimër rrezikohen nga blokimi prej dëborës.

Unë propozoj të caktohem i edhe ne, shokët e Byrosë Politike, që të merremi me zbatimin e këtyre detyrave dhe çdo mbrëmje të raportohet se çfarë u bë sot e çdo të bëhet nesër. Festën ta organizojmë mirë si këtu në Tiranë, ashtu edhe në rrethet e tjera, por ta përdorim atë për të rritur akoma më shumë mobilizimin e klasës punëtore dhe të të gjitha masave punonjëse për realizimin e planeve të shtetit. Mendimi im është që letrat dhe raportet t'i lëmë. Komiteti Qendror do të na kërkojë llogari pse nuk i kemi shqyrtuar të tëra çështjet që janë vënë në planin e punës, po kur t'i shpjegojmë që ato i lamë, pse u mobilizuam për të realizuar planin ekonomik të shtetit, besoj se do të na falë. Konkretisht propozoj që Hysniu të marrë nën drejtimin e tij problemin e grumbullimit dhe të futjes së misrit, orizit e fasuleve në depot e shtetit dhe të aktivizohen për këtë qëllim në radhë të parë organet e grumbullimit. Për këtë, përveç aparateve që ka Hysniu nën vartësinë e tij të tërhiqen edhe shokët e aparateve të Drejtorisë së bujqësisë dhe të Drejtorisë së organizimit të Komitetit Qendror. Ata të Drejtorisë së industrisë e të tregëtisë do të mobilizohen në tjetër drejtim.

Beqiri është i zënë me përgatitjen e paradës, po megjithatë edhe ai të marrë në dorë problemin e transportit për transportimin e mineraleve, të lëndës së parë për industrinë tonë, e sidomos të naftës. Kjo të mos bëhet shkak që të pengohet transportimi i sendeve ushqimore, industriale dhe i lëndës djegëse për qytetet. Ushqimet, në bazë të planit të tregëtisë, duhet të shkojnë në vendet e caktuara, në radhë të parë në zonat malore,

pastaj në dyqanet e Tiranës, të Durrësit etj. dhe kripa të shkojë në çdo vend. Puna të fillohet park më park pse atje ka konfuzion të madh dhe çështja t'u shpjegohet qartë të gjithë punëtorëve. T'u thuhet atyre se po vjen dimri, planet nuk i kemi realizuar dhe për këtë Komiteti Qendror ju bën thirrje të mobilizoheni totalisht për të kryer të tëra urdhërat që do të merrni nga lart në lidhje me zbatimin e planit. Të përgatiten, pra, politikisht njerëzit e transportit me parti dhe pa parti. Beqiri të shikojë se mos bëjë ndonjë sakrificë edhe nga ushtria.

Edhe Spirua është i ngarkuar me shumë punë të tjera, po megjithatë ai ka mundësi të marrë kontakt me drejtuesit e disa ndërmarrjeve kryesore dhe t'i aktivizojë ata që ta realizojnë planin. Përlua gjithashtu, bashkë me aparatit e tij, duhet të jetë në çdo fabrikë, kombinat, punishte etj. Por edhe në bazë të mos merrmi me çështje të vogla ose vetëm duke bërë mbledhje. Mund të mbledhen gjysmë ore punëtorët bashkë me komitetin profesional, t'u vihen detyra konkrete për të kryer, t'u thuhet atyre që të hidhen në sulm për të plotësuar planin dhe ata me siguri do të mobilizohen. Përsa i përket anës si do t'i kryeni këto detyra mund të mendoni vetë, mbasi keni edhe shumë njerëz të tjerë në dikaster që ju ndihmojnë. Prandaj i orientoni mirë ata në punë sidomos për këto 15-20 ditë. Mua më duket se këtë gjë mund ta bëjmë.

E gjithë Partia është e mobilizuar dhe punon që plani të realizohet, por gjendjes reale duhet t'i përgjigjemi edhe ne me disa masa më të forta politike dhe organizative. Vështirësitë natyrore duhet t'i kapërcejmë. Ja për shembull, Qafa e Malit mbi Gjirokastër u zu, atje

ka rënë mbi 1 m. dëborë dhe bagëtia është në rrezik të mbetet pa ushqim. Të mos harrojmë se akoma është nëntor. Shenjat atmosferike tregojnë se sivjet do të ketë dimër të madh, prandaj buldozerët duhet të jenë në gatishmëri të plotë. Brenda këtyre 1-2 muajve duhet të punojmë me heroizëm.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

**LETËR DËRGUAR KOMPOZITORIT KRISTO KONO
KU E URON PËR OPERETËN E PARË SHQIPTARE
«AGIMI»**

20 nëntor 1954

SHOKUT KRISTO KONO

Korçë

Ju uroj përzemërsisht sukses të madh për veprën tuaj, operetën «AGIMI» që shfaqet për herë të parë në Korçë. Opereta «AGIMI», e para vepër e këtij lloji në historinë e muzikës sonë, qoftë për ju fillimi i mirë për një sërë veprash të tjera kombëtare, ku të pasqyrohen veprat madhështore të popullit dhe të Partisë së tij heroike! Uroj gjithashtu që vepra dhe përpjekjet tuaja në krijimtarinë e frutshme muzikore të bëhen shembull dhe inkurajim për të gjithë kompozitorët e vendit tonë.

Partia e Punës e Shqipërisë i çmon shumë veprat e bukura të të gjithë kompozitorëve tanë dhe këta kanë te Partia e tyre ndihmësen dhe përkrahësen më të zjarrtë.

Ju lutem t'i transmetoni të gjithë kolektivit të artistëve dhe punonjësve të Teatrit të Korçës, urimet e

mija të përzemërta dhe suksese në punën e tyre krijuese. Të gjithë vëllezërve dhe motrave korçare, ju uroj nga zemra festën e madhe të lavdishme të 10-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë.

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 278 (1918), 20 nëntor 1954

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

10-VJETORI I ÇLIRIMIT TË SHQIPËRISË, FESTA E MADHE KOMBËTARE E POPULLIT SHQIPTAR¹

28 nëntor 1954

Dhjetë vjet më parë, më 29 Nëntor 1944, u çlirua përfundimisht Shqipëria nga pushtuesit e egër fashistë gjermanë dhe nga zgjedha shekullore e klasave sunduese e feudoçifligarëve dhe e borgjezisë së vendit që e kishin vënë veten e tyre në shërbim të fashizmit italo-gjerman dhe kishin shitur interesat e atdheut e të popullit. Për herë të parë në historinë e tij të lashtë, populli shqiptar mori në duart e veta pushtetin politik dhe ekonomik, u bë zot i fateve të tija dhe atdheu ynë hyri në rrugën e ndritur të ndërtimit të bazave të socializmit.

Fitoret e mëdha të revolucionit tonë popullor u arritën pas një lufte të gjatë dhe heroike që bëri populli ynë. Këto fitore u bënë të mundura vetëm në saje të marrjes në dorë të çështjes së Luftës nacional-çlirimtare nga Partia heroike Komuniste Shqiptare (më 1948 e ktheu emrin në Partia e Punës e Shqipërisë), e cila e çoi popullin në fitore.

Me revolucionin e madh socialist të Tetorit, revolucion që çau frontin e kapitalizmit dhe vendosi në një

¹ Artikull i botuar në gazetën «Pravda».

të gjashtën e botës shtetin e fuqishëm socialist, agoi dita e lirisë dhe e pavarësisë për popullin shqiptar.

Fitorja e lavdishme, me një rëndësi shumë të madhe historike për fatet e njerëzimit, që korri Bashkimi Sovjetik mbi hordhitë gjakatare të Hitlerit dhe të satelitëve të tij, ndihmoi në çlirimin e një varg popujve të Evropës dhe të Azisë, ndër ta edhe popullin shqiptar.

Gjatë dhjetë viteve të çlirimit të vendit, është bërë një kthesë rrënjësore në jetën e popullit shqiptar dhe në fatet e atdheut tonë. Para çlirimit Shqipëria, nën regjimin monarkist feudoborgjez të Ahmet Zogut ishte e varur politikisht dhe ekonomikisht, në fillim te anglezët dhe pastaj krejtësisht te Italia fashiste. Pavarësia e Shqipërisë ekzistonte vetëm në kartë. Në realitet populli vuante si kurrë ndonjëherë. Para çlirimit në Shqipëri 80 përqind e popullsisë ishin analfabetë. Në fshat mbretëronte mizerja e madhe, uriya. Në qytet ishte e njëjta gjendje. Përveç disa punishteve e fabrikave të vogla, në Shqipëri mungonte industria. Nga papunësia punonjësit shqiptarë braktisnin atdheun dhe shkonin në emigrim për të punuar, si në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Australi, Argjentinë, Brazil, Turqi etj. ku i priste shfrytëzimi i egër. Regjimi feudoborgjez i Zogut mbytëte çdo gjë të re dhe përparimtare dhe shtypte e shfrytëzonte pa mëshirë popullin. Nën regjimin e vjetër e antipopullor të Zogut fashistët italianë hodhën në duart e tyre të gjitha pasuritë: naftën, kromin, bakrin, bitumin. Feudalët shqiptarë filluan t'u shisnin tokat koncesionarëve italianë, të cilët hidhnin në rrugë të madhe fshatarët shqiptarë.

Në prill të vitit 1939, Italia fashiste e sulmoi dhe e

okupoi Shqipërinë. Populli shqiptar rroku armët dhe hyri në luftë për çlirimin e tij, kundër okupatorëve fashistë dhe tradhëtarëve të vendit. Në këtë luftë populli shqiptar fitoi lirinë, mposhti tiraninë, shkatërroi dhe likuidoi klasat shfrytëzuese, vendosi pushtetin e demokracisë popullore — formë e diktaturës së klasës punëtore, krijoi miqësinë e përjetshme e të pathyeshme me popujt e Bashkimit Sovjetik dhe me ata të vendeve të demokracive popullore.

Nën udhëheqjen e lavdishme të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe me ndihmën e popujve të Bashkimit të madh Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore, populli shqiptar, ju përvesh punës me një hov dhe me një entuziazëm të papërskruar për ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë.

Çfarë i sollën popullit shqiptar dhjetë vitet e çlirimit?

Reforma agrare, që mori fund në vitin 1946, e bëri fshatarin e varfër dhe të mesëm zot të tokës. Afro 45 për qind e ekonomive të varfëra fshatare morën tokë.

U shtetëzuan të gjitha koncesionet e huaja, minierat e burimet minerale si ato të naftës, të qymyrit, të bitumit, të bakrit etj. U shtetëzuan gjithashtu bankat, ndërmarrjet industriale, transporti, pyjet, tregëtia e jashtme u bë monopol i shtetit, u zhduk përgjithmonë papunësia.

Në ndërtimin e bazave të socializmit, gjatë këtyre dhjetë viteve të çlirimit, janë arritur suksese të konsiderueshme. U krijua industria e re kombëtare. Minierat tona të naftës, të qymyrit, të bakrit, të bitumit, të kromit, janë zgjeruar dhe prodhojnë më shumë se para

luftës. Ato janë mekanizuar e pajisur me maqineri të reja. Vetëm duke e krahasuar prodhimin e vitit 1954 me atë të vitit 1938, prodhimi i minierave tona është rritur në 5,6 herë.

Nën pushtetin popullor në Shqipëri u krijua industria e lehtë. Janë ndërtuar: Kombinati i tekstileve «Stalin», fabrika e sheqerit, kombinati i drurit, fabrika e fermentimit të duhanit, uzinat e zhveshjes së pambukut etj. Të gjitha këto fabrika e kombine janë pajisur me maqineri të teknikës së sotme. Prodhimi industrial, në fund të vitit 1954, në vendin tonë do të rritet 11,4 herë në krahasim me vitin 1938. Industria jonë e re nga viti në vit po e rrit prodhimin e artikujve të përdorimit të gjerë. Qarkullimi i mallrave të tregëtisë në fund të këtij viti do të rritet 150 për qind në krahasim me 1938. Në të gjithë qytetet tona, të mëdha e të vogla, shndrit drita elektrike. Është ndërtuar Hidrocentrali «Lenin», i cili furnizon me energji elektrike kryeqytetin dhe industrinë e tij. Tani është duke u ndërtuar një hidrocentral tjetër edhe më i madh mbi lumin e Matit. Të tilla janë frutet e mrekullueshme në fushën e industrisë të cilat ja dha pushteti popullor popullit shqiptar këto dhjetë vjet. Populli ynë këto ja detyron politikës së drejtë të Partisë së Punës si dhe ndihmës së Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore. E gjithë industria jonë është në duart e klasës punëtore të re. Punëtorët tanë patriotë e entuziaztë në punën e tyre mësojnë nga metodat e reja sovjetike. E lidhur ngushtë me fshatarësinë punonjëse klasa jonë punëtore, me besim të plotë, po e çon vendin në rrugën drejt ndërtimit të jetës së re.

Në lëmin e bujqësisë, me gjithë vështirësitë, janë arritur suksese të mëdha. Para luftës në vendin tonë traktori gati nuk njihej fare, tani, me qindra traktorë dhe makina të tjera bujqësore punojnë në fushat tona. Fshatarësia jonë përparimtare, përqafo me etje të madhe agroteknikën moderne në bujqësi. Pushteti popullor dhe Partia i kanë vënë rëndësi të veçantë zhvillimit të bujqësisë për ta nxjerrë përfundimisht nga prapambetja. Çdo vit kredi të konsiderueshme i jepen nga shteti fshatarësisë punonjëse për të përmirësuar prodhimet bujqësore, i jepen farëra të zgjedhura, kafshë pune dhe ndihmohet të përpunojë tokën. Në vendin tonë janë krijuar kooperativat e para bujqësore. Ato ngrihen mbi bazën e vullnetarizmit dhe këto janë bërë shembull për të gjithë fshatarësinë punonjëse për prodhime të larta, për organizimin e punës dhe për përmirësimin e jetesës. Po të krahasojmë shifrat e së kaluarës me ato të vitit 1954 ne do të shohim se në krahasim me vitin 1938 në vitin 1954 sipërfaqja e tokës së mbjellë është rritur 70 për qind. Vendi ynë nga një vend agrar më i prapambetur në Evropë, është shndërruar tash në një vend agraro-industrial dhe po forcohet vazhdimisht potenciali i tij ekonomik. Gjatë këtyre dhjetë viteve të çlirimit vendi ynë ka bërë reformat më të mëdha revolucionare në historinë e tij dhe zhvillon me hov të papërshtatshme forcat prodhuese. Mirëqenja në fshatin shqiptar nuk ka krahasim me të kaluarën. Fshatarëve u janë ulur detyrimet, taksat, janë ulur tre herë çmimet gjatë këtyre viteve. Me të gjitha këto masa që shteti ynë ka marrë që prej çlirimit e deri sot është ngritur standardi i jetesës, janë shtuar të ardhurat e popullsisë çdo vit. Po të

krahasojmë të ardhurat e popullsisë të vitit 1953 me ato të vitit 1950 ne do të shohim një rritje prej 56 për qind.

Në vendin tonë brenda këtyre dhjetë viteve të çlirimit është bërë një revolucion i madh në lëmin e arësimit dhe të kulturës.

Njerëzit e Shqipërisë së re, dhe në radhë të parë të rinjtë, janë të etshëm për kulturë dhe arësim. Në vitin 1955 do të zhduket te ne analfabetizmi, kjo plagë e tmerrshme e së kaluarës. Para çlirimit në vendin tonë, në fshatra e qytete, kishte vetëm 643 shkolla fillore dhe 11 shkolla 7-vjeçare dhe të mesme. Sot në Shqipërinë e popullit ka 2 140 shkolla fillore me 136 800 nxënës, 315 shkolla 7-vjeçare me 39 700 nxënës dhe 28 shkolla të mesme me 8 600 nxënës. I gjithë vendi është mbushur me një rrjet bibliotekash, me salla leximi, kënde të kuq e klube. Pushteti popullor çeli 6 institute të larta ku mësojnë lart nga 1 200 studentë. Gati 900 inxhinierë, agronomë, veterinerë, doktorë, ekonomistë e specialistë të tjerë të rinj janë hedhur sot në prodhim. Me qindra studentë të tjerë vazhdojnë studimet në vendet vëllezër.

Ruajtjes së shëndetit të popullit Partia dhe pushteti popullor i kanë dhënë një rëndësi të veçantë. Një rrjet i gjerë spitalesh, ambulancash, preventoriumesh janë ngritur në qytete e në fshatra. Në saje të këtyre masave po luftohet me sukses malarja, tuberkulozi e sëmundje të tjera. Ky kujdes i veçantë i Partisë ka bërë që shëndeti i popullit të përmirësohet.

Garanci e sigurtë e këtyre fitoreve të mëdha të korrura gjatë dhjetë viteve të çlirimit, si dhe garancia e së ardhshmes është Partia e Punës e Shqipërisë. është

aktivi i saj heroik i përbërë nga komunistë të kalitur në Luftën e ashpër nacional-çlirimtare dhe në luftën e klasave, i mbujtur me ideologjinë triumfuese dhe krijuese të marksizëm-leninizmit.

Partia luftoi, lufton dhe do të luftojë që radhët e saja të qëndrojnë kurdoherë të pastra nga çdo ideologji e huaj, që niveli ideologjik i Partisë të ngrihet çdo ditë, që komunistët shqiptarë të jenë shembull për çdo gjë, të jenë njerëz të guximshëm, krijues, të dashur me popullin dhe të sakrifikojnë edhe jetën për kauzën e shenjtë të popullit.

Partia zbuloi dhe shtypi pa mëshirë të gjitha komplotet e kurdisura nga reaksioni i brendshëm dhe i jashtëm kundër demokracisë sonë popullore.

Të gjitha këto detyra të mëdha, për krijimin e shoqërisë së re, Partia jonë i kryen me sukses për arsye se ajo udhëhiqet nga idetë e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit. Partia jonë gëzon simpatinë dhe dashurinë e pafund të popullit shqiptar. Partia është e lidhur me popullin në mënyrë të pazgjidhshme dhe atje qëndron forca e saj e madhe.

Këto fitore të mëdha që ka korrur populli dhe Partia jonë, gjatë këtyre dhjetë viteve, do t'i ruajmë dhe do t'i zgjerojmë pse Partia zbaton me rigorozitet vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste. Partia jonë do të punojë pa pushim për konsolidimin e pushtetit popullor. Partia do ta ruajë dhe do ta forcojë çdo ditë aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse, aleancë që është baza e pushtetit tonë popullor. Partia do ta zhvillojë kurdoherë e më shumë patriotizmin e masave të popullit dhe do ta edukojë atë me frymën e interna-

cionalizmit proletar. Ajo do të luftojë pa u lodhur për përmirësimin e vazhdueshëm të jetesës së punonjësve të vendit tonë. Partia jonë do të mësojë pa pushim nga eksperiencia e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, pse kështu ajo do të korrë kurdoherë fitore për popullin shqiptar, pse kështu ajo do të plotësojë me nder detyrën e madhe dhe të rëndë historike që i ka besuar populli shqiptar. Republika Popullore e Shqipërisë është dhe do të jetë një faktor paqeje në Ballkan dhe në Evropë. Politika e Partisë dhe e qeverisë sonë është një politikë paqeje, ajo është për fqinjësi të mirë me të gjitha shtetet që respektojnë të drejtat legjitime të vendit tonë.

Populli shqiptar, i udhëhequr dhe i edukuar me një patriotizëm të lartë dhe me internacionalizmin proletar nga Partia e tij e Punës, i lidhur ngushtë e për jetë me popujt e Bashkimit të madh Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore në Evropë dhe në Azi, po ecën përpara me hov, me guxim dhe po ndërton me sukses socializmin, po ndërton jetën e tij të lumtur.

Botuar për herë të parë, me shkurttime, në gazetën «Pravda» Nr. 332 (13265), 28 nëntor 1954

Botohet sipas tekstit të gazetës «Pravda» Nr. 332 (13265), 28 nëntor 1954

**FJALA E MBAJTUR NË MBLEDHJEN SOLEMNE
ME RASTIN E 10-VJETORIT TË ÇLIRIMIT
TË ATDHEUT**

28 Nëntor 1954

Të dashur shokë, vëllezër, motra dhe miq,

Sot populli shqiptar, i gëzuar e i lumtur në atdheun e tij të lirë dhe sovran, në pushtetin e tij popullor dhe i udhëhequr nga Partia e tij heroike e Punës, feston 10-vjetorin e çlirimit të plotë të Shqipërisë nga zgjedha e fashistëve okupatorë italianë dhe gjermanë e nga thundra shekullore e feudalëve dhe e borgjezisë së vendit.

Fitorja e madhe e popullit shqiptar që u arrit më 29 Nëntor 1944, nën udhëheqjen e vendosur revolucionare të Partisë Komuniste të Shqipërisë, është kurorëzimi i të gjitha përpjekjeve, kryengritjeve dhe luftërave të përgjakshme që ka bërë populli shqiptar gjatë shekujve dhe deri tani në kohët tona.

Gjergj Kastrioti, Skënderbeu, heroi legjendar i Shqipërisë, me të drejtë i tha popullit shqiptar: «... Lirinë nuk jua solla unë, atë e gjeta në zemrat tuaja...». Trimi i urtë i shekullit XV, që nuk e njohu kurrë dis-

fatën, por i mposhti ushtritë e sulltanëve osmanllinj dhe intrigat e princërve shqiptarë që përpiqeshin ta pengonin në krijimin e një shteti të unifikuar, u mbështet vazhdimisht te populli sepse e kishte kuptuar më së miri se populli s'ka mōrtje kurrë.

Historia e lashtë e popullit tonë, një ndër popujt më të vjetër të Gadishullit Ballkanik, tregon vitalitetin e madh të një populli të vogël, i cili ka pasë vendosur t'i rezistonte me çdo kusht shfarosjes dhe të rronte i lirë në vendin e tij. Shqiptarët mateshin në luftëra me armiq të egër dhe të pabarabartë, por faktet tregojnë se as barbarizmat as mjetet e shfarosjes nuk mundën ta thyejnë rezistencën dhe as të mposhtin ndjenjat e lirisë së një populli, të një grusht populli të vogël, siç është populli shqiptar. Legjionet e Cezarëve, hordhitë e osmanëve, intrigat e imperialistëve, tanksat dhe avionat e Hitlerëve e të Musolinëve kaluan mbi ne, na vranë, na gjakosën, na dogjën, por as na përkulën, as na mundën. Shqipëria dhe populli heroik shqiptar qëndruan në këmbë, të pamposhtur dhe më të fortë se kurrë. Populli shqiptar ruajti të paprekura gjuhën, kulturën, zakonet, kostumet, traditat e lirisë dhe të trimërisë. Më kot shtypësit imperialistë dhe borgjezia reacionare janë përpjekur dhe përpiqen t'i shtypin popujt dhe t'i skllavërojnë. Ata nuk kanë mundur dhe nuk do të mundin kurrë t'i shpëtojnë demaskimit dhe dënimit që u rezervon populli. Shembull mund të marrim popullin e vogël shqiptar. Qindra vjet me radhë ai luftoi dhe fitoi kundër turqve. Edhe pas vdekjes së Skënderbeut populli ynë kurrë s'e përkuli kurrizin, por mbajti lart flamurin e lirisë. Kryengritjet fshatare, si në Jug,

ashtu edhe në Veri të Shqipërisë, u shkaktuan kokëçarje të mëdha otomanëve dhe më vonë imperialistëve anglezë, gjermanë, amerikanë etj. Në luftërat ballkanike populli shqiptar mori pjesë me armë në dorë për t'u shpëtuar zinxhirëve të imperatorisë otomane dhe për të mposhtur planet robëruese të Kongresit të Berlinit, të Bismarkut¹ dhe të lordit anglez Bikonstild². Patriotët e shquar të «Rilindjes shqiptare», me armë dhe me shkrimet e tyre të zjarrita, i treguan botës se të drejtat e popullit shqiptar nuk mund të merreshin aq lehtë nëpër këmbë. Por ujqërit imperialistë i shtypën në gjak përpjekjet dhe aspiratat e popullit tonë.

Si rezultat i luftërave të popullit shqiptar, më 28 Nëntor 1912, plaku patriot Ismail Qemali, i rrethuar nga përfaqësuesit e popullit, ngriti në Vlorë flamurin kombëtar. Shqipëria shpalli pavarësinë e saj. Kjo qe një ngjarje e rëndësishme në jetën e popullit tonë, sepse ishte një hap i madh përpara në krijimin e shtetit të pavarur shqiptar. Por populli shqiptar shpejt u bind se vuajtjet e tija nuk kishin marrë fund, se në fuqi mbetën feudalët dhe vendin e okupatorëve turq e zunë imperialistët e perëndimit dhe veglat e tyre në Ballkan. Shqipëria përsëri u ricoptua. Qeveritë shqiptare të asaj kohe s'kishin asgjë të përbashkët me popullin, ato mbrojnë privilegjet e klasave sunduese, të feudoborgjezisë. Këto qeveri nuk i ndryshuan aspak marrëdhënjet eko-

¹ O. Bismark (1815-1898), personalitet politik e diplomat i Gjermanisë e Prusisë, themelues i imperatorisë junkero-borgjeze gjermane.

² B. Bikonstild (1804-1881), lider i Partisë konservatore angleze, kryeministër i Anglisë 1874-1880.

nomike dhe shoqërore feudale dhe gjysmëfeudale. Por fshatarësia jonë s'e kish në traditë ta përkulte kurrizin. Ajo u çua në kryengritje kundër princit kukull gjerman, Vedit, dhe kundër qeverisë së tij të përbërë nga pashallarë e bejlerë. E gjithë Shqipëria e mesme mori zjarr nën flamurin e vegjëlisë. Fshatarësia kryengritëse rrëzoi pushtetin e princit kukull dhe të bejlerëve që e pasonin, dogji kulla të feudalëve, konfiskoi pasuri të tyre, u ndau toka fshatarëve dhe krijoi pushtetin e këshillave të popullit. Por borgjezia që sa po lindte e tradhëtoi këtë kryengritje fshatarësh dhe, në koalicion me imperialistët dhe feudalët, i theu fshatarët kryengritës për arsye se konditat e nevojshme, zhvillimi i kapitalizmit dhe tok me të klasa punëtore me pararojën e saj, mungonin në vendin tonë. Më vonë, në 1920, përsëri populli ynë rroku armët dhe me gjithë lëkundjet e agallarëve luftoi kundër imperialistëve italianë dhe i hodhi këta në det. Përsëri në vitin 1924 populli u ngrit me armë në dorë dhe luftoi kundër koalicionit të feudalëve dhe të agentëve të imperialistëve perëndimorë me Ahmet Zogun në krye, e rrëzoi këtë dhe vendosi një qeveri demokratike borgjeze. Por qeveria demokratike borgjeze e 1924-s i pati ditët të shkurtëra. Ajo bëri gabime të rënda, nuk u mbështet si duhet në popull, nuk zbatoi reformat ekonomike, shoqërore dhe kulturore për të cilat luftoi populli. Ajo e la fshatarësinë në baltë dhe hyri në kompromise të rrezikshme me imperialistët dhe feudalët. Nga këto gabime dhe në këto rrethana imperialistët anglezë, amerikanë, italianë, gjermanë dhe të tjerë që s'ja kanë dashur kurrë të mirën popullit shqiptar, sollën në fuqi satrapin, Ahmet

Zogun, i cili vendosi mbretërinë e tij të terrorit dhe të shtypjes.

Sigurisht, përpjekjet gjigande të një populli të vogël, siç ishte populli ynë, që luftonte për pavarësi do të dështonin në një kohë kur raportet e forcave ndërkombëtare në Evropë dhe në botë qëndronin të pandryshueshme. Por kjo nuk vazhdoi, pse këto raporte forcash në arenën ndërkombëtare ndryshuan me krijimin dhe veprimtarinë madhështore të Partisë së lavdishme Bolshevike që themeloi Lenini i madh. Që prej vitit 1905, kur shpërtheu revolucioni në Rusi, një shpresë e madhe i pushtoi patriotët shqiptarë që luftonin për t'u çliruar. Çetat heroike çlirimtare të atyre kohëve, shkrimet e zjarra të poetëve dhe të shkrimtarëve patriotë, kryengritjet e fshatarëve të Shqipërisë së mesme, rezistenca e popullit kundër regjimit të feudalëve dhe më në fund partizanët e lavdishëm të Luftës nacional-çlirimtare, i prinin në beteja idetë ngadhënjimtare të revolucionit të madh të udhëhequra nga proletariati rus.

Në Revolucionin e madh socialist të Tetorit, kur proletariati i lavdishëm rus në aleancë të ngushtë me fshatarësinë përmbysi carizmin e urryer dhe klasat sunduese kapitaliste dhe nën udhëheqjen e Partisë së madhe Komuniste që themeloi Lenini i madh vendosi në një të gjashtën e botës regjimin socialist të punëtorëve dhe të fshatarëve, ndryshoi raporti i forcave në arenën ndërkombëtare, ndryshuan fatet e njerëzimit dhe u hap një epokë e re e lavdishme për të. Njerëzit e thjeshtë të botës panë, që në ditët e para, te Bashkimi Sovjetik farin që do t'u ndriçonte rrugën dhe mikun që do t'u jepte dorën për të shpëtuar nga shfrytëzimi

dhe robëria. Atdheu i madh i socializmit dhe i komunizmit i kapërceu me sukses të gjitha provat e tmerrshme dhe kurthet e përgjakshme që i rezervonte botës së re socialiste bota e vjetër kapitaliste. Bota pa të realizohen në jetë idetë ngadhnjimore të Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, pa superioritetin e regjimit socialist mbi atë kapitalist. Bashkimi Sovjetik, Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe njeriu sovjetik që farkëtuan dhe kalitën Lenini i madh dhe vazhduesi i veprës gjeniale të Leninit, Josif Visarionoviç Stalini, janë një shembull i madh për popujt dhe njerëzit e thjeshtë të botës. Vitaliteti i madh i regjimit socialist u vërtetua veçanërisht gjatë Luftës së dytë botërore kundër fashizmit gjerman dhe satelitëve të tij. Heroizmat e popujve sovjetikë dhe të Ushtrisë legjendare Sovjetike, drejtësia e kauzës për të cilën ranë me miliona njerëz, shkatërruan maqinën luftarake hitleriane.

Jam shumë i lumtur sot, në këtë ditë të gëzuar të festës më të madhe të popullit tonë, të përshëndes me gjithë zemër, në emër të popullit shqiptar, të qeverisë dhe të Partisë së Punës të Shqipërisë, delegacionin qeveritar sovjetik. Populli shqiptar, sot në këtë ditë të shenjtë, u betohet popujve vëllezër të Bashkimit Sovjetik, mbrojtësve dhe përkrahësve të tij, se dashurinë dhe miqësinë që ushqen për ta do ta çelnikosë dhe do ta ruajë si gjënë më të shenjtë.

Lufta nacional-çlirimtare është faqja më e ndritur e historisë së popullit shqiptar, pse ajo çliroi njëkohësisht atdheun nga zgjedha e okupatorëve fashistë, dërmoi përgjithmonë klasat sunduese feudalo-borgjeze, i dha pushtetin e plotë popullit, i siguroi këtij miqësinë me popujt

e Bashkimit Sovjetik, me popujt e vendeve të demokracisë popullore dhe me të gjithë popujt përparimtarë të botës dhe krijoi të gjitha mundësitë për ndërtimin e shoqërisë së re socialiste në vendin tonë. Natyrisht një program i tillë madhështor, që përmbledh të gjitha aspiratat dhe dëshirat e popullit, nuk mund të realizohej pa pjesëmarrjen e të gjithë popullit dhe pa udhëheqjen e një partie marksiste-leniniste, pararojë e klasës punëtore dhe e masave punonjëse, siç ishte Partia e lavdishme Komuniste e Shqipërisë, sot Partia e Punës e Shqipërisë. Populli dhe Partia e tij, të bashkuar si një trup i vetëm, janë farkëtuesit e kësaj vepre të shkëlqyer. Populli shqiptar e kurorëzoi me fitore Luftën nacional-çlirimtare edhe në saje të shkatërrimit të plotë të hordhive naziste nga Ushtria legjendare Sovjetike.

Partia jonë, e udhëhequr vazhdimisht nga shkenca marksiste-leniniste dhe nga eksperiencia e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, përpunoi një vijë të drejtë, të qartë për popullin dhe pa asnjë lëkundje e kompromis me okupatorët dhe veglat e tija. Këtë vijë të drejtë, në interes të popullit dhe të atdheut, ligji i vetëm dhe i shenjtë i saj, Partia jonë e mbrojti deri në fund me sakrifica të rënda të anëtarëve të saj, bijve heroikë të popullit tonë. Partia heroike Komuniste Shqiptare, pjellë e lavdishme e popullit shqiptar, trimëreshë, e pamposhtur dhe e urtë si vetë populli, e mbryjtur me idetë e Revolucionit të madh të Tetorit, me interesat jetike të popullit shqiptar në zemër, me «Historinë e Partisë Komuniste (bolshevike) të Bashkimit Sovjetik» në gji, ngriti lart flamurin e vegjëlisë, flamurin e popullit shqiptar dhe nëpërmjet betejash të përgjakshme e priu

popullin tonë, të grumbulluar në Frontin Nacional-Çlirimtar, në fitoren vendimtare, në fitoren më të madhe të historisë së tij shekullore.

Lufta çlirimtare e popullit që filloi më 7 prill 1939, kur vendi ynë u sulmua barbarisht nga ushtritë fashiste italiane të Musolinit dhe shkoi duke u zmadhuar deri në kryengritjen e përgjithshme, tregoi vendosmërinë e madhe të popullit, trimërinë e tij të papërshekrueshme, sakrificat e panumërta që bëri ai për të fituar lirinë dhe për të vendosur regjimin e vet të demokracisë popullore. Vështirësi të mëdha kapërcyen me sukses populli dhe Partia jonë gjatë rrugës së vështirë të luftës. Përveç terrorit të madh të okupatorëve dhe të tradhëtarëve, Partisë dhe popullit tonë ju deshën njëkohësisht të përballonin intrigat djallëzore të fashistëve, të kuislingëve, të feudalëve, të borgjezisë reaksionare dhe të fuqive imperialiste, të cilët, të gjithë të bashkuar, u përpoqën ta diskreditonin dhe ta izolonin Partinë tonë heroike nga populli, ta shpartallonin bashkimin politik dhe luftarak të popullit tonë që kishte krijuar dhe çimentuar Partia në Frontin Nacional-Çlirimtar, ta shpartallonin Luftën nacional-çlirimtare dhe t'i rrëmbenin popullit shqiptar fitoren nga duart. Reaksionarët në vendin tonë, të grumbulluar në organizatat tradhëtare «Balli Kombëtar», «Legaliteti» etj., ndoqën natyrisht rrugën e të parëve të tyre, u shitën te okupatorët e huaj për të përjetësuar okupacionin dhe për të ruajtur privilegjet në kurriz të atdheut dhe të popullit punonjës. Sigurisht koalicioni i feudoborgjezisë së vëndit me okupatorin do të thyhej, sikundër u thye prej energjive të mëdha revolucionare të popullit shqiptar, prej aleancës së klasës punëtore dhe

të fshatarësisë punonjëse që Partia Komuniste Shqiptare e krijoi, e farkëtoi dhe e çmoi si forcën e madhe lëvizëse të shoqërisë sonë. Feudoborgjezia tradhëtare që u përpoq të fshihte me lloj-lloj petkash pseudonacionale fytyrën e saj të përgjakshme dhe të shëmtuar, u demaskua, u izolua, u dërmua pa mëshirë nga forca e Ushtrisë heroike Nacional-Çlirimtare.

S'ka dyshim se Lufta nacional-çlirimtare, ku luhej fati i popullit shqiptar, na kushtoi shtrenjtë. Me dhjetëra mijë nga bijtë dhe bijat më të mira të popullit tonë dhe të Partisë ranë në fushat e nderit. Ju ftoj të nderojmë kujtimin e pavdekshëm të dëshmorëve të lavdishëm të popullit shqiptar që luftuan heroikisht dhe bënë fli jetën e tyre për lirinë e popullit dhe pavarësinë e atdheut! *(dëgjuesit ngrihen në këmbë dhe mbajnë një minutë heshtje)*. Armiku na dogji dhe na bëri shkrumb krahina të tëra, na shkatërroi ekonominë, rrugët, urat, portet. Minierat u hodhën në erë. Çdo gjë duhej ndërtuar që nga fillimi. Por çka ishte vendimtare, për fatin e popullit dhe për jetën e brezave të ardhshëm të vendit, u fitua. U fitua liria, u mposht tirania, u thyen dhe u dërmuan klasat sunduese, populli mori në duart e veta fuqinë, u vendos pushteti i demokracisë popullore, formë e diktaturës së klasës punëtore, u fitua miqësia e përjetshme me popujt e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore. Politika e drejtë, e urtë dhe guximtare marksiste-leniniste e Partisë sonë triumfoi plotësisht.

Më 29 Nëntor 1944, kur Ushtria jonë Nacional-Çlirimtare shporri nga toka atërore hordhitë e fundit të

Hitlerit dhe i ndoqi ato e i luftoi këmba-këmbës në tokat e Jugosllavisë, u hapën për vendin tonë perspektiva të reja, të shkëlqyera. Që prej kësaj date historike dhe deri sot, janë mbushur dhjetë vjet dhe gjatë kësaj periudhe dhjetëvjeçare është bërë një kthesë rrënjësore në jetën e popullit shqiptar.

Në ç'gjendje ndodhej Shqipëria para çlirimit? Nën regjimin monarkist feudal të Ahmet Zogut Shqipëria ishte krejtësisht e varur politikisht dhe ekonomikisht, në fillim te imperialistët anglo-amerikanë dhe pastaj te Italia fashiste e Musolinit. Pavarësia e Shqipërisë ekzistonte vetëm në kartë dhe populli vuante të zezat e ullirit. Aleanca e feudalit Ahmet Zogolli me Musolinin solli shkatërrimin e plotë të vendit tonë dhe i hapi rrugën okupacionit të Shqipërisë prej Italisë fashiste. Politika e brendshme e satrapit feudal, Ahmet Zogut, ishte politika e shtypjes së të drejtave të njeriut, e zhdukjes së të gjitha të drejtave demokratike, ishte një varg intrigash në kurriz të popullit nga feudalët dhe pasanikët, ishte një politikë korrupsioni, e hurit dhe e litarit, kundër çdo njeriu të thjeshtë dhe patriot, kundër çdo gjëje të re dhe përparimtare. Politika ekonomike e regjimit të Zogut mund të përmbliidhet me pak fjalë: braktisje krejtësisht e bujqësisë, shfrytëzimi në palcë i fshatarësisë nëpërmjet metodash më të egra mesjetare. Në fshatin tonë mbretëronte mizerja e madhe, uria, sëmundjet, injoranca. Në qytete po kjo gjendje e vajtueshme: nga njëra anë aparati burokratik dhe shtypës i regjimit të bejlerëve dhe të pasanikëve, nga ana tjetër populli që vuante nga uria. Sektori industrial ishte i panjohur për regjimin e Zogut, përveç disa punishteve të vogla në

duart e pasanikëve, ku shfrytëzoheshin në palcë punëtorët dhe artizanët. Papunësia ishte e madhe dhe punëtorët shqiptarë, të uritur, braktisnin atdheun dhe shkonin në emigracion në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Australi, Argjentinë etj., ku i priste po ai shfrytëzim i egër. Në këto kondita kaq të rënda dhe të vështira rronte dhe luftonte për të shpëtuar nga kjo tirani populli shqiptar. Nën regjimin e Zogut fashistët italianë «de facto» ishin zotër të vendit, ata zaptuan çdo gjë. Shfrytëzimi i minierave të naftës, kromit, bakrit, bitumit etj. u bë koncension i tyre. Të gjitha pikat strategjike të vendit tonë u okupuan prej fashistëve italianë. Bejlerët dhe feudalët e korruptuar dhe tradhëtarë ua shitën tokat koncensionarëve italianë, të cilët filluan të sillnin kolonët e tyre nga Italia dhe të dëbonin nga tokat e tyre fshatarët shqiptarë. Dumpingu i mallrave italianë mbuloi tregun shqiptar dhe thithi të gjithë lëndën e parë, deri te misri i gojës së popullit. Filloi të rritet dhe të mahet te ne borgjezia tregëtare e madhe spekulante, e cila u lidh me fashistët kundër popullit shqiptar. Këtyre mjerimeve të mëdha të popullit ju shtuan mjerimet e luftës. Por hallet për Shqipërinë morën fund me çlirimin. Shqipëria e dikurshme e mjeruar sot ka ndryshuar krejtësisht. Atdheu ynë i dashur sot është forcuar, është zbukuruar dhe është përmirësuar jeta e njerëzve.

Ç'i sollën popullit shqiptar dhjetë vitet e çlirimit?

Menjëherë pas çlirimit, Partia dhe qeveria jonë i vunë detyra të mëdha vetes për të rindërtuar vendin e shkatërruar dhe për të përmirësuar jetën e popullit. Programi revolucionar i Partisë dhe i qeverisë i entuziaz-

moi masat e gjera të popullit, të cilat, të organizuara, u hodhën në një punë kolosale për zbatimin e këtij programi madhështor. Populli shqiptar, guximtar dhe krijues, me zgjuarësinë e tij, me duart e tija të arta dhe me vendosmërinë që e karakterizon, brenda këtyre dhjetë viteve të çlirimit, ka bërë mrekullira në zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës së tij. Populli ynë pa qartëse politika ekonomike e Partisë dhe e qeverisë sonë, kishte për qëllim ngritjen sa më të shpejtë të nivelit të jetës materiale dhe kulturele të masave punonjëse që është ligji themelor i socializmit. Për t'ja arritur sa më shpejt këtij qëllimi, që në muajt e parë të çlirimit, u shtetëzuan dhe u bënë pronë e popullit bankat, minierat, fabrikat, mjetet e transportit. U konfiskuan pasuritë e borgjezisë së madhe tregëtare spekulante dhe u bënë pronë e popullit. Konkensionet e huaja morën fund. U fshinë borxhet e fshatarësisë dhe të popullit punonjës, i cili shpëtoi nga spekulatorët dhe fajdexhinjtë që i kishin pirë gjakun. Tregëtia e jashtme u bë monopol i shtetit.

Zbatimi me sukses i reformës agrare i dha fshatarit punonjës tokën, likuidoi pronarët e mëdhenj, varrosi feudalizmin. 70 211 familje fshatare të varfëra dhe pa tokë morën nga reforma agrare 172 659 hektarë tokë, 474 227 rrënjë ullinj, 5 923 kafshë pune etj. U krijua kështu sektori socialist i ekonomisë, i cili me ligjet e tij të ekonomisë socialiste, krijoi mundësitë që ky sektor të zhvillohet, të forcohet në mënyrë të harmonishme, proporcionale, të planifikuar. Këto masa revolucionare të Partisë dhe të pushtetit popullor, bazat e të cilit u hodhën që gjatë luftës, u zgjeruan edhe më tej. Më 11 janar

1946 Shqipëria u shpall Republikë Demokratike Popullore. Populli varrosi me luftë regjimin e vjetër të feudalëve dhe të borgjezisë, shkatërroi nga themelet aparatit shtypës të klasave sunduese dhe vendosi regjimin e demokracisë popullore, formën e diktaturës së klasës punëtore dhe të masave punonjëse, me anën e së cilës populli shqiptar fitoi për herë të parë në historinë e tij të gjitha të drejtat dhe liritë demokratike dhe shtypi pa mëshirë tentativat e armiqve të brendshëm, e armiqve të mundur dhe të shpronësuar, komplotet e imperialistëve dhe të agjentëve të tyre.

Në këtë mënyrë pushteti, nga një instrument shtypës dhe shfrytëzues në kurriz të popullit dhe në fitim të bejlerëve e të kapitalistëve, u shndërrua nga revolucionin ynë popullor në një instrument në duart e popullit për të shtypur dhe zhdukur kapitalizmin dhe shfrytëzimin e njeriut prej njeriut.

Që më 1946, me realizimin e reformave të mëdha ekonomike dhe shoqërore, siç ishin reforma agrare, shtetëzimi i minierave, industrisë, bankave, transportit, tregëtisë së jashtme, dhe me forcimin e pushtetit popullor, i ndërtuar që nga themelet mbi gërmadhat e pushtetit burokratik të feudoborgjezisë, vendi ynë, i udhëhequr nga Partia e tij Komuniste, kreu me sukses detyrat demokratike të revolucionit tonë dhe hyri me hapa të sigurtë në rrugën e ndërtimit të bazave të socializmit.

Mbi zhvillimin industrial. Dihet se vendi ynë ka qenë më i prapambeturi në Evropë nga ana industriale. Vetëm revolucionin popullor munda ta ndryshojë rrënjësisht këtë gjendje në një kohë shumë të shkurtër. Partia

jonë, e udhëhequr nga parimet marksiste-leniniste dhe në shembullin e eksperiencës sovjetike, i kushtoi dhe do t'i kushtojë edhe këtej e tutje një vëmendje të posaçme zhvillimit industrial si konditë pa të cilën është e pamundur të ndërtohet socializmi në një vend.

Në këtë drejtim janë ndërtuar: Kombinati i tekstilëve «Stalin», fabrika e sheqerit, Kombinati i drurit «Nako Spiru», uzinat e zhveshjes së pambukut, orizit, Fabrika e çimentos në Vlorë, fabrika e ekstrakt-taninit, ajo e fermentimit të duhanit, Uzina «Enver» e shumë të tjera. Është zgjeruar dhe modernizuar industria e naftës, e bakrit, kromit, qymyreve, bitumit. Është forcuar dhe zgjeruar industria ushqimore, ajo e lëndëve të ndërtimit, industria lokale dhe artizanati i kooperuar e privat.

Prodhimi i përgjithshëm industrial karakterizohet nga këta tregues: kundrejt 1938 më 1950 afro 4 herë dhe në 1954 afro 11,4 herë. Më 1955 parashikohet të jetë 11,7 herë. Përveç sektorëve industri-miniera, industria lokale dhe artizanati që zënë vendin kryesor me 73 për qind, janë të rëndësishme dhe në zhvillim e sipër edhe degët industriale jashtë këtyre sektorëve, si ato në vartësi të Bashkimit Qendror të Kooperativave të Konsumit, Komitetit të grumbullimeve, Ministrisë së Tregëtisë, të Ndërtim-Komunikacionit, të Shëndetësisë, Drejtorisë komunale etj. Si rrjedhim është rritur pesha specifike e prodhimit industrial në prodhimin e përgjithshëm nga 18,3 për qind që ishte më 1938, në 40,6 për qind më 1950 dhe 60,8 për qind më 1954.

Koeficientët e prodhimit për çdo banor më 1954 kundrejt 1938-s për disa artikuj kryesorë, janë këta: 25 herë më shumë energji elektrike, 28 herë qymyr

guri, 35 herë tekstile të pambukta, 23 herë lëndë të sharruar, 2 herë kripë.

Industria jonë zhvillohet në përputhje të plotë me ligjin ekonomik të zhvillimit të planifikuar proporcional të ekonomisë popullore dhe si rrjedhim prodhohen mjete prodhimi dhe mallra të konsumit të gjerë. Prodhimi i mjeteve të prodhimit kundrejt vitit 1938 ka qenë 4 herë më shumë më 1950 dhe 11,3 herë më shumë nga realizimi i pritshëm i vitit 1954, kurse ai i mallrave të konsumit 4 herë më shumë më 1950 dhe 10,5 herë më shumë nga realizimi i pritshëm i vitit 1954.

Ritmet në disa degë kryesore të industrisë karakterizohen kundrejt vitit 1938, respektivisht për vitet 1950, me realizimin e pritshëm të vitit 1954 dhe projektplanin e 1955-s nga këto shifra: nafta 311,6 për qind, 419,2 për qind dhe 436,9 për qind; qymyr guri 113,2 për qind, 4000 për qind dhe 5058,8 për qind; kromi 745,6 për qind, 1367,3 për qind dhe 1693,9 për qind; veshmbathja 546,1 për qind, 3370 për qind dhe 3301,1 për qind; energjia elektrike 513,5 për qind, 1900 për qind dhe 2209,1 për qind; materiali i ndërtimit 692,8 për qind, 2900 për qind dhe 2312,7 për qind. Dhe për disa artikuj kryesorë, kundrejt vitit 1938, respektivisht për 1950-n, me realizimin e pritshëm të 1954-s dhe projektplanin e 1955-s kemi këto ritme: nafta brut 1,2 herë, 1,6 herë dhe 1,8 herë; tekstilet e pambukta 3,2 herë, 44,4 herë dhe 45,8 herë; sapuni 78 për qind, 1,6 herë dhe 2,3 herë; lëndë druri e sharruar 16,3 herë, 29,5 herë dhe 32,4 herë; tulla dhe tjegulla 3,5 herë, 16,5 herë dhe 21,9 herë.

Ndërsa për artikujt e mëposhtëm, kundrejt vitit 1950, respektivisht për realizimin e pritshëm të 1954-s

dhe projektplanin e vitit 1955, kemi këto ritme: këpuçë dhe opinga 1,8 herë dhe 2,2 herë; mobilje dhe orendi 2,6 herë dhe 3,1 herë; prodhime poçerie 3,9 herë dhe 5,2 herë e kështu me radhë.

Vëmendje e posaçme i është kushtuar zhvillimit të industrisë ushqimore, e cila, kundrejt vitit 1938, më 1950 ka qenë 174,5 për qind dhe 750 për qind me realizimin e pritshëm të 1954-s; më 1955 parashikohet në 740 për qind. Këtu del se ç'kujdes tregon pushteti popullor për ushqimin e popullit. E kundërta ndodh në shtetet kapitaliste, ku ritmet në industrinë e mallrave të konsumit ose zbresin, ose kanë rritje shumë të ngadalshme, si për shembull në Greqi, kundrejt vitit 1950, prodhimi i industrisë ushqimore më 1951 ka qenë 110 për qind dhe 108 për qind në vitin 1952. Po kështu në Itali, kundrejt 1950-s, po në industrinë ushqimore, më 1951 prodhimi ka qenë 103 për qind dhe 107 për qind më 1952.

Ky zhvillim i vrullshëm i prodhimit industrial del më në dukje po të merret parasysh se vetëm në sektorët industri-miniera dhe industri lokale janë ngritur 169 ndërmarrje, kundrejt 60 që ishin më 1938, dhe në artizanat kemi 101 kooperativa, kundrejt artizanëve privatë të paorganizuar që ekzistonin më 1938. Janë ngritur mbi 40 ndërmarrje të tjera të reja, kundrejt 10 të paraluftës, që merren me prodhimin industrial, por që varen nga sektorë të tjerë.

Një tregues tjetër e bën akoma shumë më të qartë punën e madhe që është bërë në zhvillimin e prodhimit industrial. Ky tregues del nga numri i madh i artikujve të rinj që janë prodhuar gjatë këtyre dhjetë viteve në

vendin tonë. Këta janë afro 548. Nga këta artikuj industria ka prodhuar 88, artizanati 115, minierat 12, industria lokale 27, bujqësia 66, në shëndetësi janë prodhuar 222 dhe 18 në ndërtim e komunikacion, kurse numri i asortimenteve është disa herë më i madh.

Partia dhe qeveria janë preokupuar vazhdimisht që zhvillimi industrial i vendit të mos përqëndrohet në pak qytete ose qarqe, por të shpërndahet në mënyrë të harmonishme në të gjitha qarqet dhe afër lëndëve të para. Si rrjedhim i kësaj, prodhimi industrial global më 1954 (realizimi i pritshëm) rezultoi i shpërndarë sipas qarqeve kështu: Në Berat 5,8 për qind, në Dibër 2 për qind, në Durrës 14,4 për qind, në Elbasan 5,4 për qind, në Gjirokastër 5,5 për qind, në Korçë 13 për qind, në Kukës 0,8 për qind, në Shkodër 12,9 për qind, në Tiranë 28,6 për qind dhe në Vlorë 11,6 për qind.

Këto suksese të mëdha në zhvillimin industrial e kanë burimin në entuziazmin dhe vendosmërinë e klasës sonë punëtore të mrekullueshme, e cila çdo vit e më shumë ka shtuar përpjekjet për rritjen e rendimentit. Në industrinë nacionale p.sh. rendimenti më 1952 ka qenë 37,7 për qind më i lartë se në vitin 1951 dhe më 1953 ka qenë 11,4 për qind më i lartë se më 1952 dhe kështu me radhë. Lavdi klasës sonë punëtore! Përsëritje punëtorëve të shquar të vendit tonë, si Petro Olldashi i Kombinatit të Naftës «Stalin», Rexho Sinani i Minierës së qymyr gurit në Memaliaj, Dodë Preng Doda i Minierës së bakrit në Rubik, Safet Alushi dhe Afërdita Pashko të Kombinatit të tekstileve «Stalin», Rifat Muja i Fabrikës së çimentos në Shkodër, Rexhep Saraçi i Fabrikës së sheqerit në Korçë, Pashk Mirashi i sha-

rrave të Pukës, e qindra e qindra punëtorëve të tjerë pararojë të vendit tonë që punojnë me vetëmohim për t'i dhënë atdheut më shumë prodhime për të mirën dhe lumturinë e popullit tonë.

Këto suksese nuk përjashtojnë faktin se mund të ishin akoma edhe më të mëdha, po të mos ekzistonin akoma një sërë mungesash dhe të metash që ngadalësojnë rritjen e rendimentit në punë dhe si rrjedhim uljen e kostos. Është e domosdoshme që punonjësit e industrisë të përdorin të gjitha mundësitë, eksperiencën dhe aftësitë e fituara për një punë më të kualifikuar.

Të shtojmë përpjekjet për përvetësimin e teknikës çdo ditë e më shumë, kusht i domosdoshëm për rritjen e rendimentit në punë, për shfrytëzimin më rentabël të rnaqinerisë, për ritme prodhimi akoma më të mëdha.

Të shtojmë përpjekjet për shfrytëzimin e të gjitha rezervave të brendshme duke filluar nga eliminimi i humbjeve të kohës së punës, nga përdorimi me kursimin më të madh të çdo lloj materiali, nga vënja në jetë, gjerësisht, e eksperiencës sovjetike dhe të punëtorëve tanë më të mirë etj.

Të përmirësojmë çdo ditë e më shumë qëndrimin kundrejt punës, në mënyrë që disiplina në punë të mos jetë vetëm për një pakicë, por të bëhet një veti e domosdoshme për të gjithë dhe të jetë karakteristika dalluese e punonjësve, të cilëve u është besuar një pasuri shumë e çmueshme që duhet të ruhet si sytë e ballit dhe të shfrytëzohet sa më mirë.

Të përpiqemi të vëmë në praktikë me masa konkrete porosinë e Partisë dhe të qeverisë për uljen vazhdimisht të kostos së prodhimit, duke u preokupuar që jo

vetëm t'i japim popullit më shumë mallra, por t'ja japim me çmime sa më të ulëta dhe me kualitet sa më të lartë.

Çdo punonjës, i çfarëdo sektori, duhet të luftojë me të gjitha fuqitë e tija që të shtojë rendimentin në punë dhe të ketë parasysh vazhdimisht fjalët e Vladimir Iliç Leninit:

«Rendimenti i punës është, në fund të fundit, gjëja më e rëndësishme, gjëja kryesore për fitoren e rendit të ri shoqëror»¹

Në sektorin e bujqësisë janë arritur suksese të dukshme. Sipërfaqet e mbjella në vitin 1954 i tejkalojnë 70 për qind ato të vitit 1938 dhe prodhimi global bujqësor i së njëjtës periudhë është ngritur më tepër se dy miliard lekë më shumë se ai i vitit 1938. Kjo tregon lidhjet e ngushta të fshatarësisë me tokën që i dha pushteti popullor, përkrahjen e madhe të qeverisë dhe të Partisë. Fshatari në Shqipërinë e tij popullore është i gëzuar se tokën e ka të tijën dhe prodhimet i ka të tijat dhe jo më për beun dhe aganë. Rezultatet e punës së tij e provojnë këtë. Sipërfaqja e mbjellë me drithërat e bukës është shtuar sivjet 37,9 për qind më shumë se në vitin 1938 dhe prodhimi total i drithit të bukës për të njëjtën periudhë është 29,4 për qind më i madh. Ajo tokë që ishte më parë e braktisur dhe nuk prodhonte, jo vetëm që e ka shtuar prodhimin e bukës, por në vitin 1954, në krahasim me 1938-n, janë mbjellë 7098,6 për

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 29, f. 474.

qind më shumë pambuk, 239,8 për qind më shumë duhan dhe kultura e panxhar sheqerit është përhapur kudo në zonën më pjellore të Korçës. Po të krahasojmë rritjen e rendimenteve të kulturave të ndryshme, ne do të shohim se në vitin 1954 u prodhuan 180,8 për qind më shumë grurë, 108,6 për qind më shumë duhan, 1031,7 për qind më shumë oriz, 66 herë më shumë pambuk nga sa prodhohej në vitin 1938.

Si u arritën këto rezultate? Këtu sigurisht pasqyrohet ndihma e madhe e pushtetit. Shumë toka që në të kaluarën ishin moçalishte, sot janë kthyer në fusha të bukura dhe pjellore.

Brenda këtyre 10 viteve janë hapur 4 200 km. kanale kulluese si ai i Ventrokut në Korçë, janë tharë dhe bonifikuar 50 000 hektarë tokë si kënetat e Maliqit, e Rushkullit në Durrës, e Kavajës, Levanit. Një kjo.

E dyta, vetëm në pushtetin popullor u bë i mundshëm përdorimi në shkallë të gjerë i ujit të lumenjve për të ujitur fushat. Brenda këtyre 10 viteve janë hapur 189 kanale ujitëse dhe sipërfaqja e ujitshme është rritur rreth dy herë e gjysmë në krahasim me vitin 1938.

E treta, fshatarësia punonjëse, gjatë këtyre 10 viteve është furnizuar nga shteti me materiale dhe inventar bujqësor të konsiderueshëm, rreth 564 000 kv. farëra të zgjedhura dhe të shumëllojshme, rreth 420 000 kv. plehra kimike, mbi 400 milion lekë në formë krediti agrar, përveç mijëra plugjeve, kultivatorëve, lesave, makinave bujqësore etj. E gjithë kjo ndihmë e madhe që i është dhënë fshatarësisë, influençoi rrënjësisht në zhvillimin e bujqësisë.

E katërta, për të parën herë në bujqësinë e vendit

tonë, pushteti popullor solli nga Bashkimi Sovjetik traktorë të fuqishëm, maqineri bujqësore moderne, auto-kombajna, të cilat punojnë në fushat e atdheut tonë. Sot funksionojnë 13 stacione të maqinave dhe të traktorëve, fuqia motorike e të cilëve është rritur 8,5 herë më shumë në krahasim me gjendjen e vitit 1947 dhe kjo fuqi motorike punon një sipërfaqe toke prej 149 741 hektarë unitet hamullor më shumë se në vitin 1947.

E pesta, në bujqësinë tonë janë futur metoda të reja të agroteknikës së përparuar sovjetike. Fshatari ynë i përqafton me etje të madhe këto metoda dhe u shikon rezultatin. Pushteti popullor i ka dërguar fshatarit për ta ndihmuar 126 agronomë të lartë dhe inxhinierë pyjesh, 51 zooteknikë dhe veterinerë të lartë, 14 inxhinierë bonifikimesh, ndërtimi, mekanikë e të tjerë, 606 teknikë të mesëm bujqësorë të shumëllojshëm. Ai ka hapur për bijtë e fshatarëve dy shkolla njëvjeçare të mekanikës bujqësore, dy shkolla të ulëta bujqësore njëvjeçare, një shkollë dyvjeçare për kooperativat, tre teknikume bujqësore dhe një Institut të lartë bujqësor me 291 studentë në degë të ndryshme të bujqësisë. Janë ngritur në vendin tonë inspektoratet shtetërore të farërave, Instituti i kërkimeve shkencore bujqësore në Tiranë, qendra e studimit zooteknik në Shkodër dhe seksioni i bujqësisë pranë Institutit të shkencave.

E gjithë kjo punë e frutshme në bujqësi e ka ndryshuar krejtësisht gjendjen e fshatit tonë nga e kaluara. Atje nuk ekziston më mizerja, uria dhe prapambetja. Jeta e fshatarit tonë ka ndryshuar si nata me ditën në krahasim me të kaluarën e zezë. Përpara këtyre rezultateve, padronët e papagallo të «Zërit të Ame-

rikës» thyejnë turinj të dhe bëhen qesharakë. Por, a mos pret gjë fshatari ynë nga Ali bej Këlcyra, Eqrem bej Vlora, Gjon Marka Gjoni e të tjerë gjakpirës të fshatarësisë dhe të popullit tonë? Le të lehin qentë në hënëz, karvani ecën përpara.

Sektori socialist i bujqësisë, i cili përbëhet nga fermat shtetërore dhe kooperativiste bujqësore është zgjeruar dhe forcuar. Ai sot përbën 15 për qind të të gjitha tokave të mbjella të Republikës. Megjithëse pesha specifike e këtij sektori është akoma e vogël, në krahasim me sektorin individual, roli i tij është i konsiderueshëm në shtimin e prodhimit bujqësor dhe në edukimin e fshatarësisë për ndërtimin e socializmit në fshat. Mjafton të përmendim se vitin e kaluar sektori socialist prodhoi 13,1 për qind grurë, 6,3 për qind misër, 22,8 për qind oriz, 25 për qind pambuk dhe 64 për qind panxhar nga sasia e prodhimit total të Republikës.

Kooperativat bujqësore, në përgjithësi, janë bërë shembull për ekonomitë individuale, ato janë forcuar ekonomikisht dhe organizativisht dhe jeta e anëtarëve të tyre është përmirësuar në mënyrë të dukshme. Duke përfshirë edhe kooperativat e ngritura këtë vit, sot në 150 fshatra të Republikës rreth 8 562 ekonomi që janë baras me 5,3 për qind të të gjitha ekonomive fshatare, me 51 184 frymë dhe me një sipërfaqe prej 32 253 hektarë që është barazi me 9,27 për qind të të gjithë sipërfaqes, janë organizuar në kooperativa.

Në vitin 1953 kooperativat bujqësore prodhuan për çdo hektar: 3,3 kv. grurë, 1,6 kv. misër, 2,8 kv. pambuk dhe 114 kv. panxhar më shumë se sa sektori individual. Është për t'u lavdëruar veçanërisht puna e kooperati-

vistëve të qarkut të Korçës, të cilët në vitin 1954 siguruan rendimente shumë të larta në krahasim me ekonominë individuale. Sukseset e arritura nga kooperativat bujqësore kanë ngjallur interesimin dhe dëshirën e fshatarësisë për krijimin e kooperativave të reja.

Megjithëse blegtoria, e dëmtuar rëndë nga lufta, akoma nuk ka një zhvillim të kënaqshëm, në shumë lloj kafshësh e ka tejkaluar gjendjen e paraluftës, veçanërisht në gjedhet 1,3 për qind, në dhëntë 9,3 për qind, në derrat 370 për qind, në shpendët 31,4 për qind dhe në bletët 76 për qind. Gjithashtu rezultate të dukshme janë arritur në zhvillimin e frutikulturës. Deri në fund të këtij viti, në krahasim me gjendjen e vitit 1938, numri i pemëve frutore arrin në 233,4 për qind më shumë, i ullinjve 19,4 për qind më tepër dhe i agrumeve 143,7 për qind më shumë.

Plani 15-vjeçar i zhvillimit të kulturës së ullirit dhe plani 7-vjeçar i zhvillimit të apikulturës që aprovuan Komiteti Qendror dhe qeveria vitin e kaluar, si dhe plani 15-vjeçar i zhvillimit të agrumeve, të frutikulturës dhe të vitikulturës në vendin tonë, që do të aprovohen për së shpejti, kanë një rëndësi të madhe për ekonominë popullore. Realizimi i tyre me sukses do ta shndërrojë vendin tonë në një kopësht të bukur për prodhimin e ullirit, agrumeve, frutave, rrushit, verërave, mjaltit, që janë aq të rëndësishëm për ushqimin e popullit tonë dhe për të shtuar eksportimet.

Në luftën për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë, për forcimin e rendit socialist në fshat, nën kujdesin e Partisë dhe të qeverisë, duke përvetësuar dhe zbatuar shkencën agronomike dhe eksperiencën sovjetike në

bujqësi, me mijëra punonjës të bujqësisë të fermave shtetërore, të stacioneve të maqinave dhe të traktorëve, të kooperativave bujqësore dhe fshatarë individualë, dallohen për rendimente të larta në punë dhe në prodhime bujqësore. Të tillë janë traktoristi Budo Isufi nga Shkodra, i cili punon për llogari të vitit 1958, prodhuesi i dalluar i grurit, Zenel Sula, nga Durrësi që ka marrë 45 kv. për hektar, Miftar Poliqi nga Peshkopia që ka marrë 95 kv. misër për hektar, Ali Jagodina nga Elbasani që ka marrë 32 kv. pambuk për hektar, një kooperativiste në rrethin e Korçës që ka marrë 900 kv. panxhar për hektar, Andon Belshi nga Elbasani që ka marrë 20 kv. duhan për hektar, ose kooperativa e Terovës që mori 22,5 kv. grurë për hektar në 67 hektarë, apo ferma e Cërrikut që mori 17,05 kv. grurë për hektar në 235 hektarë dhe kooperativa e Kamicës që mori 9,5 kv. duhan për hektar në 19 hektarë.

Ekspozitat bujqësore që u çelën gjatë muajit tetor në të gjitha qarqet e Republikës, ku morën pjesë 19 700 prodhues të dalluar të bujqësisë, midis të cilëve 1 520 gra, treguan se si po rritet ushtria e ndërtuesve të socializmit në fshat, se si po ngrihet ndërgjegjja ndaj punës për kryerjen me nder të detyrave që u ka caktuar Partia dhe qeveria për zhvillimin e bujqësisë.

Rezultatet që kanë arritur në bujqësi këta prodhues të dalluar janë një dëshmi e gjallë e realitetit të mundësive dhe të rezervave që ekzistojnë në bujqësinë tonë.

Por këto rezultate që janë arritur në bujqësi gjatë këtyre dhjetë viteve, janë akoma të pamjaftueshme. Prodhimet bujqësore dhe blegtorale akoma nuk i këna-

qin kërkesat e popullit, nevojat e industrisë me lëndë të parë dhe eksportet tona. Bujqësia ka rezerva të mëdha dhe këto rezerva duhen shfrytëzuar për të mirën e popullit.

Plani i parë pesëvjeçar dhe plenumet e Komitetit Qendror të dhjetorit 1953 dhe të prillit 1954, na kanë vënë si detyrë të madhe dhe urgjente përmirësimin e vazhdueshëm dhe me një ritëm më të shpejtë të mirëngjes materiale dhe kulturele të popullit. Për këtë qëllim ne duhet të disponojmë akoma më shumë prodhime bujqësore dhe blegtorale, me të cilat duhet të na furnizojë bujqësia.

Prandaj duhet t'i kushtohet kujdes i posaçëm punës për rritjen e rendimenteve për hektar të kulturave bujqësore. Sot punimet fushore, zgjedhja, pastrimi dhe ruajtja e farërave, mbjelljet dhe shërbimet kulturele të bimëve, që janë faktori vendimtar për prodhime të bollshme në bujqësi, nuk bëhen në kohë dhe me kualitetin e duhur.

Një vëmendje e posaçme i duhet kushtuar blegtorisë. Duhet të merren masa serioze për sigurimin e bazës ushqimore dhe të strehimit të blegtorisë për dimër që janë kondita të domosdoshme për zhvillimin e saj.

Duhet t'i jepet fund shfrytëzimit të dobët të mjeteve të punës, të maqinerive bujqësore dhe të forcës motorike, të forcohet organizimi i punës si në sektorin socialist, ashtu edhe në atë privat dhe të mos lejohet ashtu si ndodh sot që prodhimet bujqësore qëndrojnë në fushë dhe rrezikohen të dëmtohen nga faktorët atmosferikë.

Duhet luftuar me këmbëngulje kundrejt të meta-

ve që ekzistojnë në drejtimin e punëve të bujqësisë. Organet e bujqësisë, si në qendër dhe në periferi, duhet të dalin nga burokracia e shkresave dhe e formularëve, të njohin nevojat e bujqësisë në vend dhe t'i japin ndihmë praktike bazës në zgjidhjen e problemeve.

T'i vihet kujdes i veçantë punës propagandistike midis punonjësve të bujqësisë për t'i njohur ata me realizimet e shkencës, me agroteknikën e përparuar, me eksperiencën sovjetike dhe me eksperiencën e punonjësve të dalluar të bujqësisë sonë për t'i vënë ato në shkallë të gjerë në jetë.

Zhvillimi i mëtejshëm i të gjitha degëve të bujqësisë është një nga detyrat kryesore dhe urgjente për të gjithë punonjësit e vendit tonë. Për të zgjidhur me sukses këtë detyrë duhet, në radhë të parë, të mobilizohet më mirë Partia dhe organet e pushtetit në bazë, të përmirësohet rrënjësisht puna e organeve të bujqësisë në qendër dhe poshtë, të mobilizohen më shumë njerëzit e shkencës dhe të kulturës, të industrisë dhe të ndërtimit, të tregëtisë dhe të kooperativave për t'i kryer me kohë dhe mirë detyrat që u ka caktuar Partia në drejtim të bujqësisë dhe të fshatit.

Një kujdes shumë i madh dhe një ndihmë e madhe do t'i jepet sektorit të bujqësisë nga Partia dhe qeveria, në mënyrë që bujqësia të dalë përfundimisht nga prapambetja dhe t'i përgjigjet si duhet nevojave të popullit dhe të industrisë.

Të gjithë kuadrot e Partisë dhe të pushtetit që merren me bujqësinë, të gjithë kooperativistët dhe fshatarët duhet t'u kushtojnë një vëmendje shumë të madhe problemeve bujqësore, të mos i lënë këto të

zgjidhen në mënyrë spontane, por të studjojnë dhe të zbatojnë metodat e përparuara agroteknike, duke i përshtatur ato me klimën, me tokën, me kulturat e ndryshme dhe në rajone të ndryshme. Toka, mëma që pjell për popullin kaq pasuri, duhet trajtuar me kujdesin më të madh, në mënyrë që çdo pëllëmbë tokë e punuar mirë, e plehëruar si duhet, e lesuar, e ujitur etj., të na japë maksimumin e prodhimeve. Vetëm me një kujdes të tillë për tokën, për farërat, për bimët, për kafshët e punës dhe për veglat bujqësore do t'i japim vendit tonë prodhime të bollshme. Kjo është një detyrë e madhe që ne duhet ta plotësojmë si duhet. Ne duhet të jemi kurdoherë realistë dhe të mos kënaqemi me pak e të mos mendojmë se çdo gjë do të realizohet pa luftë dhe pa përpjekje. Është krejt e vërtetë se kurrë ndonjëherë nuk është parë një aktivitet i tillë krijues i masave. Ky është faktori vendimtar i sukseseve tona, por lufta e klasave në fshat nuk është shuar dhe nuk duhet neglizhuar. Pengesa ne do të hasim në rrugën tonë dhe këto ne duhet t'i kapërcejmë.

Shumë rëndësi i është kushtuar gjatë këtyre dhjetë viteve zhvillimit të komunikacionit si sektor jetik për zhvillimin e gjithanshëm të vendit. Përveç zhvillimit të madh që kanë pasur gjatë këtyre dhjetë viteve transporti automobilistik dhe ai detar, për të parën herë populli ka sot edhe transportin hekurudhor.

Nga 112 mijë ton mallra që lëviznin përmes transporteve automobilistike dhe detare më 1938, më 1954 (realizimi i pritshëm) lëvizin, përmes të tre llojeve të transportit, 1 462 000 ton. Nga 44 mijë pasagjerë që lëviznin më 1938, më 1954 (realizimi i pritshëm) lëvizin

3 190 000 pasagjerë. Më parë nuk ekzistonte shërbimi urban, kurse me këtë lloj shërbimi lëvizin 4 770 000 njerëz.

Lëvizja e «njëqindmijshtit»¹ ka përfshirë 307 shoferë, nga të cilët 65 e kanë tejkaluar njëqindmijshtin. T'i nderojë populli ynë shoferët tanë heroikë, si Nasho Vasil Batiava i parkut automobilistik të Sarandës, Jorgo Mitrojorgji i parkut automobilistik të Tiranës, Xheladin Jakupi e Haki Duro të parkut të Shkodrës, Koço Afezulli i parkut të Durrësit e shumë të tjerë që janë në ballë të luftës për ndërtimin e socializmit.

Shërbimi postar ka marrë një zhvillim të jashtëzakonshëm. Si rrjedhim linjat telegrafike gati janë dyfishuar kurse ato telefoniket janë shtuar 47,3 herë më shumë. Janë shtuar stacionet radiofonike nga 1 në 9 dhe kështu me radhë, qendrat postare në fshat dhe në qytet, numri i centraleve dhe i qendrave telefonike.

Në degën e investimeve dhe të ndërtimeve, gjatë këtyre dhjetë viteve, janë kryer dhe financuar nga shteti afro 21,5 miliard lekë, nga të cilët 24 për qind në industri, 19,7 për qind në miniera, 19,4 për qind në komunikacion, 13,7 për qind në bujqësi, 3,6 për qind në arësim e kulturë, 1,5 për qind në shëndetësi, 5,3 për qind në ekonominë komunale dhe 12,8 për qind në sektorë të tjerë. Vetëm për ndërtesa banimi janë investuar rreth 2,5 miliard lekë ose 11,6 për qind të krejt investimeve. Nga 2,5 miliard lekë, 2 miliard janë investuar për ndërtesa banimi të reja dhe afro 500 milion për

¹ Kështu quhej lëvizja për të bërë 100 mijë km. rrugë pa e çuar maqinën në ofiçinë për riparim të përgjithshëm.

meremetime. Një vëllim i tillë ndërtimesh do të thotë afërsisht 13 000 apartamente.

Pjesë shumë të rëndësishme - zënë ndërtimet në krejt investimet. Ato përfaqësojnë 65 për qind të investimeve. Ndërtimet në këto dhjetë vjet janë zhvilluar si kurrë ndonjëherë; kundrejt 1938-s, në vitin 1950 kanë qenë 9 herë, këtë vit 11 herë (me realizimin e pritshëm) dhe më 1955 do të jenë rreth 12,5 herë më shumë. Edhe ndërtimet janë të shpërndara në të gjitha qarqet. Më 1954 (me realizimin e pritshëm) për shembull, kemi këtë shpërndarje: 7,2 për qind në Berat, 7,7 për qind në Dibër, 10,8 për qind në Durrës, 11 për qind në Elbasan, 6 për qind në Gjirokastër, 7,7 për qind në Korçë, 3 për qind në Kukës, 7,4 për qind në Shkodër, 20 për qind në Tiranë dhe 19,2 për qind në Vlorë. Fill pas çlirimit e deri sot vendi ynë ka qenë dhe vazhdon të jetë një kantier i madh ndërtimi. U rindërtuan në një kohë rekord të gjitha shkatërrimet e luftës. Janë ndërmarrë ndërtime të guximshme me rezultate të shkëlqyera.

Kanale kulluese dhe ujitëse janë hapur në çdo cep të Shqipërisë. Kombinate, fabrika dhe ndërtime industriale madhështore, ndërtesa bujqësore, arti, kulture, sporti, arësimi, saniteti, ndërtime rrugësh, ujësjellësash, kanalizime etj. zbukurojnë qytetet, fshatrat dhe qendrat e punës të vendit tonë. Qytete të reja janë ngritur në qendra minerare, industriale dhe bujqësore, si për shembull në Patos, në Memaliaj, në Bulqizë, në fabrikën e sheqerit e në fermën e Maliqit, në fermat e Kamzës, të Lushnjes etj. Lagje të reja janë shtuar në qytetet tona si për shembull në Tiranë etj. Porte, hekur-

dha, rrugë të reja, vajgursjellës, hidrocentrale etj. plotësojnë këtë kuadër të bukur.

Krahas me zhvillimin politik, arësimor dhe kulturor të masave tona punonjëse ka shkuar edhe zhvillimi teknik. Klasa jonë punëtore përmes kësaj pune kolosale për zhvillimin e industrisë, të bujqësisë, të komunikacioneve, të ndërtimeve etj., çdo vit e më shumë ka shtuar përpjekjet për përvetësimin e teknikës së përparuar dhe të eksperiencës sovjetike në ndërtimin e socializmit. Vetëm gjatë këtyre gjashtë viteve të fundit kanë mbaruar kurse kualifikimi, perfeksionimi dhe shkolla të rezervave të punës mbi 76 mijë vetë, nga të cilët 33 mijë në industri, miniera dhe artizanat, 7 mijë në bujqësi, 7 mijë në komunikacione, 14 mijë në ndërtim dhe 15 mijë në sektorë të tjerë.

Klasa jonë punëtore, me përpjekjet e saja të lavdishme për realizimin e planit pesëvjeçar, duke ecur çdo vit përpara në përvetësimin e teknikës, prej vitit 1951 deri në shtator të këtij viti, ka bërë 1 671 shpikje dhe racionalizime. Nga këto 836 në sektorët e industrisë dhe të minierave, 75 në bujqësi, 127 në komunikacion, 329 në ndërtim dhe 304 në sektorë të tjerë.

Është rritur në aftësi teknike dhe në numër klasa jonë punëtore. Nga 43 mijë vetë më 1947, në 90 500 vetë më 1954 (realizimi i pritshëm). Paga mesatare e punëtorëve, duke marrë parasysh uljet e çmimeve nga viti 1947 deri në vitin 1954, është rritur 33,5 për qind. Numri i sulmuesve nga 6 323 në vitin 1950 është rritur në 32 313.

Si rrjedhim i zhvillimit të industrisë dhe të bujqësisë është shtuar qarkullimi i mallrave në vendin tonë

dhe është përmirësuar jeta materiale e punonjësve. Xhirua globale e tregëtisë nga 4,5 miliard lekë në vitin 1945, ka hipur në 7,3 miliard lekë më 1950 dhe në 12,5 miliard lekë në vitin 1954 (me-realizimin e pritshëm), ose 277 për qind kundrejt 1945-s dhe 171 për qind kundrejt 1950-s. Projektplani i vitit 1955 parashikon një rritje të xhiros globale prej 13 për qind mbi realizimin e pritshëm të vitit 1954.

Rol shumë të madh luan tregëtia socialiste, shtetërore dhe kooperativiste. Një rrjet prej 2 854 dyqanesh, nga të cilët 994 në fshat, i shërben sot popullit. Pesha specifike e tregëtisë socialiste ka shkuar nga viti në vit duke u ngritur: nga 21,4 për qind që ishte në vitin 1946 dhe 76,9 për qind në 1950, në vitin 1954 (realizimi i pritshëm) është 81,6 për qind.

Është përmirësuar furnizimi i masave punonjëse. Çdo frymë në vitin 1954, kundrejt 1950-s ka marrë më shumë: sheqer 56,3 për qind, yndyrna 92,3 për qind, makarona 37,1 për qind, mish-peshk 9,5 për qind, djathë-gjizë 110 për qind, sapun rrobash 77,8 për qind, tekstile të pambukta 81,8 për qind, të leshta 72,7 për qind, këpucë 111,8 për qind dhe opinga 200 për qind.

Për efekt të zhvillimit ekonomik, në përgjithësi, dhe të forcimit të pushtetit popullor, kanë shkuar duke u zgjeruar marrëdhënjet qytet-fshat dhe aleanca në mes të klasës punëtore dhe fshatarësisë çdo vit e më shumë është bërë faktor vendimtar për suksese më të mëdha në luftën për mbrojtjen e paqes dhe ndërtimin e socializmit. Kundrejt vitit 1952, më 1953 në tregun reciprok janë grumbulluar 208,2 për qind drithëra, 259,6 për qind fasule, 449,8 për qind oriz, 211 për qind

djathë-gjizë etj. Kundrejt këtyre prodhimeve dhe si stimulacion të bimëve industriale, duhan, pambuk dhe panxhar sheqeri, fshatarësisë i janë dhënë më 1953, në krahasim me vitin 1952, 121 për qind sheqer, 118,8 për qind sapun rrobash, 181,1 për qind të pambukta, 169,1 për qind të leshta etj.

Me zhvillimin e vullshëm të ekonomisë sonë, janë zhvilluar si kurrë ndonjëherë marrëdhënjet tregëtare dhe bashkëpunimi tekniko-shkencor në mes të vendit tonë dhe Bashkimit Sovjetik e vendeve të demokracisë popullore. Vendi ynë ka lidhur marrëveshje tregëtare dhe tekniko-shkencore me afat të gjatë dhe çdo vit lidh marrëveshje tregëtare me Bashkimin Sovjetik, me republikat popullore, të Polonisë, Çekosllovakisë, Hungarisë, Rumanisë, Bullgarisë dhe me Republikën Demokratike Gjermane. Kohët e fundit më 14 tetor, vendi ynë lidhi marrëdhënje tekniko-shkencore edhe me Republikën Popullore të Kinës.

Vëllimi i eksport-importit kundrejt vitit 1946, më 1950 ka qenë më se 7 herë më shumë dhe 13 herë në vitin 1953. Shumë rëndësi kanë pasur, gjatë këtyre 6 viteve të fundit, importimet për vendin tonë, për faktin se ato përfaqësojnë në pjesën më të madhe pajisje komplete dhe maqineri për ngritjen e industrisë, mekanizimin e minierave, të bujqësisë dhe të ndërtimeve dhe për fuqizimin e transporteve. Eksportimet tona kundrejt vitit 1946, në vitin 1950 kanë qenë 3,5 herë më shumë dhe afro 6 herë në vitin 1953.

Mbi të ardhurat kombëtare. Të ardhurat kombëtare më 1954, kundrejt vitit 1951, janë rritur 50 për qind. Si rrjedhim janë rritur të ardhurat në buxhetin e shte-

tit. Në kundërshtim me buxhetet e vendeve kapitaliste, ku pjesa më e madhe e shpenzimeve harxhohet në garën e armatimeve, pra, për varfërimin e masave, në buxhetin tonë, shpenzimet më të shumta harxhohen për mirëqenjen e masave.

Nga viti 1951 deri më 1953 shpenzimet për ekonominë popullore janë rritur nga 40,4 për qind në 47,2 për qind, ato për arësimin dhe kulturën nga 9,1 për qind në 10,6 për qind, shpenzimet për shëndetësinë, sigurimet shoqërore dhe kujdesin social nga 8,4 për qind janë rritur në 9 për qind.

Gjendja financiare e popullit tonë çdo vit e më shumë është përmirësuar. Shtimi i depozitave të kursimit, nga 39 milion lekë në vitin 1950 në 138 milion lekë më 1953, e dëshmon një gjë të tillë.

Ngritja e nivelit material dhe kultural të popullit tonë, si rezultat i revolucionit popullor dhe i punës së tij ndërtimtare dhe paqësore, pasqyrohet shumë mirë nga disa tregues kryesorë të demografisë: lindjet për çdo 1 000 banorë janë shtuar nga 34,7 në vitin 1938, në 38,5 më 1950 dhe në 40,7 më 1953. Vdekjet për çdo 1 000 banorë janë pakësuar nga 17,8 në vitin 1938, në 14 më 1950 dhe në 13,6 më 1953. Si rrjedhim i këtyre dy faktorëve, shtesa natyrale vjetore e popullsisë, në krahasim me atë të vitit 1938, ka qenë 132 për qind më 1948, 177,2 për qind më 1949, 170 për qind më 1950, 164,3 për qind më 1951, 141,2 për qind më 1952 dhe 201,1 për qind në vitin 1953. Vitaliteti demografik i popullit tonë ka shkuar duke u shtuar: ndër 195,2 të lindur mbi 100 të vdekur në vitin 1938, në 274,7 më 1950 dhe në 298,9 në vitin 1953.

Gjatë këtyre dhjetë viteve populli ynë ka arritur rezultate të shkëlqyera në zhvillimin e arësimit e të kulturës. Marksizëm-leninizmi na mëson se revolucioni kultural është pjesë e domosdoshme dhe e pandarë e revolucionit socialist, se klasa punëtore s'mund të bëhet zot i vërtetë i vendit e të ndërtojë socializmin, në qoftë se nuk do të dalë nga injoranca, nëse s'do të krijojë inteligjencien e saj, nëse nuk do të zotërojë shkencën dhe s'do të dijë ta ndërtojë ekonominë në bazë të shkencës. E udhëhequr nga këto mësimë Partia jonë ka udhëhequr dhe po udhëheq me sukses zhvillimin e revolucionit kultural në vendin tonë.

Në këtë ndërmarrje të madhe historike Partia dhe populli ynë kanë hasur dhe hasin vështirësi të mëdha, sepse shekujt e robërisë dhe regjimi i satrapit Zog e kishin lënë vendin në një gjendje shumë të prapambetur ekonomike dhe kulturele. Mjafton të përmendim se më se 80 për qind e popullsisë ishte analfabete. Dy të tretat e fëmijëve ishin të dënuar të mbeteshin analfabetë. Okupatorët dhe klasat sunduese, feudalët e borgjezia, ishin të interesuar ta mbanin popullin tonë në injorancë e errësi që ta shtypnin dhe ta ripnin atë më lehtë.

Megjithkëtë, gjatë këtyre dhjetë viteve, populli ynë ka arritur rezultate të tilla në zhvillimin e arësimit e të kulturës që janë të pakrahasueshme me ç'ka mundur të realizojë gjatë gjithë historisë së tij të mjerueshme të së kaluarës.

Fitore historike për popullin tonë është fakti se gjatë këtij viti shkollor përfundon likuidimi i analfabetizmit në tërë ata që janë nën moshën 40 vjeç dhe

kështu zhduket një plagë e madhe shekullore. Për herë të parë në vendin tonë u vendos arësimi fillor i detyruar për tërë fëmijët, në mjaft qytete është bërë i detyruar arësimi 7-vjeçar dhe ne shkojmë drejt krijimit të konditave për ta bërë arësimin 7-vjeçar të detyrueshëm kudo. Më 1938, në Shqipëri kishte 643 shkolla fillore me 52 000 nxënës dhe 11 shkolla 7-vjeçare e të mesme me 6 300 nxënës, kurse në vitin 1954, vetëm pas dhjetë vjet çlirimi, numri i shkollave fillore arriti në 2 140 me 136 800 nxënës, numri i shkollave 7-vjeçare në 315 me 39 700 nxënës dhe numri i shkollave të mesme në 28, me 8 600 nxënës. Për herë të parë në historinë e vendit tonë u hapën 6 institute të larta, në të cilat mësojnë 1 200 studentë. Gati 900 inxhinierë, doktorë, agronomë e të tjerë kanë mbaruar shkollat e larta në Bashkimin Sovjetik dhe në demokracitë popullore dhe me qindra studentë të tjerë vazhdojnë të mësojnë jashtë shtetit. Krahas shkollave të ditës është ngritur një rrjet i gjerë shkollash nate dhe me korrespondencë për t'u dhënë mundësinë punonjësve të marrin arësim e kulturë pa u shkëputur nga prodhimi. Me mijëra punëtorë ndjekin shkollat e kurset e perfeksionimit. Për herë të parë janë hapur shkollat e rezervave të punës që kanë për qëllim të shtojnë radhët e klasës punëtore me gjak të ri, me punëtorë të kualifikuar e të kulturuar. Kështu Partia dhe shteti kanë krijuar mundësitë praktike që arësimi të bëhet i masave, që bijve dhe bijave të punëtorëve e të fshatarëve punonjës t'u hapen dyert e diturisë e të shkencës.

S'ka dyshim se krijimi i inteligjencies popullore është një nga sukseset më të mëdha të popullit tonë në

këta dhjetë vjet pas çlirimit, sepse, siç dihet, asnjë shtet, e aq më pak diktatura e proletariatit, s'mund të bëjnë pa krijuar inteligjencien e tyre, kuadrot e tyre. Me qindra janë kuadrot dhe specialistët që sot drejtojnë me sukses kombinatet e fabrikat tona, në miniera e në hekurudha, në spitale e shkolla, në ferma e kooperative, në aparatit tonë shtetëror e kudo. Madhështia e kësaj fitoreje qëndron në faktin se këta janë punëtorët, fshatarët punonjës, barinjtë e bujqërit që deri dje shfrytëzoheshin deri në palcë. Dhjetë vjet përpara armiqtë tanë thoshin se punëtorët dhe fshatarët e Shqipërisë s'do të jenë në gjendje ta drejtojnë shtetin, ekonominë, kulturën, se pushteti popullor s'do të jetë në gjendje të krijojë kuadrot e tij, se ai do t'i ketë ditët të numëruara. Por dhjetë vjet në liri i përmbysën shpresat e armiqve dhe treguan forcën e pashtershme krijuese të popullit tonë të çliruar. Radhët e inteligjencies sonë përbëhen jo vetëm nga ata që kanë mbaruar pas çlirimit shkollat e larta, jo vetëm nga intelektualët e vjetër patriotë, por ato shtohen dita-ditës edhe nga kuadrot e punëtorëve të përparuar, të kalitur në luftën për ndërtimin e socializmit. Nga radhët punëtore kanë dalë drejtues të ndërmarrjeve tona industriale si Sulo Kurti ish punëtor krahu, sot nëndrejtor i Ndërmarrjes së prodhimit të naftës në Patos dhe deputet në Kuvendin Popullor, ose Islam Islami, ish bari dhe sot nëndrejtor i Minierës së kromit në Bulqizë etj.

Hov, të paparë në të kaluarën, ka marrë zhvillimi i kulturës, artit, letërsisë etj. Shqipëria, ku deri dje sundonte analfabetizmi, sot ka Institutin e saj të kërkimeve bujqësore dhe Institutin shtetëror të shkencave,

baza për krijimin në të ardhshmen të Akademisë së shkencave të RPSH. Para çlirimit, në Shqipëri, s'kishte asnjë teatër, asnjë muzeum, asnjë shtëpi kulture, kurse sot ka 11 muzeume, një rrjet të gjerë shtëpish kulture e bibliotekash, 6 teatro profesionistë. Janë vënë në skenë dhe opera e baletë klasike. Fakti që në vitin 1954 në Shqipëri ka rreth 1 700 grupe teatrale me afro 10 000 amatorë dhe që në festivalin muzikor të këtij viti kanë marrë pjesë 4 000 e ca grupe koresh e vallesh me 42 425 amatorë, tregon ç'hov ka marrë në Shqipërinë e re zhvillimi i veprimtarisë krijuese të masave punonjëse. Populli dhe sidomos rinia jonë kanë etje të zjarrtë për kulturë dhe kjo duket edhe nga frekuentimi i madh i kinemave e teatrove tona. Vetëm në gjashtëmujorin e parë të vitit 1954 teatrot profesionistë janë frekuentuar nga afro 250 000 vetë dhe kinematë, gjatë këtij viti, nga afro 5 milion spektatorë. Shkrimtarët, kompozitorët, artistët tanë, të frymëzuar nga lufta dhe puna heroike e masave tona punonjëse për ndërtimin e socializmit, kanë mobilizuar forcat e tyre që t'i japin vendit vepra arti sa më të denja, që të jenë në radhët e para të ndërtuesve të Shqipërisë së re. Vetëm gjatë vitit 1954, janë bërë 91 kompozime, duke përfshirë këngë masash, tablo, oratorio dhe operetën e parë shqiptare «Agimi» të kompozitorit Kristo Kono, e cila u shfaq për nder të 10-vjetorit të çlirimit. Vetëm gjatë konkursit letrar, për nder të 10-vjetorit të çlirimit, janë dorëzuar 130 vepra letrare. Si trashëgimtarë të denjë të shkrimtarëve të mëdhenj të Rilindjes sonë, shkrimtarët e Shqipërisë së re e kuptojnë fare mirë se letërsia luan një rol shumë të rëndësishëm në edukimin komunist të

masave tona punonjëse, se detyra e tyre e nderit është të shprehin në veprat e tyre luftën vetëmohuese dhe interesat e popullit, t'i këndojnë së resë përparimtare, të përcëllojnë në hekurin e skuqur të satirës e kritikës së rreptë mbeturinat e së vjetrës e prapambetjen, të luftojnë pa mëshirë armiqtë dhe çdo shfaqje armiqësore. Detyra e shkrimtarëve tanë është të përvetësojnë sa më mirë metodën e realizmit socialist, të mësojnë sa më shumë nga traditat më të mira të letërsisë klasike botërore, të zhvillojnë traditat e letërsisë sonë klasike përparimtare, të jenë të lidhur si mishi me koskën me realitetin tonë dhe me luftën e popullit tonë se vetëm kështu do të mund t'i japin popullit shumë vepra me përmbajtje të lartë e të shkruara me mjeshtëri artistike. Kurrë më parë shtypi nuk ka qenë kaq i përhapur në masat. Sot botohen 28 gazeta e revista me një tirazh të përgjithshëm prej 17 milion copë, kurse në vitin 1938 ishte rreth 3 milion. Gjatë dhjetë viteve janë botuar 1 145 lloj librash me më shumë se 11 milion copë tirazh.

Të gjitha rezultatet e arritura nga populli ynë, gjatë këtyre dhjetë viteve, në fushën e arësimit e të kulturës, tregojnë se në vendin tonë ka lindur dhe po zhvillohet me sukses kultura e re, kulturë socialiste nga përmbajtja dhe nacionale nga forma e saj. Baza ideologjike e kulturës sonë të re është marksizëm-leninizmi. Kultura jonë e re duhet t'u shërbejë besnikërisht interesave të klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse, t'u shërbejë këtyre klasave si armë e fuqishme për të ndërtuar socializmin dhe për të luftuar tërë armiqtë e klasës. Kultura jonë e re, në esencën e saj, është thellësisht internacionaliste dhe armike e nacionalizmit

borgjez si dhe e armës tjetër të këtij, kozmopolitizmit. Lenini i madh gjithmonë ka theksuar se komunizmi është i vetmi trashëgues legjitim i të gjitha sukseseve të kulturës botërore, se kultura socialiste mund të zhvillohet vetëm mbi bazën e përpunimit kritik të zhvillimit të mëtejshëm të kulturës, shkencës e teknikës së përparuar të krijuar gjatë shekujve nga njerëzimi. Kultura jonë e re është e vetmja trashëgimtare legjitime e gjithshkaje përparimtare që ka krijuar populli ynë gjatë historisë së tij. Partia jonë i kushton një vëmendje shumë të madhe studimit dhe përpunimit të gjuhës sonë nacionale, zhvillimit të traditave përparimtare të popullit tonë, studimit e përpunimit të historisë së vendit tonë, folklorit tonë, të historisë së letërsisë e të artit të popullit tonë, të muzikës sonë nacionale. Vetëm në konditat e demokracisë popullore u bënë të mundura këto, u bë e mundur që populli ynë dhe miqtë tanë të njohin me tërë shkëlqimin e tyre veprat e këndshme të Naimit, Çajupit etj., të njohin vlerat e çmuara të kulturës sonë nacionale.

Për të gjitha rezultatet e shkëlqyera të arritura në lëmin e arësimit e të kulturës, brenda dhjetë viteve, populli ynë me plot të drejtë mund të jetë krenar. Këto suksese të shkëlqyera, që u bënë të mundura vetëm në konditat e sistemit të demokracisë popullore, tregojnë avantazhet e pakundërshtueshme të këtij sistemi. Këto suksese janë arritur nga masat tona punonjëse, të cilat, të çliruara nga prangat e shfrytëzimit, po zhvillojnë inisiativën e tyre krijuese. Fitoret e mëdha të popullit tonë në zhvillimin e revolucionit kultural i dedikohen udhëheqjes së drejtë të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Veçanti e revolucionit kultural që po zhvillohet në vendin tonë dhe në demokracitë e tjera popullore, është se ky revolucion bëhet në kondita më të favorshme nga ai që u zhvillua në Bashkimin Sovjetik, bëhet më lehtë, më shpejt, me më pak sakrifica, sepse ne kemi edhe ndihmën e vendit të parë socialist.

Por, me gjithë sukseset, ne kemi akoma për të bërë. Prapambetja kulturele e masave është pengesë shumë serioze për ndërtimin e socializmit e të shoqërisë që ngrihet në bazën e teknikës dhe të shkencës më të përparuar. Partia jonë është e ndërgjegjshme se kryerja e revolucionit kultural s'është një gjë e lehtë por një proces i gjatë, i komplikuar, i vështirë. Por Partia është e sigurtë se me dashurinë e zjarhtë për mësim dhe me vullnetin e çelniktë që kanë masat tona punonjëse, inteligjencia jonë, komunistët, populli ynë do ta kryejë këtë ndërmarrje historike me sukses. Vetë ndërtimi i socializmit, zhvillimi i industrisë së përparuar, i kolektivizimit të bujqësisë e të tjera, jo vetëm kërkojnë zhvillimin e revolucionit kultural, por edhe krijojnë bazën materiale për zhvillimin e tij me sukses.

Mbi mbrojtjen e shëndetit të popullit. Pushteti popullor i ka kushtuar vëmendje të posaçme mbrojtjes së shëndetit të popullit dhe në këtë drejtim janë arritur suksese jo më të vogla se në sektorët e tjerë. Kundrejt vitit 1938, për shëndetësinë dhe sigurimet shoqërore bashkë, më 1951, 1952 dhe 1953 janë shpenzuar respektivisht 34 herë, 45 herë dhe 46 herë më tepër.

Para çlirimit 35 për qind e krejt aktivitetit shëndetësor ishte përqëndruar në Tiranë. Ky aktivitet përmblidhej në 8 spitale me kapacitet 820 shtretër, në 36

ambulanca, 2 dispanseri antimalarike, 7 qendra anti-larvore si dhe një laborator bakteriologjik. Asnjë organizim profilaksie ose luftim kundër sëmundjeve ngjitëse apo për kontrollin higjieno-sanitar nuk ka ekzistuar. Mungonte gjithashtu çdo legjislacion sanitar.

Disa krahasime me vitin 1938 mund të japin idenë e qartë se sa është zhvilluar shërbimi sanitar: më 1938 numri i të shtruarve në spitalet ka qenë 9 800, kurse në vitin 1953 ka qenë 77 000. Më 1938 numri i vizitave në ambulancat ka qenë 160 000, ndërsa në vitin 1953 1 112 000. Më 1938 ka pasur në spitalet një shtrat për çdo 1 268 banorë, kurse në vitin 1953, një shtrat për çdo 371 banorë.

Si rrjedhim i afro 300 milion lekë investimeve që janë bërë për shëndetësinë, gjatë këtyre dhjetë viteve, sot kemi: 48 spitale me 3 559 shtretër, 5 sanatoriume me 1 300 shtretër, 4 preventoriume me 520 shtretër, 3 befotrofe me 270 shtretër, 55 çerdhe për fëmijë me afro 2 300 shtretër, 89 maternitete e reparte maternitësh me 781 shtretër dhe shumë institucione të tjera si p.sh. 10 dispanseri antituberkulare, 8 poliklinika, 34 dispanseri antimalarike etj.

Është organizuar lufta kundër tuberkulozit dhe kundër sëmundjeve të tjera si sifilizit, malarjes etj. Që më 1949 sifilizi ngjitës primar është zhdukur në vendin tonë. Me luftën kundër sëmundjeve ngjitëse janë arritur rezultate të mira. Si rrjedhim është ulur morboziteti i tifos së zorrëve, i tifos së morrit, i difterisë etj. Janë korrur suksese të mëdha në luftën kundër malarjes. Nga 59,2 për qind dhe 16,5 për qind që ishin më 1938 indekset splenik dhe parazitar, ranë në 7,7 për

qind dhe 0,2 për qind në vitin 1953. Numri i malarikëve nga 75 000 që ishte më 1951 ra në 28 000 në vitin 1953 dhe përqindja e infektuar e popullsisë nga 6,2 ra në 2,2.

Vdekja në fëmijët kundrejt paraluftës është kufizuar shumë. Nga statistikat e vjetra 1931-1936 del se nga 1 000 fëmijë nën një vit në Tiranë dhe në Vlorë vdisnin respektivisht 332 dhe 190; në vitin 1953 këto shifra kanë zbritur respektivisht në 98 dhe 72. Më 1953 mesatarja e vdekjeve të fëmijëve nën një vit, në krah të Republikën, ka qenë 99 për mijë.

Punonjësit dhe fëmijët e tyre në Republikën tonë gëzojnë me ligj të drejtat e pushimit dhe ato të sigurimeve shoqërore. Mbi 7 000 punëtorë dhe mbi 8 000 pionierë kaluan pushimet vitin e kaluar në shtëpitë e pushimit. Fondi i sigurimeve shoqërore më 1953 ka qenë 79 për qind më i madh se më 1950.

Historia tregoi se vetëm udhëheqja e klasës punëtore, e klasës më revolucionare të shoqërisë dhe e avantgardës së saj, Partisë së Punës të Shqipërisë, mundi t'i sigurojë popullit tonë për herë të parë lirinë dhe pavarësinë e vërtetë. Udhëheqja e drejtë e Partisë i siguroi popullit tonë jo vetëm çlirimin por edhe rilindjen e tij, zhvillim të paparë politik, ekonomik dhe kultural.

Një nga meritat e mëdha të Partisë sonë është farkëtimi i aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse. Partia jonë ka punuar dhe punon vazhdimisht për forcimin e aleancës midis klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse, sepse udhëhiqet nga mësimet e Leninit të madh që thotë se kjo aleancë është e domosdoshme, jo vetëm për triumfin e revolucionit socialist e vendosjen e diktaturës së proletariatit, por edhe për

ndërtimin e socializmit e të komunizmit, se kjo aleancë është principi më i lartë i diktaturës së proletariatit. Forcimi i aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse është garanci se populli ynë i bashkuar në Frontin Demokratik, nën udhëheqjen e Partisë, do të korrë gjithnjë fitore.

Partia jonë ka mundur të arrijë suksese të shkëlqyera sepse ajo ka qenë e lidhur ngushtë me masat e popullit, ka pasur përkrahjen e tyre. Historia i tregoi popullit tonë se politika e Partisë u përgjigjet interesave të tij më jetike, se për Partinë s'ka interesa të tjera më të larta veç atyre të popullit, se ligji më i lartë i Partisë është përmirësimi i vazhdueshëm i jetës së popullit. Prandaj populli ynë ka besim të patundur te Partia dhe me të gjitha forcat mbështet politikën e saj.

Në lidhjet e çelnikta të Partisë me masat qëndron garancia e ruajtjes së pavarësisë dhe e ndërtimit të socializmit në Shqipëri. Partia gjithnjë është udhëhequr nga teza e njohur marksiste se masat janë krijueset e historisë, krijueset e të gjitha të mirave materiale dhe e të gjitha vlerave kulturore të shoqërisë. Socializmi ndërtohet nga masat dhe tempi i ndërtimit të tij varet direkt nga shkalla e ndërgjegjes së masave, nga edukimi, organizimi dhe udhëheqja e tyre prej Partisë. Prandaj Partia në qendrën e punës së saj vë edukimin e masave punonjëse, nxitjen e zhvillimit të fuqive dhe inisiativës së tyre krijuese.

Partia jonë është e pathyeshme, se ajo udhëhiqet nga shkenca gjithnjë fitimtare e marksizëm-leninizmit, e cila i jep asaj mundësi të njohë ligjet objektive të

zhvillimit të shoqërisë dhe ta ndërtojë politikën e saj mbi një bazë shkencore.

Partia jonë që nga fillimi ka luftuar kundër shfaqjeve oportuniste, likuidatore, trockiste dhe i ka spas-truar radhët e saja nga elementët armiq e të huaj. Uniteti i Partisë është sot më i fortë se kurrë. Në unitetin e radhëve të Partisë qëndron sekreti i pathyeshmërisë së saj, prandaj Partia do t'i mbajë kurdoherë radhët e saja të pastra dhe do ta ruajë unitetin e saj si sytë e ballit.

Të tilla janë ndryshimet që janë bërë në vendin tonë brenda këtyre dhjetë vjet çlirimi, kohë shumë e shkurtër në jetën e një populli, por periudhë plot aktivitet dhe suksese që populli i krijoi vetëm tash që është vetë në fuqi, që udhëhiqet nga Partia e tij e Punës, nga flamuri i leninizmit dhe që ka ndihmën e Bashkimit Sovjetik. Populli ynë me mirënjohje e falenderon Bashkimin Sovjetik dhe Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik për ndihmën që i japin. Gjithashtu falenderon nga zemra popujt miq të vendeve të demokracisë popullore dhe partitë komuniste e punëtore të këtyre vendeve që e kanë ndihmuar vazhdimisht popullin tonë.

Shokë,

Gjatë këtyre dhjetë viteve të pasluftës, vendet tona të kampit të socializmit dhe të paqes, me Bashkimin Sovjetik në krye, kanë zhvilluar një luftë të paepur në dy drejtime: në ndërtimin e jetës së lumtur për popujt e tyre dhe në mbrojtjen e paqes në botë.

Ndërtimi i socializmit e i komunizmit dhe mbrojtja e paqes në botë është një problem i pandarë që buron nga vetë karakteri i pushteteve tona popullore. Në mes të vendeve të kampit të socializmit dhe të paqes është vendosur një miqësi e sinqertë, një bashkëpunim vëllazëror në bazën e principit të barazisë së plotë dhe të respektit të sovranitetit shtetëror. Sukseset e arritura në Bashkimin Sovjetik në lëmin e ekonomisë dhe të kulturës kanë qenë për vendet tona të demokracisë popullore një ndihmë jashtëzakonisht e çmueshme dhe një stimul dhe eksperiencë e pakufishme. Në sajë të kësaj ndihme bujare dhe të shumanshme, popujt e vendeve të demokracisë popullore kanë korrur suksese të mëdha në një kohë kaq të shkurtër. Të gjithë popujt e botës dhe njerëzit e thjeshtë me pikëpamje politike të ndryshme kanë kuptuar drejtësinë e politikës paqësore të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore dhe janë grumbulluar në kampin e paqes për ta mbrojtur paqen. Gjatë këtyre dhjetë viteve pengesa shumë serioze janë ngritur nga imperialistët në rregullimin e problemeve ndërkombëtare. Qarqet luftënxitëse imperialiste amerikane po përgatitin në ethe plane kriminale, për të hedhur botën në një kasaphanë të tmerrshme atomike. Me mjerimet dhe urinë e popujve që kanë nënshtruar, me kapitalet e tyre ata ndërtojnë buxhete kolosale luftime. Për të mbajtur gjallë histerinë e luftës, me një propagandë shpifëse, që s'është parë kurrë, ata përpiqen të çoroditin mendjen e njerëzve me nerva të dobëta për t'i çuar pastaj në kasaphanë, sikundër bënë në Kore, në Vietnam e gjetkë. Disfata e tyre e turpshme në Kore dhe

në Vietnam, është një dëshmi e gjallë e vitalitetit të madh të popujve që mbrojnë lirinë e pavarësinë dhe një mësim kuptimplotë për imperialistët luftënxitës që me politikën e tyre të forcës dhe të luftës do të pësojnë kurdoherë disfata.

Konferenca e Gjenevës, ku triumfoi politika paqësore e Bashkimit Sovjetik dhe e Republikës Popullore të Kinës, i tregoi botës se nga lufta e popujve, pavarësisht nga manevrimet e SHBA, mund të shuhet një vatër e rëndësishme zjarri e ndezur nga imperialistët amerikanë dhe shërbëtorët e tyre, por ishte edhe një demonstracion i qartë i tezave paqësore të politikës së jashtme sovjetike se me anë negociatash mund të zgjidhen probleme të mbetura pezull në lëmin ndërkombëtar, ashtu sikundër është i mundur dhe i realizueshëm principi i mbrojtur kurdoherë nga Bashkimi Sovjetik dhe vendet e kampit të socializmit, i bashkëjetesës paqësore të të dy sistemeve, të sistemit socialist dhe të sistemit kapitalist.

Është e vërtetë se janë arritur disa suksese të ndieshme në uljen e tensionit ndërkombëtar, por është gabim të kujtohet se të gjitha pengesat për zgjidhjen e drejtë të çështjeve me rëndësi ndërkombëtare janë zhdukur. Qarqet imperialiste luftënxitëse, përpara disfatave të bujshme të politikës së tyre të forcës dhe të korrupsionit, po i shtojnë përpjekjet kriminale. Imperialistët amerikanë dhe shërbëtorët e tyre përpara zemërimit të madh të popujve, pengojnë ndalimin e përdorimit të bombës atomike dhe me hidrogjen, pengojnë çarmatimin, pengojnë pjesëmarrjen e Kinës së lavdishme, të Shqipërisë dhe të shumë vendeve të tjera në

Organizatën e Kombeve të Bashkuara, kanë okupuar Taivanin dhe e kanë shndërruar atë në një çerdhe banditësh dhe bazë ushtarake për një vatër të re zjarri kundër Republikës Popullore të Kinës dhe botës mbarë. Me akordet e Londrës dhe të Parisit, ata përpiqen të ringjallin militarizmin gjerman dhe të ndezin kështu zjarrin e një lufte të tretë botërore.

Përpara kësaj politike, të luftës shkatërrimtare për mbarë njerëzimin, vihet politika paqësore e Bashkimit Sovjetik dhe propozimet e tij për sigurimin kolektiv të Evropës. Këto propozime u tregojnë popujve të etshëm për paqe rrugën e vërtetë që duhet të ndjekin për të siguruar paqen. Propozimi i qeverisë sovjetike, për krijimin e një sigurimi kolektiv evropian, ka ngjallur entuziazëm në të gjithë popujt dhe ka forcuar besimin në forcat e tyre dhe në triumfin e kauzës së tyre. Populli shqiptar dhe qeveria e tij janë dakord me propozimin sovjetik për mbajtjen e një konference ku të diskutohet dhe të vendoset marrëveshja mbi sigurimin evropian¹ dhe urojnë me gjithë zemër suksese për triumfin e kauzës së paqes.

Populli ynë është shumë i interesuar dhe lufton me mish e me shpirt për mbrojtjen e paqes. Shqipëria demokratike popullore s'lejon më të konsiderohet nga

¹ Propozimi i atëhershëm për sigurimin kolektiv në Evropë synonte në luftën kundër imperializmit amerikan dhe rimilitarizimit të Gjermanisë Perëndimore. Sot ky synim është shtrembëruar krejt nga revizionistët sovjetikë. Ata e duan këtë «sigurim» për të forcuar aleancën imperialisto-revizioniste që drejtohet kundër popujve të Evropës.

imperialistët si një monedhë shkëmbimi dhe një trampin lufte kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore. Për këtë arsye Shqipëria e vogël është një faktor i madh paqeje në Ballkan dhe pse është e tillë, njerëzit e çmendur luftënxitës, tradhëtarët e atdheut tonë në shërbim të këtyre imperialistëve dhe mbeturinat e klasave sunduese që ëndërrojnë me nostalgji të ardhurat e dikurshme të çifligjeve, e akuzojnë vendin tonë dhe popullin shqiptar se gjoja turbullon paqen. Pse ne mbrojmë me të drejtë dhe me vigjilencë të madhe popullin dhe atdheun tonë të shenjtë, pse ne shtypim dhe do të shtypim pa mëshirë armiqtë e popullit, zotërinjtë imperialistë na quajnë turbullues të paqes. Pse ne nuk lejojmë që kufitë tanë të shenjtë të preken dhe të kapërcehen nga bandat dhe diversantët tradhëtarë, të paguar me dollarët e Uashingtonit, pse ne i shfarosim dhe do t'i shfarosim kurdoherë pa nishan këta banditë, pse ne s'lejojmë që të shkelet hapësira ajrore e atdheut tonë dhe ujërat territoriale të vendit, imperialistët dhe shërbëtorët e tyre na akuzojnë se turbullojmë paqen. Kur dhelpra s'e arrin dot rrushin e pështyn, por pështyma bie në fytyrën e saj. Kështu ngjet edhe me akuzat e poshtra të imperialistëve luftënxitës karshi popullit shqiptar dhe regjimit të tij. Populli shqiptar sa i vuajtur është, aq eksperiencë ka nga jeta, aq mirë i njeh intrigat dhe poshtërsitë e imperialistëve të ndryshëm dhe tradhëtarëve të vendit dhe aq më të forta i ka nervat; ai s'do t'ja dijë as nga shpifjet as nga intrigat dhe as nga kërcënimet e armiqve të tij. Kush duhet të konsiderohet turbullues i paqes, luftënxitës, shtypës dhe robërues, një popull i

vogël me një milion e treqindmijë banorë, që kërkon të rrojë i lirë dhe sovran në vendin e tij, që s'i bie kurrkujt në qafë, që derdh djersë për të ndërtuar një jetë më të mirë, që është i gatshëm në çdo çast të rrojë në fqinjësi të mirë me të gjitha shtetet që i respektojnë të drejtat e tij, apo ato shtete imperialiste që e sulmojnë dhe e gjakosin këtë popull të vogël, ata që fill pas çlirimit kurdisën kaq komplete, atentate dhe sabotazhe kundër pushtetit popullor, ata që e pengojnë Shqipërinë të bëhet anëtare e Kombeve të Bashkuara, apo, më në fund, ata që kanë marrë nën sqetull të gjithë tradhtarët dhe kuislingët shqiptarë jashtë, që i ushqejnë, i armatosin dhe i dërgojnë tinës në Shqipëri për të sabotuar dhe për të bërë atentate? Sigurisht turbullues i paqes s'është populli shqiptar as regjimi i tij popullor, por janë ato shtete dhe ato qarqe imperialiste që i kanë kurdisur gjithë këto plane djallëzore Shqipërisë. Por intrigat dhe planet e tyre kanë dështuar dhe do të dështojnë kurdoherë. Shqipëria s'është më ajo e dikurshmja, ku sundonte beu dhe agai, të cilët e shisnin atdheun për një grosh. Shqipëria tash është e popullit, e udhëhequr nga Partia e tij e Punës e Shqipërisë. Shqipëria kurdoherë është e fortë, pse ndjek me konsekuencë një politikë vendimtare paqësore dhe ndërtime dhe se rruga e saj është e drejtë. Populli shqiptar bën pjesë në familjen e madhe të 900 milion vetëve, bën pjesë në kampin e fuqishëm të socializmit dhe të paqes dhe gëzon të gjitha të mirat e kampit tonë. Populli shqiptar është më i fortë se kurrë ndonjëherë, pse është i lidhur me miq të mëdhenj dhe besnikë me traktate miqësie, ndihme reciproke, tregëtare, ekono-

mike, kulturalc etj. dhe sot populli shqiptar ecën çdo ditë përpara drejt përparimit, drejt rrugës së begatshme të socializmit.

Vendi ynë është i njohur dhe ka marrëdhënje diplomatike me 15 shtete të Evropës dhe të Azisë. Politika e qeverisë sonë ka qenë kurdoherë një politikë për paqe dhe për krijimin e marrëdhënjeve të fqinjësisë dhe miqësore me cilindo shtet që i do të mirën popullit tonë dhe respekton të gjitha të drejtat e tija. Ne konstatojmë se marrëdhënje fqinjësie janë vendosur me popujt e Jugosllavisë. Në mes të qeverisë sonë dhe asaj të Republikës Federative të Jugosllavisë, janë zgjidhur disa probleme siç ishin, vendosja e marrëdhënjeve diplomatike dhe ndreqja e piramidave të kufirit. Qeverisë së Republikës sonë popullore nuk do t'i mungojë vullneti i mirë që në interes të përfitimeve reciproke, të bazuara në mirëkuptim dhe në respektimin e të drejtave sovrane të të dy shteteve, t'i përmirësojë edhe më tej këto marrëdhënje. Ne shpresojmë se edhe qeveria e Republikës Federative të Jugosllavisë do të shfaqë kurdoherë vullnet të mirë. Në mes të Shqipërisë dhe Italisë gjithashtu marrëdhënjet e fqinjësisë janë përmirësuar. Ne konstatojmë se propozimet e qeverisë sonë për shqyrtimin e detyrimeve të Italisë ndaj vendit tonë, në lidhje me reparacionet dhe restitucionet e vendosura nga Konferenca e Paqes në Paris, janë pranuar nga qeveria italiane. Janë pranuar gjithashtu propozimet e qeverisë sonë për shkëmbime tregëtare dhe janë vendosur shkëmbime delegacionesh nga të dy palët. Ne urojmë që të tilla marrëdhënje të vendosen edhe me vende të tjera.

Të dashur shokë dhe miq,

Atdheu ynë, Shqipëria, zbukurohet dhe forcohet dhe kjo i detyrohet punës së palodhur të popullit, të klasës punëtore, të fshatarësisë, të rinisë, të inteligjencies popullore, të grave të Shqipërisë, të cilët, të gjithë të bashkuar si një trup, ndjekin me besim dhe zbatojnë me besnikëri vijën e Partisë dhe të qeverisë së Republikës sonë popullore. Patriotizmi i madh i popullit dhe uniteti i shëndoshë i popullit dhe i Partisë, bëri të kapërcehen të gjitha vështirësitë dhe të korren këto rezultate të mëdha. Regjimi i demokracisë popullore hapi për popullin tonë perspektiva të shkëlqyeshme dhe sot në këtë ditë feste, çdo shqiptar e shikon me besim të ardhshmen e tij të lumtur, pse çdo rrugë të jetës e ka të hapur dhe për të s'do të ketë më vuajtje dhe mjerime.

Populli shqiptar e ka kurdoherë të qartë se derisa do të ekzistojë rrethimi kapitalist, ai duhet të jetë shumë vigjilent ndaj armiqve të jashtëm dhe të brendshëm, të cilët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për ta penguar në rrugën e tij ndërtimore. Duhet ruajtur dhe mbrojtur si sytë e ballit fitoret e arritura dhe duhet punuar me të gjitha energjitë për t'i zhvilluar edhe më tej këto fitore. Prandaj mbrojtja e paqes për popullin tonë do të thotë, në radhë të parë, mbrojtja me vigjilencë e kufive të atdheut, mbrojtja e pushtetit popullor, mbrojtja e jetës së popullit dhe e ekonomisë popullore nga çdo tentativë sabotuese e armikut. Partia na mëson se kurdoherë duhet të vigjilojmë që interesat e larta të popullit dhe të atdheut të mos preken nga

kurrkush. Interesat e larta të popullit kërkojnë që të mobilizohen totalisht energjitë e mëdha të vendit tonë për të arritur suksese të mëtejshme në ekonominë e vendit dhe të ketë në çdo familje shqiptari më me shumicë bukë, mish, vaj, zarzavate, oriz, sheqer dhe sende të nevojës së përditshme. Bollëku në vendin tonë ka mundësi të krijohet dhe do të krijohet, pse provat e këtyre dhjetë viteve çlirimi janë të gjalla. Mundësitë në vendin tonë janë kolosale dhe populli shqiptar këto mundësi do t'i transformojë, me punë të palodhur, në pasuri me vlerë të madhe që do t'i shërbejnë për zbulimin e mëtejshëm të jetës së tij. Populli shqiptar ka Partinë e tij heroike të Punës që e udhëheq me vendosmëri drejt rrugës së begatshme, ka pushtetin e tij që e mbron nga çdo rrezik, përkrahjen e kampit të socializmit, prandaj ai është i bindur dhe i sigurtë se do të korrë suksese edhe në të ardhshmen.

Gëzimi i popullit tonë në këtë ditë është i papërshkrueshëm, edhe për faktin se në gjirin e tij ka delegacionet e popujve miq e vëllezër të Bashkimit të lavdishëm Sovjetik, të Kinës së madhe, të Çekoslovakisë, Bullgarisë, Rumanisë, Polonisë, Hungarisë, të RDP të Koresë, të RD Gjermane, të Mongolisë, të RD të Vietnamit, ka përfaqësuesit e popullit vëlla të Francës. Miqësia e popujve tuaj ndaj vendit tonë, të dashur delegatë, është një fitore e madhe për popullin tonë. Këtë miqësi të shenjtë populli ynë do ta kalitë çdo ditë në frymën e internacionalizmit proletar dhe do t'i qëndrojë besnik për jetë. Jam i ngarkuar t'ju falenderoj me gjithë zemër dhe t'ju përshëndes në emër të popullit shqiptar, të Partisë dhe të qeverisë sonë.

Popull shqiptar,

Jam i ngarkuar nga Komiteti Qendror i Partisë sonë dhe nga qeveria e Republikës t'ju përshëndes për zemërsisht dhe t'ju uroj nga zemra festën e madhe të 10-vjetorit të çlirimit, të përshëndes dhe të uroj klasën tonë heroike punëtore që është në ballë të luftës për ndërtimin e bazave të socializmit! Përshëndetje të nxehta fshatarësisë sonë heroike dhe patriote, e cila, në aleancë të ngushtë dhe nën drejtimin e klasës punëtore, po e transformon fshatin dhe bujqësinë po e çon në rrugën e socializmit! Përshëndes inteligjencien popullore dhe patriote, përshëndetje të zjarra dhe urime e suksese në detyrën e tyre të shenjtë Ushtrisë sonë të lavdishme Kombëtare, rojeve tona heroike të kufive të atdheut, punonjësve trima dhe vigjilentë të sigurimit të shtetit! Përshëndetje të zjarra grave heroike të Shqipërisë, këshilltareve të popullit dhe punonjëseve të palodhura të aparateve të shtetit tonë! Përshëndetje të zjarra rinisë sonë të dashur heroike, pionierëve dhe pionierëve të dashur, pjesa më e shtrenjtë e Partisë dhe e popullit! Përshëndetje revolucionare të zjarra anëtarëve dhe kandidatëve heroikë të Partisë së Punës të Shqipërisë që janë nga bijtë dhe bijat më të dashur të popullit tonë, që luftojnë me heroizëm dhe me vetëmohim për kauzën e shenjtë të popullit, për begatinë e atdheut, për triumfin e ideve ngadhënjimtare të Marksit, Engelsit, Leninit, Stalinit!

Motra dhe vëllezër shqiptarë,

Të bashkuar më fort se kurrë ndonjëherë tjetër rreth Partisë dhe qeverisë, le të ecë populli ynë kurdoherë përpara drejt një jete akoma më të bukur dhe më të begatshme. T'i përvishemi punës me fuqi të dhjetëfishuara, t'i rrëmbejmë natyrës me punën tonë të palodhur dhe krijimtare të gjitha pasuritë dhe këto t'i vëmë në shërbim të popullit tonë. Të ecim drejt fitoreve të reja. Ne na prin flamuri i lavdishëm i Partisë së Punës të Shqipërisë, prandaj për popullin tonë do të ketë kurdoherë dhe vazhdimisht fitore dhe ditë të lumtura.

Lavdi popullit heroik shqiptar, i cili i grumbulluar si një trup në Frontin Demokratik dhe i udhëhequr nga Partia e Punës e Shqipërisë, ecën kryelartë në rrugën e ndritur të socializmit!

Lavdi Partisë heroike të Punës të Shqipërisë, e cila, në krye të popullit shqiptar, çliroi përgjithmonë atdheun nga robëria dhe që me heroizmat e saj të papërshkrueshme, me unitetin e saj të çelniktë, me pjekurinë dhe urtësinë e saj shembullore, me besnikërinë e saj të pakufishme ndaj marksizëm-leninizmit, është faktori vendimtar i të gjitha fitoreve të korrura dhe garancia e madhe dhe e sigurtë e fitoreve në të ardhshmen!

Të rrojë dhe ta mbrojmë me të gjitha forcat tona Republikën Popullore të Shqipërisë dhe kufitë e saj të shenjtë, pse ky është amaneti i dhjetëra mijë dëshmorëve tanë!

Të rrojë dhe ta forcojmë çdo ditë e më shumë miqë-

sinë e pathyeshme me popujt vëllezër të Bashkimit të lavdishëm Sovjetik, të Kinës së madhe të Mao Ce Dunit, me popujt heroikë të Vietnamit, të Koresë, të Bullgarisë, të Çekosllovakisë, të Polonisë, të Hungarisë, të Mongolisë, të Rumanisë, të Republikës Demokratike Gjermane!

Të rrojë dhe të forcohet çdo ditë e më shumë kampi ynë i fuqishëm i paqes dhe i socializmit!

Të luftojmë me të gjitha forcat tona për të mbrojtur paqen në botë!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 285 (1925), 29 nëntor 1954

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**FJALA E MBAJTUR NË PRITJEN E DHËNË PËR
NDER TË DELEGACIONIT QEVERTAR KINEZ QË
KA ARDHUR NË VENDIN TONË ME RASTIN
E 10-VJETORIT TË ÇLIRIMIT**

[Nëntor 1954]

I dashur shoku Li Hsien Nien,

Të dashur shokë anëtarë të delegacionit qeveritar të Republikës Popullore të Kinës,

Më lejoni të dashur shokë t'Ju shpreh Juve dhe nëpërmjet Jush Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës, Komitetit Qendror të Partisë së lavdishme Komuniste të Kinës, Presidentit të Republikës, shokut të dashur Mao Ce Dun dhe mbarë popullit vëlla kinez, falenderimet tona më të nxehta për pjesëmarrjen Tuaj në festën e madhe të popullit shqiptar, 10-vjetorit të çlirimit të atdheut tonë.

Me një ndjenjë krenarie legjitime, në këto ditë të gëzuara dhe të lumtura populli ynë përshëndeti midis përfaqësuesve të vendeve të tjera mike edhe përfaqësuesit e Kinës së lavdishme Popullore, miq të shtrenjtë e të dashur të popullit tonë.

Një distancë prej disa mijëra kilometrash i ndan

vendet tona nga njëri-tjetri, por kjo distancë e madhe sot nuk mund të jetë më pengesë si në të kaluarën. Në epokën e lavdishme të këtij shekulli, kur të gjitha rrugët të çojnë në komunizëm, nuk ka dhe nuk do të ketë pengesa për bashkimin dhe vëllazërimin e popujve.

Idetë ngadhnjimore të marksizëm-leninizmit po hyjnë çdo ditë e më thellë në mendjen e njerëzve të thjeshtë kudo në botë. Këto ide të pavdekshme triumfuan plotësisht 37 vjet më parë në një të gjashtën e botës. U krijua kështu i pari shtet socialist, u vunë në jetë idetë e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, ku klasa punëtore në aleancë të ngushtë me fshatarësinë, pasi përmbysi nga themelet botën e vjetër, ndërtoi me sukses socializmin.

Gjatë Luftës së dytë botërore, shumë popuj të Evropës dhe të Azisë, midis të cilëve populli i madh kinez dhe populli shqiptar, deri dje të shtypur e të skllavëruar, të frymëzuar nga idetë gjeniale të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit dhe të ndriçuar nga rruga e lavdishme e triumfit të socializmit në Bashkimin Sovjetik, thyen prangat e skllavërisë kapitaliste, vendosën pushtetin e tyre të demokracisë popullore dhe ndërtojnë me sukses socializmin. Idetë triumfuese të marksizëm-leninizmit e zgjeruan shumë kampin e paqes, të demokracisë dhe të socializmit që përfshin sot 900 milion njerëz. Popujt triumfuan në Kinën e madhe, në RDP të Koresë, në RD të Vietnamit, Mongoli, Poloni, Çekosllovakia, Hungari, Rumani, Bullgari, në RD Gjermane dhe në Shqipëri dhe vendosën pushtetin e tyre pse ata u ndriçuan në rrugën e tyre të fitores nga idetë e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, pse ata u udhë-

hoqën me urtësi nga partitë e tyre të lavdishme komuniste dhe punëtorë.

Republika motër Popullore e Kinës është pjesë e pandarë e kampit të madh të paqes dhe të socializmit. Ajo u ngrit në saje të luftës së vendosur të popullit heroik të Kinës të udhëhequr nga Partia e lavdishme Komuniste Kineze me shokun e dashur dhe të urtë Mao Ce Dun në krye. E udhëhequr nga parimet e marksizëm-leninizmit, Republika e madhe Popullore e Kinës po ndërton me sukses bazat e socializmit. Ajo sot luan një rol shumë të rëndësishëm në mbrojtjen e paqes në Azi dhe në të gjithë botën. Republika motër Popullore e Kinës është bërë sot një fuqi botërore e dorës së parë, pjesëmarrja e së cilës është e domosdoshme kudo ku paraqiten për t'u zgjidhur seriozisht probleme të rëndësishme ndërkombëtare. Konferenca e Gjenevës¹ ishte një provë që tregoi rolin e madh që mund të luajë shteti vigan kinez për forcimin e paqes, për uljen e tensionit ndërkombëtar.

Populli ynë ushqen një simpati, dashuri të sinqertë për popullin e madh vëlla kinez pse të dy popujt tanë udhëhiqen nga të njëjtat ideale dhe ndjekin të njëjtën rrugë, rrugën që të çon në socializëm dhe komunizëm, rrugën e lumturisë dhe të begatisë së popujve tanë. Nuk ka asnjë dyshim se e udhëhequr me urtësi nga Partia e lavdishme heroike e Kinës dhe nga udhëheqësi i dashur

¹ Është fjala për konferencën e ministrave të punëve të jashtme të disa vendeve, midis të cilëve edhe i RP të Kinës, që u mbledh në Gjenevë nga 26 prilli deri më 21 korrik 1954 për çështjen e Koresë dhe të Indokinës.

dhe i urtë i popullit kinez Mao Ce Dun, Republika motër Popullore e Kinës do të ecë gjithnjë drejt sukseseve të reja në ndërtimin e jetës së re. Garanci për sukseset, si deri tani ashtu dhe në të ardhshmen, janë përpjekjet heroike të vetë popullit të lavdishëm të Kinës që është i vendosur për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e pavarësisë së atdheut të tij të madh, është ndihma e madhe, bujare e pa interes, eksperiencia e Bashkimit Sovjetik dhe vendosmëria e të gjithë popujve për ruajtjen dhe forcimin e paqes.

Populli shqiptar i uron popullit të madh vëlla kinez suksese të mëtejshme në ndërtimin e jetës së tij të re. Partia e Punës e Shqipërisë, të dashur shokë delegatë të Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës, do të vërë të gjitha forcat që miqësia midis popullit të vogël shqiptar dhe popullit të madh heroik të Kinës të forcohet për ditë e më shumë.

Rroftë dhe u përforcoftë miqësia e përjetshme dhe e pathyeshme midis popullit kinez dhe shqiptar.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**PËRGJEGJE LETRËS SË SHOKUT LI HSIEN NIEN
KU FALENDERON POPULLIN KINEZ PËR
DHURATAT QË I KA DËRGUAR POPULLIT TONË**

2 dhjetor 1954

I dashur shoku Li Hsien Nien dhe shokë anëtarë të delegacionit qeveritar kinez¹,

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë e priti me gëzim të madh letrën tuaj, me anën e së cilës na njoftoni se populli kinez i dërgon popullit tonë, me rastin e 10-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë, dhuratat e mëposhtme: 20 000 ton grurë, 2 000 ton oriz, 2 000 ton sheqer, 100 000 metra tekstile të mëndafshhta, 200 ton litar kërpi, 100 ton zmalto dhe 40 ton kallaj.

Në emër të Partisë së Punës të Shqipërisë, Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të mbarë popullit shqiptar, ju falenderojmë nga zemra për këto dhurata bujare dhe shumë të çmueshme. Dhuratat tuaja janë shprehje e përzemërt e vëllazërimit dhe e miqësisë

¹ Ky delegacion ka ardhur në vendin tonë me rastin e 10-vjetorit të çlirimit.

së ngushtë që lidh popullin e vogël shqiptar me popullin kinez prej 600 milionësh. Mallrat që i dhurohen popullit tonë nga ana e popullit kinez janë një kontribut i rëndësishëm në përpjekjet e Partisë dhe të qeverisë sonë për përmirësimin e mëtejshëm të jetës së masave punonjëse të vendit tonë.

Populli shqiptar, që lufton me të gjitha fuqitë e tija për ndërtimin e bazave të socializmit, e çmon ndihmën dhe përkrahjen e popullit të madh kinez, ashtu sikurse ndihmën e Bashkimit të lavdishëm Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore, si faktor të domosdoshëm për fitoren e socializmit. Marrëdhënjet miqësore midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës kanë marrë kohët e fundit një hov të madh zhvillimi. Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë do të përpiqen që edhe në të ardhshmen këto marrëdhënje të zhvillohen pa pushim dhe që miqësia e popullit tonë me popullin vëlla kinez të rritet e të forcohet çdo ditë e më tepër. Miqësia midis popujve tanë është e pathyeshme.

Ju lutemi edhe një herë, të dashur shokë, të bëheni interpretë të falenderimeve tona më të përzemërta dhe të mirënjohjes sonë pranë Partisë Komuniste të lavdishme të Kinës, Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës, Presidentit të Republikës, shokut të dashur Mao Ce Dun dhe mbarë popullit kinez për dhuratat e çmuara që i jepen falas popullit tonë.

Ne i urojmë popullit vëlla kinez suksese gjithmonë më të mëdha për forcimin dhe lulëzimin e Republikës Popullore të Kinës.

Rroftë dhe u përforcoftë miqësia e pathyeshme midis popullit shqiptar dhe popullit të madh kinez!

Për Komitetin Qendror të PPSH

Sekretari i Parë

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 290 (1930), 4 dhjetor 1954

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**TELEGRAM¹ DREJTUAR KQ TË PK TË KINËS ME TË
CILIN E FALENDERON PËR URIMET E DËRGUARA
ME RASTIN E 10-VJETORIT TË ÇLIRIMIT
TË VENDIT TONË**

4 dhjetor 1954

**KOMITETIT QENDROR TË PARTISË KOMUNISTE
TË KINËS**

P e k i n

Më lejoni, të dashur shokë, t'ju shpreh, në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të mbarë popullit shqiptar, falënderimet më të nxehta për urimet që na bëtë me rastin e 10-vjetorit të çlirimit të atdheut.

Populli shqiptar dhe Partia e Punës e Shqipërisë, ushqejnë një simpati dhe dashuri të madhe për Partinë e lavdishme Komuniste dhe popullin e madh vëlla kinez me të cilin e lidh një miqësi e pathyeshme.

¹ Telegramë të tilla u janë drejtuar edhe mjaft partive dhe vendeve të tjera që dërguan përshëndetje me rastin e 10-vjetorit të çlirimit të vendit.

Me këtë rast i urojmë me gjithë zemër popullit vëlla heroik kinez suksese të mëtejshme në rrugën e tij për ndërtimin e socializmit dhe për përforcimin e paqes në botë.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

MBI DISA DETYRA PËR FORCIMIN E PUNËS NË SMT

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

17 dhjetor 1954

Siç u tha edhe nga shokët e tjerë të Byrosë Politike, gjendja aktuale e SMT-ve nuk paraqitet e mirë, ato kanë të meta serioze për shkak të dobësive të vetë drejtorive të tyre dhe të Ministrisë së Bujqësisë. Ne duhet të bëjmë përpjekje të mëdha që këto të meta të zbulohen dhe të zhduken. Prandaj të theksohet në vendim që Ministria e Bujqësisë dhe Drejtoria qendrore e SMT-ve, së bashku dhe me ndihmën e komiteteve të Partisë, të marrin masa dhe të zhdukin të metat që ekzistojnë.

Një çështje me rëndësi për SMT-të është shfrytëzimi i agregateve që ato kanë në dispozicion. Agregatet që kemi sot, megjithëse të pakta në numër, nuk përdoren si duhet prandaj t'i vëmë gishtin kokës të mendojmë e të veprojmë se si t'i shfrytëzojmë mirë ato, pastaj të kërkojmë të tjera nga jashtë. Unë jam dakord të im-

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi punën e SMT-ve dhe masat për përmirësimin e mëtejshëm të tyre».

portojmë agregate, që të mundim t'i përdorim për të gjitha proceset e ndryshme të punës, por duhet që ato të mos i lëmë të na i prishë shiu, përkundrazi t'i ruajmë dhe t'i shfrytëzojmë mirë. Këtë çështje ta shikojnë me kujdes si dikasteret, ashtu dhe komitetet e Partisë, po më shumë duhet ta shikoni ju, drejtorë të SMT-ve¹, që agregatët të mos mbeten si mall i vdekur.

Rëndësi të madhe duhet t'i vëmë zbatimit të kontratave. Ashtu siç e ngritën edhe shokët, Ministria e Bujqësisë duhet të ketë kujdes dhe të mos japë urdhëra të përgjithshme për të gjitha zonat pa studjuar mirë veçoritë e secilës prej tyre. Çdo urdhër i saj të jetë i studjuar mirë dhe të marrë parasysh kushtet e rrethit apo të zonës. Në rast se në një zonë pambuku i pavjelë është shumë i paktë dhe nuk ka ndonjë interes, atje duhet filluar menjëherë nga punimi i tokës dhe në asnjë mënyrë të mos lëshohet automatikisht urdhër që pa u mbledhur edhe gonxhet e fundit të pambukut të mos punohet toka. Mua më duket se në këto raste kemi më shumë humbje. Përveç të tjerave, kjo bën që të shkelen edhe kontratat nga ana e fshatarëve, të spekulohet prej tyre në kurriz të shtetit dhe në mbjelljen me vonesë të kulturave bujqësore. Është e vërtetë se ka fshatarë të cilët ngurojnë që traktori të hyjë shpejt në arë, pse ata duan ta përdorin atë edhe për kullotë dhe mendojnë që traktori ta bëjë punën e vet më vonë. Kjo është gabim dhe me këtë nuk duhet të pajtohen SMT-të, pse mbjellja me vonesë është në dëm të ekonomisë së

¹ Në mbledhje ishin thirrur edhe drejtori i SMT-së së Elbasanit dhe i asaj të Lushnjës.

shtetit dhe të vetë fshatarit, të cilit duhet t'ja shpjegojmë mirë këtë çështje. Po të hyjë në arë traktori dhe të fillojë punimin e tokës, do të shkojë me siguri edhe fshatari dhe mbjelljet do të shpejtohen, pra kontrata e SMT-së me fshatarin do të zbatohet. Duke e bërë këtë punë më vonë, vjen dimri dhe traktori e ka vështirë të hyjë në arë, pra kemi humbje.

Në organizimin e punës së SMT-ve, me gjithë përmirësimet, ka akoma mjaft për të bërë. Kështu për she-mbull, duhet një aktivizim dhe kontroll më i mirë i agronomëve të SMT-ve, një bashkëpunim më efektiv i tyre me agronomët e tjerë që janë në rreth. Të mbahet parasysh se detyra e agronomëve të rrethit apo të qarkut është në fushë dhe ata duhet të bashkëpunojnë patjetër me SMT-të. Ky është një problem me shumë rëndësi që duhet zgjidhur në praktikë. Po kështu, në SMT-të duhet të vendosim një disiplinë të fortë, të arrihet që traktoristët të jenë në pararojë të klasës punëtore në fshat dhe të mos thyejnë disiplinën, duke u larguar pa leje në pazar, të mos lejohet që të shpërdorohet ose të vidhet karburanti, të tregohet kujdes për mirëmbajtjen e maqinerisë etj.

Në këto e të tjera drejtime, mua më duket se duhet të ketë më shumë inisiativë. Çfarë u kushton drejtuesve të SMT-ve, që, për të mos i lejuar njerëzit e pandërgjegjshëm ose armiq të vjedhin, të marrin inisiativën për të ndërtuar një barrakë të thjeshtë ku të vendosen e të mbrohen maqinat mbjellëse, kultivatorët dhe traktorët? Pse të vijnë çështje të tilla deri këtu në Byronë Politike, kur mund të zgjidhen në bazë me inisiativë e luftë më të madhe? Nuk kërkohet të bëhen depo me

betonarme për ruajtjen e karburantit ose për maqinat, po ndërtime të thjeshta, që nuk janë të vështira për një drejtori SMT-je. Kështu mund të zgjidhet edhe çështja e ndërtimit të shtëpive lëvizëse. Unë jam dakord për pajisjen e qendrave të brigadave me mjete të importuara nga jashtë, por, po të bëjmë një kontroll të mirë në cfiçinat tona, jam i bindur se do të gjejmë çdo gjë për këtë qëllim. Megjithatë, në qoftë se ka mbetur pa sjellë nga jashtë ndonjë gjë që nuk e sigurojmë dot vetë me forcat tona, faji është i Ministrisë së Bujqësisë që, kur ka bërë planin, nuk i ka parashikuar e kërkuar edhe ato.

Këtu u ngrit edhe nevoja e plotësimit të SMT-ve me kuadro nga dikasteret e tjera. Këtë çështje ne e kemi diskutuar edhe në një mbledhje të Sekretariatit dhe ishëm të një mendimi që ky problem të mos na paraqitet i pastudjuar. Unë nuk jam në kundërshtim që të mos jepen kuadro për SMT-të, po nuk jam dakord të na bëhen propozime në mënyrë të shkëputur dhe pa e studjuar problemin në prizmin e interesit të përgjithshëm, mbasi, siç dihet, kuadrot e lartë të ne numërohen me gisht. Nevoja për kuadro kanë edhe sektorë të tjerë. Në transport për shembull ka pak teknikë dhe tani që do të na vijjnë shumë automobila të tjerë ky problem bëhet akoma më i vështirë. Prandaj çështjen e kuadrit, aparati i Komitetit Qendror duhet ta studjojë në kompleksin e përgjithshëm. Përsa i përket propozimit që në SMT-të të mos ketë nëndrejtorë politikë, por në vend të tyre të jetë një sekretar i veçantë i komitetit të Partisë që të ndjekë problemet e SMT-ve, unë them të mos shpejtohemi. Situata të ne ndryshon krejtësisht nga ajo e ndonjë vendi tjetër, për këtë arsye ne s'mund të

kërkojmë që të zbatojmë të njëjtat forma organizimi. Le të vazhdojmë edhe kështu siç e kemi organizimin, kjo nuk do të thotë që të mos bëhet studimi, ndërsa për sekretar partie të veçantë në rreth mendoj se s'është nevoja, çështjet e bujqësisë i ndjekin instruktorët e seksionit të bujqësisë, të cilët lidhen me një sekretar të komitetit të Partisë.

Lidhur me ndalimin nga puna të traktoristëve, mundet që Ministria e Bujqësisë të rëndohet me shumë faj, por faktet na tregojnë se për të gjithë kuadrot e rinj që mbarojnë shkollat ne mundohemi, harxhojmë edhe të holla dhe, kur vjen fundi, ndonjë traktorist hidhet poshtë, pushohet. Kjo është një çështje me shumë rëndësi, të cilën duhet ta shikojmë me kujdes të madh dhe ta kontrollojmë, pse do të gjendemi përpara vështirësive akoma më të mëdha. Mendoj që në këtë çështje të vendosim një rregull: pa aprovim të byrosë së komitetit të Partisë të qarkut, për shembull asnjë traktorist të mos pushohet, ashtu siç kemi edhe rregullin tjetër, sipas të cilit asnjë komitet partie rrethi nuk përjashton nga Partia atë që është punëtor pa marrë vendim Sekretariati i Komitetit Qendror. Kjo do të bëjë që të mendohet mirë para se të veprohet për të pushuar një traktorist, pse jo vetëm që ata i kemi të paktë, por duhet punuar me ta për edukimin dhe trajtimin e tyre.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

PËR FORCIMIN E MËTEJSHËM TË PUNËS SË PARTISË E TË KOMANDËS UNIKE NË USHTRI

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

21 dhjetor 1954

Partia i kushton një kujdes të madh forcimit të ushtrisë. Ky kujdes është treguar me kohë, qysh në fillim të krijimit të ushtrisë dhe vazhdon e do të vazhdojë të rritet kurdoherë. Megjithëse Partia e ka pasur në qendër të vëmendjes forcimin gjithnjë e më të madh të ushtrisë, këtej e tutje ajo do ta dhjetëfishojë kujdesin e saj. Këtë e lyp situata ndërkombëtare, rreziku që kërcënon kampin e paqes e të socializmit, pjesëtar i të cilit është edhe vendi ynë.

Ushtria jonë ka bërë çdo vit përparime të mëdha.

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth raporteve «Mbi gjendjen ushtarako-politike të ushtrisë», paraqitur nga Ministria e Mbrojtjes Popullore dhe «Mbi punën politike dhe organizative të organeve të Partisë e të rinisë në ushtri», paraqitur nga një ekip i KQ të PPSH.

Ajo vazhdimisht forcohet në rrugën e drejtë të Partisë; njerëzit e saj kaliten dhe edukohen më mirë nga të gjitha pikëpamjet. Megjithkëtë, ekzistojnë edhe disa të meta, të cilat vihen në dukje në raportet që na janë paraqitur. Pavarësisht nga kjo ne mund të themi se ushtria jonë nuk i ka plotësuar keq detyrat që i ka ngarkuar Komiteti Qendror i Partisë. Por nga analizat që ne bëjmë herë pas here këtu në Komitetin Qendror na dalin edhe detyra të reja për ta shpënë më përpara punën e Partisë në ushtri.

Me gjithë kujdesin e treguar, duhet thënë se interesimi i aparatit të Komitetit Qendror për ushtrinë nuk ka qenë në shkallën e duhur dhe ky nuk është vetëm faji i tij. Faji fillon në radhë të parë që nga ne sekretarët e Komitetit Qendror pse nuk i kemi ndjekur më nga afër problemet e ushtrisë. Ekipet për kontroll e ndihmë nga ana jonë si Komitet Qendror duhet të dërgojmë vazhdimisht në ushtri, ashtu siç e bëjmë këtë edhe për organizatat e Partisë në terren. Një kontroll i tillë do të jetë një ndihmë edhe për vetë punonjësit e aparatit të Komitetit Qendror, të cilët do të edukohen dhe do të mësojnë se si të merren më mirë me problemet ushtarake dhe do të jenë në gjendje të japin ndihmën e duhur.

Nuk mund të zhiduken të metat që kemi në ushtri pa udhëheqjen luftarake, të shëndoshë të Partisë, pa kuptuar thellë se çështjet e ushtrisë nuk janë të shkëputura nga udhëheqja e Partisë. Në mendjen e çdo komandanti, komisari apo ushtari duhet të rrënjoset mirë pikëpamja që, në radhë të parë, unë jam njeri i Partisë, e cila më ka ngarkuar detyra të larta që duhen kryer me nder. Secili duhet ta ketë të qartë se urdhërat e

komandës ose detyrat e organizatës bazë dalin nga një burim i vetëm: nga Partia. Prandaj puna e Partisë dhe e komandës në ushtri duhet të jetë e koordinuar dhe jo njëri t'i bjerë gozhdës dhe tjetri patkoit.

Komandanti dhe komisari i repartit të ne përbëjnë komandën unike. Këtë duhet t'ja bëjmë mirë të qartë Partisë dhe të gjithë oficerëve, komandantëve dhe komisarëve dhe të punohet në mënyrë të tillë që edhe komisarët të interesohen si duhet për problemet ushtarake, pse pa i njohur ato, komisarët nuk mund të kenë sukseset e duhura në drejtimin e Partisë për të mobilizuar efektivin që përgatitja luftarake e trupave të realizohet qind për qind. Por edhe komandanti nga ana e tij duhet të kuptojë mirë se detyrat ushtarake nuk mund të zbatohen si duhet, sado specialist që të jetë ai, pa u mbështetur te Partia, pa e bërë efektivin të ndërgjegjshëm, pa menduar se në ndërgjegjen e njerëzve ka akoma mbeturina, të cilat manifestohen në mungesën e disiplinës, në zellin e paktë të disave për të mësuar etj. Këto e të tjera mbeturina ekzistojnë ku më shumë e ku më pak dhe pa u mbështetur te Partia ato s'mund të luftohen dhe detyrat ushtarake nuk mund të kryhen. Është e pakuptueshme që komandanti të interesohet për çështjet ushtarake dhe jo për çështjet e Partisë, ashtu siç është e pakuptueshme që komisari të interesohet për problemet e Partisë dhe jo për ato ushtarake. Çdo kuptim tjetër dobëson komandën unike dhe shpie në atë që të mos zbatohen si duhet detyrat e Partisë për përgatitjen politiko-ushtarake të efektivit. Komandantët duhet të mendojnë si njerëz partie, ta kenë të qartë se kanë të bëjnë me njerëz dhe jo me automatë. Le të mendojnë

pak këta komandantë se edhe në ndërgjegjen e tyre ka mbeturina dhe, kur një superior jep një urdhër të rreptë, të fortë, në kokën e vartësve mund të krijohen edhe pikëpamje jo të drejta. Prandaj ata ta kenë parasysh këtë dhe të mos shpërdorjnë të drejtën që ka komandanti për të urdhëruar vartësit. Me të drejtë komandanti kërkon të zbatohen ligjet dhe rregulloret, por para se të japë një urdhër ose të marrë një vendim, të mendojë e të veprojë si njeri partie, me qëllim që kuadrot dhe trupat të edukohen për t'i zbatuar ato në mënyrë të ndërgjegjshme.

Fakti që stërvitja ushtarake zhvillohet në rregull, sipas programeve, tregon se organizatat e Partisë nuk rrinë duarlidhur. Por në raportet që na janë dhënë, më duket se puna e Partisë në ushtri nuk pasqyrohet plotësisht. Kjo mendoj se s'është e drejtë. Atje punohet mirë dhe kjo duket edhe në stërvitjet luftarake. Megjithkëtë, unë mendoj se stërvitjes shokët e ushtrisë, që nga ministri e deri poshtë duhet t'i vënë rëndësinë më të madhe. Gjatë zhvillimit të saj duhet të luftohet formalizmi dhe të metat e tjera që vihen re herë pas here. Kjo është e domosdoshme, pse ushtria po pajiset me armë moderne dhe me një teknikë të lartë. Për këtë arsye, edhe njerëzit tanë duhet të ngrihen më tepër nga ana ushtarake. Që të arrihet kjo, Partia duhet të jetë motori i të gjithë punës që zhvillohet në ushtri.

Rrezikun e luftës nuk duhet as ta nënvleftësojmë, as ta mbivlerësojmë. Përgatitja politiko-ushtarake ka për qëllim që të rritë gjithnjë e më shumë aftësitë luftarake të ushtrisë dhe të gjithë popullit tonë, me qëllim që të jemi në gjendje të përballojmë çdo agresion të armikut,

sado i rrufeshëm dhe i befasishëm që të jetë ai. Rëndësi të madhe ka edukimi i aviatorëve tanë, forcimi i mëtejshëm i mbrojtjes kundërajrore dhe i gjithë artilerisë. Prandaj njerëzit që do të jenë në artilerinë kundërajrore duhet të jenë të aftë, të zot dhe të edukohen mirë që kundërveprimi i tyre të jetë shkatërrues për armikun. Në këtë kuadër duhet vlerësuar veçanërisht pregatitja politike dhe luftarake e trupave në artilerinë bregdetare. Atje Partia dhe komanda duhet të mobilizohen që jo vetëm të bëhen në rregull punimet, sipas planeve të caktuara, por kuadrit që do të ketë në dorë këtë artileri, t'i vihet kujdes i posaçëm. Ata duhet të jenë besnikë dhe njerëz të zot, të dinë mirë zanatin...

Edhe këmbësoria ka rëndësi të madhe për ne, pse ajo duhet të bëjë që armiku të gozhdohet në vend, që ai të mos kalojë asnjë çap në tokën tonë. Prandaj këmbësori, jo vetëm të edukohet, por të bëjë edhe stërvitje teorike e praktike, të lidhura këto me konditat e vështira e shumë të vështira që mund të na krijohen në kohë lufte.

Një tjetër problem me rëndësi është ai i ndërlidhjes. Kësaj arme, ashtu si dhe gjithë armëve të tjera, i është vënë rëndësi, por është e domosdoshme që atë ta forcojmë akoma më tepër. Në ushtri kemi më shumë mjete të forta ndërlidhjeje, po ndërlidhja në sektorin civil është e dobët, komunikimi i menjëhershëm me qarqet ose rrethet është i vështirë. Me këtë ndërlidhje si mund t'i kryejmë detyrat e mëdha në rast lufte? Prandaj ne duhet që tani të mendojmë e të veprojmë që ndërlidhjen edhe në sektorin civil ta kemi të fortë.

Shkurt, të gjitha armëve t'u vëmë rëndësi të madhe.

Udhëheqja e tërë punës në ushtri nga Partia është vendimtare. Mua më duket se këtë rol e kanë kuptuar mirë të gjithë shokët e Partisë, edhe ata që janë efektivë në ushtri. Megjithkëtë dëshiroj të theksoj që organizatat e Partisë medoemos duhet ta mbështetin punën e komandës dhe të luftojnë që të rritet autoriteti i saj. Pa autoritetin e komandës nuk do të kemi sukseset e duhura. Te ne s'ka asnjë tendencë ose rrymë, bile as ndonjë shenjë, që t'i kundërvihet autoritetit të komandës, por s'bëjmë keq të kujtojmë se pa komandë me autoritet nuk mund të ketë ushtri të fortë. Prandaj Partia të përpiqet me të gjitha format e punës për edukimin e efektivit që jo vetëm të ngrihet prestigji i komandës, por të forcohet gjithnjë e më shumë edhe dashuria e trupave për të. Kjo duhet të jetë në krye të punës edukative që zhvillon Partia me njerëzit, me qëllim që të krijohet te ata një bindje e plotë për detyrat ushtarake që shtron komanda. Partia jonë nuk mund të pranojë që vija e saj dhe urdhërat ose vendimet e komandës të zbatohen në mënyrë automatike, pa u kuptuar, pa qenë të ndërgjegjshëm. Zbatimi i ndërgjegjshëm i vendimeve dhe i detyrave në ushtri është për të mirën e saj, të popullit dhe të atdheut. Çështja e kuptimit të drejtë politik dhe ideologjik të vendimeve, direktivave e rregulloreve që janë në ushtri siguron zbatimin me përpikëri të tyre dhe kjo është shumë e rëndësishme. Këtu duhet të synojë Partia dhe në këtë mënyrë do të arrijmë që ta ngremë akoma më tepër prestigjin e komandës. Nga ana tjetër, të gjitha organet ushtarake dhe politike nuk duhet t'i lejojnë ata komandantë, të cilët, me vep-

rimet e tyre të jashtëligjshme që s'përputhen me vijën e Partisë, të ulin autoritetin e komandës.

Në ushtrinë tonë, ku edukimi udhëhiqet nga Partia janë të gjitha mundësitë që këto urdhëra, rregullore e direktiva të drejta të komandës të zbatohen; vetëm çështja është që të përdoren mirë të gjitha format e punës për një edukim të shëndoshë, pse nuk janë masat disiplinore ato që e zgjidhin problemin, por në radhë të parë edukimi i njerëzve, kuptimi i thellë nga ana e tyre i detyrave të mëdha që shtrohen për mbrojtjen e atdheut. Është e qartë se komanda në ushtri ka një rol të madh. Tani vjen puna e autokritikës dhe e kritikës ndaj saj. Natyrisht edhe komandanti e komisari kur gabojnë duhet të korrigojnë, pra edhe të kritikohen e të dënohen për fajet e tyre, por a duhet shtruar çdo gjë në organizatën bazë? Unë mendoj se ka edhe rrugë të tjera. Një komandant, për shembull, për një gabim që bën thirret dhe këshillohet nga eprori i tij, me të mund të bisedojë edhe komisari, por në rast se ai e përsërit gabimin, atëhere çështja shtrohet në organizatën bazë të Partisë.

Në parim një njeri që gabon duhet të kritikohet, të korrigojë ndryshe nuk ndreqet. Por komisarët, komandantët, Drejtoria politike duhet të gjejnë mënyrat dhe metodat më të ndryshme për t'i korrigjuar njerëzit dhe, brenda vijës së Partisë, të mos lihen pa u kritikuar e korrigjuar. Mirëpo nuk mendohet e nuk veprohet kështu në të gjitha rastet dhe, si pasojë, kalohet ose në masa shtetërore, ose bëhet një kritikë e zbehtë. Në këtë çështje nuk ka receta për çdo rast. E vetmja recetë e njohur është që në ushtri urdhërat e komandës nuk

diskutohen, por zbatohen deri në fund. Mirëpo njerëzit, duke punuar bëjnë edhe gabime, të cilat duhen ndrequr. Kjo kërkon që të zhvillohet një punë e gjerë edukative nga organizata bazë e Partisë. Nuk mund të themi se njerëzit në ushtri janë pa kulturë. Përkundrazi, niveli i përgjithshëm kultural sot në ushtri është më i lartë, prandaj edhe puna e edukimit është më e lehtë se përpara. Vetëm se organizatat bazë mendoj se duhen gjallëruar. Këtu nuk duhet të kapemi pas termave për një «kujdestari të tepruar», por duhet të bëjmë kujdes në çështjen e zhvillimit të mbledhjeve të organizatave bazë, të cilat, pa kritikë dhe autokritikë, nuk mund të bëhen luftarake. Në rast se në organizatën bazë diskutojnë 2-3 vetë, kuptohet se atje ka diçka që nuk ecën: ose komunistët janë me nivel shumë të ulët, ose veprohet me metoda pune që janë të huaja për Partinë, kështu mjaftohet me dy-tre diskutime dhe mbledhja mbyllet. Këto nuk janë veprime të rregullta dhe në raste të tilla organizata bazë nuk ecën në rrugë të drejtë. Ose të marrim çështjen kur komunistët nuk aktivizohen për të ndihmuar një sektor pune që nuk ecën, qoftë përsa i përket disiplinës, qoftë për jetën e ushtrisë, për mirëmbajtjen e kafshëve etj. Pa ngarkimin e komunistëve me detyra mbledhjet e Partisë janë formale, pse ne nuk jemi për të bërë mbledhje për mbledhje. Në organizatë, komunistët duhet të ngarkohen jo vetëm me detyra të përgjithshme, po edhe me detyra të veçanta. Ashtu sikurse ne ngarkojmë ekipe për të shqyrtuar një sektor, edhe organizata bazë në ushtri mund të ngarkojë një grup shokësh për të parë nëse ka rregull në fjetoren e ushtarëve, nëse kafshët mbahen mirë etj.

Edhe mbajtja e procesverbaleve në mbledhjet e organizatave bazë të Partisë ka rëndësi. Ky nuk është një formalitet burokratik, por një rregull i domosdoshëm, që i jep mundësi degës politike dhe komisarit të njihen me jetën e organizatës bazë, të marrin dijeni të plotë mbi gjendjen morale, politike e ushtarake të efektivit. Por faktet tregojnë se procesverbalet ose protokollet nuk vlerësohen si duhet. Sigurisht, të deleguarit dhe instruktorët në organizatat bazë të Partisë duhen dërguar, por edhe procesverbalet apo vendimet nuk duhen nënvleftësuar. Ne nuk duam që vendimet e organizatës bazë të mbeten në letër, kryesorja është që ato të zbatohen. Po kështu, procesverbalet vërtet duhen mbajtur por rëndësi ka që ato të shfrytëzohen. Komandës së repartit dhe deri ministrisë u duhet bërë e qartë situata, ç'probleme kanë dalë, ç'detyra janë nxjerrë dhe si mendon Partia për t'i zgjidhur ato. Këto janë disa mendime, por praktika do të na mësojë se si duhet të veprojmë, si duhen bërë raportet, si të hartohen vendimet, si duhen mbajtur protokollet etj., po ne duhet të përpiqemi të dimë se si zbatohen detyrat që shënohen në këto dokumenta, gjë që kërkon herë pas here edhe kontroll.

Shokët kanë bërë mirë që kanë parë edhe çështjen se si punojnë komisarët. Në ushtri ne kemi kuadro shumë të mirë për këtë qëllim. Në rast se na mungojnë mund të marrim edhe nga komandantët dhe t'i caktojmë komisarë. Po nuk mjafton vetëm fakti që të kemi në ushtri komisarë të shëndoshë, është e rëndësishme që të forcojmë më tej punën e Partisë, të mos lihen pasdore format e edukimit, të zhvillohen mbledhjet e rregullta të seminareve, të tregohet kujdes i madh për forcimin

e byrove të organizatave bazë. Të forcohet puna edhe me instruktorët e degëve politike, veçanërisht të instruktorëve të Drejtorisë politike, që ata të bëhen shembull për të tjerët. Po të bëhen mirë të gjitha këto gjëra, atëhere do të kemi rezultate të mëdha.

Në të gjitha këto probleme, komisarët duhet të luajnë një rol të madh, të ndihmojnë dhe të këshillojnë organizatën bazë, byronë ose sekretarin e saj që të përsosin gjithnjë udhëheqjen. Parimisht komisarë është përfaqësuesi i Partisë në repart, prandaj ai duhet të qëndrojë sa më afër organizatave bazë dhe të gjitha aparateve të zgjedhura duke ndihmuar që të zbatohen mirë direktivat e Partisë dhe urdhërat e komandës. Ai duhet të shikojë raportet, të bëjë vërejtjet e tija, të koordinojë datat e mbledhjeve me komandën, të merret me punën që duhet të bëjnë shtëpitë e kulturës etj. Po kështu mund të themi edhe për punën që duhet bërë me kuadrin. Format janë caktuar drejt, por çështja është se si punojmë ne për t'i vënë në jetë këto forma. Drejtoria politike duhet të luajë një rol shumë të rëndësishëm në këtë çështje, ajo duhet të interesohet më tepër për të gjithë kuadrat e ushtrisë...

Këto ishin disa çështje që doja të theksoja unë për forcimin e mëtejshëm të punës së Partisë e të komandës në ushtri.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

SHËNIM NË LIBRIN E PËRSHTYPJEVE TË MUZEUMIT TË SHKODRËS

29 dhjetor 1954

Muzeumi i Shkodrës është një thesar i çmueshëm jo vetëm për qytetin e Shkodrës, por për gjithë vendin. Shkodra, qytet i vjetër heroik, me një kulturë të lashtë dhe me tradita të shquara patriotike ka qenë dhe është kurdoherë një qendër e rëndësishme kulturele dhe artistike e vendit tonë. Kultura, arti, muzika po marrin një zhvillim të pashembullt sot në pushtetin popullor. Muzeumi është një nga këto qendra kulturele. Në muzeum janë ekspozuar në mënyrë shkencore dhe të kulturuar shumë pjesë me vlerë të madhe (dhe kjo i detyrohet drejtorit të muzeumit, shokut Vasil Llazari.) Sigurisht që me një interesim akoma më të madh nga ana e njerëzve të kulturës dhe të arteve, muzeumi do të pasurohet më shumë. Muzeumi vazhdimisht duhet të ketë kujdesin e Partisë dhe të pushtetit në Shkodër, të ndihmohet në zhvillimin e tij nga patriotët, nga rinia, nga të gjithë njerëzit përparimtarë dhe të bëhet kështu një shkollë, një vend pelegrinazhi, një qendër kulturele e rëndësish-

me, ku populli të vijë të shikojë të kaluarën e lavdishme të stërgjyshërve tanë dhe realizimet e tij të mrekullueshme nën udhëheqjen e Partisë së tij të Punës.

*Botohet sipas origjinalit
që gjendet në muzeumin
e Shkodrës*

FJALA E MBAJTUR NË KONGRESIN E KATËRT TË BASHKIMEVE PROFESIONALE TË SHQIPËRISË

11 shkurt 1955

Të dashur shokë,

Më lejoni t'i sjell Kongresit tuaj të katërt të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë dhe nëpërmjet tij klasës punëtore dhe gjithë punonjësve të vendit tonë përshëndetjet më të nxehta të Partisë së Punës të Shqipërisë, të Komitetit Qendror të saj dhe të qeverisë së Republikës sonë popullore duke ju uruar nga zemra suksese në punë. Partia dhe qeveria kanë bindjen e plotë se Kongresi i katërt i Bashkimeve Profesionale do të shënojë një datë të rëndësishme në zhvillimin dhe forcimin më të madh të ekonomisë popullore, të mirëqenjes së masave punonjëse, të forcimit dhe të mbrojtjes së republikës popullore dhe të paqes në botë.

Sot është 10-vjetori i Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë, dhe nuk mund të ishte e rastit që fill pas çlirimit të atdheut nga thundra e okupatorëve dhe e feudoborgjezisë, me inisiativën e Partisë Komuniste të Shqipërisë, të themeloheshin bashkimet profesionale. Kjo ishte një nevojë urgjente dhe historike. Partia Komuniste e Shqipërisë, çliruesja e lavdishme e atdheut,

pararoja e klasës punëtore dhe e masave të tjera punonjëse të vendit, duhej t'i organizonte masat punëtore në një organizatë të fortë, të konkretizonte e të zhvillonte në rrethanat e reja pas çlirimit të vendit programin e saj revolucionar të reformave të mëdha politike, ekonomike dhe kulturele, të konsolidonte diktaturën e klasës punëtore, të çelnicoste hegjemoninë e klasës punëtore në aleancë revolucionare me fshatarësinë punonjëse dhe Shqipëria e re të ecte kështu me hapa të sigurtë në rrugën e lavdishme të socializmit. I takonte, pra, Partisë sonë, që e çoi popullin në fitoren e madhe të çlirimit, ta organizonte, ta edukonte dhe ta udhëhiqte popullin në rrethanat kur ky e mori fuqinë në duart e veta. Bashkimet profesionale u bënë mbështetja e fuqishme kryesore e Partisë dhe e qeverisë në kryerjen e këtyre detyrave të mëdha historike.

Partia jonë, që gëzon besimin absolut të popullit punonjës, ndërmoi me sukses veprën historike të transformimit revolucionar të vendit tonë, shumë të prapambetur nga çdo pikëpamje, e shkëputi për jetë Shqipërinë nga zinxhirët e kapitalizmit dhe të imperialistëve, nga pushteti i mallkuar shfrytëzues i feudalëve dhe i borgjezëve dhe i hapi vendit perspektiva të ndritura. Partia jonë, që përfaqëson virtytet më të larta të popullit dhe që realizon në jetë njërën pas tjetrës dëshirat dhe aspiratat e popullit, korri në çdo lëmë të aktivitetit shoqëror, ekonomik dhe kultural suksese të rëndësishme, pse ajo frymëzohet dhe udhëhiqet në çdo hap të saj nga marksizëm-leninizmi dhe pse populli ynë ka për-krahjen e vazhdueshme të Bashkimit të madh Sovjetik.

Frutet e punës së palodhur që gëzon populli sot.

dhe që janë një bazë e shëndoshë për suksese më të mëdha në të ardhshmen, e kanë burimin në lidhjet e ngushta të Partisë me popullin, të popullit me pushtetin e demokracisë popullore, e kanë burimin në aleancën e shëndoshë të punëtorëve me fshatarët, me intelektualët dhe me gjithë punonjësit e vendit, nën udhëheqjen e përgjithshme të klasës punëtore. Shprehja e kësaj miqësie, e kësaj dashurie, e kësaj aleance të ngushtë dhe të sigurtë, që udhëhiqet nga klasa heroike punëtore, duket me forcë në gjirin e bashkimeve profesionale të vendit tonë, të udhëhequra nga Partia e Punës. Ishte drejtësia e vijës politike, ekonomike dhe organizative të Partisë që krijoi këtë aleancë të shëndoshë të punëtorëve dhe të fshatarëve rreth së cilës u grumbulluan si kurrë ndonjëherë tjetër të gjitha shtresat e tjera punonjëse patriotike dhe demokrate të vendit, dhe zhdukën përgjithmonë sistemin ekonomik dhe shoqëror të feudoborgjezisë, i dhanë fshatarit tokën, mjetet e punës dhe fabrikat, uzinat, minierat, transporti, bankat etj., u bënë pronë të përjetshme e popullit punonjës.

Është i qartë roli i madh që kanë luajtur bashkimet profesionale, brenda një periudhe të shkurtër prej dhjetë vjetësh. Bashkimet profesionale janë bërë mbështetja kryesore e Partisë dhe e qeverisë në luftën për forcimin dhe demokratizimin e vazhdueshëm të pushtetit popullor, në ngritjen dhe zhvillimin e ekonomisë popullore, në edukimin komunist të klasës punëtore dhe të të gjithë punonjësve, në ngritjen dhe zhvillimin e arësimit dhe të kulturës, në ngritjen e nivelit material të punonjësve dhe në forcimin e aftësisë mbrojtëse të atdheut tonë.

Po të hedhim një sy gjatë periudhës 10-vjeçare të së kaluarës, ne do të shohim se ndryshime të mëdha janë bërë në organizatën e bashkimeve profesionale. E vogël ka qenë ajo në fillim, e vogël si klasa jonë punëtore, si numri i vogël i punonjësve të tjerë të vendit tonë, në arësim, në shëndetësi, në bujqësi, në tregëti, në administratë etj. Niveli kultural, arësimor, shkencor dhe teknik i kuadrove tanë ka qenë shumë i ulët, për arësye të prapambetjes së madhe në të cilën e kishin mbajtur regjimet e së kaluarës popullin tonë. Megjithëse traditat e luftës greviste nuk kanë qenë shumë të zhvilluara, klasa jonë punëtore dhe populli ynë, gjithnjë në luftë të vazhdueshme kundër okupatorëve dhe shfrytëzuesve feudalë, fituan në Luftën nacional-çlirimtare një eksperiencë shumë të madhe, shumë të pasur. Hovi i vrullshëm revolucionar i klasës punëtore dhe i gjithë popullit shqiptar do të kapërcente çdo pengesë, do të fitonte të gjitha fortesat. Sot bashkimet profesionale të udhëhequra nga Partia janë bërë organizata më e fuqishme e vendit tonë. Në këtë organizatë militojnë më dhjetëra e dhjetëra mijë punonjës. Klasa jonë punëtore është shtuar, është çelnikosur, ashtu si është forcuar industria jonë. Me dhjetëra mijë teknikë të ulët dhe të mesëm janë edukuar në shkolla profesionale, në kurse; kanë dalë me mijëra mësues e pedagogë të rinj, me mijëra inxhinierë, mjekë, agronomë, veterinerë, financierë, njerëz të artit dhe të kulturës kanë mbaruar shkollat e vendit dhe universitetet e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore; kanë dalë me qindra traktoristë e shoferë të rinj; punonjës të administratës shtetërore, të enteve të ndryshme të prodhi-

mit, njerëzit që janë zgjedhur dhe drejtojnë punët e pushtetit, kanë fituar një eksperiencë të madhe. Gjithë kjo forcë e edukuar nga Partia nëpërmjet bashkimeve profesionale, ka marrë në duart e veta drejtimin dhe zhvillimin e ekonomisë popullore dhe zbaton me sukses detyrat që i ka shtruar përpara Partia dhe qeveria, detyra që kanë për qëllim ngritjen në një shkallë më të lartë të nivelit të jetesës së masave punonjëse, duke shtuar prodhimet industriale dhe bujqësore, duke përhapur akoma në një shkallë shumë më të gjerë arësimin e kulturën në popull. Punonjësit e vendit tonë kanë ditur të përfitojnë nga eksperiencia e madhe e ndërtimit socialist në Bashkimin Sovjetik. Brenda dhjetë vjetësh çlirim, Shqipëria ka bërë hapa gjigandë përpara në industri, në bujqësi, në arësim, në kulturë etj. Jeta e popullit është përmirësuar dhe as që mund të krahasohet me mjerimet e së kaluarës. Këto ndryshime në jetën e popullit, nën udhëheqjen e urtë të Partisë, i bënë vetë punëtorët, fshatarët, intelektualët, patriotët e të gjithë Shqipërisë të bashkuar si një trup, pse atyre ju krijuan mundësitë, pse ata i krijuan vetë të gjitha këto mundësi dhe ditën të organizohen, të punojnë në mënyrë të organizuar dhe të krijojnë kështu vlera të mëdha për të zbukuruar jetën e tyre dhe faqen e atdheut. Fjalët i merr era thotë një fjalë e vjetër, por veprat qëndrojnë. Ç'kanë bërë regjimet e urryera të feudoborgjezisë për shekuj me radhë dhe që sot imperialistët amerikanë dhe anglezë ëndërrojnë dhe predikojnë t'i kthejnë përsëri në fuqi? Le të pyesin krahët, duart, këmbët, dhe zemrat e popullit tonë, që akoma na dhëmbin, dhe na therin nga plagët e pambyllura.

Ç'ka bërë pushteti i popullit brenda një periudhe kaq të shkurtër për t'i shëruar këto plagë shekullore? Për këtë flasin veprat, flasin realizimet, flet i madh e i vogël në Shqipëri që i prek me dorën e tij këto realizime, pse me dorën e tij i ka ndërtuar, i shfrytëzon për veten e tij, pse për këtë qëllim i ka krijuar. Në të kaluarën bejlerët, agallarët, tregëtarët e mëdhenj dhe regjimi i tyre për të mbajtur popullin të shtypur thoshin: «Shqiptarët s'bëhen kurrë tre veta së bashku, s'bëhet stan me lepura». Por ne jo vetëm që u treguam sa u vllente lëkura atyre «luanëve», por u treguam në mënyrë të shkëlqyer forcën monolite të popullit tonë heroik, bashkimin e tij të çelniktë dhe epërsinë e rendit tonë të demokracisë popullore mbi rendin e tyre të kalbur. Armiqtë e popullit, imperialistët luftënxitës dhe satelitët e tyre, më kot mundohen ta mbulojnë diellin e Shqipërisë me shoshë. Ata bëhen qesharakë dhe demaskohen.

Partia vazhdimisht na mëson të jemi objektivë në çdo gjë, të shohim të mirat dhe të këqiat. Ne kemi suksese jo të vogla në punën tonë, por kemi edhe të meta dhe disa herë serioze. Kundër këtyre të fundit duhet të luftojmë me këmbëngulje dhe t'i zhdukim. Partia na mëson që çdo gjë duhet të jetë nën kontrollin e vazhdueshëm të klasës punëtore dhe të punonjësve dhe vigjilencës revolucionare të masave të mos i shpëtojë asgjë. Në këtë drejtim bashkimeve profesionale u bien detyra me përgjegjësi të madhe. Organizatat e bashkimeve profesionale, që janë shkolla e komunizmit, duhet të bëjnë përpjekje të mëdha për ta ngritur në një nivel të lartë ndërgjegjen e anëtarëve të tyre, të

ngrenë ndërgjegjen socialiste të punonjësve dhe t'i bëjnë këta të aftë dhe të ndërgjegjshëm për të luftuar me këmbëngulje të metat që shfaqen në punë dhe që e kanë burimin në mbeturinat mikroborgjeze në ndërgjegjen e njerëzve, në qëndrimin akoma jo të drejtë ndaj pronës së përbashkët socialiste, në kuptimin jo të plotë të disiplinës në punë, në luftën akoma jo këmbëngulëse kundër burokratizmit e të këqiave të tjera. Që të mund të arrihen rezultate të kënaqshme në këtë drejtim duhet vetë udhëheqja e bashkimeve profesionale, në të gjitha shkallët të shkundet nga puna burokratike dhe nga rutina që akoma e pengon, të gjallërohet, të lidhet shumë më ngushtë me masat, të dëgjojë më shumë zërin e tyre dhe të marrë masa të shpejta dhe të përshtatshme për të përmirësuar punën. Puna e bashkimeve profesionale duhet të mos jetë kurrësi një punë zyre dhe letrash siç është bërë në përgjithësi zakon. Bashkimet profesionale kanë fjalën e tyre në çdo gjë, pse klasa punëtore dhe të gjithë punonjësit që militojnë në këtë organizatë të fuqishme janë zbatuesit dhe kontrolluesit e rreptë të vendimeve të Komitetit Qendror dhe të detyrave të qeverisë. Nga punonjësit varet fati i realizimit me sukses të planeve ekonomike të shtetit, pra të mirëqenjes së popullit. Këtë duhet ta realizojnë mirë punonjësit e vendit, drejtuesit e bashkimeve profesionale si edhe disa komunistë e komitete partie që akoma nuk i vënë rëndësinë e duhur, rëndësinë e madhe, punës me bashkimet profesionale. Këta komunistë dhe këto komitete partie, me lehtësi mund të përdorin formulat se «bashkimet profesionale janë shkolla e komunizmit», «ripa transmisioni. . .» etj., por

në praktikë s'janë në gjendje t'i zbatojnë si duhet, s'janë në gjendje ta organizojnë punën në atë mënyrë që bashkimet profesionale të bëhen me të vërtetë «shkolla e komunizmit» etj. Dua të theksoj se ka komunistë që nuk dallohen nga masa e anëtarëve të bashkimeve profesionale, kur ata duhet të jenë në ballë, të shquhen si luftëtarët më të mirë, si sulmuesit dhe novatorët më të shquar, si udhëheqës që janë. Të tillë komunistë duhet të shkunden, pse pengojnë ecjen e punës përpara. Me qenë anëtar i Partisë është nderi më i madh, por këtë nder duhet ta meritosh me një punë çdo ditë më të madhe dhe më të frutshme.

Partia duhet të vërë të gjitha forcat për të ngritur akoma më shumë autoritetin e bashkimeve profesionale, duke punuar më mirë në drejtimin që bashkimeve profesionale, t'u jepen kontingjente kuadrosh nga më të mirët, të ngritur nga ana marksiste, me një ndërgjegje klase të shëndoshë, organizatorë të përsosur, njerëz me perspektiva të qarta dhe rigorozë në zbatimin drejt të udhëzimeve dhe të vendimeve të Komitetit Qendror. Partia të mobilizohet e tëra për ngritjen ideologjike, kulturalë, teknike të punonjësve, t'i kalitë këta nëpërmjet punës, të rritë në ta ndërgjegjen e klasës dhe t'i bëjë luftëtarë të së resë kundër së vjetrës. Partia duhet ta kuptojë mirë se situatën në ndonjë ndërmarrje që nuk realizon planin nuk mund ta shpëtojë një instruktor i saj që kalon andej një herë në muaj, por organizata e Partisë që udhëheq të gjithë punonjësit e asaj ndërmarrjeje, dhe sidomos kur në atë ndërmarrje komunistët dinë të luftojnë në krye të organizatës profesionale të ndërmarrjes. Varet shumë nga organizata e

bashkimeve profesionale të ndërmarrjes, që planet e kësaj ndërmarrjeje të realizohen, që neglizhencat në punë nga ana e njerëzve, nga ana e udhëheqjes së ndërmarrjes ose nga mosinteresimi si duhet i ministrisë, të luftohen. Kur në ndonjë ndërmarrje nuk realizohet plani, është bërë zakon të thuhet se ka pasur arsye objektive dhe subjektive, dhe si rrjedhim, qoftë ministria, qoftë udhëheqja e ndërmarrjes vënë gjithë zellin e tyre t'i regjistrojnë këto arsye. Por këtë zell dhe këtë kujdes të madh nuk e tregojnë gjatë gjithë periudhës që duhet të realizohet plani, të marrin masat e duhura dhe të shpejta që t'u dalin përpara shkaqeve subjektive dhe objektive. Them edhe shkaqet objektive, pse edhe ato në disa raste e kanë burimin në shkaqet subjektive. Në rast se, për shembull, fabrika e çimentos në Shkodër, që është një ndërmarrje e përparuar, nuk e realizon planin për arsye objektive pse s'i vete qymyri, kjo është objektive për këtë fabrikë ndërsa për minierën e Kërrabës është subjektive e kështu me radhë. Bashkimet profesionale në prodhim, dhe si rrjedhim organizata e Partisë në ndërmarrje, nuk qëndrojnë si duhet në ballë të luftës për t'u vënë fre, ose më mirë për t'i vënë në vendin që meritojnë të gjithë ata njerëz që pengojnë realizimin e detyrave, që pengojnë realizimin e kontratave kolektive, që shkelin disiplinën në punë ose disiplinën financiare. Këtu mendoj unë ka lëshime të dënueshme nga të dy palët, qoftë nga organet shtetërore, qoftë nga bashkimet profesionale. Kjo, natyrisht çon në shtimin e burokratizmit, në një farë komprometimi, në një pajtim me të metat dhe kur

ngjet kështu, rezultati, natyrisht, është i keq. Atëhere dalim me justifikime.

Dua të theksoj gjithashtu se disa dikastere akoma nuk marrin masat e duhura për të zhdukur një sërë të metash në punën e tyre. Në radhë të parë është Ministria e Ndërtimit dhe e Komunikacionit. Interesimi i këtij dikasteri për drejtimin e mirë të punimeve, për kontrollin e tyre, për marrjen e masave me kohë, për kujdesin sidomos të jetës së punëtorëve, ka qenë dhe vazhdon të jetë i dobët. Çështja nuk është aq te ajo se na mungojnë mjetet ose specialistët ose fuqia punëto-re, megjithëse kjo e fundit është një problem serioz por jo i pazgjidhshëm, se sa te fakti që në Ministrinë e Ndërtimit e të Komunikacionit mungon organizimi i shëndoshë i punës dhe kontrolli në punë. Ministria e Ndërtimit duhet të krijojë kushte më të mira për punëtorët me ato mjete që i ka caktuar qeveria. Kushtet që u janë krijuar punonjësve të ndërtimit nuk shfry-tëzohen, nuk administrohen si duhet dhe me kohë mje-tet nga drejtuesit e dikasterit dhe të ndërmarrjeve të ndërtimit. Ministria e Ndërtimit dhe e Komunikacionit për këtë çështje ka faj, por në këtë drejtim nuk leh-tësohet aspak Ministria e Tregëtisë dhe kooperativat e shitblerjes, por as edhe bashkimet profesionale. Të tilla lëshime të dënueshme bëhen edhe në Ministrinë e In-dustrisë dhe të Minierave. Ministria në fjalë duhet ta përmirësojë metodën e punës dhe të interesohet më konkretisht dhe më gjallërisht për mbarëvajtjen e ndër-marrjeve industriale të sektorit të vet, t'u vërë veshin si duhet dhe të bëjë përpjekje më të mëdha për të zgjidhur nevojat dhe problemet që i shtrohen nga posh-

të. Në analizat e planit që ne bëjmë, konstatojmë me kënaqësi se shumë ndërmarrje e realizojnë planin; shkakut që shumë të tjera nuk e kanë realizuar planin është mosmarrja e masave me kohë nga ana e dikastereve, zgjatja dhe zvarritja e studimeve dhe e raporteve, burokratizmi i theksuar nga lart. Bashkimet profesionale janë në gjendje dhe duhet t'i luftojnë me këmbëngulje këto gabime, të vënë sa më parë në korrent Partinë dhe ajo të marrë masa urgjente dhe t'ua presë rrugën këtyre gjërave dhe atyre njerëzve që ngadalësojnë, që zvarritin, që pengojnë e që nuk bëjnë përpjekje të organizojnë mirë punën. Në forcimin e rregullit, të disiplinës e të kontrollit duhet gjithashtu të marrin masa edhe Ministria e Shëndetësisë dhe ajo e Bujqësisë etj.

Disiplina në punë, shokë, duhet të forcohet, pa disiplinë nuk mund të ecet përpara. Në punën tonë ajo është rritur, është forcuar, por ka akoma shumë të meta dhe lëshime, kemi shumë për të bërë në këtë drejtim. Elementët e liq dhe armiq, përfitojnë nga këto lëshime dhe na dëmtojnë. Duhet t'ua presim duart këtyre të liqve. I ligu mund të peshkojë vetëm në ujë të turbullt, ai ka frikë nga rregulli, nga disiplina, nga vigjilenca. Këto, pra, ne duhet t'i forcojmë sa më shumë pse vetëm kështu do të evitojmë vjedhjet, prishjet dhe dëmtimet që peshojnë në kurrizin e standardit të jetesës të të gjithë punonjësve. Këtu duhet të luftohet sistematikisht indiferentizmi i disave që mendojnë vetëm për të bërë një punë pa perspektivë dhe kënaqen sa të marrin rrogën, pa menduar se vlera e rrogës së tij ngrihet, kur prodhimi shtohet, kur rritet rendimenti në punë,

kur ulet kostua e prodhimit dhe kur s'u lihet shteg vjedhësve, abuzuesve e armiqve të tjerë që përpiqen të na dëmtojnë. Mund t'u jap një shembull tipik në këtë drejtim. Në Shkodër, kryetari i kooperativës së artizanatit ishte një luftëtar i vjetër, me plot dekorata për merita të së kaluarës, por ai flinte mbi ato dekorata, ai ishte aq indiferent për punën, ishte aq i dashur dhe gojëmbël me një armik të popullit, si Alfred Daberdukun, sa që për dy vjet me radhë e la të vidhte sa të donte, i dorëzoi bile dhe çeqe të bardha të firmoste ky myteber si të donte dhe kur të donte. Rezultati ishte se ky armik vodhi disa miliona dhe syleshi, që flinte mbi dafina, s'kishte tjetër ç'të thoshte veçse i vinte turp që do të dilte në gjyq. Si ky rast i Shkodrës ka edhe të tjerë. Për mbrojtjen e pasurisë së përbashkët socialiste duhet të bëhet një luftë e madhe teorike, edukative dhe praktike. Kjo mbrojtje të mos mbetet vetëm në formula ose parulla se atëhere është shterpë. Unë do të marr një shembull. Çështjen e banesave. Nuk ka shtet në botë, përveç Bashkimit Sovjetik, ku qiratë e shtëpive të jenë kaq të lira siç janë te ne. Kjo është një fitore e madhe dhe një favor që u bën shteti i tyre punonjësve të tij. Nga ana tjetër shteti ka ndër-tuar me mijëra dhe me mijëra apartamente. Këto s'janë të mjaftueshme, bile unë mund të them se, me gjithë shumatat e mëdha që shteti investon dhe do të vazhdojë të investojë çdo vit, ky problem qëndron akoma i mprehtë në qytete dhe sidomos në qytetet e mëdha, pse në fshatra jo vetëm që nuk ka krizë banesash, por me kënaqësi të madhe konstatohet se me ndihmat në lëndë të parë që shteti u akordon fshatarëve, këta po

ndërtojnë në shkallë të gjerë shtëpi të reja e komode. Por le të vijmë te bancsat e qyteteve. Këto banesa nuk i mbajnë kudo mirë dhe ky është faji i disa punonjësve që banojnë në to. Duhet t'i ndërtojë dhe t'i meremetojë pasuria e shtetit, kjo është e drejtë dhe ajo s'e bën punën si duhet e duhet të marrë masa urgjente, por kjo s'do të thotë që familja që rri brenda t'i vërë kazmën shtëpisë, të çajë drutë dhe të bëjë zjarr në mes të dhomës, të thyejë penxheret e dyert, të mos e mbajë pastër e të tjera gjëra të tilla që mund t'i cilësoj pa drojtje si kriminale. Kundër këtyre, natyrisht, duhet të marrim masa. Por këta njerëz, ndër të cilët mund të ketë dhe funksionarë, militojnë në bashkimet profesionale, militojnë në Front e në organizatat e tjera të masave. Këta njerëz duhet t'i vënë pak gishtin kokës. Këta duhet të kuptojnë se shtëpitë ku ata banojnë janë të shtetit, por në fakt janë të tyre, një pjesë e mundit dhe e djersës së tyre shkon në ndërtimin e apartamentit, të cilin ai duhet të përpiqet ta mbajë mirë e pastër, ta zbukurojë, ta mobilojë aq sa ka mundësinë dhe jo ta prishë. Në rast se ai e prish duhet të mendojë se ato pare që shteti do të vërë për ta ndrequr, do të dalin përsëri nga të ardhurat e shtetit, nga akumulimet e shtetit që do të thotë të rëndojnë përsëri mbi punonjësit. Ndonjë burim nga qiejt shteti ynë s'ka. Këto të ardhura janë edhe për shtëpinë, për dhomën, për apartamentin ku mblidhet dhe rron familja. Por familja rron, rriten kalamanët me shkollë, përmirësohet jeta, përmirësohen ushqimet, veshjet etj., në saje të punës së pjesëtarëve të aftë të çdo familjeje. Në rast se këta njerëz jo të ndërgjegjshëm ndaj apartamenteve

të shtetit, që janë pronë e përbashkët e popullit, sillen po aq keq me mjetet e punës që janë të përbashkëta dhe që në saje të tyre zbukurohet jeta, atëhere si vete puna? Natyrisht jo mirë. Nuk mund të jetë e drejtë pikëpamja se për apartamentin nuk interesohet, por për punët e tjera ai është shembullor. Jo, logjika s'të lejon të arrish në mendimin se mund të ketë dy qëndrime në këtë çështje ndaj pasurisë së shtetit.

Të marrim çështjen e sigurimeve shoqërore. Shumat kolosale që sigurimet shoqërore i përdorin, s'dalin nga ndonjë burim ekstraordiner, ato rrjedhin nga prodhimi shoqëror dhe përdoren për t'u ardhur në ndihmë punonjësve në bazë të ligjeve dhe të urdhëresave në fuqi. Këto administrohen nga bashkimet profesionale. Këtu nuk e kam çështjen se si përdoren këto fonde dhe as për punën burokratike që bëhet nga seksioni përkatës i bashkimeve profesionale dhe që duhet të gjallërohet më shumë, por e kam çështjen në kuptimin e drejtë që duhet të kenë disa punonjës që përfitojnë nga këto sigurime shoqërore. Derisa këto fonde e kanë burimin te prodhimi, sa më tepër të shtohet prodhimi, aq më të mëdha do të jenë këto fonde, aq më tepër dhe aq më mirë do të përfitojnë punonjësit e vendit tonë. Përveç pensioneve, fatkeqësive në punë, ndihmës së nënave, zhvillimit dhe përhapjes së artit e kulturës, bashkimet profesionale çdo vit dërgojnë me mijëra e mijëra punonjës dhe pionierë në kampet e pushimit në të katër anët e Shqipërisë. Këto nga viti në vit do të shtohen, s'ka asnjë dyshim. Prandaj shtimi i rendimentit në punë që krijon bollëkun, përmirëson jetën e punonjësve, shton gjithashtu fondet e sigurimeve sho-

qërrore. As klasa punëtore as bashkimet profesionale nuk duhet të lejojnë që disa njerëz jo të ndërgjegjshëm të abuzojnë me fondet e sigurimeve shoqërore duke u bërë bisht ligjeve në fuqi. E kam fjalën për ata persona që në saxe të disa çertifikatave e raporteve rrinë me muaj të tërë pa punë, në mos me vite dhe marrin rrogë në kurriz të fondeve që u përkasin punonjësve dhe jo parazitëve. Bashkimet profesionale këtyre gjërave duhet t'u japin fund, dhe kjo s'duhet të jetë vetëm problem për disa zyrtarë të bashkimeve profesionale, por për të gjithë anëtarët dhe masën e punonjësve. Çështja e kontrollit nga ana e masave punonjëse duhet të ngrihet kudo me forcë. Është pikërisht, shokë, për këtë që Partia dhe qeveria jonë i ka ngritur çështjet me forcë dhe pa drojtje, është pikërisht për këtë që klasa punëtore dhe punonjësit e vendit tonë i kanë përqafuar dhe zbatuar me forcë dhe drejt direktivat dhe udhëzimet e Partisë dhe të qeverisë që vendi ynë ecën përpara dhe ne kemi korrur suksese. Ne do të korrin suksese akoma më të mëdha, ne do të kapërcejmë akoma vështirësi që do të hasim në rrugë, ne do t'i ndreqim edhe gabimet edhe njerëzit që gabojnë, ne flasim me besim të madh për këtë gjë, pse jemi komunistë, pse kemi besim të madh te njerëzit, pse njerëzit ndreqen, ndreqen dhe gabimet, duke u mobilizuar të tërë dhe duke i përdorur të gjitha mjetet që na ka vënë në dorë Partia. Ne na udhëheq Partia jonë marksiste-leniniste, që e konsideron njeriun si gjënë më të çmueshme, që e do njeriun dhe ja zbukuron atij mendjen dhe jetën, e bën atë luftëtar të paepur për t'i ndërruar

faqen atdheut tonë, ashtu sikundër ka bërë deri tani, ashtu si do të bëjë edhe më shumë në të ardhshmen.

Lenini dhe Stalini vazhdimisht na mësojnë se kritika dhe autokritika është një armë e mprehtë e partive tona leniniste që gjallëron, që fuqizon, që shëron dhe ndreq, që çon përpara drejt fitoreve të reja veprën e madhe të Partisë dhe të popullit. E kundërta është vdekjeprurëse. Imperialistët dhe kampionët e tradhëtisë dhe të shtypjes, të cilëve u është bërë një jetë e dytë shpifja dhe mashtrimi, mendojnë se kritika e drejtë që ne u bëjmë njerëzve që gabojnë dhe çështjeve që nuk shkojnë ashtu si duhet, është «fundi i regjimit tonë popullor». Regjimi popullor nuk i trembet kritikës së drejtë, pse me anën e saj ai zbulon pikërisht ato gjëra që janë konsekuenca direkte të mbeturinave borgjeze dhe mikroborgjeze në dëm të interesave të masave të gjera punonjëse, zbulon pikërisht punën armiqësore që imperialistët dhe shërbëtorët e tyre ndër marrin kundër interesave jetike të popullit. Autokritika jonë bolshevike nuk e rrokullis njeriun në greminë, por e gjallëron, e spastron, e bën të vlefshëm për shoqërinë. Kapitalistët dhe qojlet e tyre jo vetëm që nuk mund ta kuptojnë forcën gjallëruese të kritikës dhe të autokritikës sonë, por për ata dhe regjimin e tyre, ajo është vdekjeprurëse, pse sikur ata të guxojnë ta përdorin qoftë edhe një grimë këtë armë, regjimi i tyre i grabitjes, i shtypjes dhe i shfrytëzimit rrokulliset në greminë. A kanë interes armiqtë e popullit që t'u zbulohen kalbësirat, të spastrohen ferrat që u ngjiten disa njerëzve nëpër këmbë? Jo, në asnjë mënyrë. Ata dëshirojnë të mbushet ara me gjemba që të mos mbijë gru-

ri, kurse ne dëshirojmë të kundërtën, të mbijë gruri dhe të spastrohen ferrat. Ata dëshirojnë që njerëzit të prishen për t'i bërë më mirë masha të tyre, t'i përdorin kundër popullit, t'i shtrydhin si limoni dhe pastaj t'i flakin. Kurse ne duhet dhe përpiqemi që t'i shërojmë njerëzit që janë për të shëruar, t'i bëjmë të vlefshëm për popullin. Prandaj armën e mprehtë të kritikës dhe të autokritikës që na ka vënë në duart tona Partia jonë, bashkimet profesionale duhet të jenë nga të parët që ta përdorin si duhet, pse në të milton i zoti i kësaj arme të fuqishme, klasa heroike punëtore.

Komiteti Qendror i Partisë e ka çmuar vazhdimisht rolin e madh të bashkimeve profesionale si organizata luftarake e klasës punëtore në veprën e ndërtimit të socializmit. Lufta e Partisë, e qeverisë dhe e popullit synon në zhvillimin dhe forcimin e industrisë, në zhvillimin dhe forcimin e bujqësisë, në ngritjen në një nivel më të lartë të kushteve të jetesës së masave punonjëse, duke shtuar prodhimet industriale dhe bujqësore për konsumin e gjerë, duke ulur koston e prodhimit, duke shfrytëzuar vazhdimisht rezervat e mëdha të brendshme. Komiteti Qendror i Partisë dhe qeveria shprehin bindjen e plotë se klasa jonë punëtore dhe gjithë punonjësit e vendit do t'i shtojnë akoma më shumë përpjekjet në punë, do ta forcojnë akoma më shumë organizimin dhe disiplinën për të përmbushur me sukses dhe para afatit detyrat e rëndësishme që u ngarkon viti i fundit i planit të parë pesëvjeçar. Jeta e popullit tonë pati përmirësime të dukshme vitin që kaloi. Të bëjmë që vitin e sivjetëm ta shtojmë akoma më shumë bollëkun dhe të forcojmë akoma më shumë

bazat ku do të mbështetet plani i dytë pesëvjeçar, që Partia dhe qeveria janë duke e përgatitur.

Lenini dhe Stalini na mësojnë se rritja e rendimentit në punë është kushti vendimtar i fitores së rendit socialist. Kjo duhet të bëhet jetë për çdo punonjës, për çdo repart, për çdo ndërmarrje, për të gjithë udhëheqësit e shtetit e të organizatave shoqërore dhe ekonomike. Që t'ja arrijmë si duhet kësaj gjëje, duhet që bashkimet profesionale të ndihmuara pa pushim dhe në mënyrë të ndërgjegjshme nga organizmat shtetërore, të zhvillojnë pa u lodhur emulacionin socialist, të organizojnë garat socialiste. Bashkimet profesionale duhet të kuptojnë se zhvillimi i garave socialiste nuk pajtohet me formalizmin dhe burokracinë, gjë që vërtetohet shpesh në bashkimet profesionale. Emulacioni socialist si një lëvizje krijuese e masave punonjëse nxjerr vazhdimisht metoda të reja në prodhim, nxjerr zbatues të talentuar të metodave të përparuara sovjetike dhe të punëtorëve tanë, nxjerr vazhdimisht shpikës, novatorë, racionalizatorë që janë mburrja e klasës punëtore dhe e gjithë popullit shqiptar. Të përkrahen me të gjitha forcat këta njerëz të shquar të atdheut tonë siç janë, Petro Olldashi, Budo Isufi e qindra të tjerë, të ndihmohen fuqimisht në kërkimet dhe zbatimin e metodave të reja, të përhapet eksperiencia e tyre kudo, të inkurajohen nga ana morale dhe materiale. Kjo është një nga detyrat më të rëndësishme jo vetëm të bashkimeve profesionale, por edhe të organeve ekonomike e të organizatave të Partisë.

Partia dhe qeveria i bëjnë thirrje klasës punëtore dhe të gjithë punonjësve që të mobilizojnë të gjitha

forcat për shfrytëzimin e të gjitha mundësive të brendshme, të ekonomizojnë, asgjë të mos shkojë dëm, të luftohet me këmbëngulje të madhe për uljen e kostos, për përmirësimin e cilësisë, për realizimin e planit në kohën e duhur dhe në të gjitha asortimentet e caktuara. Këto janë probleme kapitale të ekonomisë sonë dhe që sigurisht do ta preokupojnë seriozisht kongresin dhe të gjithë punonjësit e vendit tonë. Nga zbatimi i përpiktë i këtyre detyrave të rëndësishme të planit të prodhimit, varet mirëqenja dhe plotësimi në mënyrë të kulturuar e me çmime të ulëta i nevojave të përditshme të punonjësve.

Komiteti Qendror i Partisë e konsideron si një detyrë të dorës së parë kujdesin e madh dhe të përditshëm për ngritjen e nivelit material dhe kultural të punonjësve të vendit tonë. Në saxe të këtij kujdesi jeta e masave punonjëse të vendit tonë as që mund të krahasohet me të kaluarën. Ajo po përmirësohet nga viti në vit. Bashkimet profesionale duhet të tregojnë më shumë kujdes, inisiativë dhe këmbëngulje në përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të punës dhe të jetës së punëtorëve dhe nëpunësve sidomos në drejtim të përmirësimit të furnizimit me sende ushqimore dhe veshmbathje, në drejtim të realizimit të planit të ndërimit të banesave, të përmirësimit të shërbimit në mensat, klubet, spitalet, në shtëpitë e pushimit të punëtorëve dhe të pionierëve. Bashkimet profesionale duhet ta shtojnë kujdesin për mbrojtjen e punëtorëve në punë, të ndërhyjnë në mënyrë aktive për zhdukjen e aksidenteve dhe për masat profilaktike kundër sëmundjeve. Kujdes duhet të tregohet për punëtorët nëna, duke

rritur numrin e çerdheve, të kopshteve etj. dhe duke i mbajtur mirë këto.

Bashkimet profesionale duhet të bëjnë një luftë të vendosur kundër çdo shfaqje indiferentizmi dhe pakujdesie nga ana e organeve ekonomike shtetërore ndaj kërkesave dhe nevojave të drejta të punonjësve. Ato duhet të luftojnë që të përmirësohet në mënyrë të gjithanshme puna e aparatit ekonomik shtetëror, të ndërhyjnë në mënyrë aktive për të zgjidhur konfliktet midis punëtorëve dhe administratave të ndërmarrjeve që lindin ngandonjëherë si rezultat i zellit të tepruar administrativ, i shtrembërimeve burokratike dhe i neglizhencave nga ana e disa drejtuesve të ekonomisë popullore.

Edukimi politiko-kultural dhe tekniko-profesional i punëtorëve, përhapja sa më e gjerë në masat e njohurive shkencore, janë detyra nga më të rëndësishmet të bashkimeve profesionale. Këto duhet të edukojnë punonjësit me frymën e besnikërisë ndaj atdheut, Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës sonë Popullore, ndaj Bashkimit të madh Sovjetik dhe kampit të socializmit. Bashkimet profesionale duhet ta shtojnë gjithnjë e më tepër solidaritetin e klasës sonë punëtore me luftën që zhvillon klasa punëtore e vendeve kapitaliste, koloniale dhe gjysmë koloniale për të drejtat e saja, për paqe, liri, demokraci dhe socializëm.

Bashkimet profesionale duhet të përpiqen për ngritjen e vazhdueshme të nivelit tekniko-profesional të punëtorëve, të ngrenë vazhdimisht aftësitë e tyre në shfrytëzimin e maqinerive, të zhdukin sa më parë disproporcionin që ekziston ndërmjet maqinerisë moderne

dhe nivelit teknik akoma të prapambetur të punëtorëve tanë. Bashkimet profesionale duhet ta shtojnë kujdesin për frekuentimin e shkollave të natës, për zhdukjen e plotë të analfabetizmit në radhët e punëtorëve dhe për shfrytëzimin e plotë të klubeve, bibliotekave, kinemave, fushave të sportit, palestrave etj. Në këtë mënyrë, bashkimet profesionale të edukojnë një klasë punëtore të shkathët, të guximshme, të mësuar, të aftë për rritjen e prodhimit dhe për mbrojtjen e atdheut.

Mbrojtja e atdheut nga çdo rrezik duhet të jetë detyra kryesore e çdo qytetari. Sukseset e mëdha që ne kemi arritur në forcimin e Republikës sonë popullore, në forcimin e ekonomisë, të arësimit e të kulturës dhe në forcimin e aftësisë mbrojtëse të atdheut natyrisht nuk shikohen me sy të mirë nga ata që nuk ja duan të mirën popullit tonë. Dhe ata tërbohen, shpifin, kërcënojnë. Por ata nuk janë në gjendje të gjejnë se kërcënimet e tyre s'bëjnë efekt në popullin tonë, që është i regjur dhe i ka nervat të forta dhe s'tutet kollaj. Republika jonë popullore, që është ngritur me gjakun dhe djersën e popullit, po lufton me të gjitha forcat e veta për paqen, për demokracinë, për socializmin. Për këtë arsye ajo është e fortë dhe e patundur në rrugën e saj të drejtë. Republika jonë popullore lindi në saje të luftës së popullit tonë heroik të udhëhequr nga Partia e tij e lavdishme si edhe në saje të heroizmeve të Ushtrisë legjendare Sovjetike që çliroi botën nga fashizmi. Ajo u forcua dhe lulëzoi në saje të punës vetëmohuese të popullit tonë, të udhëheqjes së drejtë të Partisë së tij, si edhe në saje të ndihmës së Bashkimit Sovjetik, të Kinës së madhe dhe të ven-

deve të tjera të demokracisë popullore. Sot duhet të jetë fare e qartë për imperialistët amerikano-anglezë dhe për qarqet luftënxitëse të këtyre vendeve se Shqipëria e vogël nuk ka qenë dhe nuk do të jetë kurrë e vetmuar siç llomotitin ata ose siç ua do zemra atyre. Natyrisht në këto momente, kur luftënxitësit, imperialistët amerikanë dhe përkrahësit e tyre, po përdorin të gjitha mjetet për të nxitur histerinë e luftës, për të përgatitur një luftë të re botërore, populli ynë, i gjithë kampi i paqes dhe i socializmit duhet t'i bëjë sytë katër, të jetë vigjilent dhe të dhjetëfishojë përpjekjet për të bërë që të dështojnë planet e luftënxitësve imperialistë. Prandaj vigjilenca revolucionare kudo, nga të gjithë patriotët e vendit duhet të jetë në rendin e ditës. Të goditen pa mëshirë armiqtë, nën çfarëdo maske që ata do të përpiqen të fshihen dhe të veprojnë. Duhet t'u bëhet një luftë e pamëshirshme vjedhësve dhe dëm-tuesve të pasurisë së përbashkët, të kapen dhe të demaskohen ata pa mëshirë dhe t'i jepen drejtësisë së popullit. Të evitohen dhe të korrigjohen sa më parë të metat në punë dhe në njerëzit, të shpëtohen njerëzit sa më shumë që të jetë e mundur nga laqet dhe gënjeshttrat e armiqtve. Të mobilizohemi tërësisht për realizimin e planeve tona në çdo sektor, pse kjo do të thotë të forcojmë akoma më shumë atdheun tonë dhe aftësinë e tij mbrojtëse. Të demaskohen në popull, me të gjitha mjetet, qëllimet e agresorëve dhe veprat kriminale të imperialistëve amerikanë dhe të shërbëtorëve të tyre. Çështja e ndalimit absolut të armëve atomike dhe me hidrogjen të bëhet një çështje e madhe e popullit tonë ashtu siç është për të gjithë njerëzimin. Po-

pulli ynë përkrah me të gjitha forcat e tija politikën paqësore të qeverisë sovjetike, politikë që synon në mbrojtjen e paqes. Politika paqësore e Bashkimit Sovjetik është kundër luftës dhe kundër formimit të blloqeve agresive që imperialistët amerikano-anglezë dhe shërbëtorët e tyre kanë krijuar dhe po krijojnë. Shteti ynë dhe populli shqiptar si pjesëmarrës i Konferencës së Moskës që u mbajt me 29 nëntor 1954, është solidar me vendimet historike për krijimin e një pakti të sigurimit kolektiv evropian, dhe kundër Traktateve të Parisit dhe të Londrës që synojnë të riarmatosin Gjermaninë revanshiste të Bonit për t'i vënë përsëri zjarrin Evropës. Shoku Molotov më 8 shkurt në Sovjetin Suprem deklaroi se *«të tetë shtetet që morën pjesë në Konferencën e Moskës deklaruan në mënyrë të qartë se në qoftë se ratifikohen marrëveshjet e Parisit, ata do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të forcuar pozitat e tyre ndërkombëtare dhe për të garantuar paqen dhe sigurimin evropian... E para midis masave të këtyra është përgatitja për të përfunduar një Traktat të miqësisë, bashkëpunimit dhe ndihmës reciproke midis të tetë vendeve që morën pjesë në Konferencën e Moskës»*.

Politika paqësore e kampit të socializmit është përqaftuar nga të gjithë njerëzit e thjeshtë dhe përparimtarë të botës, të cilët kudo luftojnë në mënyrë aktive dhe të paepur për të bërë që të dështojnë planet agresive të luftënxitësve. Kauza jonë e drejtë kurdoherë do të fitojë. Për popullin tonë lufta për mbrojtjen e paqes, për forcimin e Republikës sonë popullore, për forcimin e ekonomisë dhe të aftësisë mbrojtëse të atdheut duhet

të jetë kurdoherë në rendin e ditës, në shpirtin e çdo qytetari patriot dhe në çdo punë, në çdo hap që ai hedh përpara, këto çështje jetike të popullit dhe të atdheut ai duhet t'i ketë vazhdimisht parasysh.

Pozitat e brendshme dhe ndërkombëtare të vendit tonë janë më të forta se kurrë ndonjëherë tjetër. Arësytet vendimtare të kësaj situatë të fortë të vendit tonë janë lidhjet prej gjaku në mes të Partisë sonë heroike dhe popullit shqiptar, janë lidhjet e shëndosha në mes të pushtetit popullor e popullit, është udhëheqja e drejtë dhe tejpamëse e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe e Komitetit Qendror të saj, që udhëheqin në mënyrë të urtë dhe të guximshme popullin tonë drejt rrugës së socializmit. Arësyeja vendimtare e këtyre sukseseve qëndron në unitetin e çelniktë të Partisë së Punës të Shqipërisë, të forcës monolite të Komitetit Qendror të saj, të heroizmit dhe të pjekurisë së anëtarëve të Partisë, bij nga më besnikë të popullit. Arësyeja vendimtare është se populli ynë i do me gjithë shpirt dhe është lidhur për jetë me popujt vëllezër të Bashkimit Sovjetik, të Kinës së madhe të Mao Ce Dunit dhe të vendeve të demokracisë sonë popullore. Populli ynë trim dhe guximtar, i udhëhequr nga Partia e tij dhe i rrethuar me një dashuri kaq të zjarrtë nga miqtë dhe shokët e tij të mëdhenj do të rrojë në shekuj dhe do të lulëzojë.

Komiteti Qendror i Partisë ka besim të patundur se Bashkimet Profesionale të Shqipërisë do ta mbajnë kurdoherë lart flamurin e internacionalizmit proletar, do të forcojnë kurdoherë e më shumë radhët e tyre rreth Partisë dhe Komitetit Qendror të saj, do të kryej-

në me nder detyrat e tyre të rëndësishme dhe do të luftojnë si kurdoherë me heroizëm për përparimin e mëtejshëm të atdheut dhe për mbrojtjen e paqes në botë.

Rroftë klasa heroike punëtore e vendit tonë!

Rrofshin Bashkimet Profesionale të Shqipërisë!

Rroftë Kongresi i katërt i Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë!

Rroftë Partia heroike e Punës e Shqipërisë, frymëzuesja dhe realizuesja e të gjitha fitoreve të vendit tonë!

Rroftë dhe u forcoftë Republika jonë popullore!

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 36 (1989), 12 shkurt 1955*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

KOMUNISTËT NË BAZË DUHET TË LUFTOJNË MË SHUMË PËR T'I ZGJIDHUR VETË PROBLEMET

Nga biseda në takim in me zëvendëssekretarin e organizatës bazë të Partisë dhe kryetarin e komitetit profesional të NBSH-së «Irakli Terova» Korçë

15 shkurt 1955

Zëvendëssekretari i organizatës bazë të Partisë dhe kryetari i komitetit profesional të NBSH-së «Irakli Terova» kishte ardhur te shoku Enver për çështjen e një toke prej 20 ha, që ferma e kishte shkëmbyer me kooperativën bujqësore të Vinçanit për ta mbjellë vreshtë por meqenëse ajo nuk u shfrytëzua për këtë qëllim, ai kërkoi, për arsye të largësisë, të bëhej rishkëmbimi. Ai ngriti edhe disa çrregullime që kishte vënë re në sektorin e tregëtisë.

Shoku Enver në përgjegje, midis të tjerave, i tha:

Këto probleme ju duhet t'ja kishit ngritur Ministrisë së Bujqësisë, asaj të Tregëtisë dhe Partisë në rreth që ato të ndërhyjnë për t'i zgjidhur. Gjëra të tilla atje mund të ketë shumë, megjithëse për këto çështje ne i kemi dhënë urdhëra e direktiva bazës sa jemi lodhur.

dhe aktive e konferenca partie janë bërë e po bëhen vazhdimisht. Me sa duket atje ka ardhur koha të zhvishet «shpata» e t'i thuhet komitetit të Partisë ç'bën, pse nuk vë rregull në pushtet, në komitetin ekzekutiv? Të kërkohet llogari pse në seksionin e tregëtisë dhe në kooperativat e shitblerjes ka hatëre, që këto gjëra të luftohen me forcë që të mos shtyhen dhe të presin shumë njerëzit në dyqane. Të kërkohet llogari e të thuhet ç'është kjo punë që del një shpallje ku thuhet se pikat e triskave të vitit 1954 nuk shkojnë për vitin 1955 dhe kur shumë njerëz i dogjën ato del një shpallje tjetër ku thuhet se shkojnë? Prandaj të merren masa ndaj atyre që bëjnë gjëra të tilla. Në konferenca të kërkohet që ata të tregëtisë të dalin e të flasin pse ndodhin këto, dhe aty të propozohen masat kundër atij njeriu që ka lejuar këto çrregullime. Dua të them që lufta në bazë të forcohet në radhë të parë nga anëtarët e thjeshtë të Partisë pse populli kur sheh që në ballë janë komunistët, ai lidhet më fort me Partinë. Prandaj të merren masa të rrepta ndaj atyre që nuk punojnë mirë, e në radhë të parë ndaj drejtuesve, pse ka nga ata që nuk i shohin këto gjëra, sepse janë mësuar me to. Lenini ka thënë se në aparatit shtetëror ka burokraci. Ai na mëson se klasa punëtore, në vendet tona ku ndërtohet socializmi, ku ajo ka fuqinë në dorë, nuk bën greva si në vendet kapitaliste, sepse te ne në pushtet janë njerëz të klasës punëtore, fshatarë të varfër e të mesëm, intelektualë përparimtarë me origjinë nga borgjezia e vogël. Natyrisht të gjithë këta sjellin me vete mbeturinat e vjetra, por klasës punëtore i takon t'i luftojë këto mbeturina. Ka dhe nga ata që janë

mësuar të rrojnë me këto mbeturina. Ka disa prej këtyre që u rritet mendja. Ata drejtorë që nuk punojnë mirë, klasa punëtorë dhe anëtarët e Partisë duhet t'i zbulojnë dhe t'i kritikojnë dhe kur ata nuk i ndreqin gabimet ose kur janë futur në llum, janë komprometuar, kanë krijuar miqësi e tarafe të palejueshme dhe bëjnë hatëre për të forcuar pozitat e tyre, atëherë Partia i shkarkon nga detyra që kanë. Këta njerëz që futen në të tilla kallëpe e kuptojnë se nuk janë në rrugë të drejtë, prandaj që të aprovohet veprimtaria e tyre kërkohet të gjejnë mbështetje jo në njerëzit e mirë, po në elementin e dobët si vetja e tyre. Ata grumbullojnë rreth tyre elementë që u krchin bishtin, servilë. Prandaj asnjëherë të mos mendojmë se drejtuesi i shch vetë këto gjëra dhe ta flemë mendjen. Jo, komunisti s'duhet të mendojë kështu. Le të jetë ç'të dojë e kushdo, drejtor apo sekretar partie. Kur punon mirë ne e lavdërojmë dhe e respektojmë, kur punon keq e kritikojmë ose edhe e heqim. Lufta në bazë, pra, nga komunistët ka rëndësi të madhe.

Ju në Korçë keni mjaft suksese në çdo drejtim, për faktin se atje Partia është e fortë. Të marrim p.sh. çështjen e vjedhjeve. Si kudo edhe atje bëhen vjedhje, po ato nuk bëhen në atë gjerësi si në ndonjë qark tjetër. Niveli i fshatrave të Korçës ndryshon si nata me ditën me fshatrat e qarqeve të tjera. Po kjo nuk do të thotë se në Korçë gjithshka shkon mirë, pse edhe atje ka dobësi të tilla si këto që the ti, prandaj kundër atyre të luftojë e gjithë Partia dhe të mos i mbetet kjo punë vetëm sekretarit. P.sh. vjen te ju Maqo Çomo, që është zëvendësministër i bujqësisë, ai jep urdhëra dhe thotë

bëni kështu ose ashtu, por edhe ti si çdo komunist, aq më tepër si zëvendëssekretar i organizatës bazë, ke të drejtë t'i thuash atij: «Unë nuk e gjej të drejtë punën tuaj që vjen në fermë dhe as bisedon as këshillohesh, bile as që merr kontakt me komunistët dhe me organizatën profesionale. Ne këtu punojmë, kemi vështirësi, prandaj ta bëj këtë kritikë që të mbash kontakt edhe me ne». Pastaj mund t'i thuash: «Drejtori ynë për këtë dhe për këtë çështje nuk është në rregull».

Ti i kupton mirë gjërat, vetëm se duhet të luftosh bashkë me gjithë shokët e Partisë atje që t'i vini në vend ato. Atje ku ka gjëra që nuk ecin thirreni drejtorin në organizatën bazë dhe kritikojeni. Në rast se drejtori është në kundërshtim me pikëpamjet tuaja, shkoni menjëherë në komitetin e Partisë, te sekretarët, flisni haptas me ta dhe u kërkoni që të vijnë për ta zgjidhur çështjen në vend, dhe me siguri ata do të vijnë. Ju duhet të shkoni atje, se prandaj e kemi Partinë, po të ndodhë ndryshe i shkruani Komitetit Qendror. Udhëheqja nuk mund të bëjë asnjë minutë pa bazën. Po të mos zgjidhen çështjet mirë në bazë ne do të mbeteshim si një pemë e madhe që i janë tharë rrënjët.

*Botohet për herë të parë sipas
procesverbalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

**VENDIMET E PARTISË DUHET TË UDHËHEQIN ÇDO
DITË DHE ÇDO ORË GJITHË VEPRIMTARINË E
ORGANEVE TË PUNËVE TË BRENDSHME**

*Nga fjala e mbajtur në mbledhjen e kuadrove kryesorë
të Ministrisë së Punëve të Brendshme*

4 mars 1955

Shokë, sigurisht ju e kuptoni rëndësinë e madhe që ka vendimi i Byrosë Politike të Komitetit Qendror¹, i cili është rezultat i analizës që i ka bërë Komiteti Qendror punës së Ministrisë së Punëve të Brendshme. Si e dëgjuat edhe vetë, Partia e vlerëson drejt punën tuaj. Unë nuk do të futem në të gjitha çështjet që përmban vendimi, pasi ju, me diskutimet që zhvilluat, i trajtuat këto me hollësi duke vënë mirë në dukje si sukseset, ashtu dhe të metat që ekzistojnë në punën e këtij dikasteri dhe të organeve të tij vartëse.

Në veprimtarinë e organeve të punëve të brendshme ka pasur suksese të rëndësishme në të gjitha drej-

¹ Është fjala për vendimin e Byrosë Politike «Mbi gjendjen e brendshme të RPSH dhe mbi veprimtarinë e organeve dhe reparteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme» (2 shkurt 1955).

timet dhe veçanërisht në drejtim të luftës kundër bandave të diversantëve dhe të spiunëve që imperializmi i huaj dhe satelitët e tij kanë hedhur në vendin tonë, për të sabotuar ndërtimin e bazave të socializmit në Republikën Popullore të Shqipërisë. Në këtë drejtim sukseset kanë qenë të mëdha. Kjo punë është drejtuar nga Ministria juaj me besnikëri dhe vigjilencë, për të ka punuar me këmbëngulje Partia, që ju, kuadrot e Ministrisë së Punëve të Brendshme, të jeni në gjendje të orientoheni në çdo situatë, të zbatoni si duhet direktivat e Partisë e të qeverisë. Gjithashtu suksese ka pasur edhe në luftën kundër grupeve ose individëve, qoftë në sektorin ekonomik, qoftë në luftën e tyre politike kundër Partisë dhe pushtetit popullor. Me gjithë të metat që kanë ekzistuar në mbrojtjen e ekonomisë socialiste, prapë se prapë ka pasur suksese. Nuk mund të thuhet që puna e organeve të punëve të brendshme ka qenë e paktë, pse ato kanë luftuar edhe në këtë drejtim, por mund të kishin rezultate akoma më të mëdha. Gjithashtu suksese të rëndësishme kemi pasur në punën e njerëzve tanë që mbrojnë dhe ruajnë kufitë e atdheut.

Por me gjithë këto suksese, Komiteti Qendror vë re se në punën tuaj ka edhe gabime e të meta, të cilat, ju, jo vetëm i pranuat, por edhe i ilustruat me shembuj konkretë, gjë që tregon se sa të drejta janë konkluzionet e Komitetit Qendror.

Ju e dini, shokë, se sa rëndësi të madhe kanë vendimet e Komitetit Qendror. Nuk mund të themi se puna e tyre mbaron me një të lexuar. Këto vendime duhet t'ju udhëheqin çdo ditë dhe çdo orë në veprimtarinë tuaj. Gjithë punën tuaj ju duhet ta mbështetni

në direktivat e Komitetit Qendror, po nuk u mbështetët në këto direktiva, patjetër puna juaj do të çalojë dhe do të lejohen gabime në vijë, në parim dhe veçanërisht në praktikë. Për këtë flasin të gjitha vendimet e Partisë për sektorin tuaj, që analizojnë punën vjetore të organeve të punëve të brendshme. Këto direktiva duhet të jenë të pandara nga ju, pse puna e sektorit tuaj drejtohet e ndihmohet nga afër nga udhëheqja e Partisë, sepse puna juaj është sa e rëndësishme aq dhe delikate. Në rast se në punën tuaj kontrolli dhe ndihma e Partisë nuk janë të plota, atëherë mund të shkaktohen rreziqe dhe dëme në çështjen e ndërtimit të socializmit.

Komiteti Qendror konstaton se me punimin e vendimit [2 shkurt 1955] ne kemi pasur suksese në forcimin e Partisë dhe të punës në organet e punëve të brendshme, në edukimin e kuadrove me frymën e shëndoshë të Partisë, në zhdukjen e një sërë të metash që ishin dukur në punë e sipër. Por megjithatë, siç doli edhe këtu, në veprimtarinë e organeve të punëve të brendshme disa të meta akoma nuk janë zhdukur. Ekzistojnë të meta, të cilat, sikurse na mëson Partia, rrjedhin nga disa mbeturina mikroborgjeze në ndërgjegjen e njerëzve. Këto të meta ekzistojnë dhe të mos rrojmë me iluzione. Në rast se mendojmë që këto të meta mund të zhduken me fshesë, gabojmë.

Partia na mëson se njerëzit e Ministrisë së Punëve të Brendshme duhet të jenë nga njerëzit më të mirë, besnikë të Partisë, kjo është e domosdoshme, por ata duhet të jenë nga më të mirët edhe nga ana e ngritjes ideologjike dhe politike, pse në rast se janë të tillë forcohet besnikëria e tyre dhe rritet ndërgjegjja patriotike,

në këta njerëz kuptohen më mirë detyrat, orientohen më drejt në çdo situatë, kanë inisiativë më shumë dhe gabojnë më pak. Pra, Partia kërkon nga ju më shumë se nga çdo anëtar tjetër partie që të ecni me hapa të sigurtë. Duhet me u forcue ideologjikisht, dhe konstati-mi i Komitetit Qendror është se në këtë drejtim nuk bëhen përpjekje të mjaftueshme. Duhet pra që kësaj çështjeje t'i vini rëndësi. Çështja e edukimit duhet të bëhet si çështja e bukës që ha në drekë dhe në darkë. Sa mund të rrini pa bukë, aq mund të rrini edhe pa kulturë, pa marksizëm-leninizmin. Prandaj të ndiqni shkollat dhe kurset e sigurimit.

Komiteti Qendror ka besim se detyrën, për të ngritur kurdoherë nivelin tuaj ideologjik dhe kultural, ju do ta kuptoni më thellë. Në këtë mënyrë do të shtohen edhe aftësitë tuaja për të luftuar më tepër të metat që ekzistojnë në ndërgjegjen e njerëzve. Për edukimin dhe mbarëvajtjen e kuadrove në shkollë qendra duhet ta ndihmojë më shumë bazën. Edhe për shkollën e sigurimit nuk po shoh interesimin që duhet. Ne kemi një rregull që atje ku ka shumë anëtarë partie duhet të ketë komitet partie, kurse në këtë shkollë s'ka as komitet partie as degë. Pra, dhe lidhjet e komitetit të Partisë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme me këtë shkollë janë fare të pakta. Nuk ka ardhur njeri në Komitetin Qendror e të thotë që «kjo shkollë është e ngarkuar shumë, që këtu ka njerëz me nivel mjaft të ulët arësivor dhe lëndët që zhvillohen nuk përve-tësohen si duhet».

Përveç luftës për ngritjen ideologjike, rëndësi të jashtzakonshme duhet t'i vini jetës në organizatën bazë,

sepse ajo është shkolla ku ju duhet të edukoheni. Kritika dhe autokritika nuk është në lartësinë e duhur dhe e rreptë, kritika i vë njerëzit përpara përgjegjësisë kur gabojnë. Ju e patë se si njerëzit janë përmirësuar, kanë hyrë në rrugën e korrigjimit, pse organizata bazë është si ajo vareja që hekurin e punon dhe e zbukuron. Organizata bazë duhet bërë luftarake, veçanërisht te ju në Ministrinë e Punëve të Brendshme, pse në rast se një njeri në një sektor tjetër shkakton njëzet për qind dëm, në sektorin tuaj shkakton dëm jashtëzakonisht të madh. Unë them edhe një gjë tjetër, që për çdo punëtor të sigurimit Partia të bëhet vendi më i dashur, së cilës t'i hapim zemrën. Pse e them këtë? E them jo se Partia nuk është për ju vendi më i dashur, por sepse ka dhe ndonjë që, megjithëse mund të ndodhet përpara ndonjë problemi të vështirë, nuk këshillohet me Partinë. Ju keni dëgjuar për një të tillë që kohët e fundit vrau veten, pse e akuzonin se kishte vjedhur, kurse në fakt ai nuk kishte vjedhur asgjë. Por në vend që ky njeri të vejë te komisari ose te sekretari i organizatës bazë bile deri në Komitetin Qendror e t'u thotë që «nuk kam vjedhur, jam në pozitë shumë të vështirë, ndihmomëni», i shkruan letër Partisë dhe komandës për besnikërinë e tij ndaj tyre dhe vret veten! Pse ndodh kjo? Shpjegohet fare thjeshtë. Kjo ndodh për shkak se ai që ka një problem jetik, akuzohet kot, nuk shkon në Parti ku të gjejë të drejtën, po ja heq vetes. Por, pse ndonjeri atë që ka s'ja thotë Partisë? Sepse kur bëhen kritikant në organizatën bazë, ka raste që çështjet nuk shikohen ashtu si duhet, drejt, nuk krijohet një atmosferë e ngrohtë, që ai ta konsiderojë

veten në Parti si në shtëpinë e tij, por bëhet një punë e shpejtuar, e përciptë, zyrtare. Te ne nuk duhet të ngjasin gjëra të tilla, prandaj të forcohet Partia dhe, kur them Partia do të thotë të forcohen organizatat bazë, komunistët.

Por organizata bazë forcohet, kur të forcojmë gjithnjë e më tepër si disiplinën e Partisë edhe të shtetit. Këtu u theksuan disa raste që tregojnë se disiplina nuk është në atë nivel që kërkohet. A mund të lejohet kjo, shokë, në organet e punëve të brendshme? Në asnjë mënyrë. Përkundrazi, në organet e punëve të brendshme disiplina është e domosdoshme të jetë e hekurt. Duhet kuptuar mirë se kush thyen disiplinën e Partisë ai nuk ka zbatuar si duhet vijën e saj. Prandaj, t'i ndreqim dobësitë në këtë drejtim dhe disiplinën e Partisë e të shtetit ta forcojmë nga dita në ditë jo vetëm në organet e punëve të brendshme, por në të gjithë sektorët e tjerë. Këtë e kërkon ndërtimi i socializmit, këtë e kërkojnë interesat e popullit. Sa më e fortë të jetë disiplina jonë, aq më vështirë e ka armiku të na dëmtojë.

Një nga preokupacionet më të mëdha që duhet të kenë organet e punëve të brendshme është çështja e ruajtjes së sekretit. Komiteti Qendror i Partisë ka dhënë udhëzime të qarta në këtë drejtim dhe organet e punëve të brendshme duhet të tregohen shembull për të gjithë. Partia na mëson që t'i ruajmë mirë dokumentat, ta mbyllim gojën për çështjet sekrete, pse ka raste që nuk tregohet kujdesi i duhur. Një nga arësyet për këtë është se në disa shokë ekziston familjariteti, i cili, përveç të tjerave, i bën ata që t'i bisedojnë çështjet sekrete me njëri-tjetrin dhe të dekonspirojnë. Ja, pra, se edhe

kjo e ka burimin te mbeturinat e vjetra që ekzistojnë në ndërgjegjen e njerëzve. Ai që ka dokumenta sekrete të thotë: «Më jep kasafortë», «dua çelës të sigurtë». Po të insistohet gjendet çdo gjë, edhe kasafortat, edhe çelësat. Prandaj herë pas here të bëhet kontroll dhe të shikohet se kush tregon kujdes e kush i nënvleftëson këto çështje të rëndësishme. Shokët duhet të jenë jash-tëzakonisht rigorozë në ruajtjen e sekretit të shtetit.

Meqenëse ra fjala për familjaritetin dua të them dy fjalë. Shokët do të ndreqen, po t'u thuhet të katër të vërtetat në sy. Unë di, për shembull, se si një komisar, nuk ja ka vënë në dukje gabimet shokut të tij më të afërt, komandantit, i cili, edhe pse nuk është anëtar partie, duhej kritikuar për të metat me qëllim që të ndihmohej. Partia këllij shoku i ka dhënë një besim të madh duke e bërë komandant, ai është trim, por me guxim duhet të luftojë jo vetëm kundër armiqve, por edhe kundër të metave që ka ai vetë. Po të shikojë se ku i ka të metat e tij, do të konstatojë edhe disa shfaqje mendjemadhësie që e pengojnë të ecë përpara e të futet edhe në Parti. Këtej unë mund të nxjerr konkluzionin që komisari ka familjaritet me komandantin dhe nuk e mban si duhet afër për ta ndihmuar.

Shfaqje të familjaritetit janë dukur edhe në shokë të tjerë. Por familjariteti është i dëmshëm kudo, në çdo sektor, sidomos për njerëzit e sigurimit dhe gjithë efektivin e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Këtu u bënë kritika dhe autokritika kundër disa rasteve të familjaritetit. Natyrisht është fjala kundër familjaritetit të sëmurë, kur i mbulojmë gabimet njëri-tjetrit dhe dëmtojmë si punën, ashtu dhe ata që gabojnë, të cilëve

nuk u themi të metat në kohë, por i lëmë ato të trashen. Por kjo nuk duhet të na çojë në ekstrem që të mos shoqërohemi me njëri-tjetrin se mos thonë që «këta kanë familjaritet». Mos e ngatërmoni dashurinë e shokut me detyrën, në detyrë duhet me qenë rigoroz, prandaj kërkoni llogari, kështu forconi dashurinë dhe miqësinë. Në qoftë se kjo çështje nuk shikohet kështu, atëhere nuk është parë në mënyrë komuniste.

Një gjë tjetër që u konstatua këtu, është që shokët e bazës ankohen për shokët e qendrës se nuk i ndihmojnë, prandaj këta duhet ta ndryshojnë metodën e punës, të venë poshtë e të japin ndihmën e tyre. Kjo e metë nuk është vetëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme, por në të gjitha dikasteret, prandaj të luftohet burokratizmi. Mund të thuhet që Ministria e Punëve të Brendshme ka shumë kartëra nga të cilat mund të evitohet një pjesë e madhe. Shokët e bazës duhet të interesohen edhe vetë, por shokët e qendrës të mos mjaftohen vetëm me një ose dy fjalë. Këta duhet t'i ndihmoni dhe t'i edukoni që të japin rezultatet që kërkohen. Duhet të shikoni që të mos ketë rutinë në punë.

Komiteti Qendror dhe Byroja Politike shtrojnë detyrën që organet e Sigurimit të Shtetit të përmirësojnë gjithnjë e më shumë punën edhe në drejtim të luftës kundër armikut, për të nuhatur, sipas momentit se ku ai paraqitet më i rrezikshëm. Tentativat e diversantëve i kemi likuiduar, armiku pa se humbi shumë, prandaj ndërroi rrugë. Ai po e intensifikon luftën e tij në sektorin ekonomik dhe këtu sigurimi nuk ka qenë si duhet vigjilent. Kjo nuk duhet kuptuar që armiku hoqi dorë nga hedhja dhe futja e diversantëve, por tani e ka nga-

dalësuar. Ai ul këtë, por intensifikon propagandën. Ne duhet t'i kundërvihemi kësaj propagande të armikut dhe të mos nënvleftësojmë punën politike të Partisë, bisedat në familje, në zyrë, konferencat në qendra pune, në fshat etj. Armiku e bën punën e vet: ai hedh, për shembull, fletushka. Dikush mund të thotë se «ne i kemi mbledhur të gjitha këto fletushka» nëpër fshatra, por puna është se ka ndonjë që i lexon dhe mund të lëkundet. Këto gjëra nuk duhen nënvleftësuar, ju jeni njerëz partie, njerëz të sigurimit. Armiku thotë «mos flisni haptas, hidhni gurin e fshihni dorën, kujdes nga njerëzit e sigurimit». Pra Partia nuk duhet ta nënvleftësojë propagandën e armikut, por ta vlerësojë drejt dhe të dijë ta ndërtojë punën e vet.

Është e vërtetë se tani nga ana e armikut nuk kemi një punë të hapur, të organizuar me komitete, por ka sabotatorë në ekonomi, që dëshirojnë dhe nxitin të futen sa më shumë njerëz në burg e kështu të përhapet pakënaqësia. Prandaj në këtë drejtim Sigurimi i Shtetit dhe policia duhet ta forcojnë luftën kundër vjedhësve dhe shpërdoruesve, por siç thashë, pa harruar drejtimet e tjera. Duhet që Ministria e Punëve të Brendshme të marrë masa aktive që lufta kundër sabotatorëve në ekonomi të bëhet e ashpër. Detyra jonë është që ta forcojmë vazhdimisht vigjilencën revolucionare, t'i bëjmë sytë katër. Të ecim përpara me guxim, por me vigjilencë, vigjilencë, vigjilencë. Nuk duhet të ecim si kali i arabasë.

Spektori i policisë duhet të vlerësohet më shumë nga organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Me sa duket ky sektor duhet ndihmuar më tepër. Doemos këtu ka rëndësi të madhe vetë puna e Partisë në terren,

por edhe nga Ministria e Punëve të Brendshme, nga udhëheqja dhe nga drejtoritë e punëve të brendshme duhet që policisë t'i kushtohet kujdes më i madh. Unë pashë këtu vetëm dy shokë që janë veshur me uniformën e policisë. Kjo nuk është e mirë. Populli kërkon t'ju shohë me uniformën që ju ka dhënë.

Një çështje tjetër që ka rëndësi të madhe është çështja e shëndetit tuaj. Nga të dhënat që ka Komiteti Qendror, në radhët tuaja ka mjaft njerëz që janë me shëndet jo të mirë, pse janë të gjithë njerëz që kanë qenë në luftë. Vështirësitë e pasluftës dhe sidomos de-tyra juaj, funksioni juaj, bën që sistemi nervor të lodhet dhe jeni më të predispozuar të sëmureni. Disa masa janë marrë tani, por Komiteti Qendror mendon se këto nuk janë të mjafta. Shokët thanë edhe për ndërtesat që nuk janë të mjafta. Plani i ndërtimit nuk vete mirë. Nuk është se nuk janë interesuar shokët drejtues, por duhet me u interesue në mënyrë më këmbëngulëse. Janë disa kuadro që duhet t'u sigurohet më parë banesa, sepse puna e tyre nuk pret, pse bëjnë një punë të rëndë me nerva, për këta duhet kujdesur më parë, pastaj edhe për të tjerët.

Partia kërkon nga ju që të tregoni kujdes të veçantë për veten tuaj. Gjëja e parë është të bëni gjimnastikë, kulturë fizike. Për shëndetin tuaj kjo është kryesorja e shumë e rëndësishme dhe nuk është për të qeshur. Në Kinë ka një rregull të tillë të përgjithshëm që, në orën dymbëdhjetë, për shembull, duhet të lesh çdo gjë e të bësh gjimnastikë. Këtë gjë ne nuk po e bëjmë, por në radhë të parë duhet ta bëni ju. Të keni parasysht që kur veni në mëngjez në zyrë, ta keni kokën të freskët, sepse

keni të bëni me njerëz dhe jo me maqina. Ju keni të bëni me lloj-lloj njerëzish. Nuk mund të lejohet që njeriu i sigurimit të bëhet nervoz. Prandaj çështjen e shëndetit dhe gjimnastikën duhet ta keni kurdoherë në kujdes. Të vini rregull për të fjetur. Këto mund t'ju duken pa rëndësi, por nuk është ashtu. Gjumin duhet ta bëni në rregull, kjo nuk do të thotë që, kur kini punë, ta lini atë, por jo të rrini edhe kot. Kur të keni mbaruar punën duhet të shkoni me fjetë. Pastaj është çështja e ushqimit. Gratë tuaja janë të mira, por i ndihmoni të gatujnë mirë e pastër, gjellë më të ushqyeshme e të shijshme e, kur të shkoni në shtëpi, të gjeni një ambient të gëzuar, të pastër e të ngrohtë. Në këtë drejtim, në çështjen e edukimit të grave ne kemi faj. Ty 'Partia të futi në punë, të çoi në shkollë, të edukoi, kurse ajo, për arsye të prapambetjes ose të fanatizmit ka mbetur në vend dhe kjo nuk është për fajin e saj. Ti shkon në kinema me shokë kurse atë e lë në shtëpi. Duhet të interesoheni shumë për ato.

Edhe një çështje tjetër: mbi lidhjet me masat e popullit. Forcat e sigurimit janë të dashura me popullin. Ne kemi suksese në këtë drejtim por nuk do të thotë që nuk ka të meta. Përsëris që forca e sigurimit qëndron në lidhjet e tija me masat dhe këtu ka me qindra njerëz të sigurimit e të policisë, që janë lidhur si mishi me koskën me popullin. Kur flasim për lidhjet me popullin kemi parasysh se ju jeni njerëz të Partisë, jeni njerëz politikë, dhe jo vetëm specialistë në një degë. Si njerëz partie, ju duhet të jeni edhe aktivistë shoqërorë, për shembull, të ndihmoni organizatën e Frontit, pse këtu ka shumë sektarizëm. Fronti ka rëndësi të madhe,

ashtu sikurse edhe në Luftën nacional-çlirimtare. Ne na intereson që të kemi sa më pak kundërshtarë, që armiku të ketë sa më pak ushtarë. Sot ngjasin gjëra të tilla, që disa mësuesve, të cilëve ne u kemi dhënë në dorë edukimin e brezit të ri, nuk u jepet triska e Frontit. Edhe për mjekët po kështu, disa thonë se janë të vjetër dhe mbajnë qëndrime sektare me ta. Ju i kini mundësitë që ta ndihmoni Partinë për forcimin e organizatës së Frontit.

Ju, sigurisht, jeni në korrent të situatës ndërkombëtare. Ju jeni njerëz që e lexoni gazetën «Zëri i Popullit» dhe në qoftë se ka ndonjë që nuk e bën këtë, ai duhet të ndryshojë rrugë. Njerëzit e sigurimit duhet të jenë në korrent për të gjitha çështjet, si jashtë dhe brenda vendit tonë, prandaj leximi i gazetës ka rëndësi të madhe për të qenë në korrent të situatës politike të jashtme, të brendshme dhe të gjendjes ekonomike.

Shoku Enver pasi trajtoi disa çështje të rëndësishme të situatës së jashtme e të brendshme, përfundoi:

Këto kisha në përgjithësi për të vënë në dukje. Komiteti Qendror ka besim te ju, se do t'i kuptoni drejt të gjitha këto çështje të rëndësishme dhe do t'i zbatoni drejt. Të mos ju trembin këto të meta, përkundrazi kur t'i njihni do ta dënoni më mirë shkaku të tyre.

Të jeni vigjilentë dhe mos lëshoni asnjë gram ndaj armikut të brendshëm e të jashtëm, të jemi akoma më vigjilentë se më parë!

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**TELEGRAM URIMI DËRGUAR SEKRETARIT
TË PARË TË PARTISË SË PUNONJESVE
TË HUNGARISË, MATIAS RAKOSHI, ME RASTIN
E 10-VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË REPUBLIKËS
POPULLORE TË HUNGARISË**

30 mars 1955

I dashur shoku Rakoshi,

Me rastin e ardhjes së delegacionit shqiptar në Budapest për të marrë pjesë në festën e madhe të 10-vjetorit të çlirimit të Republikës Popullore të Hungarisë, përfitoj nga rasti t'Ju dërgoj përshëndetjet e nxehta vëllazërore dhe t'Ju uroj shëndet dhe jetë të gjatë.

Ne gëzohemi dhe urojmë gjithashtu popullin vëlla hungarez për sukseset e mëdha që ka arritur në rrugën e tij për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e paqes që udhëhiqet nga miku i përbashkët i popujve tanë Bashkimi i lavdishëm Sovjetik.

Populli dhe komunistët shqiptarë në këto ditë të lumtura dhe të gëzueshme për popullin mik hungarez e ndejnë veten afër tyre dhe marrim pjesë me gjithë zemër në festën tuaj të madhe të 10-vjetorit të çlirimit.

Duke përfunduar Ju uroj edhe një herë shëndet

dhe jetë të gjatë Juve dhe suksese të mëtejshme popullit tuaj dhe Partisë motër të Punonjësve të Hungarisë në rrugën për ndërtimin e socializmit dhe në përpjekjet e përbashkëta për forcimin e mëtejshëm të kampit tonë të paqes, të demokracisë dhe të socializmit!

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LENINIZMI — BURIM I PASHTERSHËM I FITOREVE TË POPULLIT SHQIPTAR¹

22 prill 1955

Gjatë gjithë historisë së tij populli shqiptar ka luftuar me trimëri për liri dhe pavarësi, për bukë dhe «dritë». Por megjithkëtë ai ka vuajtur shekuj me radhë nën zgjedhën e pushtuesve të huaj dhe nën shtypjen e feudoborgjezisë së vendit.

Si mundi populli shqiptar që është vetëm një popull i vogël, të matej në një luftë të pabarabartë me armiq të tillë si ushtritë fashiste italo-gjermane, t'i shporrte nga toka e tij dhe të vendoste pushtetin e tij popullor? Si mundi Shqipëria, një vend me një ekonomi dhe me një kulturë të prapambetur, të hynte në rrugën e ndërtimit të socializmit? Është e qartë për të gjithë se populli shqiptar fitoi, Shqipëria doli në dritë, sepse në botë triumfoi leninizmi, sepse populli shqiptar gjeti te ky një burim të fuqishëm dhe jetëdhënës.

Lenini themeloi Partinë e lavdishme Komuniste të

¹ Artikull dërguar gazetës «Për një paqe të qëndrueshme, për një demokraci popullore».

Bashkimit Sovjetik që u bë një shembull i shkëlqyer për të gjithë partitë revolucionare marksiste të klasës punëtore. Lenini ka qenë udhëheqësi i Revolucionit të madh të Tetorit që ndriçoi rrugën e çlirimit të proletariatit dhe të masave punonjëse të të gjithë botës. Lenini krijoi shtetin e parë të punëtorëve dhe të fshatarëve, shtetin sovjetik që u bë flamurtari dhe mburoja e lirisë, e paqes dhe e sigurisë të të gjithë popujve të botës, të mëdhenj dhe të vegjël. Lenini ka treguar rrugët e kalimit nga kapitalizmi në komunizëm; idetë e tija të pavdekshme janë baza e të gjitha fitoreve dhe e të gjitha sukseseve të shkëlqyera që korrin popujt sot.

Idetë e Leninit të madh përhapen si rrezet e diellit në të gjithë botën. Ato u përhapën edhe në Shqipëri dhe ngjallën shpresat e popullit shqiptar.

«Popujt po zgjohen — shkruante patrioti Mihal Grameno më 1928 — dhe ata pyesin: «rrojtje është kjo e jona? Kjo po i shtyn dita me ditë ata në idealin e lirisë së vërtetë që është socializmi».

Populli shqiptar mësoi nga goja e Leninit ekzistencën e Traktatit të fshehtë të Londrës, me anën e të cilit imperialistët përgatitnin copëtimin e Shqipërisë që, pas pesë shekujsh skllavërie, kishte shpallur pavarësinë e saj.

«Pa Leninin — shkruante më 1924 gazeta demokratike «Politika» — nuk do të kishte fuqi në botë që të mundej të prishte këtë traktat».

Populli shqiptar gjeti në shtetin e ri të sovjetëve, në udhëheqësin e tij, Leninin, një mik dhe një mbrojtës të sinqertë. Prandaj ai i mbështeti te ata shpresat e tija.

«Ne jemi thellësisht të bindur — i shkruante qeverisë sovjetike më 1920 një tjetër patriot i shquar, Bajram

Curri — se e larta qeveri e republikës sovjetike do të bëjë që gjithë bota të gëzojë parimet e drejtësisë. Populli shqiptar pret prej Rusisë Sovjetike që të thotë fjalën e saj vendimtare dhe shpëtimtare dhe të vendosë në Ballkan paqe të drejtë dhe të vërtetë».

Gjatë Luftës së dytë botërore, kur hordhitë fashiste kërkonin të skllavëronin vendet ballkanike, popujt e këtyre vendeve ishin të bindur se vendi i madh i sovjetëve do ta thoshte fjalën e tij vendimtare dhe shpëtimtare mbi fatin e tyre. Me këtë bindje dhe me një besim të patundur në Bashkimin Sovjetik populli shqiptar u ngrit si një trup i vetëm për të luftuar kundër okupatorëve fashistë dhe bashkëpunëtorëve të tyre, «për një Shqipëri të lirë dhe demokratike popullore».

Por populli shqiptar në këtë luftë kishte nevojë për një shtab që ta udhëhiqte. Ky shtab u formua në kohën e duhur. Më 8 Nëntor 1941 u themelua Partia Komuniste e Shqipërisë që u vu në krye të popullit dhe udhëhoqi luftën e tij në fitoren mbi hordhitë fashiste dhe për vendosjen e pushtetit popullor. Si mundi një Parti kaq e re, që lindi në kushte të vështira, të udhëhiqte me sukses një luftë kaq të ashpër kundër një armiku të pabarabartë? Ajo mundi ta bënte këtë gjë, sepse ishte një Parti e tipit të ri, e udhëhequr nga leninizmi. Doktrina e Leninit u bë burimi i fuqisë së saj. Te ajo e gjeti Partia jonë e re dritën e orientimit të saj.

Këtë herë, lufta dhe sakrificat e popullit shqiptar nuk shkuan kot. Në saje të udhëheqjes së urtë dhe të guximshme të Partisë sonë Komuniste, në saje të ekzistencës së shtetit sovjetik, në saje të luftës heroike të popujve sovjetikë dhe të fitores së ushtrisë së tyre

legjendare mbi nazizmin gjerman populli shqiptar u çlirua përgjithmonë dhe u bë zot i fateve të tij.

Populli shqiptar dhe Partia e tij filluan një luftë të re, luftën për ndërtimin e bazave të socializmit. Në këtë luftë populli shqiptar dhe Partia e tij u kthyen drejt burimit jetëdhënës, leninizmit, drejt eksperiencës së madhe të Partisë dhe të shtetit të themeluar nga V. I. Lenini dhe të forcuar nga vazhduesi i veprës së tij J. V. Stalini.

Partia jonë kishte parasysh mësimin e Leninit sipas të cilit, për të siguruar fitoren e revolucionit popullor ajo duhej ta shpinte këtë deri në fund. Krahas me plotësimin e detyrave antiimperialiste dhe antifeydale të revolucionit, u kryen me sukses edhe detyrat e një faze të re të revolucionit, të fazës së transformimeve socialiste. Në dritën e mësimëve të Leninit në vendin tonë u kryen transformime të mëdha ekonomike dhe shoqërore. Pushteti popullor që ushtronte funksionet e diktaturës së proletariatit mori një varg masash revolucionare si zbatimi i reformës agrare, shtetëzimi i industrisë së minierave, i transporteve, i bankave, i tregëtisë së jashtme dhe i të gjitha koncesioneve të huaja. Kështu u zhduk baza ekonomike e klasave të përmbysura, pozitat kyçe të ekonomisë kombëtare u përqëndruan në duart e shtetit, u krijua sektori socialist dhe vendi ynë hyri me hapa të sigurtë në fazën e ndërtimit të bazave të socializmit. Që më 1946, pjesa e industrisë socialiste (duke përfshirë edhe kooperativat e artizanatit) në prodhimin e përgjithshëm të industrisë arrinte 73 për qind, kurse pjesa e industrisë private arrinte vetëm 27 për qind.

Duke ndjekur mësimet e Leninit mbi industrializimin socialist të vendit si kusht i domosdoshëm për ndërtimin e bazave ekonomike të socializmit, Kongresi I i Partisë Komuniste të Shqipërisë (sot Partia e Punës e Shqipërisë), që u mbajt më 1948, vendosi që «Partia do të ketë kurdoherë si pikësynim me rëndësi industrializimin dhe elektrifikimin e vendit».

Meqenëse Shqipëria ishte një vend me një industri shumë të vogël dhe primitive ajo nuk mund ta bënte industrializimin socialist të vendit pa ndihmën e Bashkimit Sovjetik në radhë të parë dhe të vendeve të demokracisë popullore me makineri dhe materiale të tjera të caktuara për ndërtimin e industrisë së vendit.

Duke u udhëhequr nga mësimet e Leninit, Partia e Punës e Shqipërisë e ka shtruar drejt çështjen e industrializimit. Në planin e parë pesëvjeçar, ajo caktoi si detyrë kryesore transformimin e Shqipërisë nga një vend i prapambetur agrar, në një vend agraro-industrial. Në luftën për realizimin e këtij programi, u arritën rezultate të shkëlqyera. Në fund të vitit 1954, prodhimi i përgjithshëm i industrisë ishte 11,4 herë më i madh nga ai i vitit 1938; në fund të vitit 1955, ai do të jetë 11,7 herë më i madh. Në zhvillimin e përgjithshëm të industrisë, ritmet e shtimit të prodhimit të mjeteve të prodhimit kanë qenë më të mëdha se ato të prodhimit të sendeve të konsumit. Kështu për shembull, më 1954, në krahasim me vitin 1938, prodhimi i mjeteve të prodhimit u shtua 11,3 herë; kurse prodhimi i sendeve të konsumit u shtua 10,5 herë. Në krahasim me vitin 1938, në fund të vitit 1954 prodhimi i naftës u shtua 419,2 për qind, ai i qymyr gurit 4 000 për qind; i kromit 1 367,3

për qind; i elektrikut më shumë se 1 900 për qind etj.

Në përputhje me ligjin ekonomik të zhvillimit të planifikuar e të harmonishëm të ekonomisë kombëtare, Partia jonë e Punës i kushton gjithashtu vëmendje zhvillimit të industrisë së mallrave të konsumit. Kështu, për shembull, prodhimi i industrisë ushqimore më 1954 arriti 750 për qind në krahasim me vitin 1938. Gjithashtu është shtuar në shkallë të madhe edhe prodhimi i artikujve të veshmbathjes, në një shkallë aq të madhe sa që po të krahasohet përsëri viti 1954 me vitin 1938, prodhimi i të pambuktave është shtuar 44,4 herë. Si rezultat i zbatimit të politikës së industrializimit të vendit tonë, në fund të vitit 1954 kishte afro 209 ndërmarrje kundrejt 70 më 1938. Pesha specifike e prodhimit industrial në prodhimin e përgjithshëm të ekonomisë kombëtare më 1954 u ngrit në 60,8 për qind kundrejt 18,3 për qind më 1938.

Me anën e industrializimit, siç na ka mësuar Lenini, Partia e Punës e Shqipërisë shton dhe forcon klasën punëtore, e ngre rolin e saj udhëheqës në shoqëri, forcon aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë, ngre rendimentin e punës dhe shton burimet që kanë për qëllim ngritjen e mirëqenjes materiale dhe kulturele të masave punonjëse. Me anën e industrializimit, Partia jonë forcon pavarësinë ekonomike dhe shton fuqinë mbrojtëse të vëndit.

Kongresi II i Partisë së Punës të Shqipërisë (1952) tërhoqi veçanërisht vëmendjen e Partisë mbi zhvillimin e bujqësisë me një ritëm më të shpejtë. Për të zbatuar direktivat e Kongresit II të Partisë plenumet e Komit-

tetit Qendror të dhjetorit 1953 dhe të prillit 1954 morën vendime dhe masa me rëndësi që favorizojnë zhvillimin e bujqësisë dhe që kanë për qëllim ngritjen e mëtejshme të nivelit të jetesës së punonjësve. Në bazë të zbatimit të këtyre vendimeve, gjendja ekonomike e fshatarësisë u përmirësua. U bë falja e detyrimeve të prapambetura në natyrë, ulja prej 50 për qind e tatimit në natyrë për disa shtresa të fshatarësisë dhe pakësimi i koeficientit për shtresat e tjera, ulja e çmimeve të veglave bujqësore, u shtua ndihma e shtetit në kredi bujqësore, në farëra të seleksionuara, në kafshë pune etj.

Plenumet e Komitetit Qendror të dhjetorit 1953 dhe të prillit 1954 caktojnë si detyrë kryesore për zhvillimin e bujqësisë ngritjen e rendimentit të kulturave bujqësore. Kështu, në përputhje me planin, prodhimi i drithërave të bukës më 1955 do të shtohet 30 për qind, prodhimi i pambukut 63 për qind, ai i panxhar sheqerit 100 për qind. Për ta përfunduar me sukses këtë detyrë, po shtohen në mënyrë të ndieshme furnizimet që i jepen bujqësisë në materiale, plehra kimike dhe caktohen për ato më shumë kredi.

Një ndihmë e madhe do t'i jepet bujqësisë në shtimin e sipërfaqeve të ujtura dhe të punimeve të bonifikimit. Më 1955 në krahasim me vitin 1954 sipërfaqja e ujitur do të jetë 129 për qind. Fuqia e mekanizimit të bujqësisë shtohet çdo vit. Më 1954, fuqia motorike e SMT-ve, në krahasim me vitin 1947, u shtua 8,5 herë, më 1955 ajo do të shtohet 30 për qind në krahasim me vitin 1954. Me anën e këtyre masave dhe në sja të ndihmës dhe të eksperiencës së Bashkimit Sovjetik, bujqësia jonë rritet dhe forcon bazat e saja për zhvilli-

ka parasysh mësimit e Leninit sipas të cilit revolucionit socialist nuk mund të jetë i plotë pa revolucionin kultural. Veçanërisht ky mësim ka një rëndësi të madhe për vendin tonë, po të merret parasysh se okupatori i huaj dhe regjimet feudoborgjeze e mbanin në një gjendje kulturele jashtëzakonisht të prapambetur, që karakterizohet sidomos nga fakti se 80 për qind e popullsisë ishte analfabete. Sot në Shqipëri e re, krahas me zhvillimin e industrisë socialiste dhe me transformimin socialist të bujqësisë, është krijuar dhe po forcohet baza materiale e zhvillimit të kulturës dhe e ngritjes së nivelit kultural të masave punonjëse. Është duke u plotësuar një nga detyrat më të rëndësishme të revolucionit kultural: likuidimi i analfabetizmit për shtetasit nën 40 vjeç. Është vendosur arësimi fillor i detyrueshëm dhe pjesërisht ai 7-vjeçar. Më 1954, numri i shkollave fillore ishte 335 për qind më shumë dhe numri i nxënësve të tyre — 263 për qind më i lartë se më 1938. Numri i shkollave 7-vjeçare dhe të mesme është ngritur nga 11 në 345 dhe numri i nxënësve të tyre nga 6 315 në 48 340. Për të parën herë janë themeluar gjashtë institute të larta me 1 200 studentë nga të cilat do të dalin këtë vit specialistët e parë të përgatitur në vendin tonë. Afro 900 inxhinierë, mjekë, agronomë dhe specialistë të tjerë kanë mbaruar studimet e tyre në shkollat e larta të Bashkimit Sovjetik dhe në vendet e demokracisë popullore dhe me qindra studentë të tjerë mësojnë jashtë shtetit. Me mijëra punonjës studjojnë në shkollat e natës dhe me korrespondencë, në kurset e perfeksionimit, në shkollat e rezervave të punës etj.

Fakti që në Shqipëri, ku më parë nuk kishte asnjë

teatër, sot vihen në skenë opera dhe balete, botohen romane dhe poema, kompozohen simfoni dhe opereta origjinale, është një provë e zhvillimit dhe e lulëzimit të kulturës së popullit shqiptar.

Të gjitha këto suksese dhe transformime në ndërtimin socialist të ekonomisë dhe të kulturës i detyrohen para së gjithash faktit se ne kemi ndjekur me këmbëngulje mësimet e Leninit mbi forcimin e aleancës midis klasës punëtore dhe fshatarësisë, aleancë që është baza e regjimit të demokracisë popullore. Partia hodhi bazat e kësaj aleance gjatë Luftës nacional-çlirimtare, ajo e forcoi atë edhe më shumë gjatë periudhës së kryerjes së transformimeve revolucionare dhe të gjitha planet dhe masat e ekonomisë kombëtare u përpunuan duke pasur parasysh forcimin përherë më të madh të kësaj aleance. Kongresi II i Partisë caktoi si detyrë kryesore politike të planit të parë pesëvjeçar forcimin e aleancës midis klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse, forcimin e rolit udhëheqës të klasës punëtore në këtë aleancë.

Mësimet e Leninit mbi këtë aleancë ndriçuan rrugën e të gjitha partive komuniste dhe punëtore. V. I. Lenini duke përcaktuar karakterin dhe rëndësinë e politikës së re ekonomike në raportin e tij në Kongresin IX të Sovjetëve të Ruisë vinte në dukje:

«Detyra që ne jemi duke zgjidhur tani, hë-përhë — përkohësisht — të vetmuar, duket si një detyrë thjesht ruse, por në të vërtetë kjo është një detyrë që do të dalë përpara gjithë socialistëve. . . Shoqëria e re, e cila do të mbësh-

tetet në aleancën e punëtorëve dhe të fshatarëve, është e pashmangëshme. Shpejt a vonë, njëzet vjet më parë apo njëzet vjet më pas, ajo do të vijë dhe për të, për këtë shoqëri ne ndihmojmë të gjejmë format e aleancës së punëtorëve dhe fshatarëve, kur punojmë për zgjidhjen e detyrës së politikës sonë të re ekonomike. Këtë detyrë ne do ta zgjidhim dhe do të krijojmë një aleancë të punëtorëve dhe fshatarëve aq të shëndoshë sa që s'do të ketë forca në botë, që ta prishin».¹

Historia e ka vërtetuar dhe e vërteton plotësisht këtë parashikim gjenial të Leninit.



Ndërtimi i ekonomisë socialiste dhe zhvillimi i kulturës së re nuk mund të bëhen pa zhdukur pengesat, pa vështirësi, pa luftë.

«Kalimi nga kapitalizmi në komunizëm, ka thënë Lenini, është një epokë e tërë historike. Derisa kjo të mos ketë marrë fund, shfrytëzuesve patjetër u mbetet shpresa për restaurim, dhe kjo shpresë kthehet në orvatje për restaurim»².

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 33, f. 133-139

² V. I. Lenin. Veprat, vëll. 28, f. 285

Duke u frymëzuar nga doktrina e udhëheqësit të madh, Partia jonë i edukon masat punonjëse me frymën e vigjilencës revolucionare të intrasigjencës kundrejt armiqve të klasës, u mëson atyre që të zhdukin të gjitha vështirësitë që ndeshen në rrugën tonë.

Në vendin tonë, ku shoqëria bën kapërcime të mëdha nga marrëdhënjet feudoborgjeze në marrëdhënjet socialiste, lufta kundër ideologjisë dhe kulturës borgjeze, kundër moralit dhe psikologjisë feudoborgjeze, kundër zakoneve prapanike, bestytnive etj., është një nga detyrat më të rëndësishme dhe të menjëhershme. Për këtë arsye Partia jonë i ka dhënë dhe i jep një rëndësi të madhe përhapjes së kulturës socialiste dhe ideologjisë marksiste-leniniste në masat punonjëse, ajo thekson nevojën për të armatosur, në radhë të parë, komunistët me këtë kulturë dhe me këtë ideologji, me shkencën e vërtetë të ligjeve të zhvillimit të shoqërisë.

Partia e Punës e Shqipërisë, si parti e tipit leninist, vepron dhe zhvillohet mbi bazën e mësimëve të Leninit për forcimin e unitetit të Partisë dhe të udhëheqjes kolegjiale, për inkurajimin sa më shumë të inisiativave krijuese të masave dhe për forcimin e lidhjeve midis Partisë dhe këtyre. Vendimet e Plenumit të Komitetit Qendror që u mbajt në korrik të vitit të kaluar frymëzohen veçanërisht nga këto mësimë të Leninit.

Partia e Punës e Shqipërisë edukon çdo ditë masat me frymën e internacionalizmit proletar, të mirënjohjes së thellë dhe të miqësisë ndaj popujve të Bashkimit Sovjetik, me frymën e miqësisë vëllazërore me të gjitha vendet e demokracisë popullore, me frymën e solidari-

tetit me popujt dhe me njerëzit që luftojnë për paqen, lirinë dhe demokracinë.

Çdo ditë e më shumë vendet e demokracisë popullore forcojnë marrëdhënjet politike, ekonomike dhe kulturele midis tyre dhe në radhë të parë me Bashkimin Sovjetik. Deklarata e Konferencës së Moskës¹ është një shprehje e gjallë e këtyre marrëdhënjeve të reja të bazuara në politikën e paqes dhe të sigurimit të popujve që u shpall nga Lenini i madh që në ditët e para të lindjes së shtetit sovjetik. Populli shqiptar e përshëndeti këtë deklaratë si një inisiativë me rëndësi për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë së popujve dhe veçanërisht për sigurimin e lirisë dhe të pavarësisë së Republikës Popullore të Shqipërisë.

Në fillim të këtij muaji, sesioni i dytë i Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë dëgjoi dhe aprovoi një raport mbi politikën e jashtme dhe të brendshme të qeverisë sonë popullore dhe mbi buxhetin e vitit 1955, i cili, krahas me shtimin e fondeve të caktuara për ndërtimin e ekonomisë dhe të kulturës popullore, parashikon, edhe shtimin e shpenzimeve që kanë për qëllim forcimin e fuqisë mbrojtëse të vendit. Populli shqiptar e përkrah plotësisht këtë politikë të Partisë dhe të qeverisë, sepse ai ka kurdoherë parasysh mësimin e Leninit, sipas të cilit për vendet që ndërtojnë socializmin në kushtet e rrethimit kapitalist ekziston jo vetëm rreziku i orvatjeve të reaksionit të brendshëm për të rivendosur kapitalizmin, por edhe rreziku i ndërhyrjes

¹ Kjo deklaratë u aprovua në Konferencën e Moskës që zhvilloi punimet nga 29 nëntor deri në 2 dhjetor 1954.

së shteteve imperialiste për të përmbysur me forcë pushtetin e punonjësve.

Lenini ka thënë se një nga detyrat kryesore të diktaturës së proletariatit është organizimi i mbrojtjes së atdheut socialist. Ky mësim i Leninit ka një rëndësi të madhe për vendet tona, sidomos në kushtet e sotme të zhvillimit të gjendjes ndërkombëtare, në kohën që imperialistët amerikanë, anglezë dhe shërbëtorët e tyre përgatitin një luftë të re botërore, përpiqen që të rilindin me çdo kusht Vermahtin revanshist në Gjermaninë Perëndimore, duke kërcënuar kështu paqen në Evropë dhe në të gjithë botën.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe satelitët e tyre ndjekin rrugën e provokimit dhe të përgatitjes së luftës, organizojnë garën e armatimeve, ndjekin rrugën e kërcënimeve ndaj kampit të socializmit dhe popujve të vendeve paqësore, rrugën e skllavërimit dhe të shfrytëzimit përherë më të madh të popujve kolonialë dhe të popujve të vendeve kapitaliste.

Ne jemi për parimet leniniste të bashkekzistencës. Ne shprehemi për këto parime, sepse ne jemi të sigurt për forcat e socializmit, të sigurtë se kemi zgjedhur rrugën e drejtë, rrugën drejt komunizmit. Lufta që bëjnë Bashkimi Sovjetik dhe të gjitha vendet e kampit të socializmit për një paqe të qëndrueshme në të gjithë botën nuk është një shenjë e dobësisë së tyre, por përkundrazi ajo shpreh besimin e tyre në një të ardhshme të lumtur dhe dëshirën e tyre për të jetuar dhe për të punuar në paqe.

Populli shqiptar që është i ndërgjegjshëm për detyrat e tija dhe për përgjegjësinë e tij për ruajtjen e paqes

dhe për forcimin e kampit të socializmit, ecën me vendosmëri në rrugën e Leninit.

Duke kremtuar përvjetorin e 85-të të lindjes së V. I. Leninit me një dashuri të pakufishme dhe me një mirënjohje të thellë, Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli shqiptar bashkojnë përherë më shumë dhe mobilizojnë forcat e tyre për të korrur suksese të reja në ndërtimin e bazave të socializmit dhe në forcimin e Republikës Popullore të Shqipërisë.

Botuar për herë të parë në gazetën «Për një paqe të qëndrueshme, për një demokraci popullore», Nr. 16 (337), 22 prill 1955

Botohet sipas tekstit të gazetës «Për një paqe të qëndrueshme, për një demokraci popullore», Nr. 16 (337), 22 prill 1955

**FJALA E MBYLLJES NË PLENUMIN XIII TË KQ TË
PPSH «MBI PUNËN IDEOLOGJIKE TË PARTISË
DIJE MASAT PËR PËRMIRËSIMIN E SAJ»¹**

27 prill 1955

Shokë,

Ky plenum ka një rëndësi të madhe për Partinë tonë dhe do të armatosë shokët e udhëheqjes dhe të gjithë komunistët me forca të reja për të kryer më mirë detyrat e mëdha dhe shumë të rëndësishme që kemi përpara.

Punimet e këtij plenumi u zhvilluan me sukses, por mendoj se duhet të kishte një kritikë më të fortë në drejtim të Byrosë Politike që i ka lënë pa i marrë në analizë në një mbledhje të mëparshme të plenumit këto çështje kaq të rëndësishme. Megjithatë Byroja Politike dhe Sekretariati herë pas here kanë shqyrtuar probleme ideologjike, kulturore e arsimore dhe mbi këtë bazë është punuar nga ana e Partisë. Por kjo nuk ka qenë e mjaftueshme. Çështjet ideologjike Byroja Politike duhej t'i ngrinte në shkallë plenumi, i cili, si organi udhëheqës

¹ Ky plenum u mbajt më 25-27 prill 1955.

kryesor i Partisë pas kongresit, t'i zbërthente e t'i zhvillonte më tej ato, sepse janë probleme të rëndësishme dhe jetike për Partinë tonë. Këtu qëndron gabimi dhe e meta serioze e Byrosë Politike. Por kjo nuk ka rrjedhur se Byroja Politike nuk është preokupuar për çështjet ideologjike. Jo. Puna është se ashtu siç ngjet ndonjëherë në të gjithë Partinë, ne akoma nuk kemi arritur ta organizojmë si duhet punën në mënyrë të atillë që t'i japim rëndësi çdo sektori e, në radhë të parë, sektorëve më të rëndësishëm si atyre ekonomikë, ideologjikë etj. Në rast se këtë plenum do ta kishim organizuar më përpara, përfitimi dhe forcimi i punës ideologjike të Partisë, natyrisht, do të kishte qenë edhe më i madh. Kjo dobësi t'i bëhet mësim udhëheqjes dhe Partia në bazë të mësojë nga gabimet që bëjmë ne, sepse këto të meta në udhëheqje manifestohen edhe në punën e komiteteve të Partisë në rrethe dhe të organizatave bazë.

Siç u theksua në plenum, në raportin e Byrosë Politike dhe në diskutimet e shokëve, në drejtim të punës ideologjike, kulturele, arësimore, në propagandën e Partisë me masat dhe në sektorët e ndryshëm të prodhimit ka mjaft rezultate, po ka edhe dobësi. Përsa i përket punës ideologjike, natyrisht, ne kemi shumë dobësi, por duhet të vlerësojmë edhe përpjekjet që ka bërë Partia gjatë kësaj periudhe të shkurtër të jetës së saj. Mund që shumë anëtarë të Partisë sonë të mos e dinë marksizëm-leninizmin me baza. Por fakti është që vendi ynë po ecën përpara, po ndërton me sukses socializmin dhe po arrihen rezultate në të gjithë sektorët. Fakti që vija e Partisë në të gjitha drejtimet, politike, organizative ashtu edhe në çështjet ekonomike zbatohet dhe

mbrohet me një vigjilencë mjaft të madhe dhe aktive, tregon se kuptimi dhe ndjenjat e njerëzve të Partisë janë kalitur në mënyrë të tillë që nuk mund të kalojnë aqë lehtë shtrembërime parimore në vijën e Partisë. Partisë sonë nuk mund t'i kalojnë lehtë gjëra të tilla, bile mund të them as masave të popullit. Kur ndonjë zile bije trosh anëtarët e Partisë ngrihen menjëherë. Kështu shpjegohet kur shoku Tuk Jakova bëri diskutimin e tij të gjithë shokët e plenumit reaguan drejt dhe menjëherë, ata e ndjenë dhe e kuptuan se ai nuk ishte në rrugën e Partisë. Ky është fakt që tregon se kuadrot e Partisë sonë kanë aq pjekuri dhe kalitje ideologjike sa të kuptojnë problemet në bazë të marksizëm-leninizmit. Por sigurisht mendojmë, dhe kështu është drejt të thuhet, se jemi akoma larg nga ai nivel marksist-leninist që kërkohet dhe në këtë drejtim nuk kemi ecur sa duhet përpara.

Komunistët që janë aq të zotë e të vendosur për të mbrojtur vijën e Partisë, që janë aq të hedhur në punë për të zbatuar detyrat në të gjithë sektorët, ekonomikë, arësitorë, kulturalë etj, duhet t'i shtojnë edhe më tepër përpjekjet për të studjuar më imtësisht marksizëm-leninizmin. Sigurisht kjo detyrë është kryer, por me të meta. E vërteta është se Partia jonë ecën përpara pa u ndalur, anëtarët e saj kanë një vullnet të madh, që po shtohet dita-ditës, për të mësuar, për t'u armatosur me marksizëm-leninizmin dhe me kulturën e përgjithshme e profesionale. Rezultatet e arritura që janë të mëdha, lufta e drejtë për zbatimin në praktikë të vijës së Partisë dhe eksperiencia konkrete e Partisë sonë në fushën e edukimit ideologjik, të gjitha këto, kanë ndih-

muar që niveli i Partisë sonë dhe i masave të gjera të popullit të ngrihet më lart e të ecë kurdoherë përpara. Këtë gjë duhet ta vlerësojmë mirë duke marrë parasysh të kaluarën e popullit tonë, nivelin e tij të ulët kultural e në radhë të parë nivelin kultural të komunistëve, sidomos të atyre klasave e shtresave mbi të cilat mbështetet Partia. Prandaj, duke marrë parasysh se kemi një bazë e një brumë të shëndoshë, ne i kemi të gjitha mundësitë që të arrijmë suksese më të mëdha në ngritjen e mëtejshme të nivelit ideologjik të komunistëve, në armatosjen e tyre me idetë e marksizëm-leninizmit.

Ju të gjithë e dini se po të armatosemi si duhet me marksizëm-leninizmin, do të na hapen perspektiva më të gjera në punë, nuk do të gabojmë në kryerjen e detyrave tona, do t'i zgjidhim drejt dhe shpejt problemet dhe do të orientohemi mirë në çdo situatë. Në qoftë se ushtari do të jetë i ngritur ideologjikisht, ai do të dijë ta mbajë e ta përdorë më mirë pushkën, pavarësisht në se mund ta dijë ose mos ta dijë mirë artin ushtarak, ai do të jetë në gjendje të kuptojë si duhet rëndësinë e detyrave luftarake dhe do të bëjë përpjekjet e duhura që ta mësojë më mirë edhe artin ushtarak. Kështu mund të themi edhe për atë që përdor tornon ose për atë që ndjek një shkollë. Prandaj marksizëm-leninizmi është kyçi që hap të gjitha portat, që krijon të gjitha mundësitë për të fituar ndërgjegjen socialiste, që sheshon të gjitha pengesat dhe i bën komunistët të korrin kurdoherë fitore.

Edukimi marksist-leninist në radhë të parë do të jetë nën kujdesin e veçantë të Komitetit Qendror të

Partisë. Duke marrë parasysh se Partia i ka krijuar të gjitha kushtet për të gjithë anëtarët e saj, më duket se është e dënueshme të mos përfitohet në shkallën që kërkohet dhe të mos konsiderohet çështja e studimit si një ushqim i domosdoshëm dhe i nevojshëm për mendjen e komunistit. Nuk ka komunist që të mos dojë të kryejë me përpikëri detyrat, që të mos ndjejë përgjegjësinë e rëndë që ka mbi supet e tij, që të mos kuptojë besimin e madh që i është dhënë nga populli. Por që të plotësohen si duhet detyrat, duhet që të përdoren mirë armët që na jep Partia. Shumë shokë thonë se e kanë të vështirë të shtrohen të studiojnë. Po, edhe e vështirë është dhe këtë nuk e them për të justifikuar shokët. Por për komunistët nuk ka vështirësi që të mos kapërcehet. Nga ana tjetër, të kuptohet se sa më tepër që shkon koha, aq më e lehtë bëhet detyra e përvetësimit të marksizëm-leninizmit, vetëm se kjo punë duhet organizuar mirë, nga të gjithë komunistët, atje ku i ka caktuar Partia. Vullneti ekziston dhe për këtë ne jemi plotësisht të bindur, vetëm se edukimi marksist-leninist duhet udhëhequr mirë, duhet drejtuar dhe kontrolluar mirë.

Po të ndjekim jetën e shokëve në Shkollën e Partisë konstatojmë se në fillim Byrosë Politike dhe Sekretariatit u vinin vërejtje të tilla si: «Nuk përvetësohet dot lënda», «shokët gjejnë vështirësi të mëdha», «disa shokëve u dhemb koka ose sëmuren nga nervat» etj. Por çdo vit që kalon, vërejtje të tilla na vijnë më pak, bile sivjet nuk kam dëgjuar më ndonjë gjë të tillë. Kjo tregon se sa shkon koha, njerëzit e Partisë sonë jo vetëm që kanë një dëshirë akoma më të madhe, po gjejnë

më shumë lehtësi për të mësuar. Pra, kushtet nuk janë si përpara, por janë përmirësuar. Lufta revolucionare e Partisë dhe e popullit tonë, përpjekjet me vështirësitë, leximi, sado i paktë dhe i parregullt, eksperiencia e punës së Partisë, i ka bërë njerëzit tanë të ecin përpara, të kalojnë pengesa dhe të përgatitet kështu brumi për të mësuar më rrënjësisht.

Me gjithë këto përparime, vihet re se nga disa udhëheqës nuk po tregohet po ai vullnet që tregojnë shumë shokë të bazës. Ndjekja e Universitetit të natës të marksizëm-leninizmit, vazhdimi me korrespondencë i Shkollës së Partisë dhe studimi individual, lënë shumë për të dëshiruar. Unë mendoj se është e papranueshme pikëpamja që ngrihet nga disa shokë kur thonë se «nuk kemi kohë për të studjuar, pasi jemi shumë të zënë me punë». Unë e di se shokët janë vërtet të zënë me shumë punë, po edhe unë jam i zënë me punë, e megjithkëtë kjo nuk më pengon aspak të lexoj, të gjej kohë të studjoj. Derisa Partia çështjen e edukimit marksist-leninist e vë në radhë të parë dhe e konsideron si një nevojë kryesore, atëhere përse shokët e udhëheqjes nuk ndërtojnë programe të tilla që, pasi të kenë kryer punën, të gjejnë kohë edhe të mësojnë në vend që të mbushin deftere dhe formularë me kilometra për të mbajtur statistika të kota, për të shkruar raporte plot me ujë? A nuk është më mirë që këtyre gjërave t'u futim gërshërët dhe të kemi më shumë kohë në dispozicion për të studjuar marksizëm-leninizmin i cili është burimi jetëdhënës dhe do të na lehtësojë në kryerjen e detyrave të rënda që na ka caktuar Partia? Në rast se ka komunistë që nuk kanë aq zell për ta bërë këtë

gjë, atëhere ata duhet ta dinë se ka edhe një disiplinë partie, të cilën nuk duhet ta shkelin. Partia na thotë të mësojmë, të ndjekim kurset, universitetet, shkollat politike etj., etj. Këto ne duhet t'i bëjmë patjetër. Ta organizojmë, pra, punën në mënyrë të tillë që në radhë të parë ne t'i ndjekim këto kurse e këto shkolla për t'u armatosur me marksizëm-leninizmin. Ne mund të themi shumë parulla, mund të bëjmë plot konstatime, po në rast se nuk e organizojmë punën si duhet që këto parulla t'i vëmë në jetë dhe të luftojmë me të gjitha forcat që ato të bëhen jetë te çdo njeri, në radhë të parë te çdo komunist, ne nuk kemi bërë asgjë. Në rast se këto që u thanë këtu në plenum mbeten vetëm fjalë e fraza dhe nuk përvetësohen e nuk zbatohen nga Partia, në bazë të situatës dhe të forcave që ekzistojnë, atëhere ne nuk jemi në rregull.

Edukatorët tanë të mëdhenj Lenini dhe Stalini na mësojnë se organizimi i punës për edukimin marksist është një çështje e rëndësishme.

Prandaj studimit të marksizëm-leninizmit duhet t'i vëmë rëndësi të veçantë. Duhet të kemi mirë parasysh faktin se ekziston ideologjia borgjeze, të cilën ne do ta luftojmë si duhet vetëm kur të jemi të armatosur mirë me ideologjinë marksiste-leniniste. Shfaqjet e ideologjisë borgjeze në vendin tonë janë të shumta për arsësyet që i dimë. Ne duhet të dimë gjithashtu se ideologjia borgjeze depërton, hyn edhe në radhët e Partisë. Lufta dhe jeta e Partisë sonë e tregojnë më së miri këtë. Që nga themelimi i saj e deri sot në Partinë tonë kanë hyrë njerëz bartës të ideologjisë borgjeze, kundër së cilës ajo ka bërë një luftë të ashpër. Por në

Partinë tonë militojnë njerëz që e kanë dashur dhe e duan Partinë me gjithë shpirt, që kanë sakrifikuar dhe janë gati të sakrifikojnë për vijën e saj edhe jetën e tyre, që e kanë përkrahur dhe e përkrahin Partinë me të gjitha forcat. Por tërë kjo armatë komunistësh duhet të armatohet me ideologjinë e Partisë, me marksizëm-leninizmin, që të përmbushë rolin e pararojës, të zhdukë mbeturinat e ideologjisë borgjeze që ekzistojnë në ta dhe që i pengojnë të ecin përpara dhe ta zbatojnë mirë e pa lëkundje vijën e Partisë. Pse do të pengohen këta për ta zbatuar mirë vijën e Partisë? Sepse zakonet e vjetra, pikëpamjet borgjeze, qofshin edhe të vogla, paragjykimet, ndikimet e huaja që kanë ekzistuar dhe ekzistojnë në ndërgjegjen e njerëzve dhe që vijnë nga jashtë në shumë forma të ndryshme, hyjnë në Partinë tonë dhe përhapen nëpërmjet njerëzve. Në rast se Partia nuk është vigjilente dhe nuk i edukon këta njerëz me ideologjinë e saj për t'i spastruar nga mbeturinat e së kaluarës, atëhere mund të lindin sëmundje të rrezikshme për Partinë. Prandaj duke i parë çështjet në prizmin e interesit të mbrojtjes dhe të forcimit të Partisë, të forcimit të unitetit të saj, duhet që komunistët edukimin e tyre marksist-leninist ta konsiderojnë detyrën numër një. Për këtë Partia duhet të mbështetet në kuadrot e sprovuar të Luftës nacional-çlirimtare dhe të ndërtimit të bazave të socializmit. Shokëve që kanë luftuar nuk u lejohet ta neglizhojnë çështjen e edukimit të tyre marksist-leninist. Ata duhet të mendojnë që të jenë komunistë revolucionarë deri në fund. Atdheu mbrohet me armë, po ai mbrohet edhe me dituri e me kulturë dhe, që të përvetësohen këto, në radhë të parë, duhet të përvetëso-

het marksizëm-leninizmi. Kuadrot e Partisë duhet të kuptojnë se ndërtimi i socializmit nuk është një gjë e thjeshtë, por një proces shumë i komplikuar. Prandaj që t'i dalim mbanë kësaj detyre kaq të ndërlikuar dhe të madhe, duhet të edukohemi, duhet të ushqehemi vazhdimisht me marksizëm-leninizmin.

Për edukimin marksist-leninist duhet t'i vëmë rëndësi më të madhe formave të arësimit të Partisë, sidomos shkollave politike në qytete dhe në fshatra. Ndoshta jemi zgjeruar shumë me këto forma, duke marrë parasysh edhe faktin se propagandistët janë me një nivel të ulët. Ne duhet të marrim masa që ta përmirësojmë gjendjen e sistemit të arësimit politik. Por kjo gjë nuk duhet kuptuar në mënyrë të ngurtë saqë tani kush, është analfabet, të hiqet fare nga format e arësimit të Partisë. Është e domosdoshme që të ngrihet cilësia e punës në këto forma, por, për komunistët Partia e ka për detyrë të organizojë mësimin me ta. Ajo duhet t'i krijojë kushtet çdo anëtarit të Partisë që ta mësojë marksizëm-leninizmin, si për atë që punon e jeton në majë të shkëmbit, edhe për atë që punon në fabrikë. Çështja është që të bëhen përpjekje të dyfishta, analfabetët t'i ndihmojë Partia që të ngrihen vazhdimisht dhe të mos shkojnë duke mbyllur shkollat politike në mënyrë automatike. Në rast se udhëheqësit vazhdojnë të interesohen për këto kurse dhe shkolla politike, ashtu si janë interesuar deri tani, edhe sikur t'i shkurtojmë këto, cilësia atje nuk do të përmirësohet. Prandaj, këto shkolla politike të bëhen një vatër e madhe dhe e zjarrtë ku të mësohet marksizëm-leninizmi në mënyrë të gjallë dhe krijuese.

Kur vemi në Shkollën dyvjeçare të Partisë, e cila

ka një rëndësi të jashtzakonshme për Partinë, nxënësit na thonë: «Teoria marksiste-leniniste që po mësojmë këtu, nuk po lidhet si duhet me praktikën». Si mund ta lidhim këtë teori me praktikën në shumë anë, kur interesimi nuk është njëlloj nga të gjithë, si nga pedagogët efektivë ashtu edhe nga ata që japin disa leksione e bëjnë konferenca? Shokët që mësojnë në Shkollën e Partisë na thonë se këta të fundit që janë kuadro partie dhe punojnë në bazë duhet të sjellin praktikën e punës së tyre dhe eksperiencën e Partisë më mirë se kushdo tjetër, por ata nuk janë pedagogë të rregullt të shkollës. Bile disave u ka hipur mania ta mbushin leksionin që zhvillojnë me plot fraza dhe citate të qepura njëra pas tjetrës! Kjo nuk është e drejtë. Në këtë mënyrë, kjo qendër kaq e rëndësishme për edukimin e kuadrit me marksizëm-leninizmin në veprim, nuk e luan rolin që i takon. Megjithëse ne nuk vuajmë nga praktikizmi, shokët e shkollës na thonë se mësimet që zhvillohen atje nuk lidhen me praktikën. Parimet e kolektivizimit dhe kriteret e tatimit thuhën pa i ilustruar me shembuj nga jeta jonë, sepse lektorët që punojnë në sektorët e bujqësisë ose të financës nuk shpjegojnë se çfarë të meta ka në praktikën e sektorëve të tyre dhe cila është eksperiencia pozitive. Këtë gjë kërkon Partia jonë. Kështu nxënësit që kryejnë Shkollën e Partisë do të dalin të qartë, do të orientohen drejt në luftë për ndërtimin e socializmit dhe do t'i kuptojnë më shpejt problemet kur të venë në praktikë. Ne i kemi këto mundësi dhe duhet medocemos t'i kthejmë në realitet.

Disa shokë udhëheqës kanë drojtje të venë në Shkollën e Partisë. në shkollat politike, në Universitetin

e natës të marksizëm-leninizmit etj., duke menduar se atje mësimet zhvillohen në një nivel të lartë teorik dhe mund t'u bëhen pyetje për të cilat mendojnë se nuk do të jenë në gjendje të përgjigjen. Një farë sedre të tillë kanë edhe disa sekretarë të komiteteve të Partisë dhe të organizatave bazë. Ata kanë frikë se «do t'u ulet autoriteti në rast se nuk do të përgjigjen drejt»! Kjo gjë duhet luftuar. Sedrën ne duhet ta kemi në rrugë të drejtë. Kjo do të thotë që të mësojmë, sepse Partia na ka ngarkuar një detyrë të rëndë: të mësojmë dhe të edukojmë njerëzit. Partia nuk mund të lejojë një sedër të sëmurë, që dëmton edukimin komunist. Kështu duhet ta kuptojë dhe në këtë mënyrë duhet të veprojë çdo udhëheqës. Rëndësi ka edhe ana tjetër e problemit, që, si në shkollat politike, ashtu edhe në Shkollën e Partisë etj., nuk duhet të mësohet vetëm teoria e lidhur me praktikën, por duhet t'i kushtohet kujdes edhe gjetjes së metodës në të mësuar, sepse ne vuajmë shumë edhe në këtë drejtim.

Edhe studimit individual duhet t'i vihet rëndësi se nuk po ecën si duhet. Bile unë do t'i propozoj Byrosë Politike të marrë edhe disa masa të tjera për këtë problem. Mendoj se nuk është e mjaftueshme që shokët e udhëheqjes të vazhdojnë vetëm disa seminare dhe të mbështetemi vetëm në dëshirën e tyre për të studjuar në shkollë, gjë kjo që është shumë pozitive. Të gjithë duan të venë në shkolla të larta të Partisë e të tjera, po natyrisht, në këtë drejtim ka dhe një farë kufiri, nuk mund të shkojnë të gjithë. Pastaj këto mundësi që ka krijuar Partia këtu, a nuk duhet edhe këto të shfrytëzohen nga kuadrot tanë? Po, duhet edhe këto të

shfrytëzohen. Prandaj në Universitetin e natës të marksizëm-leninizmit duhet të venë për të mësuar edhe nga shokët e Komitetit Qendror, me ta ne mund të bëjmë edhe kurse të veçanta. Kështu mund të themi edhe për sekretarët e komiteteve të Partisë në rrethe e për kadro të tjerë. Pra, t'i shfrytëzojmë të gjitha mundësitë për këtë qëllim. Këtë e them se Komiteti Qendror është edhe përpara vështirësive për t'i zëvendësuar shokët që dërgohen për studime. Shumë shokë bëjnë pyetjen: «A mendon gjë për ne Komiteti Qendror në lidhje me vazhdimin e shkollave?» Komiteti Qendror është përballë kryerjes së shumë detyrave të mëdha dhe në rast se do të kënaqte dëshirat e të gjithë shokëve, atëhere kush do ta udhëhiqte këtu Partinë, pse siç dihet në këto çështje ka edhe plane. U përmendën këtu shumë shokë që ndjekin institutet dhe shumë të tjerë që ndjekin shkolla të tjera pa shkëputje nga puna, ndërsa një pjesë shokësh nuk bëjnë asgjë. Atëhere përse disa ndjekin shkollat dhe disa të tjerë jo? Duket qartë se nuk është vetëm çështja e kohës, që shumë shokë po na e ngrenë me forcë kaq të madhe.

Format e propagandës dhe të edukimit në masë kanë dhënë rezultate të mëdha për Partinë dhe këto rezultate u dukën edhe një herë në zgjedhjet e Frontit, të pushtetit, të gjykatave etj. Vetëm se shpeshherë në konferencat që zhvillohen me masat ka formalizëm e stereotipizëm, nuk preket si duhet realiteti, nuk preken çështjet atje ku i dhëmb popullit, nuk lidhen mirë parimet me problemet që na preokupojnë dhe t'u jepet atyre shpejt rruga e zgjidhjes. Konferencat kanë rëndësi shumë të madhe për edukimin e popullit që ai të ecë në vijën

e Partisë dhe të hidhet si duhet në aksion. Kjo kërkon që të gjithë shokët e Partisë ta kuptojnë mirë rolin e konferencave dhe të mos i quajnë ato si një punë angari që nuk jep frut, që nuk lypin një vëmendje të veçantë, përgatitje të kujdesshme, por vetëm hajde të vete atje dhe të them tri fjalë të thëna e të stërthëna. Një gjë jo pozitive është edhe çështja që zëri i masës në këto konferenca ose informacione politike nuk dëgjohet si duhet. Kritikën e masës disa herë mbyten. Këto dobësi, natyrisht, reflektohen edhe në Parti, ku kritika e auto-kritika nuk janë në shkallën e duhur. Por kjo është akoma më e theksuar në masat dhe ndodh që disa komunistë të mos kuptojnë edhe rolin e tyre të madh për të sqaruar me durim masat. Mendoj se duhet të ndryshojë kuptimi dhe metoda e punës në këtë drejtim, pasi konferencat me popullin janë një nga format e edukimit politik dhe u çelin njerëzve horizonte për të punuar në rrugë të drejtë.

Partia jonë karakterizohet nga durimi, sidomos me masat e popullit. Të tregohet sektarizëm me masat është e palejueshme. Ka komunistë që bëhen nervozë kur populli kërkon shpjegime. Mirëpo shumë njerëz nuk i kuptojnë ato që thotë një konferencier, ka prej tyre që dëgjojnë, heshtin dhe në fund marrin kapelen e ikin. Ti mendon atëherë se gjithshka u sqarua, po je i gabuar. Ka raste që ndonjëri nga masa kërkon të flasë dhe ti e ul duke i thënë se «ti je reaksionar». Është e vërtetë se lufta e klasave ekziston kudo, se ka njerëz që kanë lakra në kokë, por njerëzit e mirë e të ndershëm nuk duhen futur në kallëpin e armiqve. Ka nga masat bile edhe mësues që bëjnë pyetje të natyrshme dhe duhen sqaruar.

Ka gjithashtu raste kur shokut që ka bërë leksionin i thuhet «këtij mos ju përgjigj se nuk është njeri i mirë, pyetjen e bën me qëllim» etj. Le ta bëjë me qëllim pyetjen. Në rast se nuk është njeri i mirë, demaskoje me argumenta në vend, që ta njohë e të bindet dhe masa, po kur bën një pyetje, pse ka nevojë të sqarohet, atëhere shpjegoja, sqaroje. Kështu konferencat janë frutdhënëse dhe të gjalla.

Konferencat me pyetje-përgjigje do të ishin një formë që do t'i nxitin komunistët të mësojnë, do t'i bëjnë ata që të jenë në gjendje t'u japin përgjigje pyetjeve të ndryshme dhe do ta çojnë si duhet në masë zërin e Partisë. Po të veprohet kështu, komunisti do të ketë përgjegjësi të madhe, ai nuk do të vejë në konferencë me duar në xhep. Prandaj të zhvillohen edhe konferenca pyetje-përgjigje. Të gjitha këto që u thanë më lart komitetet e Partisë duhet t'i konsiderojnë si çështje të rëndësishme dhe shumë serioze, por që deri tani nuk ua kanë vënë kujdesin e duhur. Çështja kryesore që thotë Partia është se nuk duhet të udhëheqim nga zyra, por të vemi në bazë për të njohur terrenin, jetën. Njerëzit të mësohen të luftojnë çdo gjë të keqe, bile të inkurajohen nga Partia në këtë drejtim, sepse kështu ajo do të dijë ku u dhemb masave.

Me të drejtë kritikohen ekipet e shumta që dërgohen poshtë, në bazë. Vetë puna konkrete e udhëheqjes dhe e komunistëve që venë në bazë duhet të jetë më e kualifikuar. Të marrim çështjen e seminareve që zhvillohen. Komiteti Qendror ka vendosur që në seminarët me sekretarët e organizatave bazë duhet të vejë sekretari i parë i komitetit të Partisë të rrethit, i cili të

pregatitet me kohë duke mbajtur parasysh gjendjen konkrete të organizatave bazë, si mobilizohen ato, ku janë të metat e tyre, cilët komunistë janë treguar luftëtarë dhe cilët të mefshtë, si është realizuar plani atje dhe si këtu etj. Si të jetë pregatitur mirë, atëhere të vejë në seminar dhe në bazë të të dhënave që ka nga Partia, të ngrejë ato probleme që ai i gjykon se duhet të shtrohen medoemos në seminar. Po sekretari i parë nuk vete në këto forma, sekretari i dytë disa herë nuk vete, por edhe kur vete, nuk shkon i pregatitur si duhet, e t'i shohë gjërat me syrin e një drejtuesi.

Popujt e vendeve të demokracisë popullore dhe populli ynë kanë mundësi të përfitojnë edhe nga eksperiencia e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik për të mësuar marksizëm-leninizmin nëpërmjet gjithë formave të përmendura më sipër. Këtij qëllimi i shërben edhe leximi i literaturës së madhe e të gjerë që botohet në Bashkimin Sovjetik. Kjo literaturë nuk shfrytëzohet sa duhet nga njerëzit tanë. Shumë shokë e quajnë si të tepërt leximin edhe të romaneve, sipas tyre, ai që lexon roman sikur merret me një gjë që nuk ka rëndësi. Mos harroni, shokë, se Marksisi dhe Engelsi nuk linin pa lexuar edhe librat e romancierëve të dëgjuar si Balzak etj. Po kështu edhe Lenini e Stalini. Te dhoma e Stalinit do të gjeje gjithnjë stiva me libra e romane për të cilat jepte dhe mendime. Ai gjente kohë t'i lexonte ato, kurse shumë nga kuadrot tanë nuk e kanë akoma atë dëshirë për leximin dhe shfrytëzimin e librit artistik. Nga ana tjetër, Komiteti Qendror akoma nuk bën si duhet një politikë të drejtë që literatura, e cila botohet te ne, të zgjidhet në përputhje me momentet konkrete të ndërti-

mit të bazave të socializmit në sektorët e ndryshëm. Tok me librat e ndryshme të Marksit dhe të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit, tok me leksionet e materiale të tjera, punonjësit e ndryshëm, njerëzit e Partisë dhe masat e popullit, të kenë edhe romane, edhe literaturë të tillë që do t'ua lehtësojnë studimin e marksizëm-leninizmit. Një seleksionim të tillë në këtë rrugë, Komiteti Qendror akoma nuk e ka vendosur mirë dhe qartë. Ne kemi një shtëpi të botimeve, por mund të them se atje botohet me kritere dhe pa kritere. kjo sjell si pasojë që zgjedhja e librit për botim nuk bëhet mirë dhe popullit nuk i jepet ushqimi i duhur. Te ne po ndërtohen hidrocentrale. Në Bashkimin Sovjetik janë shkruar plot libra dhe romane mbi ndërtime të tilla, ku pasqyrohen të gjitha vështirësitë dhe pengesat që hasen për ditë. Edhe në punën tonë ndeshen të tilla vështirësi. Atëhere, kur ne po ndërtojmë vepra të tilla, përse nuk po përkthehen libra që kanë të bëjnë me to? Po kështu edhe për kolektivizimin mund të përkthehen shumë libra pasi kjo çështje ka rëndësi të madhe dhe propaganda jonë në këtë fushë nuk po bëhet si duhet. Bile kjo propagandë është lënë fare prapa, gjë që ka konsekuenca të këqia për kolektivizimin. Ne parimet i dimë mirë po kur vjen çështja për të ngritur kooperativa bujqësore, bëhen gabime, sepse shkohet ose majtas, ose djathtas dhe më në fund na dhemb koka.

Çështja e forcimit të punës edukative ka rëndësi të madhe, sidomos në fshat. Në qytete ky problem ecën më mirë, por në fshat jemi më dobët dhe këtu puna është më e vështirë. Këtë duhet ta njohim dhe përpjekjet e Partisë duhet të jenë shumë më të mëdha. Të

marrim çështjen e arësimit, të kulturës dhe të artit në fshat. Partia ka krijuar atje mundësi të mëdha për zhvillimin e arësimit, por shfrytëzimi i këtyre mundësive nuk është i plotë. Edhe kontrolli i Partisë mbi këto probleme nuk është në lartësinë e duhur, ndihma e saj në drejtim të shkollave në fshat mund të themi se është lënë pasdore, dhe kjo është e dënueshme. Mësuesve Partia nuk u jep mbështetjen dhe rëndësinë e duhur dhe kjo punë duhet pasur parasysh jo vetëm për mësuesit që janë tanët, të klasës, po edhe për ata që janë të lëkundur, por që ne u kemi besuar këtë mision kaq të madh partie. Ata nuk ndihmohen për t'u edukuar dhe për t'u spastruar. Ata nuk ndihmohen që ta bëjnë shkollën një epiqendër të rëndësishme për zhvillimin e arësimit dhe të kulturës. Mësuesi është personi që merret me këto çështje dhe që ka lidhje të ngushtë me familjet e fshatit, sepse fshatarët i kanë besuar atij edukimin e fëmijëve të tyre. Duhet të formohet kuptimi i drejtë për mësuesin, sepse në mjaft raste duket se nënvleftësohet roli i tij.

Nga ana tjetër komunistët në fshat bëjnë pak përpjekje për ngritjen e tyre kulturele dhe arësimore. Unë nuk do të hyj në detaje, nëse kemi apo nuk kemi bazë materiale, por ato që kemi sikur t'i shfrytëzojmë si duhet, sidomos në fshat, më duket se do të bëjmë një përparim kolosal. Sikur të arrinim që komunistët në fshat, dhe nuk besoj të ketë kundërshtime, të lexonin me vërejtje dhe kujdes «Zërin e Popullit», organin e Komitetit Qendror, sa forca do të kishim ne në fshat, sa lart do të ngrihej ai nga pikëpamja politike dhe kulturele, sa do të nxiteshin njerëzit në punë, sa do të

armatoseshin ata me forca për të kapërcyer vështirësitë dhe sa do të ecte përpara fshati ynë!

Ne flasim kudo për rezervat e brendshme. Të mendojmë sa rezerva ka në Parti, në këta dhjetëra mijëra anëtarë dhe kandidatë partie që e duan Partinë, popullin, marksizëm-leninizmin. Por këto forca të mëdha nuk po e japin rendimentin e duhur në këto çështje. Ne bëjmë një krim të madh që këto rezerva kaq kolosale të mos i shfrytëzojmë dhe të mos i hedhim në luftë. Në shfrytëzimin e këtyre rezervave të mëdha nuk ka pengesa të rëndësishme. Pra, me këto materiale që kemi në rast se Partia përpiket t'i shfrytëzojë si duhet, do të arrijmë përparime më të mëdha. Ne nuk kemi një, po shumë gazeta që mund të shfrytëzohen, vetëm se duhet që edhe ato të përmirësohen. Këto gazeta dhe revista teknike, bujqësore, artistike etj. nuk po shfrytëzohen si duhet nga Partia. Por pse ndodh kështu? Ne më parë duhet t'i vëmë detyrë vetes që ato të shfrytëzohen në maksimum dhe vetëm atëhere do të kemi krijuar mundësitë që t'i plotësojmë shumë mirë këto kërkesa që vijnë nga të katër anët. Është vështirë të plotësohen të tëra nevojat tona, prandaj t'i shfrytëzojmë mirë mundësitë që kemi dhe medoemos rezultatet do të jenë më të mëdha. Kjo punë do të bëjë që tokat të punohen më mirë nga fshatarët, të shfrytëzohet më mirë plehu organik, t'u bëhen bimëve shërbimet kulturale etj. Ata që kanë mbaruar filloren, do të nxiten të vazhdojnë 7-vjeçaren në fshat ose në fshatin e afërt dhe ata që kanë kryer 7-vjeçaren, do të ndjekin të mesmen e kështu me radhë shkollat e larta etj. Si mund të zbatohen metodat agroteknike nga fshatarët në rast se ne nuk kemi batalione

të tëra me njerëz teknikë nëpër fshatra? Por si do të dalin këta njerëz? Këta do të dalin me një organizim të mirë të punës për të ngritur nivelin arësimesor e kulturor të tyre.

Kam përshtypjen se edhe për zhvillimin e artit në fshat ka neglizhenca të palejueshme. Komunistët e fshatit kanë filluar të humbasin shijet e drejta për artin popullor, të humbasin interesimin e duhur për zhvillimin e muzikës, të valleve e të humorit të lartë të popullit. Shpeshherë nuk bëhen përpjekjet e duhura për ta organizuar këtë punë më mirë dhe në mënyrë masive. Unë e di se në rrethe zhvillohen olimpiada ku marrin pjesë njerëz të talentuar nga radhët e popullit, të cilët sillen në qark, bile edhe në Tiranë. Kjo tregon se në fshat ka plot njerëz që i kanë kënduar dhe i këndojnë luftës së popullit, punës, dashurisë për vendin dhe çdo gjëje përparimtare. Populli ynë, që është heroik e punëtor, ndjenjat e tija i ka shfaqur dhe i shfaq edhe nëpërmjet këngëve, valleve, vjershave etj. Me rastet e olimpiadave bëhen konkurse, por kjo punë nuk është e vazhdueshme. Një gjë e tillë duhet të bëhet vazhdimisht dhe jo vetëm me të rinjtë por edhe me pleqtë, me gratë e burrat në fshat. Por këto gjëra nuk bëhen mirë sepse organizimi i punës nga ana e Partisë nuk është në shkallën e duhur. Populli ynë është plot humor, atëhere përse të lëmë dhe të presim që në fshat të shfaqen vetëm skeçe që dërgohen nga lart? Në bazë ka talente për të bërë vjersha të goditura e plot gjëra të tjera, por këto i neglizhojmë dhe nuk i organizojmë si duhet.

Folklori ynë popullor është i pasur, por ne duhet ta zhvillojmë e ta pasurojmë atë më tej nëpërmjet shumë

formave dhe mundësive që kemi. Por kam përshtypjen se në fshat, megjithëse ka shumë mundësi, nuk organizohet si duhet dëfrimi i njerëzve, të cilët kanë nevojë të gëzojnë e të argëtohen. Në fshat ne nuk duhet të kërkojmë vetëm punë, gjithnjë punë dhe detyra, por të organizojmë edhe dëfrimin e fshatarëve, çlodhjen e tyre. Por a ka menduar seriozisht Partia për këtë çështje në fshat? Për çfarë çlodhje, vallë, duhet menduar? Jo për të ndenjtur nën kumbull, por fshatari, kur është koha për të punuar, të punojë, kur është koha për t'u çlodhur, të çlodhet në mënyrë të kulturuar, duke shfrytëzuar ato talente dhe mundësi të mëdha që ka në fshat. Pastaj edhe nga qyteti të dërgojmë ekipe, grupe artistike etj. Po këto gjëra ne nuk i organizojmë si duhet. Unë jam dakord të ngrihen shtëpi leximi në fshat, sigurisht atje ku kemi mundësi. Por në rast se Partia e kupton siç e ka kuptuar deri tani këtë çështje që shtëpia e leximit nuk është gjë tjetër veçse një dhomë e keqe ku janë vendosur pesë libra, nuk kemi gjë në torbë. Pa mendoni pak, si mund të vejë fshatari pas punës në këtë vend që e ka një orë larg nga shtëpia, të futet në një qoshe ku janë vendosur tre libra dhe të lexojë? Në kushtet që janë sot këto shtëpi leximi, fshatari nuk mund të vejë. Shtëpitë e leximit së pari duhet të ngrihen në vendin më të mirë të fshatit, për shembull afër shkollës dhe të bëhen qendra të rëndësishme kulture, duke zëvendësuar sheshin e kishës ku venë rrinë mjaft fshatarë e ku nën hijen e selive kryqi u rri përpara! Në këto qendra kulture, me një program të caktuar të organizohen valle, këngë, t'u bihet veglave muzikore

popullore, të kërcejnë të rinjtë, pleqtë dhe gratë, të organizohen drama e skeçe të vogla humoristike etj.

Ne kemi shumë probleme në fshat në fushën ideologjike si paragjykime fetare, fanatizëm, prapambetje e të tjera. Nuk mjafton të luftojmë vetëm me propagandë dhe me masa administrative, por do të luajnë rol edukativ edhe ai skeçi ose drama e vogël. Për shembull, mund të shkruhet një dramë, tragjedia e së cilës mund t'i ngjasë një fshatari në familje me një vajzë për shkak të prapambetjes dhe fanatizmit. Vënja në skenë në mënyrë marksiste e kësaj ngjarjeje, fshatarin që ka gabuar, do ta bëjë të mendojë thellë e të thotë: pse kam vepruar kështu? Duke parë efektet edukative të një skeçi ose drame teatrale me një ose dy akte, a nuk do të ishte mirë që shkrimtarët tanë, bashkë me romanet me 2-3 vëllime që po shkruajnë, të shkruajnë edhe gjini të vogla, me tematikë aktuale për fshatarin?

I gjithë aktiviteti kultural në fshat të zhvillohet në shtëpitë e leximit ose në vende të përshtatshme për këtë qëllim. Kështu çlodhja do të jetë e organizuar ditën e djelë, ashtu siç e bëjnë punëtorët dhe fshatarëve do t'u bëhet zakon të çlodhen e të shohin konkretisht se si interesohet Partia për t'ua bërë jetën më të bukur. Në këtë mënyrë puna në fshat do të vejë më mirë për tërë javën. Në shtëpitë e leximit të ketë edhe disa romane, atje do të punojë edhe një njeri, po në rast se Partia nuk do t'i japë ndihmë këtij, ai vetëm nuk do të mund ta bëjë punën. Duhet kuptuar mirë se shtëpitë e kulturës luajnë një rol të madh në edukimin e masave të gjera të popullit. Ato vlejné për zhvillimin e arësimit, artit e kulturës. Shteti për to shpenzon shuma

të mëdha të hollash, megjithkëtë ka njerëz që qahen se na mungon kjo ose ajo. Këta i vënë rrotat përpara qerres, por Partia na mëson që të luftojmë me vështirësitë, të jemi kurdoherë krijues, të shfrytëzojmë mirë të gjitha mjetet që kemi.

Komunistët e fshatit, në radhë të parë, duhet të çojnë në këto qendra edukimi e çlodhjeje nënat, gratë dhe motrat e tyre, bile të veshura me rroba të reja, që kjo të bëhet traditë. Këtu duhet të luajë një rol të madh rinia. Por kjo nuk është vetëm çështje e rinisë, pastaj rinia nuk është vetëm për valle e dëfrim, por për punë në radhë të parë. Komiteti Qendror i Rinisë dhe organizatat e Partisë dhe të rinisë në bazë duhet të ruhen nga formalizmi dhe t'i organizojnë konkretisht në vend aktivitetet kulturele. Prandaj shokët drejtues të Partisë dhe të rinisë duhet të venë më shumë në bazë e të ndihmojnë.

Muzika jonë duhet të bazohet në motivet popullore, siç na mëson marksizëm-leninizmi. E tillë duhet të jetë edhe muzika klasike, një muzikë realiste, muzikë e popullit, që të pasqyrojë me tërë madhësinë dhe bukurinë e vet ndjenjat e pastra, luftarake e përparimtare të tij. Muzika e popullit tonë shpreh ndjenjat dhe luftën e tij për liri, për pavarësi dhe socializëm. Ajo na frymëzon dhe na edukon. Me këtë nuk dua të them që muzikantët tanë të nënvleftësojnë muzikën e vendeve të tjera, qoftë muzikën popullore qoftë muzikën klasike të tyre. Fakti është se nga kompozitorët me famë botërore ne kemi dëgjuar disa pjesë të veprave, siç janë ato të Verdit, Leonkavalos, Bizësë, Grigut etj. Por duhet të zbatojmë me përpikëri atë që thotë Marksi që në kulturën borgjeze ka gjëra pozitive që duhet të merren e të perfek-

sionohen, po ka edhe gjëra të tjera që duhen skartuar. Edhe kompozitorët tanë duhet të udhëhiqen nga ky parim.

Instrumentat popullore luajnë një rol të madh për zhvillimin e folklorit dhe për dëfrimin e punonjësve. Janë të drejta kërkesat që bën Partia për shtimin e bazës materiale të kulturës. Ne duhet të kemi më shumë aparate kinemash, violina, mandolina etj., dhe Partia do të bëjë përpjekje që t'i shtojë më shumë këto. Por më duket se nuk vlerësohen, nuk zhvillohen dhe nuk propagandohen sa duhet instrumentat popullore. Bile ka edhe nënvleftësim të tyre. Kjo nuk është e drejtë, përkundrazi është e dënueshme. Ka njerëz që ngrejnë çështjen për të sjellë sa më shumë instrumenta nga jashtë, sikur gjoja pa to, pa pasur fizarmonika etj., nuk mund të ketë kulturë. Instrumentat muzikore që kërkohen janë të nevojshme, po ne kemi mundësi të krijojmë edhe në vend vegla muzikore popullore, pastaj të sjellim edhe më tepër fizarmonika e mandolina. Do të përdorim edhe nga këto instrumenta, por kjo nuk do të thotë që të harrojmë instrumentat popullore, këngët popullore, bejtexhinjtë popullorë, që shprehin ndjenjat e popullit, që përfaqësojnë jetën, luftën dhe diturinë e tij. Mund të na pëlqejë edhe një muzikë e huaj popullore, dhe atë mund ta dëgjojmë, por në radhë të parë ne kemi muzikën tonë popullore dhe do të dëgjojmë melodinë e bukur të saj. Nuk mund të themi se e kuptojmë dhe e ndjejmë më mirë Bizenë se sa Veip ose Selman Qorri¹ në Gjirokastër, që thurin bejte e i

¹ Kështu njiheshin në Gjirokastër Veip Merkuri dhe Selman Koro.

bien cules aq mirë. Ah, sikur t'i dëgjoja një herë ata tani, do të më rrëmbehej zemra! (tani janë plakur, bile njëri edhe ka vdekur). Me këtë melodi jemi rritur. Poeti ynë Naim Frashëri thotë:

«Ku i bjen bariu xhurasë, ku kullosin bagëtia,
Ku mërzen cjapi me zile, atje i kam mendt e mija..»

Një cule e thjeshtë është, por fshatari me të i këndon luftës së popullit tonë, varfërisë së tij dhe urrejtjes kundër beut dhe agait, që e linin pa bukë dhe pa këpuçë. Pra instrumentat popullore ne duhet t'i zgjerojmë në masë dhe po të bëjmë këtë do të shohim sa talente të reja do të dalin nga gjiri i popullit dhe sa dashuri të madhe do të ndjejnë njerëzit për atë gërxxh dhe për atë mal ku kanë lindur e janë rritur.

«Tek Mezhgorani në grykë, Asim Zeneli zë pritë. . .» këndon me dashuri populli ynë. Kjo këngë tregon luftën e popullit për të çliruar atdheun. Kësaj kënge të bukur ja merr ai tjetri me cule. Këto vjersha dhe këngë të gjithë ne i kuptojmë më mirë se sa Vagnerin. Ndoshta disa nga ne mund ta kuptojnë Vagnerin pasi dimë historinë e popullit gjerman, kemi lexuar edhe disa romane ku është mbështetur ai për hartimin e veprës së tij, dimë edhe pikëpamjet e tija që i kemi lexuar në kritikë e bëra. Gjithashtu dimë se Hitleri e bëri muzikën e Vagnerit muzikën e preferuar të kohës së vet sepse në shumë pjesë të veprës së Vagnerit përfaqësohet pesimizmi i Shopenhauerit. Por te Vagneri ka edhe anë pozitive e revolucionare, prandaj njerëzit tanë që mërrren me kulturë duhet t'i studjojnë dhe t'i njohin mirë

këto gjëra, se disa që kanë studjuar në Perëndim, fluturojnë e rrëmbehen nga muzika e huaj. Verdi a Vagneri, Bethoveni a Shopëni kanë vendin e tyre në artin botëror, por kjo nuk do të thotë që të nënvleftësojmë muzikën tonë popullore. Të gjithë kolosët e njohur të muzikës klasike janë mbështetur e janë frymëzuar nga historia e folklori i popujve të tyre.

Duke qëndruar kurdoherë në çështjen e folklorit dhe të muzikës popullore mendoj se përveç arsyeve të tjera, ne vetë po fenojmë zhvillimin e tyre me një kontroll të tepruar nga ana e Drejtorisë së agjitacionit dhe të propagandës në aparatine Komitetit Qendror dhe me një farë qëndrimi sektar të palejueshëm. Ne kërkojmë që folklori, këngët dhe vallet tona, të drejtohen në mënyrë strikte, me disa kuadro të paktë që nuk e kanë nivelin e nevojshëm kultural dhe që kanë pikëpamje jo shumë të drejta në lidhje me zhvillimin e artit, të muzikës dhe të kulturës sonë. Krijimet e një-rëzve të popullit që mbështeten në kulturën dhe në folklorin popullor, mund të mos jenë aq të perfeksionuara nga ana artistike, por nuk janë të gabuara në përmbajtje. Do të vijë koha që të ketë më shumë art në krijimet popullore dhe t'i stilizojmë ashtu si duhet krijimet e këtyre muzikantëve, që kanë anët e tyre të mira dhe të dobëta. Pastaj është edhe çështja që të mos jemi sektarë e lokalistë në vlerësimin e folklorit të krahinave duke thënë, për shembull «këngët labe janë monotone», «kjo muzikë ka një notë dhe ajo tjetra ka dy nota» etj. Nganjëherë këto fjalë thuhën si me shaka, por ka në to një dozë të nënvleftësimit të krijimtarisë popullore.

Njerëzit e Partisë sonë dhe veçanërisht ata që merren me artin dhe muzikën duhet ta analizojnë mirë punën në këtë front ideologjik. Shokët e Drejtorisë së agjit-propit nuk është e domosdoshme që këto gjëra t'i studjojnë në detaje, as nuk pretendoj e të them që të bëhen pianistë ose violinistë, por të orientohen nga teoria marksiste-leniniste e të interesohen më mirë për artin dhe muzikën. Dhe, për të marrë vesh muzikën, natyrisht duhet medoemos të stërvitësh edhe veshin.

Ne kemi një pjesë të vogël që kanë mësuar në konservatoret e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore, të cilët janë pajisur me një kulturë të lartë muzikore dhe kanë mësuar rrugën e muzikës ruse dhe sovjetike, kemi edhe njerëz të tjerë që kanë një farë kulture muzikore, por që kjo kulturë është borgjeze dhe duhet spastruar në rrugën e edukimit ideologjik. Natyrisht kjo nuk është për fajin e tyre, por faktet janë fakte. Kompozitorët tanë që kanë mësuar në Francë, në Itali, në Gjermani etj, të edukohen në çdo drejtim. Gjatë këtyre kohëve muzika në perëndim është zhvilluar në mënyrë të shturur, është zhvilluar sidomos muzika dekadente. Atje jepen pjesë nga kompozitorë të mëdhenj, por jepet edhe muzikë nga kompozitorë të tjerë që nuk vlejnë dhe kjo është një nga arësyet që ka një shturje në njerëzit e artit muzikor. Ndonjë nga kompozitorët tanë mund të flasë për «Karmenin» e Bizosë, për teknikën e lartë të kësaj vepre se gjoja e kupton atë etj, por çështja është që ta kuptojë nga ana ideologjike, të kuptojë luftën e popullit heroik spanjoll, që është vrarë e therur kundër reaksionit. Ose të marrim Verdin. Ndonjëri mund të

thotë se e kupton muzikën e Verdit, por e ka vështirë të depërtojë në thelbin ideologjik të saj, që është frymëzuar nga lufta e popullit italian për bashkimin kombëtar, kundër okupatorëve austriakë, është frymëzuar nga historia e lëvizjes çlirimtare të popullit italian. Kompozitorët tanë duhet të ushqehen me ideologjinë tonë revolucionare mbi muzikën, të brumosen në forma të ndryshme, të edukohen me frymën marksiste-leniniste për kuptimin e drejtë të muzikës lidhur me ngjarjet e popullit, me shkaqet që kanë bërë të lindë kjo muzikë, në mënyrë që ata të spastrojnë kokën e tyre nga pikëpamjet e vjetra dhe t'i shohin gjërat nën prizmin e marksizëm-leninizmit. Ndryshe, do të jetë e vështirë që këta njerëz të muzikës të ecin përpara. Njerëzit tanë që kanë kryer studimet në Bashkimin Sovjetik për muzikë dhe për artet e tjera, të punojnë drejt dhe me modesti me këta njerëz, ashtu sikurse është populli ynë. Këtë nuk e them për të dekurajuar shokët dhe njerëzit që kanë mësuar muzikën, por vihet re se në ta ka disa shfaqje megalomanie.

Partia t'i ketë në kujdes njerëzit e muzikës dhe të shkencave, të cilëve u ka dhënë mundësi të pajisen me shkencën dhe artin më të përparuar në bótë dhe pret shumë prej tyre. Kur kthehen në atdhe këta njerëz duhet të mendojnë detyrat që kanë ndaj popullit dhe Partisë. Ata duhet të kenë gjithashtu konsideratë për njerëzit që, megjithëse nuk kanë bërë shkollat e tyre, përpiqen të zhvillohen. Prandaj të mos i quajnë ata injorantë dhe t'i lënë mënjane, të mos jenë sektarë me ta. Njerëzit tanë duhet të futen mirë në botën e tyre dhe të bëjnë që ata vetë të kuptojnë se çfarë duhet

pastruar nga bagazhi që kanë, t'i bindin që të zotërojnë marksizëm-leninizmin në terrenin e tyre, në muzikë dhe në art. Këtë ne duhet ta bëjmë se ka raste që edhe folklorin, këtë pasuri të madhe të popullit, ata e deformatojnë, futin në të tona që nuk janë karakteristika të muzikës përparimtare, përkundrazi të muzikës dekadente dhe bëjnë kështu, dashur pa dashur, shtrembërime të palejueshme. Jam dakord që shumë gjëra duhet të përpunohen, por motivet e rëndësishme të ruhen. Këtë gjë ne duhet ta shohim me kujdes edhe në kostumet kombëtare, ku është e domosdoshme gjithashtu të ruhen motivet popullore të thjeshta dhe të bukura dhe mos të kërkojmë format e komplikuar të veshjeve të huaja.

Partia jonë duhet të punojë si në të gjithë sektorët e tjerë, ashtu edhe me elementët që kanë një farë kulture borgjeze. Këta njerëz nuk duhen nëvleftësuar ose sikterisur, siç veprojnë disa shokë, sepse këta intelektualë ose artistë janë vërtet elementë të klasave borgjeze dhe pikëpamjet e tyre i përhapin në shtresat e tjera, por duke i edukuar me frymën e Partisë, ata tërhiqen në shërbim të popullit, të klasës punëtore. Po nuk vepruam kështu, atëherë u kemi hapur rrugën pikëpamjeve borgjeze në shtresat e tjera. Shtresat e mesme dhe të varfëra nuk janë të ndara me ndonjë mur prej hekuri dhe, pikëpamjet që thithin ata, kalojnë edhe në radhët e Partisë sonë. Prandaj Partia t'i analizojë mirë këto gjëra dhe të marrë masa të përshtatshme për t'i ngritur këta njerëz nga ana ideologjike dhe profesionale.

Këto gjëra duhet të zhvillohen me kujdes dhe në rrugë të drejtë. Partia ka një barrë të rëndë në këtë drejtim. Interesi i Partisë sonë, interesi i ndërtimit të

socializmit në vendin tonë është që kultura të zhvillohet në masë, në bazë të ideve të marksizmit, sipas të cilave në shoqërinë komuniste nuk duhet të ketë njerëz që të merren tërë jetën me një profesion, që njeriu duhet të dijë, ta zëmë, edhe nga letërsia, muzika dhe piktura.

Desha të ndalesha pak edhe në çështjen e letërsisë. Në këtë lëmë, ashtu sikurse edhe në artet e tjera dhe në muzikë duhet të bazohemi kryesisht në zhvillimin e kulturës popullore, të ngremë lart dhe të vëmë mirë në dukje vlerat e popullit tonë, të vëmë në dukje të tëra anët pozitive të kulturës sonë popullore, vlerat e shkrimtarëve tanë të vjetër dhe të rinj dhe këto të bëhen pasuri e gjallë e popullit tonë. Në këtë drejtim kemi ngurtësi të madhe, kemi neglizhenca të palejueshme, nënçështim dhe shumë herë pikëpamje të gabuara në vlerësimin e disa gjërave.

Kultura, arti dhe letërsia të ne janë ato pasuri që do të farkëtojnë njerëzit e rinj të Shqipërisë së re. Partia jonë ka bërë mjaft në këtë drejtim. Por kërkohet të luftojmë akoma më shumë. Rezulton se edhe në këtë front kaq të rëndësishëm ka njerëz me parti dhe pa parti që kanë marrë kulturë borgjeze të vendeve të ndryshme. Detyra jonë është që, me një punë të vazhdueshme, të bëhet një pastrim dhe riedukim i tyre në radhë të parë i komunistëve. Ky është një front. Fronti tjetër më i rëndësishëm për Partinë është ai që vetë masat e popullit të edukohen me kulturë të shëndoshë, të pastër dhe të bazuar në marksizëm-leninizmin. Partia duhet të mendojë seriozisht që në këtë tokë të virgjër të ngulen bimë të shëndosha. Që këto bimë dhe pemë me lule të mbijnë si duhet, është detyra e Partisë që t'i armatosë

me marksizëm-leninizmin njerëzit që kanë mësuar në shkollën borgjeze, të cilët, duke qenë të spastruar, të luftojnë në lëmin e letërsisë. Duke punuar për të zbatuar drejt vijën e Partisë dhe duke u mbajtur afër, mendja e tyre do të spastrohet sa të jetë e mundur më shumë nga mbeturinat e kulturës borgjeze, pse asnjëri nuk mund t'i shpëtojë presionit të kësaj kulture. Do të ishte shumë e gabuar që ne t'u mbyllim dyert elementëve përparimtarë që kanë kryer shkollat në vendet e Perëndimit. Ne duhet t'u bëjmë kritikën në rrugën marksiste-leniniste veprave të letërsisë botërore, me qëllim që të dihen se cilat janë anët e mira që duhet të marrim e cilat janë anët negative, që duhet t'u biem me sopatë të madhe, t'i godasim. Këtë e them se ka rëndësi pasi autorë të huaj lexohen jo vetëm nga ata që kanë mbaruar shkollën e vjetër, por edhe nga të rinjtë e sotshëm, të cilët, duke mësuar në shkollën e re, lexojnë jo vetëm Gorkin e Majakovskin, por edhe Shekspirin, Hygonë, Rolandin etj.

Krahas intelektualëve të vjetër që janë të shëndoshë, ka edhe disa prej tyre që rrinë të mbyllur dhe, gjithë kulturën borgjeze, kush më shumë e kush më pak e kanë në kokë, pra këta nuk janë me ne ideologjikisht, po kanë edhe shumë frikë të shfaqin sheshit pikëpamjet e tyre. Po të fillohet të diskutohet me ta, krijohet menjëherë një ftohtësi e madhe ndaj tyre dhe ata nuk guxojnë të zënë në gojë as kulturën franceze as kulturën italiane, se druhen se mos goditen me masa administrative. Njerëzit e aftë dhe të pregatitur të Partisë të futen në terrenin e tyre, ta ndryshojnë situatën

dhe t'i ngrenë në këmbë këta njerëz, me të cilët duhet një punë shumë e durueshme.

Që njerëzit tanë të mos gabojnë, sidomos ata që punojnë në frontin ideologjik e kultural, duhet të armatosen në radhë të parë me marksizëm-leninizmin, që do t'i orientojë në punën dhe në veprat e tyre si një busull e vërtetë. Armatosjen me idetë e marksizëm-leninizmit duhet ta bëjnë edhe të gjithë shokët e Partisë, veçanërisht ata që merren me agjit-propin, me drejtimin e Partisë etj, të cilët studimin me këmbëngulje dhe durim duhet ta kenë detyrë të dorës së parë.

Libra për të studjuar ka plot. Natyrisht ne duhet të përkthejmë edhe të tjera e të botojmë më shumë, por mendoj që në planet e botimit të librave të zënë vend më mirë ato vepra që do të na duhen për të sqaruar njerëzit tanë dhe që ndezin në zemrat e tyre dashurinë për punën dhe për popullin. Ne kaq i kemi mundësitë në sektorin e botimeve, vetëm se duhen zgjedhur mirë ato vepra të huaja që do të botohen dhe kjo të bëhet sipas një plani të studjuar në çdo lëmë të aktivitetit, si për libra artistike, ashtu dhe për libra tekniko-shkencore etj. Secili kërkon që në sektorin e vet të ketë sa më shumë botime, por duhet mbajtur parasysh se kjo nuk bëhet dot menjëherë. Kur këto plane bëhen të pastudjuara, atëhere rezultatet janë të pakta. Shpeshherë në vend që të sillen nga jashtë gjëra që sot janë shumë të nevojshme, sillen shumë nga ato, për të cilat hëpërhë nuk ndihet nevoja. Kështu mund të themi edhe për botimet. Në këto çështje duhet të mos tërhiqemi nga megalomania, por çdo gjë të bëhet e studjuar e të mos ngutemi. Kultura dhe shkenca

janë një pus pa fund ku sa më shumë të mësosh, aq më tepër të duket se di pak.

Përsa u përket shkrimeve tona popullore dhe folkloristike mua më duket se puna që është bërë e po bëhet është e mirë, por kjo pasuri nuk shfrytëzohet sa duhet. Dhe kur ne pyesim se ç'po bëhet në këtë fushë, na thuhet se me këto probleme merret Instituti i shkencave. Mirë Instituti i shkencave, por a interesohet për këto probleme Drejtoria e agjitacionit dhe e propagandës? Jo, nuk interesohet. Këto shkrime janë një thesar i madh për historinë, për gjuhën dhe zakonet e popullit tonë, por thesar që qëndron i fjetur. Këtu nuk është vetëm çështja që këto shkrime nuk botohen, sepse shfrytëzimi i tyre mund të bëhet në mënyrë të shuman-shme, puna është se për këto probleme nuk ka një drejtim të shëndoshë nga Partia. Por nuk është vetëm kjo. Pas çlirimit është mbledhur shumë nga folklori i popullit në vendin tonë. Por ç'po bëhet me librat që kanë punuar të tjerët në regjimet e kaluara, megjithëse shumë prej tyre kanë qenë armiq të vendit tonë, por që i kanë mbledhur këto pasuri me vlerë të madhe siç janë «Visaret e kombit» që përbëhet nga 6 vëllime? Vjershat që janë botuar në këto vëllime pavarësisht se kush i ka mbledhur, duhen krasitur, duhen studjuar dhe duhen komentuar. «Bleta» e Thimi Mitkos, që ka një rëndësi aq të madhe, është mbuluar nga pluhuri. Pse t'i neglizhojmë këto pasuri? Pavarësisht se kush i ka mbledhur, ato janë të popullit, me to do të frymëzohen për të kaluarën e lavdishme të popullit njerëzit dhe rinia jonë. Këto gjëra nuk shihen si duhet me sy të drejtë dhe nuk shfrytëzohen.

Me shumë kujdes duhen parë shkrimet e vjetra dhe gazetat. Kohët e fundit u nxorën prej tyre çështje me shumë rëndësi, siç janë qëndrimet e disa patriotëve tanë për revolucionin e vitit 1905 në Rusi dhe për Leninin. Të mos mendohet se puna mbaroi me kaq, pse në to mund të ketë akoma shumë gjëra të bukura dhe kjo është e kuptueshme, pasi në atë kohë ka pasur një shpërthim të popullit tonë në drejtim të rrugës demokratiko-borgjeze. Njerëz përparimtarë të asaj kohe kanë shkruar, por ka nga këto shkrime që janë në duart e privatëve, janë akoma të pabotuara. Ato përbëjnë një thesar të madh të popullit tonë. Ministria e Arësimit dhe Instituti i shkencave duhet të mendojnë për këto, t'i mbledhin, t'i ruajnë dhe, ato që janë të mira, t'i jepen popullit t'i mësojë. Këto janë të nevojshme të bëhen sepse historia e popullit shqiptar nuk është historia e disa viteve, po është historia e një jete të tërë, gjatë së cilës kanë luftuar bijtë e popullit shqiptar që kanë ndihmuar për të krijuar historinë e popullit me anët pozitive dhe negative, të cilat Partia duhet t'i vërë në dukje medoemos. Kjo është një fushë e gjerë.

Përsa i përket çështjes së shkrimtarëve, them se të gjithë ne, anëtarët e Komitetit Qendror, anëtarët e Byrosë Politike dhe të Sekretariatit, jemi dakord që ata të ndihmohen sa të jetë e mundur më shumë, sepse shkrimtari është ai që me krijimet e tij do të ndihmojë fuqimisht në kalitjen dhe në edukimin e njerëzve. Shkrimtarëve kjo ndihmë nuk do t'u mungojë nga Partia, bile do t'u shtohet akoma më shumë. Shkrimtarët tanë duhet të bëhen të denjë për misionin e lartë që u ka ngarkuar Partia. Komunistët, që punojnë në Lidh-

jen e Shkrimtarëve, përpara se të bisedojnë për anën ekonomike, që edhe kjo ka rëndësi dhe ne duhet t'i ndihmojmë, është e domosdoshme të ngrenë çështjen e forcimit të ndërgjegjes, të kalitjes dhe të edukimit të tyre në frymën e Partisë. Shkrimtarët tanë janë me qëndrim të shëndoshë, por në radhët e tyre ka edhe njerëz me mbeturina të theksuara mikroborgjeze. Këtë e them jo vetëm për njerëzit pa parti, po edhe për komunistët. Disa i trashëgojnë këto mbeturina jo për fajin e tyre, por nga jeta që kanë bërë në të kaluarën, nga kultura që kanë marrë. Kritika dhe autokritika, shtruarja drejt e problemeve, ndihma që duhet të japin shumë prej tyre për diletantët, shkrimtarët e rinj etj., duhet të zhvillohen vazhdimisht. Ka në shkrimtarët tanë nga ata që mendojnë më shumë si do të pritët nga shokët vepra e tyre, se sa të mendojnë si të luftohet dhe të punohet më mirë që me veprat e tyre t'i shërbehet ndërtimit të socializmit. Ata që mendojnë kështu duhet ta ndryshojnë mendimin, veprimin dhe metodën e punës, të mos mbyllën në vetëvete, po të venë në masat e popullit, të lidhen ngushtë me luftën e tij heroike për ndërtimin e jetës së re. Vetëm kështu veprat e tyre mund të jenë realiste, marksiste-leniniste.

Debati, kritika dhe autokritika në fushën e letërsisë kanë shumë rëndësi. E them këtë se ka raste që, kur zhvillohet kritika, disa shkrimtarë preken ose midis tyre ekziston mendimi i gabuar «mos më kritiko, që dhe unë mos të të kritikoj». Këto qëndrime s'janë të drejta. Në këtë drejtim të ndihmojë edhe organizata e Partisë, jeta e së cilës duhet të gjallërohet dhe puna

ideologjike e saj dhe e Komitetit të Partisë të Tiranës, të përmirësohet.

Kanë bërë mirë disa shkrimtarë që kanë shkruar edhe gjashtë muaj në terren për ta njohur jetën e fshatarit, për t'u frymëzuar e për të krijuar. Këtë iniciativë ta thellojmë e ta vazhdojmë më shumë. Të mos çuditet ndonjëri edhe nga ndonjë pyetje, siç ka ndodhur në Peshkopi, ku fshatarët kanë dashur të dinë se ç'është atomi. Fshatari, duke marrë parasysh se shkrimtari është njeri i ditur, do të bëjë edhe pyetje të tilla. Punën, jetën, botën e tij shpirtërore duhet ta shikojmë ashtu siç është. Të mësojmë prej tyre dhe t'i mësojmë ata, kështu na porosit Partia. Por kjo s'bëhet me një vizitë shpejt e shpejt. Të njohësh realitetin, karakterin e punëtorit ose të fshatarit, kjo kërkon kohë, pikësynime të qarta, përpjekje, shkrirje me popullin. Në rast se nuk bën dot punë zyre, futu po deshe në kooperativën bujqësore, bëhu edhe anëtar i saj në goftë se ke në mendje që për një vit ose për dy të nxjerrësh një libër të bukur.

Janë shkruar romane ose libra të bukura, siç janë ato të Dhimitër Shuteriqit, të Fatmir Gjatës, të Sterjo Spases etj. Për veprat e tyre këta shkrimtarë duhen inkurajuar dhe përgëzuar. Po, shokë, te ne ka talente që rriten e ngrihen vazhdimisht duke u frymëzuar andej nga është burimi i madh — nga populli. Për shkrimtarët tanë është nder i madh të preokupohen shumë për talentet e reja. Çdo shkrimtar të ketë kënaqësi të madhe kur ndihmon dhe ngre dy-tre shkrimtarë të rinj. Kjo është rruga më e drejtë që duhet ndjekur. Lidhja e Shkrimtarëve duhet ta kuptojë drejt këtë

çështje. Lidhjes së Shkrimtarëve nuk duhet t'i lejohet e drejta që veprat e reja të shkrimtarëve të rinj, pa kaluar atje, të mos botohen. Jo. Shkrimtarët e afirmuar e kanë për detyrë t'i ndihmojnë shkrimtarët e rinj, por ata nuk kanë asnjë të drejtë që kjo ose ajo vepër të mos shtypet. Ndërmarrja e botimeve le ta botojë veprën e një shkrimtari. Më vonë, po të ketë ndonjë kritikë nga Partia ose nga Lidhja e Shkrimtarëve le t'ja bëjnë veprës. Në rast se do të veprohet si deri tani do të jetë një frenim për zhvillimin e letërsisë dhe të talenteve të reja.

Shkrimtarët e afirmuar, që kanë mundësi të japin më shumë, mund edhe t'i lehtësojmë pak, por sot për sot nuk jemi dakord me një propozim që na ka ardhur, sipas të cilit janë krijuar kushtet që ata të bëhen shkrimtarë profesionistë, të jenë të lirë nga çdo punë tjetër. Nuk është e drejtë pikëpamja që njerëzit e krijimtarisë letrare e artistike të shkëputen nga aktivitetet arësimore, kulturele e shoqërore e të merren vetëm me krijimet e tyre. Ata duhet t'i ndihmojmë në forma të ndryshme, t'i ndihmojmë edhe për çështjen e fondit letraro-artistik, por jo ashtu si mendojnë disa, që qeveria të vërë disa milion lekë dhe kur të kenë nevojë shkrimtarët, të marrin sa u duhet. Por duhet që edhe vetë shkrimtarët të kontribuojnë në këtë fond e njëkohësisht të ndihmojë edhe qeveria. Shteti do t'i ndihmojë shkrimtarët, por në rrugë të drejtë, sipas kushteve dhe mundësive tona. Vetë shkrimtarët të ndihmojnë për krijimin e këtij fondi dhe këto fonde të përdoren mirë, sepse kemi akoma shumë të meta dhe interesat e popullit nuk shihen si duhet, bile ka njerëz që thonë «mall

shteti është ky», «le ta marrin», prandaj edhe në radhët e shkrimtarëve duhet të krijohet një kuptim i drejtë për pasurinë e shtetit, që është e të gjithë popullit.

Ose le të marrim problemin e monumenteve të lashta dhe të reja. Për këto thesare nuk ka dhe aq interesim. Ky është një krim që i bëhet popullit dhe pasurisë së tij. Po të jetë se pengojnë fondet, fonde mund të jepen dhe të shtohen, por rëndësi të madhe ka, në radhë të parë, interesimi i njerëzve të Partisë për këto pasuri me kaq vlerë të madhe. Njeriu që është atje në Butrint, të jetë i atillë që të kuptojë sa rëndësi të madhe kanë për vendin tonë ato monumente të lashta, kështu edhe ai që qëndron në Pojan, në Muzeumin arkeologjik dhe etnografik të Tiranës etj. Në kalatë e vjetra po shkatërrohen muret, jo vetëm nga natyra, po edhe nga disa njerëz të pandërgjegjshëm. Ndër ta ka edhe të tillë që po prishin edhe monumentet e vorrezave ose vijat artistike të ndërtesave tona, që tregojnë shijen dhe guston artistike të popullit tonë në shekuj. Këto gjëra te ne vazhdojnë akoma të nënvlef-tësohen. Por a është i drejtë një qëndrim i tillë? Jo, nuk është i drejtë. Të gjitha këto hyjnë në pasurinë e madhe të kulturës së lashtë të popullit tonë. Prandaj ato jo vetëm duhet të mbahen mirë, por edhe të shfrytëzohen për të edukuar njerëzit dhe të ngjallet në popull dashuria për to, në mënyrë që mos të jetë më nevoja të mbrohen nga një roje, por vetë populli t'i ruajë si sytë e ballit. T'i edukojmë njerëzit me këtë kujdes, sepse ky është një mjet për të çelnikosur dashurinë e popullit për atdheun e tij, për «gurët e thatë», që thotë populli, për kalatë, ku është derdhur gjaku i

tij. Kur t'i shpjegohen mirë popullit këto gjëra, atij do t'i hyjë medoemos dashuria për to.

Për të gjitha këto çështje materiale dhe teknike, sikurse thuhet në raport, ka pasur nënvleftësim nga Byroja Politike dhe nga qeveria. Në planin e vitit 1955 dhe në planin e dytë pesëvjeçar këto gabime nuk do të përsëriten më, por do të shihen më mirë, më drejt, llogaritë do të bëhen më të studjuara, pra më të mira. Po të veprohet kështu, do të kemi fitime të mëdha në edukimin e njerëzve dhe të ekonomisë sonë. Ne do të bëjmë gjithshka të mundshme edhe për sektorin ideologjik e kultural, por jo jashtë mundësive dhe llogarive. Me masat që do të marrim, me shfrytëzimin e mjeteve që kemi, me shfrytëzimin e madh të rezervave si dhe shfrytëzimin e mundësive të brendshme, do të bëhen shumë gjëra më tepër dhe ne do t'i japim kështu një hov më të madh zhvillimit të muzikës, të artit, të letërsisë dhe në radhë të parë do të forcojmë punën për përvetësimin e marksizëm-leninizmit, për edukimin dhe kalitjen e njerëzve tanë në këtë fushë.

Lufta e Partisë tregon se ka njerëz që bëjnë gabime, bile dhe i përsëritin, gjë kjo që është shumë e keqe. Partia duhet të luftojë me këmbëngulje dhe me durim të madh, në rrugë të drejtë që gabimet të mos përsëriten. Të metat dhe gabimet në fushën e edukimit ideologjik na kushtojnë shtrenjt. Mos të harrojmë momentet ndër-kombëtare, përgatitjet për luftë nga ana e imperialistëve, kërcënimet që i kanosen botës nga një luftë e re botërore, gjatë përgatitjeve të së cilës armiku do të përdorë mjete të mëdha propagandistike për të krijuar konfuzion në vendet e kampit tonë. Përveç përgatitjeve

për luftë, imperialistët po përpiqen dhe do të përpiqen të krijojnë konfuzion për të prishur unitetin e popullit rreth Partisë sonë, për të çarë unitetin e Partisë, ata përpiqen vazhdimisht të thyejnë unitetin e udhëheqjes në forma të ndryshme, të hapëta ose të fshehta etj. Pra, që të përballojë Partia këto situata duhet ta shtojë në kulm vigjilencën dhe të armatoset mirë edhe nga ana ideologjike.

Situata e brendshme dhe e jashtme e vendit tonë po forcohet. Burimi i forcës së popullit tonë dhe i situatës së qëndrueshme që është krijuar te ne është politika e drejtë e Partisë sonë, puna heroike e popullit tonë. Por në këtë situatë kaq të favorshme Partia duhet të mendojë që ka edhe detyra të mëdha. Për këtë ne duhet të jemi plotësisht të ndërgjegjshëm, prandaj ta forcojmë për ditë e më shumë situatën e brendshme me të gjitha mundësitë që kemi. Të forcojmë të gjithë sektorët e aktivitetit tonë ekonomik, kultural, ushtarak dhe të sigurimit të vendit tonë. Të tëra këto aktivitete të udhëhiqen direkt nga Partia me një vigjilencë të shumëfishuar, me kokë e jo në mënyrë spontane siç ndodh ndonjëherë, sepse kemi përgjegjësi të madhe.

Gjithashtu një përgjegjësi shumë të madhe kemi ne për ruajtjen e unitetit të Partisë dhe të pastërtisë së radhëve të saja. Sa të jetë e mundur duhet të çelmosim bashkimin e popullit tonë në rrugën e Partisë dhe të luftojmë me vendosmëri për të kryer të gjitha detyrat që na vihen përpara nga Komiteti Qendror. Në radhë të parë ne udhëheqësit jemi përgjegjësit kryesorë për kryerjen e këtyre detyrave, sepse njerëzit e bazës kërkojnë ndihmën tonë, e cila nuk mund të jepet me paru-

lla. Kjo ndihmë duhet të jetë konkrete dhe që të jepet si duhet, është e domosdoshme që ne të mësojmë për ditë dhe të luftojmë, të luftojmë dhe të mësojmë. Të gjitha këto detyra duhen kombinuar në mënyrë të harmonishme dhe në radhë të parë të kemi parasysh forcimin e vigjilencës në gjirin e Partisë.

Të hidhemi tani pak në çështjen e shokut Tuk Jakova¹.

Natyrisht, çështja e Tukut duket sikur erdhi në mënyrë të papritur, kështu u tha këtu nga disa shokë. Por nuk është e drejtë të thuhet se erdhi si e papritur, sepse shoku Tuk nuk është hera e parë që gabon në vijën e Partisë. Kjo është e dyta dhe e treta herë dhe vazhdimisht ai ka gabuar nga e djathta. Ne, anëtarët e Byrosë Politike, mendojmë se Tuku gabon rëndë në të gjitha çështjet që ngriti përpara këtij plenumi me anën e diskutimit të tij. Ato nuk janë në rrugën marksiste-leniniste, por në rrugën e kundërt me vijën e Partisë.

Le t'i analizojmë një e nga një çështjet që ngriti ai përpara këtij plenumi.

Të gjitha çështjet që ngriti Tuku janë të lidhura me njëra-tjetrën, ato janë një vijë, si një zinxhir i vetëm e i përshton të tëra një pikëpamje.

Ai ngriti këtu çështjen e grupeve komuniste dhe kërkoi nga Byroja Politike e nga Plenumi i Komitetit Qendror që kjo çështje të rishikohet pasi, sipas tij, «po

¹ Shih këtë vëllim faqe 335 ku analizohet gjerësisht veprimtaria armiqësore e Tuk Jakovës.

bëhen gabime, po kritikohen njerëz, po shtrembërohet çështja e grupeve» etj., etj.

Tani unë nuk do të futem me hollësi në çështjen e grupeve, sepse Partia e ka të qartë këtë gjë dhe qysh me kohë e ka analizuar drejt. Analiza që i është bërë punës së grupeve që 14 vjet përpara, lufta e Partisë me armë dhe lufta që bëhet sot për ndërtimin e bazave të socializmit, tregon e vërteton përcaktimin e drejtë që u ishte bërë nga Partia jonë karakteristikave të grupeve. Në kohën e luftës, vetëm në momentet e para flitej për çështjen e grupeve, po pastaj nuk u fol më dhe, për 10 vjet të tëra, as që është ngritur fare ky problem, as që e ka preokupuar fare Partinë një gjë e tillë.

Jeta ka vërtetuar drejtësinë e përcaktimit që bëri Partia për grupet. Tani, pas 14 vjetësh shoku Tuk e dëgjojmë ta ngrejë këtë çështje dhe kërkon që Partia të preokupohet pikërisht në këto momente të rëndësishme të jetës së saj, kur ajo ka përpara detyra kaq të mëdha dhe kolosale. Ai e kërkon një gjë të tillë në mënyrë revizioniste, ai don që të rikthehemi në punën fraksioniste të ish-grupeve komuniste dhe të shohim nëse ishte apo nuk ishte e drejtë puna e tyre. Ky njeri kërkon të peshojë me zigj në se puna ime apo e jotja është matur mirë, megjithëse dihet që pesha e çdo njeriu përcaktohet nga aktiviteti i secilit. Pra, në këto momente kaq të rëndësishme shoku Tuk kërkon të bëjë problem një çështje që nuk është problem, sepse Partia e ka zgjidhur drejt me kohë. Qëllimi i tij është të krijojë në Parti konfuzion, të preokupojë njerëzit e Partisë me çështjen e grupeve, ta futë Partinë në qorr-sokak, të revizionojë vijën e Partisë.

Shoku Tuk i ngriti çështjet këtu me një ton serioz dhe shumë të vendosur, gjë që tregon se te ai kjo nuk është e rastit. Prandaj ne mendojmë se ky është një akt diversioni, për të çorientuar Partinë, për të krijuar ngatërresa, që Partia të rikthehet në çështjet e kaluara, të cilat ajo i ka zgjidhur një herë e mirë dhe të krijohet kështu një gjendje e vështirë për Partinë. Kjo është një rrugë antiparti.

Të vijnë tani në çështjen e udhëheqjes së Partisë. Çështja që ngriti Tuku ka për qëllim ta thyejë unitetin e udhëheqjes së Partisë. Pikësëpari Tuku kërkon të akuzojë udhëheqjen e Partisë se gjoja nuk është internacionaliste dhe konsekuente ndaj Miladin Popoviçit. Por udhëheqja e Partisë sonë është treguar plotësisht internacionaliste ndaj Miladin Popoviçit, bile në momentet më kritike të jetës së Partisë, në kohën kur po demaskohej klika titiste. Tuku e di fare mirë se në çështjen e Miladin Popoviçit kjo klikë politikën e vet në Shqipëri e mbështeste kundër vijës marksiste-leniniste të Partisë sonë. Klika titiste ka folur vazhdimisht se Miladin Popoviçi me Dushan Mugoshën kanë qenë ata që kanë themeluar Partinë Komuniste të Shqipërisë dhe kanë ngritur kuadrot e saj. Kjo propagandë është shpifëse. Domethënë, nëse ekziston një Parti Komuniste në Shqipëri dhe që pati suksese, kjo, sipas titistëve, ndodhi se kishte një Parti Komuniste Jugosllave dhe se ishte Miladin Popoviçi, ai që krijoi Partinë tonë, të cilit, më vonë trockistët jugosllavë i dhanë plumbin pas kokës.

Pse Tuku e ngriti dhe e ngre çështjen në atë formë sikur Partia jonë, nëse u formua, kjo i detyrohet Miladinit, se ai qenka, sipas Tukut, i vetmi themelues

i Partisë sonë? Shokët që diskutuan e thanë drejt se nuk ishte Miladin Popoviçi ai që formoi Partinë Komuniste të Shqipërisë, po ishin kushtet e brendshme dhe të jashtme të vendit tonë, se Partinë tonë e formoi populli shqiptar, ndjenjat e tij të luftës për liri, dashuria e tij e madhe për Bashkimin Sovjetik që u sulmua nga Gjermania hitleriane. Partinë tonë e formuan komunistët shqiptarë, sido që ishin, me gabimë dhe pa gabime por që e donin me gjithë zemër popullin shqiptar dhe që kishin besim të madh te Bashkimi Sovjetik. Ishte pra, lufta e popullit tonë, heroizmi i tij, urrejtja kundër armiqve okupatorë, ishte populli dhe komunistët shqiptarë, ishim vetë ne, përfaqësuesit e atyre grupeve që u bë e mundur të formohet Partia jonë me gabime ose pa gabime. Ndhimën që dha Miladin Popoviçi Partia jonë e ka përcaktuar drejt. Si mund të themi atëhere që erdhi Miladin Popoviçi dhe e formoi Partinë? Pse Miladin Popoviçi nuk e formoi më përpara Partinë tonë edhe në Peqin ku ishte i internuar, ose Dushani? Pse nuk e formuan më parë Partinë disa të ashtuquajtur organizatorë të ardhur nga Greqia ose nga Franca? Tuku më duket se i harron faktorët objektivë e subjektivë që përcaktuan formimin e Partisë: rolin e madh të momentit nacional, luftën që ziente në popullin tonë, idetë e mëdha të leninizmit që frymëzuan popullin tonë, faktorin e jashtëm vendimtar, Bashkimin Sovjetik dhe tani del e na thotë se krijimi i Partisë sonë i dedikohet Miladin Popoviçit. Kjo pikëpamje jo vetëm që është antimarksiste po edhe tendencioze.

Është e urrejtshme të flasësh për veten tënde, po jam i detyruar të flas, se është çështja për të mbrojtur vijën e

Partisë. «Ç'është kjo Shtëpi e Partisë» — tha Tuku me një farë përbuzje — «vetëm fotografia e Enver Hoxhës me dy leje-kalimi». Tuku, duke qenë në këtë rrugë shumë të gabuar, jashtë vijës së Partisë, harron se në këtë Shtëpi Muze të Partisë, që është një vend historik për Partinë tonë, nuk është vetëm fotografia e Enver Hoxhës, po atje janë pasqyruar të gjitha ngjarjet që kanë rrjedhur qysh përpara formimit të Partisë, atje pasqyrohet lufta e popullit tonë. Atje ka fotografi të patriotëve të Rilindjes, janë fotografitë e demonstratave të popullit, atje ka pamje nga të Luftës nacional-çlirimtare të popullit tonë, atje janë fotografitë e shumë heronjve të popullit dhe të anëtarëve të Partisë sonë, që kanë rënë në luftë me emrin e Partisë në gojë dhe nuk është aspak e vërtetë që është vetëm fotografia e Enver Hoxhës. Pastaj edhe kjo fotografi nuk është vetëm për dy leje-kalimi, po ajo është për shkak se Enver Hoxhën që nga formimi i saj dhe deri sot Partia e ka zgjedhur sekretar të saj. Pra, ajo fotografi nuk është vënë atje vetëm për dy leje-kalimi, por Partia ka gjykuar se duhet të jetë, pa qenë ndoshta as fotografia e Tukurit, e Koço Tashkos apo e ndonjë tjetri. Është tjetër çështje nëse duhet ose nuk duhet të jenë edhe fotografitë e tyre në Shtëpinë Muze të Partisë. Në rast se Enver Hoxha nuk u zgjodh atëhere sekretar i Partisë, kjo është thënë dhe dihet se në atëhere ishim të rinj, se ishin momente të rëndësishme dhe jetike për Partinë, se atëhere Partia po ecte pas gjithë atyre dallgëve me kokë në torbë, se njerëzit duhet të provoheshin në luftë dhe të shihej cili do të ishte njeriu që duhej të udhëhiqte Partinë. Por në realitet Komiteti Qendror

Provizor ma besoi mua barrën e drejtimit të Partisë pa ma vënë emrin sekretar i Partisë.

Tuku, na del edhe me një pikëpamje tjetër. Njerëzit e udhëheqjes ai i ndan në ata që kanë qenë konsekuentë dhe në ata që nuk kanë qenë konsekuentë. Kjo nuk është e vërtetë, se të gjithë shokët e udhëheqjes kanë qenë konsekuentë në vijën e Partisë dhe në mbrojtjen e saj. Tuku nga një anë e heq rolin e sekretarit të parë dhe nga ana tjetër thotë se vetëm Enver Hoxha ka qenë konsekuent në udhëheqjen e Partisë. Shokët e tjerë ai nuk i përfill aspak, pra i likuidon. Me një fjalë ai likuidon kështu të gjithë udhëheqjen e Partisë.

Pastaj shoku Tuk na nxjerr një fshesë tjetër duke na dhënë kështu përshtypjen e gjoja një vizitori në muzeum. «Çfarë do fotografia e Gogo Nushit që është vënë si udhëheqës i lëvizjes nacional-çlirimtare», thotë Tuku, «po Spiro Koleka, ç'kërkon këtu në periudhën e luftës»? Ç'tregojnë këto pikëpamje? Këto tregojnë tendencën për të likuiduar udhëheqjen. Këto janë tendenca likuidatore. Si mund të thuhet «ç'kërkon Gogo Nushi dhe Spiro Koleka atje?» Ata janë vënë atje jo për sytë e tyre të bukur, po për luftën që kanë bërë dhe për besnikërinë e tyre të madhe ndaj Partisë, për trimërinë që kanë treguar, pavarësisht kur kanë ardhur në udhëheqje. Për këto merita Partia i ngriti deri në udhëheqjen e saj.

Por logjika e Tukut të çon jo vetëm në likuidimin e përgjithshëm të udhëheqjes, por ai fut edhe një spicë përçarëse në udhëheqje, sepse sipas pikëpamjes së tij, në udhëheqje ka dy palë njerëz: ata që kanë luftuar me pushkë dhe ata që kanë luftuar ndryshe. Sipas

Tukut, ata që kanë marrë pushkën në Luftën nacional-çlirimtare, duhet të jenë udhëheqësit e Partisë. Por ne e quajmë shumë heroike edhe luftën e Gogo Nushit, pse ai vepronte brenda në Tiranë, punonte çdo ditë me qefin në kokë, i rrethuar nga të katër anët me spiunë. Po t'i thoshte Partia edhe Gogos «merre pushkën dhe dil në mal e lufto», do ta merrte edhe ai pushkën dhe do të kishte dalë partizan si të gjithë ne. Por Partia e kishte ngarkuar atë në Tiranë dhe ai punoi e luftoi pa u lodhur. Mos vallë në luftën e ardhshme sipas Tukut shokët e Komitetit Qendror që do t'i lëmë në qytete nuk do të jenë në luftë? Në rast nevojë Partia përsëri do t'i thotë ndonjerit rri në qytet dhe udhëhiq aty Partinë. Atëhere si nuk e ka udhëhequr Partinë ky Komitet Qendror që ka ekzistuar, sigurisht, me këto gabime që janë vërtetuar, si nuk e ka udhëhequr ushtrinë tonë Shtabi i Përgjithshëm me ato të meta që janë vërtetuar, pra, si e sollën popullin në fitore? Tuku i harron këto gjëra, gabon rëndë duke i ngritur çështjet në një rrugë të shtrembër.

Por pse e ngriti Tuku kështu këtë çështje? Mund ta them edhe këtë, megjithëse këto janë gjëra që dihen. Ai ka qenë anëtar i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror. Pse u ngrit sot çështja e Miladin Popoviçit nga ana e Tukut? Përse këto çështje të grupeve që ka menduar Tuku nuk i ka ngritur më përpara? Si e kupton çështjen e kultit të personit me të cilën Tuku donte të na bënte këtu teori dhe ra brenda, me çështjen e fotografive etj? Po pse, sot është hapur Shtëpia Muze e Partisë? Përse nuk ka ardhur me kohë Tuku dhe t'i shtronte këto në rrugë të drejtë qëkur ka menduar,

por i ka lënë të grumbullohen kështu? Ne mendojmë se këto gjëra nuk mund të jenë gjëra të rastit, po janë një vazhdë, janë çështje në drejtim të të cilave Tuku ka gabuar gjithnjë edhe herë të tjera dhe Partia, siç e dini, i ka dhënë dorën që të korrigojohet. Le të na i sqarojë këto vetë shoku Tuk, por ne kemi të drejtë të shfaqim mendimin tonë. Ai i ngriti sepse pikëpamjet e tija, janë pikëpamje oportuniste, të djathta, deviatore dhe qëllimet e tij janë likuidatore. Tuku, sipas mendimit tonë, nuk është dakord me këtë udhëheqje dhe, nga ana ideologjike, ai nuk është në pozita të drejta, por mendon më shumë nga ana personale e lokaliste. Të gjitha këto janë shtrembërime të vijës së Partisë dhe ne mendojmë që po të ishte në muzeum fotografia e Tukut, besoj se këtë çështje ai nuk kishte për ta ngritur kështu.

Çështja e goditjes së udhëheqjes manifestohet te Tuku edhe në disa gjeste të tjera. Ka ca kohë që shihet te Tuku një frymë mungese bashkëpunimi me disa shokë të Byrosë Politike dhe jashtë rrugës marksiste-leniniste. U diskutua para ca kohe çështja e tatimit bujqësor. Nga një anë Hysniu dhe nga ana tjetër Tuku kanë pasur mendimet e tyre, por Tuku nuk bindet të bisedojë mbi këtë çështje, duke thënë se «unë në asnjë mënyrë nuk mund të bisedoj me Hysniun, unë kam pikëpamjen time dhe nuk tundem nga ajo»! Çështja arrin deri atje sa të detyrohem unë ta vë në rrugë Tukun e t'i them që të vejë medoemos të diskutojë me Hysniun për këtë problem në rrugën e drejtë të Partisë.

Në qëndrimet e Tukut shihet edhe një farë mëndjemadhësie dhe fodullëku dhe, kur bisedon, i duket sikur

fjalët e tija janë topa. Këto nuk janë shënja të mira në personin e Tukut. Këto gjëra që thamë ziejnë prej kohësh në kokën e tij. Le të marrim edhe çështjen e abetares, që nuk është një gjë kaq e thjeshtë. Kjo çështje është diskutuar dhe mund të mos qe nevoja të ngrihej këtu, por në këtë situatë, duhet ta vëmë në dukje sepse tregon pikëpamjet jo të drejta të Tukut. «Dukagjini duhet të mbetet Dukagjin» thotë Tuku. Kjo nuk është e vërtetë, nuk mund të jetë kështu. Është fakt historik që edhe në vende të tjera, të përparuara si në Francë e gjetkë gjuha provinciale ka ndryshuar, ka evoluar dhe është formuar gjuha unike, letrare, gjuha kombëtare. Mund të themi edhe për Dukagjinin se ai nuk mund të mbetet siç është sot. Edhe vetë Tuku duhet të ketë vënë re se e ka thyer gjuhën si të gjithë ne dhe se te ne, siç është e natyrshme, dialektike, po përpunohet gjuha letrare. Byroja Politike nuk është ngutur për të marrë një vendim mbi këtë çështje, se kjo s'bëhet me dekret. Natyrisht, do të bëhet si është më mirë. Edhe në raport thuhet se problemi i gjuhës zyrtare do të studjohet, do të diskutohet, ndërsa Tuku megjithëse e di këtë çështje, na e ngre këtu në një frymë të tillë që nuk është aspak e drejtë.

Ose ai na ngre këtu çështjen e qëndrimit të disa zyrtarëve në Shkodër ndaj një vajze. Ne biseduam edhe bashkë për këtë çështje dhe unë jam dakord me mendimin e shokëve që secili të jetë i matur në marrëdhënje me ata që kanë përbërje shoqërore jo të mirë. Po të kemi, duhet t'u japim punë që edhe ata të jetojnë, por natyrisht këta njerëz nuk duhet të vendosen në vende kyçe, por të paktën t'u japim edhe atyre mundësi të

punojnë e të rrojnë. Por kur shohim se Tuku mban një qëndrim tjetër ndaj njerëzve të tillë, kjo s'është gjë tjetër veçse oportunizëm, që s'pajtohet me vijën e drejtë të Partisë.

Si konkluzion, ne mendojmë që të gjitha këto pikëpamje të Tukur mund të cilësohen si pikëpamje thellësisht oportuniste, si tendencë për të revizionuar vijën e Partisë dhe si rishikim i të gjitha veprimeve aktuale të udhëheqjes së Partisë. Me këtë udhëheqje, sipas Tukur, Partia nuk është në rregull. Atëhere ne mendojmë se do të bënim gabim po të plotësonim dëshirën e shokut Tuk për revizionimin e kësaj vije. Një gjë e tillë në asnjë mënyrë nuk mund të bëhet dhe nuk do të lejojmë që Partia të futet në këtë rrugë të shtrembër. Në këtë drejtim ne kemi eksperiencën e mādhe të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik se si ajo ka luftuar kundër këtyre prirjeve kaq të rrezikshme, kemi edhe eksperiencën e Partisë sonë, që na armatós me forca për të mos gabuar e për të mos shkelur në dërrasë të kalbur.

Ne nuk na çudit fakti që Tuku ka rënë në këto gabime shumë të rënda dhe konstatojmë se me gjithë premtimet që ka bërë përpara Komitetit Qendror ai përsëri gabon. Rrethanat që e kanë nxitur të mendojë dhe të bjerë në gabime kaq të rënda oportuniste dhe deviatore, Tuku duhet t'ja thotë Komitetit Qendror, haptas, pa drojtje, pavarësisht se ka gabuar një herë, dy herë dhe tri herë. Ai ka eksperiencë se sa i matur dhe sa i drejtë ka qenë kurdoherë Komiteti Qendror jo vetëm ndaj tij, por ndaj të gjithë shokëve që kanë gabuar. Komiteti Qendror ka goditur rëndë dhe ashpër

të gjithë armiqtë e Partisë, pse ai është Komiteti Qendror i një Partie marksiste-leniniste të tipit të ri, dhe që i peshon me kujdes të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me vijën dhe me njerëzit. Por çështjeve duhet t'u shkohet deri në fund se kështu e kërkon interesi i lartë i Partisë dhe gjithashtu Komiteti Qendror i ndihmon e do t'i ndihmojë deri në fund, njerëzit që gabojnë. Interesi i Partisë është që njerëzit të ndreqen, por ata që gabojnë duhet të vijnë dhe me zemër të hapur t'ja thonë të tëra Partisë si kanë menduar e si kanë vepruar dhe Komiteti Qendror do ta gjykojë punën e tyre. Kjo është rruga e drejtë që ndjek Partia.

Ne mendojmë që këtë çështje Komiteti Qendror ta thellojë. Eksperienca e Partisë sonë na mëson që çështje të tilla duhet të shihen me kujdes dhe deri në fund. Prandaj ne i propozojmë plenumit që këtë çështje ta marrë në dorë Byroja Politike, të bisedojë me shokun Tuk dhe ta sqarojë. Byroja Politike ta përpunojë çështjen dhe, më në fund, t'ja paraqesë plenumit për ta gjykuar dhe për të marrë vendimin përkatës. Ne mendojmë se do të jetë më mirë të veprohet kështu, se sa të vazhdohet tani mbledhja e plenumit për të zbërthyer këtë çështje pa bërë më parë përgatitjen e nevojshme.

Ne i themi edhe një herë shokut Tuk se është mirë që ai vetë të pohojë ato ç'ka menduar. Ai duhet t'i analizojë mirë shkaqet e thella që e kanë shtyrë të arrijë në këto pikëpamje, pasi mendojmë që këto nuk janë të rastit. Diçka shumë e rëndësishme nuk është në rregull në kokën e shokut Tuk. Ndryshimet e gjendjes politike, vendimet e marrura nga Komiteti Qendror, apo qëndrimet e Partisë në situatat që kalojmë, duhet

të kenë një farë influence te ai. Prandaj mendojmë që ai vetë të thellohet dhe të reflektojë mirë mbi këto çështje.

Kaq kisha unë në emër të Byrosë Politike për këtë çështje.

Është dakord plenumi me këtë propozim të Byrosë Politike? *(Të gjithë, pa përjashtim, duke përfshirë edhe Tuk Jakovën, ranë dakord me propozimin e Byrosë Politike për zgjidhjen e kësaj çështjeje në Plenumin e ardhshëm të Komitetit Qendror).*

*Botohet për herë të parë, me
ndonjë shkurtim, sipas origji-
nalit që gjendet në AQP*

**NGA BISEDA NË TAKIMIN ME NJË DELEGACION
GRASH QË MOREN PJESË NË KONFERENCËN
KOMBËTARE TË NËNAVE¹**

10 maj 1955

Pasi përshëndeten dhe pasi folën gratë me dashuri dhe entuziazëm për Partinë tonë e merr fjalën shoku Enver:

Siç e dini, Partia jonë lufton që populli të rrojë më mirë, që në vendin tonë të ketë me bollëk gjithshka. Ky është qëllimi i Partisë dhe këtë qëllim populli e sheh qartë. Partia nuk ka vetëm fjalë po edhe punë, ato çka vendos ajo i kryen me sukses, sepse vija e saj është e drejtë dhe populli e ka përqaftuar këtë vijë pasi sheh qartë se ajo është krejtësisht në interesin e tij. Populli me Partinë janë të lashkuar si mishi me thoin, prandaj është e drejtë, ashtu si thoni ju, që do të punoni me vendosmëri që të zbatohen si duhet vija dhe direktivat e Partisë. Ju po shihni se shumë gjëra janë bërë në vendin tonë, se populli ynë ka korrur shumë suksese. Tani ne kemi një industri krejt moderne që më parë nuk e kishim. Te ne sot prodhohen tekstile, vegla e

¹ Kjo konferencë u mbajt në Tiranë më 9 maj 1955.

sende të ndryshme për popullin. Minierat tona po zhvillohen, kemi naftë, bakër etj. Edhe bujqësia tani në vendin tonë nuk është si bujqësia e vjetër kur fshatari ynë vuante për bukë. Ajo po përparon çdo ditë dhe vetë populli ynë ecën çdo ditë përpara.

Gratë e vendit tonë, natyrisht, kanë luajtur një rol shumë të madh, vendimtar në çlirimin e Shqipërisë, në ndërtimin e bazave të socializmit, në punën për ngritjen e mirëqenjes së popullit dhe në të ardhshmen ato do të vazhdojnë të luajnë rol akoma më të madh. Atje ku gratë nuk marrin pjesë në prodhim nuk mund të ketë përparim. Pra këto përparime që shohim në vendin tonë i detyrohen edhe pjesëmarrjes aktive të grave në jetën politike, ekonomike etj. të vendit tonë. Puna e grave është e madhe dhe Partia ka të ju një mbështetje të jashtëzakonshme për ndërtimin e socializmit, për zhvillimin e kulturës, të arësimit, të bujqësisë, të industrisë dhe për rritjen e brezit të ri, që është shpresa dhe e ardhshmja e vendit tonë. Sa më mirë që ju, nëna, t'i rritni të rinjtë dhe të rehat me ide të shëndosha dhe me patriotizëm në rrugën e Partisë dhe të marksizëm-leninizmit, aq më e fortë dhe më e pasur do të jetë Shqipëria, pse njerëzit e edukuar me një frymë të tillë do të hedhin hapa më të mëdha përpara. Të kemi kujdes se në të moshuarit kemi edhe disa mbeturina në kokë që s'na lënë të ecim si duhet, kurse të rinjtë janë gjithnjë në sulm dhe ata në asnjë mënyrë s'duhet të pengohen. Prandaj roli i nënave për edukimin e fëmijëve është me rëndësi shumë të madhe.

Ju e keni vënë re se si çdo vit ka ndryshuar situata në vendin tonë. Gjithnjë e më shumë janë shtuar

mallrat në treg, fshatarët rrojnë më mirë, punëtorëve po u përmirësohet jeta. Po këto që janë bërë nuk janë të mjaftueshme, sepse, siç e dimë, menjëherë nuk ndreqet shtëpia. Duhet të punojmë vazhdimisht çdo ditë që të rrojmë më mirë. Tani Partia dhe qeveria po pregatitin planin e dytë pesëvjeçar që parashikon një përparim akoma më të madh të vendit tonë, sidomos bujqësisë do t'i vihet një rëndësi akoma më e madhe. Partia dhe qeveria kanë bërë mjaft dhe në të ardhshmen do të kenë parasysh që akoma më shumë të ndihmohet fshati.

Si pyeti gratë delegate se si shkon puna me luftën kundër analfabetizmit në radhët e tyre, shoku Enver vazhdoi:

Sa të jetë e mundur ne duhet të mësojmë. Mësimi duhet t'i vihemi të gjithë me durim, pse mësimi na ka hapur sytë. Partia jonë na mëson se pa mësim nuk ecim dot përpara. Zhvillimi i gjithanshëm i vendit tonë nuk mund të ecë përpara si duhet pa njerëz të mësuar. Prandaj edhe gratë tona duhet të mësojnë dhe çdo ditë të përparojnë.

Pastaj shoku Enver këshilloi gratë që t'i vënë një rëndësi të madhe pastërtisë, kudo, dhe sidomos në familje pse ajo është një nga faktorët kryesorë për ruajtjen e shëndetit të njeriut, sidomos të fëmijëve që ata të rriten të shëndetshëm e të gëzuar.

Ju diskutuat në konferencë si u çlirua Shqipëria, si po ndërtohen sot bazat e socializmit dhe si populli ynë i mbron me vendosmëri fitoret e tija. Ne kemi dhe armiq që presin të na godasin atje ku mund të kemi pika të dobëta. Mirëpo vendi ynë po forcohet dita-ditës.

Ju keni dëgjuar për Konferencën e Varshavës, tani atje do të nënshkruhet një marrëveshje me vendet e kampit të socializmit. Ne kemi qenë të lidhur ngushtë me Bashkimin Sovjetik dhe me vendet e demokracisë popullore, sido që armiqtë tanë thoshin se Shqipëria gëlltitet menjëherë. Po fjalë të tilla ne i dinim se ishin pa baza. Megjithatë edhe zyrtarisht kjo lidhje e ngushtë midis vendeve tona do të bëhet sepse nesër mblidhet Konferenca në Varshavë.

Në planin e dytë pesëvjeçar ne do të marrim masa akoma më të rëndësishme për zhvillimin e bujqësisë një nga të cilat do të jetë zhdukja e gardheve. Shumë tokë humbet fshatari me këto gardhe, pastaj në gardhet rriten ferra që pengojnë deri në një masë rritjen e grurit etj. Tani fshatari e ka vështirë ta prishë gërdhin, sepse ky i tregon kufirin, por Partia thotë: prishe gardhin sepse kështu nuk do të ketë më pengesa që në arat tona të futet traktori. Pastaj do të kemi edhe maqina të mëdha që do të shërbejnë për të shndërruar disa pyje në toka buke. Nga Bashkimi Sovjetik kemi sjellë e do të sjellim më shumë traktorë si dhe maqina që lëvizin dhë e që hapin kanale. Po të kaloni nga zona e Lushnjës, do të shikoni maqina të tilla që zëvendësojnë punën e qindra punëtorëve. Tani maqina na duhen më tepër dhe Partia e qeveria i kanë marrë masat që të sjellin edhe të tjera, mirëpo s'mjaftojnë vetëm këto, na duhen edhe njerëz që të punojnë me kokë e që të dinë si të punojnë e si të kujdesen si për maqinat ashtu edhe për bimët që mbjellin.

Duke ju drejtuar delegateve fshatare shoku Enver tha:

Populli ynë e kupton se ato që thotë Partia janë të drejta dhe zbatimi i tyre është për të mirën e tij. Por në disa fshatarë ka edhe mendime të tilla si p.sh. «kemi kohë të mbjellim», «ka kohë për të prashitur» etj. në kohën kur duhet të fillojë mbjellja ose prashitja. Veç kësaj shumë fshatarë humbasin kohën duke shkuar sa në një pazar në tjetrin, si p.sh. disa fshatarë nga Çermenika një ditë venë në pazarin e Elbasanit, një ditë në atë të Cërrikut, një ditë tjetër në Librazhd etj. dhe ngandonjëherë pa pasur asgjë për të shitur. Çermenika p.sh. është vërtet malësi, vend i varfër, po edhe atje duhet që fshatarët, rinia dhe Partia të punojnë më shumë që të shtohen prodhimet, që jeta të bëhet edhe atje më e mirë dhe më e gëzuar.

Në fshatra nuk organizohen as dëfrimet dhe as ditët e pushimit siç bëhet në qytete. Fshatarët kanë të drejtë të pushojnë, po natyrisht jo duke ndenjtur shtrirë në shtëpi. Prandaj duhet të organizohet edhe në fshat ndonjë pjesë e vogël teatrale, muzikë, të mblidhet rinia të luajë në shtëpinë ose vatrën e kulturës, ose edhe në sheshin e shkollës, të mblidhen burra dhe gra ku të kërcëjnë e të këndojnë, të çlodhen e të dëfrenjë. Partia ka marrë vendim që çështja e arësimit dhe e kulturës, muzika, lodrat, shfaqjet, dëfrimi dhe prehja të bëhen të organizuara që të bëhet një jetë më e gjallë edhe në fshat. Ne nuk duhet të kënaqemi me ato që bëhen por të ecim gjithnjë përpara. Në Gjirokastrë p.sh., kur bëhet ndonjë dasëm bëhen shakara me thumba, njerëzit qeshin, dëfrenjë. Këto gjëra i bën vetë populli, por ne duhet t'i organizojmë ato me një pjesëmarrje më të gjerë.

Pasi pyeti dhe u interesua për trajtimin e arësimit-

tarëve dhe si foli për detyrat e mëdha që kanë ata për edukimin e brezit të ri, shoku Enver porositi që arësimitarët të ndihmohen më shumë në punën e tyre sepse atyre populli u ka besuar edukimin e fëmijve.

Në lidhje me forcimin e luftës për mbrojtjen e paqes, shoku Enver tha:

Lufta për mbrojtjen e paqes duhet të jetë e ashpër, sepse miliardëet kudo që janë përpiqen të rrëmbejnë fitoret e popujve. Në vendet kapitaliste pasanikët mendojnë të vrasin njerëzit dhe kalamanët, që popullsia të mos shtohet etj. Prandaj duhet ta mbrojmë me vendosmëri paqen dhe një nga mjetet për mbrojtjen e saj është që t'i mbajmë kurdoherë sytë hapët ndaj veprimeve të armiqve dhe të mos themi se tani i zhdukëm armiqtë. Armiq ka akoma, vetëm se janë të dobët. Por në rast se ne do të flemë, ata do ta ngrenë dorën. Prandaj për të mbrojtur interesat e popullit duhet t'i kemi sytë hapët dhe mendtë në kokë, pse sa më i fortë të jesh, aq më tepër frikë ka armiku.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**TELEGRAM PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR SHOKUT
HO SHI MIN ME RASTIN E 65-VJETORIT
TË DITËLINDJES SË TIJ**

18 maj 1955

SHOKUT HO SHI MIN

V i e t n a m

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë Ju dërgon përshëndetje vëllazërore me rastin e 65-vjetorit të ditëlindjes Suaj dhe Ju uron shëndet të mirë dhe jetë të gjatë për të mirën dhe lumturinë e popullit vietnamez.

Partia dhe populli ynë ndjekin me simpati dhe interesim luftën e popullit vietnamez nën udhëheqjen e Partisë dhe të qeverisë demokratike, me Ju në krye, për rimëkëmbjen e vendit dhe mbrojtjen e paqes në Azi dhe në botë dhe Ju urojmë suksese të mëtejshme në punën Tuaj paqësore.

**Për Komitetin Qendror të PPSH
Sekretari i Parë**

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 117 (2070), 18 maj 1955

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 117 (2070), 18 maj 1955

FJALA E MBAJTUR NË MBLEDHJEN E JASITZAKONSHME TË KUVENDIT POPULLOR MBI RATIFIKIMIN E TRAKTATIT TË VARSHAVËS

28 maj 1955

Të dashur shokë deputetë,

Populli shqiptar priti dhe aprovoi me gëzim të papërshekruar Traktatin e miqësisë, të bashkëpunimit dhe të ndihmës reciproke që u nënshkrua midis tetë vendeve që morën pjesë në Konferencën e Varshavës¹. Ai e përshëndeti këtë traktat si një fitore të shkëlqyer të kampit të socializmit dhe të paqes të kryesuar nga Bashkimi Sovjetik, si një mjet që mbron fitoret dhe

¹ Si kundërpeshë e ratifikimit të marrëveshjeve të Parisit, që parashikonin futjen e Gjermanisë Perëndimore në NATO, tetë vende të kampit socialist u mblodhën në Varshavë nga 11-14 maj 1955, ku u nënshkrua «Traktati i miqësisë, i bashkëpunimit dhe i ndihmës reciproke» dhe u krijua Komanda e përbashkët e forcave të armatosura të vendeve socialiste evropiane për garantimin e paqes dhe të sigurimit në Evropë. Por pas tradhëtisë së revizionistëve sovjetikë ai u shndërrua nga një traktat i tillë në një traktat agresiv të tipit fashist. Këtë e vërtetoi pushtimi i Republikës Socialiste të Çekosllovakisë (21 gusht 1968) nga forcat e armatosura të pesë vendeve të Traktatit të Varshavës.

jetën paqësore në vendet tona, si një fitore të të gjithë njerëzve që luftojnë për mbrojtjen dhe sigurimin e paqes në botë.

Ky traktat tregon forcën monolite të kampit tonë dhe miqësinë e singertë e të përjetshme që lidh popujt e vendeve tona në mes të njëri-tjetrit.

Karakterit i Traktatit të miqësisë, të bashkëpunimit dhe të ndihmës reciproke që u nënshkrua në Varshavë, është paqësor e mbrojtës dhe krejt në kundërshtim me atë të Paktit të Atlantikut Verior, karakteri i të cilit është agresiv.

E gjithë bota përparimtare e ka sot të qartë dhe është dëshmitare e politikës agresive të qarqeve imperialiste të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Anglisë, Francës dhe satelitëve të tyre, të cilët, me anën e politikës së urryer të forcës dhe të garës së çmendur të armatimeve, përpiqen ta hedhin botën në një kasaphanë të re. Qarqet sunduese të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Anglisë dhe të Francës po përgatiten në ethe për luftë kundër kampit tonë të socializmit dhe të paqes. Përgatitjet e tyre në këtë drejtim janë të mëdha dhe Traktati i Parisit¹ u dha mundësi imperialistëve të

Prandaj me kërkesën e qeverisë sonë në përputhje me vendimin e Plenumit V të KQ të PPSH (5 shtator 1968) Kuvendi Popullor i RPSH në sesionin e 6-të të legjislaturës së 6-të më 12 shtator 1968 vendosi denoncimin e Traktatit të Varshavës dhe çlirimin e RPSH nga çdo detyrim që rrjedh nga ky traktat.

1 Më 23 tetor 1954 përfundoi punimet Konferenca e Parisit e nëntë ministrave të jashtëm të fuqive perëndimore. Konferenca vendosi futjen e Gjermanisë Perëndimore në Paktin agresiv të Atlantikut Verior (NATO) dhe në blokun «Bashkimi i Evropës Perëndimore».

riarmatosin Gjermaninë Perëndimore, për ta përdorur këtë si një fuqi sulmi kundër vendeve tona paqësore. Por popujt tanë dhe gjithë popujt e botës i kanë akoma të freskëta tmerret dhe vuajtjet e pashembullta që solli Lufta e dytë botërore, prandaj sot, vetëm dhjetë vjet pas fitores mbi hordhitë hitleriane, këta popuj nuk mund të shohin të qetë ringjalljen e Vermahtit gjerman, të shohin përsëri në krye të kësaj ushtrie agresive xhelatët dhe banditët hitlerianë që dogjën dhe vranë me miliona njerëz. Ne kurrë nuk mund ta harrojmë gjakun e vëllezërve tanë, të partizanëve trima që luftuan në male, nuk mund të harrojmë qytetet e djegura të vendit tonë. Kurrë nuk mund të harrojmë ne sakrificat e mëdha të popujve vëllezër të lavdishëm sovjetikë, miliona e miliona bij të tyre të vranë për lirinë e popujve, nuk mund ta harrojmë popullin vëlla polak dhe Varshavën e rrafshuar, popullin vëlla çek dhe masakrat e Lidicës¹, luftën e popujve jugosllavë, vuajtjet e popujve vëllezër të Bullgarisë, të Rumanisë dhe të Hungarisë. Dhe, që të mos përsëriten më këto tmerre të luftës, që të mos qajnë më zemrat e nënave, vendet e kampit tonë të socializmit dhe të paqes nuk mund të rrinë më duarkryq para imperialistëve që vringëllojnë armët. Bashkimi i madh Sovjetik dhe vendet tona të demokracisë popullore, me politikën e tyre të drejtë, paqësore, bënë të gjitha përpjekjet dhe do të vazhdojnë të bëjnë që

¹ Fshat çekoslovak i cili u shkatërrua plotësisht nga hitlerianët më 1942. Të gjithë burrat dhe të rinjtë e Lidices u pushkatuan nga gjermanët, ndërsa gratë dhe fëmijët u dërguan në kampet e përqendrimit. Fshati u dogj.

njerëzit të rrojnë të lumtur dhe të lirë në shtëpitë e tyre, të ndërtojnë në qetësi, të krijojnë bollëkun për popujt e tyre.

Në bazë të propozimeve të Bashkimit Sovjetik për sigurimin kolektiv të Evropës, të gjitha vendet tona dhe njerëzit e ndershëm e përparimtarë të botës u bënë thirrje dhe propozime të drejta qeverive amerikane, angleze dhe franceze që të ndalonin ratifikimin e marrëveshjeve të Parisit, por këto nuk ua vunë veshin këtyre propozimeve, dhe shkëlmuan vullnetin e popujve. Në Konferencën e Moskës, Bashkimi Sovjetik dhe vendet e demokracisë popullore evropiane, që kanë afro 300 milion banorë dhe që përfaqësojnë gjysmën e popullsisë së Evropës, deklaruan botërisht se në qoftë se do të ratifikoheshin marrëveshjet e Parisit, nga ana e shteteve tona do të merreshin masa efektive për mbrojtjen dhe sigurimin e popujve tanë dhe të paqes në Evropë e në botë. Qarqet imperialiste nuk i morën parasysh këto propozime të drejta. Konferenca e Varshavës dhe traktati që u nënshkrua ishin, pra, rezultat logjik i politikës paqësore mbrojtëse të kampit tonë të paqes dhe të socializmit. Me këtë traktat historik vendet tona u angazhuan të ndihmojnë njëri-tjetrin, në rast se sulmohen, duke përfshirë edhe përdorimin e forcës së armatosur. Po në këtë konferencë u themelua Komanda e bashkuar e forcave të armatosura të vendeve tona.

Një rëndësi të madhe ka fakti që në Konferencën e Varshavës, asistoi përfaqësuesi i Kinës së madhe dhe, në emër të saj, ai deklaroi se Republika Popullore e Kinës mbështet dhe aprovon plotësisht Traktatin e miqësisë, të bashkëpunimit dhe të ndihmës reciproke

të të tetë vendeve dhe qëllimet e tij të larta për sigurimin kolektiv në Evropë.

Traktati i Varshavës përputhet plotësisht me ndjenjat, dëshirat dhe aspiratat e popujve paqedashës të botës, ai përputhet me Kartën e Kombeve të Bashkuara, ai qëndron i hapur për të gjitha ato shtete që dëshirojnë të marrin pjesë në të. Kjo provon karakterin paqësor të traktatit tonë, ndërsa ngjet e kundërta me Paktin agresiv të Atlantikut Verior, i cili është një mjet i rrezikshëm në duart e imperialistëve amerikanë për të hedhur botën në një kasaphanë të re.

Shokë deputetë,

Traktati i miqësisë, i bashkëpunimit dhe i ndihmës reciproke midis vendeve socialiste evropiane të kampit tonë është një ngjarje e rëndësishme në historinë e popullit tonë. Ç'vuajtje të tmerrshme ka hequr populli ynë derisa arriti ditën e lumtur të çlirimit. Shekuj me radhë imperialistët e ndryshëm na kanë shtypur, na kanë djegur, na kanë vvarë. Ata e kanë pasë bërë Shqipërinë plaçkë tregu, duke ja shitur atë herë njërit dhe herë tjetrit, kurdisnin traktate të hapëta dhe të fshehta prapa kurrizit dhe në dëm të interesave të popullit tonë. Imperialistët e ndryshëm mendonin se barbarizmat e tyre do të ishin të përrjetshme, se çizmja e tyre e gjakosur do të rëndonte mbi gjoksin e popujve. Ata mendonin se popujt do të mbaheshin tërë jetën nën zgjedhën e tyre dhe do të shërbenin si skllevër për milionerët, bejlerët dhe agallarët. Por Revolucioni i madh socialist i Tetorit, i cili u bë dielli i ndritshëm për lirinë

dhe jetën e popujve, i dha grushtin vdekjeprurës botës gjakatare të imperialistëve. Shteti i fuqishëm i Sovjetëve që krijoi Lenini i madh u bë vatra e zjarhtë e aspiratave dhe e dëshirave më të larta të popujve, u bë shpresa e njerëzve të shtypur, shpresa e lirisë dhe e pavarësisë.

Populli shqiptar, megjithëse nën vuajtjet dhe nën lëngatat e tmerrshme të feudalëve dhe të bejlerëve shqiptarë, me kriminelin Ahmet Zogu në krye, por i papërkulur kurrë, i drejtoi sytë dhe shpresat nga Bashkimi Sovjetik. Në errësirën që e mbulonte, populli shqiptar u udhëhoq në rrugën e çlirimit nga leninizmi. Partia Komuniste e Shqipërisë, tani Partia e Punës e Shqipërisë, që në ditët e para të lindjes së saj i tha popullit të rrokte armët kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve, të lidhej përjetë me një miqësi të pathyeshme me Bashkimin Sovjetik e ta konsideronte këtë miqësi si një gur themeltar dhe një nga faktorët vendimtarë të fitoreve të tij, për të kaluar nga errësira mesjetare në dritën e rendit socialist. Miqësia me Bashkimin Sovjetik, lufta legjendare e popujve dhe e Ushtrisë Sovjetike kundër hordhive të Hitlerit që faktori vendimtar i jashtëm, që i siguruan popullit shqiptar lirinë, fitoren kaq të dëshiruar mbi okupatorët fashistë dhe mbi klikat feudale e borgjeze të vendit. Gjaku i popullit tonë heroik i derdhur si rrëke në Luftën nacional-çlirimtare nuk vajti kot, pse populli ynë me zemër të madhe, diti ta përziejë gjakun e tij të kulluar me gjakun e bijve heroikë të Bashkimit Sovjetik dhe të popujve të tjerë që luftuan kundër hordhive hitleriane. Duke ndjekur shembullin e popujve sovjetikë, duke u udhëhequr kurdoherë nga mësimet dhe nga eksperiencia e lavdishme

e Partisë Komuniste që themeloi Lenini i madh, populli ynë vendosi pushtetin e tij popullor dhe ju përvesh punës me një entuziazëm të papërshkruar për të ndërtuar themelet e jetës së tij të re. Me një dashuri të madhe dhe të sinqertë, Bashkimi Sovjetik, hap më hap e ka ndihmuar dhe e ndihmon popullin tonë të ndërtojë jetën e lumtur. Frutet e kësaj miqësie dhe të kësaj ndihme i shikojmë në vendin tonë, i shikojmë në industrinë e re moderne që kemi ngritur dhe që po e zhvillojmë dhe e forcojmë, në zhvillimin e bujqësisë sonë, në zhvillimin e kulturës së re të popullit. Ndihma e Bashkimit Sovjetik dhe e vendeve miq e vëllezër të demokracisë popullore, të Kinës Popullore, të cilat pa kursyer e ndihmojnë popullin tonë, bëri që të përmirësohet jeta e vendit, që Shqipëria të lulëzojë dhe t'i hapen perspektiva të shkëlqyera. Kjo ndihmë është shprehje e lartë e miqësisë dhe e marrëdhënjeve të reja leniniste që janë vendosur në mes të vendeve tona socialiste. Këtë miqësi të madhe dhe të sinqertë populli ynë do ta ruajë, do ta forcojë dhe do ta çelnikosë. Këtë miqësi na e kanë zili armiqtë e tërbuar të vendit tonë. Ata bëjnë një mijë përpjekje me forma djallëzore që këtë miqësi ta dobësojnë. Por armiqtë kurrë nuk kanë pasur sukses dhe kurrë nuk do të kenë sukses ta dëmtojnë qoftë edhe një grimë këtë miqësi. Kjo është rrënjësor thellë në zemrat e popullit, në zemrat e punëtorëve, të fshatarëve, të intelektualëve patriotë, në zemrat e nënave dhe të motrave tona, në zemrat e rinisë sonë heroike që rritet e lumtur. Të fuqishme janë idetë e leninizmit që lidhin vendet tona, i çelniktë është uniteti i popujve tanë. Këtë e provon fakti që populli ynë ka dhjetë

vjet që po u reziston me vendosmëri dhe me sukses të gjitha orvatjeve të imperialistëve amerikanë dhe anglezë e shërbëtorëve të tyre, të cilët përpiqen të na dobësojnë, të na frikësojnë, por që dështojnë në çdo hap. Përpara të gjitha këtyre orvatjeve të armiqve ngrihet i fuqishëm patriotizmi dhe vendosmëria e popullit shqiptar, besimi i madh në Partinë e Punës të Shqipërisë dhe besnikëria e tij e patundur ndaj marksizëm-leninizmit. Gjatë këtyre dhjetë viteve, çdo ditë dhe çdo vit populli shqiptar ka parë dhe ka ndjerë thellë frutet e forcës së leninizmit dhe të unitetit të popujve, që është bërë burim i të gjitha këtyre të mirave, është bërë mburojë kundër të gjitha të këqiave dhe rreziqeve që i kanosehin popullit tonë.

Traktati i miqësisë, i bashkëpunimit dhe i ndihmës reciproke i forcoi akoma më shumë lidhjet e popullit tonë me popujt e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore. Partia jonë me politikën e saj të drejtë, i ka thënë kurdoherë popullit se Shqipëria kurrë nuk ka qenë e izoluar, se kush prek Shqipërinë, prek kampin tonë të socializmit dhe të paqes.

Disa mendjeshkurtër mendonin dhe propagandonin se këto ishin vetëm fjalë. Miqësia dhe vëllazërimi i popullit tonë me popujt e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore janë një realitet i çelnikosur nga leninizmi. Traktati i miqësisë, i bashkëpunimit dhe i ndihmës reciproke nuk është veçse shprehja de jure e këtij realiteti të shkëlqyer. Me mijëra letra i kanë ardhur Komitetit Qendror nga të gjitha anët e vendit, me të cilat punëtorët, fshatarët, njerëzit e thjeshtë i shprehin dashurinë dhe mirënjohjen Par-

tisë së Punës të Shqipërisë që i siguroi popullit shqiptar të gjitha këto fitore të mëdha. Populli shqiptar, i lidhur me mish e me shpirt me Partinë e tij që e çliroi përgjithmonë, që e udhëheq me sukses në rrugën e ndërtimit socialist, e do me gjithë shpirt Partinë, pse ajo i qëndron besnike deri në fund marksizëm-leninizmit që është shprehja e vullnetit të tij. Populli e do me gjithë shpirt Partinë se ajo e lidhi popullin shqiptar me popujt e Bashkimit të madh Sovjetik, me popullin e madh kinez dhe me popujt vëllezër të demokracisë popullore.

Çdo shqiptar, po ta pyesësh sot, të thotë se ne jemi mbi 900 milion dhe nuk thotë më njeri se jemi një milion. Armiqtë, pra, le të mendohen shumë përpara kësaj force kolosale, përpara këtij muri të çelniqtë ku do të thyejnë kokën të gjithë ata që do të tentojnë ta prekin. Ëndërrat e armiqve mbi Shqipërinë kanë mbaruar. Shqipëria sot ka zot dhe ecën përpara. Ne jemi të bindur se populli shqiptar, i armatosur me këto forca të mëdha, me këtë guxim dhe entuziazëm dhe me këtë besim të madh në të ardhshmen, do t'i shumëfishojë energjitë e tija të pashtershme për plotësimin e detyrave të ndërtimit të socializmit, për rritjen e fuqisë mbrojtëse të atdheut tonë, për fuqizimin dhe modernizimin e ushtrisë sonë heroike. Populli shqiptar do të hidhet akoma më me vrull për të realizuar planet e shtetit, për të ndërtuar sa më shpejt dhe sa më mirë, për të prodhuar sa më shumë që ai të ketë me bollëk.

Populli ynë i udhëhequr nga Partia e lavdishme e Punës, në miqësi të ngushtë me Bashkimin Sovjetik, me Kinën e madhe të Mao Ce Dunit si dhe me të gjithë

popujt vëllezër të demokracive popullore, do të ecë me hapa të sigurtë përpara drejt socializmit.

Populli shqiptar do t'i qëndrojë besnik Traktatit të miqësisë, të bashkëpunimit dhe të ndihmës reciproke që u nënshkrua në Varshavë, do të ruajë me vigjilencë interesat e kampit të socializmit, do të vërë të gjitha forcat për të siguruar paqen në Ballkan dhe në Evropë dhe do të jetë kurdoherë i gatshëm për të kryer misionin që ka, duke qenë pjesëmarrës i Konferencës së Varshavës.

Populli shqiptar, më i fortë se kurrë, do të vazhdojë të shtojë vigjilencën kundër armiqve të jashtëm dhe të brendshëm dhe do të jetë i pamëshirshëm kundër kujtdo qoftë që do të tentojë të cënojë interesat e popullit, të atdheut dhe të Partisë.

Në emër të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe duke u mbështetur në vullnetin e zgjedhësve të mi, unë jam plotësisht dakord me Traktatin e miqësisë, të bashkëpunimit dhe të ndihmës reciproke që u nënshkrua në mes të vendeve në Varshavë dhe ju ftoj, shokë deputetë, ta aprovojme njëzëri këtë traktat.

Të rrojë miqësia e popullit shqiptar me popujt vëllezër të lavdishëm të Bashkimit Sovjetik, me popullin e lavdishëm të Kinës së madhe, me popujt e vendeve të demokracisë popullore!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 128 (2081), 29 maj 1955

Botohet me ndonjë shkurtim sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

MBI GABIMET E TUK JAKOVËS

*Raport i mbajtur në emër të Byrosë Politike
në Plenumin XIV të KQ të PPSH¹*

15 qershor 1955

Shokë,

Qëllimi kryesor i shokut Tuk Jakova, siç del nga diskutimi i tij në Komitetin Qendror dhe nga autokritikat me shkrim që i dorëzoi Byrosë Politike, ka qenë të reviziononte vijën politike të Partisë të caktuar nga Kongresi I dhe II. Ai pretendon se «në historinë e Partisë ka shtrembërime në paraqitjen reale të ngjarjeve» dhe insiston me forcë «që të korrigjohen këto gabime, pse vetëm atëhere anëtarët e Partisë do ta mësojnë mirë historinë e Partisë».

Shtrembërimet në historinë e Partisë, sipas shokut Tuk Jakova, janë në radhë të parë në çështjen e grupeve komuniste.

¹ Ky raport u pregatit sipas porosisë së Plenumit XIII të KQ të PPSH, prill 1955.

Shoku Tuk e konsideron shtrembërim në vijë çështjen e theksimit të anëve negative të punës së grupeve në atë mënyrë, siç janë përcaktuar në Kongresin I të Partisë. Ato, sipas shokut Tuk, duhet të zbuten, dhe një nga metodat e zbutjes, që mendon ai është «të flasim pak për anët e dobëta të punës së grupeve dhe të theksojmë e të flasim më shumë për anët pozitive të tyre». Kjo është teza e përgjithshme e Tukut në lidhje me këtë çështje, të cilën ai e ka zbatuar edhe në praktikë. Shoku Tuk ka vepruar në këtë drejtim nëpërmjet leksioneve që ka zhvilluar në Shkollën e Partisë dhe me këshillimet që i ka dhënë një pedagogu të historisë së Partisë. Por këtu ka qenë fjala vetëm për lehtësimin e grupit të Shkodrës, ku Tuku militonte para formimit të Partisë. Duke bërë këtë punë shoku Tuk ka pasur për qëllim, siç e thotë ai vetë në autokritikën e tij, të nxirrte mirë në dukje rolin udhëheqës të tij në grupin e Shkodrës, pas arrestimeve të disa shokëve shkodranë.

Del e qartë se shoku Tuk Jakova nuk ka qenë dakord jo vetëm me Rezolucionin e Mbledhjes së grupeve komuniste në lidhje me grupet, por as më vonë nuk ka qenë dakord me përcaktimin e kësaj vije nga Kongresi I i Partisë.

Ne mendojmë se shoku Tuk Jakova është në rrugë të gabuar.

Mund të themi se asnjëherë brenda këtyre 10-12 viteve nuk është ngritur nga ndonjë anëtar partie çështja se në vlerësimin e aktivitetit të grupeve komuniste janë bërë gabime ose shtrembërime. Kjo tregon se Partia e ka shumë të qartë këtë çështje dhe është unani-

misht e vendosur dhe dakord me të gjitha vendimet e konferencave, plenumeve, kongreseve dhe dokumentave të saj mbi këtë problem. Vetëm shoku Tuk Jakova nuk është dakord me këtë çështje dhe ai e ka mbajtur këtë mos pajtim me vendimet e Partisë, në vetëvete, pa e shtruar në Parti për gati 14 vjet me radhë.

Tezat e shokut Tuk, në lidhje me revizionimin e punës së grupeve komuniste, përmbajnë në vetëvete shumë shtrembërime serioze në vijë.

E para dhe nga më seriozet është se shoku Tuk Jakova vazhdon t'i shikojë Partinë, luftën e saj heroike, vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste, udhëheqësit e saj të sprovuar dhe të zgjedhur demokratikisht nga konferencat dhe kongreset, nën prizmin e pjesëtarit të ish-grupit të Shkodrës. Të kthehesh pas 14 vjetësh në një çështje që është shtruar drejt nga Partia, lufta e madhe e së cilës e vërtetoi saktësinë e këtij përcaktimi, të kthehesh pas 14 vjetësh në një çështje të tillë kur uniteti dhe forca e Partisë u çimentuan, u kalitën, nëpërmjet luftërave heroike, kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve, kundër grupashëve, fraksionistëve, trockistëve, deviatorëve, tradhëtarëve të Partisë, do të thotë të bësh një punë antiparti, do të thotë të bësh tentativa për të krijuar në gjirin e Partisë një luftë grupazhi dhe fraksioniste.

E dyta, si e thekson edhe në autokritikën e tij, shoku Tuk Jakova shtyhet në këtë rrugë nga një dozë e madhe lokalizmi. Fryma e lokalizmit aq e theksuar te Tuk Jakova, është e rrezikshme, jo vetëm për një udhëheqës, por edhe për një anëtar të thjeshtë partie. Fryma e lokalizmit mund dhe të çon në pikëpamje të rrezikshme antimarksiste, siç është nacionalizmi borgjez. Në

rastin e shokut Tuk Jakova lokalizmi e ka çuar atë në devijim që ta shohë Partinë nën prizmin e një ish-pjesëtari të grupit komunist të Shkodrës, e ka çuar atë në regjionalizëm: gegë dhe toskë, dhe këtë e provon çështja e abetares në gjuhën toskërishte që përdoret në shkollat e Veriut të Shqipërisë¹, për të cilën shoku Tuk Jakova protestoi energjikisht përpara plenumit, duke thënë në mes të tjerash se «dukagjinasi, dukagjinasi do të mbetet», sikur të tjerët mendojnë se dukagjinasi duhet të bëhet skraparli. Shoku Tuk Jakova duke qenë i sëmurë në këto çështje, duket se ka pikëpamje nacionaliste-borgjeze edhe për shumë probleme të tjera të Partisë dhe të shtetit. Kur ai ka arritur të njohë se këto çështje i ka parë me syrin e një lokalisti, duhet të thellohet shumë në këtë drejtim, pse me siguri ky shtrembërim i ka rrënjët më të thella dhe i ka shkaktuar Tuk Jakovës devijime akoma më të mëdha në pikëpamjet e tija prej komunisti. Vetë fakti që Tuk Jakova përpiqet dhe kërkon që grupit komunist të Shkodrës t'i lustrohet puna, tregon që Tuk Jakova mendon se këtij grupi i është ngrënë haku, se është nënvleftësuar lufta e tij etj. etj. dhe kjo mund të shkojë zinxhir, shumë larg, në rast se je i sëmurë, siç është Tuk Jakova.

E treta, të zvogëlosh gabimet dhe pikëpamjet e gabuara e antimarksiste të grupeve, siç mendon shoku Tuk

¹ Siç e vërteton analiza shkencore, gjuha e sotme letrare shqipe nuk është toskërishtja, e ngritur drejtpërsëdrejti në gjuhë kombëtare, por është ndërtuar mbi bazën e elementit të përbashkët të shqipes, duke thithur njëkohësisht, në përpjesëtime të ndryshme, edhe elemente të veçanta e të rëndësishme nga struktura fonetike gramatikore e leksikore e të dy dialekteve.

Jakova, kjo do të thotë të mos mendosh si marksist. Grupet e para komuniste në Shqipëri kanë pasur anët e tyre pozitive dhe negative. Këto janë vënë drejt në dukje nga analizat që ka bërë Partia. Anët pozitive të grupeve komuniste i kanë shërbyer kauzës së Partisë, ndërsa anët negative e kanë dëmtuar shumë atë. Gabimet e grupeve, qofshin këto parimore, apo akte banditizmi, të ngritura në teori nga elementët trockistë dhe tradhëtarë, që militonin dhe që në disa raste udhëhiqnin në këto grupe, kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë mësim të vlefshme për Partinë tonë, pse armiqtë e Partisë vazhdojnë ta luftojnë atë me po ato armë antimarksiste.

Gabimet e rënda dhe të dëmshme të grupeve komuniste shoku Tuk Jakova i quan të tepërta të theksohen ashtu si duhet dhe kërkon që ato të zbuten. Këto pikëpamje janë shumë të rrezikshme dhe thellësisht oportuniste. Pikëpamje të tilla oportuniste të Tuk Jakova nuk janë të rastit, ato vazhdojnë si një vijë e pandërprerë në të gjithë veprimtarinë e tij, siç do ta shohim edhe më poshtë.

Është e qartë se çështja e revizionimit të grupeve nga ana e shokut Tuk Jakova, nuk është ngritur rastësisht, por krahas me pikëpamjet e tija të gabuara e antiparti që thamë më lart, ka ekzistuar edhe megalomania e Tuk Jakovës, i cili, i pajisur me të gjitha këto pikëpamje, doli në rrugën antiparti, jo vetëm për të rehabilituar veten, jo vetëm për të nënvleftësuar gabimet e tij të rënda, jo vetëm për të treguar se udhëheqja ka gabuar ndaj tij me masat që ajo ka marrë, masa që ai i quan të rënda, por për të revizionuar të gjithë vijën e Partisë dhe për të likuiduar udhëheqjen e saj.

Le të analizojmë vazhdimin e tezave antiparti të shokut Tuk Jakova.

Duhet të theksojmë që në fillim se burimi i tezave antimarksiste të shokut Tuk Jakova nuk është vizita e tij në Muzeumin e Luftës nacional-çlirimtare, siç do ta paraqitë ai. Këto teza janë bluar me vite të tëra në kokën e Tuk Jakovës dhe s'mund të jenë kurrë përshtypje të rastit të një vizitori të thjeshtë muzeumi. Vetë paraqitja e tyre, në përmbajtje dhe në format e veprimit, ashtu siç i shtroi shoku Tuk në Plenumin e Prillit të KQ dhe në autokritikat e tija, tregojnë qartë se kjo është një sëmundje e vjetër.

Çështja e grupeve që ngre shoku Tuk Jakova, jo vetëm që nuk është aq e thjeshtë dhe që me lehtësi «tërhiqet», siç thotë ai në autokritikën e tij, por ajo e ka bishtin pas si dardha që thotë populli.

Teza tjetër e Tukut është se «Partinë e formoi Miladin Popoviçi dhe në rast se Partia ka pasur një vijë të drejtë, kjo i detyrohet vetëm Miladin Popoviçit». Duke u nisur nga kjo tezë, Tuk Jakova bënte konkluzionin tjetër të gabuar se gjoja në çështjen e kultit të personit Partia jonë kishte devijuar dhe se ky devijim ishte akoma më i theksuar për arsye se «Partia bënte gabim serioz që nuk deklaronte se Miladin Popoviçi themeloi Partinë, se vija e Partisë gjatë luftës ishte e drejtë, se Miladin Popoviçi ishte faktori vendimtar, se fotografitë dhe busti i Miladin Popoviçit duhej të ishin në muzeume e në zemrat e njerëzve shqiptarë dhe më në fund se atij duhej t'i ngrihej një monument i madh».

Vetë shtruarja e çështjes së Miladin Popoviçit në këtë mënyrë, nga ana e Tukut, i cili me këtë tezë kërkon

të dalë si mbrojtësi marksist i rolit të masave, kundër kultit të personit, tregon se në këtë problem ai është në rrugë krejt antimarksiste dhe s'bën gjë tjetër veçse ekzalton kultin e personit që Partia jonë e ka dënuar dhe e dënon. Shtrembërimet në praktikë dhe jo devijimet, në lidhje me kultin e personit, Komiteti Qendror i ka marrë në diskutim dhe ka vendosur drejt. Shoku Tuk Jakova ka marrë pjesë në atë mbledhje plenumi dhe ka qenë dakord me konkluzionet e tij. Vihet pyetja, pse shoku Tuk Jakova nuk i ngriti këto çështje që në atë kohë dhe pse ai gabon përsëri kaq rëndë duke mbrojtur në fakt kultin e personit?

Përgjegjja është e qartë: Tuk Jakova formalisht ka pasë qenë dakord me Plenumin e Komitetit Qendror të Korrikut 1954 ku u diskutuan shtrembërimet në praktikë në lidhje me kultin e personit dhe duke mos qenë dakord me këtë parim marksist-leninist, ai vazhdon ta ekzaltojë kultin e personit, natyrisht për qëllime anti-parti.

Pikësëpari, Partia në Kongresin I të saj e ka shtruar drejt, në mënyrë marksiste dhe internacionaliste, çështjen e Miladin Popoviçit, i cili si komunist dhe internacionalist e ka ndihmuar Partinë tonë. Këtë çështje Partia e ka shtruar në momentin e krizës më të madhe, në lidhje me çështjen jugosllave. Kjo gjë ka treguar se Partia jonë nuk është udhëhequr dhe as do të udhëhiqet nga «konsiderata politike të momentit», siç pretendon shoku Tuk, por kur është për të vepruar në rrugën marksiste-leniniste dhe për të mbrojtur parimet marksiste-leniniste, Partia nuk heziton kurrë. Vetëm individë të lëkundshëm mund të hezitojnë. Por Partia nuk ka thënë

dhe nuk do të thotë kurrë, siç pretendon Tuk Jakova, se «Miladin Popoviçi ka themeluar Partinë» dhe se «drejtësia e vijës së saj i detyrohet këtij», pse kjo s'është e drejtë. Partinë nuk e ka themeluar Miladin Popoviçi dhe s'është Miladin Popoviçi faktori vendimtar që vija e Partisë gjatë kohës së luftës ka qenë e drejtë. Të mendosh si Tuk Jakova do të thotë të mendosh jo si marksist, por si antimarksist, si likuidator.

Partinë Komuniste të Shqipërisë e formuan komunistët shqiptarë. Pa komunistët shqiptarë nuk mund të themelohej Partia Komuniste e Shqipërisë. Komunizmi nuk importohet nga jashtë. Kjo një. E dyta, s'është vullneti i Miladin Popoviçit që themeloi Partinë tonë, por vullneti dhe dashuria e komunistëve shqiptarë për komunizmin. Për formimin e Partisë nga komunistët shqiptarë ishin krijuar gjithashtu kushtet objektive të brendshme dhe të jashtme. Tezat marksiste-leniniste të Partisë sonë për këtë çështje vendimtare dhe historike janë të qarta për të gjithë, me përjashtim të shokut Tuk Jakova dhe të atyre që kanë qenë në kundërshtim me marksizëm-leninizmin. Populli shqiptar ka luftuar me shckuj për t'u çliruar nga zgjedha e imperialistëve të ndryshëm dhe nga feudoborgjezia e vendit. Energji të pashtershme ishin grumbulluar në popullin tonë të mjeruar nga shtypja dhe shfrytëzimi. Okupacioni i Shqipërisë nga fashizmi italian ndezi si vullkan zemrat e shqiptarëve për çlirimin kombëtar. Populli shqiptar i kishte sytë dhe zemrën nga Bashkimi Sovjetik. Shpresat dhe shpëtimin e tij nga robëria shekullore i priste nga Moska, nga leninizmi. Nga gjiri i popullit tonë të vuajtur dolën komunistët e parë, që me besim të madh ndaj Bashkimit

Sovjetik, ndaj Leninit dhe Stalinit, ndaj Partisë së lavdishme Bolshevike, filluan punën, individualisht, në grupe, me të mira e me gabime, derisa arritën në formimin e Partisë.

Pra s'ishte Miladin Popoviçi që i solli këto situata në çantë as i krijoi ai me frymën e shenjtë këta komunistë dhe as që ai që themeloi Partinë. Partinë tonë e themeloi populli ynë i vuajtur dhe heroik. Nga gjiri i tij dolën njerëzit që themeluan Partinë, udhëheqjen që kërkonte populli. Partia jonë pati kurdoherë një vijë të drejtë, pse e drejtë ishte vija e popullit dhe së atë e ndriste në çdo hap marksizëm-leninizmi, të cilit Partia jonë i qëndroi, i qëndron dhe do t'i qëndrojë besnike deri në fund. Ne e çmojmë si duhet dhe sa duhet shokun Miladin Popoviç, por tezat e shokut Tuk Jakova, jo vetëm që janë të gabuara, por edhe antimarksiste e antiparti. Këto teza janë gjithashtu likuidatore, pse Tuk Jakova, nga një anë shqelmon faktorët objektivë që na mëson marksizëm-leninizmi se pa ekzistencën e tyre nuk mund të formohet Partia jonë dhe, nga ana tjetër, kërkon të likuidojë rolin e udhëheqjes së vërtetë të Partisë sonë të porsaformuar. Partinë tonë e ka udhëhequr që në fillim Komiteti Qendror Provizor dhe askush tjetër, dhe as që mund të bëhej ndryshe. Në këtë Komitet Qendror Provizor nuk u caktua në formë se kush ishte sekretar i përgjithshëm, por është fakt i njohur që këtë rol që në fillim, e luajti Enver Hoxha dhe jo shoku Miladin Popoviç dhe as mund ta luante shoku Miladin Popoviç. Me udhëheq komitetin qendror të një partie dhe me ndihmë shokët e komitetit qendror janë dy gjëra që nuk duhen ngatërruar.

Shoku Tuk Jakova i ngre këto çështje gjoja për hir të «përpikërisë historike» dhe kërkon që të vihen drejt. Është e qartë se këto çështje që janë drejt, Tuk Jakova kërkon t'i përmbysë dhe t'i vërë së prapthi. Edhe qëllimi, edhe përmbajtja, edhe forma që ka përdorur shoku Tuk Jakova për këtë problem, historikisht janë jo të drejta, por sidomos ato janë antimarksiste dhe antiparti.

Por, mos vallë Tuk Jakova në ngritjen e këtyre çështjeve parimore të historisë së Partisë, në mënyrë kaq të gabuar është shtyrë nga «konsiderata historike»? Jo. Logjika marksiste, me të cilën duhet të analizohen këto probleme që ngre Tuk Jakova, nuk të çon në atë rrugë, në rrugën e «konsideratave historike». Nuk mund të jenë gjithashtu bindëse për ne ato që thotë shoku Tuk Jakova se gjoja ai kaloi në këtë rrugë të gabuar për arsye se mbeti i pakënaqur nga masa që u muar ndaj tij për fajet që ai kishte bërë, faje këto të rënda dhe për të cilat do të flasim më poshtë. Por tani, dëshirojmë të theksojmë faktin se masa për përjashtimin e shokut Tuk Jakova vetëm nga Byroja Politike e Komitetit Qendror në krahasim me fajet e tij dhe në dritën e këtyre gabimeve të reja, mund dhe duhet të konsiderohet shumë e lehtë. Përveç kësaj, Byroja Politike, pas vendimit të marrë ndaj Tuk Jakovës dhe duke menduar ta ndihmonte seriozisht atë që të korigjohet, të ndreqet, të spastrohet, e ngarkoi me një detyrë shumë të rëndësishme, siç ishte ajo e zëvendëskryeministrit. Shokut Tuk ju krijua një ambient i ngrohtë shoqëror, ai u ndihmua pa kursyer dhe deri në atë shkallë sa që trajtimi i tij ekonomik nuk ndryshonte shumë nga ai i anëtarëve të Byrosë Politike. Një trajtim i tillë që i është bërë

shokut Tuk mund të quhet mjaft liberal. Megjithatë ai ishte i pakënaqur nga udhëheqja dhe asnjëherë, për kaq vjet me radhë, kur në kokën e tij zienin gjithë këto gjëra të sëmura, nuk pati kurajën komuniste t'ja shfaqte pakënaqësitë ose vërejtjet e tija udhëheqjes së Partisë, e cila ja kishte krijuar të gjitha mundësitë që të sqarohet.

Pse s'e bëri, pra, Tuku këtë veprim që të sqarohet? Përgjegjja është e qartë: ai nuk e bëri sepse s'ishte dakord me udhëheqjen e Partisë, jo vetëm për arësye personale, pse mbeti i pakënaqur nga masa e përjashtimit të tij nga Byroja Politike, por për shumë gjëra të tjera politike të një rëndësie të dorës së parë për Partinë.

Duhet të dalim nga rrethi i ngushtë «i muzeumit», ku Tuk Jakova kërkon të na shëtitë dhe të zhvillojmë më mirë pikëpamjet e tija, pse çështja e muzeumit s'është veçse një manifestim arrogant kundër udhëheqjes së Partisë, një metodë antiparti. S'ka asnjë dyshim se Tuk Jakova, siç e pohon edhe vetë, është shumë fodull, kapadai, bajraktar, por prapa këtyre veseve të këqia janë fshehur sëmundje të tjera shumë të rrezikshme për Partinë.

Përveç çështjeve që analizuam më lart, shoku Tuk Jakova në plenumin e prillit të këtij viti tha se, përveç shokut Enver që ka qenë konsekuent në vijën e Partisë, që nga fillimi e deri tani, udhëheqësit e tjerë nuk kanë qenë konsekuentë. Një mendim i tillë jo vetëm është krejtësisht i padrejtë dhe antiparti, por mund ta cilësojmë armiqësor, në rast se nuk e njohim Tuk Jakovën me anët pozitive dhe negative të tij. Udhëheqja e Partisë sonë është një udhëheqje kolegjiale dhe këtu qëndron forca e saj. E gjithë udhëheqja e Partisë sonë dhe udhë-

heqësit veç e veç kanë qenë kurdoherë konsekuentë në vijën e Partisë, besnikë të saj, besnikë të marksizëm-leninizmit. Ata që s'kanë qenë konsekuentë në vijën e Partisë, Partia dhe Komiteti Qendror i ka qitur jashtë radhëve të saja ose të udhëheqjes. Një pikëpamje e tillë nuk synon tjetër veçse të minojë besimin ndaj udhëheqjes, të krijojë anarki dhe konfuzion. Por shoku Tuk nuk i hodhi shigjetat vetëm në një drejtim, ai njëkohësisht ngriti edhe çështjen se shokët Gogo Nushi e Spiro Koleka nuk e paskan vendin në Muzeumin e Luftës nacional-çlirimtare, e cila sipas tij përbën një periudhë të veçantë në vetëvete, të shkëputur si të thuash nga periudha e pasçlirimit dhe se shokët Gogo dhe Spiro nuk e paskan vendin atje ku janë vënë, për arsye se këta nuk e paskan udhëhequr luftën. Këto pretendime absurde të Tuk Jakovës janë krejtësisht të padrejta, të pathemelta dhe antiparti. Periudha e Luftës nacional-çlirimtare dhe ajo e pasçlirimit nuk mund të shkëputen kurrë nga njëra-tjetra, ato janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Të përpiqesh t'i shkëputësh këto periudha do të thotë të bësh një punë antimarksiste. Jo vetëm që nuk mund të shkëputet periudha e pasçlirimit nga ajo e Luftës nacional-çlirimtare, por as këto të dyja nuk mund të shkëputen kurrë nga e gjithë historia e popullit tonë në të kaluarën, nga përpjekjet dhe luftërat e tija shekullore për liri, pavarësi, bukë, tokë dhe demokraci. Të mendosh siç mendon Tuk Jakova, se duhen ndarë këto periudha, se Byroja Politike aktuale duhet të shkëputet nga periudha e luftës, do të thotë të jesh në kundërshtim me materializmin dialektik dhe historik. Partia jonë ka qenë e do të jetë përjetë besnike e

këtyre parimeve dhe këto i ka zbatuar në jetë e po të mos i ishin errësuar sytë shokut Tuk Jakova, ai do të shihte qartë se edhe në kuadrin e ngushtë të Muzeunit të Luftës nacional-çlirimtare, edhe në Shtëpinë Muze të Partisë, këto parime përbëjnë shtyllën kurrizore të muzeumeve.

Vetëm Tuk Jakova mori guximin të thotë se shoku Gogo Nushi nuk e ka vendin si udhëheqës i Luftës nacional-çlirimtare. Natyrisht, kjo është një shpifje, pse e gjithë Partia dhe populli e njeh shokun Gogo Nushi si një nga udhëheqësit e Partisë dhe të Luftës nacional-çlirimtare nga më heroikët, nga më besnikët, nga më të vendosurit. Kudo që e ka çuar Partia, ai ka qenë i gatshëm, konsekuent dhe besnik i Partisë. Shoku Spiro Koleka, para formimit të Partisë, ka qenë si të gjithë ne, përparimtar, patriot, demokrat, antifashist, antizogist, simpatizues i komunizmit e më në fund komunist. Ai militonte në një grup komunist, i cili u shpërnda më vonë nga grupet e tjera dhe elementi i shëndoshë i këtij grupi u fut në Parti. Spiro Koleka ishte një nga këta elementë të shëndoshë. Ai e gjeti rrugën e vërtetë që kërkonte, ai luftoi me vendosmëri për Partinë dhe për popullin. Partia e emëroi anëtar të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, ai qëndron konsekuent dhe besnik i Partisë. Në qoftë se Tuk Jakova ka gabuar rëndë kaq herë në vijën politike dhe organizative të Partisë, shoku Spiro Koleka nuk ka gabuar asnjëherë. Në mbledhjen e Byrosë Politike që u zhvillua në lidhje me këtë çështje, Tuk Jakova ngriti gjithashtu çështjen se, me gjithë gabimet që kishte bërë, «meritonte të ishte në Byronë Politike më parë se Pilo

Peristeri». Edhe këto pretendime të shokut Tuk Jakova natyrisht janë pretencioze dhe të pathemelta.

Nga ana tjetër, Tuk Jakova, me këto teza kërkon të errësojë rolin udhëheqës të Partisë gjatë Luftës nacional-çlirimtare, duke u përpjekur që këtë rol ta minimizojë në një rol udhëheqës të disa personave, të shkëputur nga një udhëheqje organike, nga një udhëheqje kolektive dhe e organizuar në të gjitha format dhe instancat mbi baza marksiste-leniniste. Këto teza e çojnë shokun Tuk në rrugën anarkiste, për të mos përsëritur mbi çka thamë më sipër se sa larg është Tuku nga mbrojtja e parimit të rolit të masave në histori dhe udhëheqja kolegjiale e vendimtare e Partisë dhe sa i zhytur është ai në «kultin e personit», në ekzaltimin e personit dhe të «egos».

Por fajet e Tukur nuk ndalen këtu, në rrugën anti-parti, ai shkon edhe më tej. Në Plenumin e Prillit të KQ, në mbledhjen e Byrosë Politike dhe në autokritikën e tij të parë, ai shtron dhe mbron tezën që «në ekspozita dhe në muzeume duhet të dalin fotografitë e të gjithë shokëve që kanë marrë pjesë në konferenca partie, në kongrese partie, që kanë udhëhequr njësite, që kanë qenë në çdo mbledhje të një rëndësie historike (me përjashtim të atyre që kanë tradhëtuar)». Është e kuptueshme se sa e rrezikshme është kjo rrugë ku kërkon Tuku që të ecë Partia. Tuku përjashton vetëm ata që kanë tradhëtuar; ndërsa ata që kanë gabuar rëndë në vijën e Partisë, që s'kanë qenë konsekuentë dhe besnikë të vijës së saj, ai nuk i përjashton. Përkundrazi, Tuku kërkon t'i rehabilitojë në sy të Partisë dhe të popullit. Jo vetëm kaq, por ai kërkon me këmbëngulje që ky «ga-

bim», siç e quan ai, ndaj këtyre njerëzve, fotografitë e të cilëve sot nuk ekspozohen, duhet të korrigojohet. Kjo do të thotë të revizionohet vija e Partisë në këtë drejtim, sepse Komiteti Qendror gjoja paska gabuar ndaj këtyre shokëve. Me këtë Tuku do të thotë se lufta e ashpër e Partisë kundër deviatorëve, fraksionistëve, lufta kundër korrenteve antimarksiste dhe antiparti, kundër trockistëve e të tjerë të këtij kallëpi, paska qenë një gabim i rëndë. Ç'i kanë bërë Partisë këta njerëz, ç'dëme të mëdha i kanë sjellë punës së Partisë dhe të popullit, për Tুকun kjo s'ka asnjë rëndësi. Jo vetëm që s'ka rëndësi, por derisa Tuku kërkon që këta elementë të rehabilitohen, dhe kjo do të thotë qartë se ai është në kundërshtim me vendimet e marrura nga Komiteti Qendror ndaj këtyre njerëzve, është në kundërshtim me vendimet e Kongresit I dhe II, është në kundërshtim me parimet marksiste-leniniste, me të cilat është mbrujtur dhe çelnikosur Partia jonë, mbi të cilat bazohet dhe udhëhiqet ajo. Partia jonë i shqelmon vendosmërisht këto pikëpamje të theksuara oportuniste dhe likuidatore të Tuk Jakovës.

Tuk Jakova me tezat e tija është për shuarjen e luftës kundër ideologjisë armike në Partinë tonë, është për shuarjen e luftës së ashpër kundër trockizmit dhe presionit kapitalist që synon të likujdijë partitë tona marksiste-leniniste, ai është për revizionimin e vijës së drejtë të Partisë në drejtim të shuarjes së luftës kundër tendencave antiparti, ai është për një jetesë paqësore me tendencat antiparti në gjirin e Partisë, është për shndërrimin e Partisë sonë marksiste-leniniste në një parti borgjeze e social-demokrate. Është e qartë, jo

më për udhëheqjen, jo më për një anëtar të thjeshtë të Partisë, por edhe për çdo njeri të ndershëm të popullit se pikëpamjet e Tuk Jakovës janë pikëpamje trockiste, antiparti, antimarksiste dhe armiqësore për Partinë. Vija e Partisë sonë në këto probleme të një rëndësie të jashtzakonshme ka qenë plotësisht e drejtë. Të gjitha vendimet e Partisë që janë marrë ndaj elementëve që kanë devijuar në vijë, që kanë tradhëtuar marksizëm-leninizmin, kanë qenë plotësisht të drejta dhe plotësisht të argumentuara. Partia ka mbrojtur dhe do të mbrojë me të gjitha forcat parimet marksiste-leniniste, që përbëjnë forcën dhe jetën e saj, të ardhshmen dhe sigurinë e popullit tonë. Partia jonë do ta ashpërsojë akoma më shumë luftën kundër tendencave oportuniste, trockiste, deviatore të çdo kallëpi dhe nën çdo maskë që të paraqiten, do të luftojë me ashpërsinë më të madhe presionin e borgjezisë mbi Partinë tonë, do të luftojë me të gjitha forcat për të mbrojtur Partinë dhe unitetin e çelniktë të saj dhe Tuk Jakova të jetë i sigurtë se Partia nuk do të ecë kurrë në rrugën e humnës ku ai tenton ta futë.

Fort e çuditshme është se edhe pas ndihmës që i dha Byroja Politike, Tuk Jakova nuk e ka realizuar këtë greminë ku ai po rrokulliset, por mjaftohet të thotë vetëm se «përsa i përket rehabilitimit të këtyre njerëzve që kanë devijuar dhe gabuar rëndë në vijë, heq dorë nga kjo pikëpamje, pasi e shoh se kjo është delikate dhe mund të shkaktojë edhe konfuzion», në vend që të thotë haptazi se kjo është një punë thjesht armiqësore dhe jo krijon konfuzion, por shkallmon e i hap varrin Partisë dhe parimeve marksiste-leniniste të saj.

Nuk është hera e parë që shoku Tuk Jakova gabon kaq rëndë në vijën e Partisë. Herën e parë ai gaboi shumë rëndë, por ai gaboi edhe një herë, akoma më rëndë se herën e parë. Të dy herët shoku Tuk Jakova gaboi në të njëjtat drejtime dhe gabimet e tij kanë shkuar duke u rritur, janë thelluar e zhvilluar më shumë. Vetëm ky konstatim tregon qartë, por këtë do ta vëmë mirë në dukje më poshtë, se s'është e vërtetë siç pretendon Tuk Jakova në autokritikë, që gjoja gabimet e para i ka pasë kuptuar thellë, se kritikën i ka pranuar me gjithë zemër dhe se vetëm masa i është dukur e rëndë! Jeta tregoi dhe provoi se gabimet e para të rënda ai nuk i ka pasë kuptuar, nuk i ka pasë thelluar si duhet, kritikën nuk i ka quajtur të drejtë, ashtu siç pretendon dhe autokritika e tij del se ka qenë e përcipte dhe formale. Marksizëm-leninizmi na mëson se ai që njih ndershmerisht gabimet, shumë vështirë mund të gabojë në po atë drejtim. Kurse Tuk Jakova gaboi akoma më rëndë se më parë, në të njëjtin drejtim, pikërisht se gabimet nuk i ka njohur.

Në ç'drejtime ka pasë gabuar Tuk Jakova herën e parë? Gabimet e tij janë të freskëta në kujtesën tonë, por le të përmendim përmbledhjen e këtyre gabimeve, duke cituar tekstualisht përcaktimin në Kongresin II të Partisë:

«U konstatua se veprimtaria e Tuk Jakovës, karakterizohej nga një oportunizëm dhe liberalizëm i madh, nga një mungesë vigjilence revolucionare e theksuar dhe nga një neglizhencë serioze në zbatimin e detyrave. Këto gabime e kishin çuar Tuk Jakovën në praktikë të vepronte e të mendonte në kundërshtim

me vijën politike dhe organizative të Partisë. Kështu ngjau që kapitullimin e Ymer Dishnicës në Mukje, pikëpamjet oportuniste të Sejfulla Malëshovës, punën antiparti të grupit të Niazi Islamit me shokë, jo vetëm t'i nënvleftësonte po t'i kuptonte me vonesë. Tuk Jakova vijën politike të Partisë dhe të shtetit në lidhje me fenë dhe me klerin katolik, veçanërisht, nuk e kishte kuptuar drejt dhe vepronte në kundërshtim, duke mos e parë rrezikun e elementëve klerikë reaksionarë. Tuk Jakova nuk e urrente në shkallën e duhur armikun e klasës dhe kjo e bënte atë të binte shumë herë në pozita oportuniste.

Si sekretar i Komitetit Qendror për kuadrot, Tuk Jakova, nuk e kishte kryer detyrën si duhet dhe kishte bërë lëshime serioze. Te Tuk Jakova mungonte vigjilenca dhe ekzistonte një kënaqësi e tepruar në vetëvete. Ngaqë ai kishte të tilla pikëpamje lufta për forcimin e Partisë, të kritikës e të autokritikës, të demokracisë së brendshme, ishte dobësuar. Të gjitha këto tregonin qartë se Tuk Jakova për një kohë të gjatë ishte në opozicion me vijën e Partisë dhe në rast se Partia do të ishte vënë në rrugën oportuniste të Tuk Jakovës, kjo patjetër do ta çonte në likuidimin e saj dhe të pushtetit popullor»¹.

Krahasoni tani këtë përmbledhje të shkurtër të gabimeve të para të Tuk Jakovës, sillni në mend zhvillimin e plenumit dhe të aktiveve ku u analizuan gjerësisht gabimet e para të Tuk Jakovës, mendoni veprimtarinë armiçësore, trockiste, likuidatore, antimarksiste, an-

¹ Enver Hoxha, Vepra, vëll. 9. f. 225-226.

tiparti të Sejfulla Malëshovës dhe të Ymer Dishnicës dhe i krahasoni me analizën e sotme që ne po u bëjmë gabimeve të dyta të shokut Tuk Jakova. Është e qartë se shokut Tuk Jakova jo vetëm gabimet e para nuk i kanë shërbyer asnjë grimë për t'u shëruar, jo vetëm se ai ka bërë një autokritikë formale, por ka vazhduar me ndër-gjegje në rrugën e tij të gabuar dhe i ka zhvilluar e thelluar në mënyrë të rrezikshme këto pikëpamje anti-marksiste dhe antiparti.

Nuk mund të qëndrojë në këmbë çështja e fodullëkut dhe e kapadaillëkut që gjoja Tukun e paskan shtyrë të ribjerë në këto gabime të rënda. Ne e thamë se kapadaillëku dhe bajraktarizmi janë të huaja për komunistët dhe duhet të luftohen me këmbëngulje prej tyre, por në rast se Tuk Jakova do të vazhdojë të mbahet nga kjo degë për të gjetur rrënjët e thella të gabimeve të tij, atëhere dega do të thyhet dhe ai do të bjerë në llum.

Është një arësye çështja e mungesës ideologjike që e bën komunistin të gabojë. Kjo nuk mund të mohohet. Kush është i ngritur ideologjikisht, mund të gabojë më pak, por nuk është aspak e vërtetë se ata që kanë nivel të ulët ideologjik gabojnë orë e çast, siç bën Tuk Jakova. Në Partinë tonë kemi me dhjetëra mijë anëtarë, të cilët, nga ngritja ideologjike dhe kulturele, po t'i krahasosh me Tuk Jakovën, janë si nata me ditën, por ata jo vetëm që nuk gabojnë në vijë, siç bën Tuk Jakova, por ecin drejt dhe e mbrojnë vijën e Partisë me heroizëm, me konsekuencë, me besnikëri të madhe. Në qoftë se Tuk Jakova mbështetet përsëri në këtë degë që është i ulët ideologjikisht, prandaj gabon dhe nuk thellohet shumë për të gjetur dhe për të zbuluar arësytet e vërteta të gabimeve, me atë ngritje

ideologjike që ka tani, ai do të futet edhe më thellë në llum. Vetë fakti i analizës së parë të gabimeve të tij që bëri Komiteti Qendror, plenumet dhe Kongresi II, duhet të ishin një shkollë ideologjike marksiste-leniniste për Tukum, ashtu siç ishin për gjithë Partinë. Por Tuku ideologjinë marksiste-leniniste e kupton si një stoli të shkëputur nga lufta e Partisë, nuk e kupton si një armë për të çarë rrugën përpara, si armën e shkëlqyer të Partisë sonë për të ndërtuar socializmin dhe komunizmin dhe për të shkallmuar nga rrënjët botën kapitaliste. Tuku e sheh studimin e marksizëm-leninizmit jo me syrin e një komunisti, në luftë dhe në veprim, por me syrin e një artizani të intelektualizuar.

Është gjithashtu absurde dhe pa themel thënja e Tukut se gjoja mosdërgimi i tij në Bashkimin Sovjetik, ose mosqenja e tij në Shoqërinë e Miqësisë me Bashkimin Sovjetik ose në Plenumin e Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë, e kanë shtyrë atë në pakënaqësi etj. Përsa i përket besimit ndaj Tukut dhe trajtimit të tij nga udhëheqja, këto i thamë më lart. Ndërsa përsa i përket heqjes së Tukut nga ato detyra sekondare, ky ishte një vendim i Komitetit Qendror dhe ky vendim s'u muar vetëm ndaj Tukut, por ndaj mjaft udhëheqësve kryesorë, që ishin ngarkuar me shumë funksione dhe me detyra honorifike. Ky vendim ishte i drejtë dhe vetëm Tuku që ka qenë i sëmurë e ka parë shtrembër këtë dhe e përdor sipas qejfit të tij.

Tuk Jakova përveçse ka gabuar rëndë në vijën politike, siç e analizuam më lart, ka bërë edhe një gabim tjetër të madh organizativ.

Të gjitha këto pikëpamje të shtrembra që zienin

në kokën e Tukut që prej vitit 1952, të paktën siç thotë ai, dhe megjithëse nuk i mungon guximi, siç thotë përsëri ai, këto pakënaqësi Tuk Jakova nuk pati asnjëherë guximin komunist t'i shtronte përpara udhëheqjes, ashtu si na mëson Partia dhe siç e lypin rregullat e saja organizative. Përjashtohet çdo arësyetim se ai nuk i di këto rregulla organizative, përjashtohet gjithashtu çështja se atij nuk i ishin krijuar kushtet që haptazi të kritikonte çdo veprim dhe çdo njeri për çështjet që ai mendonte, drejt ose gabim, se ishin për të kritikuar. Përjashtohet dhe është gjithashtu qesharake që Tuku të pretendojë se për kaq vjet me radhë ka harruar t'i shtrojë këto gjëra përpara udhëheqjes.

Përkundrazi, Tuk Jakova, duke qenë në kundërshtim me vijën e Partisë dhe me udhëheqjen dhe duke shkelur vijën organizative, jo vetëm që ka bërë atë skenën e dënueshme përpara drejtorit të muzeumit, kur e dinte fare mirë si anëtar i Komitetit Qendror se ku duhet t'i bënte vërejtjet e tija, por këto pakënaqësi dhe pikëpamje të shtrembra, ai i bisedoi me disa shokë, jashtë rregullave të Partisë. Me sa dimë ne deri tani, dhe këtë jo nga goja e shokut Tuk Jakova, ky ka biseduar me shokun Bedri Spahiu dhe me dy shokë të tjerë. Shoku Tuk Jakova as në një nga autokritikat e tija, as në mbledhjen e Byrosë Politike, as edhe në mbledhjen e Plenumit të Prillit të KQ nuk ka zënë në gojë asnjë nga shokët në fjalë. Ndërsa dy shokët deklaruan vetë përpara plenumit çka kish biseduar Tuku me ta, shoku Bedri Spahiu nuk foli asgjë për këtë në plenumin e prillit. Kur Byroja Politike në mbledhjen speciale që bëri me Tukun e pyeti këtë dy herë të deklaronte a kishte biseduar dhe çfarë kishte bi-

seduar me shokun Bedri, ai refuzoi të flasë duke thënë: «S'mbaj mend ç'kam folur me shokun Bedri». Për çështjen e Bedriut do të flasim më vonë, pasi të kemi mbaruar me çështjen e Tukut.

E gjithë kjo metodë pune e Tuk Jakovës bie erë e rëndë e një përgatitjeje terreni për të gjetur mbështetje në disa shokë në Parti dhe në udhëheqje për të përkrahur tezat e tija antiparti, në mos një punë grupazhi antiparti.

Shoku Tuk Jakova nuk harroi të shtronte përpara Plenumit të Prillit të KQ edhe çështjen e një mbesës së Patër Anton Harapit, tradhëtarit të njohur, e cila vrau veten duke u hedhur nga dritarja e spitalit. Këtë çështje shoku Tuk Jakova e shtroi sikur fajin e ka një udhëheqës i Partisë në Shkodër, i cili gjoja është treguar sektar dhe ka shtrembëruar vijën e Partisë në praktikë. Kjo mund të jetë edhe ashtu si thotë shoku Tuk, megjithëse çështja po hetohet, pse vetëvrasja e vajzës u bë një vit më vonë se ajo të ishte pushuar nga puna, vetëvrasja mund të jetë shkaktuar nga fillimi i meningjitit, ose çështje dashurie etj. Kjo do të vërtetohet, por një gjë është provuar: atë vajzë e kanë shoqëruar në varrim vetëm farefisi i saj prej jo më shumë se 50 vetësh, kurse Tuk Jakova u shpreh këtu në plenum, duke thënë se asaj vajze, mbesës së tradhëtarit Patër Anton Harapit, ju bënë nderime të tilla, saqë kurrë Shkodra nuk mund t'i bëjë në rast se vdes një udhëheqës! Ne jemi në kundërshtim të madh me shokun Tuk Jakova. Shkodra ka qenë, është dhe do të jetë e popullit, e Shqipërisë, e Partisë dhe jo e klerit reaksionar e as e clementëve të tjerë të reaksionit. Ne nuk e nënvleftësojmë rrezikun e

klerikëve katolikë reaksionarë, por as e mbivlerësojmë atë siç bën Tuk Jakova, i cili kërkon të na frikësojë. Partia jonë nuk frikësohet nga një grusht reaksionarësh, pse ajo e ka me vete të gjithë popullin heroik, patriot dhe punonjës të Shkodrës.

Pas kësaj analize ne jemi akoma më të bindur se ç'ishim në Plenumin e Prillit të KQ, kur dhamë mendimin tonë se edhe forma e paraqitjes së pikëpamjeve nga ana e shokut Tuk ka qenë tendencioze dhe në formë të dukshme diversioni, për të mbjellë konfuzion dhe për ta çuar plenumin në rrugë të gabuar. Natyrisht, Tuk Jakova u gabua rëndë dhe këtë herë, si edhe herët e tjera, ai nuk e ka njohur forcën e Partisë dhe unitetin e çelniktë të udhëheqjes për të mbrojtur unitetin në Parti dhe vijën marksiste-leniniste të saj. Tuk Jakova, natyrisht i ka pasë grykuar çështjet e Partisë dhe i ka vlerësuar anëtarët e plenumit me syrin e tij prej komunisti shumë të sëmurë dhe kujtoi se do të gjente në Komitetin Qendror një pellg me oportunistë. Për fat të keq të tij dhe për lavdinë e Partisë dhe të marksizëm-leninizmit, Tuk Jakova e mori përnjëherësh përgjegjen e merituar nga anëtarët e Plenumit të Komitetit Qendror, që qëndrojnë vigjilentë dhe luftojnë me konsekuencë dhe me heroizëm për të mbrojtur interesat e larta të Partisë dhe të popullit në rrugën e leninizmit.

Më në fund Byroja Politike, me qëllim që ta ndihmonte edhe më shumë shokun Tuk dhe t'ja përgatiste këtë çështje sa më qartë Komitetit Qendror, e këshilloi atë të thellohej më tepër në autokritikën e tij dhe të gjente arësyet e vërteta politike dhe organizative që e shtynë të bënte këto gabime të rënda, të gjente arësyet e

thella dhe haptazi e sinqerisht t'i thoshte Partisë pse ai i mbajti pa i thënë për kaq kohë këto pakënaqësi dhe pse i shfaqti pikërisht në këto momente. E ndihmuam shokun Tuk, duke e pyetur se mos vallë ngjarjet ndërkombëtare të kohëve të fundit i kanë lëkundur atij besimin në drejtësinë e vijës së Partisë, i kanë errësuar atij gjykimin. Tuk Jakova është përgjegjur se asgjë s'ka nga këto. Mirëpo ne nuk jemi të bindur me këtë pohim të shokut Tuk Jakova.

Si konkluzion i kësaj analize, që Byroja Politike i bëri çështjes së gabimeve të shokut Tuk Jakova, është se atij i është lëkundur besimi në vijën e drejtë politike dhe organizative të Partisë dhe kjo ka shkaktuar te ai mosbesim ndaj udhëheqjes së Partisë.

Tuk Jakova, i zhytur në pikëpamje oportuniste dhe duke mos i njohur sinqerisht gabimet e para të tij, nuk ka pranuar masën e drejtë që Komiteti Qendror ka pasë marrë ndaj tij në vitin 1951. Kjo gjë, natyrisht, ka bërë që ta mbajë atë në pozitat e vjetra të sëmura antiparti, oportuniste të theksuara.

Duke mos bërë autokritikë të sinqertë, duke mos qenë i bindur në gabimet e tij të rënda dhe duke qenë në kundërshtim të heshtur me vijën e Partisë, Tuk Jakova, vazhdoi t'i thellojë akoma më shumë gabimet e tij dhe doli përsëri në rrugë të kundërt me Partinë dhe me vijën e saj marksiste-leniniste. Tuk Jakova u përpoq që të revizionohej e gjithë vija e Partisë, sepse sipas tij në të ishin vërtetuar gabime të rënda. Tezat e Tuk Jakovës për revizionimin e vijës së Partisë janë thellësisht antimarksiste, antiparti dhe oportuniste; ato janë për likuidimin e Partisë dhe të udhëheqjes marksiste-leniniste

të saj, ato janë për pajtimin me tendencat antiparti, antimarksiste, oportuniste, deviatore dhe fraksioniste në gjirin e Partisë; ato janë për shuarjen e luftës kundër ideologjisë borgjeze dhe presionit të borgjezisë mbi Partinë tonë; ato janë shkatërrimtare për një parti marksiste-leniniste si Partia jonë. Shoku Tuk Jakova për të dylën herë ka gabuar rëndë dhe i ka sjellë një dëm të madh Partisë. Ai nuk ka qenë i sigurtë ndaj Partisë. Partia dhe udhëheqja e saj e ka ndihmuar shumë dhe sinqerisht që të korrigohej dhe të dilte në rrugë të drejtë, por shoku Tuk Jakova e ka shqëlmuar këtë ndihmë të drejtë dhe komuniste të Partisë dhe të udhëheqjes.

Shoku Tuk Jakova ka punuar në kundërshtim me rregullat organizative të Partisë, duke ja fshehur udhëheqjes pikëpamjet e tija të kundërta me vijën e Partisë, dhe duke ua shtruar këto në rrugë të rrezikshme dhe antiparti disa shokëve të Partisë dhe të udhëheqjes. Shoku Tuk Jakova t'i flasë më hapët dhe më sinqerisht Partisë që ta ndihmojë Partinë dhe që Partia ta ndihmojë atë, ashtu si ka bërë dhe do të bëjë kurdoherë me anëtarët e saj kur gabojnë. Tuk Jakova, më shumë se kurdoherë tjetër, ka nevojë për një ndihmë të madhe, pse gabimet e tij u përsëritën dhe janë shumë të rënda.

Komiteti Qendror le t'i gjykojë dhe të vendosë.



Siç jeni në dijeni, Tuk Jakova për çështjet që shtroi në Plenumin e Prillit të KQ ka biseduar me Bedri Spahiun dhe me dy shokë të tjerë. Asnjë nga këto bisedime,

jo në rrugë partie, nuk është konfirmuar nga Tuku. Megjithëse shoku Bedri Spahiu diskutoi në plenum, pasi kishte folur Tuk Jakova, pasi shumë shokë të Komitetit Qendror ishin ngritur dhe goditën pikëpamjet e gabuara të shokut Tuk, pasi edhe dy shokët me të cilët Tuk Jakova kishte biseduar më parë, deklaruan bisedimet me Tukun, Bedriu nuk u ngrit në plenum, jo vetëm të diskutonte dhe të thoshte pikëpamjen e tij në lidhje me tezat e Tukut, por as t'i raportonte plenumit bisedimet që ai kishte pasur shumë kohë më parë me të. Kjo ishte detyra minimale e një anëtarë të thjeshtë partie. Shoku Bedri heshti dhe, si është shprehur më vonë në autokritikën e tij, ai ishte i vendosur të mos diskutonte për këto çështje, pse gjoja mendonte se për ato do të mblidhej përsëri plenumi. Rastësisht Bedriu i tha shokut Manush Myftiu pas seancës së fundit të Plenumit të Prillit të KQ, se Tuku kishte biseduar me atë për këto çështje. Menjëherë, për këtë gjë, shoku Manush, i raportoi Byrosë Politike. Edhe pasi Plenumi i Prillit i KQ ja ngarkoi Byrosë Politike të analizonte dhe t'ja pregatiste Komitetit Qendror çështjen e Tuk Jakovës, shoku Bedri Spahiu as që kërkoi të vinte në dijeni Byronë Politike për çka ai dinte mbi këtë punë dhe ta ndihmonte Partinë. Shoku Bedri heshti derisa vetë Byroja Politike u detyrua ta thërriste. Pra, shoku Bedri heshti në plenum dhe më pas ai as që mori inisiativën t'ja raportonte Byrosë Politike bisedimet që ka pasur me Tukun.

Kur u pyet shoku Bedri nga Byroja Politike për këto bisedime me Tukun, ai i shtroi çështjet shumë

cekët, të errëta, me plot kontradikta, aspak të thelluara, pa parë nga ana e tij asnjë rrezikshmëri në tezat e Tuk Jakovës, megjithëse ka pasur kohë të mendohej dhe të thellohej. Byroja Politike, natyrisht, nuk mbeti e kënaqur. Ajo e ndihmoi shokun Bedri dhe e këshilloi të thellohej më shumë në këto çështje, të dilte me një autokritikë më të hapët dhe t'ja paraqiste këtë me shkrim. Ai e paraqiti këtë raport ose autokritikë, në rast se mund ta quajmë të tillë. Kjo «autokritikë» është pasqyra e po atyre çështjeve që ai paraqiti në mbledhjen e Byrosë Politike, por këtë herë natyrisht me fjalë më të peshuara, më të matura, më lakonike. Me gjithë kujdesin e dukshëm të Bedriut për ta shkruar këtë «autokritikë», natyrisht nuk mundi t'ja mbushte mendjen Byrosë Politike, e cila caktoi tre anëtarë të saj të bisedonin përsëri me Bedrinë ku ai të sqaronte arësyet e vërteta, që nuk dilnin gjëkund në «autokritikën» e tij dhe që e shtynë atë të heshtte. Edhe këto bisedime të fundit me shokun Bedri kanë qenë pa rezultate të dukshme.

Të analizojmë tani ku qëndrojnë gabimet e Bedri Spahiut.

Ç'ka biseduar Tuk Jakova me Bedri Spahiun? Këto gjëra Bedriu i redukton në shtatë radhë, të cilat përbëjnë sintezën e sintezave të tezave të Tukut që shtroi në Plenumin e Prillit të KQ. Megjithatë, Bedriu thotë se Tuku i ka folur atij për vendosjen keq të fotografive të anëtarëve të Byrosë Politike në Muzeumin e Luftës nacional-çlirimtare, i ka folur për shokët Gogo dhe Spiro që fotografitë e tyre «s'e kanë vendin atje ku janë vendosur», i ka folur për «shtrembërimet» e çështjes së grupeve dhe për abetaren. Kur është pyetur Bedriu se si i

ka gjykuar këto pikëpamje të Tukut, ai i lë këto krejtësisht të mbylura, për arsye se këtu qëndron çështja më delikate që Bedriu duhet të sqarojë. A ka qenë apo s'ka qenë dakord Bedri Spahiu me pikëpamjet e Tuk Jakovës, ose deri ku ka qenë? Kjo është çështja kryesore që Bedriu duhet ta sqarojë haptazi dhe sinqerisht. Po kështu edhe Tuk Jakova, në rast se dëshiron ta ndihmojë Partinë dhe shokun Bedri Spahiu, duhet të mos heshtë, po t'i kujtohen mirë dhe qartë bisedimet e tij me Bedrinë dhe pikëpamjet e këtij të fundit në këtë çështje kryesore.

I thamë Bedriut që, si anëtar i Komitetit Qendror, kur dëgjoji pikëpamjet e Tukut që kishin të bënin me vijën e Partisë, pse nuk e vuri në dijeni Komitetin Qendror? Përgjegjja e Bedri Spahiut ka qenë se këtyre çështjeve nuk u vuri rëndësi. Natyrisht për ne, një përgjegje e tillë nga një anëtar i Komitetit Qendror, jo vetëm që s'është aspak bindëse, por tregon edhe mungesë të madhe të vigjilencës revolucionare dhe pajtim me pikëpamjet e Tuk Jakovës. Në vazhdim të diskutimeve me shokun Bedri Spahiu, ai pohoi se kish vajtur, kish parë muzeumin dhe më në fund arriti të thosh se muzeumin, me ndonjë gabim të vogël, të parëndësishëm, e gjeti në rregull dhe realizoi se Tuk Jakova gabohej në atë çështje. Por edhe pas vizitës në muzeum, ku Bedriu konstatoi se Tuku gabohej, ky përsëri nuk i dha rëndësi kësaj çështjeje dhe jo vetëm nuk vuri në dijeni Komitetin Qendror, por nuk shkoi as te Tuku për t'ja kundërshtuar pikëpamjet e tija dhe ta ndihmonte në ndreqjen e gabimeve.

Këto fakte na bindin edhe një herë për atë që Bedri

Spahiu jo se nuk u ka vënë rëndësi këtyre problemeve delikate, por më tepër se në këto çështje pikëpamjet e Tuk Jakovës puqeshin me të tijat. Por, të supozojmë për një moment se të gjitha këto çështje shoku Bedri Spahiu, duke mos qenë vigjilent, i ka quajtur të parëndësishme, dhe, duke mos u vënë rëndësi, siç thotë ai, nuk lajmëroi as udhëheqjen e Partisë. Por, kur çështjet u shtruan në Plenumin e KQ dhe u kërkua që shoku Tuk Jakova të ndreqte gabimet e tij, që kishin të bënin me vijën e Partisë atëhere punët ndryshuan, pse shokët e plenumit, një nga një, u ngritën dhe i goditën ashpër pikëpamjet antiparti dhe antimarksiste të Tuk Jakovës. Edhe dy shokët me të cilët kish folur Tuk Jakova vunë në dukje bisedimet që kish bërë më parë ai me ta. Të gjitha këto diskutime u bënë para se të ngrihej dhe të fliste Bedriu, i cili edhe kur diskutoi, heshti për të gjitha këto gjëra. Në këtë rast, teza e Bedriut se i mungon vigjilenca revolucionare bie dhe nuk qëndron në këmbë. Teza tjetër se këto çështje ai i kishte gjykuar të parëndësishme dhe prandaj s'ja kishte raportuar Komitetit Qendror, bie gjithashtu dhe s'qëndron në këmbë. Atëhere, kur të gjitha këto arësye rrezohen, kur Komiteti Qendror i dënon pikëpamjet e gabuara të Tuk Jakovës, pse shoku Bedri Spahiu, që s'i mungon as mprehtësia, as gjykimi, as retorika, nuk flet po hesht? Kur ishte pyetur prej nesh pse nuk foli në këtë kohë, kur gjërat ishin të qarta, shoku Bedri nxori si arësye se «isha i vendosur të mos flisja në atë mbledhje, pse mendoja se kjo çështje do të merrej në shqyrtim përsëri në ndonjë mbledhje tjetër».

Natyrisht kjo është një arësye për ata që duan të

gjejnë një shkak dhe për të mos shfaqur arësytën e vërtetë.

Të gjithë anëtarët e Komitetit Qendror e dinin pse kanë eksperiencën e Partisë, se çështja e Tuk Jakovës nuk mund të zgjidhej në këmbë dhe në një seancë ku diskutoheshin problemet e mëdha ideologjike të Partisë. Ata e dinin fare mirë se çështja e Tukut do të shtrohej gjerë, por megjithkëtë ata folën, dhanë mendimin e tyre të parë dhe të drejtë për të mbrojtur vijën e Partisë. Ne i thamë shokut Bedri se kjo arësye nuk është bindëse dhe s'mund të qëndrojë në këmbë, i thamë singërisht edhe çka mendonim ne, pse nuk foli Bedriu në plenumin e prillit për bisedimet që kishte bërë me Tuk Jakovën. Mendimi ynë është dhe këtë ja thamë Bedriut, se heshtja e tij është shkaktuar nga këto rrethana:

Që të fliste Bedriu duhej ose të dënonte pikëpamjet e Tuk Jakovës, ose t'i mbronte, meqenëse këto pikëpamje përbënin thelbin e bisedimeve të mëparshme në mes të tyre. Po të mbronte tezat e Tuk Jakovës, në rast se ai ka qenë dakord me to, do të gabonte rëndë, pse Bedriu nga diskutimet e anëtarëve të plenumit e realizoi se Tuk Jakova gabohej shumë rëndë në vijë, pra edhe Bedriu tok me të. T'i kundërshtonte tezat e Tuk Jakovës ashtu si i kundërshtoi plenumi, Bedriut i duhej të pohonte dhe të bënte autokritikë se ishte që më parë në dijeni dhe s'kishte pasur kundërshtim me këto teza. Ose duke marrë parasysh se Tuk Jakova nuk e zuri në gojë Bedrinë, Bedriu mund ta dënonte Tuk Jakovën, pa pohuar se kishin biseduar më parë për këto çështje dhe kanë pasë qenë dakord. Por këtu ishte rrezik që Tuk Jakova të merrte fjalën dhe të pohonte se kishte bise-

duar më parë me Bedrinë për këto çështje dhe s'kishte gjetur asnjë kundërshtim nga ana e tij. Bedriu zgjodhi rrugën e heshtjes.

Pra si konkluzion, Bedriu, megjithëse e kuptoi rrezikshmërinë e tezave të Tuk Jakovës për Partinë, nguroi, u tremb të dilte përpara plenumit dhe t'ja thoshte haptas, shtrembër ose drejt, ashtu si mendonte. Bedriu ishte i vendosur të mos fliste për të fituar kohë dhe për asgjë tjetër. Të gjitha këto arësytetime që u bënë nga ana jonë, Bedriu nuk i pranoi, bile u revoltua dhe u bë nervoz duke pretenduar se ai nuk mund të kishte frikë të fliste, por megjithatë pranoi se logjika të çon në këto konkluzione, ku dalim ne.

Bedriu vazhdoi të mos flasë edhe pas plenumit, duke qenë në dijeni të plotë se Komiteti Qendror ngarkoi Byronë Politike ta studjonte këtë problem dhe t'ja pregatiste plenumit. Bedriu, si anëtar i Komitetit Qendror dhe duke ditur kaq gjëra në lidhje me Tukun, e kishte për detyrë që të vinte vetë të ndihmonte Byronë Politike dhe të mendonte të paktën: «herën e parë udhëheqjen nuk e vura në dijeni, pse këto gjëra i quajta të parëndësishme, herën e dytë, kur çdo gjë ishte e qartë dhe ishte koha të flisja, unë s'fola në plenum; të paktën të tretën herë të marr kurajën se jam komunist dhe të vete haptazi dhe sinqerisht t'ja them Byrosë Politike të gjitha». Bedriu edhe të tretën herë këtë gjë s'e bëri dhe arësyeja që dha ai kur u pyet ishte kjo: «mendoja se ato që do t'i thoshja unë Byrosë Politike nuk do ta ndihmonin atë». Arësye shumë e çuditshme nga një anëtar i Komitetit Qendror dhe sidomos kur Komiteti Qendror e By-

roja Politike s'kanë aspak dijëni për bisedimet që ka bërë Tuk Jakova me Bedri Spahinë.

Të gjitha këto qëndrime a nuk mund të na detyrojnë të mendojmë se shoku Bedri nuk flet, para se të gjejë fjalën me Tuk Jakovën për qëndrimin që duhet të mbajnë mbi këtë çështje? Ne mund të gabohemi, por Bedriu le të na sqarojë dhe të na bindë.

Gjithashtu ne e besojmë Bedrinë kur na thotë se «medoemos do të fliste më vonë», kur të merrej përsëri në shqyrtim çështja e Tukut, por ne kemi edhe të drejtën të dyshojmë, pas gjithë këtyre veprimeve jo të drejta, që Bedriu mund edhe të mos fliste. Të supozojmë për një minutë sikur shoku Manush t'i quante të parëndësishme çka i tha Bedriu, ashtu si i ka quajtur Bedriu çka i tha atij Tuku dhe të mos e vinte përnjëherë në korrent Byronë Politike. Kur do të vinin në plenumin e sotmë, Tuku nuk do të fliste, nuk do të fliste as Bedriu, dhe po të mos fliste edhe Manushi, atëherë as plenumi as Byroja Politike nuk do të dinin gjë për bisedimet e Tukut me Bedrinë. Kështu çështja do të bëhej më serioze pse njerëzit nuk do të ndihmoheshin që të shëroheshin dhe të sqaroheshin.

Si konkluzion i analizës së çështjes së Bedriut, del se ai ka gabuar rëndë, duke mos e vënë në korrent udhëheqjen e Partisë për bisedimet që ai ka pasur me Tukun, jo vetëm që në fillim, por gjatë gjithë etapave të zhvillimit të tyre. Bedriu në këtë çështje ka shkelur rregullat organizative të Partisë dhe Statutin e saj, të cilat ai i njeh fare mirë. Bedriut i ka munguar kurajua dhe guximi prej komunisti t'ja thoshte hapët dhe sinqerisht Partisë këto çështje, t'i thoshte Partisë arësyet e vërteta

dhe të thella që e penguan të ecte në rrugën e drejtë të Partisë në këto çështje. Arsyet që ve përpara Bedriu për të shpjeguar të tilla veprime s'qëndrojnë në këmbë dhe nuk mund t'i rezistojnë logjikës marksiste-leniniste.

Këto janë anët organizative të gabimit të shokut Bedri në këtë çështje që po analizojmë. Duke u bazuar në këtë analizë, ne kemi arritur në konkluzionin se Bedriu, megjithëse nuk ka qenë inisiator i këtyre gabimeve të rënda në vijë të Tuk Jakovës, është treguar i gatshëm t'i dëgjojë, t'i aprovojë dhe të ketë rënë dakord me të gjitha ato çka i tha Tuku.

Çka i tha Tuku, ne dimë vetëm ato çka thotë Bedriu, por ato janë të mjafta për ta ngarkuar Bedrinë me gabime të rënda për të cilat ai është përgjegjës.

S'është e rastit që Tuk Jakova gjeti Bedriun dhe i hodhi këto ide antiparti. Këto ai i ka bërë sigurisht duke pasur parasysh të kaluarën në Parti të Bedriut, duke shfrytëzuar te ai disa pakënaqësi të hapëta ose të heshtura që kishte vënë re, duke pasur parasysh vërejtjet dhe masat që janë marrë nga Partia ndaj Bedriut dhe për këto masa Tuku ka menduar se Bedriu ka qenë i pakënaqur. Tuku të gjitha këto i ka matur me kutin e vet.

A kanë ekzistuar te shoku Bedri pakënaqësi ndaj Partisë, vijës dhe udhëheqjes së saj? Këto kanë qenë pyetjet që ne i bëjmë vetes, meqenëse shoku Bedri nuk thellohet vetë dhe kur u pyet nga ne, ai u përgjegy se asgjë nuk ekziston nga këto. Ne mendojmë se te shoku Bedri duhet të ketë pasur pakënaqësi dhe paqartësi në vijën e Partisë për disa çështje.

Ne dimë se Bedriu ka pasur në jetën e Partisë ten-

denca të theksuara oportuniste, tendenca që e puqin me Tjukan, dhe Partia ka marrë masa ndaj tij. Në jetën e Partisë, te Bedriu ka pasur vazhdimisht tërheqje, si me thënë sa të jetë e mundur e më shumë të rrijë në hije, të kryejë ato detyra të caktuara që i ka ngarkuar Partia. Një tërheqje e tillë nuk ka arësytën e thjeshtësisë, një tërheqje e tillë në hije nuk i përshtatet karakterit të Bedriut që është impulsiv, shumë herë nevrik etj. Natyra e Bedriut është e atillë që ai është ambicioz në punë, prandaj ne mendojmë se këtu ka një kontradiktë të theksuar midis natyrës së Bedriut dhe qëndrimeve të tij në tërheqje. Një komunist, qoftë edhe kur ka gabuar rëndë, por që i ka njohur gabimet, ecën me kurajë të dhjetëfishuar përpara. Te Bedriu nuk e shohim këtë karakteristikë. Ne mendojmë se Bedriu duhet të ketë pakënaqësi dhe paqartësi në vijë. Mund që ai të mos jetë plotësisht dakord me masat që janë marrë ndaj tij nga ana e Komitetit Qendror, mund që të mos i ketë kuptuar qartë gabimet e tij. A ka pasur shfaqje të hapëta pakënaqësie dhe paqartësie nga ana e Bedriut si shfaqjen te Tuku? Ne nuk kemi parë, por na kanë rënë në sy disa gjëra që do t'i themi më poshtë.

Qëndrimet e Bedriut ndaj shokëve të udhëheqjes, veçanërisht ndaj nesh, shokëve të Byrosë Politike, kanë qenë korrekte, por jo të ngrohta, ashtu siç janë treguar shokët e Byrosë të ngrohtë e të afërt me të. Kjo gjë na ka bërë përshtypje shumë kohë më parë, por ishte e natyrshme të mos e vinim re, sidoqë vazhdimisht kur piqeshim i thoshim: «Ku je, na mori malli, s'të shohim fare etj.». Këto janë vetëm shfaqje të jashtme dhe mund të mos kenë rëndësi.

Po një korrektesë e tillë e ftohtë është konstatuar te shoku Bedri edhe në lidhjet e punës me aparatën e Komitetit Qendror. Çdo çështje që ka ai, e bën me letër, çdo përgjegje e kërkon me shkrim (nuk flasim këtu për raportet kryesore). Ndryshe janë kontaktet e të gjithë shokëve të Komitetit Qendror dhe të ministrave me aparatën e Komitetit Qendror. Kjo gjë është vërejtur te ai. Shoku Bedri është në gjendje vetë të na sqarojë dhe duhet të na sqarojë që të jemi edhe ne të qartë, pse te Bedriu ka nënvleftësim për aparatën e Komitetit Qendror, kjo gjë mund të shkojë edhe më lart nga aparati, duke marrë parasysh se Bedriu ka qenë vetë në Byronë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të Partisë dhe nuk është i qartë për gabimet që ka bërë e për masën që është marrë ndaj tij dhe kjo pakënaqësi manifestohet në mënyrë të dukshme te Bedriu.

Një çështje tjetër që na ka rënë në sy në shkrimet e Bedriut, të viteve të fundit, është ngritja e çështjeve të nacionalistëve të vjetër në një formë të ekzaltuar dhe me një zell të madh, gjë që të lë të kuptosh sikur gjoja ai po e ndreq harresën e Partisë në këtë çështje. Në qoftë se ekziston një pikëpamje e tillë, kjo natyrisht është e gabuar, pse këtë problem Partia kurrë s'e ka lënë në harresë. Përkundrazi e kaluara e njerëzve përparimtarë dhe patriotë të popullit tonë është një thesar kombëtar i popullit dhe i Partisë. Por Partia e ka pasur dhe kurdoherë e ka për detyrë t'i shpjegojë çështjet nën prizmin e marksizëm-leninizmit dhe të spastrojë ferrat e pikëpamjeve nacionaliste-borgjeze. Duke e njohur Bedrinë në pikëpamjet jo shumë të qarta të fillimit në lidhje me fenë etj., ja kujtojmë këto mo-

mente për të mos rrëshqitur në pozita të gabuara, nacionaliste-borgjeze.

Çështja tjetër që është një fakt, është mosinteresimi i shokut Bedri për aktivizimin e Shoqërisë së miqësisë me Bashkimin Sovjetik ku ai është president. Për këtë punë jo të kënaqshme Bedriu është kritikuar si veças ashtu edhe në Plenumin e Prillit të KQ, por ai as u interesua ta ngrinte këtë problem si një nga çështjet e punës ideologjike të Partisë siç u ngrit edhe në plenum.

Sido që në Plenumin e Prillit të KQ u tha për sukseset në përgjithësi në sektorin e arësimit, dhe suksese ka në realitet, ne po të futemi më thellë, në brendinë e çështjes, do të gjejmë të meta serioze në punën e arësimit, do të gjejmë një rutinë të dëmshme në mjaft shkolla, mësues e pedagogë, një punë shumë burokratike dhe formale, mungesë perspektive dhe inisiative nga ministria dhe nga trupi mësimor. Energji dhe mundësi të mëdha ekzistojnë në arësim. Partia duhet më shumë dhe më seriozisht të interesohet, pse interesimi i saj në bazë ka qenë i paktë, por edhe interesimi i ministrisë nuk ka qenë më i madh. Shumë shkolla janë ndërtuar të reja, por mjaft nga ato i sheh të shkatërruara, të rjepura, pa xhame. Shkollave që janë bërë model nuk u është dashur fond i veçantë nga shteti. Ato i kanë bërë arësimitarët dhe nxënësit. Po t'i thuash Ministrisë së Arësimit pse s'ecin shkollat në këtë rrugë, sigurisht do të të përgjigjet se «s'ka fonde, s'ka materiale».

Duhet vënë në dukje se me rastin e punimit të vendimit të plenumit të prillit të këtij viti Partia në bazë e ka kritikuar mjaft Ministrinë e Arësimit për këto probleme

dhe veçanërisht shokun Bedri për mos interesim dhe shumë herë përbuzje për çështjet e artit dhe të kulturës. Të tilla kritika i janë bërë kudo shokut Bedri dhe drejtorit të kulturës në Ministrinë e Arësimit, Frano Jakovës, të cilit Bedriu ja ka varur në qafë të gjithë drejtimin e sektorit të kulturës e arteve dhe as e drejton e as e kontrollon, prandaj ai bën çfarë të dojë vetë. Puna e Frano Jakovës është një punë krejtësisht e dëmshme dhe e rrezikshme, jo vetëm në gjirin e drejtorisë dhe të njerëzve të artit në kryeqytet, por është një përbuzje për artin, muzikën etj., të rajoneve të ndryshme të Shqipërisë, me përjashtim të Shkodrës, ku do ta gjesh çdo herë, jo për punë, por për ahengje dhe për t'i sjellë Tuk Jakovës informata të trilluara dhe me karakter tendencioz të mbledhura në qarqet reaksionare që frekuenton ai në qytetin e Shkodrës.

Të gjitha këto situata duhet t'i analizojë thellë shoku Bedri, i cili duhet të gjejë arësyet e vërteta që e kanë shtyrë atë të bëjë gabimet e përmendura më lart.

Të bësh gabime si ato të Bedriut, nuk mund të mos jesh i shtyrë nga disa konsiderata ose kundërshtime të heshtura ndaj vijës së Partisë ose nga pakënaqësi të patreguara. Ne arrijmë në këto konkluzione, se gabimet e Bedriut janë gabime të rënda në vijë, se këto duhet ta kenë burimin në pakënaqësi dhe paqartësi të disa çështjeve të vijës së Partisë. Ato që ne mundëm t'i analizojmë, ja parashtrijmë plenumit dhe ai le t'i gjykojë dhe të vendosë.

Por ne u themi edhe një herë shokëve Tuk Jakova dhe Bedri Spahiu, të jenë krejtësisht të hapët dhe të sinqertë përpara Partisë, për ta ndihmuar që dhe kjo

t'i ndihmojë si duhet këta shokë, të cilët kanë gabuar për shumë herë me radhë, dhe ata duhet të binden se kanë mbajtur rezerva, prandaj kanë gabuar. Vetëm kur të shkunden nga të gjitha rezervat atëhere garancia është shumë e madhe se ata nuk do të gabojnë më dhe Partia do t'u japë dorën e saj shpëtimtare, siç ka bërë dhe siç do të bëjë kurdoherë.



Partia duhet të jetë kurdoherë vigjilente. Siç e shohim, elementë të lëkundshëm në vijën e Partisë e rrezikojnë këtë në rast se nuk shtohet në kulm vigjilencia e saj. Partia jonë ka kaluar shumë prova të hidhura, pse elementë të tillë të lëkundshëm, deri edhe armiq, kanë pasë infiltruar deri në udhëheqjen e Partisë. Të tillë kanë qenë Sejfulla Malëshova, Ymer Dishnica, Liri Gega, Koçi Xoxe, Pandi Kristo etj. Të tillë kanë qenë elementët e tjerë të lëkundshëm në vijë, të cilët më në fund janë hedhur në kundërshtim të hapët me vijën e Partisë, kanë vepruar fshehurazi dhe haptazi kundër Partisë, kundër marksizëm-leninizmit. Partia i ka spastruar këta elementë të rrezikshëm dhe nga kjo luftë e ashpër kundër elementëve tradhëtarë, deviatorë, fraksionistë, trockistë që janë përpjekur me të gjitha mjetet të likuidonin Partinë dhe pushtetin popullor, Partia ka dalë e fortë, ka çelënikosur radhët e saja dhe unitetin në Parti dhe në udhëheqje. Partia ka fituar gjithashtu një eksperiencë të madhe nga këto pësi-me dhe nuhatja revolucionare e saj është mprehur jashtë-

zakonisht. Kjo është provuar në jetën dhe në luftën e Partisë, këtë e provoi edhe një herë Plenumi i Prillit i Komitetit Qendror, ku anëtarët e Komitetit Qendror i kuptuan menjëherë pikëpamjet antimarksiste dhe antiparti të Tuk Jakovës dhe i thanë atij aty për aty se të tilla teza nuk kalojnë nga Komiteti ynë Qendror. Përpara plenumit Tuk Jakova ndeshi në unitetin e çel-niktë dhe marksist-leninist të udhëheqjes së Partisë sonë.

Por mësimet e Partisë nuk mund të themi se kanë qenë mësimet të vlefshme për disa shokë siç është Tuk Jakova. Partia ka theksuar dhe thekson vazhdimisht se presioni i borgjezisë mbi Partinë tonë është i madh, se ideologjia armike përpiket me luftë të bëjë rrënime në radhët e Partisë sonë, të krijojë pika të dobëta dhe të sëmura nga ku të mund të infektojë Partinë. Kjo ideologji dhe presionet e huaja e armiqtësore përpiqen të mbjellin konfuzion, të dobësojnë besimin ndaj Partisë dhe vijës së saj të drejtë, të dobësojnë më tej nervat e të dobtëve, të mbjellin pakënaqësi në njerëzit e lëkundshëm, të nxitin e të kultivojnë veset mikroborgjeze dhe të përgatitin kështu fushën për veprime të egra kundër Partisë dhe pushtetit popullor.

Partia na mëson orë e çast se armiku punon që të vërë në gjumë vigjilencën revolucionare të anëtarëve të Partisë dhe kështu të mund të veprojë më lirisht. Armiku përpiket të zhvillojë në njerëzit e Partisë ndjenjën false të një qetësie dhe të zbutjes së luftës së klasave, të zbutjes së kritikës dhe autokritikës bolshevike, pse këto janë armë të mprehta të Partisë, të cilat po të jenë kurdoherë të ngritura, armikut dhe tentativave të tija u prilet menjëherë hovi dhe koka. Mjaft

shokë si Tuk Jakova i harrojnë shpejt këto mësimë të vlefshme të Partisë dhe prandaj bëjnë gabime kaq të rënda që dëmtojnë Partinë dhe popullin. Pse nuk u vë veshin dhe nuk i zbaton si duhet këto mësimë të Partisë shoku Bedri Spahiu, i cili nuk reagon përpara gjërave që s'tingëllojnë në vijë, po i merr shumë lehtas? Le të mendojë pak seriozisht se në ç'rrugë të rrezikshme e çojnë Partinë ato gjëra që ka dëgjuar nga Tuk Jakova dhe i ka ngrënë si bukë e djathë të mëngjezit.

Partia na ka mësuar dhe na mëson vazhdimisht se manifestimet oportuniste në vijë, devijimet nga e djath-ta janë shumë të rrezikshme, sidomos në Partinë tonë që është akoma e re. Në periudha të ndryshme ato janë shfaqur të acaruara dhe në forma të ndryshme. Këto pësime të Partisë duhet të na bëhen kurdoherë mësimë dhe jo objekte të historisë, siç mendon Tuk Jakova.

Pikërisht pse Tuk Jakova këto mësimë të mëdha të Partisë sonë i ka lënë t'i zërë pluhuri i muzeumeve, gaboi për të dytën herë. Shpejt i harroi Tuku gabimet e tij të rënda oportuniste; shpejt e harroi Tuku premtimin solemn që i bëri më parë Komitetit Qendror se «Tuk Jakova nuk shkel më në dërrasë të kalbur». Për fat të keq ai shkeli përsëri në dërrasë të kalbur, se mësimet e Partisë s'i vuri as në tru, as në jetë. Kush largohet nga parimet e Partisë, kush i merr si gjëra të lehta mësimet, rregullat, ligjet e Partisë, ai do të gabojë, do ta trashë gabimin dhe më në fund do të gjendet në luftë me Partinë. Është e thjeshtë të flasësh për kritikën dhe autokritikën me fjalë dhe me deklarata, por është shumë e vështirë t'i zbatosh ato si duhet në jetë. Sikur Tuk Jakova ta kishte thënë hapët, që ditën e parë atë

që i lindi në mendjen e tij, çdo gjë do të sqarohet dhe ai nuk do të binte në këto gabime të rënda. Sikur shoku Bedri të kishte vepruar po ashtu, çështja do të qe sqaruar më parë.

Ashpër i ka pasë kritikuar shoku Bedri shokët e sigurimit në rrethin e Delvinës se gjoja ata pa të drejtë akuzonin disa shokë të byrosë së komitetit të Partisë në atë rreth për mungesë vigjilence dhe gratë e tyre për vjedhje. Raport i bëri ai Komitetit Qendror për këtë çështje, raport të hollësishëm bile, ku i paraqiste këta shokë të sigurimit si një bllok kundër udhëheqjes së Partisë dhe konferencës së Partisë të Delvinës. Po ta lexosh këtë raport që i ka bërë Bedriu Komitetit Qendror për shokët e sigurimit të Delvinës, mund të krijosh përshtypjen e një shoku shumë vigjilent që shikon edhe qimen në vezë.

Por, kur vjen puna për pikëpamjet antiparti, antimarksiste dhe revizioniste të Tuk Jakovës, kur Tuk Jakova, në mënyrë të palejueshme nga rregullat e Partisë, përçmon udhëheqësit, Bedriut kjo s'i bën asnjë përshtypje, këto ai i quan gjëra të parëndësishme.

Duam të theksojmë këtu se vigjilenca e Bedriut për çështjen e Delvinës nuk ka qenë në rrugë të drejtë, pse jeta dhe koha u dha të drejtë shokëve të sigurimit të Delvinës. Akuzat dhe dyshimet e tyre u faktuan se ishin të drejta. Disa nga gratë e atyre shokëve kishin vjedhur. Mund të nxjerrim konkluzionin e fundit se, kur ka qenë puna për të mprehur vigjilencën, Bedriu, është përpjekur ta shuajë. Mund t'i themi shokut Bedri se vigjilenca kundër vigjilencës së vërtetë revolucionare është shumë e dëmshme, është një vigjilencë oportuniste, si me thënë,

kurse në rastin e Tuk Jakovës s'ka fare vigjilencë dhe kjo është e natyrshme kur notohej në ujërat oportuniste.

Është për këto arsye, shokë, që vigjilenca revolucionare duhet të shtohet pa pushim, se armiqtë punojnë me egërsinë më të madhe kundër Partisë dhe popullit tonë, se lufta kundër oportunistit dhe oportunistëve duhet të ashpërsohet dhe të goditen që në shfaqjet e para. Partia jonë duhet ta zbatojë dhe të bëjë të veprojë me efikasitet të madh arma e mprehtë e kritikës dhe e autokritikës bolshevike kundër çdo shfaqjeje të dëmshme dhe të rrezikshme për Partinë, kundër kujt do qoftë, me pozitë të ulët ose të lartë në Parti dhe në shtet.

Duhet shokë, e gjithë Partia dhe shokët udhëheqës pa përjashtim, të ristudjojnë Statutin e Partisë, t'i kenë kurdoherë të freskëta në kokën dhe në zemrat e tyre të drejtat dhe detyrat e anëtarit të Partisë, të kenë të freskëta rregullat dhe ligjet e Partisë dhe jo të harrohen ato, siç bëjnë Tuk Jakova dhe Bedri Spahiu.

Disiplina e Partisë në përgjithësi dhe disiplina ndaj rregullave organizative duhet të na udhëheqin në çdo punë dhe kush i neglizhon ato, me siguri do të gabojë. Në Partinë tonë, disiplina e vetëdijshme duhet të jetë e hekurt. Me fjalë këtë e thonë mjaft dhe Tuku e Bedriu, por kur vjen puna ta zbatojnë si Tuku dhe Bedriu e harrojnë dhe e shkelin. Lufta e komunistëve për të mbrojtur parimet e Partisë duhet të jetë një luftë e shenjtë, lufta për të çelnikosur çdo ditë e më shumë unitetin e Partisë duhet të jetë edhe ajo një luftë e shenjtë. Detyrë e dorës së parë për Partinë është zbatimimi i parimit të luftës së klasave edhe brenda radhëve të Partisë, pse rasti i Tuk Jakovës duhet të na bëjë

të mendojmë se lufta e klasave nuk shfaqet kurdoherë dhe kudo me një maskë. Esenca e luftës dhe e qëllimeve të armiqve të klasës janë kurdoherë të njëjta: likuidimi i Partisë dhe i pushtetit popullor, por format janë të ndryshme. Komunistët duhet të jenë vigjilentë, t'i diktojnë këto forma dhe t'i luftojnë armiqtë e Partisë dhe të klasës, në çdo formë që ata do të shfaqen.

Ne nuk do të flasim këtu për çështjen e ngritjes ideologjike, për studimin e marksizëm-leninizmit nga të gjithë anëtarët e Partisë, pse për këtë problem të rëndësishëm u bë një plenum i veçantë, ai i prillit të këtij viti, por duam të theksojmë edhe një herë me këtë rast të hidhur që i ngjau Partisë se shokët e Partisë dhe në radhë të parë shokët e udhëheqjes, do të bëjnë gabimin më të madh në rast se neglizhojnë studimin e teorisë së Partisë sonë, marksizëm-leninizmin, në rast se atë nuk e bluajnë mirë në kokën e tyre, në rast se nuk e bëjnë një jetë të dytë dhe ta zbatojnë në jetë dhe në luftë, ta përdorin për aksion.

Nga çështja e Tuk Jakovës dhe e Bedri Spahiut, Partia dhe udhëheqja duhet të nxjerrin mësim të vlefshme. S'ka asnjë dyshim, dhe këtë na e mëson marksizëm-leninizmi, na e mëson lufta e Partisë sonë, se pas kësaj çështjeje, Partia jonë do të forcohet akoma më shumë, udhëheqja e Partisë dhe uniteti i saj do të bëhen akoma më të fortë dhe më të çelniktë.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**FJALA E MBYLLJES NË PLENUMIN XIV TË KQ
TË PPSH «MBI VEPRIMTARINË ANTIPARTI
DHE ARMIQËSORE TË TUK JAKOVËS
DHE TË BEDRI SPAHIUT»**

17 qershor 1955

Më lejoni, shokë, të them edhe unë disa fjalë rreth çështjeve që u diskutuan në këtë plenum lidhur me veprimtarinë antiparti dhe armiqësore të Tuk Jakovës dhe të Bedri Spahiut.

Duket qartë se analiza që i bëri Byroja Politike dhe Komiteti Qendror këtij problemi me rëndësi kaq të madhe për Partinë ka qenë plotësisht e drejtë dhe mund ta cilësojmë shpëtimtare për të. Kjo u arrit për arsye se udhëheqja e Partisë sonë është një udhëheqje marksiste-leniniste, e kalitur, e sprovuar dhe luftarake për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, të interesave të popullit tonë, të interesave të udhëheqjes së lavdishme të popullit, Partisë së Punës të Shqipërisë, të interesave të socializmit dhe të komunizmit.

Së pari, sipas mendimit tim, Plenumi i Komitetit Qendror tregoi një pjekuri të madhe për zgjidhjen e drejtë të kësaj çështjeje. Me diskutimet që bëri, ai qëndroi në lartësinë e duhur dhe, me mprehtësinë më

të madhe e me vigjilencën revolucionare më të shëndoshë, i analizoi thellë, me hollësi dhe në bazë të fakteve veprimet antiparti e antimarksiste që kanë kryer Tuk Jakova dhe Bedri Spahiu. Kjo është një garanci shumë e madhe për Partinë tonë, garanci jashtëzakonisht e madhe. Ky fakt dëshmon qartë edhe një herë se Komiteti Qendror i Partisë sonë është një mburojë e çelniktë e parimeve të leninizmit, se në Komitetin Qendror të Partisë sonë nuk mund të kenë vend për shumë kohë oportunistët dhe armiqtë, me gjithë mjetet, format, metodat dhe maskat që ata mund të përdorin. Përpara unitetit të çelniktë të Partisë sonë elementë si Tuk Jakova e Bedri Spahiu nuk mund të kenë jetë të gjatë në Parti.

Së dyti, Tuku, Bedriu dhe të tjerë si këta duhet të kuptojnë se uniteti i Komitetit Qendror nuk është vetëm një formulë, por një realitet i madh. Udhëheqja e Partisë sonë është një udhëheqje e shëndoshë, kolegjiale, leniniste-staliniane. Në Komitetin Qendror nuk mund të zotërojnë vetëm mendimi i njërit ose i shtatë vetëve, siç ka pretenduar Tuku, kur është marrë vendim ndaj tij, por është vullneti, mendimi e vendimi kolegjial i gjithë Komitetit Qendror. Këtë e provon jeta, e provojnë faktet. Këtë e vërtetuan më së miri edhe punimet e këtij plenumi, ku ne praktikua një formë tjetër, me qëllim që Tuku e Bedriu të shihnin posaçërisht se uniteti i Komitetit Qendror, uniteti i mendimit dhe i veprimit në Komitetin Qendror të Partisë sonë nuk është ashtu si mendojnë këta. Forma që u përdor në këtë mbledhje të plenumit është se anëtarët e Byrosë Politike folën në fund, ndërsa ata që folën të parët ishin

anëtarët e Komitetit Qendror, të cilët i shfaqën lirisht mendimet e tyre, ashtu sikurse kanë vepruar vazhdimisht kur e kanë marrë fjalën në udhëheqjen e Partisë sonë. Pikëpamja që kanë pasur Tuku dhe Bedriu se në udhëheqje nuk ka unitet mendimi e kolegjalitet, është krejtësisht e gabuar dhe pa baza.

Konkluzionet në të cilat arritën Byroja Politike dhe plenumi që diskutuan gjerësisht dhe drejt çështjen e Tukur dhe të Bedriut, nuk i tund as topi. Këto konkluzione nuk erdhën vetë, por janë rrjedhim logjik i fakteve dhe janë plotësisht me baza. Jeta dhe lufta e Partisë tregojnë se, në qoftë se ka ndonjë çështje që nuk qëndron si duhet, lufta e Partisë shumë shpejt i nxjerr në shesh të gjitha të vërtetat. Konkluzionet në të cilat ka arritur Plenumi i Komitetit Qendror i Partisë sonë janë këto:

Tuku dhe Bedriu nuk mund të ndahen nga njëri-tjetri sepse ata kanë qëllime të njëjta. Konkluzioni i cili bazohet në analizën e Byrosë Politike, është se këta të dy, me veprimtarinë e tyre, kanë dashur ta likuidojnë Partinë tonë të Punës, Partinë tonë marksiste-leniniste dhe në vend të saj të ishte një parti social-demokrate, antimarksiste, me tendenca fashiste. Pra, qëllimi i këtyre të dyve ishte një: ta likuidonin Partinë tonë marksiste-leniniste dhe ta zëvendësonin atë me një parti tjetër borgjeze, ashtu siç bëri më përpara Titua me udhëheqjen e tij.

Natyrisht, për të likuiduar Partinë, më parë duhet të likuidohet udhëheqja ekzistuese marksiste-leniniste dhe udhëheqja e Partisë të jetë në duart e tyre. Këto janë veprime të egra të armiqve dhe kur flasim kështu

kemi parasysh trockistët dhe të gjithë armiqtë e tjerë të Partisë. Këtu nuk është çështja me likuidue një, dy ose katër nga shokët e udhëheqjes, por me likuidue të tërë udhëheqjen marksiste-leniniste të Partisë sonë, domethënë me likuidue gjithë këtë udhëheqje që mbron marksizëm-leninizmin, parimet e Partisë sonë, pra me likuidue atë që mbron interesat e popullit shqiptar, të socializmit dhe të komunizmit në vendin tonë. Ky ishte qëllimi i tyre.

Për të arritur këtë qëllim, natyrisht, armiku u bie njerëzve: një këtu, një atje që t'i eliminojë këta një nga një dhe pastaj t'i zëvendësojë me njerëz të tjerë, të huaj për marksizëm-leninizmin që do ta çonin Partinë dhe popullin tonë në prehërin e imperializmit. Pikat duhet t'i vëmë mirë mbi «i», edhe për arësyen sepse Tuku e Bedriu në tërë veprimtarinë e tyre, gjë që do ta shpjegoj edhe më poshtë, janë vënë në kundërshtim me vijën marksiste-leniniste të Partisë sonë. Ata nuk mund të pajtoheshin me këtë vijë. Fjalëve të tyre jo thashë kështu, jo thashë ashtu, nuk është nevoja t'u hyjmë prapë në hollësi, se janë të qarta. Tani mendoj të përqëndrohem në disa konkluzione përgjithësuese për të parë se përse këta njerëz arritën deri këtu.

Ata arritën deri këtu sepse nuk janë marksistë-leninistë dhe Bedriu jo vetëm që s'është i tillë, por ai është edhe armik i Partisë dhe i popullit, fajet e tij janë shumë më të rënda. Tuku e Bedriu nuk kanë qënë kurrë marksistë-leninistë. Cilët janë dhe si veprojnë ata që nuk janë marksistë, por hiqen si të tillë? Nga vetë eksperiencia e Partisë sonë, nga eksperiencia e madhe e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe e lëvizjes

komuniste ndërkombëtare të proletariatit, ne dimë metodat, format, formulat dhe aktivitetin e të gjithë njerëzve pseudomarksistë të Internacionales II dhe të trockistëve, që erdhën si bishtra dhe bashkëveprues të Internacionales II.

Çështja që ngriti Tuku mbi grupet e vjetra komuniste, nuk është diçka e thjeshtë. Qëllimi i Tukur nuk ishte vetëm për të ngritur veten e tij, por të rrithej edhe anët e dobëta të këtyre grupeve, të cilat, siç e dimë, të gjitha kanë qenë pikëpamje kokë e këmbë të gjalla antimarksiste, domethënë kanë qenë pikëpamje për të luftuar çdo gjë që çonte në formimin e Partisë, në mbrojtjen e komunizmit, në çlirimin e atdheut. Shumë njerëz të grupeve, njëri nga këta është edhe Bedriu, që na del më i egër (do ta shpjegoj më vonë pse) si dhe Tuku, nuk janë spastruar nga pikëpamjet antimarksiste të këtyre grupeve. Jeta e Partisë, lufta e saj, i shkatërroi rrënjësisht pikëpamjet antimarksiste të grupeve, por këto pikëpamje kanë ekzistuar e janë ruajtur vazhdimisht te Tuku e Bedriu.

Çfarë pikëpamje antimarksiste të grupeve duhet të përmendim ne me këtë rast? Grupet nuk kishin besim te proletariati, pra ishin kundër diktaturës së proletariatit. Mbani mend teorinë e Anastas Lulos në grupin e të cilit ka milituar edhe pas formimit të Partisë shoku Bedri. Grupi ku militonte Bedriu ka qenë për okupimin e Shqipërisë nga Italia. Krerët e këtij grupi thoshin se ky okupim do t'i bëjë shumë mirë Shqipërisë, sepse do të bëjë që të ngrihen fabrika dhe do të krijohet proletariati, pastaj shohim e bëjmë. Domethënë të kemi proletariati një herë, pa të tjerat pastaj i shohim, pikë-

pamje këto që janë antimarksiste, trockiste. Këto pikëpamje te Bedriu i shohim në faktin që ai pranon të bëhet anëtar i partisë fashiste, dhe me këtë ai pranoi okupacionin e Shqipërisë. Këtë fakt asnjëri nuk mund ta mohojë. Bedriu ishte i mendimit se duhej të futeshin në partinë fashiste dhe ashtu bëri duke pretenduar se atje do të grumbulloheshin njerëzit dhe me ta do të bënin punë. Këto pikëpamje antimarksiste Bedriu i ka zbatuar në jetë. Bedriu u fut në partinë fashiste, siç duket jo me qëllim që të maskohej. Tani po del qartë se ai në të gjente pika takimi nga ana ideologjike.

Ç'pikëpamje e veprime të tjera antimarksiste kishte në grup? Në grup ishte ngritur në teori edhe çështja e banditizmit. Fakte për Bedrinë nuk kemi që të ketë marrë pjesë në vjedhje ose të ketë bërë veprime imorale etj. Këtë nuk e themi, por akti i sotëm i Bedriut, duke mbajtur një qëndrim tepër arrogant ndaj plenumit, për mua është një akt fashist, ndryshe nuk ka si të shpjegohet. Domethënë ideologjikisht Bedriu është në rrugë fashiste dhe kjo që bëri sot është një akt banditizmi. Edhe një patriot, pa qenë marksist, dhe të tillë ka me qindra dhe mijëra në vendin tonë, nuk mund të sillët ashtu si u suall sot përpara Komitetit Qendror Bedriu, të cilin Partia e ka zgjedhur deri në udhëheqjen më të lartë të saj. Ai, pra, nuk pati asnjë respekt për Partinë. Ai mbajti një qëndrim të tillë, sepse pikëpamjet e tija janë fashiste. Çështjet që kërkon të ngrejë Bedriu këtu, nuk mund ta gënjejnë Komitetin Qendror, as nuk mund të prekin zemrat e shokëve nga fjalët e tija që tha se jo kam qenë i varfër, jo jam rritur në mizerje etj. Ç'tregon e vërteta? Në jetë ka ndodhur që mund

të jesh i varfër dhe ta tradhëtosh popullin dhe Partinë. Faktet vërtetojnë se si ke luftuar ti dhe si i ke mbrojtur Partinë dhe popullin.

Pikëpamjet nacionaliste-borgjeze të Bedri Spahiut Byroja Politike nuk i thotë kot; këto ajo i ka të bazuara. Përveç atyre që u thanë çështja është se të gjitha këto veprime të Bedriut puqen me ideologjinë e klerit bektashian. Pas tërë këtyre pikëpamjeve e veprimeve antimarksiste, nuk mund të gëlltitet më ajo që ka thënë vazhdimisht Bedriu se «unë u bëra myhib për arësye taktike». Kjo nuk është çështje taktike e Bedriut, por një çështje ideologjike. Në kokën e tij ekzistojnë pikëpamje idealiste, që pajtohen plotësisht me pikëpamjet reaksionare të klerit. Bedriu në kokën e tij ruan pikëpamje idealiste, që s'kanë asgjë të përbashkët me marksizmin. Le të marrim çështjen që Bedriu e quan përsëri si një qëndrim taktik. Ai ka kërkuar për të studjuar libra të shoqërive të ashtuquajtura fetare amerikane e angleze, por që s'janë tjetër veçse shoqëri agjenturale. Ç'është ky njeri, që na hiqet si marksist dhe në kohë aq të vështira për popullin e komunistët orvatet për të studjuar libra të tillë? Kjo ndodh se Bedriun e tërheqin këto ide fetare, idealiste. Po a luftoi Bedriu? Po, luftoi, ashtu si luftoi. Po pse luftoi, kur kishte të gjitha këto gjëra në kokë? Në Luftën nacional-çlirimtare mori pjesë i gjithë populli, pse momenti ishte çlirimi i vendit. Kështu edhe Bedriu, i shtyrë nga ky moment u hodh në luftë. Edhe Tuku mori armën dhe luftoi, por me gjithë pjesëmarrjen në luftë këto pikëpamje nuk ndryshuan te këta njerëz. Në fakt Bedriu edhe pse mori pjesë në luftë, që nga fillimi i saj, ka qenë kundër vijës së

Partisë, kundër udhëheqjes së zgjedhur nga Partia. Këto gjëra ne i dimë nga analizat që janë bërë dhe që shoku Haki Toska me plot të drejtë i vuri shumë mirë në dukje. Këto tregojnë se gjatë gjithë periudhës së luftës Bedriu nuk ka qenë dakord me Komitetin Qendror dhe me vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë.

Po të analizojmë qëndrimet e Bedriut edhe gjatë luftës ndaj fshatarësisë, çfarë konkluzione teorike duhet të nxjerrim? Ne mund të nxjerrim se ai nuk ka qenë për fshatarësinë e varfër, por për agallarët. Komiteti Qendror e ka kritikuar Bedrinë për veprimet e tij në Gjirokastër në lidhje me fshatarësinë. Kjo ilustron faktin se Bedriu nuk ka qenë kurrë marksist. Ai, siç e theksuam, nuk ka qenë dhe nuk është as me proletariatin, duke mos pasur besim në atë, dhe si rrjedhim nuk ishte as dhe për aleancën e proletariatis me fshatarësinë. Kjo duket e paimagjinueshme, por kështu del, po të analizojmë faktet, dhe erdhi koha që ta bëjmë një analizë të tillë.

Bedriu, pikëpamjet antimarksisteleniniste i shfaq edhe më vonë, në periudhën pas çlirimit. Ato mbeten vazhde në tërë veprimtarinë e tij. Pse themi që këto gjëra nuk janë të rastit? Faktet tregojnë se pikëpamjet e Bedriut puqen edhe me pikëpamjet e Sejfulla Malëshovës. Po pse u puq Bedriu me to, ç'influencë ka pasur Sejfullau te Bedriu? Puna është që të dy këta janë në një rrugë, në rrugën kundër vijës së Partisë. Sejfullau hidhet më përpara kundër Partisë, por kjo nuk do të thotë se Bedriu nuk është në një rrugë me të, ai ka qenë që më përpara në atë rrugë, prandaj vajti dhe ju mbështet Sejfullaut dhe Ymer Dishnicës. Kur u godit

Sejfullau, Bedriu me Tukur thanë të tërhiqemi nga Byroja Politike sepse, duke mos qenë dakord me vijën e Partisë, i trembeshin Partisë, nuk mund të rronin me një udhëheqje të tillë që mbronte marksizëm-leninizmin, prandaj kërkuan të tërhiqen. Ku është parë që një marksist të tërhiqet nga detyra që i ka vënë Partia? Bedriu ngrihet dhe me mburrje thotë që nuk më ka hequr Byroja Politike, por kam kërkuar të hiqem vetë pasi kam qenë anëtar i partisë fashiste, sikur Partia nuk e dinte këtë gjë. Partia këtë gjë e dinte dhe pat menduar se që një gjë e rastit, e imponuar, por jeta dhe aktet e Bedriut tregojnë se ai nuk ishte për në Komitetin Qendror, prandaj kërkoi që të tërhiqej si anëtar i tij. Kjo nuk piu ujë atëhere kur u likuidua oportunizmi i Sejfulla Malëshovës dhe Bedriu vuajti shumë. Në kohën që do të bëhej Kongresi II i Partisë Bedriu mendoi se ishte rasti që të kërkonte të largohej nga Byroja Politike. Vetëm një antimarksist mund ta bëjë një veprim të tillë. Edhe Tuku ka gabuar shumë rëndë, por të paktën ai thotë se do të bëjë të gjitha përpjekjet që të ndreqem atje ku do të më dërgojë Partia. Qëndrimi i egër i Bedriut para Plenumit të KQ është një demonstracion tjetër fashist, me të cilin ai vërteton se duhet të hidhet jashtë nga udhëheqja. Pa dyshim që edhe mendimi im është që Bedriu të përjashtohet jo vetëm nga udhëheqja por edhe nga Partia. Këtë e ka menduar edhe ai me qëllim që të shpëtojë një herë e mirë nga vuajtjet që po kalon prej kaq vjetësh! Dhe në fakt, Bedriu, vuan se ai ndodhet pa dashje, pa vullnetin e tij në një parti marksiste-leniniste duke qenë antimarksist-leninist dhe kundër marksizëm-leninizmit. Edhe veprim-

met e tij, po t'i marrësh të shkëputura, dalin në këtë rrugë; të gjitha këto janë në kundërshtim me Partinë, veprime me krijue pengesa që vija e Partisë të mos zbatohet si duhet, që ndërtimi i socializmit në vendin tonë të mos ecë përpara me vrull.

Në këtë rrugë Bedriu patjetër nuk do të vinte brrë dhe të thoshte ja ku i kam. Ne, këto veprime të Bedriut nuk na kanë kaluar pa i vënë në dukje dhe pa i kritikuar. Por tani është koha që t'i analizojmë thellë ato, se nuk janë të shkëputura, por janë veprime sistematike kundër Partisë, kundër vijës së saj të drejtë. Bedriu kërkon të fshehë këmbët si gjarpëri, ai mundohet të mos thotë asnjë fjalë për pikëpamjet e tija të nacionalizmit borgjez. Budalla ai nuk është, se po i pranoi këto, dalin në shesh të gjitha veprimet e tij. Merrreni me mend: ai pranoi të quhet më mirë antimarksisist vetëm të mos pohojë asgjë mbi nacionalizmin borgjez të tij. Pastaj, Bedriu me pikëpamje të tilla si mund të mos puqej me Tukun? Medoemos ai do të puqej me çfarëdo rrymë që të ishte, qoftë kjo e trockizmit jugosllav, e atij italian e x ose y , me çdo maskë antimarksiste që të shfaqej ajo, vetëm t'i binte me varë udhëheqjes së Partisë. Dhe është fakt, që Bedriu punoi për të dobësuar udhëheqjen, pavarësisht se ai ka gjukuar Koçi Xoxen etj. Por, imperializmi, Titua etj, ja falin Bedriut gabimet kundrejt këtyre, sepse ai punoi kundër Partisë dhe popullit duke goditur udhëheqjen e tyre marksiste-leniniste. Pastaj se ç'do të bëjnë Titua dhe agjentura imperialiste me Bedrinë, kjo është një gjë tjetër. Ne dimë se në gjirin e borgjezisë ka kontradikta, por tani ata shohin vijën kryesore, qëllimin strategjik

të saj, që është zhdukja e komunizmit dhe e partive komuniste, pastaj nesër i rregullojnë punët midis tyre.

Të vijnë përsëri në grupin e Shkodrës. Tuku prapë nuk është spastruar nga pikëpamjet e gabuara të këtij grupi. Interesimin kaq të madh të Tukur për artizanatin duhet ta shpjegojmë edhe teorikisht. Pse Tuku është më shumë i interesuar për artizanët, se sa për klasën punëtore dhe për zhvillimin e bujqësisë? Sepse në parim Tuku ka akoma pikëpamje trockiste, deviatore, oportuniste, të cilat që të gjitha janë antimarksiste. Ai mbështetet kryesisht te artizanët, te borgjezia e vogël dhe jo te klasa punëtore dhe aleanca e saj me fshatarësinë. Fakte mund të sjellim sa të duash, por kjo tanimë është e qartë. Edhe çështja e influencës së klerit katolik nuk është zhdukur te Tuku. Ai duhet të bëjë një luftë shumë më të madhe kundër këtyre shfaqjeve. Këtu nuk është puna te letra e priftit, por te i gjithë helmi që përhapin në popull kisha, dervishët, hoxhallarët dhe priftërinjtë. Përse e bëjnë ata këtë gjë? Qëllimi kryesor i tyre është lufta kundër komunizmit dhe konkretisht në rastin tonë kundër Partisë sonë marksiste-leniniste. Po t'i analizosh këto, shumë gjëra dalin fare të qarta. Tuku edhe në këtë drejtim është një marksist jashtëzakonisht i dobët. Tuku ka luftuar. Këtë nuk ja mohojmë. Po lufta që ka bërë ai nuk e ka ndihmuar që të zhvishet nga kjo ideologji armiqësore borgjeze. Tuku nuk mund të ishte me gjithë zemër me udhëheqjen e Partisë dhe me vijën e saj, pasi pikëpamjet e tija mikroborgjeze, oportuniste e kanë mbërthyer dhe nuk e lëshojnë. Ka vepruar ose jo në mënyrë të organizuar Tuku, kjo nuk ka shumë rëndësi për ta shpjeguar çështjen. Par-

tia duhet ta shohë mirë, thellë dhe deri në fund këtë çështje se po të ketë qenë një punë e organizuar puna e Tukurit është akoma më e rrezikshme. Por për të shpjeguar çështjen, Tuku medoemos duhet t'i ketë menduar këto gjëra se pikëpamjet e tija janë të tilla që nuk e lënë të mendojë ndryshe. Këto janë çështje ideologjike dhe nuk janë në rrugën e Partisë sonë. Pra del se pikëpamjet antimarksiste e antiparti e kanë çuar Tukurin në këtë rrugë që i shkakton Partisë dëme, ndërsa Bedriu e kanë çuar edhe më tej. Ai tani nuk është më në pozita armiqësore, por është armik i Partisë. Po ta shikojmë në këtë prizëm, është e natyrshme dhe nuk duhet të çuditemi pse këta shokë dalin në këtë rrugë. Momentet që kalojnë dhe veçanërisht me këto pikëpamje Tuku don të dalë në rrugën e titizmit.

Titistët, Titua dhe shokët e tij, kanë devijuar nga rruga marksiste-leniniste, ata e kanë tradhëtuar marksizëm-leninizmin. Kjo qëndron dhe do të qëndrojë e palëvizur. Kjo nuk ka si zhduket. Ajo do të zhduket vetëm në rast se këta njerëz japin prova, në rast se luftojnë dhe i japin prova konkrete popullit jugosllav dhe lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare që me të vërtetë i korrigjuan gabimet e tyre përse i përket marksizëm-leninizmit. Por deri tani ata nuk kanë bërë asnjë nga këto. Këto prova për Partinë tonë janë gjëja kryesore. Ato do të tregojnë nëse edhe Tuku e Bedriu do të korrigjohen apo jo. Ne nuk mund të lejojmë, ashtu si do të donte Tuku e Bedriu, të qëndrojnë në Parti duke ruajtur pikëpamjet e tyre e të kundërta me Partinë, d.m.th. të rrojmë tok të dy palët. Në këtë mënyrë ne nuk mund të rrojmë tok. Përse i përket qëndrimit të

titistëve ndaj vendit tonë, të gjitha ato që kemi thënë qëndrojnë, nuk lëvizin, sepse puna dhe veprimet e tyre janë antimarksiste. Një klikë që ka kaluar në nacionalizëm borgjez, që kërkon të shkatërrojë partinë e vet, marksizëm-leninizmin, një klikë që është kundër Leninit dhe Stalinit, një klikë që kërkon të të gllabërojë, një klikë e tillë është në pozita antimarksiste. Por kjo nuk na ndalon ne të kemi marrëdhënje të mira miqësie e fqinjësie me popujt e Jugosllavisë, të kemi marrëdhënje tregëtare e shtetërore.

Unë mendoj se Tuku duhet të thellohet akoma më shumë. Edhe unë jam që Tuku të përjashtohet nga Komiteti Qendror, ashtu siç është dakord i gjithë plenumi, por të qëndrojë në Parti. Vetëm propozoj edhe një masë tjetër, që për një kohë të pacaktuar të mos ketë asnjë vend drejtues në Parti. Tuku të mos pandehë se qëndrimin e tij në Parti e bëjmë për oportunitet. Atë e mbajmë në Parti se Komiteti Qendror kërkon edhe një herë t'i japë dorën Tuk Jakovës me gjithë këto gabime kaq të rënda që ka bërë, sepse Komiteti Qendror ka një fije shpresë që ai mund të përmirësohet. Por të mos mendojë Tuku se tani ne kemi besim të plotë se ai do t'i ndreqë gabimet, pasi është hera e dytë që bën të tilla gabime, këtë radhë bile edhe më të rënda se të parat. Por Partia do ta ndihmojë atë, por duhet që ai të ndihmojë veten më parë që të mund të meritojë këtë dorë që i jep Partia. Tuku e ca më shumë Bedriu të kuptojnë mirë se Partia nuk i persekuton njerëzit, në asnjë mënyrë. Përkundrazi Komiteti Qendror pranon që organizatat bazë ta kritikojnë e t'i thonë: «Si po e mbani në Parti Tuk Jakovën pas gjithë këtyre gabimeve të rënda që ka bërë»

dhe Komiteti Qendror do t'u përgjigjet: T'i japim Tukat edhe një herë dorën, t'i japim edhe një herë një ndihmë të vogël, por Tuku duhet të japë prova. Komiteti Qendror masën që merr duke e lënë Tukan në Parti e bën me ndërgjegje të plotë, sepse Komiteti Qendror është udhëheqja e një Partie marksiste-leniniste. Së pari, Bedriut, pastaj edhe Tukat, të mos u shkojë mendja se Partia këtë gjë e bën se mos pakësohet influenca e saj në Shkodër ose në Gjirokastrë. Në rast se ka njerëz që mendojnë se komunistët dhe populli i Gjirokastrës ose i Shkodrës e duan Partinë për sytë e bukur të Bedriut, të Tukat ose të ndonjë tjetri, ata gabojnë. Populli e do Partinë se ajo e shpëtoi nga okupatorët, i dha lirinë dhe pushtetin në dorë dhe tani po e çon në socializëm. Populli i do njerëzit që e duan Partinë dhe, përkundrazi, i urren ata që janë kundër Partisë, e cila është gjëja më e shtrenjtë për popullin. Ata të jenë të bindur se populli dhe Partia do ta brohorasin këtë vendim se është plotësisht i drejtë. Populli dhe Partia do të thonë: jashtë Partisë gjarpërinjtë. Në Parti dhe në popull, duhet të jesh i hapët dhe të mos bësh dredhira e të tilla gjëra të kësaj natyre, siç bën Bedriu. Prandaj këtë gjë duhet ta kenë mirë parasysh Tuku e Bedriu, sepse Partia nuk trembet nga elementët e sëmurë, qofshin brenda ose jashtë saj. Bindja e Partisë është e tillë që një ose pesë njerëz nuk e tronditin e as e cënojnë prestigjin e madh të Partisë në popull.

Përsa i përket Bedriut unë jam i vendosur qind për qind me ato që thashë dhe mendimin tim plenumi ta marrë në diskutim, domethënë që Bedriu të përjashtohet jo vetëm nga Komiteti Qendror, por edhe nga Partia

dhe të këshillohet që të vërë mend se kjo rrugë e çon shumë-shumë larg. Tani, ashtu si thamë, atje ku do t'i caktojë Partia këta duhet të punojnë me ndërgjegje të plotë, të bëjnë shkollën që nga fillimi. Megalomaninë dhe gjithë ato veset e tjera që janë shumë të këqia, t'i luftojnë me ashpërsinë më të madhe, se vetëm këtu qëndron shpresa e rehabilitimit të tyre. Kështu ata do të mund të futen në binarët e Partisë dhe të marksizëm-leninizmit, sepse tani nuk janë, sidomos Bedriu është fare jashtë këtyre binarëve.

Tani nuk kemi pse të zgjatemi më tepër. Këto që thamë t'i hedhim në votë një nga një.

Kush është që Tuku të përjashtohet nga Komiteti Qendror dhe nga funksionet e sotme shtetërore, por të qëndrojë anëtar partie dhe për një kohë të pacaktuar të mos ketë asnjë post drejtues në Parti?¹

Kush është dakord që Bedriu të përjashtohet nga Komiteti Qendror, nga Partia si dhe nga funksionet e sotme shtetërore?²

*Botohet për herë të parë sipas
procesverbalit të Plenumit të
KQ të PPSH që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

1 Të gjithë anëtarët e plenumit janë dakord.

2 Të gjithë anëtarët e plenumit janë dakord që Bedri Spahi u të përjashtohet nga Komiteti Qendror, nga Partia dhe të shkarkohet nga funksionet e sotme shtetërore.

R A P O R T

«MBI AKTIVITETIN E KËSHILLIT TË PËRGJITHSHËM DHE DËTYRAT E MËTEJSHME TË FRONTIT DEMOKRATIK»

*Mbajtur në Kongresin e tretë të Frontit Demokratik
të Shqipërisë*

17 qershor 1955

Të dashur shokë,

Kaluan plot 5 vjet nga koha që u mbledh Kongresi ynë i dytë. Në këto 5 vjet vendi ynë ka shënuar fitore të reja shumë të mëdha në rrugën e ndërtimit të bazave të socializmit, janë bërë ndryshime të mëdha në jetën e popullit tonë. Populli ynë, i udhëhequr nga Partia e lavdishme e Punës dhe me ndihmën e Bashkimit Sovjetik në radhë të parë dhe të vendeve të tjera të demokracisë popullore, ka realizuar me sukses detyrat madhështore që i shtroi plani i parë pesëvjeçar i zhvillimit të ekonomisë popullore.

Partia me planin e parë pesëvjeçar shtroi detyra të rëndësishme që në lëmin ekonomik të vazhdonim me

ritëm më të shpejtë punën për ndërtimin e bazave ekonomike të socializmit, për ta kthyer vendin nga një vend agrar i prapambetur në një vend agraro-industrial; në lëmin politik të forconim aleancën midis klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse, të forconim rolin drejtues të klasës punëtore në këtë aleancë, të punonim për kufizimin e elementëve kapitalistë të fshatit e të qytetit, për ngritjen e nivelit kultural të masave punonjëse, për ngritjen e ndërgjegjes socialiste të klasës punëtore dhe për forcimin e vigjilencës revolucionare e të patriotizmit të masave punonjëse. Sot në këtë kongres ne mund të deklarojmë se këto detyra jemi duke i kryer me sukses.

Organizata jonë e madhe e Frontit Demokratik ka luajtur një rol të rëndësishëm në sigurimin e gjithë këtyre sukseseve.

Ne punojmë tani për të realizuar para kohe detyrat e rëndësishme që na shtron plani i vitit të fundit të pesëvjeçarit të parë dhe njëkohësisht përgatitemi t'i fute mi me forca të shumëfishuara planit të dytë pesëvjeçar që do të shënojë një hap të ri të madh përpara në rrugën e ndërtimit të socializmit në vendin tonë. Duke bërë bilancin e fitoreve të deritanishme dhe duke nxjerrë detyrat për të ardhshmen, kongresi ynë i tretë do të luajë një rol shumë të rëndësishëm në mobilizimin me entuziazëm të masave të gjera të popullit tonë, të grumbulluara në radhët e organizatës sonë të Frontit Demokratik, për realizimin si kurdoherë me sukses të tërë këtyre detyrave që shtrohen.

Vendi ynë punon dhe lufton për një jetë më të mirë, jo i veçuar dhe i shkëputur nga vendet e tjera. Ne ndërtojmë socializmin duke ecur krah për krah me të gjitha

vendet që ndjekin këtë rrugë me Bashkimin Sovjetik në krye.

Me të gjitha vendet e kampit të madh të socializmit ne kemi marrëdhënje të ngushta bashkëpunimi dhe ndihme reciproke. Në bazë të koordinimit të planeve, vendet tona plotësojnë nevojat e njëri-tjetrit për një ngritje më të shpejtë të mirëqenjes së çdo njërit nga popujt tanë.

Njëkohësisht populli ynë lufton dhe punon për ndërtimin e bazave të socializmit në kushtet e rrethimit kapitalist; në kushtet kur krahas vendeve ku është vendosur sistemi socialist, ekzistojnë dhe vende me sisteme të kundërta, vende kapitaliste.

Partia dhe qeveria jonë, të nisura gjithnjë nga parimi i mirënjohur leninist i mundësisë së bashkëkzistencës së dy sistemeve të ndryshme socialiste dhe kapitaliste, kanë punuar vazhdimisht për vendosjen e marrëdhënjeve të mirëkuptimit reciprok me këto vende me sisteme të ndryshme. Për këtë arsye krahas me gjithë partitë dhe qeveritë e vendeve të demokracisë popullore, ne kemi bërë të gjitha përpjekjet për uljen e tensionit ndërkombëtar, për ruajtjen dhe sigurimin e paqes.

Por do të ishte në dëm të paqes dhe të sigurimit të popujve, në qoftë se vendet tona të kampit të paqes dhe të socializmit do të qëndronin duarlidhur përballë pregatitjeve të ethshme për luftë nga ana e kampit imperialist me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye.

Ne nuk dëshirojmë garën e armatimeve, se ne jemi për ndërtimin paqësor, për mobilizimin e tërë forcave të vendit tonë në punën e madhe ndërtimtare. Por, duke marrë parasysh pregatitjen e shfrenuar për armatosje

nga ana e vendeve imperialiste, ne, vendet e kampit të socializmit, jemi të detyruar të kundërveprojmë: t'i përgjigjemi organizimit të bloqeve të ndryshme ushtarake dhe agresive me organizimin për mbrojtjen kolektive.

Për këto arsye vendet tona u mblodhën në nëntor të vitit 1954 në Moskë dhe më vonë, në 11-14 maj të këtij viti në Varshavë, ku u konkretizuan masat për Traktatin e miqësisë, të bashkëpunimit dhe të ndihmës reciproke midis Republikës Popullore të Shqipërisë, Republikës Popullore të Bullgarisë, Republikës Popullore të Hungarisë, Republikës Demokratike Gjermane, Republikës Popullore të Polonisë, Republikës Popullore të Rumanisë, Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike dhe Republikës Çekoslovake, për krijimin e Komandës së bashkuar të forcave të armatosura të vendeve pjesëmarrëse.

Edhe më përpara vendet tona ishin të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin. Midis tyre prej kohësh janë vendosur marrëdhënje të reja të pashembullta deri sot, marrëdhënje vëllazërore, bashkëpunimi dhe ndihme reciproke, bazuar mbi parimet e barazisë së plotë dhe të respektimit të përpiktë të sovranitetit shtetëror të çdo vendi, të madh e të vogël.

Por Konferenca e Varshavës i konkretizoi akoma më shumë këto marrëdhënje. Tanimë, përballë çdo force agresive që do të guxojë të cënojë sado pak kufitë e kujt do nga të tetë vendet pjesëmarrëse të Konferencës së Varshavës, do të qëndrojnë forcat e bashkuara të të tetë këtyre vendeve. Ëndërrimet imperialiste mbi vendet e vogla të demokracisë popullore si mbi «thela», që mund të gëlltiten kollaj, u bënë pluhur e hi.

Për popullin tonë vendimet historike të Varshavës janë një fitore e madhe. Ne dimë ta çmojmë shumë mirë këtë dhe njëkohësisht dimë të çmojmë gjithashtu siç duhet edhe detyrat e mëdha që na ngarkohen nga këto vendime.

Kongresi i tretë i organizatës sonë të Frontit merr një rëndësi akoma më të madhe pikërisht për faktin se ai bëhet në këto kushte, kur në Varshavë u nënshkrua Traktati i miqësisë, i bashkëpunimit dhe i ndihmës reciproke si dhe vendimi mbi krijimin e Komandës së bashkuar, dhe përpara popullit tonë shtohet përgjegjësia për të ruajtur me vigjilencë kufitë e përbashkët të kampit tonë të socializmit në këtë kënd të avancuar, buzë Adriatikut.

Ne jemi të ndërgjegjshëm për këtë përgjegjësi të madhe dhe të shenjtë dhe garantojmë edhe një herë solemnisht sot gjithë miqtë tanë se kemi për të qenë kurdoherë në gatishmëri të plotë për të kryer me nder detyrën tonë.

I

ORGANIZATA JONË E FRONTIT, E KRIJUAR DHE E UDHËHEQUR NGA PARTIA KOMUNISTE E SHQIPËRISË, KA LUAJTUR NJË ROL TË MADH NË KURORËZIMIN ME SUKSES TË LUFTËS NACIONAL-ÇLIRIMTARE.

Shqipëria ka qenë nga vendet më të prapambetura të Evropës. Në një kohë kur pothuajse të tëra vendet e Evropës, të mëdhenj e të vegjël, kishin kryer revolucionet borgjeze, në Shqipëri ekzistonin akoma marrëdhënjet e vjetra feudale, ndonëse në gjirin e këtyre kishin

filluar të lindnin dhe po rriteshin marrëdhënjet borgjeze.

Kishte kohë që kushtet e zhvillimit të prodhimit në vendin tonë shtronin në rendin e ditës revolucionin demokratiko-borgjez, likuidimin e marrëdhënjeve feudale në prodhim që binin në kundërshtim me karakterin e forcave prodhuese dhe vendosjen e marrëdhënjeve të reja kapitaliste në prodhim, por që do t'u hapnin rrugë zhvillimi forcave prodhuese të vendit.

Tentativat e Revolucionit të vitit 1924 që synonin pikërisht për të zgjidhur këtë kontradiktë dështuan, pse ishin veprime të shkëputura të një pjese të vogël të borgjezisë liberale të vendit tonë, pa program të qartë dhe konkret për zgjidhjen e çështjes kryesore të revolucionit borgjez të ne, të çështjes së tokës.

Zgjidhja e detyrave të revolucionit demokratiko-borgjez ishte po në rend të ditës në vendin tonë, por ato mund të kryheshin vetëm me një revolucion demokratik-popullor, revolucion i masave punonjëse, i fshatarësisë dhe klasës punëtore, nën hegjemoninë e klasës punëtore kundër feudalizmit dhe borgjezisë të lidhur me okupatorët imperialistë.

Historia, pra, ngarkonte klasën punëtore të vendit tonë me një mision të lartë: të organizonte revolucionin demokratik-popullor, të qëndronte në udhëheqje mbi tërë fshatarësinë në këtë revolucion dhe ta çonte edhe më tej këtë revolucion demokratik-popullor, në revolucionin socialist.

Okupimi i vendit më 7 prill 1939 shtroi nevojën e lidhjes së detyrës së më sipërme me detyrën më urgjente dhe kategorike që vihej para tërë patriotëve shqiptarë — çlirimin e atdheut nga okupatorët e huaj.

Klasës punëtore të vendit tonë i takonte tani të organizonte revolucionin e vërtetë antiimperialist dhe antifeudal, revolucionin demokratik-popullor të të gjithë patriotëve të Shqipërisë dhe në krye të tyre ta çonte atë në fitoren e plotë.

Partia Komuniste e Shqipërisë, e themeluar më 8 Nëntor 1941, udhëhoqi me lavdi popullin shqiptar në fitoren më të shkëlqyer të historisë së tij shekullore. Ajo organizoi Luftën nacional-çlirimtare, çliroi përgjithmonë atdheun nga okupatorët dhe realizoi fitoret e revolucionit popullor.

Partisë Komuniste, pra, sot Partia e Punës, ja dedikojmë të gjitha fitoret që korrëm në Luftën nacional-çlirimtare dhe pas saj.

Partia ngriti lart flamurin e traditave të shkëlqyera shekullore të popullit tonë për liri dhe pavarësi. Shpeshherë gjatë historisë së tij popullit tonë i është dashur të mbrojë dhe të luftojë për lirinë dhe pavarësinë e tij. Populli ynë i vogël, me legjendarin Skënderbe në krye, në shekullin XV, me trimëri të pashoqe e çliroi vendin nga okupatorët otomanë, u dha mësim hordhive turke të mësuara gjithnjë të fitonin dhe i preu hovin dyndjes turke përtej Adriatikut. Bashkimi i popullit, ndërgjegjja e tij në çështjen për të cilën luftonte, besimi i tij i patundur në fitoren — këto kanë qenë arësyet që mbuluan me lavdi forcat e popullit shqiptar, nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit.

Me heroizëm dhe vetëmohim luftuan dhe punuan patriotët e shquar të Rilindjes Kombëtare, të cilët, duke shprehur ndjenjat e thella të masave të gjera të popu-

llit tonë punonjës, i treguan botës mbarë se nuk mund kurrësi të shuhet një popull e një komb, as gjuha dhe as zakonet e tij me pushkë dhe me zjarr.

Më 28 Nëntor 1912, luftërat për çlirimin kombëtar të popullit tonë u kurorëzuan me shpalljen e pavarësisë. Por, ndonëse formalisht populli mundi të fitojë pavarësinë e tij, në të vërtetë ai vazhdonte të vuante nën zgjedhën e egër të feudalëve, të borgjezisë dhe të veplave të imperialistëve të huaj. Për këtë arsye populli ynë punonjës vazhdoi të luftojë pa e përkulur shpinën, pa pushim për çlirimin e plotë të tij. Kryengritjet fshatare të njëpasnjëshme në Shqipërinë e Mesme, të Jugut e të Veriut, ndonëse nuk mundën të kurorëzoheshin me sukses të plotë, pse, siç na mëson marksizëm-leninizmi, ky është fati përgjithësisht i kryengritjeve fshatare në rast se nuk udhëhiqen nga një forcë e organizuar, kompakte dhe revolucionare, siç është klasa punëtore, ato shpeshherë lëkundën nga themelet regjimet antipopullore të pararevolucionit.

Duke mbajtur të gjalla dhe duke rrënjosur thellë në ndërgjegjen e masave punonjëse të vendit tonë këto tradita të lavdishme të së kaluarës së popullit tonë, duke i edukuar ato me frymën e patriotizmit të flaktë, me ndjenjën e zjarrtë të atdhedashurisë, Partia jonë diti të sigurojë një mobilizim të tillë të gjerë, revolucionar të masave punonjëse të vendit tonë, me një hov të tillë luftarak, që asnjëherë nuk është parë gjatë gjithë luftërave që janë bërë ndër shekuj në vendin tonë.

Nga gjerësia e pjesëmarrjes në të të shtresave më të gjera të popullit tonë, nga niveli i ndërgjegjes së pjesë-

marrësve dhe nga rezultatet e tij, revolucionit ynë demokratik-popullor nuk ka shok në historinë e lavdishme të Shqipërisë.

**Lufta nacional-çlirimtare qe një revolucion
antiimperialist, demokratik-popullor i udhëhequr
nga Partia Komuniste**

Merita më e madhe e Partisë sonë që kondicionoi kurorëzimin me sukses të revolucionit popullor qe fakti se ajo, e udhëhequr nga mësimet e pavdekshme të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, diti të krijojë dhe të çelnikosë alcancën e shëndoshë midis klasës punëtore dhe fshatarësisë, nën udhëheqjen e klasës punëtore, si forcën lëvizëse vendimtare të revolucionit tonë demokratik-popullor.

Qysh nga dita e themelimit të saj, Partia jonë e kishte të qartë se kryengritja popullore nuk mund të bëhej vetëm nga klasa punëtore dhe ca më pak vetëm nga forcat e Partisë.

Klasa punëtore e vendit tonë — ndonëse e vogël në numër — ishte klasa më e ndërgjegjshme dhe më e gatshme për revolucion. Që në ditët e para të luftës kundër okupatorit, ajo u hodh me vendosmëri në radhët e para të luftëtarëve për liri. Partia e kishte të qartë se, si klasa më revolucionare, më kompakte dhe më e interesuar për fitoren e revolucionit popullor, pse pa likuiduar okupacionin dhe marrëdhënjet feudale nuk mund të likuidohej përfundimisht shfrytëzimi i njeriut mbi njeriun, klasa

punëtore duhej të bëhej shtylla e revolucionit, udhëheqsja e tërë shtresave të tjera në revolucion. Prandaj në radhë të parë Partia forcoi punën edukative në gjirin e klasës punëtore.

Fshatarësia punonjëse ishte gjithashtu shumë e interesuar për revolucionin popullor. Ajo ishte shtypur dhe shtrydhur nga të gjitha regjimet e së kaluarës, ishte gjakosur nga okupatori fashist. E djegur për një copë tokë ajo punonte ditë e natë dhe derdhte djersë për të shtuar të ardhurat e feudalëve të vendit, kurse vetë nuk arrinte të ngopej as me bukë.

Partia i shpjegoi fshatarësisë punonjëse se interesat e saj kërkonin që ajo të hidhej me të gjitha forcat me klasën punëtore në revolucionin demokratik-popullor, i cili do t'i siguronte lirinë dhe tokën.

Ky interes i përbashkët e lidhi fshatarësinë me një aleancë të shëndoshë, të çelniktë me klasën punëtore. Kjo ishte një aleancë luftarake që farkëtoi Partia jonë.

Fshatarësia jonë e kuptoi se jo vetëm në aleancë me klasën punëtore, por edhe nën udhëheqjen e saj dhe të Partisë së saj, ajo do të mund të triumfonte.

Edhe herë të tjera kishte luftuar dhe kishte derdhur gjak fshatarësia jonë. Por frutet e gjakut të saj i gëzonin një grusht njerëzish të klasave sunduese të feudo-borgjezisë, të cilët hiqeshin si udhëheqës të saj. Ajo luftonte për tokën, lirinë dhe pavarësinë dhe më në fund fitonte shtypjen dhe shfrytëzimin më të egër. Hegjemonia e proletariatit dhe, mbi të gjitha, udhëheqja e urtë dhe e sigurtë e Partisë Komuniste, krijuan bindjen dhe garancinë të fshatarësia se kësaj radhe gjaku i derdhur nuk do të shkonte kot, se frutet e luftës do t'i gëzonin

jo më një grusht shfrytëzuesish, por masat e gjera të popullit.

Borgjezia e madhe dhe feudalët e vendit si klasë me ardhjen e okupatorit bënë kauzë të përbashkët me të. Ata u vunë në shërbim të tij kundër popullit, kundër luftës së tij. Okupacioni krijoi për ata kushte më të favorshme për shfrytëzimin e punonjësve të vendit tonë, për shtimin e fitimeve të tyre.

Kur Partia joë kishte hedhur themëlet e shëndosha të aleancës midis klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse, nën udhëheqjen e klasës punëtore, kur lufta çlirimtare e popullit tonë kishte marrë përpjestime të gjera, borgjezia reaksionare e vendit dhe feudalët e borgjezuar, të grumbulluar në organizatat e tyre tradhëtare, «Balli Kombëtar» dhe «Legaliteti» etj., dolën gjoja me parullën e luftës për çlirim, me qëllim që ta largonin fshatarësinë nga klasa punëtore, ta prishnin kështu aleancën midis tyre, ta kthenin fshatarësinë në rezervë të tyre, ta izolonin Partinë Komuniste nga fshatarësia dhe ta dobësonin kështu Luftën nacional-çlirimtare të popullit tonë. Por manevrat e tyre dështuan shpejt. Bandat e «Ballit» dhe të «Legalitetit» e treguan veten ashtu siç ishin, banda të okupacionit.

Platforma e Luftës nacional-çlirimtare, e revolucionit demokratik-popullor, antiimperialist dhe antifeudal ishte shumë e gjerë. Të interesuar për të ishin jo vetëm klasa punëtore dhe fshatarësia punonjëse, por edhe një sërë shtresash të tjera, si borgjezia e vogël dhe e mesme, intelektualët përparimtarë, zejtarët, tregëtarët e vegjël dhe klerikët patriotë etj., të cilëve u dhimbsej atdheu. Për këtë arsye Partia luftoi dhe punoi që përveç armiq-

ve, të organizonte bashkimin e mbarë popullit tonë e të gjithë patriotëve shqiptarë, pa dallim idesh e partish. Dhe Partia ja arriti këtij qëllimi, duke krijuar Frontin e madh Nacional-Çlirimtar, sot Fronti Demokratik i Shqipërisë, organizatën e madhe politike të popullit që shprehte bashkimin moral dhe politik të popullit tonë.

Themelet e kësaj organizate të madhe politike të popullit tonë u hodhën më 16 shtator 1942 në Konferencën e Pezës që u organizua me inisiativën e Partisë Komuniste të Shqipërisë.

Roli historik i Frontit Nacional-Çlirimtar u shpreh në atë se ai, nën udhëheqjen e Partisë, mundi të aktivizojë, në forma të ndryshme, në favor të Luftës nacional-çlirimtare, të heqë nga pasiviteti dhe të mobilizojë me ndërgjegje në forcat e armatosura të revolucionit, shtresat më të gjera, deri në skajet më të largëta të vendit tonë. Siç u përcaktuan edhe në Konferencën e Pezës, organet e Frontit Nacional-Çlirimtar u bënë organe lufte, organe të mobilizimit të forcave dhe të mjeteve materiale në favor të luftës, organe të vetëqeverisjes së popullit në zonat që çliroheshin, baza të pushtetit të ri demokratik-popullor.

Karakteristikat dalluese të bashkimit të popullit tonë në organizatën e madhe të Frontit Nacional-Çlirimtar qëndronin në faktin se ai ishte një bashkim luftarak, bashkim për luftë pa kompromis kundër okupatorëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre armiq të revolucionit, se baza e këtij bashkimi, strumbullari i tij, qe aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse, nën udhëheqjen e klasës punëtore dhe se forca drejtuese në këtë bashkim ishte Partia Komuniste e Shqipërisë.

Rolin e vet si forcë drejtuese e organizatës së Frontit, Partia e fitoi jo me anë të imponimit, por të bindjes. Masat e gjera të popullit tonë punonjës të grumbulluara në gjirin e Frontit Nacional-Çlirimtar e njohën drejtimin e Partisë, sepse ato panë se Partia që e para që dha kushtrimin për luftën pa kompromis kundër okupatorit dhe tradhëtarëve dhe se të parët që u bënë fli për çështjen e çlirimit të atdheut qenë bijtë e Partisë. Shembullin e devocionit ndaj çështjes së popullit e dhanë komunistët, Qemal Stafa, Vasil Shanto, Misto Mame, Vojo Kushi, Koci Bako, Perlat Rexhepi, Asim Zeneli e qindra të tjerë.

Masat e gjera të popullit tonë punonjës e njohën dhe e pranuan me gjithë zemër drejtimin e Partisë, se panë që vetëm Partia Komuniste e Shqipërisë ndiqte një politikë konsekuente në interes të popullit, vetëm Partia Komuniste e Shqipërisë kishte shpallur një program konkret që shprehte më së miri dëshirat dhe aspiratat e tyre. Në programin minimal të Partisë parashikohej: 1) luftë e paprerë dhe pa kompromis kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë; 2) marrja e pushtetit në duart e popullit, shkatërrimi nga themelet i pushtetit të vjetër të borgjezisë dhe të okupatorit dhe ngritja në vend të tij e pushtetit të ri të këshillave nacional-çlirimtare; 3) vendosja në vendin tonë e demokracisë popullore; 4) pas çlirimit të Shqipërisë zbatimi i reformave të mëdha shoqërore dhe ekonomike për popullin, në radhë të parë i reformës agrare.

Gjatë gjithë etapës së luftës dhe menjëherë pas saj Partia në krye të Frontit luftoi me të gjitha forcat dhe

të tjera, të likuidonin konkurentët e tyre, të dobësonin në luftë me njëri-tjetrin Gjermaninë dhe Bashkimin Sovjetik dhe të mund të siguronin pas luftës, kushdo për veten e vet, sundimin botëror, pra jo të çlironin popujt përgjithësisht, po të zëvendësonin okupacionin fashist.

Ishte për këto arsye që në ato momente të luftës, çështja e përcaktimit të qëndrimit kundrejt çdo vendi aleat merrte një rëndësi të madhe, vendimtare, nga i cili varej fati i çlirimit dhe i të gjitha fitoreve të popullit tonë.

Partia e udhëhoqi popullin në rrugën e drejtë. Kjo ishte rruga e lidhjeve të ngushta me Bashkimin Sovjetik. Vetëm te Bashkimin Sovjetik, mësoi Partia, populli ynë mund t'i mbështeste shpresat e tij. Vetëm Bashkimi Sovjetik do ta ndihmonte atë sinqerisht të çlirohej dhe të vendoste pushtetin popullor.

Prandaj populli ynë u lidh me gjithë shpirt me Bashkimin Sovjetik. Për herë të parë deri atëhere në historinë e tij, populli ynë i vogël gjeti një mik të sinqertë në popullin e madh sovjetik, që i donte të mirën, që luftonte për të mirën e tij, për çlirimin e tij, për sigurimin e të ardhshmes më të lumtur. Farkëtimi i miqësisë së madhe dhe i dashurisë së sinqertë me Bashkimin Sovjetik ishte një nga kushtet kryesore të fitores së popullit tonë mbi fashizmin, të çlirimit të atdheut dhe të vendosjes së pushtetit popullor. Ajo u bë mbështetja për sukseset tona në punën ndërtimtare paqësore të pasluftës.

Pikërisht duke i shikuar të gjitha çështjet nën priz-

min e miqësisë dhe të besnikërisë së madhe ndaj Bashkimit Sovjetik, Fronti Nacional-Çlirimtar, i udhëhequr nga Partia, nuk u gabua në vlerësimin e drejtë të aleancës antifashiste, nuk u gabua në vlerësimin e drejtë të kontributit të dhënë në këtë aleancë kundër hitlerianëve nga ana e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe nga Anglia, në vlerësimin e drejtë të qëllimit imediat si dhe të qëllimeve të fshehta të tyre gjatë dhe pas luftës. Dhe sepse u vlerësuan drejt këto çështje, prandaj ju vu fre që gjatë luftës, në prag të çlirimit dhe pas çlirimit, tentativave të herëpashershme, të fshehura nën petkun e «ndihmës» për të ndërhyrë në çështjet tona të brendshme nga ana e imperialistëve amerikanë e anglezë.

Farkëtimi i aleancës së çelniktë midis klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse, nën udhëheqjen e klasës punëtore, organizimi i bashkimit të pathyeshëm të popullit tonë rreth kësaj aleance nën drejtimin e Partisë, farkëtimi dhe çelnikosja e miqësisë dhe e dashurisë së madhe për Bashkimin Sovjetik, vlerësimi i drejtë i aleancës antifashiste dhe i rolit të çdo njërit pjesëmarrës në këtë aleancë, treguan qartë pjekurinë e madhe të Partisë sonë, treguan qartë se Partia jonë e ndërton politikën e saj mbi baza shkencore të vërteta, mbi shkencën e pavdekshme të marksizëm-leninizmit.

Kurorëzimi madhështor i kësaj politike ishte fitorja e revolucionit demokratik-popullor, antiimperialist dhe antifeudal, çlirimi i Shqipërisë, vendosja e pushtetit demokratik-popullor.

**PAS FITORES HISTORIKE TË 29 NËNTORIT 1944,
REVOLUCIONI YNË U ZHVILLUA PA NDERPRERJE NGA
NJË REVOLUCION ANTIIMPERIALIST DEMOKRATIK
NË REVOLUCION SOCIALIST**

Me çlirimin e vendit tonë nga pushtuesit fashistë, si rezultat i fitores së madhe historike të Bashkimit Sovjetik mbi fashizmin dhe i Luftës nacional-çlirimtare të popullit tonë, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste të Shqipërisë klasa jonë punëtore në aleancë me fshatarësinë mori në dorë pushtetin. Pushteti që u vendos në vendin tonë, me çlirimin e vendit, ishte një pushtet i ri, që ndërtohej mbi gërmadhat e pushtetit të vjetër të feudoborgjezisë, një pushtet demokratik-popullor që mbështetej në aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë, nën udhëheqjen e klasës punëtore. Vendosja e regjimit të demokracisë popullore në vendin tonë si dhe në një sërë vendesh të tjera të Evropës Lindore dhe Juglindore nuk është aspak një gjë e rastit. Ajo është e lidhur me faktorë të brendshëm dhe të jashtëm, të cilët në ato kushte konkrete historike çuan dhe nuk mund të mos çonin në vendosjen e tij.

Para së gjithash, kjo është e lidhur me faktin se revolucioni antiimperialist që u zhvillua te ne, siç thamë dhe më lart, nuk ishte një revolucion demokratiko-borgjez i zakonshëm, por një revolucion i tipit të ri, revolucion demokratik-popullor, në të cilin si forcë kryesore lëvizëse ishin klasa punëtore e fshatarësia dhe ku hegjemon qëndronte jo borgjezia si në revolucionet klasike

demokratiko-borgjeze, por klasa punëtore, e udhëhequr nga Partia e vet Komuniste.

Në kushte të tilla nuk mundej kurrsesi pushteti që lindi të ishte diktaturë e zakonshme e borgjezisë, po një pushtet i ri demokratik-popullor, diktaturë e klasës punëtore dhe e fshatarësisë punonjëse.

Nga ana tjetër, vendosja e demokracisë popullore në një sërë vendesh të Evropës Lindore dhe Juglindore, pra edhe në vendin tonë, është e lidhur me faktin se ajo u arrit në kushtet e thellimit të krizës së imperializmit, të ndryshimit të raportit të forcave në arenën ndërkombëtare pas fitores së Revolucionit socialist të Tetorit dhe sidomos në kushtet e fitores së lavdishme që korri Bashkimi Sovjetik mbi fashizmin. Ekzistenca e Bashkimit Sovjetik, roli i tij vendimtar për shkatërrimin e fashizmit dhe ndihma që u dha ai popujve që të çlirohen e të vendosnin vetë për fatin e tyre, ka luajtur një rol të madh për lindjen e fitoren e demokracisë popullore edhe në vendin tonë. Është e njohur se sikur të mos ishte Bashkimi Sovjetik, nuk do të kishte fitore mbi fashizmin.

Pas fitores historike të 29 Nëntorit 1944, pushteti ynë i demokracisë popullore zgjidhi me sukses edhe detyrat ekonomike të revolucionit demokratik, antiimperialist, ndër të cilat më e rëndësishmja ishte kryerja e reformës agrare. Njëkohësisht ai kaloi edhe në kryerjen e detyrave të revolucionit socialist. Partia e Punës e Shqipërisë u udhëhoq në tërë politikën e saj nga mësimet shumë të rëndësishme të V. I. Leninit i cili thotë:

«Në krye të të gjithë popullit dhe sidomos të fshatarësisë — për lirinë e plotë, për një re-

volucion demokratik konsekuent, për republikën! Në krye të të gjithë punonjësve dhe të shfrytëzuarve — për socializmin! Kjo duhet të jetë në të vërtetë politika e proletariatit revolucionar, kjo është parulla e klasës, që duhet të përshkojë dhe të përcaktojë zgjidhjen e çdo çështjeje taktike, çdo hap praktik të partisë punëtore gjatë revolucionit»¹.

Dhe më tej ai thotë:

«... nga revolucioni demokratik ne do të fillojmë menjëherë dhe në atë masë që do të na lejojnë forcat tona, forcat e proletariatit të ndërgjegjshëm dhe të organizuar, të kalojmë në revolucionin socialist. Ne jemi për revolucionin e pandërprerë. Ne nuk do të ndalemi në gjysmë të rrugës»².

Në etapën e parë të revolucionit pushteti i ri ishte një diktaturë revolucionare e klasës punëtore dhe e fshatarësisë, e cila pas çlirimit të vendit u shndërrua në diktaturë të proletariatit. Në këto kushte, reformat ekonomike nuk mund të mos dilnin jashtë kuadrit të reformave të zakonshme të revolucionit demokratiko-borgjez. Të tilla ishin reforma agrare, shtetëzimi i bankave, shtetëzimi i shumicës së minierave dhe i disa industrive e ndërmarrjeve të transportit si rezultat i likuidimit të koncesio-

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 9, f. 120.

² Po aty, f. 267.

neve të huaja, të cilat çuan në krijimin e sektorit socialist.

Një rëndësi të madhe pati për vendin tonë në këtë kohë zbatimi me sukses i reformës agrare, revolucion i vërtetë agrar, sepse ajo likuidoi përfundimisht mbeturinat e feudalizmit në ekonomi. Dihet se në vendin tonë këto mbeturina kanë qenë të mëdha, prandaj reforma agrare solli një përmbysje të vërtetë në fshatin tonë. Duke hedhur parullën «toka u takon atyre që e punojnë», Partia shpronësoi pronarët e mëdhenj të tokës, u hoqi atyre bazën ekonomike të shfrytëzimit dhe të sundimit dhe ua dha tokën fshatarëve pa tokë, ose me pak tokë, argatëve e fshatarëve të varfër, të cilët panë për herë të parë të realizohet një nga ëndërrat e tyre shekullore.

Reforma agrare në vendin tonë ka qenë e thellë e revolucionare, e tillë që mund të bëhet vetëm atëhere kur klasa punëtore të jetë në fuqi. Reforma agrare te ne u krye gjithashtu me forma revolucionare, gjë që u shpreh në pjesëmarrjen e drejtpërdrejt të fshatarësisë së varfër në ndarjen e tokave me anën e komiteteve të fshatarëve të varfër dhe në faktin se ndarja e tokave u zhvillua në kushtet e një lufte të ashpër klase kundër çifligarëve e kulakëve që bënë lloj-lloj dallaveresh në fshat për të penguar zbatimin e saj, për të mbajtur tokat më të mira për vete etj. Rëndësia e madhe e revolucionit tonë agrar qëndron para së gjithash në faktin se, duke konfiskuar të gjitha tokat e çifligarëve, ai likuidoi klasën më reaksionare të shoqërisë, që kishte qenë gjithnjë mbështetja e imperializmit të huaj dhe armike e egër kundër çdo përparimi në jetën tonë. Nga ana tjetër ai likuidoi vartësinë ekonomike të fshatarëve dhe marrëdhënjet feudale në prodhim duke hapur kështu rrugën

për një zhvillim më të madh të forcave prodhuese në bujqësi. Dhe në fakt në vitin 1946 u punuan më shumë toka se asnjëherë tjetër deri atëhere, u hapën toka të reja, u muarën inisiativa për hapje kanalesh ujitëse e kulluese, u shtua prodhimi bujqësor, filloi të përmirësohet jeta e fshatarëve dhe u krijuan kushtet për të kaluar në kryerjen e transformimeve socialiste në fshat drejt organizimit të ekonomive kolektive bujqësore. Si rezultat i kësaj, në vitin 1946 u ngrit kooperativa e parë bujqësore në Krutje, e cila i tregoi fshatarësisë rrugën në të cilën duhet të ecte ajo në të ardhshmen dhe drejt së cilës ajo po ecën sot me hapa të sigurtë.

Por një rëndësi të veçantë pati sidomos revolucioni ynë agrar, sepse fshatarësia punonjëse pa qartë se klasa punëtore ishte aleatja dhe udhëheqësja e saj më besnike, sepse ai shtoi akoma më shumë besimin e fshatarësisë punonjëse ndaj klasës punëtore, forcoi kështu edhe më shumë aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse, forcoi më shumë pushtetin demokratik-popullor dhe bëri që fshatarësia punonjëse të ishte tanimë e gatshme të ndiqte klasën punëtore në transformimet e tjera të mëdha me karakter socialist në etapën e dytë të revolucionit.

Për zbatimin e reformës agrare dhe të reformave të tjera demokratike, të lidhura me pushtetin, institucionet gjyqësore, shkollën etj. dhe përgjithësisht për konsolidimin e pushtetit, për ta forcuar atë vazhdimisht, për të qenë në gjendje që të luftojë e të shkatërrojë kompletet që organizonin armiqhtë me ndihmën dhe nën drejtimin e drejtpërdrejt të imperialistëve, një rol të madh ka luajtur Fronti ynë Demokratik. Fronti Demokratik e

tregoi përsëri forcën e tij të madhe menjëherë pas çlirimit, në punën që bëri për mobilizimin e masave të gjera të popullit në fshat e në qytet, për rindërtimin e shkatërrimeve të luftës, për rindërtimin e fshatrave e të qyteteve të djegura, të rrugëve e të urave të prishura, për hapjen e kanaleve ujitëse dhe kulluese, për zhvillimin e bujqësisë, për rindërtimin e ndërtimin e shkollave të reja. Ai e tregoi forcën e tij sidomos në mobilizimin e masave për të mbrojtur pavarësinë e atdheut nga përpjekjet e imperialistëve, që kërkonin të ndërhynin në punët tona të brendshme, të organizonin reaksionin e brendshëm e të organizonin komplete me qëllim që të përmbysnin pushtetin popullor. Ai e tregoi forcën e tij të madhe në zgjedhjet e 2 Dhjetorit 1945 kur u zgjodh Asambleja Kushtetuese, e cila e shpalli vendin tonë Republikë Popullore dhe i dha vendit tonë Kushtetutën demokratike, ku u sanksionuan fitoret historike që kishte arritur populli ynë në Luftën e tij nacional-çlirimtare e në revolucionin demokratik-popullor. Tërë këtë forcë Fronti Demokratik e gjente në politikën dhe në udhëheqjen e drejtë të Partisë sonë të Punës, organizatores dhe forcës së tij udhëheqëse. Politika e drejtë shkencore, largpamëse e Partisë, udhëheqja nga ana e saj e gjithë jetës së vendit, sigurimi i sukseseve të njëpasnjëshme në rrugën e ndërtimit të një jete më të mirë për popullin, bënë që forca të reja, deri dje të fjetura ose indiferente, të ngjallen, të vihen në lëvizje në interes të çështjes së popullit.

Etapës së dytë të revolucionit tonë i përkasin transformimet e mëdha ekonomike që çojnë në krijimin e sektorit socialist të ekonomisë dhe në spastrimin e or-

ganeve të pushtetit nga përfaqësuesit e borgjezisë. Shteti ynë demokratik-popullor kryen tani funksionet e diktaturës së proletariatit, kryen detyrat e revolucionit socialist.

Si rrjedhim, në këtë etapë, u shtetëzuan tërësisht edhe të gjitha minierat, ndërmarrjet industriale, mjetet e transportit, tregëtia e madhe dhe e mesme etj, të cilat ndodheshin në duart e kapitalistëve vendës.

Këto masat e fundit që filluan të merren kryesisht nga fillimi i vitit 1946 dhe që vazhduan gjatë gjithë këtij viti, patën një rëndësi jashtëzakonisht të madhe për forcimin dhe konsolidimin e pushtetit popullor, për forcimin e rolit drejtues të shtetit dhe të klasës punëtore në të gjithë jetën e vendit dhe për zhvillimin me hapa më të shpejtë dhe në bazë planifikimi të ekonomisë sonë popullore.

E udhëhequr nga mësimet e marksizëm-leninizmit, Partia jonë me këto masa zhveshi nga baza e saj ekonomike borgjezinë e madhe e të mesme, krijoi bazën ekonomike të shtetit të ri, duke krijuar sektorin socialist të ekonomisë, vuri në dorë të të gjithë popullit dhe të shtetit të tij lartësitë komanduese në ekonomi. Në këtë mënyrë, në këtë sektor të rëndësishëm u vendosën marrëdhënjet e reja socialiste në prodhim, marrëdhënjet e bashkëpunimit dhe të ndihmës reciproke të cilat hapën fushë të gjerë për zhvillimin me hov të forcave prodhuese.

Klasa punëtore mundi të kryejë këto transformime të mëdha revolucionare në vendin tonë sepse, para së gjithash, ajo udhëhiqej në tërë punën e saj nga Partia e Punës e Shqipërisë, e cila mbështetej fuqimisht dhe zbatonte me vendosmëri mësimet e marksizëm-leninizmit

dhe eksperiencën e Bashkimit Sovjetik në kushtet konkrete të zhvillimit të revolucionit dhe të ndërtimit të socializmit në vendin tonë, sepse ajo pati një aleate të fortë, fshatarësinë punonjëse, e cila i mbështeti pa hezitim të gjitha masat me karakter socialist që mori klasa punëtore. Rezistenca që deshën të organizonin mbeturinat e reaksionit, përpjekjet e tyre për t'u organizuar e për të vepruar kundër pushtetit popullor, përpjekje që arrinin në komplete për grushteshteti, në organizim bandash të armatosura e në pregtitje për kryengritje, nuk gjetën aspak mbështetje në fshatarësinë punonjëse, por përkundrazi u luftuan me vendosmëri nga fshatarësia punonjëse, e cila e dinte se vetëm duke ruajtur e duke forcuar aleancën me klasën punëtore, duke ecur krah për krah me të e nën udhëheqjen e saj, ajo do ta gëzonte tokën që mori me reformën agrare dhe do të përmirësonte vazhdimisht gjendjen e saj ekonomike.

Edhe në këtë etapë të zhvillimit të revolucionit tonë Fronti Demokratik ka luajtur një rol të rëndësishëm. Mbeturinat e reaksionit dhe elementë të tjerë kapitalistë e armiq si kulakët e fshatit etj., që u hodhën jashtë pushtetit, jashtë Frontit, u përpoqën ta paraqitin këtë spastrim si likuidimin e Frontit Demokratik. Por, siç mësojmë nga marksizëm-leninizmi, klasat që janë të destinuara të zhduken kanë një prirje të veçantë ta paraqitin fundin e tyre si fundin e botës, ndërsa në realitet ngjet plotësisht e kundërta.

Me likuidimin e sundimit ekonomik dhe politik të borgjezisë dhe të çifligarëve, me spastrimin e pushtetit dhe të Frontit nga këlyshët e tyre, Fronti Demokratik

i Shqipërisë, jo vetëm që nuk u likuidua, jo vetëm që nuk u dobësua, por përkundrazi u bë më i fortë dhe më luftarak se kurrë ndonjëherë. Në Frontin Demokratik, rreth aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse, që u çelnikos akoma më tepër gjatë tërë kësaj periudhe, u grumbulluan edhe shtresa të tjera, të cilat i mbështetën transformimet e mëdha që u bënë në vendin tonë nën udhëheqjen e Partisë. Fronti Demokratik grumbullonte e bashkonte tani klasën punëtore, fshatarësinë punonjëse, intelektualët patriotë, zejtarët, prodhuesit e vegjël etj., të cilët ishin për mbrojtjen e pavarësisë së atdheut, të fitoreve të revolucionit demokratik-popullor e të paqes, për zhvillimin e revolucionit socialist, për forcimin e pushtetit demokratik-popullor, për forcimin e miqësisë me Bashkimin Sovjetik. Të sigurtë tani për faktin se tërë këto aspirata të tyre realizohen në rrugën e përcaktuar nga Partia për ndërtimin e socializmit, këto shtresa ecin në këtë rrugë krah për krah me klasën punëtore dhe fshatarësinë punonjëse. Pra, shokë, duke ndjekur një rrugë revolucionare, nën udhëheqjen e Partisë sonë të Punës, është forcuar regjimi ynë i demokracisë popullore dhe populli ynë ka arritur fitore të rëndësishme në të gjitha fushat, si në atë politike, ashtu dhe në ato ekonomike, kulturele e shoqërore.

Ne i thyem të gjitha përpjekjet e armiqve të brendshëm e të jashtëm, që synonin të përmbysnin pushtetin popullor, të sillnin edhe një herë në fuqi pushtetin e çifligarëve e të borgjezisë. Dhe sikundër e dimë këto përpjekje kanë qenë të mëdha dhe të vazhdueshme. Imperialistët amerikanë e anglezë kanë punuar me mjetet më kriminale dhe në mënyrën më të hapur për të orga-

nizuar reaksionin e brendshëm, për të përgatitur komplete dhe kaq herë janë matur të ndërhyjnë në vendin tonë me forcat e tyre. Por Partia jonë dhe populli ynë i grumbulluar në Frontin Demokratik, forcat tona heroike të mbrojtjes e të Sigurimit të Shtetit kanë vepruar gjithnjë me urtësi e vendosmëri të madhe.

Ne të gjithë i mbajmë mend përpjekjet e imperia-
lizmit amerikano-anglez menjëherë pas çlirimit për të
sjellë në vendin tonë ushtri të tëra gjoja nën maskën e
UNRRA-s dhe të M.L. me qëllim që të kontrollonin tërë
punën që bëhej te ne, të organizonin reaksionin dhe të
ndërhynin kështu në çështjet e brendshme të vendit tonë.
Por Partia dhe populli ynë ua treguan vendin.

Nga ana tjetër boll u përpoqën përfaqësitë e Amerikës dhe të Anglisë në vendin tonë për të organizuar bashkimin dhe hedhjen në luftë të spiunëve të tyre dhe të klasave të perënduara në vendin tonë. Por edhe ato dështuan dhe u bënë pluhur e hi në saje të vigjilencës dhe të shpirtit patriotik të popullit tonë. Pastaj provokacionet e vazhdueshme, futja e diversantëve dhe, në një shkallë më të gjerë, provokacioni i hapur me armë në gusht të vitit 1949, në kufitë e Jugut, të gjitha këto forma presioni, shantazhe dhe luftime të hapëta kanë dështuar dhe do të dështojnë vazhdimisht pse «stani» ka zot.

Presioni dhe shantazhi mund t'u pinë ujë imperia-
listëve atje ku njerëzit janë me nerva të dobëta, por populli ynë i ka nervat shumë të forta, ka mendjen të freskët e të mprehtë dhe mbi të gjitha zemrën prej çeliku. Asgjë s'e tremb dot një popull që di pse lufton, që di çka mbron dhe që udhëhiqet nga një Parti heroike e kalitur në luftëra dhe përpjekje.

Përparime dhe perspektiva të mëdha në zhvillimin e ekonomisë sonë popullore në rrugën e socializmit

Në lëmin ekonomik vendi ynë ka bërë gjithashtu përparime të mëdha. Sektori socialist, i cili është rritur vit për vit, luan rolin kryesor dhe ka pozita komanduese në të gjithë ekonominë e vendit. E udhëhequr nga mësimet e marksizëm-leninizmit për ndërtimin e bazave të socializmit, Partia jonë i ka vënë rëndësi të madhe punës së industrializimit socialist të vendit. Dhe në këtë drejtim janë shënuar suksese të mëdha. Ne trashëguam nga e kaluara një industri primitive, jashtëzakonisht të vogël, peshë specifike e prodhimeve të së cilës zinte një vend minimal mbi prodhimin e përgjithshëm të vendit. Në këto 10 vjet çlirimi ne kemi bërë me të vërtetë një përmbysje në këtë drejtim. Me përpjekjet e palodhura të popullit tonë punëtor të udhëhequr nga Partia dhe me ndihmën e Bashkimit Sovjetik në radhë të parë dhe të vendeve të demokracisë popullore, ne kemi ngritur një industri të re moderne. Janë krijuar degë të reja të industrisë që s'i njihete më parë vendi ynë, siç janë ajo mekanike, elektrike, ushqimore, tekstile, e këpucëve etj. Janë ndërtuar vepra të mëdha të industrisë sonë, Kombinati i tekstileve «Stalin», Kombinati i sheqerit «8 Nëntori», Kombinati i drurit «Nako Spiru», Fabrika e çimentos «V. I. Lenin» etj. Janë zgjeruar dhe janë rritur industria e naftës, e bakrit, e kromit, e qymyr gurit, është zgjeruar dhe është shtrirë shumë industria elektrike etj.

Si rrjedhim prodhimi i përgjithshëm industrial

është rritur më tepër se 11 herë në krahasim me para-luftën. Politika e Partisë për industrializimin socialist të vendit është përcaktuar drejt nga Partia jonë; ne do të vazhdojmë të rritim gjithmonë me një ritëm më të shpejtë prodhimin e mjeteve të prodhimit, por njëkohësisht do të vazhdojmë të zhvillojmë po me ritme të shpejta edhe prodhimin e sendeve të konsumit dhe të ndihmojmë në zhvillimin më të madh e më të shpejtë të bujqësisë. Ne nuk i kemi akoma të gjitha mundësitë që të shpejtojmë akoma më shumë prodhimin e mjeteve të prodhimit, që të zhvillojmë me hapa të shpejtë të gjitha degët e industrisë së rëndë. Por ne kemi pasur kurdoherë parasysh parimin e rëndësishëm të marksizëm-leninizmit që, duke zhvilluar me të gjitha forcat përgjithësisht prodhimin industrial në vend, duhet t'i japim precedencë gjithnjë zhvillimit të prodhimit të mjeteve të prodhimit. Duke mos harruar kushtet tona ne e kemi respektuar, do ta respektojmë dhe do ta zbatojmë këtë parim duke mos u larguar prej tij asnjëherë. Plani ynë i parë pesëvjeçar që aprovoi Kongresi II i Partisë e kishte këtë gjë në plan të parë dhe plani ynë i ardhshëm pesëvjeçar s'ka dyshim se do ta ketë akoma më shumë parasysh. Por siç e kemi theksuar dhe në Kongresin II të Partisë, ekonomia jonë, zhvillimi i industrisë dhe i bujqësisë sonë, ka dhe do të ketë gjithnjë një mbështetje të fuqishme në industrinë e madhe të Bashkimit Sovjetik e të vendeve të kampit të socializmit, nga të cilat ne marrim maqineri të ndryshme për industrinë, traktorë e maqina të tjera për bujqësinë, mjete transporti, pajisje elektrike etj.

Detyrat e mëdha që na dalin neve sot në lëmin e

industrisë janë të tilla që ta bëjmë industrinë të punojë me kapacitet të plotë, të shfrytëzohen të gjitha rezervat e brendshme të saj, të ngrihet rendimenti në punë, të ulet kostua, të përmirësohet cilësia e prodhimit.

Zhvillimi i shpejtë i industrisë sonë ka bërë të rritet me shpejtësi klasa jonë punëtore. Ajo është rritur në numër, është rritur dhe në cilësi. Punëtorët tanë drejtojnë tani maqina të komplikuar, maqina nga më modernet. Kjo tregon se niveli teknik e profesional i klasës sonë punëtore është ngritur shumë. Klasa jonë punëtore, e organizuar në organizatën e madhe të bashkimeve profesionale, lufton me heroizëm të pashoq për kryerjen me sukses të detyrave në sektorin socialist të ekonomisë, duke tërhequr me shembullin e vet në rrugën e realizimit me sukses të planit të shtetit edhe fshatarësinë punonjëse si dhe të gjithë punonjësit e tjerë. Vrulli dhe entuziazmi i pashoq i klasës sonë punëtore për të kryer me nder detyrat e saja, kudo dhe kurdoherë, tregon se Partia me anën e bashkimeve profesionale ka krijuar në të ndërgjegjen për rolin e saj pararojë në shoqërinë tonë.

Krahas me ndërtimin e socializmit në qytet, duke ndjekur politikën e industrializimit socialist të vendit, Partia ka pasur dhe ka gjithashtu parasysh edhe nevojën e ndërtimit të socializmit në fshat.

Partia e ka të qartë se nuk mund, për një kohë të gjatë, shteti ynë, të bazohet në dy baza ekonomike të ndryshme: në sektorin socialist të ekonomisë në qytet dhe në sektorin privat të prodhuesve të vegjël në fshat. Është, pra, një domosdoshmëri historike për vetë fitoren e socializmit krijimi i sektorit socialist edhe në ekonominë bujqësore. Por do të ishte jashtëzakonisht e rre-

zikshme për Partinë dhe për fatet e ndërtimit të socializmit në rast se do të vepronim për krijimin e sektorit socialist në fshat, ashtu siç vepruam në qytet, duke shtetëzuar mjetet e prodhimit, pra, duke shpronësuar gjithë ato ekonomi prodhuesish të vegjël. Jo! Partia që në fillim, e mbështetur në mësimet e pavdekshme të Leninit të madh, ka theksuar se ndërtimi i socializmit në fshat do të bëhet në rrugën e organizimit gradual dhe me vullnet të plotë të ekonomive të vogla fshatare në ekonomi të mëdha kolektive, në rrugën e transformimit socialist të bujqësisë.

Duke vënë në jetë politikën e Partisë dhe udhëzimin praktik të saj që «në çështjen e kolektivizimit as nuk duhet të shpejtohem, por as edhe të qëndrojmë në vend», fshatarësia jonë punonjëse ka hyrë me hapa të sigurtë në këtë rrugë që do të sigurojë zhdukjen për gjithnjë të varfërisë dhe të prapambetjes në fshat, përmirësimin e vazhdueshëm të gjendjes materiale dhe të nivelit kultural të punonjësve të fshatit.

Fshatarësia e qarkut të Korçës, ku është kolektivizuar mbi 21,5 për qind e sipërfaqes së mbjellë, e qarkut të Beratit ku është kolektivizuar mbi 14,1 për qind e sipërfaqes, e Gjirokastrës dhe e Vlorës, po bëhen shembull për tërë fshatarësinë punonjëse të vendit tonë në këtë drejtim.

Në kushtet e tanishme të fshatit tonë, ku dominon prona e vogël dhe ku ritmet e zhvillimit të bujqësisë kanë mbetur mjaft prapa nga ato të zhvillimit të industrisë, Partia dhe shteti u japin një ndihmë të madhe teknike e financiare edhe ekonomive fshatare individuale, duke u nisur nga parimi se edhe në këto kushte

ato mund të bëhen më rentabile, të rritin rendimentet e kulturave të ndryshme dhe të marrin më shumë prodhime bujqësore e blegtorale, për të përmirësuar vazhdimisht ekonominë e jetesën e tyre dhe njëkohësisht për të dhënë akoma më shumë sende ushqimore për qytetet si dhe më shumë lëndë të parë për industrinë tonë. Në saje të ndihmës që i japin Partia dhe shteti fshatarësisë dhe në radhë të parë fshatarësisë së varfër, me anë të traktorëve e makinave të tjera bujqësore, numri i të cilave kohët e fundit është rritur shumë, me anën e kanaleve ujitëse e kulluese që ndërtohen çdo vit, me anën e farërave të zgjedhura, plehrave kimike, ndihmës teknike, me anën e agronomëve etj., bujqësia jonë ka ecur dhe po ecën vazhdimisht përpara duke shtuar përherë e më shumë sipërfaqet e mbjella, duke rregulluar më mirë përpjestimet midis kulturave të ndryshme bujqësore dhe duke rritur gjithnjë rendimentet e tyre. Një influencë të madhe rregulluese në prodhimin bujqësor të ekonomive të vogla individuale ushtron shteti ynë edhe me anën e politikës së stimulacioneve, të grumbullimeve, të tregëtisë reciproke, të çmimeve, të tati-meve etj. Në gjithë këto çështje Partia dhe qeveria ndjekin një politikë që stimulon shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale në përgjithësi dhe të disa kulturave shumë të nevojshme, por akoma jo të njohura mirë nga fshatarësia jonë në veçanti, politikë kjo që synon në shtimin përgjithësisht të të ardhurave kombëtare, në përmirësimin e gjendjes ekonomike e të jetës së fshatarit dhe njëkohësisht në kufizimin e elementëve kapitalistë në fshat.

Partia dhe qeveria në këtë drejtim udhëhiqen nga

parimi i mirënjohur socialist i kombinimit sa më të mirë të interesit personal të punonjësve me interesin e përgjithshëm të shoqërisë.

Partia dhe shteti ynë, të udhëhequr nga shkenca marksiste-leniniste, kanë pasur gjithnjë parasysh se si pjesë përbërëse e planit madhështor të ndërtimit të socializmit, krahas punës për industrializimin socialist të vendit dhe kolektivizimin e bujqësisë, është dhe puna për ngritjen e nivelit kultural e arësimesor të punonjësve, kryerja e revolucionit kultural që do të thotë zhdukja e analfabetizmit, zhvillimi kudo i rrjetit arësimesor, krijimi i inteligjencies së re, të dalë nga gjiri i klasës punëtore dhe i fshatarësisë punonjëse.

Kryerja me sukses e detyrave të mëdha dhe të rënda që i shtrohen popullit tonë për ndërtimin e jetës së re e të lumtur, kërkon njerëz të kulturuar, njerëz që ta njohin punën e tyre. Punëtori ynë punon tani me maqineri moderne dhe kërkohet nga ai që të zotërojë teknikën. Fshatari ynë punon tani në një bujqësi të zhvilluar. Ai mbjell kultura të reja, kultura të cilat kërkojnë shërbime të mëdha, ai punon me vegla të reja, me metoda të reja, prandaj nga ai kërkohet që të njohë agroteknikën. Kërkohet, pra, që të ngrihet përgjithësisht niveli kultural i punëtorit e i fshatarit, përndryshe do të vështirësohet puna jonë për ndërtimin e socializmit.

Rezultatet e arritura deri tani në këtë fushë janë mjaft inkurajuese. Këtë vit ne do të realizojmë me sukses detyrën madhështore që na vuri plani i parë pesëvjeçar: likuidimin e analfabetizmit në moshat që zë ligji. Arësimi fillor është bërë kudo i detyrueshëm, kurse në qytete e fshatra ku ka shkolla edhe ai 7-vjeçar. Tek-

nikët e rinj, të dalë nga gjiri i klasës punëtore dhe i fshatarësisë punonjëse, të pregatitur në shkollat tona, në shkollat e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore si dhe në valën e punës praktike, në prodhim, mbushin tani gjithë ndërmarrjet dhe institucionet tona.

Vendimet e fundit të Plenumit të Prillit të vitit 1955 të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, që kanë një rëndësi jashtëzakonisht të madhe për vendin tonë, kanë për t'i dhënë me siguri një hov akoma më të madh punës sonë për kurorëzimin me sukses të revolucionit kultural.

III

GJENDJA NDËRKOMBËTARE NË TË CILËN ZHVILLOIET REVOLUCIONI YNË SOCIALIST. POLITIKA JONË E JASHTME

Të dashur shokë,

Sukseset e mëdha që ka korrur populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë, në punën e vet për ndërtimin socialist në këto 10 vjet të një jete më të mirë për popullin tonë, janë të lidhura edhe me ndihmën e gjithanshme të mikut tonë të madh, Bashkimit Sovjetik.

Pa ndihmën e Bashkimit Sovjetik populli ynë i vogël do ta kishte vështirë ta çlironte vendin nga okupatorët nazifashistë. Një forcë e madhe e rritur dhe e pregatitur nga gjithë imperializmi botëror për luftë e

shkatërrim, siç ishte Gjermania hitleriane, e cila shtiu në dorën e vet dhe bëri të punojë për të pothuaj tërë Evropa, nuk mund të shembej lehtë, në rast se përballë saj nuk do t'i qëndronte Ushtria famëmadhe Sovjetike. Bashkimi Sovjetik, ushtria e tij legjendare, na ndihmoi të çlirohemi ne dhe vende të tjera nga sundimi fashist.

Pa ndihmën e Bashkimit Sovjetik, pa autoritetin e tij në arenën ndërkombëtare, pa lidhjet e ngushta të miqësisë, të bashkëpunimit dhe të ndihmës reciproke me Bashkimin Sovjetik, do të ishte e vështirë për ne, një vend i vogël, i rrethuar nga shtete kapitaliste, të mbrojmë lirinë, pavarësinë dhe fitoret që korrëm me Luftën nacional-çlirimtare. Fitorja e socializmit në një ose në disa vende, jo vetëm që kufizon sferën e veprimit dhe tregjet për imperializmin, jo vetëm që është fener dhe frymëzues që revolucionarizon masat punonjëse të vendeve kapitaliste, por ai është dhe si qefin mbi kokën e imperializmit që i kujton atij përditë, për orë vdekjen e sigurtë. Prandaj imperialistët me hekur e zjarr mundohen të mbytin kudo revolucionin, të mos lejojnë fitoren e tij. Po pse vallë imperializmi që u derdh me të gjitha forcat, menjëherë pas fitores së Revolucionit të Tetorit, mbi gjithë atë Bashkim Sovjetik që zinte një të gjashtën e gjithë botës, nuk guxoi të organizojë intervencionin pas Luftës së dytë botërore në vendet e demokracisë popullore dhe në vendin tonë të vogël? Tamam pse ai e dinte mirë se krahas popujve të vegjël, të vendosur për të mbrojtur deri në pikën e fundit të gjakut atdheun e tyre, qëndronte Bashkimi Sovjetik, Ushtria e lavdishme Sovjetike, forcën dhe aftësinë e së cilës ata patën rastin ta njohin shumë mirë.

Vetëm me forcat tona, me mundësitë tona, pa ndihmën e Bashkimit Sovjetik, pa eksperiencën e tij, populli ynë nuk do ta kishte të lehtë të ndërtonte socializmin, të hidhte të tillë hapa siç ka hedhur deri tani për krijimin e kushteve më të mira në jetesën e popullit tonë.

Populli ynë është i qartë dhe i ndërgjegjshëm për të gjitha këto, prandaj ai e konsideron popullin sovjetik si një vëlla të tij të madh, prandaj ai ka forcuar dhe ka çelënikosur gjithnjë e më shumë në zemrën e tij miqësinë dhe dashurinë për popujt sovjetikë.

Kjo miqësi ka rrënjë të thella në historinë e popullit tonë. Ajo lindi në zemrat e masave të gjera të popullit, në zemrat e masave të varfëra kur në Rusi doli në skenë klasa punëtore e udhëhequr nga Partia e saj, kur Rusia u bë qendra e lëvizjes revolucionare botërore dhe për më tepër kur Rusia, e para në botë, çau rrugën e lumturisë së popujve. Fitorja e Revolucionit të Tetorit në Rusi ngjalli shpresat në tërë botën, ngjalli shpresat edhe në popullin tonë të vogël, por heroik. Te Rusia Sovjetike, te Partia Bolshevike, te Lenini bijt e vërtetë të popullit tonë shikonin atëhere mundësinë e sigurimit të një mbështetjeje, të një miku të vërtetë që do të mund të mbronte interesat e vendit tonë.

«Është bindja dhe besimi ynë i patundur — shkruante atëhere patrioti i shquar Bajram Curri — se qeveria sovjetike, e frymëzuar nga parimet e larta të drejtësisë do ta thotë fjalën e saj vendimtare dhe shpëtimtare në lidhje me fatin e popujve të Ballkanit dhe të Shqipërisë».

Kësaj miqësie prej zemre që lidhte popujt tanë, ju vu bazë graniti pas 8 Nëntorit 1941, kur Partia Komuniste e Shqipërisë, e porsakrijuar, e lidhi fatin e popu-

llit tonë me fatet e Bashkimit Sovjetik, kur Partia jonë i tregoi popullit si rrugë të vetme shpëtimi, rrugën e lidhjeve miqësore me vendin e Sovjetëve.

Dhe kjo miqësi e tillë që përmbledh në vetëvete ndjenjat e dashurisë më të pastër, më të sinqertë dhe pa interes, ndjenjat e një respekti dhe të një mirënjohjeje të thellë, u bë një faktor i rëndësishëm i të gjitha fitoreve që ka korrur populli ynë.

Tërë këto suksese që ka korrur vendi ynë në këto 10 vjet të jetës së tij si shtet më vete, i lirë, i pavarur dhe popullor, janë arritur në kushtet e një situatë të nderë ndërkombëtare.

Qysh gjatë luftës antifashiste, dhe në mënyrë më të hapët menjëherë pas luftës, u dukën qartë dy vija me drejtime krejt të kundërta që ndiqeshin nga vendet pjesëmarrëse në koalicionin antifashist. Si rezultat u krijuan dy kampe të kundërta: kampi demokratik, antiimperialist me Bashkimin Sovjetik në krye dhe kampi imperialist, antidemokratik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye.

Si gjatë gjithë historisë së ekzistencës së tij, ashtu dhe menjëherë pas luftës, Bashkimi Sovjetik ndoqi me vendosmëri politikën e vet të sigurimit të një paqeje të qëndrueshme, politikën e marrëdhënjeve miqësore, të bashkëpunimit dhe të garantimit reciprok të bazuar mbi respektimin e sovranitetit, të të drejtave të barabarta dhe të së drejtës së mosndërhyrjes në çështjet e brendshme të popujve.

Konferencat me rëndësi të madhe ndërkombëtare të mbajtura që gjatë luftës në Teheran, Jaltë, Potsdam, Konferenca e San-Françiskos, për krijimin e Organizatës

së Kombeve të Bashkuara, krijimi i saj dhe puna e pandërprerë e delegacionit sovjetik në të, Konferenca e Paqes në Paris, mbledhjet e ndryshme të shumta me karakter ndërkombëtar që janë mbajtur dhe ku ka marrë pjesë edhe Bashkimi Sovjetik e planet konkrete që ka paraqitur ai për të siguruar paqen, kanë treguar fare qartë vendosmërinë e Bashkimit Sovjetik për të ruajtur paqen në botë.

Duke u nisur nga fakti i njohur se për më pak se një të katërt shekulli Gjermania militariste ka sulmuar dhe ka futur në kasaphanën e luftës dy herë botën, Bashkimi Sovjetik propozoi dhe insistoi për marrjen e masave më radikale për shkatërrimin e mbeturinave të fashizmit, për denazifikimin dhe çmilitarizimin e Gjermanisë, për krijimin e një Gjermanie të bashkuar, të lirë, demokratike dhe paqedashëse.

Nga ana tjetër, duke u nisur nga fakti se gara e çmendur e armatimeve dhe në mënyrë të veçantë prodhimi për qëllime luftime i armëve të shfarosjes në masë, armëve atomike dhe me hidrogjen, përbën një rrezik serioz për paqen në botë, krijon bazat për shpërthimin e një luftime të re, Bashkimi Sovjetik disa herë dhe në mënyrë konkrete ka propozuar shkurtimin e armatimeve përgjithësisht, ndalimin e prodhimit dhe të përdorimit të armëve atomike e me hidrogjen në veçanti. Me rëndësi në këtë drejtim është sidomos propozimi i fundit i qeverisë sovjetike.

Në propozimin sovjetik parashikohet që gjatë dy viteve, në dy etapa, secila nga një vit, të merren masa në fillim për ndalimin e shtimit të armatimeve, duke i mbajtur ato në nivelin e fundit të vitit 1954 dhe pastaj,

pasi të përcaktohet pika më e madhe e sasisë së mundshme për forcat e armatosura të vendeve të mëdha (deri në 1,5 milion për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Sovjetik dhe Kinën dhe deri në 650 000 për Anglinë dhe Francën), të merren masa për realizimin e pakësimit të forcave të armatosura në këto vende deri në këtë nivel të caktuar në të dy etapat: 50 për qind në vitin 1956 dhe 50 për qind në vitin 1957. Në të njëjtën kohë të pakësohen dhe fondet e këtyre shteteve për nevojat ushtarake. Propozimi parashikon gjithashtu të ndalohet krejt prodhimi, eksperimentimi dhe përdorimi i armëve atomike, të prishen bazat ushtarake, ajrore dhe detare që ndodhen në shtetet e huaja etj. S'ka dyshim se për t'u bërë gjithë këto gjëra do të duhet, në radhë të parë, vullneti i mirë dhe dëshira e sinqertë e të gjitha palëve për të evituar luftën, për të ruajtur paqen dhe nga ana tjetër, në rast se kjo do të arrihet, do të duhet pastaj organizimi i një kontrolli të shëndoshë, efektiv për çarmatimet, me poste kontrolli etj. në të gjitha limanet e mëdha, në aerodromet e në qendrat hekurudhore me rëndësi strategjike.

Këto propozime të Bashkimit Sovjetik s'ka dyshim se do të ishin një kontribut i madh në drejtim të uljes së tensionit ndërkombëtar, do të ishin shpëtim për një-rëzimin nga një luftë e re botërore, do ta lehtësonin barrën e rëndë që mbajnë popujt mbi kurriz, si rezultat i garës së armatimeve dhe do të krijonin mundësi të prodhohej më shumë për nevojat e popullit.

Një punë të madhe më me ngulm ka bërë dhe po bën Bashkimi Sovjetik në krye të kampit të socializmit për të ulur tensionin ndërkombëtar, për të krijuar mun-

dësinë e mirëkuptimit dhe të besimit reciprok midis vendeve goftë dhe me sisteme të ndryshme.

Vitet e kaluara dhe kohët e fundit janë arritur disa suksese në uljen e tensionit ndërkombëtar. Të tilla janë p.sh. sigurimi i armëpushimit në Kore, Konferenca e Gjenevës dhe ndalimi i luftës në Indokinë, nënshkrimi i traktatit të shtetit për rivendosjen e Austrisë demokratike dhe të pavarur, Konferenca e rëndësishme e Bandungut etj.

Kjo politikë paqeje që ka ndjekur dhe po ndjek me vendosmëri kampi i socializmit është përqaftuar nga të gjithë popujt e thjeshtë e paqedashës të botës, pse ajo shpreh aspiratat më të afërta dhe dëshirat më të zjarrra të punonjësve në mbarë botën.

Vetëm imperialistët amerikano-anglezë dhe satelitët e tyre ndjekin një politikë të kundërt nga ajo e kampit socialist, një politikë përgatitjeje dhe shpërthimi të një lufte të re.

Ndryshe nga Bashkimi Sovjetik dhe nga vendet e kampit të socializmit, imperialistët amerikano-anglezë dhe këlyshët e tyre u përpoqën të ruajnë kriminelët fashistë të luftës, t'i mbajnë gjallë dhe t'i stërvitin për t'i pasur të gatshëm për luftën e re që po përgatitin. Ata jo vetëm që s'janë për çmilitarizimin e Gjermanisë dhe për bashkimin e demokratizimin e saj, por përkundrazi në Gjermaninë Perëndimore, ku janë vetë zot, po ngjallin Vermahtin e ri, po sjellin përsëri në fuqi ata që dje me urë në dorë dogjën gjithë Evropën.

Gjoja me qëllim që të sigurohen dhe të mbrohen, imperialistët amerikano-anglezë po krijojnë bloqë të ndryshme ushtarake dhe baza ushtarake ajrore e detare në të katër anët e botës dhe veçanërisht rrotull Bash-

kimit Sovjetik e vendeve të demokracisë popullore. Po shtojnë përditë e më tepër armatimet, po zgjerojnë prodhimin e armëve të shfarosjes në masë dhe gjithnjë mundohen të ndezin luftën, qoftë edhe vetëm në një vend, si në Kore, në Indokinë dhe në Taivan. Lufta shkohet nga manjatët imperialistë vetëm si një burim i pashterueshëm fitimesh, prandaj çirren e bërtasin vazhdimisht për të. Më tepër se dy të tretat e të gjithë buxhetit shtetëror të Shteteve të Bashkuara të Amerikës shpenzohet për çështje ushtarake dhe afërsisht një e katërta e prodhimit të përgjithshëm të industrisë amerikane plotëson porosi të ndryshme për luftë. Kjo është një gjendje jashtëzakonisht anormale që e vë në një pozitë të vështirë vetë ekonominë amerikane pse është një gjë krejt e pamundur të mbahet për një kohë të gjatë ekonomia e vendit mbi një bazë aq të pasigurtë sikundër janë porositë e luftës.

Ndryshe nga Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera të kampit socialist, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe grupi i shteteve që i ndjekin ata nga prapa, nuk janë për t'i zgjidhur çështjet e mbetura pezull në rrugën e bashkëbisedimeve, ata janë partizanë të «politikës së forcës», d.m.th. të politikës së presionit dhe të shantazhit. Ata mendojnë t'i imponojnë botës vullnetin e tyre qoftë dhe me anë të forcës. Por ata gabohen shumë rëndë në llogaritë e tyre. Ata duhet ta dinë mirë se s'kanë të bëjnë as me njerëz me nerva të dobëta dhe as me shtete më të dobëta se vetja e tyre.

Duke folur në sesionin e shkurtit të vitit 1955 të Sovjetit Suprem, V. M. Molotovi theksoi se «*po ta krahasojmë Bashkimin Sovjetik me gjithë burimet e tij njerë-*

zore, duke pasur parasysh në të njëjtën kohë përkrahjen morale dhe politike ndaj politikës së paqes nga masat popullore të vendeve të tjera, pra në qoftë se krahasojmë Bashkimin Sovjetik ashtu sikurse është ai tani me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në qoftë se e marrim këtë vend me të gjitha të dhënat e treguara më lart, do të bëhet e qartë se Bashkimi Sovjetik nuk është më i dobët se Shtetet e Bashkuara të Amerikës».

Bashkimi Sovjetik mbron një çështje të drejtë, mbron interesat e popujve, pra gëzon dhe simpatinë e përkrahjen e të gjithë atyre, kurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë urrejtjen dhe mallkimin e gjithë popujve.

Politika paqësore që ndoqi Bashkimi Sovjetik pas Luftës së dytë botërore gjeti kurdoherë aprovimin e plotë të popullit shqiptar. Populli shqiptar dhe qeveria e tij kanë mbështetur kurdoherë dhe kanë përkrahur me të gjitha forcat politikën e Bashkimit Sovjetik për zhdukjen e mbeturinave të fashizmit, për të krijuar një Gjermani të bashkuar e demokratike, sipas vendimeve të Potsdamit, për të lënë të lirë popujt që të vendosin vetë mbi fatet e tyre, pa ndërhyrjen nga jashtë, për të marrë të gjitha masat në mënyrë që të largohet rreziku i një lufte të re.

Siç ishte e natyrshme, vendi ynë menjëherë pas luftës u gjend një pjesëtar aktiv në gjirin e kampit demokratik e antiimperialist që udhëhiqet nga atdheu i madh i socializmit, në të cilin për të parën herë në histori gjeti drejtësi, barazi, mbrojtje dhe ndihmë të vërtetë. Imperialistët amerikanë e anglezë dhe satelitët e tyre hartuan plane pas planesh dhe përdorën të gjitha mjetet për ta

kthyer Shqipërinë në një koloni të tyre, për ta shuar Republikën Popullore të Shqipërisë nga faqja e dheut. Por ata nuk mundën ta bëjnë dot këtë, sepse populli ynë i udhëhequr nga Partia, mbfonde me vendosmëri fitoret e tija dhe sepse vendi ynë bënte pjesë në kampin e fuqishëm të socializmit. Në Konferencën e Paqes në Paris, kur imperialistët amerikanë dhe anglezë deshën të mononin të drejtat tona, të na akuzonin dhe të merrnin në diskutim çështjen e kufive tanë, Bashkimi Sovjetik e mbrojti me këmbëngulje Shqipërinë, interesat e saj dhe nuk lejoi që të realizoheshin planet kriminale të tyre. Dhe kështu ngjau çdo herë që imperialistët e kërcënuan Shqipërinë, çdo herë që ata deshën të cënonin interesat e saj, çdo herë që ata u përpoqën të vënë në veprim planet e tyre kundër pavarësisë e lirisë së popullit tonë. Mjafton të kujtojmë ngjarjet e gjysmës së dytë të vitit 1946. Në këtë kohë kur reaksioni i brendshëm në Shqipëri kishte marrë goditje të rënda, kur grupet e organizatat komplotiste, të ngritura e të drejtuara nga ana e misionit amerikan e atij anglez në Shqipëri, ishin dërmuar dhe kur bandat e kriminelëve të arratisur ishin shpartalluar, imperializmi vendosi të grumbullojë dhe një herë të gjitha mbeturinat e forcave të brendshme reaksionare për t'i hedhur në sulmin e fundit «për të përmbysur» gjendjen në Shqipëri dhe mori njëkohësisht të gjitha masat për t'i hapur rrugën një agresioni kundër Shqipërisë. Të gjithë e mbajmë mend se si u ngrit e ashtuquajtura çështje e «gjendjes së luftës midis Greqisë e Shqipërisë», se si u bë provokacioni i madh në Kanalin e Korfuzit dhe se si bëhej fjalë hapur për «një sulm të shpejtë» mbi Shqipërinë. Po e gjithë kjo zhurmë çakejsh,

i gjithë ky plan gangsterësh dështoi me turp për autorët e tij, pse Ushtria jonë e lavdishme Popullore mbrojti me heroizëm të pashoq kufitë e atdheut, pse Bashkimi Sovjetik e mbrojti Shqipërinë sepse ajo ishte pjesëtare e kampit të socializmit. Dhe as atëhere as më vonë, imperializmi nuk mundi ta sulmojë Shqipërinë.

Shokë!

Ne po zhvillojmë kongresin tonë të tretë në një kohë kur në botë po zhvillohen ngjarje të mëdha ndërkombëtare, të cilat vendosin për luftën e për paqen.

Nën diktatin e imperialistëve amerikanë, kundër vullnetit të popujve të tyre, vendet kapitaliste të Evropës Perëndimore i ratifikuan marrëveshjet e Parisit. Kjo është një shkelje flagrante e tërë zotimeve që kishin marrë gjatë dhe menjëherë pas luftës forcat aleate të Perëndimit për t'i vënë fre ringjalljes së militarizmit gjerman. Kjo është një shkelje e hapët dhe e ndërgjegjshme e traktateve të nënshkruara midis Anglisë e Francës nga njëra anë dhe Bashkimit Sovjetik nga ana tjetër.

Pa kaluar akoma mirë 10 vjet nga mbarimi i Luftës së dytë botërore, imperialistët amerikanë dhe pasuesit e tyre po i hapin përsëri fushë të lirë veprimi militarizmit gjerman, që aq të zeza u shkaktoi popujve, të riarmatoset, të pregatitet lirisht dhe me ndihmën e tyre për një luftë të re.

Shpresoj që të paktën Franca dhe Anglia, të cilat e pësuan vetë nga politika e armatimit, e inkurajimit për luftë dhe e ndërzimit të Gjermanisë militariste kundër Bashkimit Sovjetik para 1939-s, të kishin vënë

mend dhe të kishin nxjerrë mësim nga historia e afërt se «e rritën dje gjarpërin që t'u hante kokën». Kush mund të garantojë se dhe këtë radhë s'ka për të ngjarë e njëjta gjë? Apo mos vallë dhe atëhere nuk flitej e propagandohej nga të katër anët se Gjermania naziste, si sot Gjermania Perëndimore e Adenaurit, përgatitet për luftë kundër Bashkimit Sovjetik? Apo mos vallë dhe atëhere nuk ekzistonin forma të ndryshme që gjoja kontrollonin masën e përgatitjeve për luftë të Gjermanisë hitleriane? Por etja e madhe për fitime dhe urdhëri i ustait, mbizotëronte te kapitalistët mbi argumentat e logjikës.

Me ratifikimin e marrëveshjeve të Parisit, Gjermania Perëndimore futet në blokun ushtarak agresiv të Atlantikut Verior si dhe në Bashkimin ushtarak të Evropës Perëndimore që drejtohen kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore. Në këtë mënyrë u lihet dorë e lirë revanshistëve gjermanë të krijojnë ushtri, e cila qysh tani në fazën fillestare do të ketë mbi 500 000 vetë, veç policisë, u lihet dorë e lirë të armatosen, bile të vënë në dorë dhe armët e shfarosjes në masë. Gjermania Perëndimore është kthyer kështu, me lejen dhe ndihmën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Anglisë dhe të Francës, në një vatër kryesore agresioni në Evropë. Gjeneralët e vjetër hitlerianë, që i kanë duart të lyera me gjakun e pastër të fëmijëve të të gjithë Evropës, janë vënë në krye të kësaj ushtrie kriminale që po përgatitet për t'i vënë dhe një herë zjarrin botës.

S'ka dyshim se një gjendje e tillë shton rrezikun për shpërthimin e një lufte të re.

Pra, kjo situatë shtronte në mënyrë urgjente përpara vendeve të kampit të socializmit nevojën që të merrnin masa të menjëhershme dhe konkrete për ta larguar rrezikun që u kërcënohej atyre dhe gjithë botës, masa për të forcuar mbrojtjen e tyre, me qëllim që të mos kapen në befasi, por të jenë në gjendje për të dërmuar çdo agresion që mund të shpërthejë kundër cilitdo nga pjesëtarët e kampit të socializmit, në qoftë se imperialistët e çmendur do të guxojnë t'i hyjnë një aventure të tillë. Konferenca e Moskës, me deklaratën e saj historike dhe tani së fundi Konferenca e Varshavës me Traktatin e miqësisë, të bashkëpunimit dhe të ndihmës reciproke të tetë vendeve evropiane dhe me krijimin e Komandës së bashkuar të forcave të armatosura të vendeve pjesëmarrëse në traktat, i shërbejnë pikërisht këtij qëllimi. Prandaj Konferenca e Varshavës dhe Traktati i miqësisë, i bashkëpunimit dhe i ndihmës reciproke si dhe deklarata për krijimin e Komandës së bashkuar të vendeve pjesëmarrëse në këtë traktat, u përshëndetën nga të gjithë popujt paqedashës dhe të gjithë njerëzit që luftojnë për paqen.

Traktati i miqësisë, i bashkëpunimit dhe i ndihmës reciproke që u nënshkrua më 14 maj në Varshavë, është i frymëzuar nga parimi i lartë i politikës së paqes që ndjekin Bashkimi Sovjetik e vendet e demokracisë popullore, nga parimi mbi mundësinë e bashkëjetesës paqesore midis sistemeve të ndryshme shoqërore. Traktati i miqësisë, i bashkëpunimit dhe i ndihmës reciproke shpreh vullnetin e vendeve pjesëmarrëse në të për të marrë masa efektive, në rast se edhe shtetet e tjera do të jenë dakord për pakësimin e përgjithshëm të armati-

meve, për ndalimin e armëve atomike, me hidrogjen dhe armëve të tjera të shfarosjes në masë dhe për marrjen e masave të tjera që i shërbejnë garantimit të paqes e të sigurimit në Evropë dhe në botë. Për këtë qëllim ai është i hapur për të gjitha ato shtete, pavarësisht nga sistemet e tyre shoqërore, që do të shprehin gatishmërinë, duke marrë pjesë në të për të bashkuar përpjekjet e tyre për garantimin e paqes e sigurimin e popujve dhe siç thuhet në traktat, ai do të pushojë së ekzistuari, në rast se do të krijohet një sistem sigurimi kolektiv në Evropë me anën e një traktati të përgjithshëm të sigurimit kolektiv.

Duke u udhëhequr nga parimet e kartës së Kombeve të Bashkuara, Traktati ynë i miqësisë, i bashkëpunimit dhe i ndihmës reciproke siguron vendet tona nga çdo agresion. Në rast të një sulmi të armatosur kundër njërit ose disave nga vendet nënshkruese të traktatit, vendet e tjera do t'i vijnë atij në ndihmë të menjëhershme me të gjitha mjetet që do ta quajnë të nevojshme. Për këtë ata krijuan Komandën e bashkuar të forcave të armatosura, deklaruan se do të marrin masa për të forcuar fuqinë e tyre mbrojtëse, se do të konsultohen në mes të tyre për çështjet ndërkombëtare dhe se do të forcojnë marrëveshjet ekonomike në mes të tyre.

Ndryshe nga traktatet, marrëveshjet dhe bloqet që lidhen ose krijojnë vendet kapitaliste midis tyre, të cilat bazohen mbi parimet e sundimit dhe të nënshtrimit të të vegjëlve nga fuqia më e madhe, Traktati i Varshavës, si dhe të gjitha format e marrëveshjeve dhe marrëdhënjeve midis vendeve të kampit të socializmit, bazohet në parimet e respektit, të sovranitetit shtetëror, të barazisë të

të gjitha shteteve, të mëdhenj e të vegjël dhe të mos-ndërhyrjes në çështjet e tyre të brendshme.

Me Traktatin e Varshavës u lidhën shtete të mëdhenj me më tepër se 200 000 000 banorë dhe shtete të vegjël me 1 300 000 banorë. Por që të gjitha shtetet, pa përjashtim gëzojnë njësoj favorët që sjell me vete traktati si dhe detyrimet që dalin prej tij.

Populli ynë heroik e ka për nder që të qëndrojë në roje të paqes krah për krah me popullin sovjetik, me popujt, bullgar, rumun, hungarez, polonez, çekoslovak, gjerman. Ai njëkohësisht di ta tregojë besnikërinë e tij, vendosmërinë e tij dhe gatishmërinë e tij, për të plotësuar zotimet dhe detyrat që i dalin nga Traktati i Varshavës.

Traktati i miqësisë, i bashkëpunimit dhe i ndihmës reciproke ka një rëndësi të madhe për paqen dhe sigurimin në Evropë.

Militarizimi i Gjermanisë Perëndimore, ngjallja e Vermahtit të ri dhe ndërsimi i tij kundër vendeve tona, përbëjnë një rrezik serioz si për të gjitha vendet evropiane edhe për Shqipërinë. Ne nuk mund të harrojmë se në të dy luftërat botërore, të ndezura nga Gjermania militariste, vendi ynë është djegur dhe zhuritur. Rrojnë akoma të gjalla në kujtimin e popullit tonë barbarizmat e push-tuesve nazistë që vrisnin foshnjat në gji të nënës, që pushkatonin në masë popullin e pafajshëm të fshatrave dhe të qyteteve tona, që digjnin e shkatërronin çdo gjë që kishin ndërtuar duart e arta të popullit tonë.

Shpeshherë imperializmi, me imperializmin amerikan në krye, na kanë kërcënuar me shpërthimin e një lufte kundër vendit tonë, për përmbysjen e regjimit po-

pullor në vendin tonë, për skllavërimin e Shqipërisë. Në propagandën e tyre frazat për një «luftë të vogël» kundër Shqipërisë, për Shqipërinë si «objektivi nr. 1» i agresionit të tyre, për «izolimim e Shqipërisë» etj. janë përsëritur me qindra e qindra herë.

Por le të rrahin sa të duan ujë në havan. Planet dhe përpjekjet e tyre kanë dështuar dhe gjithnjë kanë për të dështuar. Një «luftë të vogël» kundër Shqipërisë nuk mundi të shpërthente imperializmi, pse Shqipëria ishte pjesëtare e kampit të fuqishëm të socializmit dhe imperialistët e dinin mirë se ajo nuk do të ishte më një «luftë e vogël» por një luftë e madhe, luftë me kampin e fuqishëm të socializmit. Përsa i përket «objektivit nr. 1» në llogaritë e imperialistëve doli kurdoherë se Shqipëria ishte një koskë e fortë dhe se në kushtet kur Shqipëria ishte pjesëtare e kampit të socializmit ajo nuk mund të ishte më një objektiv, por fillimi i një përleshjeje të madhe. Kurse përsa i përket «izolimit të Shqipërisë» kjo lloj propagande nuk pati ndonjë sukses në Shqipëri dhe aq më pak ka për të pasur tani e prapa.

Populli ynë nuk do të harrojë kurrë se përderisa të ekzistojë imperializmi s'duhet ta dobësojë as për një çast vigjilencën revolucionare

Sigurimi i pavarësisë kombëtare ka qenë një çështje, për të cilën shekuj të tërë populli ynë ka derdhur gjakun rrëke. Për të fituar pavarësinë dhe për të ndër-tuar një jetë më të mirë për popullin u ngrit në Shqipëri, nën thirrjen dhe nën drejtimin e Partisë, i madh e i

vogël, në luftë kundër fashizmit. Për të mbrojtur pavarësinë dhe fitoret e arritura ka qenë dhe është kurdoherë i gatshëm populli ynë patriot.

Në historinë e Shqipërisë njihen shumë traktate. Të njohura janë traktatet që kishte nënshkruar qeveria gjakpirëse e Ahmet Zogollit me Italinë, por të gjitha ato traktate ishin traktate poshtërimi për Shqipërinë. Me to shitej pavarësia e Shqipërisë, shitej Shqipëria. Ne i anuluan që në Kongresin e Përmetit të gjitha ato traktate.

Populli ynë nuk do të harrojë kurrë dhe as për një çast se përderisa të ekzistojë imperializmi, s'duhet ta dobësojmë as për një moment vigjilencën revolucionare, aftësinë tonë për t'u mbrojtur.

S'ka dyshim se pozitat tona të brendshme dhe të jashtme sot janë më të forta se kurrë ndonjëherë. Por njëkohësisht ne duhet gjithnjë t'i mbajmë sytë hapur. Vigjilenca, shtypja që në embrion e çdo përpjekjeje të armikut të jashtëm e të brendshëm, kundër interesave të popullit tonë, gatishmëria e mbarë popullit, forcimi i aftësive mbrojtëse të vendit tonë, këto janë nga detyrat kryesore që duhet të kemi kurdoherë parasysh edhe pse ekziston Traktati i Varshavës.

Goditje të rëndë kanë marrë armiqtë e brendshëm në vendin tonë. Shpresat e tyre për një ndërhyrje nga jashtë tanimë janë venitur. Propaganda e tyre bajate, sipas avazit të Zërit të Amerikës e të Radio Londrës për «izolimim e Shqipërisë» e të tjera dokrra si këto nuk pinë më ujë. Çdo ditë armiqtë po e shikojnë se po i humbasin një nga një njerëzit që infektohen në një mënyrë ose në një tjetër nga kjo propagandë shpifëse. Po shkëputen nga influenza e propagandës së tyre të

gjithë ata që kanë qenë të helmatisur nga ajo dhe qëndronin në një farë indiferentizmi e pasiviteti. Tani që influenca e propagandës shpifëse të armiqve të pavarësisë së atdheut e të pushtetit popullor merr një goditje tjetër akoma më të fortë, këta elementë të gabuar kanë mundësi ta hedhin poshtë perden që u zinte sytë ose mykun që i mbulonte e t'i futen punës, të fitojnë ndër-gjegjen e qytetarit të Republikës Popullore të Shqipërisë. Fronti Demokratik do të ketë kujdes për ta, do t'i aktivizojë e do t'i ndihmojë që të fitojnë këtë ndër-gjegje. Kurse përsa u përket armiqve që janë të vendosur në rrugën e tyre, ata le të guxojnë të ngrenë veshët e tyre të zgjebosur dhe goditja jonë do të jetë dërmuese për ta.

Imperialistët amerikanë shfrytëzojnë tmerrësisht emigrantët shqiptarë dhe përpiqen t'ua shuajnë atyre ndjenjat e dashurisë për atdheun e tyre të lindjes, t'u errësojnë çdo perspektivë dhe t'i kthejnë në skllëvër. Imperialistët amerikanë përdorin për këtë qëllim shpifjen dhe mjetin e përçarjes, me anë të tradhëtarëve fashistë shqiptarë të emigruar.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës rron një emigracion ekonomik shqiptar pak a shumë i madh. Shqiptarët e Amerikës, me përjashtim të një pakice, kanë mbajtur dhe mbajnë qëndrim patriotik ndaj atdheut të tyre ku kanë lindur, ku prehen eshtrat e gjyshërve dhe të stërgjyshërve të tyre, ku rrojnë fëmijët dhe farefisi i tyre. Nuk mund t'ua çmojnë më mirë këtë dhëmshuri që kanë këta shqiptarë në mërgim, përveçse njerëzit e pushtetit popullor, të Shqipërisë, pse këta e dinë sa i dhëmbshur është atdheu, pse për këtë atdhe ata u vranë, u dogjën, derdhën gjak për ta mbrojtur, për ta çliruar,

për ta shpëtuar nga vuajtjet dhe mjerimet. Ne jemi mësuar që njerëzve t'u flasim hapët, pa marrë parasysh se mund të ketë nga ata që do të hidhërohen. Ne jemi të bindur se njerëzit e ndershëm, shpejt ose vonë do të na kuptojnë dhe do të na japin të drejtë. Disa shqiptarë të Amerikës thonë se Shqipërinë e kanë «shpëtuar» shqiptarët e Amerikës, disa të tjerë thonë se «Shqipërinë e ka shpëtuar Amerika». Të gjithë këta gabohen. Ne themi se shqiptarët e Amerikës dhe të gjithë emigrantët e tjerë ekonomikë me sa kanë mundur e kanë ndihmuar çështjen e Shqipërisë. Kjo ka qenë dhe mbetet detyra më e shenjtë e çdo shqiptari patriot, kudo që rron. Përsa i përket çlirimit të Shqipërisë, atë nuk e ka çliruar as Amerika, as Anglia, as Vilsoni, as Lloit Xhorxhi, as dollari e as stërlina. Përkundrazi këta Shqipërisë i kanë farkëtuar zinxhirë të rëndë. Fatim e Shqipërisë e vendosi vetë populli që luftoi dhe derdhi gjak në fusha dhe në male të atdheut, kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve, e çliroi Partia Komuniste, që udhëhoqi popullin në fitoren e tij më të madhe, e ndihmoi të çlirohet Bashkimi Sovjetik me luftën e tij legjendare kundër fashizmit. Disa shqiptarë të Amerikës mund të thonë: po Amerika luftoi kundër Gjermanisë hitleriane? Ne këtë gjë nuk e mohojmë, por dihet nga të gjithë se qarqet drejtuese reaksionare amerikane dhe angleze, në një kohë kur ushtarët e popullit amerikan dhe anglez vriteshin nga gjermanët, ato bënë njëmijë e një intriga dhe poshtërsi kundër vendit dhe popullit tonë. Ata vazhdojnë edhe sot e kësaj dite. Ku e gjetën pra, ata atë të drejtë që të përzihen në punët e brendshme të një populli sovran? A përzihet njeri në punët e tyre të brendshme?

Në Amerikë ka dy shoqëri kryesore të shqiptarëve emigrantë: «Vatra» dhe «Shqipëria e lirë». Këto janë dy qendra patriotike. Populli shqiptar kurdoherë ka dashur që këto të bashkohen, për një qëllim, të ndihmojnë më mirë vetëveten dhe atdheun e tyre, Shqipërinë. Por çështja e bashkimit është punë e tyre, kurse mbrojtja e atdheut dhe e popullit shqiptar është çështje e pandarë dhe e përbashkët. Ata të bashkuar si një trup, kundër kujt duhet ta mbrojnë atdheun dhe popullin shqiptar? Kundër shtypësve imperialistë, kundër agresorëve, kundër atyre që duan ta copëtojnë atdheun tonë. Këta kanë qenë dhe janë kurdoherë po ata, të njëjtët, që shekuj me radhë e kanë gjakosur Shqipërinë. Le të rilexojnë shqiptarët e Amerikës historinë e Shqipërisë, le të studjojnë me vëmendje ngjarjet e kohërave tona, arritjet dhe blloqet agresive të shteteve imperialiste, le të vërejnë me kë dhe për ç'qëllime Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë lidhur marrëveshje dhe traktate dhe do të shohin qartë se ç'po luhet në kurrizin e paqes së njerëzimit dhe veçanërisht të popullit tonë. Le të mendojnë shqiptarët e Amerikës kush sundon në ato shtete që kanë kërkuar kurdoherë t'i bëjnë varrin Shqipërisë dhe me kë kanë lidhje këto klika antipopullore. Shqiptarët e Amerikës e dinë fjalën e popullit që thotë: «më thua j me kë rri të të them se kush je».

Kundër kujt tjetër duhet të luftojnë, të bashkuar si një trup, patriotët shqiptarë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Australi, në Argjentinë, në Brazil, në Francë, në Itali, në Turqi etj.? Kundër tradhëtarëve shqiptarë që gjenden në emigracion. Kush janë këta? Ata janë gjakësorët e popullit, ata u lidhën me okupa-

torët fashistë italianë dhe gjermanë, ata u bënë spiunët e tyre, ata luftuan me armë popullin, e vranë, e therën, e dogjën së toku me okupatorët. Ata sot janë bërë spiunë dhe agjentë të imperialistëve amerikanë, anglezë etj. Pse luftuan këta kundër popullit, pse u bashkuan këta me okupatorët? Sepse ishin kundër popullit, sepse donin të mbronin çifligjet dhe pasuritë që i kishin grabitur popullit, sepse donin të mbanin në këmbë pushtetin e xhandarëve, të gjakpirësve, të fajdexhinjve që dërmuan të mjerin popull shekuj me radhë. Pse këta u bashkuan tani me imperialistët gjakatarë? Sepse gjakatari dhe grabitësi, me gjakatarin dhe me grabitësin do të bëjë allishverish, me shpresë të ripushtojnë të gjitha ato që humbën dhe ta shesin atdheun, siç kanë bërë përherë, ta futin përsëri popullin nën zgjedhë ashtu siç kishin bërë edhe më parë. Këta tradhëtarë thonë se janë politikanë. Ata s'janë veçse spiunë dhe tradhëtarë të ndyrë. Për ta nuk ka ekzistuar kurrë atdhe, ata janë mercenarë.

Ne dimë se të gjithë emigrantët patriotë shqiptarë, në të gjitha vendet ku sundon thundra e kapitalit, u bëjnë një luftë të madhe këtyre agjentëve tradhëtarë të atdheut. Por lufta kundër këtyre duhet të shtohet, të ashpërsohet. Këta tradhëtarë s'kanë asnjë lidhje me popullin. Ata përdorin flamurin e antikomunizmit, duke thënë se luftojnë vetëm komunistët dhe jo popullin. Por ata janë njëkohësisht kundër komunistëve dhe kundër popullit, pse komunistët tok me popullin ua bënë varrin atyre dhe regjimit të tyre të hurit e të litarit dhe çliruan përgjithmonë atdheun nga robëria. Ata janë kundër komunistëve, pse komunistët u hodhën në zjarr dhe u vranë për çështjen e shenjtë të popullit. A mos vallë në

Shqipëri janë të gjithë komunistë? Jo, por populli është i lidhur si mishi me thoin me komunistët dhe me Partinë e tyre të Punës. Populli shqiptar e do si shpirtin Partinë e tij të Punës, pse ai pa se ç'bëri Partia për të, pse ai sheh se si punon Partia për të, se si e mbron Partia popullin, se si e mbron Partia lirinë dhe pavarësinë e atdheut.

Ne, komunistët, nuk besojmë në fenë, por respektojmë besimet e popullit. Ne nuk persekutojmë as hoxhallarët as priftërinjtë, por për tradhëtarët dhe armiqtë e popullit ne nuk bëjmë dallim dhe ua japim gjyqeve, qofshin këta laikë apo fetarë. Ne e respektojmë për ndjenjat patriotike kishën autoqefale shqiptare të Bostonit, pse ajo ka mbrojtur çështjen e Shqipërisë kundër lakmive të imperialistëve grekë të megaloidesë e të tjerë. Ne u gëzuam që organizata «Shqipëria e lirë», me gjithë mosmarrëveshjet e brendshme që kish me «Vatrën» mori përnjëherë anën e kishës autoqefale shqiptare të Bostonit kundër intrigave të imperialistëve dhe agjentëve të kishës greke. Por ne jemi kundër tradhëtarëve dhe banditëve si Dervish Rexhepët me shokë. E ashtuquajtura teqe e këtij tradhëtari, s'është veç një qendër spiunazhi dhe tradhëtie që punon në dëm të interesave të atdheut dhe për të përçarë shqiptarët e Amerikës.

Gjithë shqiptarët patriotë në emigracion, tok me forcat përparimtare të vendeve ku punojnë, duhet ta shtojnë luftën kundër imperialistëve luftënxitës, të luftojnë me të gjitha forcat e tyre për mbrojtjen e paqes, ata duhet ta forcojnë luftën kundër tradhëtarëve të atdheut, t'i pengojnë këta në çdo veprim të tyre, t'i izolojnë, t'i demaskojnë. Ne e dimë se në vendet ku ata

punojnë, s'ka liri pune dhe veprimi për ta, atje sundon terrori, shpifja dhe burgu për të gjithë njerëzit përparimtarë, por lufta për paqen, lufta për atdheun dhe për jetën kërkon sakrifica. Shqiptarët kurrë nuk u janë trembur sakrificave për të mbrojtur interesat e larta të atdheut. Çdo ndihmë qoftë edhe shumë e vogël për atdheun dhe popullin, për atdheun e vegjëlisë, të atyre që deri dje kanë vuajtur e janë vrarë dhe që sot rrojnë të lirë dhe punojnë për të zbukuruar jetën, është një detyrë dhe një çështje nderi. I ashtuquajtimi atdhe i feudalëve, i bejlerëve, i agallarëve, i spiunëve, i tradhëtarëve, nuk ekziston më. Dy rrugë ka: o me popullin o kundër tij. Ai që bën gabim hidhet kundër popullit, ai diskreditohet dhe shkatërrohet. Disa shqiptarë të Amerikës ranë brenda në provokacionin e kurdisur nga Departamenti i Shtetit në lidhje me të ashtuquajturën ndihmë të presidentit Ajzenhauer popullit shqiptar. Ajo s'ishte ndihmë, por ishte helm, prandaj ne e shkelmuam dhe populli shqiptar e brohoriti veprimin e drejtë të qeverisë sonë. Shqiptarët e Amerikës duhet të kuptojnë tri gjëra: 1) populli shqiptar nuk ishte keq për fasulet e Departamentit të Shtetit, i cili do të bëjë më mirë të ushqejë miliona e miliona të papunë, që vdesin urie në Shtetet e Bashkuara. Populli shqiptar ka krijuar mirëqenjen dhe rron i lumtur. Shqiptarët e Amerikës, mos ua vënë veshin shpifjeve të radiove amerikane dhe të fashistëve shqiptarë: 2) shqiptari nuk e shet nderin, atdheun dhe lirinë, për dollarë dhe për fasule. E ashtuquajtura ndihmë e presidentit Ajzenhauer bëhet me qëllime djallëzore, prej atyre sunduesve amerikanë, që i kanë bërë dhe po i bëjnë njëmijë e një të zeza popullit shqiptar;

3) shqiptarët e Amerikës duhet të ruhen nga provokatorët e imperialistëve amerikanë dhe agjentëve të tyre në radhët e emigracionit shqiptar. Ne e kemi për detyrë t'ua themi këto vëllezërve tanë në mërgim dhe kemi bindjen se ata si kurdoherë do të ndjekin rrugën e nderit, rrugën e popullit.

Ne dimë gjithashtu se në radhët e emigracionit tradhëtar ka edhe njerëz të atillë të gabuar që i mori rryma e tradhëtisë. Ata rrojnë prej 10 vjet me radhë në mizerjen e madhe të kampeve të përqëndrimit. Ata keqpërdoren nga krerët e tyre tradhëtarë, ata shfrytëzohen barbarisht nga qentë cerberë të kampeve të përqëndrimit, ata janë shumë herë të varfër e pa bukë. Një mizëri agjentësh amerikanë, anglezë e të çfarëdo kallëpi, po i përdorin ata për punët më të ndyra dhe, kur ata refuzojnë dhe ka shumë që refuzojnë, atyre u presin bukën, u bëjnë kërcënime e shantazhe. Ata i mbajnë me shpresa dhe me gënjeshtër. Ne e dimë se ata tani i bien kokës me grushte dhe kanë humbur perspektivën.

Por atdheu është kurdoherë zemërmadh ndaj njerëzve të thjeshtë që kanë gabuar dhe që i njohin gabimet. Edhe për ata ka rrugëdalje, sikundër ka pasë rrugëdalje për shumë njerëz që kanë pasë gabuar. Pushteti i popullit ka bërë kurdoherë dallime. Të tërë, kurrë, s'i ka futur në një thes. Pushteti ynë s'ka ngarkuar kurrë, të bijën ose të birin për fajin e babait, ata janë qytetarë të lirë, punojnë, dhe puna ata i edukon të bëhen të vlefshëm për shoqërinë. Mjaft njerëz kanë pasë gabuar në kohën e Luftës nacional-çlirimtare, por ata nuk e morën baltën e atdheut në thundrat e këpucëve. Ata nuk morën arratinë si disa të tjerë, por qëndruan se kishin besim në

drejtësinë e madhe të popullit. Fronti ynë që udhëhiqet nga politika e drejtë dhe e urtë e Partisë së Punës të Shqipërisë, i ndihmoi ata të gjenin rrugën. Natyrisht për këta njerëz të thjeshtë, por të gabuar rëndë që ripen në arrati, gjendja e tyre është e vështirë, pse ata janë të rrethuar nga një atmosferë mbytëse, plot shantazhe, frikësime, shpifje, mashtrime, në urj dhe mizerje. Por këta njerëz duhet të mendojnë se ka një atdhe, një atdhe të vetëm, ku rron babai, mëma, gruaja, kalamanët e tij dhe të vazhdosh t'i bësh të keqe atdheut është një krim i madh. Në rast se ata fillojnë të mendojnë kështu, atëhere ata do ta shohin rrugën e daljes. Ne u themi atyre: braktisni rrugën tuaj të keqe sa s'është vonë! Shkëputuni nga tradhëtarët, shkëputuni nga ata që tradhëtinë e kanë në gjak, shkëputuni nga ata që dembabadem atdheun e kanë pasë bërë monedhë tregu. I demaskoni ata, i izoloni, i luftoni! Varet nga ju që atdheu t'ju ndihmojë, t'ju nxjerrë nga errësira e madhe dhe nga gremina ku kërkojnë t'ju çojnë krerët tuaj tradhëtarë dhe padronët e tyre. Ne ju themi se atdheu ynë është i fuqishëm, atdheu ynë ka miq shumë. Ne s'jemi më një milion, por 900 milion. Forcën e popullit tonë ju e njohët mirë në kohën e Luftës nacional-çlirimtare. Ajo forcë që u kalli dërmën armiqve, është shumëfishuar 900 herë. Ju e dini fare mirë, se i kishit miq dhe luftuat së bashku kundër popullit, sa të fortë ishin nazistët gjermanë dhe fashistët italianë. Por populli ynë ishte më i fortë dhe i mudi ata dhe ju bashkë me ta. I njëjti fat, akoma dhe më i tmerrshëm u rezervohet të gjithë atyre që do të guxojnë ta prekin atdheun tonë të shtrenjtë.

Ne të gjithë e kuptojmë se këto fitore të popullit

shqiptar u arritën sepse Partia jonë e Punës ka përpunuar një politikë të drejtë e largpamëse që i siguroi Shqipërisë miq të mëdhenj e të fuqishëm si Bashkimin Sovjetik, Republikën Popullore të Kinës dhe vendet e demokracisë popullore që na ndihmojnë pa u kursyer për ndërtimin e socializmit.

Vendi ynë ka ndjekur dhe ndjek një politikë të jashtme për sigurimin e paqes dhe për vendosjen e marrëdhënjeve normale, sidomos me fqinjët. Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë ka marrë inisiativa për normalizimin e marrëdhënjeve me Republikën Federative Popullore të Jugosllavisë, në bazë të parimit të barazisë dhe të interesave të përbashkëta për mbrojtjen e paqes.

Popullin shqiptar e lidh me popujt e Jugosllavisë një miqësi e sinqertë, e cila është çelnikosur në luftën e përbashkët kundër fashizmit për çlirimin e vendeve tona. Popujt tanë dëshirojnë të jetojnë në paqe dhe miqësi me njëri-tjetrin.

Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë ka bërë gjithashtu të gjitha përpjekjet dhe do të vazhdojë kështu edhe më tej për të përmirësuar marrëdhënjet e fqinjësisë së mirë dhe ato ekonomike me Italinë. Përsa i përket qeverisë së Greqisë ajo vazhdon ta mbajë qëndrimin e saj krejt të padrejtë e të pajustificuar me gjithë përcapjet e qeverisë sonë për vendosjen e marrëdhënjeve normale e të fqinjësisë së mirë që janë në interes të të dy popujve tanë. Qeveria jonë do të bëjë vazhdimisht përpjekje që marrëdhënjet në mes të dy vendeve tona të normalizohen dhe të vendoset një fqinjësi e mirë.

Edhe në të ardhshmen, Republika Popullore e Shqipërisë do të ndjekë pa hezitim politikën e saj paqësore

për sigurimin e paqes në Ballkan e në Evropë. Përpara Frontit Demokratik të Shqipërisë dalin tani detyra të mëdha për të mobilizuar masat që të jenë vigjilente, që të forcojnë Republikën tonë Popullore. Me siguri Fronti Demokratik, i udhëhequr nga Partia jonë e Punës, do ta kryejë me sukses këtë detyrë ashtu si gjithnjë deri sot.

IV

**MASAT PUNONJËSE TË VENDIT, NËN UDHËHEQJEN
E PARTISË KANË PUNUAR ME VETËMOHIM DHE ENTU-
ZIAZËM PËR TË REALIZUAR DETYRAT E MËDHA
QË SHITROI PËRPARA TYRE PLANI I PARË
PESËVJEÇAR**

Shokë,

Gjatë këtyre viteve, që nga Kongresi i dytë i Frontit Demokratik dhe deri sot, masat punonjëse të vendit, nën udhëheqjen e Partisë, kanë punuar me vetëmohim dhe entuziazëm për të realizuar detyrat e mëdha që shtroi përpara tyre plani i parë pesëvjeçar. Klasa jonë punëto-re si kurdoherë, ka qëndruar në ballë të këtyre përpjekjeve. E ndërgjegjshme për rolin e saj udhëheqës në shoqërinë tonë të re, ajo ka kthyer në një realitet të gjallë mësimet e direktivat e Partisë. Duke luftuar me vetëmohim kundër vështirësive dhe pengesave në punë, ajo ka rritur shumë prodhimin, ka forcuar organizimin dhe disiplinën, ka arritur suksese të rëndësishme në

ngritjen e nivelit politik, kultural e profesional të saj dhe i ka dorëzuar atdheut vepra të mëdha, të cilat, jo shumë kohë përpara, kanë qenë vetëm një ëndërr për popullin tonë. Në këtë mënyrë ajo ka krijuar për veten e saj dhe për mbarë popullin kushte shumë më të mira jetese, pune, edukimi dhe dëfrimi.

Një vrull i madh ka përfshirë gjatë kësaj kohe fshatarësinë tonë punonjëse, e cila, e bindur thellësisht në drejtësinë e vijës së Partisë dhe e frymëzuar nga heroizmi i klasës punëtore, ka arritur suksese të rëndësishme në rritjen e rendimenteve të kulturave bujqësore, në rritjen e sasisë dhe të prodhimtarisë së blegtorisë, në aplikimin e rregullave agrozooteknike dhe të metodave të përparuara sovjetike në bujqësi. Nga viti në vit rritet numri i bujqve të dalluar. Vetëm gjatë vitit 1954, mbi 19 700 fshatarë dhe fshatare morën pjesë në ekspozitat bujqësore që u çelën në qarqe ose rrethe. Presidiumi i Kuvendit Popullor dhe qeveria e kanë çmuar se tepërmi punën e fshatarëve përparimtarë. Gjatë viteve të planit pesëvjeçar janë dekoruar mbi 2 440 fshatarë ose fshatare me urdhëra e medalje pune për rritjen e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale. Fshatarësia jonë punonjëse po kupton gjithnjë më mirë se rruga e vetme për ndërtimin e jetës së re, më të lumtur dhe më të begatshme në fshat, është bashkimi i saj vullnetar në kooperativat dhe kolektivat bujqësore, numri i të cilave po vjen gjithnjë duke u rritur. Nga 90 kooperativa bujqësore që kishim në fund të vitit 1950, sot kemi 187 kooperativa bujqësore dhe mbi 170 kolektiva bujqësore.

Në luftën për rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë, për zhvillimin e forcimin e kulturës, të artit, të shken-

cës, për ngritjen e nivelit kultural dhe ruajtjen e shëndetit të popullit, një rol të rëndësishëm ka luajtur inteligjencia e re dhe patriotet e vendit tonë. Gjatë katër viteve të para të planit pesëvjeçar radhët e inteligjencies janë shtuar me kuadro të tjerë të devotshëm për çështjen e popullit, për çështjen e socializmit. Tërë masat punonjëse, të bashkuara në Frontin Demokratik, nën udhëheqjen e Partisë, kanë vënë gjithë fuqitë dhe aftësitë e tyre për realizimin me sukses të planit të parë pesëvjeçar. Për këtë arsye që gjatë katër viteve të para të planit pesëvjeçar janë arritur suksese të mëdha, plani pesëvjeçar është në rrugën e realizimit të tij, në disa sektorë e ndërmarrje ai është realizuar që sot.

Në këto vite të planit të parë pesëvjeçar vendi ynë ka ecur shumë përpara në rrugën e industrializimit. Prodhimi i përgjithshëm industrial, në krahasim me vitin 1950, viti i fundit i planit dyvjeçar, më 1954 u rrit në 287,6 për qind dhe në fund të këtij viti, që është viti i fundit i planit pesëvjeçar, do të rritet në 326,5 për qind. Numri i punëtorëve në të njëjtën kohë është rritur 67,2 për qind. Në vendin tonë papunësia është zhdukur plotësisht, bile mungesa e fuqisë punëtore ka sjellë vështirësi të konsiderueshme në disa degë të ekonomisë kombëtare. Në vitin 1954 koeficienti për çdo banor për disa artikuj kryesorë, në krahasim me vitin 1950, është rritur: në energji elektrike 350 për qind dhe gjatë vitit 1955 do të rritet 354 për qind, në tekstile të pambukta respektivisht 1 311 për qind dhe 1 511 për qind; në sapun rrobash 162 për qind dhe 250 për qind; në çimento 88 për qind dhe 205 për qind; në lëndë druri të sharruar 167 për qind dhe 181 për qind; në vajguri

brut gjithsejt 118 për qind dhe 127 për qind; në qymyrguri 323 për qind dhe 417 për qind; në sheqer 912 për qind dhe 1 110 për qind; në makarona 238 për qind dhe 246 për qind; në mobilje e orendi 232 për qind dhe 280 për qind.

Partia dhe qeveria i kanë kushtuar një kujdes të posaçëm zhvillimit të industrisë së rëndë dhe në mënyrë të veçantë zhvillimit të industrisë për prodhimin e mjeteve të prodhimit. Gjatë këtyre katër viteve të planit të parë pesëvjeçar, prodhimi i mjeteve të prodhimit është rritur më shumë se 7,3 herë, kurse prodhimi i mallrave të konsumit 6,5 herë.

Duke u bazuar në zhvillimin me hapa të shpejtë të industrisë së rëndë dhe në mënyrë të veçantë duke u mbështetur në ndihmën e Bashkimit Sovjetik në radhë të parë dhe të vendeve të tjera të demokracisë popullore, Partia dhe qeveria jonë kanë zhvilluar gjithashtu me hapa të shpejtë dhe me rritje të pandërprerë edhe industrinë e lehtë.

Si rrjedhim, në fund të vitit 1954 është prodhuar 1 015,7 për qind sheqer më tepër se në vitin 1950 dhe në fund të vitit 1955 kjo përqindje do të rritet në 1 245,9 për qind, makarona 270,4 për qind dhe 278 për qind, peshk i freskët 207,2 për qind dhe 261,6 për qind, sapun rrobash 189,2 për qind dhe 290 për qind, tekstile të pambukta 1 407,4 për qind dhe 1 628,1 për qind, këpucë e sandale 135,7 për qind dhe 207,9 për qind, opinga gome 227,7 për qind dhe 257,7 për qind, çimento 96,9 për qind dhe 229,8 për qind, mobilje dhe orendi 209,1 për qind dhe 240,5 për qind. Në këtë mënyrë është rritur prodhimi i energjisë elektrike, i lëndës së drurit

të sharruar, i vajit të ullirit, i tekstileve të leshta etj. Vetëm gjatë vitit 1954 industria prodhoi 10 164 plugje dhe 2 064 kultivatorë për fshatin, kurse gjatë këtij viti ajo do të prodhojë edhe 12 400 plugje e 2 000 kultivatorë të tjerë.

Industria lokale dhe artizanati e kanë zgjeruar shumë prodhimin e tyre gjatë 4 viteve të planit të parë pesëvjeçar. Vetëm dega ushqimore e industrisë lokale gjatë vitit 1954 ka realizuar prodhime me një vleftë prej 7 423,8 për qind, më shumë se sa në vitin 1950, dega e qeramikës dhe e material ndërtimit 752,6 për qind më shumë etj. Punonjësit e artizanatit qenë të parët që, në tërësi si sektor, realizuan në 4 vjet e 3 muaj planin e pesëvjeçarit të parë dhe tani punojnë për tejkalimin e tij.

Fakti që numri i ndërmarrjeve vetëm në industri-miniera nga 60 që ishte përpara luftës, arriti në 169, që janë krijuar 101 kooperativa artizanati, që gjatë këtyre viteve në vendin tonë janë prodhuar afro 548 artikuj të rinj industrialë, tregon se çfarë zhvillimi të vrullshëm ka pasur në këto vite prodhimi industrial në vendin tonë.

Krahas zhvillimit të vrullshëm të industrisë, gjatë këtij pesëvjeçari Partia dhe qeveria i kanë kushtuar një kujdes të posaçëm rritjes dhe zhvillimit të prodhimeve bujqësore dhe kanë marrë masa të rëndësishme për ta nxjerrë bujqësinë nga prapambetja, për ta ngritur nivelin e jetesës në fshat, për t'i siguruar më shumë lëndë të parë industrisë sonë dhe më tepër prodhime bujqësore e blegtorale për furnizimin e popullsisë.

Sipërfaqja e tokave të mbjella në krahasim me vitin 1950 u rrit në 114 për qind dhe gjatë vitit 1955 parashi-

kohet të mbillen 377 000 ha. Pësha specifike e sipërfaqeve të mbjella të sektorit shtetëror dhe atij kooperativist nga 2,7 për qind dhe 2,6 për qind që zinte në vitin 1950, tani është rritur në 7 për qind dhe 8 për qind respektivisht. Sektori shtetëror dhe kooperativist gjithnjë më shumë po bëhet një bazë e fuqishme dhe shembull konkret për përparimin e bujqësisë dhe për dobimin e pakrahasueshme të punës së përbashkët në kooperativa dhe kolektiva bujqësore.

Përparime janë shënuar gjithashtu edhe në rritjen e rendimenteve të kulturave të ndryshme bujqësore. Kështu në vitin 1954, me gjithë motin e keq për bujqësinë, rendimenti i grurit në krahasim me vitin 1951 arriti 107 për qind, i misrit 106,7 për qind, i orizit 153,1 për qind, i duhanit 113 për qind, i perimeve 107,6 për qind etj. Është për t'u theksuar se kooperativat bujqësore në përgjithësi kanë arritur rendimente shumë më të larta se fshatarësia individuale, gati në të gjitha kulturat bujqësore. Kështu p.sh. kooperativat bujqësore në krahasim me vitin 1951 në vitin 1954 arritën rendimentin në grurë 130,8 për qind, kurse sektori privat 105,5 për qind; në misër kooperativat bujqësore 128,3 për qind, kurse sektori privat 106,8 për qind; në pambuk kooperativat bujqësore 117,2 për qind, kurse sektori privat 76,4 për qind; në duhan kooperativat bujqësore 143,6 për qind, kurse sektori privat 112,7 për qind; në patate kooperativat bujqësore 144,2 për qind, kurse sektori privat 91,5 për qind. Kjo tregon qartë të mirat e punës kolektive, epërsinë e kooperativave bujqësore mbi pronën e copëtuar të tokës.

Si rezultat i shtimit të sipërfaqeve të mbjella dhe i sukseseve që janë arritur në rritjen e rendimenteve,

prodhimet bujqësore gjatë vitit 1954, në krahasim me vitin 1951, arritën: në drithëra buke 120,6 për qind, në drithëra për tagji 127,9 për qind, në duhan 160 për qind, në perime 187,5 për qind, në patate 161,5 për qind etj.

Ku duhen gjetur arësytet kryesore që influencuan në sigurimin e këtyre sukseseve në lëmin e bujqësisë?

Arësytet kryesore të këtyre sukseseve duhen gjetur: së pari, në patriotizmin e flaktë të fshatarësisë sonë, në ndërgjegjen e saj të kalitur nga Partia për të zbatuar detyrat që i shtrohen për ngritjen përgjithësisht të ekonomisë kombëtare, për forcimin dhe lulëzimin e atdheut dhe së dyti, në ndihmën e madhe të gjithanshme që i ka dhënë fshatarësisë punonjëse shteti ynë. Një punë të madhe për ngritjen e nivelit të bujqësisë bëjnë sot te ne stacionet e maqinave dhe të traktorëve që shteti i ka ngritur për t'i ardhur në ndihmë fshatarësisë. Në vitin 1954 vëllimi i punës së SMT-ve në unitet hamullor në krahasim me vitin 1950 arriti 322,5 për qind. Këtë vit qindra traktorë të rinj na erdhën dhe po na vijnë nga Bashkimi Sovjetik dhe nga vendet e demokracisë popullore.

Fondet e investuara për kanale dhe bonifikime në vitin 1954 janë 186,3 për qind më të mëdha se ato të vitit 1950 dhe në vitin 1955 do të investohen 277 milion lekë të tjerë ose 204,7 për qind më shumë se në vitin 1950. Në krahasim me vitin 1938 sipërfaqja e ujitshme është rritur dy herë e gjysmë dhe kjo sipërfaqe do të rritet akoma më tepër këtë vit me vënjen në shfrytëzim të kanaleve: Vjosë-Levan-Fier, Postrisë, Reç etj. Në përgjithësi investimet në bujqësi gjatë vitit 1954 u rritën 207,8 për qind në krahasim me vitin 1950 dhe gjatë këtij viti do të rriten 250,6 për qind.

Të gjitha këto tregojnë, shokë, se me masat që kanë marrë dhe kanë për të marrë Partia dhe qeveria në drejtim të bujqësisë, do të bëjnë që të realizohet me sukses orientimi i dhënë nga Plenumet e Komitetit Qendror të Dhjetorit 1953 dhe të Prillit 1954 për ngritjen e nivelit të bujqësisë dhe këto kanë për të kufizuar disproporcionin e krijuar midis zhvillimit të hovshëm të industrisë dhe prapambetjes së bujqësisë.

Gjatë këtyre viteve janë arritur suksese të rëndësishme edhe në zhvillimin e komunikacionit, të ndërtimeve dhe të investimeve. Vetëm në vitin 1954, për ndërtesa banimi u investuan 395,4 milion lekë, kundrejt 128,8 milionëve që u investuan në vitin 1950. Gjatë këtij viti do të investohen për banesa edhe 449,5 milion lekë të tjerë ose 249 për qind më tepër se në vitin 1950. Shteti ndihmon me material dhe lëndë ndërtimi ngritjen e shtëpive të reja në fshat, numri i të cilave po shtohet gjithnjë e më shumë, si dhe me kredi e ndihmë punëtorët e nëpunësit për ngritjen e shtëpive personale në qytete e në qendra pune.

**Për Partinë tonë të Punës dhe për Qeverinë e
Republikës Popullore të Shqipërisë përmirësimi
i kushteve të jetesës materiale e kulture
të punonjësve përbën ligjin më të lartë**

Si rezultat i zhvillimit të prodhimit industrial e bujqësor dhe i ndihmës që na ka dhënë kampi i socializmit me Bashkimin Sovjetik në krye, është ngritur dhe përmirësuar niveli i jetesës materiale dhe kulture të punonjësve tanë.

Për Partinë tonë të Punës dhe për Qeverinë e Republikës Popullore të Shqipërisë, përmirësimi i kushteve të jetesës materiale dhe kulturele të punonjësve përbën ligjin më të lartë. As zhvillimi i industrisë, as zhvillimi i bujqësisë, as shtimi i ndërmarrjeve të reja dhe asnjë veprimtari tjetër në fushën e prodhimit, nuk do të kishte kuptim për ne, në qoftë se nuk do t'i nënshtroheshin këtij qëllimi të lartë. Plotësimi sa më i mirë i nevojave të njeriut, ja ky është qëllimi nga i cili udhëhiqet prodhimi në vendet tona ku populli është në fuqi.

Në krahasim me vitin 1950, më 1954 populli ynë ka marrë: 75,6 për qind më tepër sheqer, 99,8 për qind më tepër yndyrna, 41,5 për qind më tepër makarona, 11 për qind më tepër mish ose peshk, 140 për qind më tepër djathë ose gjizë, 73,7 për qind më tepër sapun, 101,5 për qind më tepër të pambukta, 108,4 për qind më tepër të leshta, 85,6 për qind më tepër këpucë, 57,5 për qind më tepër opinga etj.

Të ardhurat monetare të popullatës në vitin 1954, në krahasim me vitin 1950, janë rritur 172,2 për qind. Si rezultat i uljes së çmimeve, vetëm vitin e kaluar, popullsia fitoi rreth 300 milion lekë. Paga mesatare e punëtorëve, duke marrë parasysh uljet e çmimeve që janë bërë që nga viti 1947 deri në vitin 1954, është rritur 33,5 për qind.

Gjatë këtyre viteve janë arritur suksese të mëdha në zhvillimin e arësimit e të kulturës. Analfabetizmi është duke u zhdukur për moshat nën 40 vjeç. Numri i kop-shteve për fëmijë në vitin 1954, në krahasim me vitin 1950, u rrit 178,1 për qind. Sipas planit të vitit 1955 numri i shkollave 7-vjeçare arrin në 174,6 për qind dhe

numri i nxënësve në to në 45 300 votë. 10 500 nxënës, ose 195,8 për qind më tepër ndjekin shkollat e mesme dhe 1 480 ose 1 138,4 për qind më tepër se më 1950 ndjekin shkollat e larta. Mijëra të tjerë ndjekin shkollat 7-vjeçare, të mesme dhe të larta të natës. Teatro, kinema, biblioteka janë hapur në të gjithë vendin. Folklori, baleti etj.. kanë marrë një zhvillim shumë të madh.

Një tjetër tregues i rëndësishëm i kujdesit të Partisë dhe të shtetit për rritjen e mirëqenjes materiale dhe kulturele të punonjësve është zgjerimi i aktivitetit shëndetësor gjatë këtyre viteve. Numri i spitaleve dhe kapaciteti i shtretërve, në krahasim me vitin 1950, është rritur 114,3 për qind. Janë ngritur 57 maternitete lokale dhe është rritur numri i të shtruarve në reparte materniteti në 169,4 për qind, në krahasim me vitin 1950. Numri i sanatoriumeve, i dispanserve, i poliambulancave ose i ambulancave dhe i çerdheve ditore që administrohen nga Ministria e Shëndetësisë është rritur respektivisht 125 për qind, 125 për qind, 139,6 për qind dhe 320 për qind.

Gjatë katër viteve të pesëvjeçarit të parë kanë përshtuar në shtëpitë e pushimit të punëtorëve dhe të pionierëve 23 995 punëtorë e nëpunës dhe 29 540 pionierë. Gjatë këtij viti do të pushojnë 7 000 punëtorë e nëpunës dhe 8 000 pionierë të tjerë.

Sigurimet shoqërore shtetërore janë një fitore e madhe e klasës punëtore dhe një mjet i rëndësishëm për rritjen e mirëqenjes së saj. Sigurimet shoqërore u garantojnë punëtorëve e nëpunësve 18 lloje shpërblimesh, pensionesh e ndihmash të ndryshme siç janë shpërblimet

në rast sëmundjeje e aksidenti në punë, barrë e lindje, pensione pleqërie etj.

Fondet e mëdha të sigurimeve shoqërore që shtohen çdo vit me kujdesin e Partisë, të qeverisë dhe me punën e vetë punëtorëve për shtimin e prodhimit, influencojnë në ekonominë individuale të punëtorëve dhe në të ardhurat e tyre. Në krahasim me vitin 1948 fondet e shpenzuara në vitin 1954 nga sigurimet shoqërore kanë qenë afro katër herë më të mëdha. Gjatë kësaj periudhe (1948-1954) punëtorët e nëpunësit kanë përfituar prej tyre 1 329 000 000 lekë. Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 1955 arrin në 250 milion lekë ose 15,5 për qind më shumë se sa u shpenzuan për sigurimet shoqërore në vitin 1954.

Këto janë disa nga sukseset e mëdha që ka arritur populli ynë gjatë këtyre viteve të planit të parë pesëvjeçar dhe që tregojnë qartë rritjen e nivelit material dhe kultural të masave punonjëse të vendit tonë. Krejt e kundërta ndodh në vendet ku sundon kapitali. Për jetën e njerëzve, të punonjësve, askush nuk interesohet atje. Qëllimi i vetëm i prodhimit në këto vende është të sigurojnë fitime maksimale një grusht kapitalistësh që kanë në duart e tyre mjetet e prodhimit, kurse klasa punëtorë, përgjithësisht masat punonjëse, varfërohen përditë e më tepër.

Ja ç'ngjjet p.sh. në Amerikë, që konsiderohet vendi kapitalist më i zhvilluar. Të mbërthyer në darët e krizës ekonomike që ka filluar, kapitalistët po hedhin përditë e më shumë punëtorë në rrugë të madhe. Nga të dhënat e vetë gazetave dhe të agjencive amerikane, të cilat sigurisht i zvogëlojnë, rezulton se në vitin 1954 në Shtetet

e Bashkuara të Amerikës, kishte më tepër se 5 milion njerëz të papunë tërësisht, dhe mbi 11 milion punëtorë që punonin 1-2 ditë ose vetëm disa ditë në javë. Shtrenjtësia e jetesës ka ardhur vazhdimisht duke u rritur. Kështu në vitin 1954 shtrenjtësia e jetesës arriti 115 për qind në krahasim me vitin 1949.

Si rezultat i rritjes së papunësisë, shuma e përgjithshme e pagave që ju pagua gjatë vitit 1954 punëtorëve që punojnë në industrinë përpunuese u shkurtua në 11 për qind. Niveli përgjithësisht i rrogave në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vitin 1954 ishte 9 për qind më i ulët se në vitin 1953. Çmimet me pakicë të mallrave të konsumit të gjerë në vitin 1954 ishin 10,3 për qind më të larta se në vitin 1949. Të ardhurat e bujqve amerikanë këtë vit do të pakësohen në 1 miliard dollarë. Borxhet e bujqve që kanë lënë peng tokën e tyre, u rritën në vitin 1954 deri në 500 milion dollarë. Falimentimi i bujqve të vegjël e të mesëm vazhdon pa ndërprerje. Si rrjedhim i këtyre vështirësive në jetesën e punonjësve të Amerikës, vitin e kaluar ngjisnin 34 vetëvrasje çdo ditë:

Ja pra, një vend i madh, me ekonomi të zhvilluar, me pasuri të mëdha natyrale, nuk është në gjendje t'i sigurojë pjesës më të madhe të popullsisë as minimumin e domosdoshëm për të jetuar. Dhe kjo, sepse atje ekzistojnë marrëdhënjet kapitaliste në prodhim, sepse në fuqi janë një grusht njerëzish, të cilët shtypin dhe shfrytëzojnë masat e gjera punonjëse.

Kurse një vend i vogël, deri dje më i prapambeturi në Evropë, sot është në gjendje t'u sigurojë një jetë shumë më të mirë masave punonjëse dhe për më tepër

çdo ditë që kalon, akoma më shumë rritet dhe përmirësohet niveli i tyre i jetës materiale dhe kulture. Dhe kjo, sepse te ne është populli në fuqi, sepse ne ecim në rrugën e ndërtimit të socializmit.

Populli ynë e di se këto suksese që kemi arritur u bënë të mundura edhe në saje të ndihmës së madhe të Bashkimit të madh Sovjetik, i cili i ka akorduar vendit tonë kredi, pajisje dhe maqineri të ndryshme moderne, traktorë, farëra të zgjedhura, plehra kimike, ndihmë teknike e çdo gjë që ka pasur nevojë vendi ynë. Një rol të rëndësishëm kanë luajtur gjithashtu marrëdhënjet tregëtare dhe ndihma që i kanë dhënë vendit tonë vendet e demokracisë popullore.

**Vendi ynë gjatë planit të dytë pesëvjeçar
do të ecë shumë përpara në rrugën
e ndërtimit të socializmit**

Shokë,

Sukseset që janë arritur në realizimin e planit të parë pesëvjeçar kanë krijuar kushte që të hartohet plani i dytë pesëvjeçar për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës në vendin tonë. Ky është një sukses tjetër i madh, sepse realizimi i tij do ta ngrejë në një shkallë akoma më të lartë nivelin e jetesës së popullit, do ta forcojë dhe do ta zgjerojë bazën ekonomike të socializmit dhe do të rritë akoma më shumë fuqinë mbrojtëse të vendit tonë. Plani i dytë pesëvjeçar do të sigurojë një forcim të mëtejshëm të aleancës së klasës punëtore me

fshatarësinë e varfër dhe të mesme, do të rritë ndërgjegjen socialiste dhe patriotizmin e masave punonjëse.

Në tërë punën e saj Partia dhe qeveria udhëhiqen nga parimi i lartë i përmirësimit të mëtejshëm të kushteve materiale, kulturale e shëndetësore të masave punonjëse të qytetit dhe të fshatit. Ky është edhe qëllimi kryesor i planit të dytë pesëvjeçar. Prandaj një kujdes i veçantë gjatë pesëvjeçarit të ardhshëm do t'i kushtohet zhvillimit proporcional të degëve të ndryshme të ekonomisë, sidomos zhdukjes së disproporcionit që ekziston akoma midis zhvillimit të industrisë dhe zhvillimit të bujqësisë duke siguruar investime në përqindje më të larta për sektorin e bujqësisë se sa në planin e parë pesëvjeçar.

Në sektorin e industrisë gjatë planit të dytë pesëvjeçar do të sigurohet një zhvillim i mëtejshëm i minierave dhe i industrisë së rëndë, e cila është bazë dhe mjet i rëndësishëm për zhvillimin e degëve të tjera të ekonomisë dhe burim i madh për të shtuar eksportimet. Detyrat kryesore në radhë të parë do të jenë shfrytëzimi në mënyrë racionale i kapacitetit të industrisë dhe të minierave ekzistuese dhe pastaj vënja në përdorim e kapaciteteve të reja, përmirësimi i cilësisë së prodhimeve, rritja e rendimentit dhe ulja e kostos. Do t'i kushtohet kujdes shtimit të prodhimit të naftës dhe përmirësimit të cilësisë së saj, shtimit të prodhimit të qymyr gurit, i cili duhet të plotësojë nevojat e industrisë dhe të ndihmojë në ngrohjen e qyteteve, rritjes së prodhimit të mineralit të kromit, të bakrit, duke zgjeruar në një shkallë më të gjerë elektrifikimin dhe mekanizimin e proceseve të punës.

Detyra tjetër kryesore do të jetë zgjerimi i prodhi-

mit të industrisë në mënyrë që të plotësohen më mirë nevojat e popullit të qytetit dhe të fshatit me prodhime të industrializuara dhe të ndihmohet më tepër zhvillimi i mëtejshëm i saj dhe i sektorëve të tjerë të ekonomisë. Për këtë qëllim do të shtohet prodhimi i energjisë elektrike, do t'i kushtohet një vëmendje më e madhe forcimit të bazës mekanike për riparimin e maqinerisë dhe prodhimin e pjesëve të këmbimit, do të shtohet prodhimi i lëndës së sharruar dhe i materialeve të ndërtimit, do të rritet prodhimi i tekstileve duke shtuar asortimentet, duke përmirësuar cilësinë, do të ngrihet pranë Kombinatit të tekstileve «Stalin» reparti i kadifesë, do të përmirësohet puna dhe do të rritet prodhimi në industrinë e gomës, të lëkurëve, të këpucëve, të duhanit etj. Një vend të rëndësishëm do të zërë gjatë këtij pesëvjeçari zhvillimi i industrisë ushqimore, sektorët e peshkimit dhe të artizanatit.

Në sektorin e ekonomisë bujqësore detyra kryesore edhe gjatë pesëvjeçarit të ardhshëm është forcimi dhe zhvillimi i gjithanshëm i bujqësisë me qëllim që të plotësojë nevojat e popullit me prodhime bujqësore e blegtorale dhe të ndihmojë në shtimin e eksportimeve. Kjo do të bëhet e mundur duke rritur rendimentin e kulturave, duke shtuar sipërfaqen e mbjellë, duke përmirësuar dhe duke shtuar blegtorinë, duke shtuar dhe përmirësuar punën me mjetet e mekanizuara, duke shtuar sipërfaqet e tokave të sistemuara nga ana agrare, të ujitshme e të bonifikuara dhe duke zbatuar në shkallë të gjerë rregullat agroteknike e metodat e përparuara në kultivimin e bimëve. Brenda pesëvjeçarit të dytë do të rritet sasia e nevojshme e drithërave për bukë. Një kujdes i veçantë

do t'u kushtohet bimëve industriale, rritja e prodhimit të të cilave do të sigurohet në radhë të parë duke rritur rendimentin për hektar, pa synuar shumë në shtimin e sipërfaqeve të mbjella me këto bimë. Ekonomitë bujqësore që kultivojnë pambukun, panxharin dhe duhanin do të përfitojnë në radhë të parë nga ndihma e shtetit në mjete të mekanizuara, plehra kimike, vepra për ujitje, kuadro e instruksione teknike.

Plani pesëvjeçar do t'i kushtojë një rëndësi të posaçme përmirësimit të blegtorisë, si dhe shtimit të numrit të krerëve njëhundra-kë, dhen, ahi, gjedhe dhe veçanërisht derra, me qëllim që të sigurohen më shpejt nevojat e popullsisë me mish dhe yndyrna. Ekonomitë që kanë pak bagëti, sidomos në zonat ku ka kullotë, do të ndihmohen për t'i shtuar ato. Sigurimi i bazës ushqimore është problemi kryesor për shtimin dhe përmirësimin e blegtorisë dhe ky problem duhet të zgjidhet gjatë viteve të ardhshme.

Për kryerjen e këtyre detyrave plani pesëvjeçar do të parashikojë një sërë masash konkrete për shtimin e mjeteve të mekanizuara dhe të agregateve të tyre, për rritjen e sipërfaqeve të kulluara dhe të ujitshme dhe bonifikimet, për shtimin dhe përdorimin e plehrave organike dhe minerale, për prodhimin e përdorimin e farërave, për ndihmën e shtetit sektori të bujqësisë etj. Ndërmarrjet shtetërore, bujqësore e blegtorale, do të forcohen e do të bëhen shembull përpara ekonomive bujqësore individuale dhe në bazë të bindjes së plotë e pa shkelur në asnjë mënyrë parimin e vullnetarizmit, të bëhet organizimi i pronës kolektive e cila do të marrë përpjesëtime më të gjera.

Në sektorin e investimeve dhe të ndërtimeve, detyra kryesore është marrja e masave tekniko-organizative që ky sektor të dalë nga prapambetja, të sigurojë zgjidhjen e detyrave kryesore të planit të dytë pesëvjeçar, të sigurojë fuqinë punëtore të përhershme, të përmirësohet puna e projekteve.

Rrjeti dhe kapaciteti i mjeteve të komunikacionit do të rritet dhe do të forcohet, me qëllim që të plotësohen më mirë nevojat e qarkullimit të mallrave dhe të shërbimit urban e interurban. Do të studjohet zgjerimi i mëtejshëm i rrjetit hekurudhor dhe do të shtohet kapaciteti dhe shfrytëzimi i transportit detar.

Në bazë të një zhvillimi të tillë të ekonomisë, gjatë pesëvjeçarit të dytë, do të rritet çdo vit furnizimi i popullsisë së qytetit dhe të fshatit me mallra industriale, bujqësore e blegtorale, do të shtohet xhirua e tregëtisë socialiste dhe do të sigurohen kushte që populli të fitojë më tepër arësim dhe kulturë. Në bazë të rritjes së prodhimit industrial dhe bujqësor do të shtohen të ardhurat kombëtare që sigurojnë shtimin progresiv të të ardhurave të punëtorëve, të nëpunësve dhe të fshatarëve, do të krijohen mundësitë për uljen e vazhdueshme të çmimeve dhe do të zgjerohet ndërtimi i banesave në qytetet, në qendrat e punës si edhe në fshatra.

Plani pesëvjeçar do të parashikojë masa efektive për mbrojtjen e shëndetit të popullit duke shtuar kapacitetin e institucioneve mjekësore që ekzistojnë dhe duke i zgjeruar ato. Institucionet shëndetësore do të pajisen më mirë me veglat dhe mjetet e nevojshme dhe do të merren masa profilaktike në një shkallë më të gjerë për ruajtjen e shëndetit të popullit.

Rrjeti i edukimit parashkollor, fillor, 7-vjeçar dhe të mesëm do të zgjerohet, do të sigurohet një shtrirje më e gjerë e institucioneve arësimore-kulturale sidomos në fshat dhe do të merren masa që të përmirësohet rrënjësisht puna shkencore.

Sikurse shihet vendi ynë gjatë planit të dytë pesëvjeçar do të ecë shumë përpara në rrugën e ndërtimit të socializmit. Plani i dytë pesëvjeçar do të jetë një fitore e madhe e popullit tonë, i cili, i udhëhequr nga Partia e tij e Punës, i ndihmuar nga Bashkimi Sovjetik dhe vendet e demokracisë popullore, po ndërton jetën e re e të lumtur.

Plani i dytë pesëvjeçar kërkon punë të madhe të organizuar mirë dhe të gjithanshme, vendosmëri në kapërcimin e pengesave dhe të vështirësive, besim në fitoren tonë të paevitueshme.

Duke bërë këtë bilanc të shkurtër të sukseseve që janë korrur në punën tonë për realizimin e planit të parë pesëvjeçar dhe duke pasur parasysh perspektivat që na hap plani i dytë pesëvjeçar i zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës në vendin tonë, e shoh të arësyeshme të ndalem pak në disa të meta të theksuara në punën tonë si dhe në detyrat që i dalin organizatës sonë të Frontit për përmirësimin përgjithësisht të punës së saj, për rritjen e rolit organizues dhe mobilizues të saj.

Në gjirin e shoqërisë sonë kanë ekzistuar mundësi të shumta për një ngritje akoma më të madhe të ekonomisë dhe të kulturës në vendin tonë. Por që këto mundësi të ktheheshin në realitet, d.m.th. të merrnim akoma më shumë prodhime të industrisë, më shumë ndërtesa banimi, më shumë prodhime bujqësore e blegtorale etj.,

ishte e domosdoshme të punohej më mirë, të drejtohej më mirë, të shfrytëzohej më mirë koha dhe çdo mjet pune.

Ne duhet ta themi se me gjithë përparimet e mëdha që kemi bërë në metodën e punës sonë për drejtimin e ekonomisë, në këtë drejtim kemi akoma të meta të mëdha. Ka akoma organe shtetërore dhe organizata partie që mendojnë të udhëheqin ekonominë pa e njohur konkretisht atë, pa u kujdesur për t'u futur në brendi të çështjeve që drejtojnë duke u kufizuar në dhënje udhëzimesh të përgjithshme që nuk japin shumë përfitim konkret. Nga ana tjetër në organet shtetërore akoma nuk po luftohet siç duhet kundër mënyrave burokratike dhe formalizmit në drejtimin e punëve. Ka ardhur koha të luftojmë me të gjitha forcat kundër këtyre dobësive në punën tonë të drejtimit. Të ngremë nivelin e punës udhëheqëse të organeve tona në nivelin e detyrave të mëdha që na shtron përpara ndërtimi i socializmit. Organizatat e Partisë dhe nën drejtimin e tyre organizatat e masave, punëtorët, fshatarët, të grumbulluar në bashkimet profesionale, në Frontin Demokratik, duhet të luftojnë dhe të ngrenë zërin me forcë kundër këtyre shfaqjeve të dëmshme të drejtimit në mënyrë burokratike dhe formale. Zëri i masave është arma më e fuqishme që do të luftojë me forcë të metat në punën tonë të drejtimit.

Ne luftojmë akoma në mënyrë shumë të pamjaftueshme për shfrytëzimin në maksimum të rezervave të brendshme që fshihen në të gjithë sektorët e prodhimit. Duke filluar që nga shfrytëzimi racional i kohës së punës nga çdo punonjës kudo që punon dhe deri te shfrytëzimi

maksimal i kapacitetit të maqinerive që përdoren në prodhim, nga organizimi më i mirë i vendit të punës dhe deri te shfrytëzimi në maksimum dhe kursimi i lëndës së parë, i karburantëve dhe i lëndëve ndihmëse etj., ne kemi mundësi që t'i japim shoqërisë shumë më tepër nga ç'i kemi dhënë deri sot.

Le të marrim qoftë dhe një shembull të vetëm për të treguar se çfarë mundësi ekzistojnë te ne për rritjen e prodhimit bujqësor, në qoftë se do të shfrytëzonim si duhet një rezervë të tillë të brendshme të prodhimit siç është përhapja e eksperiencës së të përparuarve, fjala vjen në bujqësi. Ju të gjithë keni dëgjuar për bujkun Ali Jagodina dhe familjen e tij, të cilët në vitin 1954 kanë marrë 36 kv. pambuk për çdo hektar tokë që kanë mbjellë me këtë bimë. Ky është një rezultat i shkëlqyer që ka arritur kjo familje, jo aq shumë për kushtet e veçanta të tokave të saja, se sa për faktin që ata kanë punuar mirë, u kanë bërë të gjitha shërbimet që kërkon bima, i kanë ndenjtur asaj kurdoherë mbi kokë. Merreni me mend sikur nga tërë tokat e mbjella me pambuk të merrnim jo sa ka marrë shoku Ali Jagodina, po qoftë dhe një të tretën e tij, ne do të kishim marrë këtë vit edhe një herë më shumë pambuk se ç'muarëm në vitin 1954. Të tillë punonjës, që marrin rendimente të larta në bujqësi, kemi mjaft dhe për të gjitha kulturat bujqësore. E njëjta gjë do thënë edhe për eksperiencën e më të mirëve në industri, në ndërtim, në transport etj. Pse atëhere organizatat tona të Frontit nuk luftojnë për përhapjen sa më të gjerë të kësaj eksperience të punonjësve tanë të dalluar?

Duhet të organizojmë më mirë përgjithësisht punën

e shfrytëzimit të rezervave të brendshme. Kjo përbën sot një nga detyrat tona kryesore në lëmin e ekonomisë. Të luftojmë për t'i zbuluar ato kudo që janë, dhe të organizojmë shfrytëzimin e tyre në maksimum.

E vëmë në dukje se të meta të rëndësishme janë vërtetuar veçanërisht gjatë kësaj kohe në sektorin e ndërtimeve. Organizimi i punës për kalimin e vështirësive në këtë sektor është i pakënaqshëm dhe plani nuk është realizuar. Krahas të metave të tjera, siç janë shfrytëzimi jo i mirë i maqinerisë, cilësia e dobët e punimeve, kostua e lartë etj., një nga pengesat më serioze për realizimin e planit të ndërtimit ka qenë dhe mospunuesimi me kohë i materialeve, i fuqisë punëtore dhe i kuadrit të nevojshëm për këtë sektor. Përmirësimi i punës sonë në sektorin e ndërtimeve përbën një nga detyrat tona më të rëndësishme. Organet shtetërore të ndërtimit gjatë këtij viti duhet të marrin masa serioze për ta nxjerrë sektorin e ndërtimit nga prapambetja. Nga ana e tyre organizatat tona të Frontit duhet të luftojnë më tepër për të mbështetur më shumë pushtetin për nxjerrjen në kohë dhe në numrin e duhur të fuqisë punëtore dhe të specialistëve për ndërtim.

Dhe gjashtë muaj na ndajnë nga mbarimi i vitit të fundit të pesëvjeçarit të parë. Le të bëhen këto gjashtë muaj, muaj vrulli të pashoq për punëtorët dhe për fshatarësinë tonë punonjëse që të zbatojmë me sukses dhe para afatit detyrat e planit të këtij viti dhe njëkohësisht të pesëvjeçarit të parë, që të sigurohet një mobilizim më i mirë, një organizim më i shëndoshë dhe një drejtim më konkret dhe operativ në punë për të filluar më të përgatitur planin e dytë pesëvjeçar.

V

**TË FORCOJMË DHE TË GJALLEROJMË EDHE MË SHUMË
ORGANIZATËN TONË TË MADHE TË FRONTIT
DEMOKRATIK**

Për të siguruar rezultate akoma më të mira në plotësimin e tërë këtyre detyrave të rëndësishme që na shtrohen është e domosdoshme të forcojmë dhe të gjallërojmë akoma më shumë organizatën tonë të madhe të Frontit Demokratik.

Ashtu si djc gjatë luftës dhe në vitet e pasçlirimit, ashtu dhe sot e paskëtaj organizata e Frontit Demokratik do të luajë një rol shumë të rëndësishëm në drejtim të mobilizimit të masave të gjera të popullit tonë për realizimin e programit madhështor që shtron Partia për ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë.

Partia e ka konsideruar dhe e konsideron Frontin Demokratik si një organizatë të madhe që lidh Partinë me masat e gjera të popullit dhe vetë masat e konsiderojnë Frontin Demokratik si organizatën e tyre që i lidh ato me Partinë. Partia e ka theksuar gjithnjë se Fronti është një organizatë politike që i shërben shumë çështjes së ndërtimit të socializmit. Prandaj në Kongresin II të Partisë së Punës të Shqipërisë është thënë se duhet ta gjallërojmë Frontin Demokratik dhe ta bëjmë atë një organizatë të fuqishme ashtu siç ka qenë gjatë luftës.

Disa shfaqje të nënvleftësimi, ose të mosaktivizimit të Frontit Demokratik që duken tek-tuk janë të dëmshme. Partia i ka luftuar dhe do t'i luftojë ato me

ashpërsi. Vetëm armiku ka interes që Fronti Demokratik të mos jetë i fortë, që ai të dobësohet. Lufta që armiku i jashtëm e i brendshëm i ka bërë Frontit Demokratik ka një histori të tërë, por ajo që duhet të mbahet parasysh është fakti se kjo luftë nuk ka pushuar dhe nuk do të pushojë. Mjafton të kujtojmë se gjatë fushatës së zgjedhjeve të këshillave të Frontit Demokratik dhe të pregatitjeve për kongresin tonë të tretë, zërat e ngjirura të Uashingtonit, të Londrës etj., ngritën një fushatë të tërë shpifjesh kundër Frontit Demokratik, kundër Partisë sonë të Punës dhe i ranë avazit të vjetër se Fronti Demokratik nuk është një gjë reale, por një maskë e Partisë së Punës të Shqipërisë. Këtij avazi u përpoqën t'i bien edhe miqtë e tyre këtu brenda vendit, që ngrenë veshët dhe që ja marrin të njëjtit avaz sa herë që dëgjojnë zërin e padronit të tyre. Por Fronti Demokratik është një realitet që ekziston që nga Konferenca historike e Pezës, këtu e 13 vjet më parë. Për këtë kanë pasur mjaft kohë e mjaft fakte të binden edhe armiqtë tanë. Është e kotë të merremi me shpifjet e tyre, të cilave u ka kaluar koha.

Por dua t'u drejtohem disa shokëve komunistë, të fshatrave e të qyteteve të zgjedhur në kryesitë e këshillave të Frontit dhe disa shokëve të komiteteve të Partisë, të cilët nuk e vlerësojnë sa duhet Frontin Demokratik. Të paktën ky konkluzion mund të nxirret nga përpjekjet e tyre të pamjaftueshme për ta aktivizuar e për ta gjallëruar këtë organizatë. Qëndrime të tilla nuk pajtohen me vijën e Partisë, bile janë kundër vijës së Partisë. Partia i ka sqaruar anëtarët e saj dhe masat e gjera të popullit se Fronti Demokratik përfaqëson sot

bashkimin e shtresave të gjera të popullit punonjës, të klasës punëtore, të fshatarësisë punonjëse (të varfër e të mesme), të intelektualëve, të zanatçinjve dhe të tregëtarëve të vegjël, e klerikëve patriotë se ai ka për bazë aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse dhe udhëhiqet nga Partia e Punës e Shqipërisë. Ai është pra, një aleancë punonjësish, të cilët bashkohen rreth Partisë dhe zbatojnë politikën e Partisë për ndërtimin e socializmit.

Pra është i palejueshëm çdo nënvleftësim ose mosinteresim për aktivizimin e Frontit Demokratik, sepse kështu dëmtohet rëndë Partia, dobësohet forca e saj, fuqia mbrojtëse e vendit, ecja përpara drejt socializmit, dobësohen lidhjet e Partisë me masat dhe lufta kundër elementëve kapitalistë.

Në këtë kohë kur janë likuiduar feudalët dhe borgjezia e madhe, kur bëhet një politikë kufizimi ekonomik e izolimi politik ndaj elementëve kapitalistë, dhe sidomos ndaj kulakëve, që janë klasa e fundit kapitaliste në fshat dhe në kohën kur luftohet për dërmimin e rezistencës së klasave të përmbysura, të cilat orvaten të kthejnë të kaluarën, ka një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me marrëdhënje aleance midis klasave e shtresave të ndryshme të shoqërisë sonë, të klasës punëtore që ka rolin udhëheqës, fshatarësisë punonjëse (të varfër e të mesme), të intelektualëve e zanatçinjve. Këto çështje, për të cilat ka marrëdhënje aleance në mes të këtyre klasave e shtresave, janë: mbrojtja e pavarësisë së atdheut, e fitoreve të revolucionit popullor dhe të paqes, dërmimi i orvatjeve të imperialistëve e të klasave të përmbysura për të kthyer të kaluarën, përparimi eko-

nomik, kultural e shoqëror i vendit në rrugën e socializmit. Kuptohet, pra, se kjo aleancë që shprehet në bashkimin e tyre në Frontin Demokratik ka baza të shëndosha, përfaqëson një bashkim interesash, prandaj kjo aleancë është e fortë dhe e qëndrueshme. Pra bashkimi i popullit tonë rreth Partisë sonë të Punës me Frontin Demokratik është një gjë reale.

Bashkimi i popullit tonë në Frontin Demokratik është një gjë reale edhe për arsye se ai ka tradita luftarake, pune dhe organizimi. Bashkimi i popullit tonë në Frontin Demokratik nuk u bë nga lart, me dekrete e vendime. Ai te ne nuk qe as një koalicion partish të ndryshme. Ai u krijua në luftë, atje, në qendra pune, në fshatra, në lagje, ku luftohej kundër fashizmit dhe u forcua atje ku ziente puna për rindërtimin e vendit e ndërtimin e socializmit, në luftë kundër armiqve. Për njerëzit pa parti, veçanërisht për ata të fshatit, kjo është organizata ku ata bëjnë jetën politike në formë të organizuar. Partia e Punës e Shqipërisë e krijoi dhe e organizoi Frontin Demokratik si një formë organizimi për mobilizimin e organizimin e forcave patriotike e demokratike të popullit, në luftën për çlirimin e vendit dhe vendosjen e pushtetit popullor, më vonë si organizatë luftarake për mbrojtjen e atdheut, për demokratizimin e vendit dhe për ta çuar deri në fund revolucionin popullor. Si dje në luftë, si në vitet e para të pasluftës, ashtu edhe sot Partia e Punës e Shqipërisë ka qenë dhe është forca udhëheqëse e Frontit.

Partia ka programin e saj, ajo përpunon një vijë të drejtë politike të bazuar në marksizëm-leninizmin, të cilën e zbatojnë gjithë levat e saja: këshillat popullore,

bashkimet profesionale, Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë, organizata e gruas, organizatat kooperativiste etj. Këtë politikë të Partisë zbaton edhe Fronti Demokratik, i cili, në kushtet e rendit të demokracisë popullore, vepron si një levë e Partisë që e lidh atë me masat më të gjera të popullit. Si levë e Partisë, pra, Fronti Demokratik nuk ka një program të veçantë, por zbaton programin e Partisë dhe realizon vijën e saj politike. Masat e gjera të popullit tonë që bëjnë pjesë në Frontin Demokratik e kanë parë nga eksperiencia e tyre se të gjitha fitoret që ka arritur populli ynë, janë të lidhura me Partinë tonë të Punës që është forca udhëheqëse e vendit. Dhe ato e dinë se bashkimi i tyre rreth Partisë sonë të Punës në Frontin Demokratik është vendimtar për ta çuar përpara vendin tonë në rrugën e socializmit.

Drejtimet kryesore të punës së gjithanshme të Frontit Demokratik mund t'i përmbledhim:

Së pari, Fronti Demokratik duhet të punojë për ngritjen e ndërgjegjes politike të masave për të rritur aktivitetin e tyre, pjesëmarrjen aktive të tyre në ndërtimin e socializmit.

Partia na mëson se masat janë krijuesit e historisë, ato janë forca vendimtare për ndërtimin e socializmit, prandaj edukimi politik i tyre, rritja e patriotizmit të tyre, rritja e vazhdueshme e aktivitetit dhe e inisiativës së tyre krijuese ka një rëndësi të jashtzakonshme. Është për këtë arsye që Fronti, si një organizatë e madhe politike që përmbledh në gjirin e vet tërë punonjësit e Shqipërisë, e ka këtë çështje në radhën e parë të detyrave të tija.

Dhe deri sot, nëpërmjet konferencave politike, mi-

tingjeve, bisedave, organizimit të shpërndarjes së shtypit etj., organizata e Frontit ka bërë mjaft në këtë drejtim.

Aktiviteti i Frontit ka qenë i dukshëm veçanërisht gjatë fushatave të mëdha politike, siç janë zgjedhjet e pushtetit lokal, të deputetëve për në Kuvendin Popullor, të gjyqtarëve popullorë etj. Organizata e Frontit është solidarizuar dhe ka përkrahur në mënyrë aktive të gjitha fushatat e rëndësishme politike në lidhje me mbrojtjen dhe forcimin e paqes. Kështu ato kanë kontribuar në mënyrë aktive që masat e popullit t'i përgjigjen me entuziazëm thirrjes së Këshillit Botëror të Paqes për nënshkrimin e apelit të Stokholmit ku nënshkruan 648 177 vetë si dhe thirrjes së byrosë së Këshillit Botëror të Paqes për ndalimin e armëve atomike, që u zhvillua këtë vit, dhe që u nënshkrua nga 873 047 vetë. Fronti Demokratik është solidarizuar dhe ka përkrahur në mënyrë aktive luftën dhe përpjekjet që kanë bërë dhe bëjnë popujt për mbrojtjen e paqes dhe të pavarësisë së tyre kundër agresionit imperialist. Duke u solidarizuar me luftën heroike të popullit korean, Fronti Demokratik e ndihmoi atë me veshmbathje dhe miliona lekë në fushatat e organizuara për këtë qëllim. Një rol të rëndësishëm në edukimin politik të masave dhe në mobilizimin e tyre për realizimin e planit ka dhënë organi i Frontit Demokratik, gazeta «Bashkimi».

Por akoma më shumë duhet të bëjmë në këtë drejtim. Në organizatën e Frontit vazhdimisht duhet t'u flitet anëtarëve për situatën politike. Atje në formë pyetje-përgjigjesh, në formë diskutimesh e shkëmbim mendimesh pa drojtje, të sqarohen njerëzit, të sqarohet

çdo lloj dyshimi ose gjë e paqartë që mund të ekzistojë të kushdo. Njerëzit e zgjedhur në këshillat e Frontit duhet të shkunden dhe t'u përgjigjen detyrave dhe besimit të zgjedhësve. Ata dhe çdo anëtar i Frontit, duhet ta ndjejnë për detyrë sqarimin konkret të njerëzve të Frontit, në konferenca e me agjitacion të vogël. Të evitohen konferencat formale dhe të papregatitura, e vetëm për të shkuar radhën. Këto konferenca duhet të pregatiten me kujdes, të jenë të gjalla dhe që të jenë të gjalla, konferencieri duhet patjetër t'u përgjigjet të gjitha pyetjeve që i bëhen. Për ato pyetje që ai duhet të hetojë dhe të informohet, nuk duhet t'i lërë në harresë, por në mbledhjen e ardhshme, duhet t'u çojë përgjigjen anëtarëve të Frontit. Konferencierët duhet të jenë kurdoherë të zgjuar, të mbajnë kontakte të ngushta me masën dhe t'u përgjigjen nevojave të masës, problemeve që preokupojnë masat. Të mbajnë lidhje të ngushta me deputetët e popullit, me njerëzit e pushtetit e të Partisë, për t'u transmetuar nevojat dhe sugjerimet e Frontit. Vetëm kështu Fronti do të gjallërohet, do të bëhet luftarak.

Në mënyrë të veçantë në situatën që kalojmë, Fronti Demokratik duhet të bëjë një punë të madhe me anëtarët e vet për të mbajtur gjallë traditat e Luftës nacional-çlirimtare, për të rritur shpirtin luftarak dhe gatishmërinë e popullit tonë.

T'u flitet akoma më tepër dhe akoma më konkretisht masave në mbledhjet e Frontit për Bashkimin Sovjetik, për përparimet e tij, për politikën e tij paqësore, për ndihmën që i jepet vendit tonë. T'u flitet për forcën e kampit tonë, për sukseset e tij.

Njëkohësisht, me fakte dhe shembuj konkretë të demaskohet imperializmi luftënxitës dhe shtypës i popujve.

Së dyti, Fronti Demokratik duhet të bëjë një punë të madhe për mobilizimin konkret të anëtarëve të vet në zbatimin e detyrave të mëdha që shtron Partia në lëmin e bujqësisë.

Në fshat, ku nuk ka organizata të bashkimeve profesionale dhe masat janë të grumbulluara në Frontin Demokratik, forca mobilizuese dhe organizuese e kësaj organizate duhet të rritet shumë. Shumë fakte tregojnë se atje ku problemet e bujqësisë janë bërë problem i organizatës së Frontit, atje ku ajo ka marrë drejtimin e emulacionit dhe të garave në fshat, atje ku asaj i janë besuar aksione të ndryshme, rezultatet kanë qenë shumë më të mëdha.

Organet drejtuese të Frontit në qendër, në qarqe dhe në rrethe i kanë bërë thirrje patriotizmit të fshatarësisë punonjëse për realizimin e planeve të shtetit. Më mirë, sidomos për problemet e korrjeve, të shirjeve dhe të grumbullimit si edhe për problemet e mbjelljeve, kanë punuar organizatat e Frontit në qarkun e Gjirokastrës, të Durrësit, në rrethin e Mirditës, të Koplikut, të Burrelit etj. Fronti Demokratik ka dhënë një kontribut të madh në mobilizimin e masave për punë vullnetare në aksione të ndryshme si hapje kanalesh, ndreqje rrugësh, prishje gjerdhesh, pyllëzime, zbukurime, ndreqje shkollash etj. Në konferencat e Frontit të qarqeve, që u zhvilluan kohët e fundit, u dhanë mjaft fakte të këtij aktiviteti dhe u përmendën miliona lekë të kursyera arkës së shtetit nga puna vullnetare. Kështu p.sh. në

qarkun e Beratit gjatë vitit 1954 janë prishur 191 685 metra linear gjerdhe, janë mbjellë 27 450 metra linear kallama, kurse vetëm gjatë muajve janar-shkurt të këtij viti, kur për nder të zgjedhjeve këto aksione i morën organizatat e Frontit, u bënë 23 073 metra linear sistemim agrar, u pastruan 97 167 metra linear kanale, u prishën 492 850 metra linear gjerdhe, u mbollën 46 700 metra linear kallama etj. Mbi 125 475 ditë-punë vullnetare janë bërë gjatë vitit 1954 në qarkun e Gjirokastrës duke i kursyer shtetit mbi 9 milion lekë. Në qarkun e Shkodrës në kanalet kryesore dhe në aksione të tjera janë bërë mbi 146 000 ditë-punë vullnetare duke i kursyer shtetit rreth 12 milion lekë. Në qarkun e Dibrës, gjatë vitit 1954, është bërë mjaft punë vullnetare për meremetimin e shkollave. Gjatë dy viteve të fundit rreth 550 fshatarë nga të gjitha anët e Shqipërisë kanë vizituar kryeqytetin nëpërmjet delegacioneve të organizuara nga Fronti Demokratik. Me qindra të tjerë janë dërguar në kooperativat bujqësore të rretheve të tjera, brenda qarkut e rrethit ose jashtë tyre.

Por edhe në këtë drejtim duhet përmirësuar akoma më shumë puna jonë. Organizatat e Frontit duhet të bëhen një mbështetje e shëndoshë e këshillave popullore në fshat për zgjidhjen e të gjitha detyrave ekonomike që shtrojnë përpara tyre Partia dhe qeveria. Problemi i rritjes së rendimenteve, duke kryer me kohë dhe me cilësi mbjelljet, shërbimet kulturore të bimëve industriale, shfrytëzimi i mirë i ujërave për ujitje dhe i plehrave, zgjedhja e farërave, lufta kundër firove, përhapja e rregullave agrozooteknike dhe e metodave të përparuara në bujqësi, pastrimi i kullotave, pyllëzimet etj. janë

çështje që mund të zgjidhen më shpejt dhe më lehtë në qoftë se ato bëhen problem i organizatave të Frontit.

Punonjësit e bujqësisë ndodhen tani përpara detyrash të tilla, të cilat janë vendimtare për arritjen dhe tejkalimin e rendimenteve të planifikuara. Fushata e korrjeve, e shirjeve dhe e grumbullimit të të lashtave, si dhe kryerja në kohën e duhur e me cilësi të lartë e të gjitha shërbimeve kulturele për bimët industriale dhe për misrin, kërkojnë punë të madhe dhe një organizim të përsosur të forcave të punës në çdo fshat, kooperativë bujqësore e fermë shtetërore.

Duhet të kemi parasysh se vonesat, qoftë dhe me 5-10 ditë në lidhje me korrjen e drithit, shkaktojnë dëmtime shumë të mëdha. Është vërtetuar se në qoftë se gruri i arrirë nuk korret në kohën e caktuar, një përqindje e mirë e tij vete dëm. Dhe ne duhet të themi se kësaj ane nuk i vëmë rëndësinë e duhur. Është e vërtetë se të korrat bien në një kohë kur në bujqësi kërkohet punë e madhe dhe intensive në të gjitha drejtimet si për prashitjen e pambukut e të misrit, për ujitjen e tyre, për t'u bërë shërbimet e tjera kulturele këtyre bimëve etj. Por pikërisht këtu qëndron roli organizues dhe mobilizues i Frontit në fshat që në këto momente vendimtare për bujqësinë, të dijë të organizojë në mënyrë sa më të përsosur forcat e punës në fshat. Dihet se jo të gjitha arat janë gati në një ditë për t'u korrur. Detyra e Frontit është që të organizojë ndihmën reciproke dhe punën kolektive për të korrur menjëherë dhe pa humbur kohë, tamam në kohën e saj çdo arë të fshatit. Kështu kemi për të shpëtuar me siguri mijëra kuinalë drithëra.

Desha të ndalesha pak edhe në çështjen e ujitjes së bimëve pranverore dhe sidomos të pambukut. Partia dhe qeveria kanë marrë masa të shumta për zgjerimin e mundësive për ujitjen e tokave, e sigurisht edhe në të ardhshmen do të merren mjaft masa të tjera në këtë drejtim. Por duhet thënë se në mjaft zona uji nuk po shfrytëzohet si duhet dhe ujitja nuk po e jep kudo atë rezultat që duhet të japë. Kështu ngjet p.sh. në rrethin e Myzeqesë, të Lushnjës, në Kavajë etj. Është tanimë e njohur, dhe eksperiencia e shumë bujqve të dalluar e ka treguar, se në rast se do të përdoret mirë uji, në rast se ujitja do të bëhet me kohë dhe sipas rregullave të caktuara, kjo influencon deri në rritjen 40 për qind të rendimenteve të këtyre kulturave, bile ka raste dhe shumë më tepër. Por të ujitësh arat nuk do të thotë, siç ngjet në shumë raste të ne, ta lëshosh ujin arave dhe të bësh sehir se si po e thëthnin atë toka. Një punë e tillë, punë angari dhe aspak e kujdesshme jo vetëm që nuk ndihmon në rritjen e rendimenteve, por përkundrazi influencon për keq. Duhet të punohet me fshatarët që ata të praktikojnë mënyrën e ujitjes me brazda dhe jo me përmytje, të bëhet ujitja ashtu siç mësojnë rregullat agroteknike. Kështu jo vetëm që uji nuk do të shkojë dëm dhe do të shfrytëzohet më mirë, gjë për të cilën ne kemi shumë nevojë, por edhe bimët e marrin siç duhet lagështirën, pa u dëmtuar aspak.

Pastaj, shumë fshatra as kujdesen fare për pastrimin me kohë të kanaleve ujitëse, në to rriten me shumicë barëra të këqia parazite dhe farërat e tyre duke i marrë me vete uji, i çon nëpër arat e pambukut, të misrit apo të bimëve të tjera. Kështu nga pakujdesia jonë, tok me

të mirat që u shpie uji tokave, u shpie dhe këto të këqia që i dëmtojnë bimët dhe ulin rendimentin e tyre.

Organizatrat tona të Frontit, nën udhëheqjen e Partisë, duhet të bëjnë një luftë më energjike kundër këtyre të metave. Në organizatat tona të Frontit në fshat duhet të diskutohen mirë këto çështje, të kritikohen ata bujq që nuk veprojnë mirë në këtë drejtim, të mësohen ata si duhet ta përdorin më mirë ujin dhe kjo çështje të bëhet problem i gjithë anëtarëve të Frontit, i gjithë fshatit.

Së treti, Fronti Demokratik duhet të zhvillojë një aktivitet shumë më të madh se deri tani në drejtim të tregëtisë, të arësimit, të kulturës dhe të shëndetësisë.

Çështja e përmirësimit të shërbimit të popullit. e pastërtisë në lokalet e tregëtisë, e ruajtjes së pronës së përbashkët dhe sidomos e luftës kundër vjedhjeve dhe abuzimeve, janë ndër detyrat më të rëndësishme për organet e tregëtisë. Organizatat e Frontit edhe në këtë fushë kanë detyra të rëndësishme. Duke qenë vazhdimisht në lidhje me organet e tregëtisë, masat e popullit kanë ndërhyrë e kanë korrigjuar shumë gabime dhe të meta, i kanë denoncuar shpeshherë vjedhësit dhe shpërdoruesit e pasurisë së përbashkët. Por shumë këshilla dhe kryesi të organizatave të Frontit në lagje, bloqe, fshatra, rrethe e qarqe, nuk i kushtojnë vëmendjen e duhur pjesëmarrjes aktive të të gjitha masave në luftën kundër këtyre të metave, nuk luftojnë për rritjen e vigjilencës revolucionare dhe shpeshherë, ashtu si dhe organet e tregëtisë, nuk mbajnë parasysh e nuk i dëgjojnë vërejtjet e sugjerimet e popullit. Lufta kundër vjedhësve dhe shpërdoruesve të pasurisë së përbashkët nuk mund të bëhet pa pjesëmarrjen e masave të gjera

të popullit. Detyra e organeve drejtuese, e organizatave të Frontit, e të gjitha organizatave dhe e çdo anëtar i është që të vigjlojnë vazhdimisht, të mos i nënvleftësojnë faktet e vogla, të ngrejnë zërin kur shikojnë çrregullime, shërbim të keq, papastërti, hatëre e akroballëqe, pse vetëm kështu mund të zhduken më shpejt të metat dhe mund të njihet elementi i pandërgjegjshëm dhe dallaveraxhi.

Masat që kanë marrë Partia dhe qeveria për luftën kundër analfabetizmit, për shkollat e natës, rritja e numrit të shkollave të të gjitha llojeve dhe e nxënësve që marrin pjesë në to, kujdesi i Partisë dhe i qeverisë për ruajtjen e shëndetit të popullit, për luftën kundër prapambetjes, fanatizmit dhe zakoneve prapanike, sigurojnë kushtet e domosdoshme për përparimin e vendit tonë në rrugën drejt socializmit. Organizatat e Frontit Demokratik kanë mbështetur aktivisht organet shtetërore në punën për ngritjen e nivelit kultural dhe për ruajtjen e shëndetit të popullit. Lufta kundër analfabetizmit, frekuentimi dhe përparimi i pjesëmarrësve, çështja e detyrimit shkollor, e ngritjes dhe e zbukurimit të shkollave, kanë qenë vazhdimisht edhe probleme të organizatave të Frontit. Organizatat e Frontit kanë punuar nga ana tjetër për përhapjen e rregullave higjienike dhe kanë ndihmuar në luftë kundër zakoneve prapanike dhe fanatizmit, të cilat janë rrënjësuar prej shekujsh në vendin tonë dhe kanë qenë burimi i shumë të këqijave. Organizatat e Frontit të rrethit të Mirditës e të Peshkopisë p.sh. kanë punuar më shumë për rregullin dhe pastërtinë në bancesat, ato të rretheve të Dukagjinit dhe të Pukës kanë marrë inisiativa të mira për pakë-

simin e therjeve të bagëtive në festat e ndryshme fetare, në dasma, vdekje si dhe për përfundimin e plotë të pajtimit të gjaqeve, zakone këto të cilat kanë dëmtuar shumë ekonominë dhe lumturinë familjare në këto krahina.

Por me gjithë këto aktiviteti i organizatave të Frontit në këtë drejtim është akoma i kufizuar. Ato duhet të japin gjithë ndihmën e nevojshme që brenda këtij viti të marrë fund analfabetizmi për moshat nën 40 vjeç, që të përhapet në fshat gjerësisht libri, shtypi, vallet dhe këngët popullore, që sa më shumë njerëz të ndjekin shkollat e natës, që shkollat të pajisen me të gjitha gjërat e nevojshme, të zbukurohen e të mirëmbahen, që t'u krijohen arësimitarëve kushte sa më të mira për punë e banim. Në këtë mënyrë organizatat e Frontit do të bëhen një mbështetje e fortë për pushtetin lokal në këtë punë shumë të rëndësishme. Duhet mbajtur parasysh fakti që në shumë rrethe akoma fanatizmi është një pengesë e madhe për të ecur përpara, që në disa vende gratë dalin me çarçafe e perçe, që disa prindër i pengojnë ato dhe të rejat të marrin pjesë në punët shoqërore, që shumë të tjerë besojnë në nuskat e fallet e nuk shkojnë te mjeku, që në disa fshatra jetohet akoma në papastërti e në kushte antihigjienike. Për këto probleme të rëndësishme organizatat e Frontit bëjnë pak, shpeshherë bile shembulli i vetë kryesive të Frontit nuk është në lartësinë e duhur. Organizatat tona duhet ta konsiderojnë këtë si një punë shumë të rëndësishme. Të luftojë Fronti në fshatra, sidomos për të zhdukur prapambetjen, besimet e kota dhe fanatizmin. Forca të reja, të freskëta mund të aktivizohen më gjerësisht në

qoftë se organizata jonë do të luftojë si duhet kundër këtyre të metave. Le të aktivizohen më shumë në këtë drejtim arësimitarët, të cilët duhet të bëhen përhapësit e përparimit dhe të kulturës në fshatra.

Më në fund, ne duhet të përmirësojmë punën tonë në drejtim të forcimit organizativ të organizatës sonë të Frontit Demokratik.

Natyrisht, Fronti nuk është parti dhe nuk mund të kërkohet që në të të vendosen ato rregulla organizative, ajo disiplinë dhe ai rigorozitet që ekziston në Partinë tonë. Por duhet patjetër të marrim më tepër masa për të përmirësuar funksionimin e organizatës së Frontit dhe sidomos të organizatave bazë të tij. Akoma nuk është kuptuar rëndësia e madhe që ka diskutimi i problemeve më të rëndësishme politike dhe ekonomike në organizatat bazë të Frontit Demokratik. Duke organizuar mbledhje të organizatave të Frontit për këto probleme, sidomos në fshatra e lagje, ku nuk ka organizata të bashkimeve profesionale, duke i përgatitur mirë këto mbledhje, duke siguruar në to pjesëmarrjen e gjithë anëtarëve të Frontit, burra dhe gra, duke marrë dhe duke dëgjuar mendimet dhe propozimet e tyre, kjo pa dyshim do të ketë një efekt të madh në mobilizimin e masave. Zëvendësimi i punës së gjallë me masat, me metodat administrative të drejtimit, që janë kaq të përhapura në disa organe tona të pushtetit, të Partisë e të organizatave të masave, patjetër krijon vështirësi në realizimin e detyrave të ndryshme.

Në të vërtetë në fshat bëhen shumë mbledhje, nganjëherë edhe më tepër se ç'duhet, por mbledhje të organizatës së Frontit bëhen shumë rrallë dhe shpeshherë

pjesëmarrja e grave dhe e të rejave konsiderohet si një gjë e panevojshme. Disa shokë tanë, aktivistë të Frontit, komunistë, punonjës të pushtetit, bien në pozita të disa njerëzve të prapambetur, të cilët thonë se s'ka nevojë të vejë gruaja në këto mbledhje ose të aktivizohet ajo, kur këtë punë e bën i shoqi, ose më i madhi, plaku, ose plaka e shtëpisë, ose vëllai etj. Këta njerëz nuk kuptojnë se këto mendime prapanike sjellin si rezultat të paevitueshëm mungesën e aktivizimit të një pjese të madhe të anëtarëve të Frontit, i lënë ato në gjumë, në një kohë kur më tepër se kurdoherë duhet veprimtaria e çdo qytetari pa përjashtim, kur Partia ka vënë të gjitha fuqitë e saja për ngritjen e nivelit politik, kultural e profesional të çdo punonjësi në fshat e në qytet. Kështu një nga të metat më të rëndësishme të organizatës së Frontit është se ajo akoma nuk përfshin të gjitha masat në aktivitetet e ndryshme që zhvillohen në fshat ose në lagje. Zhdukja e kësaj të mete është një nga detyrat më të rëndësishme të Frontit Demokratik në të ardhshmen.

Një dobësi tjetër që vihet re në punën e organizatave të Frontit në bazë, në rrethe e në qarqe është sektarizmi që tregohet në lidhje me lëshimin e kartave të Frontit. Nga gabimet, veprimet e padrejta dhe pakujdesia që tregohet në këtë drejtim janë lënë jashtë radhëve të organizatës sonë disa njerëz, të cilët nuk ka arësye pse të mos jenë anëtarë të Frontit Demokratik.

Duke mos i parë ngjarjet në mënyrë dialektike, në zhvillimin e tyre, disa organizata dhe organe drejtuese të Frontit nuk u japin kartat e Frontit disa njerëzve të thjeshtë, të cilët vërtet në kohën e luftës të gënjyer nga krerët tradhëtarë të vendit mbajtën qëndrim kundër

lëvizjes nacional-çlirimtare, por që në këto 10 vjet çlirimi kanë dhënë prova se janë penduar për fajin e tyre në të kaluarën dhe punojnë mirë për zbatimin e detyrave që shtrojnë Partia dhe qeveria për mbrojtjen e paqes, mbrojtjen e pavarësisë së atdheut dhe të fitoreve që janë arritur në vendin tonë për ndërtimin e socializmit. Pra, për lëshimin e kartave të Frontit, organizatat tona në bazë, në rrethe e në qarqe nuk duhet kurrsesi të shkëputin mekanikisht qëndrimin gjatë luftës nga qëndrimi pas luftës të këtyre njerëzve. Duhet të jetë e qartë se vetëm elementët që janë kundër vijës, qëllimit dhe detyrave të Frontit Demokratik, që vazhdojnë të mbajnë qëndrim armiqësor kundrejt popullit dhe pushtetit popullor, vetëm ata nuk kanë vend në radhët e Frontit Demokratik.

Duhet të luftohet me vendosmëri nga ana tjetër kundër formave të presionit që përdorin në disa raste disa njerëz, të cilët duke mos qenë të zot, ose duke e lënë pasdore punën për t'i sqaruar dhe për t'i bindur masat që të zbatojnë me ndërgjegje të plotë tërë detyrat ose planet që u shtrohen, e gjejnë më të lehtë t'i kërcënojnë njerëzit me heqjen e kartës së Frontit.

Këto metoda krejtësisht të palejueshme si dhe veprime të tjera të disa elementëve të pandërgjegjshëm që mundohen ta përdorin kartën e Frontit për të kënaqur kapriçiot dhe ambiciet e tyre, për t'u kapardisur dhe për të nxjerrë inatet personale, duhen dënuar me ashpërsinë më të madhe, duke i konsideruar, ashtu siç janë me të vërtetë, veprime që i shërbejnë vetëm armikut. Në asnjë mënyrë nuk duhet lejuar që t'u hiqen disa njerëzve kartat e Frontit, sepse siç thuhet «janë kokëfortë» apo «egoistë» apo «pinë raki» etj. Zakonisht në më të

shumtën e rasteve, prapa këtyre «arësytetimeve» fshihen dallaveret, ambiciet personale.

Organizatrat tona të Frontit duhet ta kenë të qartë mirë se çështja e kartave të Frontit ka një rëndësi shumë të madhe si për organizatën ashtu dhe për çdo anëtar, prandaj në këtë çështje nuk duhet të lejohen gabime dhe shtrembërime. Të zbatohet plotësisht udhëzimi i dhënë nga Këshilli i Përgjithshëm i Frontit Demokratik që çështjet e anëtarësisë, dhënja ose heqja e kartës së Frontit anëtarëve të tij, të gjykohet me kujdesin më të madh nga mbledhja e përgjithshme e organizatës së Frontit në fshat ose në lagje. Të gjykohet kështu çdo rast nga vetë populli — gjykatësi më i mirë për çdo gjë. Eksperienca e kohëve të fundit ka treguar se duke vepruar në këtë mënyrë janë ndrequr mjaft gabime dhe u është vënë fre dallavereve dhe padrejtësive në këtë drejtim.

Këshillat e Frontit në fshatra, bloqe, lagje, në rrethe e qarqe duhet të aktivizohen më shumë, duhet ta kuptojnë më mirë përgjegjësinë që u kanë ngarkuar zgjedhësit, sepse nga ata varet shumë aktivizimi i organizatave të Frontit në të gjitha problemet që u thanë më sipër. Organizatat e Partisë duhet të vënë para përgjegjësisë dhe të mbajnë qëndrim kundrejt atyre komunistëve që japin shembullin e keq në këtë drejtim, sepse njerëz të tillë nuk janë në rregull me zbatimin e vijës së Partisë.

Zgjedhjet e fundit në organizatën e Frontit ishin një masë e rëndësishme për përmirësimin e punës së organizatës. Ato treguan nga ana tjetër forcën e madhe të kësaj organizate dhe aftësitë që ka ajo për plotësimin me

sukses të detyrave që i ngarkon Partia. Pothuajse kudo zgjedhjet mobilizuan masat e popullit në aksione konkrete ekonomike, u organizuan për këtë qëllim gara midis shumë fshatrave, rretheve e qarqeve, u arritën nga kjo punë rezultate të rëndësishme. Anëtarët e Frontit kanë marrë pjesë aktive në diskutimin e raporteve, kanë bërë një numër të madh vërejtjesh e sugjerimesh rreth tyre si dhe rreth punës së organeve të pushtetit lokal, kanë kritikuar dobësitë në punën e këshillave dhe të kryesive të Frontit dhe kanë zëvendësuar me njerëz të tjerë më të aftë e më aktivë ata që nuk kishin punuar mirë. Në këshillat dhe kryesitë e Frontit kanë dalë njerëz nga më të mirët të të gjitha profesioneve dhe që përfaqësojnë plotësisht të gjitha shtresat e ndryshme të popullit. Kështu në 3 077 këshilla fshatrash, bloqesh, lagjesh, rrethesh dhe qarqesh janë zgjedhur gjithsej 17 404 anëtarë. Nga këta 13 223 (76,3 për qind) janë fshatarë; 943 (5,4 për qind) janë punëtorë; 2 251 (12,9 për qind) janë nëpunës; 239 (1,3 për qind) janë zanatçinj; 35 (0,2 për qind) janë tregëtarë të vegjël privatë; 1 802 (10,3 për qind) janë gra dhe 3 614 (20,7 për qind) janë të rinj e të reja. Nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të zgjedhur, 4 399 (25,3 për qind) janë anëtarë dhe kandidatë partie dhe 13 005 (74,7 për qind) janë pa parti. Sikurse shihet organizata e Frontit Demokratik ka një forcë të madhe, një numër të konsiderueshëm aktivistësh mbi të cilët duhet të mbështetet dhe po të drejtohen mirë ata janë në gjendje ta shpien shumë përpara punën e organizatës sonë. Por në këtë drejtim duhet të punojë më mirë dhe Këshilli i Përgjithshëm që do të zgjedhim në këtë kongres. Këshilli i Përgjithshëm që është sot ka ngritur

para organizatave të Frontit probleme të rëndësishme politike dhe ekonomike, si zgjedhjet e pushtetit, të gjyqtarëve, probleme të bujqësisë (mbjellje, korrje, shirje etj.). Ai u ka drejtuar thirrje masave të popullit dhe ato janë mobilizuar me entuziazëm për kryerjen e këtyre detyrave. Por megjithatë Këshilli i Përgjithshëm dhe kryesia e tij mund dhe duhet të kishin punuar edhe më mirë për aktivizimin e organizatës së Frontit. Anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm duhet të ishin aktivizuar më shumë, mbledhjet duhet të ishin bërë më në rregull dhe bazës duhej t'i jepej një ndihmë e madhe. Duhet thënë se edhe aparati i Frontit në qendër, rrethe dhe qarqe, ashtu siç ka qenë i organizuar deri sot, ka penguar përmirësimin e punës së organeve të zgjedhura, prandaj puna dhe organizimi i tij duhen rishikuar.



Fronti Demokratik, nën udhëheqjen e Partisë është bërë një organizatë luftarake, e cila bashkon masat e gjera të popullit tonë, të qytetit dhe të fshatit, në luftën e lavdishme për mbrojtjen e paqes, të lirisë dhe të pavarësisë së atdheut. Kongresi i tretë i Frontit do të forcojë akoma më tepër organizatën tonë të madhe, do t'i tregojë më qartë detyrat për të ardhshmen dhe do ta bëjë atë një mbështetje akoma më të fuqishme të Partisë dhe të pushtetit popullor në luftën për ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Të armatosur nga ky kongres le të vëmë të gjitha forcat për lulëzimin e mëtejshëm

të atdheut tonë, për realizimin e planit të shtetit, le të shtojmë akoma më tepër dashurinë dhe besnikërinë për mikun dhe mbrojtësin tonë, udhëheqësin e kampit të socializmit e të paqes, Bashkimin Sovjetik, le të forcojmë edhe më shumë urrejtjen për armikun e betuar të popullit tonë imperializmin amerikano-anglez, le të forcojmë pa pushim unitetin e çelniktë të popullit rreth Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore!

Rroftë populli shqiptar, trim, punëtor e paqedashës!

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë, organizatorja e të gjitha fitoreve të popullit tonë!

Rroftë organizata e madhe e popullit shqiptar, Fronti Demokratik i Shqipërisë!

Rroftë miqësia dhe aleanca me popujt vëllezër të kampit të socializmit e të paqes!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 145 (2098), 18 qershor 1955

Botohet me disa shkurtime sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

L E N D A

PARATHËNJE PËR VËLLIMIN 12 V—VII

1954

- TË RRITET MË SHUMË KUJDESI PËR KULTURËN
E PAMBUKUT — Nga diskutimi në mbledhjen e Se-
kretariatit të KQ të PPSH (7 shtator 1954) 1—8
- NGA FJALA NË PRITJEN E DIENË NGA AMBA-
SADA BULLGARE ME RASTIN E FESTËS KOMBË-
TARE TË RP TË BULLGARISË (9 shtator 1954) 9—12
- TELEGRAM PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR KON-
GRESIT IV TË PK TË BRAZILIT (20 shtator 1954) .. 13—14
- DISA VËREJTJE MBI ÇMIMET DHE STIMULACIO-
NET E PRODHIMEVE BUJQËSORE E BLEGTORALE
— Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ
të PPSH (21 shtator 1954) 15—20
- LETËR DREJTUAR KQ TË PK TË KINËS ME ANËN
E SË CILËS I SHPREH ATIJ KËNAQËSINË PËR
DËRGIMIN E AMBASADORIT TË PARË KINEZ NË
VENDIN TONË (21 shtator 1954) 21—23
- PËRSHËNDETJE DËRGUAR SHOKUT MARSEL
KASHEN ME RASTIN E 85-VJETORIT TË DITË-
LINDJES SË TIJ (21 shtator 1954) 24—25
- MBI PËRSOSJEN E MËTEJSHME TË METODËS SË

PUNËS SË PARTISË NË FSHAT — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (22 shtator 1954).	26—33
TË ZHVILLOJMË TË GJITHA LLOJET E SPORTIT DHE JO VETËM FUTBOLLIN — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (22 shtator 1954)	34—37
TË PËRMIRËSOJMË MË TEJ PUNËN E ORGANEVE TË DREJTËSISË — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (28 shtator 1954)	38—43
ZBATIMI I VENDIMIT KËRKON EDHE INISIATIVË E VETËVEPRIM — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (28 shtator 1954)	44—50
MBI DISA DETYRA QË I DALIN PËR TË ARDHSHMEN SEKTORIT TË TREGËTISË PËR NJË FURNIZIM MË TË MIRË TË POPULLIT — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (29 shtator 1954)	51—57
NGA FJALA E MBAJTUR NË PRITJEN E DHËNË NGA AMBASADA KINEZE NË TIRANË ME RASTIN E 5-VJETORIT TË THEMELIMIT TË RP TË KINËS (1 tetor 1954)	58—63
LETËR DËRGUAR KQ TË PPB TË POLONISË ME ANË TË SË CILËS KËRKON QË MARRËDHËNJET TREGËTARE MIDIS DY VENDEVE TË VIHEN MBI BAZA MË PARIMORE SI DHE AKORDIMIN E NJË KREDIE (6 tetor 1954)	64—73
TË REVOLUCIONARIZOJMË MË TEJ PUNËN E FORUMEVE TË BASHKËMEVE PROFESIONALE — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (13 tetor 1954)	74—77
TË FORCOJMË MË SHUMË PUNËN E PARTISË NË KOOPERATIVAT BUJQËSORE — Nga diskutimi në	

mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (13 tetor 1954)	78—83.
TELEGRAM PËRSHËNDETJEJE DREJTUAR KQ TË PK TË SPANJËS (18 tetor 1954)	84—85.
TË MBROJMË PRONËN SOCIALISTE — Nga disku- tими në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (21 tetor 1954)	86—88.
TË PLANIFIKOHET DREJT MARRJA DHE SHFRY- TËZIMI I KREDIVE — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (21 tetor 1954)	89—91.
PËR DEMOKRATIZIMIN E MËTEJSHËM TË KËSHI- LLAVE POPULLORE — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (28 tetor 1954)	92—96.
TË FORCOJMË MË SHUMË DREJTIMIN NË ÇËSH- TJET E BUJQËSISË — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (29 tetor 1954)	97—102.
TË KUJDESEMI MË SHUMË PËR PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË PUNËS DHE TË JETËS SË PUNË- TORËVE — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (29 tetor 1954)	103—108.
KUNDËR FRAZELOGJISË NË FAQET E SHYTYPIT TONË — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (5 nëntor 1954)	109—111.
MBI DISA MASA PËR REALIZIMIN E PLANIT DHE PËR FURNIZIMIN E POPULLIT NË STINËN E DIM- RIT — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (18 nëntor 1954)	112—116.
LETËR DËRGUAR KOMPOZITORIT KRISTO KONO KU E URON PËR OPERETËN E PARË SHQIPTARE «AGIMI» (20 nëntor 1954)	117—118.
10-VJETORI I ÇLIRIMIT TË SHQIPËRISË, FESTA	

E MADHE KOMBËTARE E POPULLIT SHQIPTAR (28 nëntor 1954)	119—126
FJALA E MBAJTUR NË MBLEDHJEN SOLEMNE ME RASTIN E 10-VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË ATDHEUT (28 nëntor 1954)	127—181
FJALA E MBAJTUR NË PRITJEN E DHËNË PËR NDER TË DELEGACIONIT QEVERTAR KINEZ QË KA ARDHUR NË VENDIN TONË ME RASTIN E 10-VJETORIT TË ÇLIRIMIT (Nëntor 1954)	182—185
PËRGJEGJE LETRËS SË SHOKUT LI HSIEN NIEN KU FALENDERON POPULLIN KINEZ PËR DHU- RATAT QË I KA DËRGUAR POPULLIT TONË (2 dhjetor 1954)	186—188
TELEGRAM DREJTUAR KQ TË PK TË KINËS ME TË CILIN E FALENDERON PËR URIMET E DËRGU- ARA ME RASTIN E 10-VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË VENDIT TONË (4 dhjetor 1954)	189—190
MBI DISA DETYRA PËR FORCIMIN E PUNËS NË SMT — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (17 dhjetor 1954)	191—195
PËR FORCIMIN E MËTEJSHIËM TË PUNËS SË PAR- TISË E TË KOMANDËS UNIKE NË USHTRI — Dis- kutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (21 dhjetor 1954)	196—205
SHËNIM NË LIBRIN E PËRSHTYPJEVE TË MUZEU- MIT TË SHKODRËS (29 dhjetor 1954)	206—207

1955

FJALA E MBAJTUR NË KONGRESIN E KATËRT TË BASHKIMEVE PROFESIONALE TË SHQIPËRISË (11 shkurt 1955)	208—232
---	---------

- KOMUNISTËT NË BAZË DUHET TË LUFTOJNË MË SHUMË PËR TË ZGJIDHUR VETË PROBLEMET — Nga biseda në takimin me zëvendëssekretarin e organizatës bazë të Partisë dhe kryetarin e komitetit profesional të NBSH-së «Irakli Terova» Korçë (15 shkurt 1955) 233—236
- VENDIMET E PARTISË DUHET TË UDHËHEQIN ÇDO DITË DHE ÇDO ORË GJITHË VEPRIMTARINË E ORGANEVE TË PUNËVE TË BRENDSHME — Nga fjala e mbajtur në mbledhjen e kuadrove kryesorë të Ministrisë së Punëve të Brendshme (4 mars 1955) 237—248
- TELEGRAM URIMI DËRGUAR SEKRETARIT TË PARË TË PARTISË SË PUNONJËSVE TË HUNGARISË, MATIAS RAKOSHI, ME RASTIN E 10-VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË REPUBLIKËS POPULLORE TË HUNGARISË (30 mars 1955) 249—250
- LENINIZMI — BURIM I PASHTERSHËM I FITORREVE TË POPULLIT SHQIPTAR (22 prill 1955) 251—266
- FJALA E MBYLLJES NË PLENUMIN XIII TË KQ TË PPSH «MBI PUNËN IDEOLOGJIKE TË PARTISË DHE MASAT PËR PËRMIRËSIMIN E SAJ» (27 prill 1955) 267—317
- NGA BISEDA NË TAKIMIN ME NJË DELEGACION GRASH QË MORËN PJESË NË KONFERENCËN KOMBËTARE TË NËNAVE (10 maj 1955) 318—323
- TELEGRAM PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR SHOKUT HO SHI MIN ME RASTIN E 65-VJETORIT TË DITË-LINDJES SË TIJ (18 maj 1955) 324
- FJALA E MBAJTUR NË MBLEDHJEN E JASHTZAKONSHME TË KUVENDIT POPULLOR MBI RATIFIKIMIN E TRAKTATIT TË VARSHAVËS (28 maj 1955) 325—334

MBI GABIMET E TUK JAKOVËS — Raport i mbajtur në emër të Byrosë Politike në Plenumin XIV të KQ të PPSH (15 qershor 1955)	335—377
FJALA E MBYLLJES NË PLENUMIN XIV TË KQ TË PPSH «MBI VEPRIMTARINË ANTIPARTI DHE ARMIQËSORE TË TUK JAKOVËS DHE TË BEDRI SPAHIUT» (17 qershor 1955)	378—392
RAPORT «MBI AKTIVITETIN E KËSHILLIT TË PËRGJITHSHËM DHE DETYRAT E MËTEJSHME TË FRONTIT DEMOKRATIK» — Mbajtur në Kongresin e tretë të Frontit Demokratik të Shqipërisë (17 qershor 1955)	393—493

I

ORGANIZATA JONË E FRONTIT, E KRIJUAR DHE E UDHËHEQUR NGA PARTIA KOMUNISTE E SHQIPËRISË, KA LUAJTUR NJË ROL TË MADH NË KURORËZIMIN ME SUKSES TË LUFTËS NACIONAL-ÇLIRIMTARE	397—409
---	---------

Lufta nacional-çlirimtare qe një revolucion antiimperialist, demokratik-popullor i udhëhequr nga Partia Komuniste	401
---	-----

II

PAS FITORES HISTORIKE TË 29 NËNTORIT 1944, REVOLUCIONI YNË U ZHVILLUA PA NDËRPRERJE NGA NJË REVOLUCION ANTIMPERIALIST DEMOKRATIK NË REVOLUCION SOCIALIST	410—426
Përparime dhe perspektiva të mëdha në	

zhvillimin e ekonomisë sonë popullore në rrugën e socializmit	420
---	-----

III

<i>GJENDJA NDËRKOMBËTARE NË TË CILËN ZHVILLOHET REVOLUCIONI YNË SOCIALIST. POLITIKA JONË E JASHTME</i>	426—451
--	---------

Populli ynë nuk do të harrojë kurrë se përdërisa të ekzistojë imperializmi s'duhet ta dlobësojë as për një çast vigjilencën revolucionare	441
---	-----

IV

<i>MASAT PUNONJËSE TË VENDIT NËN UDHEHEQJEN E PARTISË KANË PUNUAR ME VETËMOHIM DHE ENTUZIAZËM PËR TË REALIZUAR DETYRAT E MËDHA QË SHITROI PËRPARA TYRE PLANI I PARË PESËVJEÇAR</i>	452—472
--	---------

Për Partinë tonë të Punës dhe për Qeverinë e RP të Shqipërisë përmirësimi i kushteve të jetesës materiale e kulture të punonjësve përbën ligjin më të lartë	439
---	-----

Vendi ynë gjatë planit të dytë pesëvjeçar do të ecë shumë përpara në rrugën e ndërtimit të socializmit	464
--	-----

V

<i>TË FORCOJMË DHE TË GJALLËROJMË EDHE MË SHUMË ORGANIZATËN TONË TË MADHE TË FRONTIT DEMOKRATIK</i>	473—493
---	---------